

ENVER HOXHA

VEPRA

4

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTONET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

V ELLIMI

4

JANAR 1947 - DHJETOR 1948

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

“IRANË, 1970

PARATHËNJE PËR VËLLIMIN 4

Veprat e viteve 1947 e 1948 përfshihen në dy vëllime, në të 4-tin e të 5-tin.

Në vëllimin e 4-të hyjnë fjalime, mesazhe, artikuj e biseda, kurse në vëllimin e 5-të do të përfshihen raporti në Kongresin I të PKSH dhe materiale të tjera të kësaj periudhe, që kanë lidhje me shkatërrimin e ndërhyrjes armiqësore të revizionistëve jugosllavë dhe demaskimin e veprimtarisë së grupit antiparti dhe të agjenturës jugosllave në PKSH.

Në veprat që përfshihen në vëllimin e 4-të pasqyrohet lufta e Partisë dhe përpjekjet e saj për të forcuar bazën politike të rendit të ri të demokracisë populllore në Shqipëri, për të shkatërruar bazën ekonomike të kapitalizmit dhe për të krijuar bazën ekonomike të socializmit.

Në këtë vëllim del qartë kujdesi i madh i Partisë për forcimin dhe përsosjen e pushtetit popullor, lufta e saj për ruajtjen e fitoreve të revolucionit, për shkatërrimin e qendresës së klasave të përmbysurë dhe për shpartallimin e planeve e të orvatjeve të imperializmit kundër Republikës Populllore të Shqipërisë, del lufta për fitoren e të drejtave të RPSH në fushën ndërkombëtare.

Aty dalin përpjekjet e gjithanshme të PKSH për

kapërcimin e vështirësive ekonomike në fushën e prodhimit dhe të plotësimit të nevojave të ngutshme të masave punonjëse, për forcimin e zgjerimin e pronës socialiste, për organizimin socialist të ekonomisë dhe zhvillimin e planifikuar të saj. Del kujdesi i Partisë për mënjanimin e prapambetjes së madhe kulturale të trashëguar nga e kaluara dhe orientimet kryesore për zhvillimin e revolucionit në fushën e arësimit e të kulturës dhe për edukimin revolucionar të masave punonjëse në përputhje me kushtet e reja që krijoj revolucioni populor.

Në veprat e këtij vëllimi del në pah qëndrimi revolucionar i Partisë në politikën e saj të jashtme, vendosmëria e saj për të mbrojtur dhe për të zbatuar parimin marksist-leninist të internacionalizmit proletar, duke forcuar e zgjeruar marrëdhënjet e miqësisë dhe të bashkëpunimit me Bashkimin Sovjetik si dhe me vendet e tjera që kishin hyrë në rrugën e zhvillimit socialist, duke përkrahur në mënyrë aktive luftën e klasës punëtore dhe të popujve të shtypur kundër borgjezisë imperialiste.

Këto vepra dhe në mënyrë të vecantë fjalimet e shokut Enver Hoxha, mbajtur në disa krahina në Jug të Shqipërisë, janë një dëshmi e qartë e vlerësimit të lartë që i ka bërë vazhdimisht Partia rolit historik të masave dhe lidhjeve të ngushta dhe të përhershme me to, janë dëshmi e kujdesit për rritjen dhe forcimin e organizatave të masave si nyje të fuqishme që lidhin Partinë me masat popullore dhe çojnë në to politikën e saj.

Veprat e këtij vëllimi janë shkruar në një kohë

tepër të ndërlikuar, kur udhëheqja revizioniste jugosllave ndërhynë në mënyrë brutale në punët e brendshme të Partisë sonë dhe ushtronte presione të gjithanshme mbi të. Me gjithë këto ndërhyrje dhe presione, këto vepra flasin për luftën konsekutive të PKSH në zbatimin revolucionar dhe mbrojtjen e parimeve të mark-sizëm-leninizmit. Mbrojtja e këtyre parimeve në ato kushte ishte pjesë përbërëse e luftës së vendosur që zhvillonte Partia dhe personalisht shoku Enver Hoxha kundër ndërhyrjes dhe politikës revizioniste të udhëheqjes jugosllave, luftë e cila del në pah me tërë madhështinë e saj në dokumentat e tjera të Partisë dhe në veprat e shokut Enver Hoxha që do të përfshihen në vëllimin e 5-të.

NGA BISEDA ME UDHËHEQËSIT E REDAKSИSE «PIONIERI» SI DHE ME NJË GRUP PIONIERËSH

3 janar 1947

PYETJE E PJESEMARRËSVE: Si ju duket gazeta «Pionieri», shoku Komandant? ¹

SHOKU ENVER: E mirë është, por mund të bëhet edhe më e mirë.

Shumë gjëra mund të shkruhen edhe më thjeshtë. Ju duhet të jeni në kontakt të ngushtë me të gjithë pionierët, sepse po të keni lidhje drejtpërdrejt me jetën e tyre, do të dalin artikuj më të mirë e që do të kuptohen më lehtë nga lexuesit tuaj të vegjël.

Në gazeten «Pionieri» duhet të shkruani që të nxitni pionierët të mësojnë më mirë. Bile jo vetëm pionierët, por edhe drejtuesit. Mua më kanë thënë se ata që edukojnë pionierët mësojnë më pak, sepse ata punojnë vazhdimisht dhe duke punuar shumë, lënë pas dore mësimet dhe në shkollë janë të dobët. Kjo nuk është e mirë.

¹ Me emrin «Komandant» partizanët dhe populli thërrisnin shokun Enver Hoxha gjatë periudhës së Luftës nacional-çlirimtare si udhëheqës kryesor i saj. Po kështu vazhdoi të thërritej me intimitet e dashuri edhe pas çlirimtit të vendit.

Në gazetën tuaj duhet të shkruhet konkretisht për jetën e pionierëve, të vini në dukje ata që mësojnë më mirë dhe metodën se si ata mësojnë. Tani të gjithë ju jeni nxënësa dhe mund të shihni më konkretisht jetën e shkollës. Duhen tregime që t'u japin me kuptue pionierëve se si të mësojnë.

Pionierëve duhet t'u fusim dashurinë për shkollën, për familjen dhe t'i lidhim me jetën, por kjo duhet bërë në mënyrë të thjeshtë. Të luftohen veset e këqia: vjedhja, rrëna; këto duhen zhdukur nga pionierët tanë.

Programin duhet ta bazoni në jetën e vërtetë të pionierëve e në gjërat që u interesojnë.

Nuk duhet të ngjasë, siç ngjet në disa organizata, ku bëhen konferenca të kota, ku zgjaten me orë pa folur konkretisht mbi problemet që interesojnë njerëzit dhe këta i zë gjumi. Edhe për këto gjëra duhen bërë artikuj e duhen kritikuar.

PYETJE E PJESEMARRËSVE: Si ju është dukur mënyra e të shtruarit të situatës?

SHOKU ENVER: Mirë, mirë, po gjatë. Ka pasur numra, ku tri të katërtat janë politikë. Edukimin politik ju mund ta shtroni në shumë mënyra më të përshtatshme.

PYETJE E PJESEMARRËSVE: Si ju duket puna që ka bërë gazeta «Pionieri» kundër paragjykimeve fetare?

SHOKU ENVER: Artikuj të tillë ka pasë. Paragjykimet duhen luftuar, por duhet të kemi parasysh një gjë: Të moshuarit i besojnë këto gjëra. Nga ata influen-cohen edhe kalamanët. Ato janë në kundërshtim me shkencën. Të punojmë, por me sistem e takt, pa u grindur sa dhe jeta në familje të bëhet e padurueshme.

Duhet që fëmijët të influencohen më shumë nga ne se sa nga pleqtë dhe t'ua hapin sytë këtyre. Të kaluarve nga mosha është zor t'u ndrrohet mendja menjëherë.

Artikujt mbi këto gjëra duhen shkruar me shumë kujdes.

Pastaj shoku Enver pyeti: Cili është mendimi juaj, a mësojnë pionierët?

PËRGJEGJE E PJESEMARRËSVE: Në përgjithësi mësojnë më mirë se përpara. Numri i atyre që kalojnë është shtuar, është shtuar gjithashtu numri i atyre që marrin nota të mira. Por ka edhe nga ata që nuk kanë mundësi të mësojnë, sepse s'kanë konditat e duhura. Këtyre u vijnë në ndihmë edhe rrethet që kanë filluar të organizohen në shkolla.

SHOKU ENVER: Pionierët duhet të mësojnë shumë, sepse shkolla u jep dituri. Për këtë punë duhet të përpinqen të gjithë: organizata, gazeta dhe pushteti. Duhen ndihmuar pionierët duke formuar grupe studimi. Konditat ekonomike luajnë rol për të mësuar. Ka shumë kondita të ndryshme. Ka shumë pionierë që nuk janë në gjendje ekonomike të mirë. Edhe këtu duhet me ndihmue. Do të ngrejmë edhe salla leximi, ku të vobektit të vijnë të preqatitin mësimet. Këtu duhet t'i kenë të gjitha konditat e mira, të jetë ngrohët dhe të ketë libra.

A shkruajnë pionierët në gazetë? — Pyeti përsëri shoku Enver.

PËRGJEGJE E PJESEMARRËSVE: Tani nuk vijnë edhe aq shkrime. Me sa duket i shkruajnë në gazetat e murit.

SHOKU ENVER: Po, tamam nga gazetat e murit duhet t'i merrni ju artikujt.

NJË PJESEMARRËS: Pionierët nuk janë shumë afër gazetës, ndruhen, nuk kanë guxim të shkruajnë, kanë frikë se nuk u botohen.

SHOKU ENVER: Jo, nuk duhet menduar kështu. Ju provoni një herë, provoni dy herë, gjersa t'ju bota-
hen. Pionierët duhet të shkruajnë shumë në gazetën e tyre.

Gazeta duhet ta ndihmojë sa më shumë organizatën, që të jetë e lidhur ngushtë me jetën e pionierëve dhe me punët që u interesojnë këtyre. Nga ana tjetër organizata duhet të bëjë që gazetën ta lexojnë të gjithë.

Duke biseduar për organizatën, shoku Enver tha:

«Pionierëve u duhet futur në shpirt ndjenja e organizimit, e disiplinës dhe e punës. Rinia duhet të tre-
gojë kujdes më të madh, siç do të bëjë edhe pushteti. Ajo duhet të kujdeset shumë për edukimin e pionierëve. Duhet që organizata e pionierit t'i ndihmojë nxënësit në shkollë e të lidhet më mirë me pionierët. Ajo do t'ja dalë qëllimit vetëm duke punuar tamam për jetën e pionierëve.

Për shembull, çfarë ndihme u është dhënë tani pionierëve të varfër?» — Pyeti shoku Enver.

PËRGJEGJE E PJESEMARRËSVE: Me rastin e Viti
tit të ri organizata ka shpërndarë dhurata. Ne kemi
marrë emrat e pionierëve të varfër. Ata do t'i ndihmojë
pushteti.

Ku është më e fortë organizata? — Pyeti përsëri
shoku Enver.

PËRGJEGJE E PJESEMARRËSVE: Në Tiranë.

SHOKU ENVER: Ah, këta tiranasit! Të gjithë duan të mburrin vendin e tyre. Mua më kanë thënë se më e fortë është ajo e Gjirokastrës. (Qeshje).

Sa pionierë ka Tirana? — Pyeti pastaj shoku Enver.

PËRGJEGJE E PJESEMARRËSVE: 2 500. Më përpara ka pasë më tepër, por tani është bërë diferencimi, janë duke u zgjedhur më të mirët dhe mbetet për të punuar.

SHOKU ENVER: Pak ka. Po si është bërë diferencimi? Mua më kanë thënë se një pionier, që shkonte shumë mirë me mësimë dhe ishte biri i një tradhëtarë, e përjashtuan nga organizata. Dhe ai qante për ditë. Këta fëmijë s'duhet të përbuzen e të lihen mënjanë. Ka familje, që nuk u pëlqen situata e re e sotme, por pionierët nuk ua venë veshin fort, më të shumtët qëndrojnë mirë. Gjëra të këtilla, si kjo që ju tregova, nuk duhet të ngjasin në asnje mënyrë dhe duhet pasur kujdes të madh për këta fëmijë.

Pastaj, duke folur për shtëpitë e pionierëve, shoku Enver tha:

«Shtëpitë e pionierit duhet të ngrihen kudo. Mos të bëhen pengesë mungesat që ka vendi, sepse një sallë me një dy zyra është mjaft për një shtëpi pionieri dhe këto duhet t'jua gjejnë. Pastaj edhe mobiljet e gjérat e tjera do t'i plotësojmë pak nga pak. Ju kërkonit ato që ju duhen dhe ne do t'ju japim të gjitha gjérat e nevojshme».

Shoku Enver tregoi kujdes shumë të madh për zhvillimin e fiskulturës. Ndërmjet të tjerash ai tha:

«Në të rinjtë ka akoma shumë që e quajnë gjimnastikën angari, por përfat të mirë në pionierët nuk është kështu, prandaj është më e lehtë që të organizohet sporti.

Fushat ku luajnë pionierët duhen organizuar më mirë, kudo duhen bërë fusha sportive, ku pionierët të bëjnë gjimnastikë e të luajnë. Udhëheqësit të shkojnë ndër këto fusha dhe të drejtojnë çdo gjë me kujdes të madh, që të vegjelëve mos t'u ngjasë gjë e keqe. Edhe pushteti do të japë ndihmë për ndërtimin e fushave sportive. Pastaj duhet zhvilluar në të vegjëlit ndjenja e shetitjeve dhe e ekskursioneve që ndihmojnë edhe në afrimin midis pionierëve të qytetit e pionierëve të fshatit.

Unë mbaj mënd që, kur ishim të vegjël, shëtitjet ishin gëzimi më i madh për ne. Besoj që edhe sot kështu është. Edukata sportive ka një rëndësi të madhe dhe ju duhet të shkruani më shumë për të.

Përveç kësaj për shëndetin dhe dëfrimin e fëmijëve, këtë verë ne do të hapim shumë kampe. Gjendja ekonomike e vendit përmirësohet vazhdimesht dhe kështu shtohet mundësia për të hapur kampe. Organizatës i bie barra që t'i organizojë mirë këto dhe të bëhet shumë punë për edukimin. Kur pionierët të mësojnë mirë gjatë vittit, kanë të drejtë të plotë që verës të dëfrehen. Shteti do t'u sigurojë fëmijëve mundësitet e dëfrimit».

Shoku Enver, pasi foli për rëndësinë e letërsisë e të folklorit, tha:

«Duhet të botoni edhe më shumë krijime të folklorit që kështu pionierët të njojin mirë shpirtin e popullit tonë. Zgjidhni folklor të Luftës nacional-çlirimtare si dhe folklor të kryengritjeve që ka bërë populli kundër feudalëve, sepse këtu duket më mirë trimëria e popullit dhe dëshira e tij për liri.

Pionierët duhet të dinë mbi heroizmat e shokëve tanë, të marrin shembull nga këta.

Për dëshmorët duhet shkruar më dendur, por jo vetëm për kryesorët. Ka shumë trima që janë vrarë, katundarë e punëtorë të thjeshtë. Duhet mbajtur gjallë fryma e patriotizmit me fakte konkrete. Duhet t'i mbildhni këngët që këndon populli për ta e t'i botoni. Pionierët duhet të shkruajnë vjersha për këta dëshmorë, por vjersha mos të jetë e përgjithshme, të shkruhet për një dëshmor të caktuar, ç'ka qenë e si është vrarë ai. Ju duhet t'i drejtoni pionierët kur të shkruajnë».

Duke biseduar për ngritjen kulturale të redakto-rëve, shoku Enver porositi që të studjojnë veprat e shkrimitarëve dhe të artistëve të huaj që kanë zotësi dhe janë progresistë.

«Ju duhet të bëni që t'ua përkthejnë revistat e pionierëve të Bashkimit Sovjetik. Të përfitoni nga eksperiencia e tyre, se pak a shumë ata kanë një kohë të gjatë dhe kanë bërë më shumë përparime. Duhet të shikoni si i zhvillojnë temat ata e të zgjidhni ato që i përshtaten konditave tona shoqërore dhe politike e t'i adaptoni. Eksperiencia e tyre u shërben gjithë njerëzve për të mësuar shumë gjëra. Ne përpinqemi t'u japim një zgjidhje problemeve. Këto probleme i kanë zgjidhur të tjerët përpara nesh. Duhet pra të përfitoni nga pionierët e Bashkimit Sovjetik. Organizata e rinisë duhet të organizojë kurse të veçanta për kuadrin. Këta kuadro lypsen jo vetëm për punë kulturale, por edhe për punë të organizatës.

Gazeta «Pionieri» duhet të dalë me vizatime të bukura, me më shumë bojra».

PJESEMARRËSIT: Ne s'kemi njerëz që të na bëjnë të tilla vizatime.

SHOKU ENVER: Ja pra, këtu lypset kuadri. Duhet t'u mësoni atyre që kanë talent për pikturë si bëhen vizatime për gazetën tuaj dhe t'i merrni në redaksi.

PYETJE E PJESEMARRËSVE: A e keni dëgjuar «Orën e Pionierit» shoku Komandant?

SHOKU ENVER: E kam dëgjuar. Është organizuar mjaft mirë. Por për «Orën e Pionierit» duhet të ndihmojnë shumë të mëdhenjt, aktorët e teatrit të shtetit, artistët e të tjerë. Edhe «Ora e Pionierit» duhet të punojë po në drejtimin e gazetës.

PJESEMARRËSIT: Ne mendojmë shumë gjëra për të. Për shembull mendojmë të kemi çdo herë nga një përrallë, të vijnë oficerë dhe të tregojnë episode nga lufta, gjithashtu duam të trajtojmë shumë çështje aktuale.

SHOKU ENVER: Shumë mirë, duhet të keni mjaft kujdes. «Ora e Pionierit» duhet të bëhet më tërheqëse.

Pasi u bisedua mbi rëndësinë e librave për fëmijët dhe mbi nevojën e botimeve të tyre, shoku Enver pyeti pionierët pjesëmarrës se si shkonin me mësimet dhe si e jasin mësimin arësimtarët.

PJESEMARRËSIT: Ne shkojmë mirë. Mësuesit mundohen ta shpjegojnë mirë mësimin, por ka edhe të meta. Tani po del e qartë ajo që është thënë se reforma shkollore do të dojë shumë punë që të realizohet. Qysh tani kanë filluar, si të thuash, përpjekjet e para, kundërshtimet ndërmjet nesh dhe arësimtarëve që shpjegojnë lëndën me metoda të vjetra, kundërshtime ndërmjet nesh dhe nxënësve të influencuar nga kultura borgjeze e Perëndimit. Janë ato bejlurçinat që pretendojnë se dinë shumë gjëra, se kanë kulturë të shumtë, por janë të

sipërfaqshme. Në disa klasa ka dalë «arti për art dhe arti pa qëllim». Kjo ka shkaktuar që të ngjallen diskutime. Pastaj qëllon që ndonjë arësimtar na jep një problem të tillë: «një tregëtar përzien verën...»

SHOKU ENVER: «I fut kaq ujë».

PJESËMARRËSIT: Pikërisht.

SHOKU ENVER: Ka lloj-lloj pedagogësh. Përgjithësisht ata kanë kulturë të vjetër, borgjeze. Nuk e kanë zgjeruar horizontin e tyre me kulturë marksiste. Ata duhen drejtuar në rrugën marksiste-leniniste. Por kjo s'bëhet kollaj. Duhen çelur kurse nga ana e push-tetit që të edukohen mësuesit.

Në shumë gjëra duhet edhe me i sqarue. Por sqarimet i bëni në mënyrë shoqërore. Ju duhet t'i studjoni një herë mirë të metat kur t'i shihni dhe kështu do të bindni ata që kjo është rruga e mirë.

Në Perëndim ka pasur e ka shkrimtarë e shkrimtarë. Ka shkrimtarë francezë, amerikanë, anglezë, shkrimtarë e të cilëve janë shtypur me qindra edicione edhe në Bashkimin Sovjetik. Kjo do të thotë që ata të Perëndimit nuk duhen futur që të gjithë në një thes e të hidhen mënjanë.

Për t'i luftuar e që ju t'i dini më mirë, duhet me i studjue. Duhet të bëni shkëmbim idesh me arësimtarët. Kjo është e domosdoshme, por edhe delikate. Ata kanë më shumë njohuri për kulturën borgjeze. Edhe në këtë drejtim duhet t'i mundni. Ka të atillë që do të ndreqen, por ka pastaj dhe nga ata që do të vazhdojnë rrugën e tyre.

Diturinë duhet ta zhvilloni në shkollë dhe jashtë saj, individualisht.

Duke folur për studimin e historisë, shoku Enver tha:

«Çështja e historisë së Shqipërisë është një gjë me rëndësi. Historia e Shqipërisë është historia e vendit tonë. Por kjo duhet të shkruhet në metodën e re. Në të duhen shikuar gjërat progresive. Kur shohim për shembull jetën e Skënderbeut, duhet të shikojmë ç'ka pasë progresiste në jetën e tij. Ai është Heroi i Kombit. Ai është progresist për kohën e tij, sepse ngriti popullin kundër turqve. Por në të njëjtën kohë ai ishte një princ feudal që kërkonte bashkimin e principatave e të ngrinte një mbretëri me në krye veten e tij. Ai u shpall shpëtimtar i katolicizmit, por duhet treguar mirë se ai mbronte përparimin kundër osmanllinjve. Ai ngriti popullin, fshatarët luftuan nën drejtimin e tij. Prandaj historia duhet studjuar duke i vendosur ngjarjet në epokën kur kanë ndodhur.

Vetë marksizmi nuk doli vetëvetiu po është grumbullimi i një eksperience shekullore. Prandaj historia duhet shikuar e studjuar ndryshe nga më parë. Ne nuk kemi pasë njerëz që ta interpretonin e ta shkruanin drejt historinë. Ata mblidhnin disa gjëra dhe me nja dy a tri tregime të mbledhura, hartonin gjoja historinë e Shqipërisë. Nuk ka pasur ndonjë studim të veçantë e të rëndësishëm. Ne jemi një vend i vogël, por kemi një histori të madhe. Ne kemi pasur shumë kryengritje. Katundarët kanë ngritur krye shumë herë, por nuk kanë qenë të qartë në rrugën që ndiqnin. Pak kishte rëndësi në se i drejtonte Haxhi Qamili ose Rrapo Hekali. Për ta kishte rëndësi të këpusnin zinxhirat e robërisë. Haxhi Qamili quhej rrebel, po tamam, rrebel ishte për bejlerët. Haxhi Qamili ishte njeri i popullit, ai ngrinte popullin

për t'u marrë bezlerëve pasurinë, kur vinte në Tiranë ai urdhëronte djegjen e Toptanasve. Kështu kemi pasë kudo lëvizje katundarësh. Ai thoshte se luftonte për «Babën», për Sulltanin. Por populli, që digjte tëqet dhe kishat, luftonte reaksionin, sepse tëqëja dhe kisha këtë përfaqësonin.

Kjo histori e vendit tonë duhet të shkruhet dhe duhet të studjohet. Në gazeten «Pionieri» duhet të shkruani për luftërat këndër bezlerëve dhe feudalëve, për këto kemi shumë gjëra për të thënë».

Po historinë e përgjithshme të kohës së vjetër, të mesme dhe të re, si ju bëjnë pedagogët? — Pyeti shoku Enver.

PËRGJEGJE E PJESEMARRËSVE: Sivjet më mirë se vjet.

SHOKU ENVER: Këtu është zotësia e njerëzve që janë afër nesh. Ka të tjerë arësimtarë që fusin nga lakrat e tyre sa të duash. Kështu nxënësit duhet ta studojnë mirë historinë, të fillojnë diskutime. Për shembull ka pedagogë që na i nxjerrin kryqëzatat si shumë përparimtare, kurse kjo s'është e vërtetë.

NJË REDAKTOR: Ka pedagogë që duan t'i adaptohen së resë, por nuk dinë si të bëjnë dhe, duke kujtuar se bëjnë mirë, shtojnë nga të vetat. Kështu për shembull, ne studjojmë Revolucionin francez — profesori shpjegon Volterin, na e dikton, por kur muarëm dispensat pamë se ai nuk kishte thënë asgjë se Volteri nuk ishte as demokrat e as revolucionar. Ai duke bërë përbledhjen, nuk e ka parë të nevojshme këtë, ndërsa i është dukur më mirë të na tregojë se si Volteri u burgos dhe u torturua në Bastij, gjë që nuk influencon fort.

SHOKU ENVER: Revolucioni francez është studjuar nga shumë veta. Njëri për shembull e nxjerr Napoleonin ndryshe dhe tjetri ndryshe. Duhen studjuar ata që e shikojnë çështjen nga pikëpamja marksiste. Dikush La Fajetin na e nxjerr revolucionar, kurse ai ishte mbrojtës i monarkisë dhe oportunist i madh. Por ka në jetën e La Fajetit edhe gjëra progresive. Historiani marksist tregon të metat dhe të mirat. Po të mos kesh bërë një studim të imtë e të thellë, nuk mund të thuash se këta kanë qenë kështu ose ashtu. Tani detyra jonë është të studjojmë më tepër marksizmin.

*Botuar për herë të parë në
broshurën «Komandanti —
Pionierëve», Tiranë, 1947*

*Botohet sipas broshurës:
«Komandanli — Pionierëve»,
Tiranë, 1947*

**TELEGRAM DREJTUAR MINISTRAVE TË PUNËVE
TË JASHTME TË BRSS, TË SHBA, TË ANGLISE
DHE TË FRANCËS, ME TË CILIN KERKOHET QË
RPSH TË FTOHET SI ANËTARE EFEKTIVE NË
KONFERENCËN E PAQES ME GJERMANINË**

12 janar 1947

**MINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME TË BASHKIMIT
SOVJETIK, TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS,
TË ANGLISE DHE TË FRANCËS**

Me rastin e mbledhjes së afërme të Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme në Moskë¹, që do të pregetitë projekttraktatin e paqes me Gjermaninë, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë ka nderin t'i parashtrojë sa vijon kujdesit dashamirës të fuqive kryesore aleate:

Shqipëria është palë e interesuar në bisedimin e traktatit të paqes me Gjermaninë, sepse ka pësuar humbje shumë të rënda gjatë pushtimit gjerman dhe ka bërë një luftë të ashpër kundër pushtuesve nazistë.

¹ Është fjala për sesionin IV të mbledhjes së Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme të Bashkimit Sovjetik, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Anglisë dhe të Francës që u mblodh në Moskë më 10 mars — 24 prill 1947.

Në të vërtetë Shqipëria, një nga viktimat e para të sulmit fashist, mbasi u pushtua më 7 prill 1939, u hodh që në fillim në luftë kundër pushtuesve italianë e vazhdoi përpjekjen duke mos u zmbrapsur përpara asnjë sakrifice dhe e ashpérsoi luftën, sidomos gjatë pushtimit nazist. Sakrificat e bëra nga populli shqiptar gjatë pushtimit gjerman janë jashtë çdo përpjesëtimi. Shkatërrimet e vuajtjet e shkaktuara në vendin tonë nga pushtuesit nazistë janë një provë elokuente e pjesëmarrjes së tij në luftën e përbashkët. Në të vërtetë, lufta që bëri populli shqiptar përkrah fuqive aleate i detyroi gjermanët që të mbajnë në Shqipëri 3 gjer në 5 divizione nga më të stërviturat në luftë.

Në kohën e çlirimtës së Ushtria Nacional-Çlirimtare, e cila e kreu vetëm këtë detyrë të rëndë, forcat tona efektive arrinin në 70 000 njerëz të organizuar në një ushtri të vërtetë. Për të treguar besnikërinë e tij ndaj kauzës së përbashkët, populli shqiptar nuk pushoi së luftuari edhe pas çlirimtës vendit; forcat tona i ndoqën hitlerianët përtej kufive tanë dhe luftuan kundër tyre për shumë muaj në tokën jugosllave.

Bilanci i sakrificave të bëra nga populli shqiptar përfshin : 28 000 të vrarë, 12 600 të plagosur, 10 000 të burgosur dhe të internuar politikë, afër 60 000 shtëpi të djegura ose të shkatërruara.

Sakrificat e shumta në njerëz, dëmet materiale dhe përpjekjet e mëdha luftarake të bëra nga Shqipëria, e cila për këtë shkak ka pësuar humbje që mbërrijnë në shumë miliarda franga ari, janë arësyen të mjaftueshme që bëjnë të respektohen rivendikimet e saja kundër Gjermanisë.

Në bazë të këtyre sakrificave, Shqipëria u ftua në Konferencën e dëmshpérblimeve në Paris, në nënitor 1945 dhe ka nënshkruar me këtë rast aktin e fundit të konferencës në fjalë, e cila i njihet pjesë në dëmshpérblimet prej Gjermanisë. Shqipëria është anëtare me të drejta të barabarta e Agjencisë ndëralcate të dëmshpérblimeve në Bruksel¹.

Për të gjitha këto arësyte Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, duke interpretuar dëshirën e thellë të popullit shqiptar dhe duke pasur besim në frymën e drejtësisë të fuqive kryesore alcatër në favor të shteteve të vegjël, kërkon të drejtën që të ftohet të parashtrojë pikëpamjen e saj përpara Këshillit të afërm të Ministrave të Punëve të Jashtme në Moskë dhe të ftohet në kohën e duhur si anëtare efektive në Konferencën e Paqes me Gjermaninë për të marrë pjesë në të njëlloj si anëtarët e tjerë.

Kryetari i Këshillit të Ministrave dhe Ministri
i Punëve të Jashtme të RPSH
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 635,*

12 janar 1947

Botohet sipas tekstit të gazetës «Bashkimi», Nr. 635,

12 janar 1947

¹ Kjo agjenci u krijua në dhjetor 1945 për të grumbulluar dhe për të plotësuar kërkesat për dëmshpérblime të shteteve alcatë, viktima të agresionit të Gjermanisë hitleriane. Në këtë agjenci merrnin pjesë 18 shtete, midis të cilëve edhe Shqipëria.

LETËR DREJTUAR NJË NËNE QË KA MËSUAR TË SHKRUAJË E TË LEXOJË

8 shkurt 1947

ZONJËS VASILIA PAÇUKA
LAGJJA GORICË

Berat

Ju falenderoj për letrën që më çuat, e cila më gjëzoi shumë për dy arësye: se keni mësuar të shkruani fare mirë dhe jeni një nënë plakë që djemtë i keni në shërbim të atdheut, në Ushtrinë tonë Kombëtare. Prandaj letrën tuaj e këndova me gjëzim, ashtu sikundër i këndoja një djemtë e tu ushtarë, letrat që ju u dërgoni. Inku-rajoni të gjitha shoqet tuaja, plaka dhe të reja, të mësojnë të shkruajnë e të këndoja, pse sikundërqë më shkruani në letër, atyre do t'u hapen jo vetëm sytë, por dhe jeta do t'u bëhet më e lumtur, më e gjëzuar, më e bardhë. Me postë do t'ju dërgoj një seri librash që t'i këndoni, për të kuptuar më mirë sa të mëdha kanë qenë sakrificat e djemve dhe të çupave që ju, mëmat e Shqipërisë, i rritët dhe ja falët atdheut si dhe për të kuptuar, gjithashtu, më mirë detyrat që ka sot populli në ndër-

timin e jetës së tij më të mirë. Duke ju çuar të falat e mia ju uroj një pleqëri të bardhë.

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 658,
8 shkurt 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 658,
8 shkurt 1947*

**MESAZHI DREJTUAR PIONIERËVE TË SHQIPËRISË,
ME RASTIN E 5-VJETORIT TË KRIJIMIT TË
ORGANIZATËS SË PIONIERËVE**

11 shkurt 1947

Të dashur pionierë dhe pioniere,

Sot keni festën tuaj, sa gjëzim i madh për ju! Por edhe unë jam aq i gjëzuar sa edhe ju, pse kjo ditë na kujton shumë gjëra, na kujton luftën e madhe të çlirimtë të atdheut dhe, lidhur ngushtë me të, luftën dhe përpjekjet heroike të pionierëve të Shqipërisë.

Ka disa që thonë: «Eh! çfarë bënë pionierët në këtë luftë? Ata ishin kalamaj». Këtyre mendjeshkurtëve ne u përgjigjemi : «Po, është e vërtetë që ata ishin kalamaj, pse ndryshe nuk i quanin pionierë. Mirëpo ata ishin trima e të vendosur kundër okupatorit dhe ballistëve tradhëtarë». Shumë është folur dhe është shkruar për trimëritë e pionierëve shqiptarë; por sa heroizma të tjera të pionierëve tanë nuk dihen dhe nuk janë shkruar akoma! Unë kam mjaft për të thënë për pionierët, por sot do të mjaftohem t'ju tregoj juve vetëm një episod të jetës sime gjatë luftës, ku një pionier katundar ka luajtur një rol të rëndësishëm e vendimtar dhe që mund të themi se më ka shpëtuar jetën mua dhe disa shokëve të mi të Shtabit të Përgjithshëm.

Ishte koha e ofensivës së madhe të dimrit¹. Gjermanët na sulmuani nga të katër anët. Bora ishte e madhe: ditë të rënda për partizanët tanë! Tok me gjermanët na sulmuani edhe ballistët e zogistët. Partizanët luftuan si luanë, megjithëqë s'kishin shumë herë as këpucë në këmbë dhe kishin veshur në trup nga një palë rroba të grisura. Sa për ushqime, mos e zini në gojë, partizanët tanë trima rrinin edhe tri ditë pa ngrënë bukë, por asnë minutë pa luftuar. Unë me disa shokë të mi, pas luftimeve me gjermano-ballistët u ndodhëm të shkëputur nga forcat tona dhe u detyruam të qëndrojmë te miqtë tanë katundarë përderisa të gjenim shtegun, të çanim rrëthimin dhe të bashkoheshim me forcat partizane. Që të mos zgjatem, pas një kohe të gjatë dhe pasi rregulluam shtigjet me anën e shokëve katundarë, u nisëm të çanim rrëthimin. Ishim në malësitë e Elbasanit dhe duhej të kalonim në malet e Korçës. Rrugë e gjatë, plot rreziqe, plot borë e plot gjermanë dhe ballistë. Duhej të ecnim vetëm natën, të veshur si shokët katundarë, duke mbajtur me vete vetëm koburet dhe bombat. U nisëm nëpër natën e errët, shumë herë kalonim përmes fshatrave, shumë herë nëpër majë malesh, larg rrugës së zakonshme, për të mos hasur me patrullat e armikut, të cilat kishin shkelur fshatrat dhe terrorizonin popullin. Pas shumë ditësh udhëtimi, të lodhur dhe të uritur, arritëm në një fshat të vogël të Vërçës. Atje vamë në shtëpinë e një katundari partizan, shoku ynë. Sa mirë

¹ Është fjala për operacionin e pushtuesve gjermanë dhe të tradhëtarëve të vendit kundër Ushtrisë Nacional-Çlirimtare në diuin e vitit 1943-1944.

ishte në shtëpinë e atij! Atje kishte bukë, atje kishte zjarr, atje kishte mbulesa, atje kishte dhe një pionier të vogël, pionierin, për të cilin do t'ju flas. Pionieri i vogël rrinte me ne, afër vatrës, ai mbante vesh çfarë flitnim, ai na pyeste dhe gjëzonte me dorën e tij të vogël koburet tona; kur ne flitnim për gjermanët dhe ballistët, sigurisht ai thoshte me vete: «Ah të kem dhe unë një kobure si kjo!» Pionieri fjeti në dhomën tonë. Ai që në mëngjes u çua, nxori lopët nga hauri dhe filloj të luajë me qenin që lehte shumë.

Kur po bisedonim se si ta kalonim Qafën e rrezikshme të Shënepremtes, rruga jonë e vetme, pionieri hyri në dhomë dhe tha: «Ja grahnë ballistët». Dhe me të vërtetë ballistët e Vërçës dhe të Korçës erdhën në fshatin ku ishim ne. Fshati u mbush plot, në të gjitha shtëpitë u shpërndanë ballistë. Ne u bëmë gati të luftonim, po të na diktonin.

Ju e dini se ç'bënин ballistët kur binin në ndonjë fshat. Ata nuk largoheshin vegse kur dëgjonin pushkën e partizanëve, ose kur merrnin vesh se po vinin partizanët. Ata, ballistët, ishin kusarë të poshtër, ata ishin frikacakë si dreqi. Kur binin ballistët në ndonjë fshat ata e shtronin gunën dhe ja hanin të gjitha ç'kishte katundari. Neve, që ishim mbyllur në odë, s'na leverdiste kjo punë. Sa më tepër të rrinim në atë fshat, ku ishin forcat balliste, aq më i madh ishte rreziku. Ose duhej të dilnim ne nga fshati, ose duhej të iknin forcat balliste. Që të dilnim ne, ishte marrëzi, pse do të na vrissnin, se ata kishin vënë roje kudo dhe e kishin rrethuar fshatin. Atëherë duhej patjetër të largonim ballistët nga fshati që kështu ta kishim rrugën të celur. Dhe këtë detyrë të

madhe dhe vendimtare ja ngarkuam shokut të vogël, pionierit katundar. Ai e kreu detyrën me trimërinë dhe zgjuarësinë më të madhe. Pasi ja shpjeguam se ç'duhej të bënte, pionieri ja filloi punës. Brenda tri orëve ai mundi t'u kallë një frikë të tmerrshme ballistëve. Ai shkoi shtëpi më shtëpi, ku qëndronin ballistët dhe u thoshte: «E muart vesh? Tashti poqa poshtë në çaire një katundar nga Grabova dhe ai më tha se Riza Kodheli me 300 partizanë kaloi Qafën e Shënepremtes dhe sonte, një pjesë e tyre, do të hidhet në Grabovë, për në drejtim të Dumresë». Të tjera, pionieri u thoshte si pa gjë të keqë: «I dëgjuat disa pushkë dhe dy mitralozë të rëndë që gjëmonin përtej Shkumbinit? Thonë se Brigada e parë me Mehmet Shehun ka vënë përparrë gjermanët dhe Xhaf Balin¹. Ajo do të kalojë në Nartë për t'u bashkuar me forcat e Riza Kodhelit».

Këtë punë bëri pionieri për tri orë rresht. Ballistët u alarmuan në kulm. Ata filluan të shanin në sy të pionierit kryetarët e tyre, që nuk jepnin urdhër të largoheshin sa më parë nga fshati. Në një shtëpi ku ishin pesëmbëdhjetë ballistë, frika ishte aq e madhe, saqë ata i thanë pionierit: «Në rast se na sulmon natën Mehmet Shehu dhe s'kemi kohë që të largohemi, aman, eja merr këto pushkët tonë dhe i fshih ose u thuaj partizanëve që këto pushkë i kanë lënë partizanët». Kjo ishte përsëri efekti i propagandës demoralizuese që u bënte pionieri ynë ballistëve, të cilëve ai u thoshte:

¹ Xhaf Bali, komandant i bandave të armatosura të «Ballit Kombëtar» që vpronin në qarkun e Elbasanit.

«Partizanët i duan shumë katundarët, kurse ballistët iurrejnjë dhe po t'ju zënë me pushkë, ata do të kuptojnë që jeni ballistë dhe ju piu e zeza». Të nesërmen me natë të thellë, ballistët, të trembur, u larguan nga fshati ku ishim ne, ata muarën rrugën e Elbasanit dhe rruga jonë ishte e çelur, rrugën tonë na e çeli trimëria dhe zgjuarësia e një pionieri trim nga një katund i Vërgës.

Sa kujtime të tilla na sjell ndër mend dita e festës suaj, o shokë të dashur pionierë! Ju, bij të vegjël të Shqipërisë, sa vite të hidhura kaluat nga shkaku i luftës! Keni vuajtur nga uria, nga të ftohtit, keni parë tmerret që na bëri armiku, keni parë të digjen dhe të grabiten shtëpitë tona nga italianët, gjermanët, ballistët, zogishtët, keni humbur të dashurit tuaj në luftë.

Këto nuk i meritonit. Por pas furtunës, thotë populli ynë, vjen kohë e bukur. Ne të mëdhenjtë dhe ju pionierët i rezistuam furtunës me ballin lart; çliruam atdheun dhe tani po ndërtojmë një jetë të bukur.

Për ju pionierët e Shqipërisë tani e tutje do të ketë ditë të lumtura, për ju punon gjithë populli shqiptar, që t'ju sigurojë një jetë të gëzuar. Ju tani keni shkolla, juve nuk do t'ju mungojë kurrë buka. Çdo ditë që shkon, do të sjellë përmirësimë në të gjithë jetën tonë dhe në radhë të parë, tuajën; në familjet tuaja do të ketë gëzim, pse të gjithë do të punojnë të gëzuar dhe do të fitojnë me nder dhe me djersë jetën e re dhe të begatshme. Një gjë kërkojmë nga ju, o shokë pionierë: Të doni atdheun, të doni popullin, të doni të afërmit tuaj dhe të mësoni, të mësoni! Në traditat e luftës sonë heroike të rritet dhe të çelnikoset brezi juaj, shpresa e ardhme e vendit tonë dhe sot në ditën e festës suaj le

të gëzohet gjithë Shqipëria dhë të festojë tok me ju
këtë ditë të shënuar të pionierëve trima të Shqipërisë.

Me dashuri
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 660,
11 shkurt 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 660,
11 shkurt 1947*

NGA BISEDA ME UDHEHEQESIT E RINISE PAS PLENUMIT V TE KESIILLIT TE PERGJITHSHEM TE RINISE POPULLORE TE SHQIPERISE

6 mars 1947

Jam i kënaqur prej punimeve dhe vendimeve që u muarën në plenumin tuaj. Këto vendime janë fare të drejta dhe tani çështja është që këto të zbatohen. Unë jam i sigurt se rinia do t'i përbushë me sukses këto detyra që mori përsipër, pse ju të rinjtë e kuptioni mirë rëndësinë e problemeve që u shtruan dhe u biseduan në plenumin tuaj.

Rinia, pjesa më e gjallë e popullit tonë, ashtu sikundër ka qenë në ballë të luftës së lavdishme të çlirimt, duhet të jetë kudo në ballë në të gjithë aktivitetin shoqëror-ekonomik dhe kultural të vendit tonë. Rinia ka bërë shumë për çlirimin e vendit dhe po e vazhdon me heroizëm dhe me pjekuri punën e saj në këtë kohë rindërtimi dhe paqeje. Të gjithë duhet të realizojmë se çlirimi i atdheut nga armiqëtë e brendshëm dhe të jastëm dhe rindërtimi i vendit që po e kryejmë në mes të pengesave kaq të mëdha, të trashëgura nga lufta, janë vepra kolosale. Më kujtohet të kem kënduar diku në veprën e Dideroit, filozof enciklopedist, materialist fran-

cez, këtë episod të jetës së tij. Dideroi thotë: «Kur shkoja në ndonjë muzeum dhe qëndroja përpara statutit të Herkulit, e ndjeja veten sikur rritesha një centimeter, zëri më bëhej më i fortë dhe, kur dilja nga muzeumi, e hidhja hapin më me siguri». Dhe për ne lufta e çlirimit ka qenë një vepër herkuliane, për kryerjen e së cilës tërë populli ynë i nderi të gjitha energjitet e veta. Dhe vepra e rindërtimit nuk është më e vogël se e para. Prandaj përpara kësaj vepre të madhe ne duhet të hidhemi në punë me fuqi të reja, duke mbledhur të gjitha energjitet tona, për të kryer detyrat që na dalin përpara.

Ju udhëheqësit e rinisë që muarët pjesë në luftë që nga fillimi e deri në fund, që hasët në vështirësi të panumërtë, të krijuara nga okupatori dhe nga tradhëtarët e vendit, sigurisht keni parasysh se do të hasim shumë pengesa e vështirësi të reja në ndërtimin e vendit tonë. Ka njerëz, si brenda dhe jashtë Shqipërisë, që nuk u pëlqejnë rezultatet e luftës së popullit tonë si dhe rruga përparimitare dhe paqësore që ndjek ai. Imperialistët e huaj dhe agjentët e tyre nuk i kanë hedhur armët; këtë ta keni parasysh në punën tuaj. Ndërtimi i vendit tonë, që bëhet me kaq kurajo, me sakrifica, do të sigurohet me gjithë vështirësitet e mëdha ekonomike të trashëguara nga lufta shkatërrimtare. Kjo është çështja kryesore dhe për këtë qëllim ne koordinojmë të gjitha forcat në të gjitha lëmet e aktivitetit të vendit tonë. Në këtë vepër të madhe ne do të dalim me sukses, pse pushteti është në duart e popullit dhe populli ynë është një popull me plot gjallëri dhe vullnet. Gjallëria dhe vullneti kapërcejnë pengesa të mëdha. Për këtë duhet

mobilizim, organizim. Këtu rinia duhet të luajë një rol me shumë rëndësi. Ajo duhet të ketë parasysh gjithmonë veprën legjendare të shokëve të saj gjatë luftës dhe të ecë në traditat e kësaj lufte.

Shkolla është bazë e shëndoshë ku do të edukohet rinia. Çështja e arësimit dhe çështja e kulturës në vendin tonë janë shumë të rëndësishme dhe kërkojnë zgjidhje të drejtë, të shëndoshë dhe të shpejtë. Pa arësim dhe pa kulturë nuk mund të ecim përpara dhe nuk mund të zgjidhim rrënjosht dhe me sukses problemet tona. Kjo duhet të jetë e qartë për të gjithë dhe në radhë të parë për rininë, për të cilën po bëhen të gjitha këto përpjekje. Asaj i besohen nga ana e shtetit detyra të rëndësishme dhe, më në fund, ajo do të rregullojë fatin e vendit tonë. Prandaj rinia duhet të mësojë sa të jetë e mundur më tepër e më mirë. Është e vërtetë se ka mungesa të mëdha, si teknike, ashtu dhe ekonomike në lidhje me shkollën. Këto duhet t'i kuptojmë dhe t'i kapërcejjmë duke pasur kurdoherë parasysh se çdo gjë do të përmirësohet. Çështja e mësimit në të rinxjtë duhet të bëhet një çështje nderi; ai që mëson më mirë është edhe patriot i mirë, ai do t'i shërbejë vetes, atdheut dhe popullit më mirë. Po kjo gjë vihet edhe për profesorët¹ dhe mësuesit. Ata mësues dhe profesorë që e realizojnë misionin e tyre të lartë në shërbim të popullit, që shtojnë dhe përmirësojnë kulturën dhe edukatën e tyre, që adoptojnë metodat më moderne dhe më përparimtare të shkencës dhe që i kushtojnë momentet më të mira të jetës së tyre edukimit të rinisë sonë, ata meritojnë jo

¹ Mësuesit e shkollave të mesme.

vetëm mirënjojen e rinisë, por edhe të gjithë popullit. Gjithë rinia duhet të vejë në shkollë dhe në radhë të parë drejtuesit e saj. Sigurisht një pjesë e vogël e këtyre drejtuesve nga detyrat e mëdha që u ngarkohen, do të mos mundin dot ta vazhdojnë rregullisht shkollën, por ne duhet të synojmë që të mos na mbetet asnjë drejtues pa shkollë. Prakticizmi është i mirë, por ne duhet të dimë se pa zotëruar shkencën ne do të vemë deri në një vend, pastaj do të hasim në pengesa të mëdha dhe do të mos jemi në gjendje t'i zgjidhim drejt problemet tona. Të gjitha këto probleme s'ka kush na i zgjidh, zgjidhja pritet vetëm nga ne. Reforma e madhe e shkollës së re duhet të kuptohet mirë dhe të zbatohet mirë, si nga organet e larta zbatuese, ashtu edhe nga mësuesit, profesorët dhe nxënësit. Ka vështirësi teknike, ka mungesë tekstesh, ka mungesë lokalesh dhe orendish shkollore, ka vështirësi ekonomike për mësuesit, profesorët dhe nxënësit. Të gjitha këto janë probleme që duhet të zgjidhen dhe unë them se këto do të rregullohen dhe do të përmirësohen. Çdo njeri me logjikë dhe me ndjenja i kupton këto vështirësi dhe bën çmos që të ndihmojë me të gjitha forcat e tija organet e larta shtetërore për t'i kapërcyer këto vështirësi. Të gjithë e dimë se mund të mësohet mirë kur të kemi gjithë komoditetet, por merita qëndron, dhe këtu shquhen njerëzit e rinj, kur ne mësojmë, ndërtojmë, shkojmë përpara edhe nëpërmes vështirësive të mëdha. Ta marrim në dorë arësimin, ta bëjmë këtë progresist dhe ta vëmë në shërbimin e popullit. Këtu është roli i organizatës suaj që t'i sheshojë këto pengesa, të futë në shpirtin e të rinjve dëshirën e madhe dhe nevojën e domosdoshme të mësimit, të ndih-

mojë pushtetin për zbatimin e reformës dhe për luftimin e vështirësive, të ndihmojë mësuesit dhe profesorët në kryerjen e detyrave të tyre të larta.

Nga ana tjetër, në shkollë duhet të ketë ndërgjegje, disiplinë dhe rregull. Sigurisht organizata e rinisë nuk duhet të lejojë që në shtekat tona të ketë njerëz që s'ecin në rrugën e drejtë. Të kemi parasysh gjithmonë kontrollin e fortë, pse ne e dimë që kemi dhe armiq që nuk e duan shkollën tonë të re. Duhet t'i ndajmë mirë këta njerëz, pse ka armiq të vërtetë, por ka edhe nga ata që akoma janë të dezorientuar dhe pa perspektivë, ka edhe nga ata që janë indiferentë. Nuk lejohet kurssesi të futen të gjithë këta në një thes. E mira e atdheut e don që të zvogëlohet sa më shumë numri i armiqve të shkollës sonë. Në Shqipërinë e paralufstës arësimi s'ishte në dorën e popullit, por në dorën e borgjezisë pasanike dhe të bezlerëve. Shumica e arësimtarëve ka një kulturë të vjetër, por ka një kulturë. Ata që e kanë këtë kulturë të vjetër, të mos mendojnë se kjo është më e mira, më përparimtarja. Të mos kujtojnë gjithashtu se ata e kanë myllur ciklin e studimeve të tyre dhe s'kanë më nevojë për të pajisur mendjen e tyre me një kulturë të re dhe më të gjerë. Në qoftë se mendojnë kështu, ata gabohen; në rast se vazhdojnë të qëndrojnë në këto pozita, ata nuk do të jenë në gjendje t'i shërbjnë si duhet popullit dhe vetes së tyre. Unë mendoj se arësimtarëve tanë s'u mungon as zgjuarësia, as vullneti i mirë dhe jam i sigurt gjithashtu se ata do t'i përvishen punës për të spastruar nga bagazhi i tyre kultural çdo gjë prapanike dhe pa baza shkencore të drejta. Shteti do të përpinqet që t'u hapë horizonte të shëndosha

studimi profesorëve, që të mundin këta të korrigojnë të gjitha shmanget e tyre dhe të pajisen me njohuri të reja, të shëndosha dhe të panjohura më parë prej tyre. Shkollarët duhet t'i respektojnë profesorët dhe mësuesit, pse ata janë edukatorët e tyre. Atyre duhet t'u japid vendin e duhur. Nga ana tjetër dhe mësuesit e profesorët duhet të veprojnë po në të njëjtën mënyrë kundrejt nxënësve. Do të bëhen dhe gabime dhe organizata e rinasë, kur ka gabime, duhet të ndërhyjë, por kjo ndërhyrje të mos bëhet në mënyrë anarkike, pse anarkizmi nuk është në rrugën tonë. Të bëhen vërejtjet në rrugët e caktuara hierarkike, në bashkëpunim me drejtorët, me organizatën, me profesorët si dhe me organet më të larta të pushtetit popullor. Duhet të ketë bashkëpunim të ngushtë dhe mirëkuptim të plotë. Kur është për të marrë masa, do të merren masa, qofshin edhe të rënda. Shteti do t'i kontrollojë të gjithë që të japid sa më shumë, të bëhen të vlefshëm e populli të përfitojë sa më tepër.

Por, përveç shkollave të mesme, është dhe çështja e shkollave fillore e 7-vjeçare, ku edukohet brezi më i ri, pionierët. Këtu organizata e rinasë duhet të luajë një rol të madh. Puna me pionierët të mos lihet mënjanë dhe të mos merret si punë e vogël, si punë kalamajsh. Të nxiten të vegjilit të mësojnë sa më shumë e të ndjekin rregullisht shkollat, të bëhet shkolla sa më tërheqëse, të forcohet edukata dhe sjellja e mirë në ta, ndjenja e dashurisë për popullin dhe për atdheun — këto janë detyra të mëdha, që i ngarkohen organizatës suaj për t'i kryer. Botimi i librave dhe i gazetave për pionierët, organizimi i lodrave të tyre, i zbavitjeve të

shëndosha trupore dhe shpirtërore, shëndeti i tyre, duhet t'ju preokupojnë mjaft. Kur t'i edukojmë si duhet pionierët, atëherë do të shohim sa e fortë do të jetë shkolla jonë, sa e fortë do të jetë organizata e rinisë dhe sa shërbime të çmuara do t'i kemi sjellë atdheut. Kështu do të nxjerrim njerëz të popullit, që do të luftojnë dhe do të punojnë për popullin. Organizata e rinisë duhet të kujdeset për shkollat fillore. Veçanërisht u kërkohet organizatave të rinisë të Shkodrës, Durrësit, Elbasanit, Kukësit dhe të Peshkopisë të vënë të gjitha fuqitë e tyre për të ndihmuar shkollat fillore. Çështja e shkollës fillore në qytet mund të themi se shkon mirë nga pikëpamja e frekuentimit të saj, por në fshatra duhet të bëjmë punë të madhe. Ligji mbi arësimin fillor të detyrueshëm nuk zbatohet akoma si duhet. Organizata e rinisë duhet të sqarojë dhe të bindë prindërit të dërgojnë fëmijët në shkollë; i gjithë Fronti duhet ta marrë këtë si detyrë kryesore.

Me një fjalë, organizatës suaj në shkollat e mesme dhe fillore i bie barra që të lidhet ngushtë me masat e rinisë në shkollë. Format e punës së organizatës suaj, të lidhura ngushtë me shkollën, mund të jepin shumë rezultate. Kështu shteti, shkollat dhe organizata juaj, me një punë të palodhur, do të mundin të kapërcejnë shumë pengesa që na dalin përpëra. Organizata e rinisë kurdoherë ka ditur të zgjidhë si duhet të gjitha problemet në vijën tonë të re. Unë jam i sigurt se edhe këto detyra, në lidhje me shkollën, ju do t'i kryeni me sukses.

Rrugën Kukës-Peshkopi ju e mbaruat me sukses. Kjo tregoi forcën e rinisë, kjo tregoi se pas një lufte aq

të madhe, rinia është e zonja të ndërmarrë aksione të një shkalle të gjerë. Një gjë e tillë ma forcoi edhe ca më tepër besimin kur ju ngarkuan ndërtimin e hekurudhës Durrës-Elbasan. Po ndërtohet e para hekurudhë në vendin tonë; ky është një eveniment historik dhe ju e kuptoni rëndësinë e tij. Rruga e hekurt do të ndihmojë në zhvillimin e ekonomisë dhe të industrisë sonë. Ju keni marrë përsipër ta ndërtoni këtë rrugë dhe fillimi është i mbarë; qysh sot gati pesëmbëdhjetëmijë të rinj janë shkruar vullnetarë dhe gjithë rinia është më këmbë pér të kryer këtë veprë të madhe. Sa i rëndësishëm është aksioni, aq me rëndësi është dhe organizimi i këtij aksioni. Atje do të punojnë me mijëra të rinj, prandaj çdo gjë duhet të jetë e organizuar dhe e organizuar mirë. Me një organizim të tillë hekurudha do të bëhet një shkollë e madhe, nga ku do të dalin kuadro të shëndoshë, të pajisur me vullnet pér t'i shërbyer popullit; me mijëra njerëz do të mësojnë teknikën, që do të na shërbejë pér zgjerimin e rrjetit hekurudhor në vendin tonë; me mijëra do të mësojnë të shkruajnë dhe të këndojnë, do të mësojnë të rrojnë dhe të punojnë në kolektivitet, në një kolektivitet të shëndoshë, të ndershëm, punëtor. Natyrisht, pér zbatimin e planit, në këtë punë kaq të madhe, shteti shqiptar ka një barrë të rëndë. Këtu mund të ketë dhe do të ketë pengesa. Duhet ditur se Shqipëria ka shumë vështirësi dhe pengesa, sepse ka dalë nga një luftë kaq e madhe. Por këto pengesa do të përpinqemi që t'i zvogëlojmë sa më tepër, dhe organizata juaj duhet të ndihmojë pér t'i lehtësuar dhe pér t'i kapërcyer me eksperiencën dhe organizimin tuaj. Ju duhet të keni kujdes pér punën dhe të bëni vërejtjet e

duhura, kur duhet dhe ku duhet. Unë kërkoj që çdo punë të bëhet kurdoherë me rregull dhe disiplinë. Sekretariati i Rinisë Popullore ka dhënë prova zotësie, ai është në gjendje të drejtojë punë të rëndësishme dhe t'i kryejë me sukses. Unë jam i bindur se ju do të dilni mirë dhe s'ka pse të ndodhë ndryshe.

Duhet të theksohet këtu se rinia nuk do të punojë vetëm në hekurudhë, aktiviteti i saj duhet të ndjehet kudo: në fabrika, në miniera, në fshat, etj. Është e ditur se një punë kaq e madhe, si hekurudha, kërkon kujdesin e madh të udhëheqësve të rinisë dhe të organizatës suaj. Por nuk duhet të lejohet që të përqëndrohen të gjitha forcat në një ndërmarrje të vetme dhe të harrohen punët e tjera. Të gjitha punët janë të lidhura. P.sh. në hekurudhë ne kemi nevojë për të gjitha: që nga edukatori deri te benzina. Në rast se do të punohet mirë në shkollat, në minierat, në ndërmarrjet, në dyqanet e shtetit, në bujqësi, etj., atëhere do të ecë mirë dhe puna në hekurudhë. Nga kjo del se aktiviteti i rinisë duhet të jetë i gjithanshëm dhe rinia duhet të jetë kudo e para: në shkollë, në fabrikë, në fshat, në zyrë, etj. Por për ju tani dy detyra janë të rëndësishme: shkolla në radhë të parë dhe aksioni i hekurudhës.

Dua të theksoj këtu edhe një problem tjëtër me rëndësi. Rinia duhet të punojë dhe të studjojë, por duhet edhe të dëfrezë. Për zbatitjen e rinisë kemi bërë pak. Ne nuk duam që i riu të plaket para kohe. Vësh-tirësitë ekonomike që kemi hasur na kanë penguar deri diku për zhvillimin e fiskulturës dhe të sportit, po me buxhetin e ri do të përpinqemi t'i përmirësojmë këto.

Për të kryer me sukses të gjitha detyrat tuaja është

i domosdoshëm zgjerimi dhe forcimi i organizatës suaj, për të cilën do të vlejnë shumë dhe zgjedhjet. Duke pasur organizatën të fortë, do të kemi mundësi t'i kryejmë punët më mirë dhe më lehtë. Sekretariati i Rinisë u ka dhënë udhëzime dhe më përpara për këtë dhe tani ai do të vazhdojë t'ju ndihmojë edhe më tepër, t'ju udhëzojë dhe t'ju kontrollojë. Pa organizatë të fortë nuk mund të kryhen gjithë këto punë. Organizata është motori drejtues i rinisë në çdo punë. Organizata e rinisë duhet të luajë një rol të rëndësishëm, sidomos në Veri në ndihmë të pushtetit. Atje i riu duhet të ngrejë masat e prapambetura të Veriut dhe t'i bëjë këto që t'i përvishen punës dhe të bëhen të vlefshme për vete dhe për popull. Këtu është çështja që të zhduket sektarizmi, është e nevojshme dhe e domosdoshme të mobilizohen të gjithë njerëzit, i gjithë populli. Ne duhet të ndihmojmë çdo njeri që të spastrojë lakin që mund të ketë në kokë, ta ndihmojmë të punojë sa më shumë e sa më mirë dhe ta kontrollojmë në punë me një mënyrë të drejtë. Një punë e tillë e shëndoshë në brezin e ri është më e lehtë dhe më e frytshme. Të edukojmë në mënyrë të shëndoshë dhe jo përbuzëse fëmijët e atyre që me veprat e tyre dëmtuan çështjen e popullit. Nuk mund të bëjmë fajtor kalamanin për veprën tradhëtare të babës së tij. Meritë është kur ne këtë kalaman ta bëjmë një qytetar të ndershëm dhe patriot dhe jo ta shqelmojmë. Tendenca të tillë sektarizmi, në rast se paraqiten, duhet të luftohen. Por të merrni kurdoherë parasysh kushtet, vendin, krahi-nën. Ndryshe duhet parë i riu i Kurveleshit, që luftoi me heroizëm dhe i riu i Malësisë së Veriut, mbi kurri-zin e të cilit bajraktarizmi rëndonte shumë. Të jemi

shumë më indulgjentë me të rintjtë e Veriut, t'i ndihmojmë shumë që ata shpejt të arrijnë në një shkallë me të gjithë shokët e tjerë.

Ju uroj sukses në punë dhe të jeni të sigurtë se do të keni qind për qind përkrahjen e Qeverisë, përkrahjen e Frontit Demokratik, do të keni përkrahjen e madhe të Partisë Komuniste dhe timen!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 683.*

9 mars 1947

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 683.*

9 mars 1947

PROTESTË DREJTUAR SEKRETARIT
TË PËRGJITHSHËM TË OKB-së KUNDËR
SHKELJES SË UJËRAVE TOKËSORE TË
SHQIPËRISË

18 mars 1947

SHKELQESES SË TIJ TRYGVE LI, SEKRETAR I
PËRGJITHSHËM I ORGANIZATËS SË KOMBEVE
TË BASHKUARA

Nju Jork

Me ndërmjetësinë Tuaj kam nderin t'i tërheq vë-
rejtjen Këshillit të Sigurimit mbi faktin që vijon:

Më 13 mars 1947, në ora 12, një benzинatë e ardhur
në drejtim nga Italia, pa flamur dhe pa paralajmërim,
hyri në ujërat territoriale shqiptare përkundrejt Vérne-
cit, krahinë e Vlorës. Kur pa remorkiatorin shqiptar që
u nis për t'ju afruar, anija e panjohur u largua me të
shpejtë dhe nuk u identifikua.

Në kohën kur në Këshillin e Sigurimit janë në dis-
kutim e sipër shkeljet e përsëritura të kryera më parë
në ujërat tona nga ana e anijeve britanike, kjo shkelje
e re përbën një provokim të paramenduar e të papra-
nueshëm kundër sovranitetit të Shqipërisë.

Në emër të qeverisë shqiptare protestoj formalishët kundër këtyre veprave pirateske dhe i lumen Këshillit të Sigurimit të ndërhyjë, me qëllim që t'u jepet fund provokimeve të atyre që shkaktojnë incidente dhe cënojnë sovranitetin dhe indipendencën e Shqipërisë.

Kryetari i Këshillit të Ministrave dhe Ministri i Punëve të Jashtme të RPSH
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazeten «Bashkimi», Nr. 690,

18 mars 1947

Botohet sipas tekstit të gazetës «Bashkimi», Nr. 690,

18 mars 1947

**MESAZH DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR ME
RASTIN E 1 MAJIT 1947, MBAJTUR PËRPARA
POPULLIT TË DURRESIT DHE NDËRTUESVE
TË HEKURUDHËS DURRËS — ELBASAN**

1 Maj 1947

Popull shqiptar, ushtarë dhe oficerë të Ushtrisë Kombëtare, popull i Durrësit dhe i rretheve të tij, shokë dhe shoqe të rinisë që ndërtoni hekurudhën Durrës-Elbasan,

Tre vjet me radhë ne festojmë të gjëzuar ditën e 1 Majit në atdheun tonë të lirë. Dita e 1 Majit, festa e klasës punëtore të të gjithë botës, dita që përfaqëson përpjekjet heroike të punëtorëve kundër shfrytëzuesve dhe shtypësve kapitalistë, është bërë tani, për të gjithë popujt punonjës të çfarëdo vendi, simbol i lartë i bashkimit të shëndoshë në punë për ndërtimin e jetës së re për popujt, për forcimin dhe mbrojtjen e demokracisë së vërtetë, për forcimin dhe mbrojtjen e paqes dhe për luftën e pamëshirshme kundër fashizmit dhe ndihmësve të tij.

Fakti që populli ynë, me ushtrinë e tij heroike në krye, përballoi me trimëri të pashoqe hordhitë e fashiz-

mit italian dhe gjerman, i mundi këto dhe doli triumfues duke çliruar vendin dhe duke marrë pushtetin në duart e veta, vinte qartë në dukje se populli ynë, në mënyrë të padiskutueshme, do t'i realizonte me vendosmërinë më të madhe detyrat që i viheshin përpara në periudhën e pasluftës. Kjo ishte një siguri matematike për të gjithë njerëzit e ndershëm dhe punëtorë të Shqipërisë, me përjashtim të atyre armiqve të betuar të popullit që kujtonin se, si gjithmonë, do ta dridhnin punën në favorin e tyre dhe një mëngjez do të ndodheshin përsëri mbi kurrizin e popullit. Kjo gjë kurrë nuk do të ngjasë më. Revolucioni i madh, që bëri populli ynë, është aq i thellë, i ka themelitë aq të shëndosha, saqë kurrën e kurrës as klika, as njerëz të izoluar, shfrytëzues dhe mashtrues të popullit nuk do të mundin të ngrenë veshët, qoftë dhe për ta gjërvishur veprën e pavdekshme të popullit tonë.

Në ka pasur popull më të varfëruar dhe më të shfrytëzuar deri në palcë nga shkelësit e huaj dhe gjakpirësit vendas, ky ka qenë populli ynë. Këtij kurrë s'i kish qeshur buza. Lufta e dytë botërore, më e tmerrshmja që ka parë bota, e ngriti në kulm varfërimin dhe shkatërrimin e vendit tonë. Por morali i popullit tonë në asnjë moment nuk u thye. Populli ynë u rezistoi valëve të tërbuara të armiqve me një heroizëm të pashoq. Kur ushtria jonë spastroi krejt vendin nga gjermanët dhe i ndoqi këta këmba-këmbës përtej kufive tanë, një zë buçiti nga të katër anët e Shqipërisë, zëri i fuqishëm i popullit: Të ndërtojmë atdheun, të ndërtojmë jetën tonë të re.

S'është parë kurrë në historinë e popullit tonë një

vullnet kaq i madh për punë në interesin e përgjithshëm. Të gjitha masat e popullit: në fshatra e në qytete, në ara e në fabrika, në shkolla e në të gjitha institucionet e tjera, u çuan në këmbë. Entuziazmi dhe pjesëmarrja e popullit në punë mori përpjesëtime të jashtzakonshme, për arësy se populli tani kishte kuptuar se punonte për veten e tij dhe jo për të tjerët. Ai kishte kuptuar gjithashtu se përpara interesit të vogël personal qëndronte interes i përgjithshëm. Ndryshe nuk mund të rindërtohej çka na kishte shkatërruar armiku, nuk mund të ngruhej ekonomia jonë e prapambetur dhe e varfëruar. Merita e popullit tonë qëndron këtu, se ai, në përgjithësi, e kuatoi këtë gjë që në ditët e para dhe u mobilizua përpara vështirësive të panumërtë dhe mungesave të shumëllojshme. Patjetër duheshin krijuar edhe konditat për një punë të tillë. Ne nuk mund të lejonim në asnje mënyrë që reaksionarët dhe feudalët, spekulatorët dhe fajdeshinjtë të na pengonin në veprën e madhe që po ndërmerrnim në interesin e popullit tonë. Jo vetëm kaq, por ne duhej t'i detyronim këta njerëz të villnin të gjitha çka i kishin grabitur popullit dhe të ishim të pamëshirshëm kundër këtyre, që tërë jetën e kishin bërë popullin të vuante të zezat e ullirit. Kjo ishte e drejta më elementare e popullit. Duhej të ishim të pamëshirshëm kundër vjedhjes dhe spekulimit, duhej të ishim të pamëshirshëm kundër atyre që, duke parë të veniteshin dhe të shuheshin privilegjet dhe grabitjet në kurriz të popullit, filluan të shiteshin te armiqëtë e huaj e të dëmtionin popullin. Dhe kjo u bë pa asnje hezitim. Prej këtyre masave të drejta u forcua edhe më shumë bashkimi i popullit tonë dhe puna e rindërtimit mori një hov

të madh. Sektori i shtetit u bë një realitet i fuqishëm. U shtetëzuan dhe u bënë prona të popullit punëtor minierat, fabrikat, ndërmarrjet e ndryshme, që më parë shërbenin për shfrytëzimin e popullit në interesin e kapitalistëve të vendit tonë. U realizua reforma agrare, një nga veprat e pavdekshme të pushtetit tonë popullor, me mijëra e me mijëra bujqësore kanë tokën e tyre. Po t'u hedhim një vështrim këtyre dy vjetëve e ca pune në vendin tonë dhe po të marrim parasysh vështirësitet e mëdha dhe të panumërtë, që patjetër do të hasnim në rrugën tonë, mund ta shikojmë të ardhmen tonë me optimizëm. Në çdo lëmë të aktivitetit tonë shoqëror dhe ekonomik janë bërë përparime të dukshme, janë mëkëmbur dhe funksionojnë në rregull fabrikat dhe minierat tona; janë shtuar prodhimet tona bujqësore dhe blektorale, janë ndërtuar ura, rrugë, kanale; kanë filluar punime bonifikimesh të rëndësishme; arësimi dhe kultura e popullit kanë marrë rrugën e drejtë dhe rezultatet janë të kënaqshme; është organizuar aparati shtetëror dhe njerëzit tanë dita-ditës po fitojnë eksperiencë të vlefshme që e çon punën përpara; vendi po mbushet me kooperativa të ndryshme, që shërbejnë për përmirësimin e jetës së popullit dhe për ngritjen e standardit të jetesës; punëtorët e krahut dhe të mendjes në sindikatat e tyre janë bërë një mbështetje shumë e madhe e pushtetit tonë. Ushtria jonë e lavdishme, mburoja e interesave të popullit, mburoja e çelniktë e pavarësisë dhe e lirisë së atdheut tonë, po ecën në traditat heroike të Luftës së nacional-çlirimtare; ajo po forcohet dhe po modernizohet. Këto rezultate janë arritur në saje të vullnetit të madh të popullit tonë, në saje të unitetit të

popullit tonë, në saje të punës së palodhur të Frontit Demokratik, i cili me organizatat e tij, i udhëhequr nga Partia heroike Komuniste e Shqipërisë, meriton admirimin e gjithë popullit shqiptar. Por vallë në zhvillimin e kësaj pune, a ka pasur gabime dhe të meta? Nuk kam aspak ndrojtje të them se ka pasur. Ka njerëz që nuk e kanë përbushur si duhet detyrën; disa të tjcrë kanë abuzuar me përgjegjësinë që u është ngarkuar; disa funksionarë të pandërgjegjshëm kanë kapërcyer masat që u caktojnë ligjet e rregulloret; ka pasur lëshime në punë, ka pasur burokralizëm të tepruar që ka penguar dhe dëmtuar. Atje ku këto gabime janë bërë pa qëllim të keq i kemi kritikuar, kurse atje ku ato bëhen me ndërgjegje të plotë kemi marrë dhe masa të ashpra. Në këtë punë kaq të madhe, të fshehësh gabimet dhe lëshimet, që mund të jenë bërë, do të thotë të dëmtosh punën. Të mos i goditësh dhe të mos i kritikosh këto gabime, prapë çshtë një krim që mund t'i bëhet çështjes së popullit. E kemi inkurajuar edhe po e inkurajojmë kritikën e shëndoshë, pa të cilën nuk mund të ecin punët mbarë. Populli duhet ta mbajë fort dhe ta përdorë si duhet dhe ku duhet këtë armë të shëndoshë. Njerëzit që e duan çështjen e popullit, atje ku punojnë, atje ku lodhen dhe dërsijnë, të kritikojnë gabimet që bëhen, bile ashpër, pse vetëm në këtë mënyrë do të korrigjohen. Ka njerëz, por që përfat të mirë nuk janë të shumtë, që kritikën e kanë në majë të gjuhës; zaten vetëm atë punë bëjnë. Këta janë kritizerë të sëmurë, të shkëputur nga kolektiviteti, ngajeta, nga puna, nga vështirësitë në punë. Këta parazitë që hanë kot bukën e popullit, por që s'u hahet aspak buka me popu-

llin, s'bëjnë përveçse lodrën e armikut dhe puqen me armikun. Këtyre njerëzve s'kemi përtuar dhe as do të përtojmë t'u tregojmë vendin që meritojnë.

Sukseset që arritëm në vitet e kaluara në të gjitha lëmët e aktivitetit shoqëror, ekonomik, politik dhe kultural do të na shërbejnë si një bazë e shëndoshë që këtë vit dhe vitet e ardhshme të korrim suksesc edhe më të mëdha. Populli ynë sa është modest, aq është dhe dinamik; ai nuk dehet nga sukseset, por e di se përpara tij qëndron akoma një punë e madhe për të bërë, qëndrojnë detyra të rënda për t'u kryer. Vështirësi, pengesa, mungesa do të ketë në rrugën ku po ecim për ndërtimin e jetës sonë më të mirë. Ky është realiteti, por realitetin s'kemi pasur frikë ta shikonim në sy edhe atëhere kur ai ishte i tmerrshëm, jo tani që puna ka ndryshuar krejt dhe ecën në favorin tonë. Pushteti ynë popullor sot është në gjendje të veprojë që vendi ynë të hyjë në fazën e zhvillimit të ekonomisë së planifikuar. Qeveria e ka gati planin njëvjeçar për vitin 1947. Në bazë të këtij plani po zhvillohen punimet dhe për së shpcjti ky do të shpallet. Zbatimi i planit si duhet dhe me sukses, do të jetë një nga fitoret e mëdha të popullit tonë. Realizimi i planit të shtetit për vitin 1947 na hap rrugën për realizimin e planeve të tjera me afate më të gjata. Plani i shtetit përsaqëson gjithë punën vjetore të popullit tonë, të studjuar dhe të koordinuar në mënyrë të tillë që ndërtimi ekonomik dhe kultural i Shqipërisë së re të ecë përpara me hapa më të mëdha dhe të sigurta. Këtej del vetëvetiu e qartë se, për realizimin e plotë dhe me sukses të planit, duhet mobilizimi i gjithë popullit, i madh e i vogël, pse plani përsaqëson punën, detyrat,

shpresat, ndërtimin e një jete më të mirë, ngritjen e nivelit arësimor dhe kultural për çdo nënshtetas shqiptar. Zbatimi me sukses i planit të shtetit do të thotë forcimi i pushtelit tonë popullor, sigurimi i indipenden-cës dhe i sovranitetit tonë. Prandaj, për çdo nënshtetas shqiptar, që nga pionieri dhe deri te plaku i thinjur, puna, kryerja e detyrave, realizimi i planit të shtetit, janë çështje jetike, janë çështje nderi, janë çështje patriotike. Këtu tregohet dashuria për popullin, për at-dheun. Patriotizmi i çdo shqiptari as mund të kuptohet, as mund të tregohet jashtë këtyre detyrave.

Detyra të mëdha na shtrohen përpara në sektorin e bujqësisë, pse ky është një sektor shumë i rëndësi-shëm i ekonomisë sonë. Në këtë sektor duhet t'i jepet rëndësia më e madhe shtimit dhe përmirësimit të pro-dhimit. Për këtë arësy, me gjithë konditat e vështira atmosferike, duhet të vazhdohet sistematikisht fushata e mbjelljeve pranverore, fushata e mbjelljeve të bimëve industriale, të organizohet një fushatë e madhe dhe të zhvillohet iniciativa e masave të popullit për të zgje-ruar sipërfaqen e tokës së punueshme. Në këtë drejtim, përveç bonifikimeve me karakter të gjerë, të parashikuara në planin e shtetit, populli me iniciativën e vet duhet të ndërmarrë çeljen e kanaleve të vogla, spastrimin e kullotave etj. Në bujqësi duhet t'i jepet rëndësi organizimit të punës së përbashkët dhe, sipas mundësive, ngritjes së kooperativave bujqësore. Një gjë e tillë është e lidhur ngushtë me modernizimin e bujqësisë, prandaj duhet të shfrytëzohen racionalisht të gjitha stacionet e mekanikës bujqësore. Gjithë buqit e Shqi-përisë duhet të kujdesen me dashurinë më të madhe

për tokën e tyre, për mbjelljet, për farërat, për prodhimet, për kafshët e punës. Ata të futin në përdorim mjetet e reja të punës dhe të prodrojnë sa më tepër, për jetën e tyre dhe për të furnizuar me bollëk shokët e tyre në fabrika e qytete. Ndihma që u jep qeveria bujqve duhet të fuqizohet me iniciativën dhe me punën e tyre të palodhur.

· Në sektorin e industrisë shteti ynë do të vërë forcat për zhvillimin e industrisë së lehtë me fabrikat e ndryshme që ndodhen në vendin tonë dhe me ato që do të sjellë nga jashtë, për të plotësuar kështu nevojat e popullit. Do të organizojë shfrytëzimin më racional të minierave tona dhe në radhë të parë të naftës, do të organizojë studime të nëntokës, do të bëjë elektrifikimin e pjesshëm të vendit tonë. Këtu e kanë fjalën punëtorët, teknikët, organizatorët e ndërmarrjeve tona industriale. Punëtorët e Shqipërisë, që kanë luftuar me aq heroizëm për çlirimin e atdheut, duhet të punojnë po me atë heroizëm në rindërtimin e vendit tonë. Ata duhet të jenë për të gjithë shembulli më i lartë i patriotizmit, i disiplinës në punë, i zbatuesit të përpiktë të planit të shtetit. Në të gjitha vendet e punës, në kantiere, fabrika, ndërmarrje industriale duhet të punohet me gara të vazhdueshme, duhet të ngjallet dhe të zhvillohet në kulm iniciativa dhe emulacioni, duhet të vihen, të zbatohen dhe të tejkalojen vazhdimeshit normat e caktuara prej shtetit, se në këtë mënyrë do të përparojë vendi ynë, industria jonë do të shtohet dhe do të përmirësohet prodhimi, do të ulet kostua. Unë jam më se i bindur se punëtorët e Shqipërisë do t'i kryejnë deri në fund detyrat që u ngarkon atdheu.

Detyrë tjetër kryesore është zhvillimi i kooperativave të ndryshme të prodhimit, si të artizanatit, të konservave të peshkut, të bulmetit, të konservimit të frutave, etj. Kooperativat duhet të bëhen ndihmëset kryesore të organeve shtetërore për grumbullimin dhe shpërndarjen e sidomos për ato sende që s'ka mundësi t'i mbledhë shteti. Duhet që kooperativat të bëhen të masave. Një nga konditat e domosdoshme për to është që kooperativat të drejtohen kolektivisht nga anëtarët që marrin pjesë në to. Grumbullimi dhe shpërndarja e drejtë dhe e shpejtë e mallrave duhet të jetë një problem me rëndësi që duhet të preokupojë, si organet shtetërore, ashtu edhe ato kooperativiste. Dyqanet e shtetit duhet të përmirësojnë punën e tyre, pse kanë mjaft të meta dhe t'i shërbejnë popullit sa më mirë.

Lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik dhe politik të vendit tonë është çështja e arësimit dhe e kulturës. Ky problem i madh s'është vetëm problemi i mësuesve dhe i profesorëve, por është problemi i gjithë masave të popullit. Për këtë duhet të vazhdohet sistematikisht luftha kundër analfabetizmit, të ngrihen sa më shumë dhe të vazhdojnë në rregull shkollat fillore, uniket, të mesmet, shkollat e natës, shkollat e ndihmësmjeshtrave, kurset e ndryshme, etj. Arësimi dhe kultura duhet të bëhen të masave. Duhet të inkurajohet dhe të ndihmohet zhvillimi i literaturës sonë, i teatrit, i piktorës, i folklorit. Zhvillimi i këtyre të bëhet në baza të drejta, të jetë i lidhur ngushtë me realitetin shoqëror, ekonomik dhe politik të vendit tonë, të jetë i lidhur ngushtë me popullin dhe të pasqyrojë luftën e tij, përpjekjet, aspiratat, perspektivën e ndritur të rrugës ku po ecën populli ynë.

Për këtë gjë duhet luftuar kundër bazave të shtrembëra ideologjike. Profesorët, mësuesit, letrarët, artistët tanë patriotë, duhet të luftojnë kundër parimeve të gabuara dhe elementeve të gabuar, duhet të mësojnë dhe të pajisen me kulturë dhe me artin përparimtar, me shkençën e vërtetë që i shërben popullit dhe vetëm popullit.

Përveç gjithë punimeve të tjera me rëndësi që parashikon plani i shtetit, ndërtimi i hekurudhës Durrës—Elbasan zë një vend nga më të rëndësishmit. Ndërtimi i hekurudhës Durrës—Elbasan, hekurudha e parë në Shqipëri, me një rëndësi të dorës së parë për zhvillimin ekonomik dhe kultural të vendit tonë, ju besua rinisë sonë të lavdishme.

Shokë të dashur të rinisë,

Kudo ku ju thërret atdheu, ju jeni të parët. Ju të parët u gjakosët dhe u vratë në rrugët e qyteteve me okupatorët, ju të parët u hodhët në male me pushkë në dorë, ju të parët mbushët dhe udhëhoqët çetat e lavdishme të Luftës nacional-çlirimtare; heroizmat dhe theoritë tuaja legjendare e çuan popullin në kryengritjen e përgjithshme, ju ishit shtyllë e ushtrisë sonë heroike, juve ju ra barra më e madhe e luftës për çlirimin e atdheut. Dhe pas çlirimit të atdheut ju ndoqët shembullin dhe mbajtët amanctin e shokëve tuaj heroikë, që ranë nëpër fusha e nëpër male të Shqipërisë dhe të Jugosllavisë, për Shqipërinë e re, për Shqipërinë e popullit. Atdheu dhe populli është gjithëjeta juaj; askush nuk mund të pretendojë se e ka kuptuar këtë më mirë se ju. Ju me fakte e tregoni. Ju

e keni kuptuar mirë se e ardhmja është juaja dhe se duhet punuar për këtë. Ju e keni kuptuar se duhet të pajiseni me arësim dhe me kulturë, konditë e domosdoshme për të shkuar përpëra, dhe ju rregullisht dhe me sukses frekuentoni shkollat dhe kurset e ndryshme; ju e keni kuptuar se duhet ngritur ekonomia jonë dhe ju shquheni në fabrika, në punëtorira, në ara; ju e keni kuptuar se duhen mbrojtur fitoret e luftës, duhen mbrojtur populli, liria dhe pavarësia e atdheut tonë dhe ju jeni të parët që me gjësim mbushni dhe forconi radhët e Ushtrisë sonë Kombëtare, pjella më e shtrenjtë dhe më e dashur e popullit tonë. Në flamujt tuaj të rinisë nuk numërohen fitoret; ato janë të rëndësishme si njëra-tjetra. Në të gjitha punët e rëndësishme të vendit tonë është vula juaj dhe këtu është siguria në pavdekshmërinë e këtyre veprave. Vjet ndërtuat me sukses rrugën Kukës—Peshkopi, sivjet po ndërtoni hekurudhën tuaj. Unë jam i sigurt se ju do ta kryeni detyrën, se ju do t'i kapërceni të gjitha pengesat. Ju e dini se ka pengesa në punë, se ka mungesa, shumë prej jush nuk kanë këpucë në këmbë, rrobat i kanë me zhele, por s'ka gjë, kemi parë edhe momente më të vështira, shpirti juaj është i lirë, vullneti juaj është i çelniktë, patriotizmi juaj është i zjarrtë. Ne do të punojmë dhe do t'i krijojmë konditat më të mira; nesër do të kemi edhe këpucë, edhe rroba, edhe bukë më shumë, edhe kulturë më shumë. Me një rini heroike, siç është rinia jonë, atdheu ynë do të përparojë.

Rroftë rinia jonë heroike!

Lavdi të rinjve dhe të rejave që punojnë në hekurudhën Durrës—Elbasan.

Popull shqiptar,

Për realizimin e planit të shtetit është i domosdoshëm forcimi dhe modernizimi i pushtetit tonë popullor, kjo do të thotë që aparati i tij të organizohet më së miri, të përdoren të gjitha vlerat e popullit tonë, të ngrihen dhe të edukohen kuadro, dhe në anën tjetër kontrolli dhe syri i popullit të jetë i fortë dhe i shumanshëm. Kontrolli në punë të jetë i fortë, i shumanshëm. Kërkohet prej të gjithëve të marrin përgjegjësi përpara punës që u është caktuar dhe disiplina në punë duhet të jetë e hekurt. Ligjet e shtetit, urdhëresat, rregulloret, planet duhet të realizohen me rigorozitetin më të madh. Duhet të jeni të ashpër dhe intransigjentë përpara negligencave dhe gabimeve. Të gjithë funksionarët e shtetit të ruajnë modestinë, të jenë të dashur me popullin, t'i shërbejnë ditë e natë popullit. Të gjithë funksionarët e shtetit duhet të kuptojnë mirë se mbështetja jonë është në masat e gjera të popullit. Këto masa të gjera të popullit, që kanë kaq vullnet, kaq entuziazëm, duhet të drejtohen drejt, por jo vetëm kaq, ne, nga ana tjetër, duhet të mësojmë nga masat, pse ato me shpirtin e tyre krijues do të na japid zgjidhjen e shumë problemeve të koklavitura. Puna jonë duhet të karakterizohet kudo nga një ritëm i shpejtë dhe i shëndoshë; s'mjafton të radhiten shifra, por këto duhet të jenë reale, statistikat të jenë të sakta dhe të plota. Duhet të kuptohet mirë se pa këto të dhëna, do të na çalojnë shumë punët. Asnjeli s'e dëshiron këtë gjë, prandaj të punohet kudo me ndërgjegje. Kjo duhet të bëhet ligj për të gjithë.

Sot, me rastin e festës së 1 Majit, Fronti Demo-

kratik duhet t'i bëjë thirrje patriotizmit të popullit tonë dhe të mobilizojë të gjitha masat në rindërtimin e atdheut.

Punëtorë dhe bujqë të Shqipërisë, përvishuni një punë të palodhur dhe të vazhdueshme, pse nga ju varen ndërtimi dhe e ardhmja më e mirë e vendit tonë; zhvilloni garat e përgjithshme kudo që punoni; prodhoni sa më shumë dhe sa më mirë; perfeksiononi punën tuaj; kursemi sa më shumë dhe mbroni pasurinë e popullit!

Intelektualë patriotë të Shqipërisë, mobilizoni gjithë forcat tuaja dhe i vini si kurdoherë në shërbim të atdheut!

Gra të Shqipërisë, ju jeni një forcë e madhe, e gjallë e popullit tonë, që ka filluar të ndjehet dhe të peshojë fort në rindërtimin dhe përparimin e atdheut. Sa shumë e doni atdheun, sa ju dhimbset puna, sa është i madh zelli juaj për dritë, për përparim, ju këto i tregoni me prova çdo ditë. Shtojeni aktivitetin tuaj në çdo fushë, atdheu do të përparojë me ritmin e përparimit tuaj!

Rini heroike e vendit tonë, kurrë të mos ndalet hovi yt triumfues, kudo të dëgjohet kënga jote e re, kudo të duket dora jote e fortë, kudo të ndjehet mendja jote e shëndoshë. Me hovin dhe me entuziazmin që të karakterizon, ti shko në punë dhe nü shkollë, se ti je shpresa e atdheut, se ti je pranvera e jetës së popullit tonë !

Ushtarë dhe oficerë të Ushtrisë sonë Kombëtarë, juve ju ka ngarkuar populli t'i ruani dhe t'i mbroni si sytë e ballit gjérat e tij më të shtrenjta, fitoret e luftës së çlirimit: lirinë, indipendencën, integritetin e atdheut

tonë. Ky nder i madh ju bie juve dhe ju do ta kryeni me nder detyrën tuaj. Të ecni me vendosmërinë që ju karakterizon në rrugën e lavdishme të luftës së çlirimt, të forconi dhe të modernizoni Ushtrinë Kombëtare. Dashuria dhe mirënjohja e popullit ndaj djemve të tij heroikë, s'do t'ju mungojë asnje moment! Rroftë ushtria jonë heroike !

Popull shqiptar,

Forcimi i shtetit tonë, i demokracisë sonë, ruajtja e pavarësisë dhe e lirisë sonë varet nga kryerja e detyrave që na vihen përpara. Këtej varet edhe e ardhmja jonë më e lumtur.

Reaksionarëve të brendshëm dhe reaksionit ndër-kombëtar s'u leverdis që në vendin tonë të lulëzojë demokracia popullore, të forcohet pushteti i popullit, të përparojë dhe të rindërtohet vendi ynë dhe jeta jonë. Një fushatë shurdhuese është ngritur nga nxitësit e luftës, të cilët kërcënojnë popujt e lirë, kërcënojnë paqen me anë të forcës, me anë të dollarit, me anën e bombës atomike. Disa të shitur të vendit tonë, mbeturina dhe këlyshë të fashizmit, që për fat të mirë janë të paktë në vendin tonë, po ngrenë veshët e tyre të zgjebosur dhe me nostalgji mbajnë vesh dhe shikojnë se ç'e mirë do t'ju vijë nga deti. Por as nga deti dhe as nga kufitë tanë të Jugut nuk do të vijë asgjë e mirë për ta, ata i pret vetëm grushti i rëndë i drejtësisë së popullit tonë.

Këta njerëz të poshtër s'heqin dorë nga tradhëtia, ata i kanë zili dollarët dhe stërlinat që imperialistët

anglo-amerikanë u japid fashistëve grekë dhe turq për të shtypur popujt e këtyre vendeve. Më kot ata pëshpëritin qosheve se «situata do të ndryshojë, së shpejti do të kemi luftë, etj.». Por ajo që ëndërrojnë këta tradhëtarë, nuk do të ngjajë. Populli ynë u ka dalë borxhit këtyre njerëzve, populli ynë i bën sytë katër para armiqve të tij, populli ynë nuk fle dhe populli ynë do t'i shfarosë këta pa mëshirë.

Të gjitha manevrat e poshtra, që kërkon të luajë reaksioni ndërkombëtar në kurrizin e popullit tonë, po demaskohen njëra pas tjetrës dhe popujt e përparuar të gjithë botës shohin qartazi sa të padrejta janë qëndrimet e qeverive angleze dhe amerikane ndaj popullit heroik dhe paqedashës shqiptar. Të gjitha akuzat, që na bëjnë neve këto qeveri, kthehen kundër tyre dhe lodrat e qëllimet e tyre demaskohen keqas. A mundet populli ynë i vogël të kërcënojë paqen dhe Anglinë sikundërqë pretendojnë qeveritarët anglezë dhe amerikanë? Kjo është qesharake. Populli shqiptar do të rrojë i lirë, i qetë në punën e tij paqësore dhe ndërtimtare, ai do të rrojë në harmoni të plotë me të gjithë popujt përparimtarë të botës. Populli shqiptar luftoi me heroizëm për këtë paqe dhe tani puna e tij nuk i shërben përvçese paqes së shëndoshë dhe të drejtë. Populli shqiptar nuk ka frikë nga kërcënimet, nga shantazhet dhe shpifjet, ai ecën me vendosmëri në rrugën e tij të drejtë, që është rruga e përparimit dhe e paqes. Por tentativat e reaksionit ndërkombëtar për prishjen e paqes do të dështojnë me turp, pse ata janë të pafuqishëm përpara bashkimit të popujve demokratikë dhe liridashës të botës, pse në krye të forcave demokratike e

përparimtare të të gjithë botës qëndron Bashkimi i madh Sovjetik. Bashkimi Sovjetik, që çlroi botën nga sklavëria më e rëndë e fashizmit gjerman, sot, me politikën e tij të drejtë dhe paqësore, si kurdoherë, u përgjigjet dëshirave, shpresave dhe interesave të të gjithë popujve demokratikë dhe përparimtarë të botës.

Populli shqiptar e do Bashkimin Sovjetik dhe udhëheqësin e tij të madh, sepse ai sheh se Bashkimi Sovjetik e mbron Shqipërinë e vogël demokratike, i mbron të drejtat e saja të pamohueshme, mbron lirinë dhe pavarësinë e popullit të vogël shqiptar.

Populli ynë, sikundër edhe gjithë popujt e tjerë të botës, shohin te Bashkimi Sovjetik mbrojtësin e lirisë, të përparimit dhe të paqes, shohin të siguruar të ardhmen e tyre; prandaj, me rastin e festës së 1 Majit, të gjithë njerëzit e Shqipërisë brohorasin: Të rrojë Bashkimi Sovjetik dhe udhëheqësi i tij Stalini i madh.

Duke ju uruar të gjithëve nga zemra festën e 1 Majit le të brohorasim :

Rroftë populli shqiptar !

Të rrojë dhe të forcohet dita-ditës atdheu ynë i dashur !

Rroftë Bashkimi Sovjetik dhe Stalini i madh, miku më i shtrenjtë i popullit tonë !

Rroftë dhe u forcoftë dita-ditës Fronti Demokratik i popullit tonë !

Rroftë Partia heroike Komuniste e Shqipërisë !

Rrofshin punëtorët, fshatarët dhe intelektualët patriotë të Shqipërisë !

Rrofshin të rinjtë dhe të rejat që punojnë në hekurudhën Durrës—Elbasan !

Rroftë populli i Durrësit dhe i rrëthit të tij !

Rroftë dita e 1 Majit!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 729,*

2 maj 1947

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 729,*

2 maj 1947

URDHËR DITE ME RASTIN E PËRVJETORIT TË DYTË TË FITORES MBI GJERMANINË NAZISTE

9 maj 1947

Ushtarë, nënoficerë, oficerë, gjeneralë të Ushtrisë Kombëtare,

Popull shqiptar,

Sot festojmë përvjetorin e dytë të fitores mbi Gjermaninë naziste. Kjo datë e shënuar për historinë dhe fatet e gjithë botës, simbolizon luftën e ashpër të popuje liridashës dhe përparimtarë me në krye Bashkimin e madh Sovjetik, luftën dhe fitoren e tyre mbi forcat e reaksionit më të zi, fashizmit gjerman. Më 9 maj 1945, njerëzimi shpëtoi prej skllavërisë së imperializmit gjerman, i cili synonte të vendoste kudo regjimin e errësirës dhe të shlypjës më të tmerrshme. Fashizmi u mund në saje të luftës, të forcës dhe të heroizmit legjendar të ushtrisë dhe të popullit sovjetik, nën udhëheqjen e Stalinit të madh. Për këtë fitore të madhe u ngritën peshë gjithashtu forcat e tjera antifashiste dhe gjithë popujt e robëruar të Evropës. Për t'ja arritur kësaj dite u deshën sakrifica të panumërtë, miliona njerëz të vrasë, shkatërrime dhe vuajtje të mëdha. Prandaj, sot dita e fitores për gjithë botën është një ditë e madhe mobili-

zimi për ruajtjen e fitores, për forcimin e paqes dhc të demokracisë. Për disa vende, ku akoma sundon regjimi i shtypjes dhe i terrorist, dita e 9 majit është ditë përpjekjesh për të fituar lirinë dhe pavarësinë kombëtare, të drejtën për të vendosur mbi fatet e veta. Dy vjet mbas fitores mbi Gjermaninë naziste, klikat reaksionare të udhëhequra prej imperializmit amerikan po bëjnë përpjekje dhe manevra djallëzore, po hedhin parulla për një luftë të re kundër interesave dhe dëshirave të njerëzimit përparimtar. Por manevrat e tyre do të dështojnë, sepse sot më tepër se kurrë qëndron i madh dhe i fuqishëm bashkimi i forcave demokratike të gjithë botës, fronti i madh antiimperialist.

Ushtarë, nën oficerë, oficerë, gjeneralë të Ushtrisë Kombëtare,

Dita e 9 majit është ditë fitoreje, ditë festë dhc gjëzimi për ushtrinë dhe për popullin tonë. Në luftën e madhe antifashiste vendi ynë është nga të parët që u hodh pa rezerva, që u angazhua në përpjekje të ashpra dhe të pabarabarta me forcat fashiste. Lufta jonë nacional-çlirimtare arriti të bëhet një zjarr i madh kundër forcave të okupatorit. Në beteja të ashpra kundër divizioneve fashiste u rrit dhe u forcua ushtria jonë heroike. Ajo nuk u zembraps kurrë, por në luftime të përgjakshme u mbulua çdo ditë me lavdi. Ushtria jonë çlroi me forcat e veta atdheun tonë, ndoqi këmba-këmbës hordhitë naziste dhe kreu deri në fund me nder detyrën e saj. Sot në përkujtimin e ditës së madhe të fitores ne u çojmë mirën johjen tonë të thellë kujtimit të atyre mijëra dëshmorëve tanë të lavdishëm që ranë për çlirimin e atdheut dhe të popullit.

Sot Ushtria jonë Kombëtare është bërë roje vigjilente e fitoreve të luftës së çlirimit, e indipendencës dhe e integritetit të atdheut tonë. Duke ndjekur rrugën e traditave të lavdishme të Luftës nacional-çlirintare dhe duke u përgjegjur konditave të zhvillimit tonë pa-qësor, detyra e ushtarëve, nënoficerëve, oficerëve dhe gjeneralëve të ushtrisë sonë është të mësojnë artin ushtarak, të forcojnë dhe të modernizojnë radhët e ushtrisë, të bëhen sa më të zot dhe sa më vigjilentë në ruajtjen e fitoreve të popullit. Çdo ushtar dhe oficer duhet të dijë mirë se puna dhe përpjekjet e popullit tonë fuqizohen duke pasur përkrah mbrojtjen, sigurimin e ushtrisë sonë trime. Në këtë ditë fitoreje dhe gjëzimi kombëtar, gjithë populli ynë shpreh dashurinë e tij më të madhe për djemtë e tij ushtarë dhe ju uron atyre suksese në zhvillimin e tyre, në punën për forcimin e Ushtrisë sonë Kombëtare.

Ushtarë, nënoficerë, oficerë, gjeneralë të Ushtrisë Kombëtare, popull shqiptar,

Ne festojmë sivjet 9 majin duke u mobilizuar në kryerjen e detyrave që na dalin përpara në këtë rrugë. Detyra jonë kryesore është të mobilizojmë qind për qind forcat për ndërtimin e një jete më të mirë, të forcojmë bashkimin dhe unitetin tonë politik në Front. të ecim me vendosmëri dhe të kapërcejmë çdo pengesë që na del përpara, të kemi besim në të ardhmen tonë. Në këtë ditë festë dhe solidariteti ndërkombëtar ne shfaqim dashurinë dhe miqësinë tonë ndaj popujve të Bashkimit Sovjetik dhe gjithë popujve paqedashës dhe demokratikë; ne bashkojmë dëshirat dhe përpjekjet tona me ato të të gjithë popujve përparimtarë për forcimin

e paqes dhe të demokracisë, për dështimin e manevrave të shteteve imperialiste të Perëndimit, për të provokuar një luftë të re.

Rroftë dita e fitores !

Rroftë populli heroik shqiptar !

Rroftë Ushtria heroike Kombëtare !

Lavdi të përjetshme dëshmorëve tanë që sakrifikuan jetën pér atdheun dhe pér popullin!

Rroftë Ushtria e lavdishme Sovjetike dhe Stalini i madh, faktorët kryesorë të fitores së madhe mbi fashizmin skllavërues !

Rroftë Bashkimi Sovjetik, mbrojtësi i pamposhtur i paqes së vërtetë dhe i sigurimit botëror, miku më i shtrenjtë i popullit shqiptar !

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 735,*

9 maj 1947

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi». Nr. 735,*

9 maj 1947

**LETËR DËRGUAR ORGANIZATAVE TË PARTISË
NË TERREN DHE NË USHTRI NË LIDHJE
ME OPORTUNIZMIN E SEJFULLA MALESHOVËS
DHE ME DËNIMIN E KËTIJ OPORTUNIZMI
NGA KQ I PARTISË**

10 maj 1947

**GJITHË ORGANIZATAVE TË PKSH NË TERREN DHE
NË USHTRI**

*Mbi qëndrimin që duhet të mbajë Partia ndaj
Sejfulla Malëshovës*

Plenumi V i Komitetit Qendror të Partisë, i mbajtur më datën 21 shkurt 1946 përjashtoi Sejfulla Malëshovën nga Byroja dhe nga Komiteti Qendror i Partisë për arësyet të pikëpamjeve të tija politike dhe ekonomike të gabuara. Pikëpamjet politike të Sejfulla Malëshovës ishin thellësisht oportuniste, qoftë në politikën e jashtme të Partisë sonë, qoftë në politikën e brendshme. Këto pikëpamje ishin në kundërshtim me vijën e drejtë të Partisë sonë.

1. — Në politikën e jashtme, Sejfulla Malëshova nibronte një politikë të gjerë dhe liberale, kryesisht oportuniste, në lidhje me marrëdhënjet që duhej të

kishte shteti ynë me shtetet imperialiste anglo-amerikanë si dhe me ato shtete të tjera, ku situata e jashtme dhe e brendshme e tyre ishte dhe qëndron akoma e errët. Sejfulla Malëshova, marrëdhënjet e shtetit tonë me shtetet imperialiste të lartpërmendura, i vinte në një plan me marrëdhënjet që vendi ynë duhej të kishte dhe ka me shtetet thellësisht demokratike dhe aleatë e miq besnikë të popullit tonë. Sejfulla Malëshova thoshte : «për politikën e jashtme ne duhet të orientohemi nga Bashkimi Sovjetik, por zyrtarisht, ne, aleatët duhet t'i vëmë në një plan».

Qëllimet dhe tendencat e reaksionit anglo-amerikan, të cilat u manifestuan gjatë gjithë zhvillimit të luftës, qëllime dhe tendenca që Partia jonë ja vuri në dukje gjithë anëtarëve të saj me qëllim që këta të ishin të quartë në vijën politike në kuadrin e aleancës antifashiste, u shfaqën në mënyrë brutale dhe agresive, pas mbarimit të luftës, kundër Bashkimit Sovjetik, faktorit të madh të fitores, kundër demokrave përparimtare të dala nga lufta dhe veçanërisht kundër vendit tonë, ku populli kishte vendosur një regjim të tillë. Sejfulla Malëshova nuk ka dashur ta kuptonte këtë irrezik dhe këto shfaqje të imperialistëve anglo-amerikanë. Më vonë, kur u goditën nga Partia pikëpamjet e tija të gabuara, ai ka thënë : «Gabimi im personal ka qenë se unë mendoja që këto çështje (qëndrimet agresive të imperialistëve anglo-amerikanë kundër Bashkimit Sovjetik, etj.) nuk do të dilnin kaq shpejt dhe kaq të ashpra».

Do të ishte gabimi më i rëndë po të mendohej që në një situatë të tillë Partia jonë të vinte në një plan mbrojtësit e demokracisë së vërtetë, të paqes dhe të

sigurimit botëror, me imperialistët anglo-amerikanë, mbrojtësit e fashizmit dhe të mbeturinave të tij, nxitësit e një lufte të tretë botërore. Në një gabim të tillë ra Sejfulla Malëshova. Sejfulla Malëshova, konskuent në vijën e tij të gabuar, shkonte edhe më tej. Ai thoshte : «Në lidhje me situatën e jashtme është një detyrë imperative që demokracisë formale duhet t'i bëjmë edhe ndonjë koncesion. Karshi demokrative të Perëndimit duhet të jemi të matur, duhet të bëjmë disa koncesione për të mbajtur pozitat tona. Gjithashtu koncesione mund t'u bëjmë edhe në fushën ekonomike, etj.». Këto pikëpamje Sejfulla Malëshova u përpoq që Partia t'i pranonte dhe t'i zbatonte, por Partia i hodhi poshtë. Kur qeveria amerikane i vuri qeverisë sonë si kusht njohjen e traktateve të vjetra që kishte lidhur Zogu me Shtetet e Bashkuara, Sejfulla Malëshova mbronte pikëpamjen se duhej pranuar kondita e amerikanëve për njohjen e qeverisë sonë. Pranimi i një kushti të tillë do të thoshte shkelje e sovranitetit të vendit dhe të popullit tonë dhe çelja e derës për koncesione të tjera anglo-amerikanëve. Partia s'pranoi kurrsesi një kusht të tillë për popullin dhe vendin tonë. Sejfulla Malëshova detyrohet të pohojë më vonë pikëpamjen politike të tij të gabuar duke thënë : «Unë, personalisht, kam qenë për njohjen e qeverisë, e cila do të forconte pozitat tona, por nuk duhej ta konsideroja të domosdoshme njohjen e qeverisë dhe se kjo do të vinte vetëm me koncessionet që do t'i linim imperializmit anglo-amerikan». Pikëpamjet e Sejfulla Malëshovës kanë qenë po kaq oportuniste edhe ndaj marrëdhënjeve me Italinë, me të cilën ai shihte mundësira marrëdhënjesh tregëtare që në ato momente kur

ne kishim dalë nga një luftë me të dhe kur situata e brendshme në Itali ishte dhe qëndron gjithmonë e errët. Sikur Partia jonë të kishte ndjekur pikëpamjet krejtësisht të gabuara të Sejfulla Malëshovës, ajo do të humbiste pozitat drejtuese, do të vendosej në vatrat tona influenca c'egër e imperializmit dhe populli ynë do të hynte në një robëri të rëndë, të përgjakshme. Vendi ynë do të bëhej një Greqi e dytë ku do të sundonin kuislingët dhe kriminelët e luftës.

2. — Sejfulla Malëshova, kurdoherë konsekuent në pikëpamjet e tija oportuniste në politikën e jashtme, kishte po këto qëndrime edhe në politikën e brendshme të Partisë sonë. Ai ishte për një front shumë të gjerë, ku lehtësish mund të maskoheshin dhe të vpronin të organizuar armiqëtë e popullit tonë dhe ku diferencimi dhe lufta kundër këtyre elementëve armiq do të bëhej shumë e vështirë. Ai ishte për një politikë të butë kundër këtyre elementëve armiq. Megjithëse predikonte gjoja një luftë me ta, ai nga ana tjetër u jepë këtyre mundësitë ta bënин luftën kundër nesh me mjete gati të barabarta, qoftë ideologjike, qoftë ekonomike. Sejfulla Malëshova mbronte pikëpamjen e një politike të ëmbëlsuar me klerin reaksionar katolik, pikërisht kur ky po preqatitej të na godiste. «Gabimi më i madh që unë kam bërë, ka thënë Sejfulla Malëshova përpara Plenumit V të Partisë, ishte çështja me katolikët. Unë mendoja se kleri ishte kundër nesh, porse ne mund të përsitonim nga ai dhe nga ana tjetër e kishim frikë atë se ai kishte lidhje me masat. Kur më tha shoku Enver se arkipeshkvi thotë se «s'ka asnjë katolik që të jetë me Enverin» unë e nënvlërësoja armiqësinë e tyre

dhe s'mejtoja dot komplete, etj. që ata po organizonin dhe e dyta unë e vlerësoja shumë forcën e tyre, por tani u pa që ata nuk kanë qenë aq të fortë». Nga ky pohim i Sejfulla Malëshovës nuk del vetëm mbivlerësimi i forcës së klerit reaksionar, por del dhe mosbesimi në forcën e Partisë dhe të popullit tonë. Sejfulla Malëshova ishte mbrojtësi i pikëpamjes që në Asamblenë Kushtetuese të vinin një numër i konsiderueshëm «nacionalistësh» që jo vetëm s'kishin dhënë prova të mjafta për besnikëri ndaj popullit, por që kishin filluar që në atë kohë të kritikonin, gjoja si pjesëtarë të Frontit. Një pjesë e këtyre deputetëve «nacionalistë» sot ndodhen në burg për veprimtari kundër pushtetit të popullit¹. Sejfulla Malëshova, gjoja nën pretekstin e mbrojtjes së intelektualëve përparimtarë, inkurajonte dhe shtynte përpara të gjithë ata intelektualë reaksionarë dhe armiq të pushtetit tonë. Kështu e kuptonte Sejfulla Malëshova politikën e brendshme të Partisë sonë dhe ishte i bindur se kjo ishte rruga më e drejtë. Politika ekonomike e Partisë sonë, sipas pikëpamjes së Sejfulla Malëshovës, duhej gjoja të synonte në mëkëmbjen e sektorit të shtetit, por kjo duhej të bëhej në një luftë të vazhdueshme dhe të gjatë me sektorin privat ndaj të cilit duhej të tregoheshim gjerësisht liberalë dhe t'i linim fushë të gjerë veprimi dhe zhvillimi. Në artikullin: «Politika jonë ekonomike», botuar në gazeten «Bashkimi» më 25

¹ Është fjala për grupin e deputetëve tradhëtarë të kryesuar nga Shefqet Beja që, të nxitur dhe të përkrahur nga imperialistët amerikanë e anglezë, punuan për përmbysjen me forcë të pushtetit popullor. Ata u zbuluan e u gjykuau nga gjyqi i popullit dhe muarën dënimin e merituar.

dhjetor 1944, Sejfulla Malëshova shkruan: «Eshtë një detyrë e madhe aktuale, një nga detyrat kryesore që sektorët e ekonomisë sonë që kanë ekzistuar gjatë mësot, të hyjnë në aktivitet, të ngjallen dhe të lulëzojnë në bazë të iniciativës së plotë private». Një model konfuzioni dhe pikëpamjesh politike dhe ekonomike të gabuara dhe antimarksiste janë opinionet e shfaqura prej Sejfulla Malëshovës në Plenumin IV të Partisë dhe që i shënojmë më poshtë, tekstualisht të nxjerra nga procesverbalet e Plenumit IV të Komitetit Qendror.

Ja si mendon Sejfulla Malëshova: «Industria janë ka qenë në luftë me industrialët e jashtëm prandaj ne mund t'i bëjmë me vete industrialët. Kjo varet nga një politikë e drejtë ekonomike që duhet të bëjmë. Ne duhet të forcohem; fshatarët dhe punëtorët u bënë me ne gjatë luftës, por nuk i kemi qind për qind me ne. Me punën tonë duhet t'i bëjmë me vete si këta, ashtu dhe industrialët dhe gjithë shtresat e tjera. Me politikën tonë ekonomike ne duhet të nxitim punën private, iniciativën private. Industrialët janë me të vërtetë të fortë, por ne kemi minierat, bankën, pushtetin. Gjithashtu kemi në dorë tregëtinë e jashtme, monopolin. Ne duhet të forcohem ekonomikisht, por, siç do forcohem ne, do forcohem dhe ata. Kjo është në favorin tonë nga pikëpamja ekonomike. Kjo politikë e gjerë sjell me vete që në formë të zmbrapsemi, por në lidhje me situatën e jashtme, kjo është një detyrë imperative. Pra ne duhet të ndihmojmë zhvillimin e ekonomisë private, nuk duhet të trembemi, etj., etj.».

Në lidhje me përkrahjen e iniciativës private dhe të sektorit privat, Sejfulla Malëshova s'mungon t'u hapë

atyre dhe kredi në Bankën e Shtetit. Ja ç'thoshte Sejfulla Malëshova në fjalimin e mbajtur përpara autoriteteve me rastin e inaugurimit të Bankës së Shtetit më 32 janar 1945: «... Ajo (banka) do të bëhet një armë e fortë për të siguruar indipendencën tonë ekonomike. Ajo do të bëhet një faktor i madh për të ngjallur iniciativën private në tregëti dhe në industri». Por megjithkëtë zemërgjerësi që tregonte Sejfulla Malëshova ndaj iniciativës private dhe sektorit privat, përsëri kritikon push-tetin tonë, që nuk ka ditur të bëjë si duhet këtë politikë kaq zemërgjerë. Ja ç'hotë Sejfulla Malëshova në referatin që ka mbajtur në Kongresin e Frontit më 5 gusht 1945: «... U përpoqmë të ngjallim dhe të aktivizojmë në bazë të iniciativës private sektorët e ekonomisë sonë që kanë ekzistuar edhe përpara, por në këtë drejtim është bërë shumë pak, ca nga pazotsia jonë dhe ca nga vullneti i keq i një pjese me rëndësi të tregëtarëve dhe të industrialëve». Me fjalë më të thjeshta Sejfulla Malëshovës i vjen keq që Partia s'ka qenë aq dorëlëshuar ndaj tregëtarëve dhe industrialëve dhe këta të fundit s'kanë ditur të përfitojnë sa duhet.

Vetëm kështu e shikonte Sejfulla Malëshova politikën ekonomike që duhej të ndiqte Partia jonë. Kjo politikë ekonomike, e mbrojtur prej Sejfulla Malëshovës, do të thoshte dobësimi i pozitave tona politike dhe ekonomike, dobësimi i sektorit të shtetit, krijimi me duart tona i një terreni përleshjeje dhe lufte të ashpër, kundër pozitave të forta të Partisë sonë, të krijuara me kaq gjak dhe sakrifica nga populli ynë. Politika e predikuar prej Sejfulla Malëshovës do të thoshte tërheqje në të gjithë frontin nga pozitat e shëndosha që kishte fituar

Partia jonë. Sikur Partia jonë të kishte ndjekur pikëpamjet krejtësisht armiqësore, antimarksiste të Sejfulla Malëshovës në politikën e brendshme dhe në atë ekonomike, populli ynë dhe vendi ynë do të hynte nën thundrën e tmerrshme të kapitalistëve të huaj e të brendshëm, gjaku i popullit do të shërbente edhe këtë herë për të forcuar bejlerët, feudalët, industrialët, tregëtarët dhe gjithë gjakpirësit e popullit tonë. Kjo do të ishte vetëvrasje për Partinë tonë dhe krimi më i tmerrshëm ndaj popullit shqiptar. Në rast se do të ndiqej rruga e Sejfulla Malëshovës, do të ishte i pamundur rrealizimi i reformave të mëdha me karakter ekonomik dhe social që bëri me sukses Partia jonë. Reforma agrare që kreu me sukses Partia jonë, po të bëhej sipas pikëpamjes së Sejfulla Malëshovës, do të favorizonte në shkallën më të gjerë kulakët. Po Partia jonë i shqelmoi të tilla pikëpamje armiqësore, i flaku tej dhe i demaskoi pa mëshirë. Partia jonë shkon e vendosur në rrugën e vërtetë të popullit ashtu si e mësojnë mësuesit e mëdhenj të saj: Marks-Engels-Lenini-Stalini dhe prandaj Partia jonë udhëheq vendin tonë me siguri dhe me sukses drejt socializmit.

Pikëpamjet e Sejfulla Malëshovës ishin të huaja për Partinë tonë; këto ishin devijim nga vija e Partisë, këto donin të thoshnin dobësim i Partisë sonë, dobësim i luftës së klasave dhe mëkëmbje e reaksionit. Për këtë gjë Sejfulla Malëshova mori një dënim të rëndë dhe plotësisht të merituar.

Si kurdoherë Partia jonë i dha Sejfulla Malëshovës mundësi të punonte, të kuptonte gabimin e rëndë ku kishte rënë, ta ndreqte këtë gabim dhe të ecte në vijën

e drejtë të Partisë. Sejfulla Malëshova, duke qenë kurdoherë anëtar partie, ju ngarkua drejtimi i dikasterit të arësimit, dikaster shumë i rëndësishëm. Mirëpo Sejfulla Malëshova s'ë mori aspak me seriozitetin e duhur këtë detyrë. Kontributi i tij jo vetëm ka qenë zero, por me qëndrimin e tij, ai ishte bërë një pengesë për punën. Cilat qenë arësyet e një situatë të tillë? Arësyet janë këto: Sejfulla Malëshova s'ka qenë i bindur për gabimin e rëndë që kishte bërë, ai s'ishte i ndërgjegjshëm për dëmin që i kish bërë Partisë, dhe si konsekuencë, dënimin që kishte marrë, e quante të pavend. Me qëndrimin e tij krejt pasiv në një detyrë aq të rëndësishme, dhe me qëndrimet e tija oportuniste ndaj shumë elementeve jashtë Partisë dhe ndaj disa elementeve të sëmurë brenda në Parti, ai përpiquej të krijonte një situatë, ku të mendohej se «këtij njeriu i ishte bërë një padrejtësi» dhe se «ky njeri kishte një zotësi». Kjo konkretisht do të thotë të mundohesh të krijosh një rrëth mbështetjeje që të aprovojë pikëpamjet e tua të shtrembëra.

Nga ana tjetër gjithë aktiviteti i Sejfulla Malëshovës, në rast se mund ta quajmë këtë aktivitet, është karakterizuar prej një dembellëku të pashoq në punë, gjë krejt e huaj për një anëtar partie. Por Sejfulla Malëshova, me gjithë dembellëkun e tij të madh, nuk ka përtuar asnjëherë të punojë për të lënë përshtypjen dhe të krijojë opinionin se ai «zotron» teorinë marksiste-leniniste dhe pra është i aftë të drejtojë. Gjithë puna e tij tregon qartë se, Sejfulla Malëshova, jo vetëm që s'ka qenë në asnjë moment i lidhur me luftën, me jetën, me praktikën, por në punët që i qenë ngarkuar, ai ka vepruar në kundërshtim të hapët me ato që na mëson

shkenca e Partisë sonë, marksizëm-leninizmi. Vetëm nai-vët dhe armiqjtë e Partisë mund të bien në kurthin e iluzioneve që kërkon të krijojë Sejfulla Malëshova rrëth personit të tij, por jo Partia jonë Komuniste.

Patjetër, dhe kësaj situate të dytë që krijojë Sejfulla Malëshova, i pakorrigjuar në gabimet e tija, duhej t'i jepej fund dhe të merreshin masa. Sejfulla Malëshova u shkarkua nga funksioni si Ministër i Arësimit dhe pas-këtaj qenja e tij si anëtar i Partisë sonë Komuniste varet nga qëndrimi i tij dhe nga realizimi që ai do të bëjë për gabimet e mëdha të tija dhe sa ai është kapablë të japë për Partinë. Partia jonë, si çdo anëtar i tjetër të saj që gabon, i jep mundësitë të korrigohet, të bëhet i vlefshëm për të dhe të meritojë përngahera nderin e madh të jetë anëtar i Partisë. Sejfulla Malëshova duhet të japë prova dhe prova të shëndosha që të mund ta meritojë plotësisht këtë gjë.

Anëtarët e Partisë duhet të sqarohen drejt për këtë çështje dhe pikërisht sikundërqë e paraqesim më lart. Nga ana tjetër reaksiuni mund ta përdorë këtë situatë për të luftuar Partinë tonë.

Në qoftë se ndonjë anëtar partie i lëkundshëm, ose i sëmurë do të përpinqet të përfitojë nga kjo gjë për të mbjellur mjegull, duhet të merren masa të shpejta për ta sqaruar dhe, në rast se vazhdon në një pikëpamje të tillë, të gabuar; të merren masa më të rënda dhe kësh-tu të likuidohet çdo orvatje që synon, qoftë edhe një grimë, dobësimin e unititetit dhe të forcës së Partisë sonë.

Çdo parullë e reaksionit, duhet të luftohet dhe të demaskohet me qëndrimin zyrtar: «Sejfulla Malëshova u pushua nga detyra e ministrit pse ai ka treguar paaf-

tësi dhe neglizhencë të madhe në detyrë dhe ai që s'punojn dhe s'kryen detyrën në shtetin tonë, ai shkarkohet nga detyra dhe vihet atje ku ai meriton».

Partia jonë nuk dobësohet aspak duke dënuar rëndë Sejfulla Malëshovën që shtrembëron vijën e Partisë, që devijon nga vija e Partisë, përkundrazi Partia jonë forcohet. Kjo duhet t'u shërbejë shokëve të Partisë si mësim, se si ata duhet të jenë vigjilentë pér mbrojtjen e Partisë, pér mbrojtjen e drejtë të vijës së saj, të realizojnë metodat që përdor Partia jonë pér ndreqjen e gabimeve dhe të shtrembërimeve që mund t'i bëhen vijës së Partisë, pér masat e matura dhe të drejta që merr Partia kundër atyre që gabojnë, që përsëritin gabimin, që s'duan më në fund të korrigohen ose që hidhen në kampin e armiqve të Partisë.

Për Byronë Politike të Komitetit Qendror
të PKSH

Enver Hoxha

*Botuar pér herë të parë në
«Dokumenta kryesore të
PPSH» vëll. I, Tiranë 1960*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**TELEGRAM PROTESTE DREJTUAR SEKRETARIT
TË PËRGJITHSHËM TË OKB-së NË LIDHJE ME
NJË PROVOKACION TË KRYER NGA AVIACIONI
GREK KUNDËR TERRITORIT TË RPSH
NË RAJONIN PËRMET—LESKOVIK**

22 maj 1947

**SHKËLQESËS SË TIJ TRYGVE LI, SEKRETAR I
PËRGJITHSHËM I ORGANIZATËS SË KOMBEVE
TË BASHKUARA**

Nju Jork

Në vijim të komunikimeve të ndryshme të paraqitura Shkëlqesës Suaj prej përfaqësuesit shqiptar pranë OKB-së në lidhje me provokacionet e vazhduara greke me anë të detit, të tokës dhe të ajrit kundër RP të Shqipërisë, kam nderin t'Ju komunikoj sa vijon:

Më 21 maj 1947 në orën 10.40 tre aeroplanë grekë, duke ardhur nga Greqia, hynë 15 km. brenda në Shqipëri dhe fluturuan për 40 minuta mbi krahanët e Leskovikut, Peratit, Çarçovës (prefektura e Korçës) dhe nga një lartësi prej vetëm 100 metrash ata mitraluan katundet Zhepa dhe Çarçovë si dhe një stan barinjsh shqip-

tarë dhe kopetë e tyre në vendin e quajtur «Fusha e Seranit». Aeroplanët grekë vranë një plak 70-vjeçar, një vajzë 17-vjeçare dhe plagosën 8 gra e fëmijë të tjerë. Veç tyre vranë 48 kafshë samari. Në orën 11.20 në drejtim të Leskovikut aeroplanët u kthyen në Greqi.

Të gjitha provokacionet greke të kryera këto kohët e fundit, si dhe akti kriminal i 21 majit 1947, nuk janë veçse provokacione kriminale të kurdisura në dëm të popullit shqiptar prej qeverisë fashiste greke, e cila, e inkurajuar në këtë punë prej përkrahjes së huaj, është munduar të fabrikojë argumenta të përgjakshëm për të bindur më kot Këshillin e Sigurimit mbi nevojën e një nënkomisioni hetimor në Greqinë e Veriut.

Populli dhe qeveria shqiptare tërheqin vëmendjen e OKB-së, të gjithë popujve paqedashës dhe demokratë mbi faktin se kjo politikë provokacionesh armiqësore, të paramenduara dhe të njëpasnjëshme të qeverisë monarko-fashiste greke kundër popullit paqedashës shqiptar, përbën një kërcënim serioz kundër paqes dhe sigurimit në botë.

Akti kriminal dhe agresiv i 21 majit ka mbushur me indinjatë të thellë dhe të justifikuar të gjithë popullin shqiptar.

Në emër të popullit tim dhe të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë protestoj energjikisht pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër këtij krimi të shëmtuar të kryer me qëllim prej qeverisë monarko-fashiste greke dhe kërkoj që protesta jonë t'u parashtrohet me urgjencë të gjithë anëtarëve të Këshillit të Sigurimit në mënyrë që t'u jepet fund njëherë e mirë këtyre veprave të banditizmit ndërkombëtar, të bëra

prej qeverisë monarko-fashiste greke kundër sovranitetit, indipendencës dhe integritetit tokësor të Shqipërisë dhe kundër jetës së qytetarëve shqiptarë.

Kryetari i Këshillit të Ministrave dhe Ministri
i Punëve të Jashtme të RP të Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 747,
23 maj 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 747,
23 maj 1947*

**FJALA E MBAJTUR NË PRITJEN E ORGANIZUAR
PËR NDER TË PIONIERËVE TË DALLUAR
GJATE VITIT SHKOLLOR 1946—1947**

4 korrik 1947

Unë dhe shokët e mi të qeverisë jemi shumë të gjëzuar që ju presim juve, pionierët që keni ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, t'ju shohim dhe të gjëzohemi së bashku sonte. Sigurisht, ju jeni pak të lodhur nga rruga, por gjëzimi që ndjejmë do t'jua heqë pak lodhjen dhe ju ftoj gjithashtu të rrini disa ditë këtu në Tiranë, të vizitonit dhe të shihni shumë gjëra që do t'ju kënaqin.

Unë jam shumë i gjëzuar dhe për një gjë tjetër, që kam përpara pionierët më të mirë të Shqipërisë, ata që kanë dalë të parët në shkollë. Unë ju them ju lumtë, se keni bërë detyrën si duhet, keni gjëzuar prindërit edhe mua. Ne ju urojmë dhe ju këshillojmë që të punoni edhe më shumë që vitin tjetër të dilni edhe më të shkëlqyer, pse kjo është detyra juaj nga më kryesoret dhe se kështu do të bëheni edhe më të vlefshëm për atdheun.

Qeveria me gjithë pushtetin lokal dhe prindërit tuaj do t'ju ndihmojnë dhe do të punojnë me gjithë forcat, që juve, dua të them gjithë pionierëve të Shqipërisë, të mos t'ju mungojë asgjë dhejeta juaj të bëhet dita me ditë më e gjëzuar. Shkollat vitin që vjen do të jenë

më të shumta e më të bukura, fletoret dhe librat tuaja do të jenë më të bukura dhe me këto shkolla dhe me këto libra do të mësoni ju e mijëra e mijëra pionierë të tjerë. Në çdo vend të Shqipërisë nxënësit sivjet kanë dalë mirë në mësime. Kjo na jep shpresat e mëdha për të ardhmen e vendit tonë; kështu do të përparojë Shqipëria; kjo është rruga jonë. Pushimet ju i keni merituar plotësisht, prandaj duhet t'i shkoni të gëzuar. Një pjesë e pionierëve, nga ata që kanë mësuar më mirë, nga ata që prindërët e tyre janë vrarë për atdheun, do të shkojnë në kampet verore të pionierëve, të organizuara nga qeveria, të tjerë do të shkojnë në kampet e organizuara nga pushteti lokal, kurse për ata që s'do të kenë satin e mirë të venë dot në këto kampe, pushteti lokal dhe organizata e rinasë do të organizojnë lodra dhe pikniqe, që kështu të gjithë pionierët t'i shkojnë mirë pushimet. Ju e dini sa e madhe është dëshira jonë që të organizojmë kampe verore për të gjithë pionierët e Shqipërisë. Por ju e kuptioni gjithashtu se vendi ynë është ende i varfër. Ne punojmë që vendi të pasurohet dhe do t'ja arrijmë shpejt asaj dite që pionierëve të mos u mungojë asgjë.

Shumë nga ju vijnë për herë të parë në Tiranë. Ju keni parë në Tiranë shtëpi të mëdha, rrugë të gjera, por unë do t'ju këshilloj që vendet tona, malet, qytetet tona, Tiranën tonë, t'i shihni me një sy tjetër dhe t'i ndjeni me zemër ato që shikoni. Për shembull, Tirana nuk është vetëm kryeqyteti ku rri qeveria, por Tirana është diçka tjetër dhe sidomos pse 6 vjet më parë në qytetin e Tiranës, në kohët më të errëta të historisë së Shqipërisë, u formua Partia jonë, Partia heroike Komuniste e Shqipërisë. U formua Partia jonë, e cila na mësoi të luftojmë

deri në vdekje për çlirimin e atdheut dhe të popullit. Partia organizoi kryengritjen e madhe, organizoi dhe udhëhoqi luftën, çlroi Shqipërinë dhe sot ndërton Shqipërinë. Partia e mësoi gjithë popullin si të luftonte me heroizëm për çlirimin e vendit, prandaj populli ynë dhe pionierët tanë Partinë e duan si shpirtin e tyre dhe e ruajnë si sytë e ballit.

Në çdo rrugicë të Tiranës që do të shkon, çdo mur dhe çdo penxhere që do të shihni, ato ishin kala dhe fusha lufte, ku njerëzit e Partisë luftotonin fashistët dhe tradhëtarët. Në rrugët e Tiranës dhe në gjithë Shqipërinë janë bërë nga populli ynë heroizma kaq të mëdha, që mendjet tuaja akoma të njoma nuk mund t'i imagjinojnë, por zemrat tuaja të pastra i ndjejnë thellësish. Në kopshtet e pallatit të «Brigadave», ku ne jemi mbledhur sonte, janë treguar heroizma të pashoqe nga partizanët tanë. Sigurisht, shumë nga ju që kam këtu pranë kanë humbur të dashurit e tyre në luftë. Shumë nga baballarët ose vëllezërit tuaj janë vrarë në këto kopshte, duke sulmuar me bomba përmbi tela fashistët gjermanë. Por ata luftuan dhe u vranë që Shqipëria të rrojë dhe ju, bijtë e bijat e tyre, dhe ne, shokët e tyre dhe gjithë Shqipëria, mburremi me ta dhe i adhurojmë.

Shokët e rinisë duhet t'ju shpien të nderoni dhe t'i vini lule kryetarit tuaj të madh, Qemal Stafës. Armiku vetëm gjoksin i kishte parë Qemalit dhe ai me gjoks përpëra sulmoi në ballë deri në kohën e vdekjes dhe koburen ai nuk e lëshoi nga dora, as kur trupi i tij i shenjtë, i copëtuar nga plumbat e fashistëve, u shtri pa shpirt në zallin e lumiit jashtë Tiranës. Ai luftoi dhe u vra për popullin, për atdheun, për ju.

Shokët e rinasë duhet t'jù çojnë të shihni dhe shtëpinë ku ka luftuar Vojo Kushi. Trim ishte Vojo Kushi, trim i madh dhe rrallë lindin të tillë burra. Vetëm tre ishin ata dhe nga këta vetëm Vojo Kushi ishte i shëndoshë. Shoku i tij Sadik Stavaleci ishte tuberkuloz, Xhoxhi Martini e kishte trupin me plagë, por që të tre zemrat i kishin si çelik. Këta heronj luftuan 6 orë kundër qindra armiqve, kundër tanksave dhe mitralozave. A e dini se ç'bëri Vojua, kur ju mbaruan fishekët dhe bombat? Ai me gjoks përpëra sulmoi mbi tanksin. Ai luftoi dhe u vra për popullin, për atdheun, për ju.

Në çdo rrugë të Tiranës që do të shkonit, ju do të shihni veprat e atyre që organizuan luftën kundër fasizmit, ju do të shihni dhe të ndiqni gjurmët e trimit punëtor Misto Mames, e trimit punëtor Vasil Shantos, e trimit punëtor Mihal Durit, të Heroit të Popullit Kajo Karafilit e qindra e qindra të tjerëve, dhe emrat e tyre t'i ruani shtrenjtë në mendjet tuaja dhe kujtimin e shtrenjtë të tyre në zemrat tuaja të pastra, pse këta njerëz kaq të mëdhenj, vetëm në zemra të pastra e kanë vendin. Shokët e rinasë t'ju çojnë të shihni jashtë dhe brenda qytetit të Tiranës dhe t'ju tregojnë vendet ku partizanët heroikë të Divisionit I sulmonin ditë e natë gjermanët dhe ku në këto sulme merrnin pjesë edhe pionierët.

Por pse vallë partizanët ishin kaq trima? Mund t'jua them. Se ashtu i mësoi Partia, e cila u tha: «Të luftoni deri në vdekje për lirinë e Shqipërisë, për lirinë e popullit dhe për demokracinë e vërtetë». Dhe pse këto që ju tha Partia ishin dëshirat e popullit, partizanët e kryen deri në fund detyrën e tyre.

Po pse partizanët luftonin dhe vriteshin me këngë në gojë, jo sikur shkonin drejt vdekjes, por sikur venin në dasmë? Ata luftonin duke kënduar, pse ata ishin të bindur se me luftën e tyre dhe me sakrificat e tyre do t'ju siguronin juve një jetë të gjëzuar. Dhe ata jua sigruan. Ata e kryen detyrën e tyre. Tani na mbetet neve, gjithë popullit shqiptar, që nga unë e deri te ju të vegjëlit ta vazhdojmë veprën e madhe. Dëshmorët tanë na porositën: «Ta doni me gjithë shpirt atdheun, ta mbronit atdheun, ta ndërtoni atdheun, pa marrë parasysh as edhe sakrificën e fundit». Ashtu sikundër heronjtë tanë dhanë çdo gjë për Shqipërinë dhe për popullin, ashtu duhet të bëjmë edhe ne.

Ky është amaneti i tyre dhe këtë ne do ta plotësojmë. Sakrificat e dëshmorëve tanë duhet tëjenë shembull për ne dhe me këtë shembull e me kujtimin e heronjve të luftës sonë në zemër ne të ecim përpara dhe ju të mësoni dhe të mësoni sa më shumë.

Një ditë Qemal Stafa më pat thënë: «A do të jetë vallë larg ajo ditë kur ne t'i shohim pionierët tanë të gjëzuar, të kenë shkollat e tyre, vendet e dëfrimeve, t'i shohim të rriten të shëndoshë dhe të zhduket nga zemra e tyre trishtimi?» Kjo ditë erdhi, këtë jetë të gjëzuar për ju po e ndërtojmë. Mjerisht, shoku ynë i dashur Qemal Stafa nuk e pa, por ai u vra duke luftuar me bindjen e plotë se kjo ditë do të arrihej, pse ashtu kishte vendosur Partia.

Në Tiranë do të shihni dhe shumë gjëra të tjera të bukura: teatro, kinema, do të shihni si janë organizuar shkollat; shkoni vizitoni fabrikat, ku punëtorët, vëlle-zërit tuaj punojnë me heroizëm ditë e natë, shkoni shihni

hekurudhën e rinasë, veprën madhështore të vëllezërve tuaj më të mëdhenj. Pas disa ditësh do të shihni manifestimin e shokëve tuaj pionierë të Tiranës. Por ju do të shihni dhe një gjë tjetër, ju jeni mysafirët e mi deri më 10 korrik dhe atë ditë ju do të shihni një nga veprat më të shkëlqyera të Partisë sonë dhe të popullit shqiptar, do të shihni ushtrinë tonë heroike që do të parakalojë në Tiranë (*këtu entuziazmi i pionierëve ishte në kulm, ata duartrokisnin dhe brohorisnin «Rroftë ushtria jonë».* «Ushtria-Garancia»). Ju, të dashur të vegjël, keni plotësisht të drejtë. Po, ushtria është garancia, është ajo që mbron të drejtat e popullit tonë, ajo që mbron atdheun nga çdo rrezik, ajo që mbron jetën tuaj të gëzuar, prandaj keni plot të drejtë dhe duhet ta doni me gjithë shpirt ushtrinë.

Sonte do të shohim të luajnë pionierët e Tiranës; ata kanë pregetitur një shfaqje të bukur. Ju lumtë pionierëve të Tiranës! Por unë jam i bindur se edhe ju të qyteteve të tjera s'mbeteni aspak pas këtyre. Sa keq më vjen që s'ju kam parë juve të luani, pse unë s'kam ardhur në qytetet tuaja, por ja ku jua jap fjalen se unë për së shpejti do të vij në të gjitha qytetet dhe do të shoh se kush i bën shfaqjet më të mira. Mos t'ju mbetet hatëri që sonte lavdërova ata të Tiranës, lavdërimet janë përsonte, pse duhet t'i inkurajojmë ata që të luajnë më mirë, por mendimin e prerë mbi këtë gjë do ta them kur t'ju shoh dhe juve. .

Kur të shkoni në shtëpitë tuaja, u thoni prindërvë tuaj dhe gjithë shokëve tuaj pionierë shumë e shumë të fala nga unë.

Rrofshi të gjuar të gjithë ju, të gjithë pionierët e Shqipërisë, i gjithë brezi i ri i vendit tonë!

Rroftë populli shqiptar!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 785,
6 korrik 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 785,
6 korrik 1947*

URDHËR DITE ME RASTIN E PËRVJETORIT TË KATËRT TË KRIJIMIT TË USHTRISË POPULLORE

10 korrik 1947

Shokë ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe gjeneralë,

Atdheu ynë feston sot ditën e Ushtrisë Kombëtare.

Ushtria Kombëtare, e lindur nga lufta e madhe e çlirimit, luftoi me heroizëm e vetëmohim të rrallë për t'i siguruar popullit lirinë, pavarësinë dhe pushtetin popullor. Ajo me vendosmëri i kapërceu të gjitha pengesat dhe korri fitoren mbi armiqtë, duke merituar dashurinë e përzemërt dhe mirënjohjen e thellë të mbarë popullit. Atdheu nuk do të harrojë kurrë veprën e pavdekshme të ushtrisë së tij.

Këtë vit Ushtria Kombëtare feston ditën e saj, kur populli ynë është mobilizuar i gjithë për zbatimin e planit të shtetit, kur punëtorët në kantiere dhe fabrika punojnë me vrull për t'i dhënë vendit sa më shumë produkte, kur fshatarët e vendit tonë punojnë me vullnet të madh në tokën e tyre duke u përpjekur t'i japin sa më shumë prodhime vendit të tyre, kur rinia jonë herooke po punon me hov të jashtzakonshëm dhe me vetëmohimin që e ka karakterizuar gjithmonë për ndërtimin e hekurudhës Durrës-Elbasan. Kështu 10 Korriku i këtij viti e gjen popullin tonë të futur thellë në rrugën e punës paqësore për ngritjen e jetës së re e të lumtur.

Në periudhën e ndërtimit paqësor dhe të modernizimit të ushtrisë, ushtria jonë duhet të ecë përpëra dhe të dijë të korrië suksese të reja të rëndësishme, të arrijë rezultate akoma më të mira në stërvitjen e saj luftarake dhe në edukimin e saj politik. Kjo është e domosdoshme për të garantuar punën ndërtimtare të vendit tonë dhe për mbrojtjen e indipendencës dhe të integritetit të atdheut.

Të gjithë qytetarët e Republikës sonë Popullore, që kanë nderin të bëjnë pjesë në radhët e Ushtrisë Kombëtare, kanë për detyrë të shkrijnë të gjitha energjitet e tyre për ta bërë ushtrinë tonë sa më të fortë dhe sa më të disiplinuar, për të qenë e gatshme për plotësimin e detyrave që i ngarkon atdheu.

Ushtarët tanë duhet të punojnë me të gjitha fuqitë e tyre për t'u bërë luftëtarë të zot, duke përvetësuar mirë stërvitjen taktike, stërvitjen e zjarrit, stërvitjet e tjera speciale dhe edukatën politike.

Nënoficerët tanë duhet të përforcojnë punën për aftësimin e tyre në lëmin e komandimit, të përvetësojnë mirë metodën e stërvitjes luftarake, të bëhen energjikë dhe të kenë autoritetin e duhur në kryerjen e detyrës së tyre si ndihmësat kryesorë të oficerëve në stërvitjen dhe edukimin e ushtrisë.

Oficerët kanë për detyrë që të vazhdojnë, me vullnetin që i karakterizon, përpjekjet e tyre për të mësuar vazhdimisht më mirë artin ushtarak modern, për zotërimin e teknikës ushtarake, për t'u bërë të mprehtë dhe të aftë si edukatorë të gjithanshëm të ushtrisë sonë. Ata duhet të përvetësojnë metodat më të mira, të nevojshme për preqitjen ushtarake dhe politike në kohë paqe. Ata duhet të kenë vazhdimisht parasysh eksperiencën e

Luftës sonë nacional-çlirimtare prej së cilës ushtria jonë ka trashëguar një traditë të shkëlqyer.

Një nga konditat e domosdoshme për kryerjen me sukses të detyrave, nga ana e të gjithë ushtarakëve, është ekzistenca e një disipline të çelniktë dhe të vetëdijshme në radhët e ushtrisë sonë. Një disiplinë e tillë është kushti i parë dhe më i rëndësishmi për edukimin e shëndoshë luftarak të forcave tona të armatosura. Të gjithë komandantët dhe komisarët, të gjithë eprorët e reparative tona të tregojnë kujdesin e duhur për përforcimin e vazhdueshëm të disiplinës.

Gjithashtu Ushtria jonë Kombëtare duhet të përforcojë dita-ditës frymën e lartë të dashurisë ndaj atdheut e popullit, frymën e kryerjes së detyrës me përpikëri e konshencë dhe ndjenjën e përgjegjësisë që duhet të ketë çdo ushtarak në krycrjen e detyrës së tij për mbrojtjen e Republikës Popullore të Shqipërisë.

Shokë ushtarë, nënëficerë, oficerë dhe gjeneralë,

Me rastin e festës së madhe të 10 Korrikut ju përgëzoj dhe ju përshëndes duke ju uruar suksese të vazhdueshme në punën tuaj.

RROFTË USHTRIA KOMBËTARE!

RROFTË POPULLI SHQIPTAR!

Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura
të Republikës Popullore të Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel
Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 788,
10 korrik 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 788.
10 korrik 1947*

**FJALA E MBAJTUR NË KUVENDIN POPULLOR
ME RASTIN E ÇELJES SË SESIONIT III
TË ZAKONSHËM TË LEGJISLATURES SE PARË**

12 korrik 1947

Shokë deputetë,

Në emër të qeverisë dhe nga ana ime personale ju paraqes përshëndetjet tona dhe ju uroj nxehësisht suksesë dhe punë të mbarë në zhvillimin e punimeve të këtij sesioni parlamentar të rëndësishëm.

Sic e dini, në sesionin e tanishëm të Kuvendit Popullor, qeveria po paraqitet përpara jush me një sërë dekretligjesh të rëndësishme që kanë të bëjnë me të gjithë aktivitetin ekonomik, shoqëror dhe kultural të vendit tonë, siç janë në radhë të parë projektligji mbi buxhetin financiar për vitin vazhdues 1947, plani i përgjithshëm i shtetit për vitin 1947 e shumë të tjera. Këto dekretligje, natyrisht, lypin vëmendjen më të madhe dhe aprovimin e shpejtë nga ana e Kuvendit Popullor.

Dëshiroj nga ana ime dhe në emër të qeverisë që kam nderin të kryesoj, më parë se të fillojnë punimet e sesionit, të sqaroj përfaqësuesit e popullit në kuvend për politikën e qeverisë sonë në punimet për ndërtimin e atdheut tonë në të gjitha lëmët e aktivitetit ekonomik,

shoqëror dhe kultural, etj., për realizimin e këtyre punimeve të rëndësishme në të shkuarën dhe në të ardhmen imediate, për perspektivën e qartë që duhet të ketë populli dhe për detyrat e rëndësishme që u vihen përpara organeve të pushtetit dhe mbarë popullit shqiptar, për kryerjen sa më të mirë dhe sa më të shpejtë të këtyre detyrave, nga të cilat varet shkuarja përpara për ndërtimin e socializmit në vendin tonë, që do të thotë për ndërtimin e një jete të begatshme, të lumtur, plot liri dhe dinjitet për popullin punonjës të Shqipërisë.

Qenja e pushtetit në duart e forta të popullit, rezultat ky i luftës heroike të çlirimit, i revolucionit tonë të madh popullor, do të thotë sigurimi i ndërtimit të një të ardhmeje të lumtur për popullin tonë. Për këtë gjë luftuan masat e gjera të popullit shqiptar, për këtë gjë luftuan, të bashkuar si një trup i vetëm, punëtorët, katundarët dhe intelektualët patriotë të Shqipërisë. Kjo aleancë e fortë u arrit në Luftën nacional-çlirimtare, ky rezultat i dorës së parë, që është marra e pushtetit në duart e popullit, u arrit përsëri me Luftën nacional-çlirimtare. Duke i ruajtur dhe forcuar dita-ditës këto dy rezultate të luftës, populli ynë dhe pushteti i tij ecën përpara për realizimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të programit, principet fondamentale të të cilit populli i kishte caktuar që në male, kur luftonte me pushkë në dorë fashizmin dhe tradhëtarët e vendit.

Çështja e kalimit të pushtetit në duart e popullit është çështja më e madhe dhe kjo do t'i zgjidhë drejt e mirë të gjitha problemet e vendit tonë. Këtë duhet ta kuptojnë mirë populli dhe gjithë kuadrot tanë.

Këtu qëndron edhe arësyja që agresorët fashistë

provokuan kasaphanën e madhe. Qëllimi i tyre ishte të vendosnin kudo diktaturën fashiste, diktaturën më të egër të kapitalit, për të shtypur çdo liri, për të shtypur popujt, për t'i skllavëruar këta përgjithmonë që të fitonin trustet e monopolet. Të çështja e pushtetit synon gjithashtu edhe tani imperializmi d'he reaksiuni botëror. Ai përpinqet të grabitë fuqinë nga dora e popujve, atje ku këta kanë arritur ta marrin pushtetin në duart e tyre dhe ta zëvendësojë atë me një pushtet demokratik formal, që të mos jetë në duart e popullit, por në duart e një pakice elementesh, gjoja të kualifikuar dhe që dinë më mirë t'i mbrojnë e t'i administrojnë interesat e popullit, se sa ç'mund t'i mbrojë populli vetë. Këtu ishte i gjithë qëllimi i tradhëtarëve shqiptarë të orës së fundit, për të cilët do të flas më vonë. Gjithë puna e tyre ishte të rrëzonin pushtetin popullor dhe, duke përdorur termat e një demokracie false dhe formale, ata kërkonin të zëvendësonin vullnetin e popullit me forcën arbitrarë të urryer të bejlerëve, latifondistëve, tregëtarëve të mëdhenj, që të gjithë në shërbim të reaksiionit të huaj. Prandaj populli të mos ta harrojë asnjë moment çështjen e pushtetit, të jetë vigjilent për mbajtjen e tij fort në duart e veta, për përfeksionimin e tij, për përforcimin e tij.

Me pushtetin popullor, që në çlirimin e Shqipërisë filluam të marrim të gjitha masat e nevojshme dhe të domosdoshme për ndërtimin e vendit nga shkatërrimet që na kish shkaktuar lufta, të shtetëzonim të gjitha pasuritë që i ishin grabitur popullit, të shtetëzonim të gjitha fabrikat dhe minierat që u shërbenin pasanikëve për të shfrytëzuar deri në palcë popullin punonjës, de-

tyruam të gjithë spekulatorët t'i kthenin popullit të gjitha ç'i kishin grabitur dhe filluan të ngremë një ekonomi të re, mbi baza të reja. S'është nevoja të përsëris këtu ato që i keni parë dhe ndjerë vetë ju, dua të them entuziazmin e madh të popullit për marrjen e këtyre masave të para dhe vrullin e madh, vetëmohimin dhe heroizmin e tij, i cili u mobilizua i téri në rindërtimin e vendit. U ndreqën rrugët, urat, u rindërtuan fabrikat që ishin shkatërruar nga lufta, u rindërtuan kantieret e Kuçovës, të Patosit, të bakrit, të kromit, u rindërtuan shtëpi të djegura nga lufta, u normalizuajeta. Me këto masa të rëndësishme ne krijuam sektorin ekonomik të shtetit, i cili u forcua dita-ditës dhe sot mund të themi se kemi një sektor të madh të shtetit, i cili është sektori socialist i prodhimit. Njëkohësisht, me sektorin e shtetit ne krijuam rrjetin e kooperativave të ndryshme, që po zhvillohen gjithmonë e më tepër dhe ushtrojnë një kontroll dhe një disiplinë mbi sektorin privat. Ky kontroll dhe kjo disiplinë nuk kufizojnë prodhimin dhe zhvillimin e ekonomisë përgjithësisht, por qëllojnë spekulimin, anarkinë dhe të gjitha ato gjëra që ndalojnë përgjithësisht zhvillimin e ekonomisë së vendit tonë.

Është e qartë dhe ne mund të themi se kemi mundur të zgjidhim problemet ekonomike dhe të forcojmë ekonominë tonë shumë më mirë se regjimet e tjera. Këtë e kemi bërë në një kohë relativisht shumë të shkurtër dhe në kondita shumë të vështira, të shkaktuara nga lufta. Ne kemi realizuar suksese të rëndësishme në të gjitha lëmët e aktivitetit të shtetit tonë.

Sektorët e industrisë të shkatërruar u mëkëmbën të tërë dhe funksionojnë me rendiment të plotë, duke

prodhuar më tepër se përpara. P.sh., e tërë nafta brut, në raport me 1938-ën arrin në 161,1%, më 1945-ën 463,2%, më 1946-ën — 217,3%; bitumi i pastruar në raport me 1938-ën — 162,8%, me 1945-ën — 1 097%, me 1946-ën — 155,6%; lëkurët në raport me 1938-ën — 900%, me 1945-ën — 2 600%, me 1946-ën — 400%; cimentua në raport me 1938-ën — 115,5%, me 1945-ën — 588%, me 1946-ën — 231%; lënda e drurit 833%, 257%, 261%. Artizanati është mëkëmbur dhe inkurajuar. Janë ndërtuar të gjitha urat e shkatërruara me një gjatësi të përgjithshme prej ml. 5 547, janë ndërtuar ura të reja me një gjatësi të përgjithshme prej 240 ml, janë rindërtuar të gjitha pontilet e porteve tonë të shkatërruara nga lufta, është përmirësuar sipërfaqja e rrjetit rrugor prej 2 000 km, janë ndërtuar 202 km. rrugë të reja, në mes të cilave rruga e rinisë Kukës-Peshkopi. Janë rindërtuar 7 852 shtëpi banimi të djegura nga lufta, janë ndërtuar nga shteti 530 godina të reja shkollore. Janë rindërtuar linjat e telekomunikacionit, janë ndërtuar linja të reja, janë rindërtuar të gjitha centralet telegrafonike.

Arësimi dhe kultura kanë marrë një zhvillim të madh në vendin tonë. Do të mjaftohem t'ju jap disa krahasime me gjendjen e arësimit të paraluftës.

Në vitin 1938—1939 ka pasur 643 shkolla fillore me 52 024 nxënës, kurse sot, në vitin 1946—1947, kemi 1 609 shkolla fillore me 134 524 nxënës.

Detyrimi shkollor¹ për gjithë Shqipërinë sot është

¹ Është fjala për zbatimin e Ligjit Nr. 281, dt. 17 gusht 1946 «Mbi arësimin fillor të detyrueshëm», sipas të cilët, duke filluar nga viti shkollor 1946—1947, arësimi fillor bëhej i detyrueshëm për të gjithë fëmijët mbi moshën 7 vjeç.

realizuar 87%. Sot kemi 34 shkolla unike, 10 shkolla të mesme, ku mësojnë me mijëra e mijëra djem e vajza të popullit. Këtu nuk do të flas për numrin e instituteve parashkollore as për arësimin për të rritur, ku numri i klasave e kapërcen mijën e ku mësojnë lart nga 26 000 nxënës. Lufta kundër analfabetizmit po zhvillohet me një ritëm të madh. Për likuidimin e analfabetizmit në Shqipëri qeveria, e ndihmuar për këtë gjë nga gjithë Fronti Demokratik, do të vëré gjithë forcat, që çdo vit të mësojnë të shkruajnë e të këndojnë rreth 60 000 veta. Kështu që brenda disa vjetve të likuidohet analfabetizmi në Shqipëri.

Me qindra studentë vazhdojnë kurset e degëve të ndryshme të Institutit pedagogjik, që u çel sivjet në Tiranë, me qindra studentë po ndjekin shkollat e larta, në Bashkimin Sovjetik, Bullgari e gjetkë; me qindra të tjerë do të dërgohen sivjet me bursa të shtetit të mësojnë shkencën në universitete të ndryshme jashtë. Bibliotekat po shtohen dhe pasurohen në vendin tonë; kinemaja, teatri, muzika, sporti po zhvillohen me një ritëm të shpejtë dhe në një rrugë të drejtë.

Një nga problemet kryesore, që i vihej përpara pushtetit tonë popullor, për t'u zgjidhur, ishte çështja e tokës, çështja e reformës agrare. Katundarët duhej të merrnin tokën, pse u përkiste, pse ishte e tyre dhe pse ata e punonin. Dhe reforma agrare mbaroi. Me zbatimin e reformës agrare ndryshoi krejt raporti i pronës së tokës dhe tani ky raport paraqitet kështu:

Shteti	nga 18,71% zbriti në 5,03%.
Entet fetare	nga 1,26% zbritën në 0,20%.

Pronarët e mëdhenj

dhe të mesëm

Pronarët e vegjël

Proletarët e fshatit

nëga 52,43% zbritën në 16,38%.

nëga 28,07% shtohen në 43,71%

nëga 0% shtohen në 34,63%.

Nga reforma agrare përsituan 29 400 familje gjysmë-proletare, 18 219 familje proletare vendase të vendosura, 1 902 familje proletare të shpërngulura dhe 19 218 familje fshatare që mbanin tokë aq sa kishin. Fshatarët e Shqipërisë u çliruan përgjithmonë nga zgjedha e beut, e agait dhe e qehajallarëve të tyre. Gjaku që ata derdhën rrëke në luftën e çlirimt nuk u vajti kot; pushteti popullor realizoi ëndrrën e tyre shekulllore. Katundari ynë, i kërrusur nga vuajtjet shekulllore, ngriti kurrizin dhe me këngë në gojë e me besim te pushteti i tij punon tokën e vet, për të mirën e tij. Se ç'efekte imediate pati reforma agrare, do ta kuptoni me këto dy shifra që do t'ju citoj: sipërfaqja e mbjellë e tokës në Shqipëri në vitin 1938 ka qenë 221 030 ha., kurse sivjet sipërfaqja e mbjellë arrin 305 000 ha. Këto janë efektet e para pas zbatimit të reformës agrare. Mund të mendoni sa të thella, sa të mëdha janë konsekuençat e revolucionit të madh popullor, mund të mendoni sa të mëdha dhe të pavdekshme janë reformat e pushtetit tonë popullor.

Krahas me zbatimin e reformës agrare menjëherë pas çlirimt pushteti ynë i dha një rëndësi të dorës së parë sektorit të bonifikimit. Brenda këtyre dy vjetëve, me përjashtim të tokave të Maliqit, janë bonifikuar toka të ndryshme me një sipërsaqe prej 6 764 hektarësh duke çelur kanale kulluese me një gjatësi prej 125 km. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë çelur dhe 22 km. ka-

nale vaditëse që ujtin 8 316 ha. tokë. Plotësimi i këtyre veprave do të ndikojë në shtimin e prodhimit bujqësor.

Një sukses tjetër i pushtetit tonë në lëmin ekonomik është çështja e kooperativizmit. Kooperativizmi nuk ka pas ciklistuar në të kaluarën në vendin tonë. Lindja e tij është pasojë direkte e ndryshimeve të mëdha ekonomike, shoqërore dhe politike, që u vërtetuan në vendin tonë në saje të Luftës nacional-çlirimtare. Brenda një kohe të shkurtër gati prej një viti janë ngritur më shumë se 317 kooperativa të ndryshme konsumi, fshatare shitblerjeje, artizanati, fshatare të punës, peshkatarësh, etj. Vetëm kooperativat e konsumit, që veprojnë sot në vendin tonë, kanë arritur të numërojnë në radhët e tyre 40 100 anëtarë me 180 000 frysë që përfaqësojnë 75% të popullsisë së qytetit ku këto veprojnë. Përpala këtyre realizimeve dhë shumë të tjerave të prekshme, konkrete, shumëkush bën pyetjen: Si u realizuan këto vepra, si u realizuan këto suksese, me mjete financiare të varfëra, me mjete teknike të vajtueshme dhe në një vend, ku lufta kishte mbjellë mjerimin? Forca e madhe e popullit tonë i realizoi, forca krijuese e masave të gjera, politika e drejtë dhe konsekuente e pushtetit popullor, mobilizimi i mbarë popullit për ndërtimin e atdheut, lufta heroike dhe plot vetëmohim e rindërtimit, guximi dhe puna e palodhur e kuadrove tanë, të gjitha këto bënë të kaperçehen pengesat e vështirësitë dhe të arrihen këto rezultate. A ka kala që të mund t'i rezistojë forcës së një populli të bashkuar dhe heroik, siç është populli ynë? Jo, s'ka. Vetëm ata që s'ja donin të mirën popullit, dridhnin buzët që në fillim, lëshonin vrer, predikonin dhe punonin për rrëzimin e shpejtë të pushtetit tonë po-

pullor. Ata hiqeshin financierë dhe ekonomistë të mbaruar, shkencëtarë dhe dijetarë të zot, ata hiqeshin si të predestinuar të blenin lëkurë e të bënин zanate të tjera dhe të fitonin miliona në kurrizin e popullit tonë, të spekulonin me gjakun e popullit dhe të bëheshin spiunë dhe të shisnin atdheun te i huaji. Këtë zotësi s'ua mohojmë, por ata që kanë të tilla zotësi, në regjimin tonë populli nuk i lë të marrin frenat e shtetit në dorë, por i dërgon në litar dhe në burg që të vënë mend.

Mbi të gjitha këto suksese të arritura ne do të mbështetim këmbët për t'u hedhur përpara, kurdoherë përpara. Ndryshimit në substancë të ekonomisë sonë po i përgjigjen tanë forma të reja organizimi. Ne do të ecim këtej e tutje me një ekonomi të planifikuar dhe kjo është rruga që do të na çojë në socializëm. Ndërtimi i socialistit në vendin tonë duhet të jetë gjithë jeta jonë, pse vetëm kështu do të ndërrojë qind për qind faqja e Shqipërisë, populli do të shohë ditë më të bardha, jeta e tij do të jetë një jetë e gëzuar, e lumtur, e lirë. Vetëm kështu do të zhduken mjerimi dhe fatkeqësitë, do të zhdukjet injoranca, do të forcohet dashuria për familjen, për shoqi-shoqin, do të rriten njerëzit e rinj me koncepte të reja që të duan atdheun si sytë e ballit, të duan tokën e tyre, fabrikën e tyre, punën e tyre të fituar me dersën e ballit, të duan popujt e tjerë, të respektojnë dhe të mbrojnë liritë e tyre, si ato të vendit të vet. Kjo është rruga që populli ynë me vendosmërinë më të madhe do të ndërtojë, rrugë në kundërshtim me atë të sistemit kapitalist, ku mbretëron anarkia dhe kaosi, ku sundon thundra e hekurt e trusteve dhe e monopolçeve, ku mbretërojnë uria, mjerimi, fatkeqësitë, ku papunësia dhe

shfrytëzimi i klasës punëtore dhe i gjithë popullit punonjës është ligji i këtij sistemi, ku mbretëron injoranca dhe korruzioni, ku të gjitha liritë njerëzore shtypen pa mëshirë, ku njeriu për njerinë është ujk dhe ku lufta është pjellë e këtij sistemi.

Të gjitha konditat i kemi për të ecur në këtë rrugë, prandaj të mobilizojmë të gjitha energjitet e popullit tonë dhe t'i përvishemi punës me forca të dhjetëfishuara.

Buxheti financier i vitit 1947, plani i përgjithshëm i shtetit për vitin 1947, unifikimi i çmimeve që na jep mundësi të planifikojmë akumulacionet e shtetit dhe që bën që ligji i vleftës të mos mbetet një gjë spontane, por të zotërohet dhe të drejtohet struktura dhe metodologja e re e caktimit dhe e zbatimit të çmimive, çështja e rrogave të caktuara në baza të drejta, dëmthënë kush punon më shumë dhe më mirë shpërblehet më mirë, dhe ku merren parasysh të gjitha: zotësitë, rendimenti në punë, vështirësitë e vendit ku punon, etj. Të gjitha këto do të na lejojnë që ne të ndërtojmë një ekonomi me plan.

Tani ne dalim me buxhetin dhe me planin e 1947-s për nëntë muaj. Sikundërqë do ta shihni në buxhetin, shuma e përgjithshme e shpenzimeve arrin në 3 758 756 900 lekë. Këtu përmblidhet dhe buxheti lokal, shpenzimet e të cilët arrijnë në shumën prej 550 263 085 lekë. Shpenzimet janë balancuar krejtësisht me të ardhurat.

Konform me buxhetin e shtetit, parashikohen investime të konsiderueshme në planin e shtetit, sidomos në financimin e ekonomisë. Shuma e investimeve në sektorin ekonomik arrin në më tepër se 1,5 miliard lekë, më se 40% të buxhetit. Investimet kryesore do të bëhen

në minierat tona, në industrinë tonë të re dhe të vjetër, në bujqësinë që arrin në 12,55%, në botore që arrin në 12,04%, në hekurudhë që arrin në 23,60% etj. Për arësimin dhe kulturën do të shpenzohen më se 8% e buxhetit. Për shëndetësinë do të shpenzohet afro 3% e buxhetit.

Sikundërqë e shihni edhe vetë, ekonomia jonë po përparon e po forcohet nga viti në vit. Me zbatimin e planit pesëvjeçar, për hartimin e të cilit qeveria është duke punuar dhe që do t'ja paraqesë Kuvendit Popullor në një të ardhme shumë të afërt¹, ekonomia jonë do të forcohet edhe më shumë e në mënyrë progresive. Industria jonë do të perfektionohet dhe do të shumohet, zhvillimi i minierave tona do të jetë një objekt pasurimi përvendin tonë dhe të gjitha pasuritë e vendit tonë do të përdoren në një shkallë kurdoherë më të gjerë përmirësimin e jetës së popullit. Sivjet ndërtohet hekurudha Durrës-Elbasan. Vitet e ardhshme ky rrjet do të zgjerohet.

Masa të rëndësishme përmirësimi do të merren përzhvillimin më të mirë të bujqësisë, ku do të bëhen investime përbonifikime të rëndësishme.

¹ Me porosi të KQ të PKSH Qeveria e RPSH filloj të hartojë një plan 5-vjeçar që synonte krijimin dhe zhvillimin e industrije kombëtare, elektrifikimin e vendit, zhvillimin e bujqësisë mbi baza socialiste. Ai mbështetej kryesisht në forcat e brendshme dhe në ndihmën e Bashkimit Sovjetik e të vendeve të demokracisë popullore.

Ky plan nuk gjeti zbatim për arësyte të ndërhyrjes brutale të revolucionistëve jugosllavë në punët e brendshme të Partisë dhe të vendit tonë.

Të gjitha këto do të ngrenë nivelin e jetës së popullit tonë dhe që tani ne shënojmë rezultate të rëndësishme. S'ka pak ditë që u muar vendim nga qeveria për ngritjen e pagesave dhe për sistemimin e tyre¹, sikundërqë e përmenda dhe më lart. Gjithashtu u muar vendim mbi ngritjen e racionit të bukës². për të gjitha kategoritë e shtresave punonjëse të vendit tonë. Këto janë suksese që e kanë bazën te pushteti ynë popullor, te kuptimi i drejtë nga ana e popullit i politikës së pushtetit tonë dhe të Frontit Demokratik, te mobilizimi i gjerë i tij si dhe te heroizmi që tregon ai për ndërtimin e ekonomisë sonë të re, për ndërtimin e jetës së tij më të mirë.

Realizimi i planeve tona, realizimi i jetës së lumtur dhe të begatshme, varen nga puna jonë, nga kuptimi i mirë dhe kryerja me përpikëri prej të gjithëve e detyrave që na vihen përpara. Pikësëpari një punë e tillë kaq e madhe, nuk mund të realizohet pa pjesëmarrjen e të gjithë popullit, që prej të madhit dhe deri te i vogli, pa mobilizimin total të të gjithave energjive të masave të gjera të popullit. Këtu duhet të synojë pikësëpari kujdesi ynë, kujdesi i gjithë Frontit Demokratik. Por populli do të mobilizohet i téri, kur ai të ketë të qarta detyrat që i vihen përpara, kur ai konkretisht të drejtohet si duhet dhe të

¹ Është fjala për vendimin e Këshillit të Ministrave të RPSH Nr. 196 dt. 16 qershori 1947 mbi kategorizimin e ri të punëtorëve.

² Është fjala për urdhëresën e Qeverisë së RPSH Nr. 1, dt. 2 korrik 1947, sipas të cilës ngrihej racioni i bukës për të gjitha kategoritë e punonjësve.

mësohet si duhet në zbatimin e detyrave, që do të kenë si konsekuençë imediate përmirësimin e jetës së tij. Këto përmirësime ai duhet t'i shohë konkretisht, t'i prekë, të bindet. Populli do të mobilizohet i téri dhe do të vëré gjithë forcat e tija në realizimin e këtyre punimeve të rëndësishme, kur ai të bëhet faktori kryesor në realizimin e këtyre punimeve, kur ai të ketë kontrollin mbi këto, kur ai të zbatojë ligjin dhe drejtësinë e tij të madhe mbi çdo gjë. Pa i pasur qartë këto gjëra, nuk mund të ecet përpara. Të gjitha këto bëhen për popullin dhe kryhen me popullin. Kush mendon e vepron ndryshe, ai gabohet dhe s'është në rrugën konsekiente të demokracisë sonë përparimtare.

Që të kryhen si duhet këto punime dhe të realizohet plani ynë, duhet të vihen të gjitha forcat për forcimin dhe modernizimin e pushtetit tonë popullor dhe të zhduket çdo e metë që mund të jetë shfaqur deri tanë. Pushteti të shkundet nga plogështia, nga burokratizmi i tepruar dhe pengues. Ai duhet të bëhet një realitet në fshat e në lokalitet dhe të mos ketë vetëm funksione administrative. Në të duhet të marrin pjesë gjerësisht masat e gjera të popullit. Fshati luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë sonë, prandaj pushteti atje duhet të jetë më i fortë dhe sa më popullor. Pushteti ynë popullor duhet të përmirësohet dhe të perfektionohet çdo ditë në mënyrë që të kryejë detyrën e madhe që i ngarkohet në rrethanat dhe kushtet e ndryshme që krijohen me zhvillimin e situatës në vendin tonë. Këtu u bie një detyrë e madhe njerëzve të pushtetit, merita e të cilëve do të tregohet kur ata, për zbatimin e mirë të detyrave që u vihen përpara, do të dinë të adoptojnë

edhe forma të reja, të drejta, në fryshtën e Statutit të Shtetit dhe të rregulloreve në fuqi.

Zbatimi i përpiktë i planit varet nga kuptimi i mirë i detyrave nga të gjithë funksionarët e shtetit, të ngarkuar për zbatimin e planit, nga të gjithë punëtorët, fshatarët dhe intelektualët e vendit tonë. Të gjitha detyrat që përfshihen në plan janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetërën, të koordinuara, të kondicionuara njëra nga tjetra. Çalimi në një sektor pune, moszbatimi i planit si duhet në këtë sektor, ka reperkusione në gjithë sektorët e tjerë të punës. Shumë gjëra janë të reja dhe të rëndësishme, por kuadrot tanë duhet të vënë gjithë forcat t'i mësojnë dhe t'i kuptojnë mirë, që të mund ta mbajnë mirë në duart e tyre timonin e ekonomisë së re. Perfektionimi i kuadrove tanë dhe shtimi i kuadrove të specializuar duhet të jetë qederi ynë më i madh. Kuadrot do të na zgjidhin të gjitha punët. Këtu duhet të shkojmë me kurajon më të madhe, të ngremë njerëz të rinj, sa më shumë njerëz të rinj, njerëz të popullit punonjës, t'i vëmë pa frikë në krye të punës, t'i mësojmë ata, t'i udhëzojmë ata, pa u lodhur, me durim të madh dhe me siguri do të shohim se punët do të shkojnë përparrë dhe vetëm kështu do të shkojmë përparrë. Forcat e popullit janë të pashterura, populli ynë ka dhënë prova të mëdha se ai është i zoti, është i zgjuar, ka energji dhe vitalitet dhe mund ta kryejë me siguri detyrën që i ngarkohet. Djemtë e punëtorëve, djemtë e fshatarëve, që në shumicë s'dinin të shkruanin dhe të këndonin, udhëhoqën luftën e madhe të çlirimt, udhëhoqën ushtrinë tonë heroike në fitore, ata mundën gjeneralët dhe oficerët e lartë e me shkollë të fashizmit, ata sot drejtojnë me

sigurinë më të madhe repartet tona të ushtrisë, ata kanë përvetësuar artin ushtarak modern, ata po ecin dita-ditës përpara. Djemtë e punëtorëve dhe të katundarëve sot drejtojnë poste nga më të rëndësishmet të shtetit tonë, të ndërmarrjeve. Atëherë ja brumi ku është dhe nga brumet më të mirë.

Sot kërkohet nga të gjithë kuadrot e shtetit disiplinë e hekurt në zbatimin e detyrave. Pa këtë disiplinë punët, sigurisht, do të na çalojnë, dhe këtë gjë asnjë njeri i ndershëm, asnjë patriot shqiptar, nuk e dëshiron, përveçse armiqjtë e popullit. Duhet vetëmohim në punë, duhet ndershmëri në punë. Puna kurrë të mos na lodhë, por ajo të bëhet një çështje nderi dhe të na nxitë për të dhënë më tepër.

Për kryerjen e kësaj pune të madhe kërkohet organizimi i mirë i punës nga të katër anët. Nga organizimi i mirë i punës varet zbatimi i përpiktë i detyrës, varet rezultati i shëndoshë i frytit të punës, varet edukimi i shëndoshë i kuadrit, varet zbatimi i gjithë planit.

Unë mendoj që gjithë funksionarët e shtetit, që nga më i vogli dhe deri te më i madhi, të vihen përpara përgjegjësive për kryerjen e detyrave që u ngarkon populli dhe atdheu. Ta kryejnë këtë detyrë me përpikëri, me ndershmëri, me vetëmohim. Kush punon, kush e kryen detyrën si duhet, ai është njeriu më i konsideruar, më i respektuar, më i nderuar në Shqipërinë e re, ai është patrioti më i kulluar që i dhimbset populli i tij. Ata që s'punojnë, qofshin këta nëpunës të thjeshtë ose ministra, kundër tyre qeveria do të marrë masat më të ashpra dhe nuk do të lejojë kurrsesi që qenja e tyre ndër këto poste të bëhet një gangrenë, që të infektojë veprën ndërtimitare.

Për zbatimin e plotë të planit ne do të mbështetemi në mobilizimin e gjerë të popullit dhe prandaj nga kjo tribunë e lartë e Kuvendit Popullor ne i bëjmë thirrje në radhë të parë patriotizmit të madh të klasës punëtore të vendit tonë dhe u themi: Punëtorë të Shqipërisë, të qëndroni në ballë si kurdoherë, pse e ardhmja e lumtur dhe e sigurt e popullit tonë mbështetet në forcat tuaja fizike dhe mendore, në vendosmërinë dhe energjinë tuaj të madhe, në besnikërinë tuaj të pasund për kauzën e shenjtë të popullit! Ju jeni garancia më e madhe e pushtetit tonë popullor. Të vini gjithë forcat tuaja në kryerjen e detyrave të shumanshme që ju vihen përpara, në fabrika, në kantiere, në aparatin e shtetit e kudo që punoni! Ju duhet të jeni kurdoherë në sulm dhe shembull për të gjithë se si punohet më mirë, se si zbatohen dhe tejkalohen normat, se si zotërohet teknika, se si perfekcionohen njerëzit në punë, se si mbrohet pasuria e shtetit dhe e popullit, se si mbrohet atdheu. Ju punoni për pushtetin tuaj, për popullin tuaj, për jetën tuaj, prandaj bëni detyrën tuaj më mirë se kurdoherë!

I bëjmë thirrje patriotizmit të madh të katundarëve tanë dhe u themi: Katundarë të gjithë Shqipërisë, ju e shihni vetë konkretisht se sijeta juaj po përmirësoshet dita-ditës! Ju tani keni tokat tuaja, që jua dha reforma agrare, që jua dha pushteti popullor. Zinxhirët e beut dhe të agait u dërmuan përgjithmonë. Pa këtë pushtet, që është pushteti juaj, ju kurrë nuk do të kishit dalë në dritë, prandajjeta juaj dhe e kalamajve tuaj brez pas brezi është e lidhur për jetë e përvdekje me këtë pushtet. Prandaj të vini të gjitha forcat për forcimin e këtij pushteti. Detyra juaj është t'i punoni sa më mirë tokat

tuaja dhe të prodhoni sa më shumë për të pasur bollëk për veten tuaj dhe për të furnizuar gjithë Shqipërinë me prodhimet tuaja. Aleanca me klasën punëtore dhe me shtresat punonjëse të qyteteve duhet të forcohet dita-ditës dhe të kuptohet mirë prej jush. Pushteti populor ju bën të gjitha favoret dhe ndihma për ju do të jetë gjithnjë më e madhe dhe më e konsiderueshme. Të gjitha këto kanë një qëllim: që jeta juaj të bëhet dita-ditës më e mirë dhe që ju me punën tuaj të kontribuoni me të gjitha forcat në të mirën e përgjithshme. Do të jetë gabim dhe në dëmin e përgjithshëm dhe tuajin gjithashtu, që këto favore dhe ndihma që ju jep pushteti për përmirësimin e punës suaj dhe të prodhimit tuaj të përdoren për qëllime egoiste dhe të degjenerojnë në shfrytëzim. Tendenca të tilla, në rast se shfaqen, duhet t'i luftoni pa mëshirë, pse këto janë tendenca dhe pikëpamje vetëm të agallarëve dhe të fshatarëve të pasur, të cilët e kanë në gjak shfrytëzimin e të tjerëve. Asgjë nuk do të bëhet në disfavorin tuaj. Përkundrazi, të gjitha masat dhe urdhëresat që ka nxjerrë qeveria për çështjen e drithërave, janë në favorin tuaj. Ulja e çmimeve të sendeve të nevojshme është në favorin tuaj, krijimi i kooperativave të shitblerjes në fshat është për të mirën dhe lehtësimin e punës suaj, krijimi i kooperativave të punës është në favorin tuaj. Prandaj detyra juaj është të përmirësoni punën sa më shumë dhe të furnizoni me drithë dhe me prodhimet e tjera bujqësore masat e tjera punonjëse të vendit tonë, të ndihmoni në grumbullimin e bereqetit dhe të sendeve të tjera dhe të zbatoni me rigorozitet çmimet e caktuara prej qeverisë. Ekonomia juaj private duhet të ecë dhe ajo në rrugën e

planifikimit të ekonomisë sonë. Duhet të luftohet nga ana juaj me ashpërsinë më të madhe çdo tendencë që do të kërkojë të shfaqet për t'u shmangur nga kjo rrugë e drejtë, që është rruga që siguron begatinë tuaj.

U bëjmë thirrje intelektualëve patriotë, të vënë të gjitha forcat për kryerjen e detyrate kudo që punojnë. Njerëzit me të vërtetë të mësuar dhe të pajisur me një kulturë të shëndoshë s'ka se si të jenë të shkëputur nga çështja e madhe e popullit. Ata diturinë e tyre duhet ta vënë pa rezerva në shërbim të atdheut dhe të popullit.

I bëjmë thirrje patriotizmit të thellë të grave të Shqipërisë. Sot po ndërtojmë Shqipërinë e re dhe e shkuara e rëndë nuk duhet të rëndoje më mbi supet tuaja. Juve duhet me çdo kusht të dilni përpara, pse jeni një forcë e madhe, një forcë përparimtare, nga e cila pret shumë vendi ynë. Ju duhet të hyni në masë të gjerë në prodhim, shumë funksione shtetërore duhet të jenë në duart tuaja. Ju duhet të jeni në fabrika, në kooperativa, ju duhet të jeni në ara, në shkolla. Nuk mund të realizohet plani ynë pa pjesëmarrjen tuaj të gjerë. Prandaj pushteti do t'ju ndihmojë me të gjitha forcat që ju të ecni përpara dhe të kryeni detyrat dhe unë jam i sigurt se ju do t'i kryeni me heroizmin më të madh.

I bëjmë thirrje rinisë sonë heroike, mburrjes së popullit shqiptar. Rinia jonë kurdoherë e gatshme është gjendur e para atje ku e ka thirrur detyra e atdheut dhe e popullit. Vrulli i saj, entuziazmi i saj, heroizmi dhe vetëmohimi i saj duhet të jenë shembull për të gjithë. Nuk numërohen veprat e saj, ato janë të rëndësishme, si njëra dhe tjetra. Ajo vazhdimisht dhe kudo është në

punë, çshtë në sulm dhe atje ku punon rinia, ku mëson rinia, ku frymëzon rinia, dalin vepra të pavdekshme. Jeta e re është për rininë tonë, ajo e meriton plotësisht, pse ajo e ndërton me djersën e saj, me mendjen e saj, me zemrën e saj. Ai njeri që kërkon të përtërihet, të marrë forca të reja, të shkundë dyshimet dhe mjegullën që mund të ketë në zemër e në mendje, e këshilloj të shkojë në hekurudhën e rinisë, të shohë si punojnë ndërtuesit e Shqipërisë së re, si mësojnë ata, si rriten ata, si dëfrejnë ata. Ne i themi rinisë se mirënjojha e popullit shqiptar është e madhe kundrejt saj për çka ajo bën për atdheun, për çka ajo do të vazhdojë të bëjë kurdoherë. Rinia jonë është një faktor i madh për realizimin me sukses të planit të shtetit tonë dhe ajo do ta kryejë me sigurinë më të madhe detyrën e saj si në shkollë, ashtu dhe në punë.

Fitoret e luftës sonë jo vetëm që duheshin mbrojtur, por duheshin konsoliduar. Ato duhet të shërbejnë si bazë e shëndoshë për të ecur përpjekja për realizimin e plotë të dëshirave dhe të aspiratave të popullit tonë. Këtu, natyrisht, do të bëhej përpjekja e parë me ata që do të përpinqeshin që fitoret e popullit tonë, të korrrura gjatë luftës çlirimtare, të mbeteshin një letër e vdekur që të mundnin kësisoj këta armiq të popullit të manevronin dhe të intrigonin më mirë për të rivendosur regjimin e tyre të urryer të sundimit kapitalist.

Vepra e madhe që na priste pas çlirimt duhej, pra, të ishte përsëri dhe kurdoherë vepra e pavdekur e popullit dhe të pasqyronte përpjekjet e vazhdueshme të tij. Populli duhej të mobilizohej i téri për kryerjen e kësaj vepre, i frymëzuar po me ato ideale që e udhëho-

qën në luftën fitimtare, i pajisur po me atë guxim dhe me atë heroizëm që i dha fitoren mbi fashistët italo-gjermanë dhe shërbëtorët e tyre. Lufta, pra, për popullin tonë duhej të vazhdonte në forma të tjera, por po me atë ritëm dhe po me atë vendosmëri që u bë e para. Lufta duhej të vazhdonte në dy fronte, për rindertimin e vendit dhe të jetës më të mirë dhe më të lumtur dhe kundër atyre që, me njëmijë mënyra tradhëtare, do ta pengonin dhe do ta luftonin rrugën e drejtë të popullit tonë.

Kështu vihej çështja për ne për të fituar bctejën e ndërtimit të jetës së re. Duhej të vinim të gjitha forcat fizike dhe mendore, duhej të derdhnim djersë për ta ndërtuar jetën e lumtur dhe të lirë dhe duhej me goditë pa mëshirë armiqtë e çfarëdo lloji që do të na pengonin në këtë rrugë. Ai që mendon se jeta fitohet pa luftë, pa mundime dhe pa sakrifica, ai që mendon se armiku i popullit luftohet duke i bërë koncesione ose duke i fërkuar krahët dhe duke i buzëqeshur, ai është i lidhur me armiqtë e popullit dhe ai është armik i Shqipërisë së re. Njerëz të tillë ka dhe do të ketë akoma, por kjo as e tremb popullin tonë dhe as e gjen në befasi, përkundrazi, çdo ditë e më tepër ai e shton dhe e forcon vigjilencën për mbrojtjen e atdheut dhe të punës së tij, kurse tradhëtitë e disave janë të destinuara të falimentojnë dhe të shtypen që në lindjen e tyre.

Situata që u krijua në vendin tonë me Luftën nacional-çlirimtare pati konsekuenca të rënda për latifondistët bejlerë, për agallarët e pasur dhe për borgjezinë pasanike që kishte vënë miliona duke pirë gjakun e popullit. Këto klasa u hodhën në luftë të hapët dhe me

armë në dorë, krah për krah me okupatorët dhe kundër popullit, por populli fitoi. Betejat u zhvilluan të përgjakshme dhe u fituan me sakrifica të mëdha nga anë e popullit dhe për këtë arësyё revolucioni i popullit tonë ishte i plotë dhe i kishte rrënjet të shëndosha. U përmbyss miti i nationalistëve me njëqind flamurë në xhep, u çorr maska e përgjakshme e pseudodemokratëve bejlerë dhe agallarë; këta u gjendën matanë barrikadës për të mbrojtur privilegjet dhe regjimin që u lejonte të shtypnin popullin. Kuislingët shqiptarë, që u hodhën matanë detit, ndërruan padron dhe u bënë spiunët e reaksionit anglo-amerikan. As mund të bënин ndryshe, këtë zanat e kanë në gjak. Për të shitur atdheun dhe popullin te i huaji, ata janë të gatshëm në çdo moment. Ç'mund t'i lidhë këta njerëz dhe klasën e tyre me popullin shqiptar? Asgjë tjetër, përveçse me sigurue në kurri zë popullit privilegjet e tyre. Mirë, por populli u tha këtyre «harrjoje mushkë valarenë», dhe kjo ata i tërbon.

Por jo të gjithë ata që e kanë halë në sy popullin dhe pushtetin e tij, jo e tërë klasa e kapitalistëve dhe e të privilegjuarve shkoi në Itali ose në Greqinë e monarko-fashistëve. Ajo qëndroi këtu dhe ishte e detyruar t'u nënshtrohej ligjeve të drejta të popullit dhe vendimeve të prera të tij dhe kjo atë e tërbon.

Kjo klasë shfrytëzuese i humbi të gjitha ç'i kishte grabitur popullit, u zhdukën privilegjet, u ikën nga duart tokat, fabrikat, koncesionet, pasuritë kolosale, ato u bënë prona e shumicës, prona e popullit punëtor.

Por të mos të na gënjejë mendja se të gjitha këto u bënë pa luftë dhe këta njerëz u bënë zemërgjerë dhe bujarë. Ujku s'bëhet kollaj qengj ose më mirë s'bëhet

kurrë qengj. Tjetër punë nëse ujku i ka thonjtë të prerë, por po t'ja linim t'i rriteshin, ai e mbyste revolucionin tonë popullor. Kjo nuk ngjau dhe nuk do të ngjajë kurrë, pse populli ynë i ka në dorë gërvshëret dhe të mprehura mirë.

Megjithatë lufta ndërmjet klasës së kapitalistëve e të të privilegjuarve dhe popullit punëtor e pushtetit të tij vazhdoi e pandërprerë dhe, që me çlirimin e Shqipërisë e këtej, kaloi ndër disa faza të ndryshme. Por kjo ishte lufta e klasës me të gjitha tiparet e veta dhe me gjithë ashpërsinë e saj. Fashizmi, diktatura më e egër e kapitalit, nuk mundi dot t'i shtypte popujt liridashës dhe të vendoste ligjin e terrorit dhe të errësirës, nuk mundi dot ta shtypte klasën punëtore të vendeve të demokracisë popullore, por mbeturinat e tij nuk i hodhën armët. Ato, nën mbrojtjen dhe nxitjen e reaksionit ndërkombëtar dhe veçanërisht të reaksionit anglo-amerikan, u përpoqën dhe po përpiken të mëkëmben, të fuqizohen për të rrëzuar pushtetet popullore, për të shtypur demokracinë, për të preqatitur një luftë të tretë, më të egër se Lufta e dytë botërore. Ky proces ngjet dhe në vendin tonë. Mos me e njohë këtë proces dhe me nënvlefësue këtë luftë, kjo do të thotë në shqip t'u dorëzosh çelësat atyre që denbabaden e kanë munduar dhe i kanë pirë gjakun popullit, kjo do të thotë të lësh të mëkëmbet fashizmi dhe të preqatitësh varrin me duart e tua. Populli ynë s'ka nge t'i bëjë varrin vetes, përkundrazi, ai punon për lulëzimin e Shqipërisë dhe të jetës së tij dhe ua rregullon pa asnje hezitim punët atyre që kërkojnë të përsëritin kohën e vjetër.

Masat që mori pushteti popullor që në ditët e para

të çlirimit të Shqipërisë, masa të rëndësishme ekonomike dhe shoqërore ishin të natyrshme dhe të drejta. Ato ja ndërruan faqen Shqipërisë së rrënuar nga lufta e gjatë dhe e përgjakshme. Këto masa, natyrisht, forcuan pozitat e pushtetit tonë. Mirëpo një gjë e tillë nuk i leverdiste as reaksionit të jashtëm dhe as reaksionit të brendshëm. Këtu u puqën interesat e tyre, këtu e kombinuan luftën kundër popullit shqiptar bejlerët, agallarët, borgjezia pasanike dhe reaksionare, pseudointelktualët reaksionarë, qehajallarët dhe sejmenët bënë kauzë të përbashkët. Me ta u bashkua edhe një pjesë e borgjezisë liberale, të cilën masat e gjera të popullit e kishin tërhequr në luftë, sepse ajo e aprovonte deri në një farë pike rezistencën kundër fashizmit, por luftonte me shumë rezerva dhe me qëllim që të qëndronte në Front për të fituar pozita në pushtet dhe, në analizën e fundit, të rimerrete tërë pushtetin në duart e saja.

Shumë njerëz të kësaj kategorie të fundit që ndodheshin, pra, në Front, kur panë se s'mundën dot t'ja arrinin qëllimit që kishin paracaktuar, të deziluzionuar shumë ata i shkëputën lidhjet me Frontin për të shkuar në kampin e armiqve të popullit.

Të gjitha ish-klasat sunduese duke parë se i humbën pozitat e tyre dominuese ekonomike dhe politike, duhej të mbështeteshin diku për t'i rifituar këto pozita në dëm të popullit tonë. Vetëvetiu kuptohet se në popullin shqiptar jo vetëm që s'kishin asnjë mbështetje, por ishin në luftë me të, mbështetja e tyre e vetme ishte i huaji, ishte reaksiioni ndërkombëtar me në krye reaksiionin anglo-amerikan, ku në realitet ata mbështetën përpjekjet e tyre, të cilat dështuan njëra pas tjetrës.

Qëndrimet armiqësore ndaj popullit shqiptar nga ana e qeverive amerikane dhe angleze si dhë mohimi i të drejtave tona legjitime, të fituara me gjak dhe me sakrifica, kishin një qëllim dhe ky qëllim ishte të mbësh-tetnin dhe të fuqizonin veprimtarinë e përfaqësuesve zyrtarë të tyre në Shqipëri, të cilët haptas dhe në kundërshtim me çdo ligj ndërkombe tar, duke shkelur so-vranitetin e një populli e duke ndérhyrë në punët e tij të brendshme, u përpoqën, deri sa u larguan nga Shqipëria, të grumbullonin reaksionin shqiptar, ta organizo-nin këtë, ta inkurajonin për sabotazhe dhe luftë të armatosur kundër popullit shqiptar. Veprimtaria e këtyre përfaqësuesve anglo-amerikanë kundër sovranitetit të popullit tonë është e dokumentuar dhe e faktuar gjerësisht.

Reaksionarët e vendit tonë, nën udhëheqjen e agjentëve të huaj, tentuan të rimëkëmbnin «Ballin Kombëtar», «Legalitetin» dhe një seri grupesh të tjera, këlyshët e të cilëve mund t'i gjeni tanë në Greqinë monarko-fashiste. Qëllimi i të gjithëve ishte një: me rrëzue me forcë pushtetin duke shpresuar në një zbarkim anglo-amerikan, me e ba vendin tonë një Greqi të dytë, duke e vënë nën thundrën e imperializmit amerikan. Kjo ishte rruga që ndoqën mbeturinat e «Ballit Kombëtar», të «Legalitetit» dhe të grupeve të tjera reaksionare, këtë rrugë ndoqën deputetët tradhëtarë që shkelën besimin e popullit dhe kjo rrugë i çoi drejt e në burg. Këta elementë tradhëtarë bënë çmos për të diskredituar masat e drejta të pushqitit, sabotuan punën, lëshuan parullat më të helmatisura dhe më të poshtra, por unë s'kam ndër mend të numëroj këtu tradhëtitë e panumërtë të

tyre, pse puna e tyre është aq e qelbur, sa të vjen ndot. Populli shqiptar për së shpejti do t'i dëgjojë këta njerëz të poshtër të deponojnë vetë përpara gjyqit krimet, poshtërsitë, tradhëtilë e tyre të pashembullta dhe drejtësia e popullit le të vendosë për ta, ashtu si e meritojnë.

Veprimitaria tradhëtare e këtyre elementëve u zhvillua në një moment, kur gjithë populli shqiptar ishte mobilizuar për ndërtimin e vendit, kur i madhi dhe i vogël punonte në kondita të vështira ekonomike për ngritjen e një jete të re. Këta njerëz nuk mund të pajtoheshin me këtë situatë. I merrni një nga një këta njerëz dhe analizoni të shkuarën e tyre, jetën e tyre, punën e tyre dhe do të shihni se këta nuk janë përvçese njerëz të llumit, të spekulimit dhe të çdo pune jo të ndershme. Këta njerëz kishin infiltruar në ndërmarrjen e madhe të popullit me të vetmin qëllim që ta sabotonin, këta i gjenim në zbatimin e reformës agrare, këta i gjenim atje ku ndërtonim ura, rrugë, bonifikime, këta i gjenim në aparatin e shtetit, këta i gjenim deri në parlamentin tonë. Këta njerëz qahen se këtu s'ka demokraci, se këtu ka terror. Në qoftë se ata me fjalën demokraci kuptojnë të kenë liri kriminelët, hajdutët, spekulatorët, fajdexhinitë e të tjerë njerëz të këtij kalibri, të kenë liri atentatorët e së drejtës dhe të lirisë së popullit, atëhere me të vërtetë të tillë demokraci s'ka dhe s'do të ketë në Shqipëri. Kush janë ata që përdorin terrorin, populli ynë dhe pushteti i tij, apo këta kriminelë e tradhëtarë që organizojnë sabotazhe, që ushqejnë kriminelët e luftës, që bëjnë atentate kundër njerëzve të popullit, që kërkojnë të shkatërrojnë e të grabitin veprën dhe djersën e popullit? Mos kujtojnë vallë këta

njerëz se drejtësia e popullit do t'i lërë të veprojnë rehat, të strehojnë kriminelët e luftës dhe të hanë bukë tok me ta, të shesin sekretet e shtetit dhe të popullit me stërlina dhe dollarë apo do t'i lërë të lirë të sabotojnë dhe të vrasin njerëzit e popullit dhe të pushtetit të tij? Pse tentojnë të vrasin veten këta kriminelë nëpër burgjet, pse mbytin veten duke u varur në qelinë e burgut me lidhëset e brekëve dhe pse hidhen nga penxheret për t'i dhënë fund jetës së tyre? Ai që s'është fajtor, nuk e bën një gjë të tillë.

Politika e drejtë e pushtetit tonë është karakterizuar kurdoherë nga vendosmëria më e madhe për me mbrojtë popullin dhe fitoret e tij, për me mbrojtë atdheun nga çdo rrezik i brendshëm ose i jashtëm. Ajo dallohet nga vendosmëria për të shkuar me hapa të sigurtë dhe të shpejtë drejt ndërtimit të një jete të lumtur për popullin tonë. Politika e drejtë e pushtetit tonë është karakterizuar kurdoherë nga një urtësi e madhe dhe gjakftohtësi në gjykimin e çdo çështjeje, është karakterizuar nga falja për fajet e vogla, të bëra pa qëllim dhe që janë të korrigjueshme, por ajo është e ashpër kundër armiqve të popullit dhe këtë politikë të drejtë pushteti ynë do ta zbatojë deri në fund. Ka qenë dhe do të jetë kurdoherë kujdesi ynë dhe detyra e Frontit Demokratik të shkëpusë sa të jetë e mundur më shumë njerëz të thjeshtë dhe të gabuar nga thonjtë e reaksionit, t'i edukojë këta, t'i bëjë të vlefshëm për atdheun, t'i futë në rrugën e drejtë, në rrugën e nderit. Në rast se ka njerëz, që mendojnë dhe e cilësojnë këtë politikë të drejtë dhe njerëzore të pushtetit dhe të Frontit tonë Demokratik si dobësi, ne u themi se gabohen

rëndë. Dhe në rast se këta njerëz, duke u mbështetur në këtë gjykim të gabuar, përpiken të dëmtojnë interesat e popullit, duke kujtar se nuk i sheh njeri, ne përsëri u themi atyre se gabohen rëndë. Populli shqiptar punon dhe përgjon për të mbrojtur liritë e tij dhe punën e tij. Populli ynë e di fare mirë se armiqtë e tij nuk mund të zhduken as në një ditë dhe as në një mot. Në çdo fitore tonën, do të ketë nga këta që do të dalin mbi ujë, pse vetë përpjekjet dhe puna e pareshtur e popullit do t'ua çjerrë maskën këtyre armiqve. Prandaj populli ynë në ndërmarrjen e tij të madhe dhe të shenjtë duhet t'i ketë kurdoherë sytë hapët dhe të çmojë drejt çdo situatë që krijohet nga puna e tij përparimtare. Ashtu si e bëmë mobilizimin për ndërtimin e vendit, ashtu duhet të bëjmë dhe mobilizimin për të luftuar me ashpërsinë më të madhe armiqtë tanë, qofshin këta të bëndshëm, qofshin agjentë të imperializmit të jashtëm. Me armikun s'ka kompromis, s'ka mëshirë, vetëm kështu do të fuqizohet vepra e popullit, vetëm kështu do të forcohet atdheu, do të përparojë atdheu, do të fuqizohet demokracia jonë popullore. Kjo duhet të jetë rruga e Shqipërisë së re.

Vërtet Shqipëria është një vend i vogël, por në arenën ndërkombëtare ka edhe ajo vendin e vet të merituar dhe rëndësinë e saj. Fakti që popullit shqiptar dhe demokracisë së tij popullore po i bëhet një luftë e padrejtë dhe jo e ndershme nga anglo-amerikanët dhe shërbëtorët e tyre, e justifikon rolin e demokracisë sonë në mbrojtjen e paqes dhe të sigurimit botëror, justifikon gjithashtu politikën e drejtë dhe të matur të qeverisë së Republikës sonë. Është e qartë për të gjithë

popullin tonë dhe për të gjithë popujt përparimtarë të botës, si edhe për vetë popujt e Amerikës dhe të Anglisë, se qëndrimi armiqësor i qeverive angleze dhe amerikane kundrejt vendit tonë, nuk mund të justifikohet nga konsideracione thjeshtësisht teknike ose arësyte të pashiftikueshme, siç mund të ishin çështja e traktateve ose arësyet absurdë, që krijonin herë pas here këto qeveri për të mbajtur një situatë të nderur në mes të shtetit tonë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës e Britanisë së Madhe. Të gjitha pretekstet, akuzat dhe shpifjet që i bëhen vendit tonë nga ana e qeverive të këtyre dy shteteve bëhen dhe mbahen në rendin e ditës me qëllime të paracaktuara. Këto bëhen me qëllime krejt të ndryshme nga ato që pretendonin se gjoja do të hetonin situatën dhe se, për të shpejtuar njohjen e qeverisë sonë, kishin ardhur në Shqipëri edhe përfaqësitë politike dhe ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Anglisë. Qeveritë angleze dhe amerikane nuk ja duan aspak të mirën popullit shqiptar. Këtë ata e kanë treguar dhe e tregojnë çdo ditë me fakte. Fakti që populli shqiptar është bërë zot i fateve të veta, fakti që ai vetëqeveriset, ndërton vendin e tij dhe jetën e lirë me djersën e ballit dhe ashtu si i pëlqen atij, fakti që në vendin tonë demokracia po fuqizohet dita-ditës më shumë dhe bëhet një faktor për forcimin e paqes dhe të sigurimit botëror, të gjitha këto nuk u pëlqejnë aspak reaksionit ndërkombe tar dhe qeverive anglo-amerikane. Që të mos u pëlqejë një gjë e tillë dhe një punë kaq përparimtare që bëhet në Shqipëri, ajo është punë e tyre, por që të ndërhyjnë në punët e brendshme të vendit tonë, të organizojnë mbeturinat e reaksionit

shqiptar, brenda dhe jashtë Shqipërisë, t'i ndihmojnë këta hapët për të sabotuar veprën e madhe të popullit që i kushton gjak dhe djersë Shqipërisë, këtu jemi në kundërshtim të hapët dhe nuk e lejojmë aspak një punë të tillë. Dhe këtu jemi plotësisht në të drejtat tona.

Pothuajse vetëm vendi ynë nuk është njohur nga qeveritë angleze dhe amerikane, në një kohë kur këto qeveri kanë përfaqësuesit e tyre diplomatikë edhe në vendet satelite¹. Megjithkëtë, një situatë e tillë nuk e ndryshon aspak shkuarjen tonë kurdoherë përpara dhe forcimin e përparimin e demokracisë sonë popullore. Populli shqiptar dhe Republika e tij Popullore kanë fituar simpatinë dhe respektin më të madh nga të gjithë popujt përparimtarë të botës. Vetëm se një situatë e tillë nuk është në nderin e popujve të Anglisë dhe të Amerikës. Popujt e këtyre dy vendeve dhe i gjithë opioni botëror le ta gjykojë këtë qëndrim të qeverive anglo-amerikane kundrejt një populli të vogël heroik, që derdhi rrëke gjaku në luftën kundër fashizmit, që ngriti pushtetin e tij popullor dhe demokratik dhe që me forcat e tij të vogla, por i vendosur, mbron me mish e me shpirt paqen dhe sigurimin botëror. A mos vallë për këto arësyen nuk njihet vendi ynë? Vallë për këto arësyen i mohohen popullit tonë të drejtat në lëmin ndërkombëtar? Populli shqiptar është plotësisht i bindur se këto dhe vetëm këto janë arësyet që nuk i njihen të

¹ Është fjala për shtetet që gjatë Luftës së dytë botërore bashkëpunuan me Gjermaninë hitleriane.

drejtat e tija nga ana e qeverive anglo-amerikane, dhe s'ka asnë arësyet tjetër; çdo arësyet tjetër është pa baza dhe nuk qëndron në këmbë. Po të mos ishte në Shqipëri në fuqi populli, po të sundonin në vendin tonë kuislängët dhe spiunët e fashizmit, që mbahen sot me njëmijë të mira dhe në kundërshtim me të drejtat ndërkombe-tare prej qeverive anglo-amerikane, atëherë punët do të ishin ndryshe. Shqipëria, natyrisht që do të ishte njohur prej këtyre shteteve, por vendi ynë do të ishte bërë një Greqi e dytë, ku do të mbretëronte Zogu dhe terrori i bezlerëve c i kriminelëve të luftës dhe populli do të vuante në mjerimin më të madh dhe të pashebullt në historinë e tij. Zaten, për të vendosur këtë regjim terrori në vendin tonë, për të vendosur në Shqipëri klasën e spekulatorëve dhe të kriminelëve të luftës, i mbanin dhe i mbajnë këto qëndrime të padrejta ndaj vendit tonë qeveritë anglo-amerikane. Një qëndrim politik i tillë zyrtar i qeverive anglo-amerikane përkrahte veprimtarinë praktike të përfaqësuesve të tyre zyrtarë në Shqipëri. Prova dhe fakte të habitshme janë në dorën e qeverisë, të cilat tregojnë se përfaqësitet politike dhe ushtarake të qeverive angleze dhe amerikane në Shqipëri kanë qenë jo përfaqësi të dy popujve, për të cilët populli ynë ushqen simpati, por agjenci spiunazhi të reaktionit anglo-amerikan, ku preqatishin planet për rrëzimin e pushtetit të popullit tonë, ku preqatishin sabotazhet, krimet më të shëmtuara kundër sovranitetit të një populli të vogël, paqedashës dhe heroik. Populli shqiptar nuk e kuption kështu miqësinë me popujt e Anglisë dhe të Amerikës dhe nuk pajtohet kurrsesi me atë «miqësi» që kultivonin përfaqësuesit e tyre zyrtarë

në Shqipëri. Por veprimitaria e qeverive anglezë dhe amerikane nuk kufizohet në veprimet që përmendëm më lart, ajo është më e gjërë dhe e shumanshme, e orkestruar me të gjitha mjetet dhe deri në komplikacione me karakter ndërkombëtar. Qeveritë anglo-amerikane, paralel me veprimet e lartpërmendura, janë përpjekur ta paraqesin Shqipërinë si një vend të rrezikshëm që kërcënë paqen botërore, sigurimin ndërkombëtar. «Shqipëria kërcënë paqen!» Kjo i përngjet «argumentit» që përdori Italia fashiste për të sulmuar popullin grek, «argumenti» mbi vrasjen e Daut Hoxhës.

Ju, sigurisht, keni ndjekur me vëmendje rrjedhimin e ngjarjeve që kanë të bëjnë me incidentin e provokuar me qëllim nga anglezët në Sarandë, keni parë faktet dhe provat se si anglezët e kurdisën këtë çështje, si e frynë, si e ngritën dhe e çuan deri në Këshillin e Sigurimit e deri në Gjyqin ndërkombëtar të Hagës për t'i provuar botës me prova të alambikuara false dhe aspak bindëse, se Shqipëria po rrezikonte paqen. Shqipëria kurrë s'ka vënë mina në bregdetin e saj, pse as ka pasur mina dhe as ka pasur mjete me se t'i vinte. Vetë dokumentat zyrtare angleze provojnë se ata e njojin ekzistencën e minave të mbeturë që në kohën e luftës ndër ato ujëra, vetë ata njojin se spastrimi, që ata vetë e kanë bërë, s'është aspak i sigurt dhe se rruga e lundrimit paraqet rreziqe. Minat fare lehtë mund t'i kenë vënë vaporet britanike ose shërbëtorët e tyre të Athinës. Këtu lind pyetja: Ç'kérkonin vaporet angleze për shumë herë rresht, përse ata shkelën për shumë herë rresht sovranitetin e ujërave tona territoriale? Sigurisht, kanë pasur një qëllim. Anglezët pretendojnë se kanë të drejtën e

kalimit përmes kanalit të Korfuzit me anijet e tyre «paqësore», mirëpo rruga e kalimit nëpërmjet kanalit të Korfuzit nuk është pesëqind metra larg portit të Sarandës, në bregdetin e Himarës, dhe lundrimi paqësor nuk do të thotë me i pasë të gjithë topat të ngritur dhe të drejtuar nga portet tona. Po anijet e shërbëtorëve të tyre të Athinës, që për tetë herë rresht, të mos flasim për ato që ngjanë dhe ngjasin dita-ditës — ç'kërkonin në ujërat tona, deri dhe afër porteve tona? Apo dhe ato kishin «qëllime paqësore» kur grabitnin varkat tona me gjithë njerëz dhe i çonin në Korfuz, ose kur mitralonin bregdetin dhe fshatrat tona, ose kur qëllonin me top fshatrat e Konispolit? S'do shumë mend për t'i kuptuar pse bëheshin këto gjëra nga ana e tyre. Me gjithë votat, që anglo-amerikanët grumbullojnë kurdoherë në Këshillin e Sigurimit për të aprovuar të tilla akte të kurdisura dhe agresive, e drejta është nga ana jonë dhe për të fituar të drejtat tona, ne nuk gjunjëzohemi as përpara shantazheve, as përpara kërcënimeve. Dhe drejtësia do të jetë kurdoherë me të drejtët. Si argument bindës dhe të orës së fundit, që anglezët dhe amerikanët suallën për incidentin e Sarandës, ishte ky: «Qeveria Shqiptare ose i ka vënë vetë minat ose e di kush i ka vënë, për arësy se ajo i ruan me xhelozinë më të madhe kufitë dhe bregdetin e saj». Por ky argument i fundit nuk provon asgjë, ose më mirë provon një gjë, të cilën ne e pohojmë me plot gojën se është fare e vërtetë, që ne i ruajmë me xhelozinë më të madhe dhe me vendosmërinë më të madhe bregdetin tonë dhe kufitë tanë të Jugut, pse ata janë të shenjtë për ne dhe se rrëth tyre vërtiten ujqërit fashistë.

Qeveria monarko-fashiste e Athinës, e ndihmuar me të gjitha mjetet prej anglezëve dhe amerikanëve, është bërë një plagë kronike dhe shumë e rrezikshme jo vetëm për paqen në Ballkan, po edhe për paqen botërore. Fatkeqësia e popullit heroik grek nuk mund të përshtruhet. Sillni ndër mend ditën e 4 shkurtit¹ në Tiranë. Si kjo ditë ka përhera në të gjitha qytetet dhe fshatrat e Greqisë. Terrori monarko-fashist ka arritur kulmin. Por Greqia është bërë njëkohësisht epiqendra e sulmeve të armatosura dhe e provokacioneve të panumërtë kundër vendit tonë dhe kundër të gjitha vendeve të tjera demokratike të Ballkanit. Po bëhen vite me radhë që provokacionet nga ana e fashistëve grekë në kufirin tonë jo vetëm që s'pushojnë, por ato shtohen dhe bëhen në stilin më të egër fashist. Fashistët grekë sulmojnë postat e kufirit tonë, hyjnë në tokën tonë, vrasin dhe plagosin qytetarë të qetë që punojnë në ara, mitralojnë me aeroplanë dhe na vrasin njerëz dhe bagëti, grumbullojnë dhe organizojnë kriminelët shqiptarë të luftës dhe përpiken t'i futin këta në tokën tonë për të organizuar vrasje dhe vjedhje. Të gjitha këto krime hyjnë në planin e përgjithshëm të reaksionit anglo-amerikan.

Për këto provokacione të përgjakshme prej banditësh, që kanë për qëllim të vetëm prishjen e pages në Ballkan dhe në botë dhe shpërthimin e një lufte të re,

¹ Më 4 shkurt të vitit 1944, forcat e «Ballit Kombëtar», të xhandarmërisë kuksinge, në bashkëpunim me pushtuesit gjermanë organizuan në Tiranë një masakër të madhe kundër popullatës së pafajshme për të larguar popullin nga Lufta nacional-çlirimtare.

që shpall doktrina e Trumanit¹, qeveria shqiptare u ka bërë shumë herë apel Kombeve të Bashkuara që të merren masa dhe t'u jepet fund këtyre provokacioneve të panumërtë të monarko-fashistëve grekë. Komisioni hetimor i OKB-së, që erdhi në Greqi, u vu përpara faktave të pamohueshme dhe të shumta që provonin fajësinë e qeverisë monarko-fashiste të Athinës, e cila bashkë me anglo-amerikanët janë të vëlmit përgjegjës të luftës civile në Greqi. Fakte të panumërtë dhe të padiskutueshme u vunë përpara Komisionit hetimor nga përfaqësuesi i qeverisë shqiptare, të cilat provuan në mënyrë të shkëlqyer kriminalitetin e qeverisë monarko-fashiste të Athinës, përgjegjësinë për incidentet e panumërtë që ka bërë në kufirin tonë, inkursionet pirateske dhe me qëllime provokuese, që kanë bërë anijet e saj në ujërat tona, shkeljen e sovranitetit të vendit tonë nga bandat e saj, masakrat kundër popullatës shqiptare të Çamërisë, të provuara dhe të dokumentuara në mënyrë të padiskutueshme dhe më në fund përgjegjësinë e qeverisë monarko-fashiste të Athinës dhe të përkrahësve të saj anglezë në luftën e brendshme civile. Por megjithatë kërkohet të mbulohet e vërteta, të mbulohet dielli me shoshë, si thotë populli ynë, kërkohet nga ana e anglezëve, amerikanëve dhe pasojësve të tyre të zakonshëm të votës të bëhen përgjegjëse qeveria shqiptare, jugosllave dhe bullgare për luftën civile që ka shpër-

¹ Programi i ekspansionit imperialist amerikan. Ju propozua Kongresit të SHBA nga Presidenti Herri Truman më 12 mars 1947. Kishte për qëllim të ushtronte presion mbi vendet e demokracisë popullore dhe të përkrahte forcat reaksionare nëpërmjet ndihmës ushtarake dhe ekonomike.

thyer e furishme dhe e përgjakshme në Greqi. Jo, me këtë argument nuk gënjetet njeri dhe atë as që e pranon njeri. Popullin heroik grek, që është ngritur me armë në dorë për të fituar lirinë e tij, me 10 mijë partizanë grekë që luftojnë heroikisht nëpër male, as nuk i ka çuar në luftë e në kryengritje dhe as i ka armatosur qeveria shqiptare, jugosllave dhe bullgare. Ata i ka çuar mjerimi i atdheut të tyre, mjerimi i popullit të tyre, ata i ka shtyrë në luftë ideali i lirisë, i demokracisë që është vënë nën këmbë nga monarko-fashistët e Athinës dhe përkrahësit e tyre, ata i ka hedhur në luftë terrori i madh i fashistëve grekë. Populli shqiptar dhe qeveria e tij nuk janë përzier kurrë në punët e brendshme të Greqisë, pse ato s'janë punë që u përkasin dhe hedhin poshtë çdo shpifje që u bëhet nga çdo anë qoftë. Vetëm se qeveria shqiptare dhe populli shqiptar kanë pranuar dhe do të pranojnë në tokën e vet dhe do t'u japid hospitalitet popullatës dhe demokratëve të persekuuar dhe të ndjekur nga fashistët grekë. Këtë gjë na e thotë Statuti ynë dhe ligjet ndërkombëtare në fuqi. Populli shqiptar dhe qeveria e tij kërkojnë të lihen të qetë në jetën e tyre që po ndërtojnë dhe të ndalojen provokacionet e fashistëve grekë. Qeveria shqiptare, tok me popullin e vet, nuk do të lejojnë në asnje mënyrë të cënohen kufitë e tyre nga bandat e monarko-fashistëve grekë dhe do ta mbrojnë atdheun e tyre, jetën e tyre dhe demokracinë e tyre deri në vdekje. Ushtria jonë heroike, që ju e patë të parakalonte ditën e 10 Korrikut, është mburoja më e sigurt e fitoreve, e jetës sonë që po ndërtojmë, e integritetit të atdheut tonë.

Por tragjedia e popullit grek nuk është përvçese

një shfaqje në mes të shumë të tjerave që përbëjnë doktrinën e Trumanit dhe të Çerçillit. Imperializmi amerikan në krye të të gjithë reaksionit ndërkombe tar përpinqet të gllabërojë botën dhe të shtypë liritë e popujve, me kërcënime, me bombën atomike, me politikën e forcës dhe të dollarit. Një fushatë e gjerë shpifjesh është ngritur nga imperialistët kundër Bashkimit Sovjetik, kundër atij vendi dhe atyre popujve që shpëtuan botën nga fashizmi dhe që njerëzimi u është mirënjojës për jetë, kundër Bashkimit Sovjetik që qëndron si një kështjellë e pathyeshme për të mbrojtur paqen, njerëzimin dhe për të bërë të falimentojnë orvatjet e nxitësve të luftës dhe skllavëruesve të popujve të botës. Por popujt liridashës të të gjitha vendeve kanë grumbulluar të gjitha energjitetë e tyre për ta mbrojtur paqen që u kushtoi aq shtrenjtë dhe të bëjnë të dështojnë manevrat e nxitësve të luftës.

Plani Marshall¹ është një tjetër anë e doktrinës së Trumanit, e politikës së dollarit dhe të skllavërimit. Qeveria shqiptare dhe populli shqiptar e ndoqi me vëmendje zhvillimin e punimeve të Konferencës së Parisit të të tre ministrave të Jashtëm², pse vendi ynë ka nevojë

¹ Plani i nënshtimit ekonomik dhe politik të vendeve të Evropës ndaj SHBA në formën e ndihmës ekonomike. U paraqitura në vitin 1947 nga Sekretari i Departamentit të Shtetit të SHBA Xhorxh Marshall dhe u aprovua nga Kongresi i SHBA në vitin 1948.

² Është fjala për Konferencën e Ministrave të Punëve të Jashtme të BRSS, të Britanisë së Madhe dhe të Francës që u mblohdh në Paris më 27 qershor 1947 për të diskutuar rreth ndihmës ekonomike që ofronte qeveria amerikane për vendet e Evropës.

për ndihma. Konferenca e Parisit mbaroi pa asnjë përfundim. Pikëpamjet e Bashkimit Sovjetik ishin në kundërshtim me ato të qeverive anglo-franceze, sikundërqë e paraqet shtypi zyrtar i të tri vendeve respektive. Qeveria jonë para disa ditëve mori një ftesë zyrtare nga qeveria franceze dhe angleze, me të cilën ne ftoheshim për të marrë pjesë në një konferencë që organizojnë këto në lidhje me planin Marshall.

Qeveria jonë, pas një studimi që i bëri kësaj çështjeje, vendosi unanimisht ta refuzojë ftesën e qeverive angleze dhe franceze për pjesëmarrjen në këtë konferencë që do të mbahet më 12 korrik, për arësy se, sipas mendimit të qeverisë sonë, nuk ekziston një plan konkret ndihme amerikane për Evropën dhe se vetë plani Marshall është shumë i paprecizuar dhe i errët. Sa për organizatën e projektuar prej qeverive franceze dhe angleze, sipas mendimit të qeverisë sonë, ajo jo vetëm që nuk ka për qëllim të lehtësojë ndarjen e ndonjë ndihme amerikane për popujt e Evropës, por synon elaborimin e një plani ekonomik të përgjithshëm për Evropën nën drejtimin e Anglisë dhe të Francës, me aprovin definitiv të Shteteve të Bashkuara. Një plan i tillë do të shkaktonte një kaos ekonomik në Evropë dhe duke ndërhyrë në punët e brendshme të shteteve evropiane, duke shkelur vullnetin e sovranitetin e tyre do ta vinte ekonominë e këtyre shteteve nën drejtimin e mëshirën e fuqive të mëdha të Evropës dhe të Shteteve të Bashkuara. Ky plan do të ishte shkak për krijimin e një bloku dhe për një përçarje në Evropë. Qeveritë franceze dhe angleze, me ftesën që i drejtuan qeverisë sonë, kërkonin të na vinin përpëra një fakti të kryer, që ne

nuk mund ta pranonim në asnjë mënyrë, pse qeveria jonë është e bindur se vetëm respekti i parimit të sovranitetit dhe pavarësisë kombëtare, mund të jetë baza për një bashkëpunim të sinqertë dhe të frytshëm në mes të kombeve. Qeveria shqiptare nuk mund të lejojë dhe të pranojë kurrë që Sovraniteti dhe pavarësia e vendit tonë të shkelet. Të gjitha këto arësyce e shtërguan qeverinë të mos ta pranojë ftesën e dërguar prej qeverive franceze dhe angleze. Por ka edhe një arësyc tjetër të madhe që e forcon dyshimin dhe mosbesimin e qeverisë shqiptare kundrejt ndihmës amerikane dhe qëllimeve të saja dhe kjo ka të bëjë me qëndrimin kurdoherë armiqësor, të mbajtur nga qeveritë angleze dhe amerikane kundrejt të drejtave të pamohueshme të popullit tonë. Duke i marrë parasysh këto qëndrime të padrejta dhe aspak të justifikueshme, është krejtësisht e natyrshme dhe e drejtë që populli shqiptar dhe qeveria e tij të dyshojnë për sinqeritetin e ndihmës amerikane dhe realitetin e vërtetë të kësaj ndihme.

Popujt e Evropës, që pësuan rrënimet më të tmerrshme nga lufta dhe që panë me sytë e tyre dhe paguan shtrenjtë sulmin barbar të hitlerianëve e të satelitëve të tyre, konsekuenca këto të veprës dhe të politikës së klikave reaksionare dha imperialiste dhe bashkë me ta edhe popujt përparimtarë të botës mbarë, në këto momente të paslufstës kanë vënë të gjitha forcat për të mos lënë të përsëritet edhe një herë tjetër një katastrofë e tillë. Të gjithë këta do të bëjnë të dështojnë manevrat e nxitësve të luftës si Çërçilli me shokët e tij. Këtu është çështja e mbrojtjes me çdo kusht e paqes së vërtetë demokratike, e mbrojtjes së jetës sonë, e jetës së kalamajve

tanë, e mbrojtjes së fitoreve tona që na kushtuan gjak dhe rrënime. Për mbrojtjen dhe forcimin e një paqeje të tillë, populli i vogël shqiptar ka vënë dhe do të vërë të gjitha forcat e tija në balancën e popujve përparimtarë të botës, që përpinqen po për këtë qëllim. Mbrojtja e një paqeje të tillë është po aq e domosdoshme, sa ishte edhe fitorja mbi Gjermaninë naziste. Një paqe e tillë do të arrihet me gjithë përpjekjet përf Luftë të nxitësve të luftës, do të arrihet ashtu si u arrit fitorja mbi Gjermaninë hitleriane. Popujt e botës dhe Bashkimi Sovjetik me udhëheqësin e tij në krye, Stalinin e madh, do të luftojnë përf forcimin e paqes së drejtë, e paqes së vërtetë. Me Bashkimin Sovjetik, që shpëtoi njerëzimin nga fashizmi, janë gjithë popujt përparimtarë dhe liridashës të botës, me Bashkimin Sovjetik është populli ynë i vogël, pse Bashkimi Sovjetik mbron popullin tonë. I madh dhe i vogël në Shqipëri e ka kuptuar dhe e ndjen thellë në zemrën e tij se pa luftën heroike të popujve të Bashkimit Sovjetik s'do të kishte Shqipëri të lirë e demokratike dhe populli shqiptar do të masakrohej e do të shtypej pa mëshirë. I madh e i vogël në Shqipëri ka parë se me sa vendosmëri Bashkimi Sovjetik ka mbrojtur të drejtat tona, vendin tonë, pavarësinë tonë, gjakun e bijve tanë që ranë në fushën e ndcrit duke luftuar me heroizëm kundër fashizmit. Është e natyrshme, pra, që populli shqiptar ta dojë me zemër Bashkimin Sovjetik. Në një kohë kur nxitësit e luftës kërcënojnë botën me anë të forcës, me anë të bombës atomike, me anën e dollarit, kur reaksiioni ndërkombëtar po bën përpjekje më të mëdha përf të shtypur demokracinë përparimtare dhe përf të ringjallur forcat e errëta të fashizmit, zëri i

fuqishëm i Bashkimit Sovjetik me vendosmërinë më të madhe po mbron paqen dhe sigurimin, po mbron popujt dhe demokracitë e tyre përparimtare. Populli ynë me entuziazmin më të madh e përshëndet politikën e drejtë dhe paqësore të Bashkimit Sovjetik, sepse ajo është shprehje e gjallë e ndjenjave të larta dhe bujare të popujve të mbarë BRSS dhe të regjimit të tyre që kanë për parim mbrojtjen e lirive, mbrojtjen e demokracisë së vërtetë, mbrojtjen e popujve të mëdhenj dhe të vëgjël, mbrojtjen e paqes së vërtetë.

Marrëdhënjet e popullit tonë me popullin mik bulgar po bëhen dita-ditës më të përzemërtë dhe miqësore dhe populli ynë me gjithë zemër i uron Bullgarisë së re të Dimitrovit një të ardhme të lulëzuar. Me popullin rumun Shqipëria do të vendosë për së shpejti marrëdhënje diplomatike dhe populli ynë dëshiròn dhe shpreson që të tilla marrëdhënje të vendosen dhe me popujt e tjerë demokratikë, gjë që është në interesin e përgjithshëm të paqes.

Shokë deputetë,

Dëshiroj të shpreh përpara jush se qeveria, që kam nderin të kryesoj, do të vërë të gjitha forcat e veta për të zbatuar këtë politikë të drejtë që shpreh aspiratat dhe dëshirat e popullit tonë, do të vërë të gjitha forcat në zbatimin dhe realizimin në jetë të kësaj politike ndërtimtare dhe përparimtare, do të vërë të gjitha forcat për zbatimin e drejtë dhe të përpiktë të ligjeve që aprovon Kuvendi Popullor i RP të Shqipërisë dhe do të mbrojë me vendosmërinë më të madhe interesat e po-

pullit, jetën e popullit, Republikën tonë Popullore. Në çdo moment dhe çdo gjë në shërbim të atdheut dhe të popullit tonë.

Rroftë populli shqiptar!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 791
13 korrik 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 791,
13 korrik 1947*

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR POPUJVE TË
BASHKIMIT SOVJETIK NGA AERODROMI I
MOSKËS ME RASTIN E VIZITËS SË DELEGACIONIT
TË QEVERISË SË RPSH NË BRSS**

14 korrik 1947

Të dashur popuj miq të Bashkimit Sovjetik,

Qytetarë dhe qytetare të Moskës heroike,

Si përfaqësuesit e një populli të vogël të Ballkanit ju transmetojmë përshëndetjet e përzemërta në emër të popullit shqiptar dhe në emrin tonë. Ju sjellim përgëzimet miqësore dhe ndjenjat e miqësisë më të thellë dhe më të singertë. Kjo ditë është një ditë historike dhe shumë e lumtur për popullin tonë, sepse përfaqësuesit e tij janë duke vizituar sot për herë të parë vendin tuaj të lavdishëm, kryeqytetin tuaj heroik, ku drejtohen vazhdimisht zemrat dhe mendimet e popullit tonë.

Populli ynë i vogël ka vuajtur shumë që prej shumë shekujsh. Invaduesit e pamëshirshëm na kanë shtypur, e kanë zhystur vendin në gjak dhe e kanë shkatërruar por populli ynë nuk ju përkul kurrë atyre dhe luftoi heroikisht për liri. Në luftën më të rreptë kundër fašizmit gjerman dhe italian, populli ynë, i madh dhe i

vogël, burra dhe gra dualën në mal me armë nü dorë, të vendosur, ose të fitonin lirinë dhe pavarësinë, ose të vdisnin. Në e fituam lirinë dhe pavarësinë. Populli ynë ka vendosur një pushtet me të vërtetë përparimtar dhe sot është duke shkuar përpëra i vendosur për të sigruar një jetë akoma edhe më të lumtur.

Populli shqiptar mundi t'i korre të gjitha këto fitore në saje të luftës së lavdishme të popujve të Bashkimit Sovjetik, që e shpëtuan njerëzimin nga fashizmi, në saje të heroizmit të ushtrisë suaj të lavdishme të drejtuar nga Gjeneralisimi i madh Stalin, ushtri që nuk e ka shoqen në histori. Lufta dhe përpjekjet tuaja qenë shembull për ne. Ato na frymëzuan dhe na mësuan se si të luftojmë dhe të ngadhënjejmë mbi një armik të tillë të madh, siç ishte fashizmi gjerman. Populli shqiptar luftonte në fushën e nderit nëpër male, me zemrat të mbushura me dëshirën për liri dhe me emrin e Stalinit të madh në gojë. Heronjtë tanë kanë shprehur nëpërmjet luftës së tyre mirënjojen e tyre të thellë përiju dhe për udhëheqësin tuaj.

Nxitësit e luftës nuk e duan demokracinë e popullit shqiptar dhe janë duke bërë çdo përpjekje për të penguar përparimin tonë, për të cilin ne përpinqemi. Populli shqiptar i është gjithmonë mirënjojës Bashkimit Sovjetik, i cili është duke mbrojtur me një vendosmëri të madhe vendin tonë të vogël; ai është duke mbrojtur të drejtat tona dhe lirinë tonë që na kushtuan gjak dhe sakrifica.

Rroftë Bashkimi Sovjetik, mbrojtës besnik i lirisë, i të drejtave dhe i paqes së vërtetë. mbrojtës i popujve të mëdhenj dhe të vegjël!

Rroftë sa malet udhëheqësi juaj i madh, Stalini, miku i dashur dhe më i respektuar i popullit tonë të vogël!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 793,*

16 korrik 1947

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 793,*

16 korrik 1947

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR POPULLIT TË
LENINGRADIT ME RASTIN E VIZITËS SË
DELEGACIONIT TË QEVERISË SË RPSH
NË KËTË QYTET**

23 korrik 1947

Nga zemra ju përshëndes në emër të popullit tim dhe të delegacionit të qeverisë shqiptare që kam nderin të kryesoj. Ju përshëndes juve, luftëtarëve të shquar dhe heroikë të Luftës së madhe Patriotike, luftë vigane që shpëtoi botën nga skllavëria më e rëndë e fashizmit.

A mund të ketë epope më të lavdishme se ajo që keni shkruar me gjakun tuaj të kulluar vjete me radhë, duke mos u lëshuar asnjë pëllëmbë tokë fashistëve barbarë gjermanë nga qyteti i madh i Leninit dhe i revolucionit? Jo, s'mund të ketë. Vendi i madh i lavdishëm i Sovjetëve, qytetet e Bashkimit Sovjetik, popujt sovjetikë mundën të bënin të tilla mrekullira, pse ata janë të frymëzuar nga idealet më të larta dhe më të pastra të njerëzimit përparimtar, pse ata janë mbrujtur në zjarrin e luftës dhe të revolucionit më të madh që ka parë bota, pse ata janë të frymëzuar nga mësimet e të madhit Lenin dhe të Stalinit të madh, pse ata udhëhiqen nga Partia e lavdishme Bolshevikë.

Vjete me radhë ju vuajtët mjerimet më të mëdha, por asgjë s'ju tronditi besimin në fitoren e madhe. Me flamurin e Leninit dhe të Stalinit lart, ju çliruat atdheun tuaj, ju çliruat Evropën.

Ju e dini se vendi ynë ndodhet buzë detit Adriatik në Siujdhesën e Ballkanit. Vendı ynë është plot me male. Vendı ynë ka qenë sulmuar shekuj me radhë nga agresorë të ndryshëm dhe malet ishin kështjellat e popullit tonë, ku ai kurdoherë ka luftuar për të mbrojtur jetën e tij, për të fituar lirinë dhe pavarësinë.

Fashistët italianë na sulmuancë nga deti, ata ishin një mizéri e madhe, të armatosur deri në dhëmbë. Ne ishim pa armë, por ata s'i lamë të hynin rehat në portet tona. Ne u gjakosëm që në ditët e para të prillit 1939.

Të gjitha shtetet bënë veshin e shûrdhër përparrë tragjedisë së popullit tonë të vogël. Vetëm Bashkimi Sovjetik ngriti zërin e tij për mbrojtjen e popullit tonë të vogël. Fashistët e shkelën vendin tonë, por popullin tonë ata nuk ishin në gjendje ta thyenin, pse ai ishte i fortë si malet e vendit të tij, ishte i fortë si ata male ku për pesë vjet me radhë ai luftoi me heroizëm për liri.

Por pa luftën tuaj të lavdishme, pa heroizmat e Ushtrisë Sovjetike, të udhëhequr nga Stalini, ne do ta kishim të zorshme fitoren mbi armikun. Me ju është e lidhur liria e vendit tonë, prandaj populli ynë ju do me gjithë shpirt dhe ju është mirënlohës.

Populli i madh sovjetik na mbron dhe na ndihmon në çdo moment, por ka njerëz të ligj që na kërcenojnë jetën tonë, atdheun tonë, që e çliruan dhe e ndërtojmë me sakrifica të mëdha. Kurrë, gjer më sot, populli ynë i vogël s'ka pasur një mik kaq të madh e të fuqishëm,

një mik kaq të dashur dhe të singertë, siç është Bashkimi Sovjetik. Për ne, që kemi ardhur për vizitë miqësore në atdheun tuaj po tregohet një simpati dhe një dashamirësi e papërshkrueshme nga ana e qeverisë sovjetike, nga ana e Stalinit të madh, nga ana juaj. Populli ynë ju falënderon nga zemra dhe brohorit për ju, për lavdinë tuaj. Ne jemi thellësisht të prekur nga lufta juaj heroike e çlirimtë dhe nga lufta juaj plot lavdi e rindërtimit dhe ne largohemi nga qyteti i madh i Leninit dhe i Revolucionit me zemrën sa një mal, me forca të reja dhe të shumëfishuara që do të na shërbejnë për t'i vënë në shërbim të popullit tonë, në shërbim të rindërtimit të vendit tonë. Vepra e madhe e rindërtimit, që zhvillohet te ju, forca, tempi në punë dhe vetëmohimi, nuk kanë shembull në ndonjë vend tjetër. Këto janë shembulla që tregojnë madhështinë e popujve tuaj, e udhëheqësit tuaj, Stalinit të madh. Populli ynë do të marrë shembull nga ju si ndërtohet atdheu, ashtu sikundër mori shembull nga ju si luftohej armiku, si çlirohej atdheu.

Nga zemra ne brohoritim:

Rrofshin popujt heroikë dhe shumë të shtrenjtë të Bashkimit Sovjetik!

Rroftë udhëheqësi juaj, Stalini i madh, të cilin populli ynë e ka në zemër!

Lavdi të përjetshme në shekuj qytetit heroik të Leningradit!

Rrofshin qytetarët dhe qytetaret heroike të Leningradit!

Rroftë sa malet miqësia e madhe dhe e përzemërt

në mes të popujve të lavdishëm sovjetikë dhe popullit
të vogël shqiptar!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 804.
29 korrik 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 804.
29 korrik 1947*

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR POPUJVE TË
BASHIKIMIT SOVJETIK NGA AERODROMI
I MOSKËS ME RASTIN E LARGIMIT TË
DELEGACIONIT TË QEVERISË SË RPSH
NGA BRSS**

26 korrik 1947

Të dashur popuj miq të Bashkimit Sovjetik,

Ne, delegacioni i Qeverisë së Republikës Populllore të Shqipërisë, po largohemi sot nga atdheu juaj dhe nga kryeqyteti juaj heroik me përshtypjet më të thella për pritjen aq shumë të përzemërt dhe aq miqësore që na u bë prej të gjithëve dhe kudo që shkuam. Simpatia e madhe që shfaqin njerëzit sovjetikë dhe udhëheqësit e tyre për popullin tonë të vogël, tregon madhështinë e popujve tuaj, drejtësinë tuaj të madhe, tregon sa të larta dhe të pastra janë ndjenjat tuaja humanitare.

Ne pamë në vendin tuaj gjëra të habitshme që vetëm popujt sovjetikë mund t'i krijojnë. Ju po rindërtoni atdheun tuaj që pësoi shkatërrimet më të mëdha nga lufta me po atë shpejtësi dhe zotësi, me po atë heroizëm dhe vetëmohim që ju kapërcyet pengesat e tmerrshme të luftës, që ju e situat Luftën e madhe Patriotike dhe shpëtuat gjithë popujt e botës nga skllavëria më e rëndë.

Ne pamë si punon punëtoria sovjetike. Në fushat e vadiruta me gjakun tuaj, ku janë bërë heroizma të pashembullta deri tani prej jush dhe prej ushtrisë suaj të lavdishme, ne pamë të përtërihet dhe të rindërtohet me një vrull të pashoqjeta e lumtur dhe e gëzuar. Ne pamë dhe vizituam qendrat kulturale dhe artistike, pamë qendra, ku mësojnë dhe edukohen brezat e rinj të vendit tuaj. Këto na habitën dhe kanë prekur zemrat tona. E përjetshme në shekuj do të rrojë vepra juaj, vepra e kryetarit tuaj të lavdishëm, Gjeneralisimit të madh Stalin.

Në emër të popullit shqiptar dhe të qeverisë shqiptare falenderoj nxehësisht nga zemra Gjeneralisimin Stalin dhe qeverinë sovjetike për pritjen kaq të përzemërt dhe për dashamirësinë që treguan kundrejt popullit tonë. Nderi i madh që vetë Gjeneralisimi Stalin i bëri popullit tonë dhe delegacionit të tij duke na pritur shumë herë, interesimi i madh që ai tregoi për jetën e popullit tonë, për luftën tonë dhe fjalët e mira që tha për popullin tonë të vogël, janë shprehja më e lartë e simpatisë që ushqen Gjeneralisimi Stalin dhe njerëzit sovjetikë për popullin tonë. Me Gjeneralisimin Stalin dhe me sh. Mollotov ne biseduam probleme nga më të rëndësishmet për vendin tonë, që kanë të bëjnë me rindërtimin e vendit tonë dhe me ndërtimin e një jete të lumtur për popullin tonë. Ata pranuan menjëherë kërkosat tona për të na ndihmuar në ngritjen e ekonomisë sonë, në pajisjen e industrisë dhe të bujqësisë me makineri, për të na ndihmuar në lëmin kultural, arësimor, etj. Populli ynë ju është shumë mirënlohës për këtë ndihmë kaq të madhe. Populli shqiptar me mish e me

shpirt do ta mbrojë dhe do ta forcojë këtë miqësi të madhe që e lidh me popullin e madh sovjetik.

Popujt e Bashkimit Sovjetik të jenë të sigurtë se te populli shqiptar ata kanë një mik të vogël, por të vendosur dhe besnik.

Rroftë Bashkimi i madh Sovjetik!

Të rrojë i madhi Gjeneralisimi Stalin, të rrojë aq sa dëshiron zemra e popujve tuaj dhe e popullit tonë të vogël!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 803,
27 korrik 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 803.
27 korrik 1947*

**FJALA DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR ME
RASTIN E KTHIMIT NGA VIZITA QË BERI
DELEGACIONI I QEVERISE SË RPSH NË BRSS**

26 korrik 1947

Popull shqiptar,

Vajtja e delegacionit të parë zyrtar të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë në Moskë do të mbetet një nga ngjarjet më të shënuara historike të vendit tonë, në lidhje me marrëdhënjet tona miqësore me popujt e lavdishëm të Bashkimit Sovjetik. Një ngjarje të tillë, me kaq rëndësi historike e brohoriti me entuziazëm dhe përzemërsi populli ynë, pse ai e dëshironte dhe e priste me padurim një gjë të tillë, pse ai ushqen për Bashkimin Sovjetik dhe për udhëheqësin e tij të madh një dashuri të pakufishme dhe një mirënjojje të thellë. Është e natyrshme që populli ynë të ushqejë ndjenja të tillë kaq të larta për popujt miq të Bashkimit Sovjetik, pse pa këtë, pa luftën e tij heroike, pa përkrahjen e tij të madhe, nuk mund të përshkruhet fati i zi që mund t'i rezervohej popullit tonë të vogël.

Delegacioni i qeverisë sonë shkoi, pra, për vizitë miqësore në Moskë për t'u shprehur popujve të Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit të madh ndjenjat e miqësisë

së madhe, që ushqen populli ynë për ta dhe për ta forcuar sa më shumë këtë miqësi dhe marrëdhënjet në mes të popullit tonë të vogël dhe Bashkimit të madh Sovjetik, të bëhen sa më të shëndosha dhe konkrete.

Ne, përsaqësuesve të popullit shqiptar, na u rezervua pritja më e përzemërt dhe shumë miqësore prej kujtdo dhe kudo që shkuam në Bashkimin Sovjetik. Të gjithë na flitnin me simpatinë më të madhe për popullin tonë heroik, për luftën e tij të ashpër dhe të pareshtur kundër okupatorëve fashistë gjermanë dhe italianë, për ndërtimin e jetës së re dhe të ardhmes më të mirë për vendin tonë.

Ashtu sikundër Bashkimi Sovjetik ishte shembull për të gjithë popujt që luftonin fashizmin, ashtu ai qëndron sot shembull i një populli që me heroizmin më të madh mbron fitoret e luftës, ndërton atdheun e tij dhe mbron paqen dhe sigurimin botëror.

Ne pamë në Bashkimin Sovjetik gjëra të habitshme. Ne vizituam fabrika nga më të mëdhatë dhe më modernet në botë. Nuk mund të imagjinohet pa e parë me sy. se me ç'vullnet, se me ç'rregull dhe disiplinë punohet atje. Punëtoria sovjetike, që luftoi me heroizmin më të shquar për çlirimin e atdheut, sot qëndron në ballë të luftës së rindërtimit. Kudo me emrin e Stalinit në gojë po kalohet çdo normë, po thyhet çdo rekord, po tejkalohet plani pesëvjeçar. Realizimet e pushtetit sovjetik në çdo lëmë aktiviteti janë të mëdha; kudo që kaluam, kudo rindërtohej. Vizituam qendra artistike dhe kulturale. vizituam qendra arësimore, ku rriten dhe edukohen njerëzit e rinj sovjetikë. Atje ne pamë realizime që vetëm popujt e Bashkimit Sovjetik janë në gjendje t'i bëjnë. Vizituam fusha, ku janë zhvilluar betejat më të përgjak-

shme dhe ku janë treguar heroizma dhe therori të pashembullta nga ana e popujve sovjetikë. Moska heroike i tha ndal armikut në portat e saja, dhe atje filloi katastrofa e barbarëve gjermanë. Nëntëqind ditë qëndroi Leningradi heroik i rrethuar dhe i patundur. Tre kilometra larg qytetit ishte fronti. Qytetarët e Shqipërisë e kanë ndjerë thellë në zemër luftën heroike të popujve miq të Bashkimit Sovjetik. Sakrificat e popujve sovjetikë kanë qenë edhe të popullit tonë, por megjithatë, pa e parë me sy realitetin, nuk mund të imagjinohet dot si kanë luftuar popujt e Bashkimit Sovjetik, sa të papërshkrueshme kanë qenë sakrificat e tyre që i kanë bërë të gjitha me vetëmohimin më të madh.

Dhe atje, ku ishin fushat e vdekjes, ne tanë pamë toka të mbjella, ne pamë kopshte. Jeta atje ishte rilindur, ishte e gjuar, e lumtur si më parë. E pavdekshme do të jetë vepra e popujve dhe e regjimit sovjetik. E pavdekshme në shekuj do të ndrisë vepra madhështore e Stalinit të madh.

Populli shqiptar, që dhe ai derdhi gjakun në këtë luftë, me gjak është lidhur me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe do të qëndrojë besnik në këtë miqësi dhe dashuri që lidh të dy popujt.

Ne u pritëm prej Gjeneralisimit Stalin me përzemërsinë më të madhe dhe jo vetëm një herë. Kryetari i lavdishëm i popujve sovjetikë u interesua pa masë për popullin tonë, përpjekjet dhe luftën e tij ai e kishte ndjekur me kujdesin më të madh, sikundërqë ai e ka studjuar më së miri origjinën e popullit tonë. Gjeneralisimi Stalin me vëmendje u interesua për jetën e popullit tonë, për jetën e punëtorëve, të fshatarëve dhe të

intelektualëve të vendit tonë. Kujdesi i Gjeneralisimit Stalin që tregoi për Shqipërinë, fjalët aq të dashura që tha për popullin tonë të vogël, janë shprehja më e lartë e simpatisë që ushqejnë Gjeneralisimi Stalin dhe gjithë njerëzit sovjetikë për popullin shqiptar. Ne patëm bisedime për problemet e rëndësishme të vendit tonë, me Gjeneralisimin Stalin, me shokun Mollotov dhe me anëtarë të tjerë të qeverisë dhe të gjitha këto probleme u zgjidhën më së miri dhe nga ana e tyre u tregua gatishmëria më e madhe për ta ndihmuar popullin tonë. «Ne do ta ndihmojmë popullin tuaj — na tha shoku Stalin — pse shqiptarët janë njerëz të mirë». Kërkesat që bëmë ne na u pranuan menjëherë dhe qeveria sovjetike pranoi të na japë ndihmë për ngritjen e ekonomisë sonë dhe të jetës së popullit tonë. Qeveria sovjetike do të na ndihmojë me kredi duke na dhënë fabrika e traktorë, ajo do të na ndihmojë në lëmin kultural, arësimor e gjetkë.

Mirënjohja e popullit tonë është e pakufishme ndaj popujve të dashur miq të Bashkimit Sovjetik, ndaj Stalinit të madh.

Miqësia e ngushtë, që na lidh me popujt sovjetikë dhe që është një garanci për sigurimin e pavarësisë së vendit tonë, është e shenjtë për popullin tonë, prandaj populli shqiptar do të vëré të gjitha forcat dhe zemrën që kjo miqësi të bëhet dita-ditës më e fortë dhe më konkrete në të gjithë lëmët e aktivitetit të jetës së popullit shqiptar.

Popull shqiptar,

Më bie nderi i madh të të transmetoj përshtëndetjet që më dha shoku Stalin për ty:

«I thuaj të falat e mia të përzemërta popullit heroik shqiptar, të cilit i uroj suksese në jetë».

Lavdi dhe jetë të gjatë Stalinit të madh, mikut më të dashur dhe më të shtrenjtë të popullit tonë!

Rrofshin popujt e Bashkimit të madh Sovjetik!

Të rrojë sa malet miqësia e ngushtë që lidh popullin tonë të vogël me popujt e lavdishëm sovjetikë!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 803.*

27 korrik 1947

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 803.*

27 korrik 1947

**PËRMBLEDHJE E BISEDËS SË ZHVILLUAR ME NJË
GRUP GRASH FSHATARE TË DALLUARA, QË
MUAREN PJESE NË PUNIMET E PLENUMIT IV
TË BASHKIMIT TË GRAVE TË SHQIPËRISË**

15 gusht 1947

Më 15 gusht, në ora 18, shoku Enver Hoxha priti në pallatin e «Brigadave» një grup grash fshatare të dalluara, që muarën pjesë në Plenumin IV të Bashkimit të Grave të Shqipërisë. Pritja zgjati një orë e gjysmë. Gjatë kësaj kohe shoku Enver bisedoi dhe u interesua për jetën, nevojat dhe punën e gruas.

Shoku Enver pasi u interesua dhe i pyeti pjesëmarrëset e takimit mbi punimet e plenumit dhe përfundimet e tij, mbi vizitat që ato kishin bërë në hekurudhën e rinisë Durrës-Elbasan e në vende të tjera, u tha:

«Vendi ynë e fitoi lirinë për të rrojtur më mirë, që kalamanët tanë të rriten të gjuar dhe të lumtur. Tani ne do ta ndërtojmë Shqipërinë, si duam vetë. Në kohën e Zogut dhe të regjimeve të mëparshme, populli rronte i skllavëruar dhe në mjerimin më të madh. Por ai luftoi dhe u çlirua. Tani neve na presin punë të mëdha për ta ndërtuar vendin tonë. Gruaja duhet të punojë, pse shumë gjëra s'mund të bëhen pa atë».

Po, sigurisht, tha një grua, ne që dhamë djemtë tanë për luftën e çlirimit, sot do të japim edhe kontributin tonë për të ngritur ekonominë.

«Gruaja jonë në këtë luftë — vazhdoi shoku Enver — ka bërë punë të çuditshme. Është aktivizuar më shumë se gratë e disa vendeve, që e heqin veten të qytetëruara. Ajo ka luftuar që të punojë në çdo sektor pune në vendin tonë. Gruaja duhet të mësojë të shkruajë e të këndoja, të futet në punë kudo që të jetë, të zhdukë fanatizmin. Në këtë mënyrë ajo nuk do të jetë më një barrë në shtëpi. Gruaja të punojë njësoj si burri, sepse puna i zhduk të gjitha fanatizmat e mendimet e ndryshkura. Idetë e mendimet e ndryshkura i mbrojnë ata që s'ë duan të mirën e gruas. Ata që përhapin parulla, qofshin të veshur këta me rroba civile ose fetare dhe që thonë se «gruaja nuk duhet të dalë nga shtëpia, se nuk duhet të punojë» etj., pasi «është gjynah e prishet nderi» etj., janë armiqjtë e përparimit, të gruas dhe të atdheut tonë. Një grua e zonja, që i bën të gjitha punët, qoftë në arë, në shtëpi, përjashta e kudo që të jetë, është e aftë ta ruajë nderin e saj dhe të bëjë që të respektohet prej të tjera. Çështja është të luftojmë të metat që ekzistojnë në vendin tonë.

Disa njerëz, si në Jug, ashtu dhe në Veri, i pengojnë vajzat e tyre të shkojnë në hekurudhë. Ka ngjarë në disa raste që armiqjtë kanë vrarë edhe gra që donin të shkonin në hekurudhë. Disa njerëz kanë rrahu motrat ose vajzat e tyre, etj. Kundër këtyre duhet të luftojmë. S'duhen dëgjuar ata njerëz. Çfarëdo rrobesh që të kenë ata që luftojnë qëllimin tonë të drejtë për përparimin e gruas, me ta ne jemi në luftë, pse ata s'na duan.

Ne — tha pastaj midis të tjerave shoku Enver — u muarëm bejlerëve dhe agallarëve pallatet, ku më parë ata shkonin e veronin. Sot atje pushojnë me qindra nga fëmijët tanë. Tokën e atyreve ne ua dhamë fshatarëve. Këtë gjë e aprovon gjithë populli shqiptar. Po përse luftuam atëhere, sikur të mos kishim bërë këto? Tani është puna që t'i punojmë arat tonë, që fshatarët të prodrojnë më shumë për veten e tyre si dhe për të gjithë të tjerët. Kur fshatari ka bollëk edhe populli ka bollëk.

Çdo njeri ka detyra. Fshatari duhet ta punojë më mirë tokën. Qeveria do ta ndihmojë duke i dhënë farë, kredi dhe do t'i sjellë edhe traktorë. Që të gjitha këto janë për të mirën e fshatarit, prandaj edhe këta duhet t'i zbatojnë të gjitha ligjet dhe urdhëresat e qeverisë.

Në mbledhjen tuaj ju folët për detyrat që ka grua-ja sot. Këto duhet t'ua thoni edhe shoqeve, jo me fjalë të mëdha; çështja është që ato t'i kuptojnë këto detyra. Plani realizohet kudo që punohet: në arë duke e punuar tokën më mirë, duke u kujdesur më mirë për bagëtinë e për të gjitha çështjet e tjera të bujqësisë».

Pastaj gratë i treguan shokut Enver si kishin dalë me korrjet e vitit në fshatrat e tyre dhe si ja kishin shitur shtetit grurin që kishin prodhuar duke mbajtur vetëm bereqet për familjet e tyre.

«Këto — tha shoku Enver — janë vepra të mira. Qeveria e merr bereqetin për ato krahina që s'kanë bukë, për malësitë, etj., sepse qeveria mendon për të gjithë. I gjithë populli duhet të ketë racionin e bukës të caktuar. Qeveria e ka bërë hesap që asnje të mos mbetet pa bukë edhe ata që s'prodhojnë bereqet. Këto duhet t'i kuptojë fshatari, ai duhet të mendojë edhe për ata që

s'kanë. Mund të sillet drithë edhe nga jashtë, por kur ka këtu, pse të blejmë gjetkë, kurse nga jashtë mund të sjellim fabrika që neve na duhen shumë. Ndryshe s'përparon vendi».

Shumë gra fshatare, anëtare të kooperativave fshatare të punës, i folën shokut Enver për punën dhe jetën në kooperativë, për zhvillimin e tyre. Disa prej këtyre grave i bënë pyetje shokut Enver për disa çështje shumë interesante në lidhje me kooperativat fshatare, probleme këto konkrete dhe njëkohësisht parimore.

Shoku Enver nga ana e tij u bëri këtyre grave pyetje të ndryshme dhe pastaj trajtoi edhe disa çështje të bujqësisë e të kooperativave fshatare:

«Fshatarët e Shqipërisë sot kanë tokën e tyre, këtë ua dha pushteti popullor me anën e reformës agrare dhe askush s'mund t'ua prekë. Toka është e tyre për jetë. Këtë s'e lot as topi, si thotë populli ynë. Tani është çështja që tokën që mori, fshatari ta punojë sa më mirë. ta bëjë atë me të vërtetë një kopsht dhe nga kjo tokë të përfitojë shumë e çdo vit më shumë. Kjo është në interes të fshatarit në radhë të parë dhe njëkohësisht në interesin e gjithë popullit shqiptar. Por ta punosh tokën mirë, që ajo të të japë më shumë, duhen shumë përpjekje. Të mos lodhemi, por t'i udhëzojmë dhe t'i ndihmojmë konkretisht fshatarët, pse çështja s'është aq e lehtë. Në të kaluarën, dhe kjo e kaluar e hidhur dhe shekullore rëndon mbi supet e fshatarëve, fshatarët kishin arësyen dhe pengesa të mëdha që të mos ta punonin mirë tokën, së pari, toka s'ishte e tyre, por e beut dhe e agait. Fshatarët s'ishin kurrë të sigurtë për kasollën e tyre, bile as për jetën e tyre dhe të fëmijëve.

Beu dhe agai ishin të plotfuqishëm. Pjesa më e madhe e prodhimeve të tokës, që fshatari i siguronte me një-mijë mundime dhe me djersë, shkonte në hambarin e beut dhe të agait. Me pjesën tjetër që i mbetej, fshatari ishte i detyruar të paguante borxhet dhe taksat. Për ushqimin e tij dhe të fëmijëve s'ngelte gjë mbi shoshë. Fshatarët dhe fëmijët e tyre vuanin nga uria dhe nga sëmundjet. Ata ishin zhveshur e pa këmishë në trup. As që i prishej puna beut dhe agait për këtë gjë, përkundrazi ata kënaqeshin. Në këtë situatë, fshatarit s'i bënte zemra dhe as që i kishte mundësitë që ai të përmirësonte punën e tij, veglat e punës, të punonte më mirë tokën. Tani puna ka ndryshuar qind për qind. Tani fshatari ynë ka tokën e vet, ka qeverinë e vet që e ndihmon me të gjitha fuqitë, ka ushtrinë e vet që e mbron nga çdo rrezik, ka gjyqet e veta, ka policinë e vet. Në këto kondita kaq të favorshme, fshatari duhet të mendojë për të përmirësuar jetën e tij ekonomike, kulturoale dhe politike. Ai s'duhet të kënaqet me pak dhe të thotë: «Tani kam pesë hektarë tokë, do ta punoj si do ta punoj, do të prodhoj sa do të prodhoj, por të paktën familja ime do të ketë të hajë». Ai nuk duhet të mendojë kështu.

Familja e tij s'ka vetëm nevojë për misérnike, ajo ka nevojë për shumë gjëra. Fshatari duhet të ndërtojë dhe të zbulurojë shtëpinë e vet, ai duhet të shtojë mjetet e punës, t'i modernizojë këto, ai duhet të shtojë bagëtinë, të shtojë dhe të përmirësojë kafshët e punës. Në këtë mënyrë ai do të ushqehet më mirë, familja e tij do të vishet më mirë, fëmijët e tij do të venë në shkollë, ata do të edukohen, do të marrin kulturë dhe

shkencë, që do të ndihmojnë për t'i dhënë një hov më të madh përparimit të vendit në çdo pikëpamje. Nga ana tjetër është çështja që fshatari duhet të kuptojë se nuk jeton i vëtmuar, por ai është pjesëtar i shqërisë shqiptare, e cila po përparon me një ritëm të shpejtë. Të kuptojë detyrat që shtron çështja e aleancës së fshatarësise me punëtorinë dhe gjithë shtresat e tjera punonjëse, çështja e solidaritetit të të gjithë popullit punonjës. Për këtë gjë fshatari duhet të mendojë për aleatët e tij, ashtu sikundër mendojnë dhe shtresat e tjera të popullit tonë për fshatarin. Përmirësimi i jetesës të të gjitha masave tona punonjëse duhet të shkojë paralel dhe në një rrugë. Prandaj fshatari, duhet të mendojë ndryshe dhe të thotë: «Unë duhet të punoj sa më mirë tokën, të prodroj sa më shumë për familjen time dhe për gjithë popullin». Këtu s'është aspak çështja se ai do të punojë vetëm për të tjerët. Djersa e tij do t'i shpërblehet; prodhimet që ai do të shesë në kooperativat e shitblerjes do t'i sjellin fitime, të cilat do ta ndihmojnë të përmirësojë dita-ditës jetën e tij. Por në këtë mënyrë, fshatari i ka shërbyer çështjes së përgjithshme, i është përgjegjur veprës së solidaritetit. Ndërsa punëtori në qytete dhe gjithë shtresat punonjëse do të prodrojnë dhe ata më shumë vegla dhe sende përfshatarin. Nga një punë e tillë e harmonizuar, pasurohet i tërë vendi. Në këtë mënyrë do të shtohen fabrikat në vendin tonë, të cilat do të prodrojnë mallra të konsumit të gjerë dhe vegla bujqësore të mira dhe të lira, do të ndërmerrin punime bonifikimesh në shkallë të gjerë, do të shtohet numri i maqinave bujqësore, do të ngrihen shkolla, spitale, vende pushimi dhe gjithë

njerëzit e Shqipërisë do të rrojnë të gjëzuar, të lumtur. Kjo s'është aspak një ëndërr, drejt këtij realiteti po ecim, për këtë gjë po mobilizohen forcat e popullit tonë.

Që të kryhen këto punime, është e domosdoshme pra, pjesëmarrja sa më e gjerë e gruas në prodhim. Është më se e domosdoshme dhe urgjente që gruaja të marrë pjesë në bujqësi. Por prapë kjo nuk do të jetë e mjaftueshme në rast se në çdo punë nuk shkohet me plan. Në vendin tonë, ku mjetet e punës janë ende primitive, ku kafshët e punës janë të pamjaftueshme, lind nevoja e një pune kolektive, shoqërore në fshat. Fshatarët të ndihmojnë shoku-shokun, të punojnë së bashku arat duke marrë secili prodhimin e arës së tij. Këtu është çështje solidariteti me njëri-tjetrin, në mënyrë që tokat të punohen të gjitha mirë, të mos shkojë kot, as koha, as krahu i punës. Duhet të kemi parasysh se me përmirësimin e mjeteve të punës dhe shumëzimin e kafshëve të punës do të krijohen mundësítë që një pjesë e madhe e fshatarëve të vijnë në qytete të punojnë në fabrika dhe në ndërmarrje të ndryshme. Kjo gjë është në interesin e fshatarit dhe të gjithë vendit.

Çështja e kooperativave fshatare të punës, është një çështje me rëndësi, por edhe delikate. Pikësëpari në asnje mënyrë nuk duhet të detyrohen fshatarët, kundër vullnetit të tyre të hyjnë në kooperativë. Një punë e tillë jo vetëm që s'është e këshillueshme, por është edhe e dëmshme. Fshatar duhet të bindet dhe të hyjë me dëshirë në kooperativë. Ai fshatar, që nuk ka hyrë në kooperativë, por që e punon tokën mirë, që prodhon shumë, që nuk spekulon, që zbaton rregullat dhe ligjet në fuqi, që ndihmon qeverinë në zbatimin sa

më të mirë të urdhëresave, që është me gjithë shpirt me pushtetin, por megjithatë akoma s'i është mbushur mendja të hyjë në kooperativë, ky fshatar është aq patriot, aq i ndershëm sa dhe ai që bën pjesë në kooperativë. Por të jesh pjesëtar i kooperativës, do të thotë të jesh më i edukuar politikisht, të të jenë zhdukur në një shkallë të gjerë paragjykimet e vjetra, fanatizmat, të mos kesh të theksuar ndjenjën e pronës private, të kesh kuptuar dhe të kesh ndjerë thellë të mirën e punës së përbashkët dhe të fryteve të saj dhe të mos kesh qenë, as fshatar i pasur, as qehaja beu. Të krijosh kooperativën fshatare të punës dhe të marrësh pjesë në të, nuk do të thotë aspak se u shpronësove nga toka dhe mbete me gisht në gojë. Përkundrazi, toka mbetet kurdoherë jotja, por në vend që të kesh pesë hektarë, ti ke me qindra hektarë, në vend që të kesh dy qe, ti ke me qindra qe. Të gjitha këto janë të bashkuara, sikundërqë të gjithë pjesëtarët e kooperativës kanë bashkuar forcat e tyre në punë. Frytet në kooperativë ndahen sipas punës së gjithsecilit. Ai që punon më shumë, duhet të marrë më shumë, ajo familje që ka krahë pune më shumë dhe punon më shumë duhet të marrë më shumë nga ajo familje që ka krahë pune më pak dhe punon më pak. Me qenë në kooperativë, nuk do të thotë se duhet të bashkosh deri dhe pulat, sikundërqë u shpreh një shoqe fshatare këtu, pjesëtarë e kooperativës. Jo, çështja s'duhet kuptuar kështu. Pjesëtarë i kooperativës, ose më mirë të themi, një familje pjesëtarë e kooperativës, mund të ketë pulat e veta, mund dhe duhet të ketë një copë kopsht për veten e vet, ku mund të mbjellë zarzavate ose lule, sipas dëshirës, mund të

ketë dy ose tri kokë dele për veten e vet. Të gjitha të tjerat janë pronë kolektive. Fitimet e kooperativës, janë të të gjithëve dhe ndahen, si thashë më sipër, sipas punës së gjithsecilit, në bazë të rregullave të kooperativës, të vendosura prej pjesëtarëve të kooperativës vetë. Dëmet gjithashtu që mund të pësojë kooperativa u takojnë të gjithëve. Një shoqe këtu, tha se «unë kam dashur të hyj në kooperativë, por në fillim s'më pranonin, se nuk kisha qe, mezi më pranuan. Unë jam e varfër. Mirë, tash jam anëtare e kooperativës, por si-vjet doli lumi dhe mori një pjesë të arave të mia. Kooperativa më thotë se «ti do të marrësh më pak, pse arat e tua i mori lumi». Dhe kjo fshatare më pyet se a është i drejtë një veprim i tillë. Unë ju them që ta dëgjoni të gjitha, se një veprim i tillë nga ana e kooperativës jo vetëm që s'është i drejtë, por krejt i gabuar dhe i palejueshëm. Një gjë e tillë është në kundërshtim me kuptimin e kooperativës. Së pari në kooperativë hyjnë në radhë të parë fshatarët e varfër, pse ata janë në gjendje, më parë nga të gjithë, ta kuptojnë më mirë çështjen dhe rëndësinë e kooperativës dhe të punojnë më mirë për kooperativën. Së dyti, në qoftë se lumi mori një pjesë të arave, këto ara, janë të kooperativës dhe dëmi është për të gjithë kooperativën. Në qoftë se ngordhi kau i Hasanit, për shembull, i cili tanë është anëtar i kooperativës, dëmi i takon gjithë kooperativës dhe jo Hasanit. Hasani një ka që kishte e bashkoi, tanë ai s'është më i tij, Hasani tanë s'ka vetëm një ka, por ka me qindra qe, që janë qetë e kooperativës. Puna është që kooperativa të mos lërë që arat t'i marrë lumi, ose kau të ngordhë nga pakujdesia, por po u bë dëmi, ky është për

të gjithë, ashtu sikundër dhe të mirat janë për të gjithë. Po u kuptuan ndryshe, kooperativat dhe punët në koo-
perativë, atëhere kjo ka falimentuar. Çdo gjë në koo-
perativë duhet të shkojë në rregull. Kooperativën duhet ta
drejtojnë njerëzit më të zot, më besnikë, më të drejtë,
të zgjedhur nga vetë anëtarët e kooperativës. Puna e
drejtuesve të kontrollohet, këta t'i japin hesap koo-
perativës. Planet e kooperativës të diskutohen në mble-
dhje të përgjithshme, të kritikohen haptas gabimet, të
vihen në dukje dhe të çmohen sulmuesit, ata që punojnë
më mirë, ata që kujdesohen më mirë. Çështja e punës në
kooperativë dhe ndarja e të ardhurave janë dy nga gjë-
rat më të rëndësishme, ku duhet të vihet kujdesi më i
madh nga ata që drejtojnë kooperativën dhe nga gjithë
anëtarët e kooperativës, pse përndryshe do të lindin pa-
kënaqësi dhe padrejtësi që dëmtojnë rolin e kooperati-
vës dhe të ardhmen e saj. Kooperativa fshatare e punës
është forma më e përparuar në bujqësi. Ajo e bën fsha-
tarin të përmirësojë jetën e tij. Por, sikundërqë thashë,
ka mjaft pengesa që neve na duhet t'i luftojmë për t'i
zhdukur. Çështja nuk shtrohet tani për tani me krijue
kooperativa fshatare të punës, vetëm sa për të krijuar
kooperativa dhe këto të mos ecin mirë dhe të mos luaj-
në rolin e tyre. Ne, tani për tani të përpinqemi që këto
kooperativa fshatare të punës të bëhen model dhe shem-
bull për të gjithë fshatarësinë; fshatarët të shohin se
kooperativat punojnë më mirë, se prodhojnë më shumë,
se atjejeta bëhet më e gjëzuar dhe më e begatshme, se
me punën e saj kooperativa ka ngritur një shkollë më
të bukur, se kooperativa ka blerë radio, se fëmijët e
pjesëmarrësve të kooperativës janë më të shëndetshëm.

vishen më mirë, janë më të pastër, se shtëpitë e pjesëtarëve të kooperativës zbulurohen nga viti në vit, se kafshët e punës në kooperativë shtohen dhe mbahen më mirë etj., etj. Po të shohë këto gjëra fshatari ynë, ai e kupton vetë se ku është e mira dhe ai do të hyjë dhe do të punojë me bindje në kooperativë. Te fshatari atëhere nuk do të zënë më vend parullat e armikut, që thotë se «do t'ju marrin përsëri tokën po të hyni në koperativë». Atij do t'i forcohet ndjenja e kolektivitetit, e punës kolektive, do t'i zhduken paragjykimet e vjetra. Fanatizmi që e pengon akoma në rrugën e tij e shumë gjëra të tjera, mbeturina të së kaluarës së hidhur. Prandaj le të punojmë në këtë mënyrë, pse kjo është rruga më e sigurtë, është mënyra më e drejtë dhe më frytdhë-nëse. Në disa gjëra, si për shembull në ngritjen e kooperativave fshatare të punës, s'është çështja me u shpejtue, por është puna me ba gjëra të shëndosha dhe me baza, që fshatari ta kuptojë dhe të bindet se ku është e mira e tij».

Shoku Enver u interesua veçanërisht dhe bisedoi me përfaqësueset e grave të Veriut, mbi përparimet që kanë bërë ato në të gjitha drejtimet. Duke ju përgjigjur shokut Enver një grua nga Lura foli për kurset kundër analfabetizmit, për shkollat që janë çelur në krahinën e saj dhe për aktivitetin e madh që është duke u zhvilluar atje për përparimin e gruas. «Kemi shumë qejf shoku Komandant, tha ajo, të vini edhe te ne, të shihni se si punojmë dhe sa kemi përparuar».

«E ardhmja e Veriut — tha shoku Enver — është shumë e mirë. Atje do të hapen rrugë që kanë për t'i sjellë shumë të mira vendit tonë dhe krahinave tuaja.

Lura p.sh. është një vend shumë i bukur dhe me klimë shumë të mirë. Atje mund të punohet për t'u bërë një stacion klimaterik, ku të venë fëmijët dhe punonjësit tanë për t'u shlodhur.

Veriu ka qenë gjithnjë i shtypur, por qeveria do të kujdesohet që jeta atje të përmirësohet derisa të bëhet njësoj me atë të gjithë popullit të krahinave të tjera të Shqipërisë».

Duke biseduar me gratë për çështjen e forcimit të pushtetit shoku Enver tha: «Duhet ta forcojmë bashkimin e popullit, pse kështu forcohet pushteti. Gratë duhet të janë në këshilla, që janë pushteti i tyre, dhe atje të flasin për të gjitha problemet e vendit.

Duhet bërë propagandë me ata që akoma s'e kuptojnë veprën e madhe të popullit dhe t'ua shpjegojmë këtë vazhdimisht. Ka sigurisht pengesa — tha shoku Enver — por do të kalohen të gjitha».

Një grua nga Veriu, e cila kishte katër fëmijë, i tregoi shokut Enver se ajo linte fëmijët dhe shkonte në fshatrat e tjerë për të agjituar. «Më përpara, tha ajo, ne s'na dinte njeri se ku rrnim, kurse për ne tani interesohet shumë qeveria dhe ne kemi përparuar».

Përveç këtyre shoku Enver i pyeti ato se si shkoni me kurset e analfabetizmit, në se u vinin gazetat në fshat etj.

Gratë u ndanë nga shoku Enver shumë të gëzuara, duke i premtuar se do t'i kryejnë të gjitha detyrat që u janë ngarkuar.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 821,*

17 gusht 1947

*Botohet sipas tekstit të ga-
zettës «Bashkimi», Nr. 821,*

17 gusht 1947

PËRMBLEDHJE E BISEDËS SË ZHVILLUAR ME NJË GRUP TË RINJSH QË MUAREN PJESE NË PUNIMET E PLENUMIT VI TË RINISE POPULLORE TË SHQIPËRISË¹

20 gusht 1947

Më 20 gusht në pallatin e «Brigadave», shoku Enver Hoxha priti një grup të rinjsh, udhëheqës të organizatës së rinisë e të rinj të dalluar të ndërmarrjeve dhe të aksioneve të ndryshme, që muarën pjesë në punimet e Plenumit VI të Rinisë Popullore të Shqipërisë.

Shoku Enver në fillim u tha shokëve të rinisë se ishte në dijeni të punimeve të Plenumit VI si dhe të vendimeve që u muarën aty.

Shoku Enver u interesua, për punimet në hekurudhën Durrës-Elbasan:

«Më 7 nëntor do ta mbaroni hekurudhën deri në Peqin»? — pyeti shoku Enver.

¹ Në këtë bisedë muarën pjesë udhëheqës të Organizatës së Rinisë Popullore dhe udhëheqës të organizatave të rinisë në ndërmarrje dhe aksione të ndryshme.

«Po, e kemi të sigurtë», thanë ndërtonjësit e rinj të hekurudhës së rinisë.

«Rinisë — tha shoku Enver — nuk i mungon as vullneti, as entuziazmi për ta kryer këtë aksion. Në hekurudhë si në të gjitha punët e tjera duhet të keni sidomos kujdes për çështjen e edukimit dhe të specjalizimit.

Ju i keni shtruar në plenum dhe i keni kuptuar mirë problemet që u dalin përpara. Që punët të përparojnë në çdo sektor, duhet që ju të edukoheni e të mësoni. Të rintjtë në radhë të parë dhe të gjithë të tjerët atje ku punojnë, në shkolla, në fabrika, në bujqësi e gjetkë t'i vënë mendjen dhe kujdesin mësimit, punës dhe zanatit dhe t'i përvetësojnë këto. Çdo punë, që të kryhet mirë, lyp njerëz të mësuar që ta drejtojnë. Vullneti, entuziazmi, forcohen dhe mbahen gjallë dhe shtohen kur puna shkon mirë dhe përparon e puna shkon mirë, kur drejtohet nga njerëz të zot. Ju e dini se puna ngjall kurdoherë entuziazëm e sjell mirëqenjen dhe jetën e lumtur, prandaj ne nuk duhet të lëmë që entuziazmi të bjerë ose të shkojë shtrembër. Roli juaj në këtë drejtim është i madh, se kudo që do të jeni ju në ballë, atje do të ketë gjallëri, sukses, përparime. Të gjitha aksionet që po ndërmarrim, nuk duhet t'i kuptioni si të shkëputura nga njëri-tjetri, sepse të gjitha këto janë të lidhura dhe kanë për qëllim ngritjen ekonomike, sociale dhe kulturale të popullit tonë. Për këtë arësyen duhet të marrë pjesë i gjithë populli në to, ku vullnetarisht, ku me pagesë, pse frytet dhe të mirat do të jenë të përbashkëta. Ka disa njerëz, nuk flas për rininë, që i shikojnë ca ngushtë punët, sidomos çështjen e punës vullnetare, jo pse nuk

duan të punojnë vullnetarisht, por sepse kanë akoma mendime të prapambetura dhe të ndryshkura, u vjen zor të lënë të shkojnë e të punojnë të rejat dhe gratë në hekurudhë e në punë të tjera. Këtu qëndron çështja e një pune bindëse në shkallë të madhe nga ana e të gjithëve. Pa pjesëmarrjen e gjerë të gruas në prodhim dhe pra, pa zhdukjen e paragjykimeve të vjetra e të ndryshkura që ekzistojnë akoma në shumë njerëz, qofshin këta burra ose gra, ne nuk do të mundim dot t'i kryejmë si duhet të gjitha këto punime. Duhet patjetër që gruaja të marrë pjesë të gjerë në punë, për të mirën e saj në radhë të parë, si dhe për të mirën e përgjithshme. Ju të rinxjtë dhe të rejat duhet të ndihmoni shumë në këtë drejtim. Në hekurudhën Durrës-Elbasan vullnetarët e rinisë e të gruas punojnë me vrull të madh dhe kanë rezultate. Ju nuk duhet të shihni vetëm arritjen e qëllimit në punën që kryeni, por duhet të shikoni që puna të kryhet mirë dhe të fitoni eksperiencë, pse ne nuk do të qëndrojmë vetëm me një vijë hekurudhore, as me një rrugë automobili ose central elektriku. Ne do të ndërtojmë hekurudha të tjera, centrale të tjera e fabrika të tjera. Prandaj të rinxjtë, që punojnë atje dhe kudo gjetkë, duhet gati të gjithë të specializohen. Mësimetë në kurse, në shkolla, duhet t'u vini kujdesin më të madh se ju jeni kuadrot e ardhshëm, të zot e të mësuar, që do t'i drejtoni të gjitha punimet.

Rezultatet e punës suaj kanë qenë të mëdha. Zottësia dhe gjallëria juaj ka bërë që vendi ynë të shkojë përpara, që jeta të përmirësohet. Nuk mund të pretenojmë që brenda 2-3 vjetve të kemi të gjitha ç'na dëshiron zemra. Por duke marrë parasysh të kaluarën,

konditat ku ndodhemi dhe gjendjen e vështirë materiale, ne kemi ecur shumë përpara. Dhe kjo, në një pjesë të madhe, i dedikohet kontributit të rinisë sonë. Këto probleme i keni shtruar mirë në vendimet e plenumit tuaj. Çështja është që këto të kuptohen mirë nga gjithë shokët e rinisë, sepse kur kuptohen mirë, zbatohen mirë. Kështu do të vihet në lëvizje e gjithë masa e rinisë. Pas rinisë do të shkojnë të gjithë. Po të ulet entuziazmi në rini, ulet dhe në gjithë popullin. Rinia janë është e zonja të ecë gjithmonë përpara. Ja ku janë shokët e brigadës «Qemal Stafa», që u shpallën katër herë sulmues dhe na nderuan. Por dhe këtu brigadat e tjera s'mbeten pas. Dy herë sulmues dualën edhe shokët e brigadës «Alqi Kondi». Të rintjtë e specializuar të këtyre brigadave, duhet të jenë udhëheqës në punë, të mësojnë dhe të tjerët, pse vendi ynë ka nevojë për sa më shumë specialistë. Nga puna juaj do të dalin teknikë e specialistë. Këta do të mësojnë të tjerët dhe kështu do të plotësohen nevojat tona. Ju thoni se për në hekurudhë duhen 50 marangozë, po ku t'i gjesh? Ata që kemi janë angazhuar në të gjithë sektorët e tjerë të nevojshëm. Por ne nuk na mjaftojnë as 50 dhe as 100 marangozë. Ne kemi nevojë për shumë specialistë të tillë dhe duhet të shkojmë me kriterin që të preqatitim specialistë dhe teknikë dhe këta nuk preqatiten në një ditë, por kujdesi ynë i vëçantë, do të bëjë që ne t'i kemi më shpejt këta. Në fillim penxheret e dyert nuk do të jenë aq të bucura, do të na prishen edhe disa maqina, do të na harxhohet dhe ca naftë më tepër për traktorët ose për maqinat e tjera, por ne do të kemi preqatitur kuadro të zot të specializuar».

Shoku Enver pyeti pastaj një të ri nga aksioni i Pendës së Stajkës (Shkodër) për punimet e atjeshme. Ai i tregoi shokut Enver sukseset në punë, pengesat teknike dhe mungesat materiale, i tregoi gjithashtu vendosmërinë e popullit për të kapërcyer të gjitha pengesat.

«Është e vërtetë se ka mungesë materiali — shtoi shoku Enver. Ky është problem jo vetëm për ne, por edhe për miqtë tanë që na ndihmojnë. Prandaj këtë material që kemi dhe ai që na vjen, ta shfrytëzojmë në maksimum e ta ruajmë me kujdesin më të madh që të mos na prishet. T'i duam e t'i ruajmë veglat e materialin, ashtu si donim e ruanim pushkën në mal, ashtu si fshinim pushkët, me të cilat ne fituam lirinë, ashtu të ruajmë materialin, të fshijmë e të pastrojmë veglat e maqinat, me të cilat ne po ndërtojmë atdheun.

Ju folët për specialistët dhe për disa nga këta që u kanë penguar në punë. Ne duhet të përpinqemi që t'u japim mundësi specialistëve që të punojnë drejt, ju duhet të bëni përpjekje, të mësoni teknikën e të zotëroni mirë maqinën, por dhe sytë duhet t'i hapni, t'i bëni katër dhe të mos lini në asnjë mënyrë, që disa njerëz të ligj dhe armiq të na dëmtojnë në punën tonë».

Pastaj shoku Enver u foli të rinjve për detyrat e mëdha që i paraqiten rinisë në fshat: «E gjithë rinia, me në krye drejtuesit e saj, duhet t'i vëjë kujdesin më të madh punës në fshat, pse fshati për ne është një nga problemet më kryesore. Në punimet tuaja të plenumit ju patë sa rëndësi i vihet kësaj çështjeje nga plani i shtetit. Në këtë punë ka dhe vështirësi. Ju jeni të rinj, por të pjekur, i kuptioni vështirësitë dhe i kaloni. Fsha-

tarësia duhet mësuar dhe edukuar, se atje ka akoma fanatizëm dhe gjykime të mykura, të cilat s'e lënë fshatin të shkojë përpara. Fshati është prapa nga ana e kulturës, e arësimit dhe më tepër se 80% e popullsisë sonë janë fshatarë. Prandaj mendoni sa e madhe dhe sa e madhnueshme do të jetë vepra juaj për ngritjen e fshatarësisë. Rinia në fshat duhet të jetë në pararojë. Fshati duhet të shkojë përpara. Fshatarët do të ngrajnë bujqësinë, shumë fshatarë do të punojnë në fabrika e në punëtoritë, fshatarët do të mbushin shkollat. Prandaj e gjithë kjo punë lyp përpjekje, zgjuarësi, durim. Vençanërisht duhet të kemi kujdes me rininë e fshatit dhe rinia punëtore, që është më e zhvilluar dhe më e përparuar, le të bëhet motori dhe mbështetja e kësaj pune. Përparimi i Shqipërisë është i lidhur ngushtë me përparimin e fshatarësisë».

Pastaj shoku Enver vazhdoi: «Kur isha në Moskë, Stalini i madh, miku më i dashur dhe i shtrenjtë i popullit tonë më tha: «Shqipëria duhet të ecë me këmbët e veta, pse i ka të gjitha konditat dhe ne do ta ndihmojmë popullin shqiptar». Ne do të ecim përpara, kjo është përgjegjja që i dhashë mikut më të madh të popullit tonë. Sa dashuri e sa simpati ka Bashkimi Sovjetik dhe udhëheqësi i tij për popullin tonë, kjo duket qartë. Për miqësinë dhe dashurinë kundrejt Bashkimit Sovjetik rrabin të gjitha zemrat e popullit tonë, për Stalinin dhe për Ushtrinë e Kuqe buçitrin zemrat e të rinjve në male, kur luftonim; edhe sot në të gjitha anët e Shqipërisë, ku punohet për të ndërtuar jetën e re, përsëri me emrin e Stalinit sulmojnë të rinxjtë në tunelet e Rrogozhinës e çajnë malin, kurse fshatarët presin fo-

tografitë e Stalinit nga gazetat dhe i vënë në kasollet e tyre. I madh dhë i vogël në Shqipëri e njeh atë, e do dhe e ka në zemër. Një popull si yni, që ka vuajtur shkuj me radhë, nuk mund të mendojë e të ndjejë ndryshe për Bashkimin Sovjetik e për Stalinin. Ju keni vendosur të mbaroni aksionin e hekurudhës më 7 Nëntor, ditën e Revolucionit të madh socialist, dita kur u realizuan shpresat e popujve të shtypur, dita që lëshoi rrezet mbi gjithë njerëzimin. Ta forcojmë dashurinë për Bashkimin Sovjetik dhe për Stalinin e madh. Populli ynë dhe rinia duhet të kuptojë se BS është fuqia më e madhe dhe e pathyeshme, është kështjella e çelniktë që mbron paqen e njerëzimin. Të gjitha frikësimet dhe shantazhet e imperialistëve e të fashistëve, janë të destinuara të falimentojnë. T'ja bëjmë të qartë popullit këtë fakt të padiskutueshëm.

Ju keni parë si përpiqen të na dëmtojnë armiqjtë, por të gjitha manevrat e tyre po u dështojnë, sepse populli ynë është vigjilent e i fortë dhe pse ai ka miq të fortë dhe të sinqertë. Asgjë s'e ndalon popullin tonë të shkojë në rrugën që ai ka caktuar dhe ferrat, që i dallin përpara, ai i qëron pa mëshirë.

Në të gjithë këtë punë ju duhet të qëndroni në ballë. Si në luftë, ashtu dhe sot, pa ju nuk mund të ecet përpara. Detyra jonë është të punojmë me të gjitha fuqitë për popullin e atdheun, për rindërtimin e vendit dhe të jetës sonë, të ruajmë me xhelozinë më të madhe fitoret e luftës sonë, të vigjilojmë kufitë tanë, të ruajmë dhe të forcojmë miqësinë me Bashkimin Sovjetik, të vëmë forcat tona për ruajtjen e paqes. Unë ju uroj sukces në punë. Përpiquni që vendimet e plenumit t'u

zbatoni. Rinia popullore të bëhet më e fortë se kurrë, se kështu vendi ynë do të ecë përpara. Partia, qeveria dhe unë kemi besim se ju do t'i kryeni me nder detyrat tuaja».

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 825,
22 gusht 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 825,
22 gusht 1947*

SHQIPËRIA DHE VOTIMI NË KËSHILLIN E SIGURIMIT TË OKB-së¹

21 gusht 1947

Kërkesa e drejtë e Shqipërisë për t'u bërë anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara s'u pranua. Bashkimi Sovjetik, miku i singertë dhe i madh i popullit shqiptar e mbrojti me mish e me shpirt kandidaturën e Shqipërisë dhe votoi për pjesëmarrjen e vendit tonë në Kombet e Bashkuara, si një anëtare e denjë, që ka luftuar dhe lufton për principet e drejta të njerëzimit përparimtar. Polonia, mikja e popullit tonë, votoi, natyrisht, dhe ajo pro kandidaturës sonë. Shqipërisë ju shtua dhe një mike dashamirëse tjetër, Siria.

Nga ana tjetër e barrikadës, si kurdoherë gjendeshin Amerika e Anglia, konsekmente në politikën e tyre armiqësore kundër popullit tonë dhe klientët e tyre të përhershëm dhe duaxhinxjt e dollarit, Belgjika dhe Australia. Franca abstenoi, por kjo për popullin shqiptar do të thotë votim kundër.

Një përfundim i tillë votimi në Këshillin e Sigurimit përsa i përket kandidaturës së vendit tonë, nuk është

¹ Artikull i botuar në gazeten «Bashkimi».

për popullin tonë një gjë e papritur. Ai njoju më mirë miqtë dhe aleatët që i duan të mirën dhe e mbrojnë dhe, nga ana tjetër, pa qartas qëllimet e imperializmit amerikan dhe anglez dhe politikën e tyre skllavëruçese dhe antidemokratike ndaj vendit tonë dhe ndaj gjithë popujve përparimtarë të botës.

Që Shqipëria i ka të gjitha kushtet për të qenë anëtare e Kombeve të Bashkuara, bile edhe më tepër se shumë pjesëtare të kësaj organizate, kjo s'ka asnje diskutim. Këtë të vërtetë e diskutojnë vetëm amerikanët, anglezët, francezët dhe të gjitha ato qeveri që janë krijet e politikës imperialiste anglo-amerikane. Këto shtete e diskutojnë këtë të vërtetë, pse politika e qeverive të tyre është kundër demokracisë së vërtetë, kundër sigurimit botëror dhe një paqeje të drejtë, është kundër lirive të popujve. Paqja dhe sigurimi botëror është në kundërshtim me politikën e tyre skllavëruçese dhe grabitqare. Prandaj për anglo-amerikanët dhe pasuesit e tyre, Shqipëria demokratike dhe Mongolia demokratike në asnje mënyrë nuk pranohen prej tyre të bëjnë pjesë në gjirin e OKB-së. Ndërsa hyrja e Italisë, e Portugalisë dhe më vonë sigurisht e Gjermanisë dhe e Spanjës frankiste, do të pritet me krahë hapët prej tyre, bile do të kërkohet me këmbëngulje, pse realizimi i planeve të tyre të errëta, nuk mund të bëhet si duhet pa akolitë të këtij kalibri. Imperializmi anglo-amerikan përpinqet të izolojë demokracitë e vërteta dhe të shtypë ata popuj që tani kanë në krye qeveri reaksionare dhe fashiste për të preqatitur kësisoj terrenin për një përlleshje të tretë botërore dhe për të hedhur edhe njëherë njerëzimin në një kasaphanë të përgjakshme. Ky është ligji i

tyre. Këtë gjë synon politika e tyre e shumanshme qoftë ajo e ndjekur në OKB, qoftë ajo kundrejt çdo shteti të pavarur ose kolonial.

Politika e anglo-amerikanëve ndaj popullit shqiptar, ka ndjekur këtë rrugë. Asnjëherë qëllimet e politikanëve të këtyre vendeve nuk kanë qenë në favorin e demokracisë dhe të pavarësisë së vendit tonë. Ata janë përpjekur në çdo moment dhe me çdo mjet ta shtypnin popullin tonë, të shtypnin ose ta kthenin në favorin e tyre luftën e popullit shqiptar. Kur ata e panë se ishte e pamundur të mposhtej vullneti i popullit tonë dhe të shtrembëroheshin qëllimet e shenja të tij, anglo-amerikanët dhe agjentët e tyre u përpoqën të grumbullonin fashistët shqiptarë brenda e jashtë vendit në një kryqëzatë kundër pavarësisë dhe vetëqeverimit të popullit tonë. Ata organizuan dhe drejtuau sabotazhet, organizuan banditët që ekzistonin nëpër male, të falimentuarit dhe armiqtë e popullit. Ata i ndihmuau këta me të gjitha mjetet që kishin, por të gjitha planet ju dështuan dhe u demaskuan. Ata u përpoqën të krijonin incidente me karakter ndërkombëtar, për të dëmtuar popullin tonë si dhe për të gjetur pretekste dhe për të vështirësuar përpjekjet e miqve të demokracisë dhe të popujve përparimtarë, që përpiken të ndërtojnë paqen e vërtetë. Ata ndihmuau dhe ndihmojnë pretendimet absurde të fashistëve grekë, për copëlimin e vendit tonë dhe kur e panë se një gjë e tillë s'mund të realizohej, ata u përpoqën me të gjitha mjetet ta bëjnë popullin tonë të vogël dhe paqedashës, përgjegjës për luftën civile në Greqi, vepër gjakatare e tyre dhe e shërbëtorëve të tyre monarko-fashistëve grekë. Imperializmi anglo-amerikan,

atje ku s'mund të gjejë fushë veprimi, pse populli është në fuqi, përpinqet me njëmijë mënyra të krijojë situata të vështira dhe të ndeme, t'i ashpërsojë marrëdhënjet me këta popuj, të krijojë incidente, provokacione, të shpifë, të mashtrojë opinionin botëror dhe të maskojë kësisoj veprimtarinë e tij të paligjshme dhe antidemokratike. Por atje ku ai ka hedhur thonjtë, puna shkon ndryshe. Populli po shtypet e gjakoset, krimet, torturat, djegjet janë në rendin e ditës. Atje çdo gjë është vënë në shërbimin e fashistëve për të shtypur popujt, liritë, aspiratat. Dhe populli atje ka ngritur krye dhe lufton kundër rrebeshit që kërcënon jetën e tij. Kjo ngjet në Greqi. Arësyet e luftës civile në Greqi nuk duhet të kërkohen në fqinjët e saj paqesorë dhe demokratikë, por në ndërhyrjen anglo-amerikane në punët e brendshme të Greqisë, në metodat e tyre skllavëruese, në ndihmën me armë dhe me material që ata u japid monarko-fashistëve për të shtypur popullin heroik grek dhe për ta bërë Greqinë një bazë të imperializmit dhe të fashizmit për të kërcënuar paqen në Ballkan dhe në Evropë. Anglo-amerikanët përpiken të krijojnë me çdo kusht vatra agresioni kundër popujve edhe paqes; Greqinë ata kërkojnë ta bëjnë një prej këtyre vatrave.

Po një gjë e tillë ngjet në Indonezi dhe në të gjitha kolonitë e imperializmit anglo-franko-amerikan, ku popujt luftojnë për të drejtat dhe për lirinë e tyre. Ç'po ngjet në Itali, prapë është e qartë. Imperializmi amerikan i ka hedhur thonjtë në grykë popullit italian dhe me anën e shërbëtorëve të tij, ai përpinqet ta shtypë popullin italian, të sjellë në fuqi dhe në liri të plotë veprimi njerëzit e Musolini, fashistët me damkë, përgje-

gjës të kasaphanës së dytë botërore. Ai përpinqet që Italia të bëhet përsëri një vatër agresioni dhe zjarri. Frankua dhe klika e tij vazhdojnë të sundojnë dhe të forcohen në kurrizin e popullit spanjoll dhe tok me Portugalinë e Salazarit, të qëndrojnë fole të nazizmit dhe të fashizmit për kërcënimin e paqes botërore. Plani Marshall synon skllavërimin e atyre popujve, qeveritë e të cilëve, të shitura te dollari amerikan, bëjnë të gjitha përpjekjet, për të forcuar pozitat e reaksionit dhe të fashizmit në dëm të interesave të popujve të tyre dhe në favorin e imperializmit amerikan. Reaksiuni anglo-amerikan përpinqet që me çdo kusht të ringjallë Gjermaninë naziste, ta armatosë këtë dhe ta ketë përsëri si një qen roje dhe armë për kërcënimin edhe një herë të jetës dhe të së ardhmes së popujve përparimtarë.

E gjithë kjo politikë e imperializmit anglo-amerikan dhe qëllimet e kësaj politike manifestohen në çdo hap nga përfaqësuesit amerikanë, anglezë dhe satelitët e tyre në OKB. Ata përpinqen që OKB-ja të bëhet një SDN¹, e dytë, një vegël dhe mjet për qëllimet e tyre imperialiste dhe grabitqare. Ata kërkojnë që OKB-ja të mbulojë dhe të aprovojë metodat dhe veprimet e tyre antideemonkratike dhe agresive. Ata përpinqen të përsërisin historinë e vjetër dhe tragjike të Versajës² dhe të SDN-së.

¹ SDN (Société des Nations) — «Lidhja e Kombeve».

² Është fjalë për vendimet që mori Konferenca e Paqes në Paris (Pallati i Versajës) në vitin 1919, që kishin për qëllim të siguronin rindarjen e botës midis fuqive imperialiste duke pasur si bazë raportin e ri të forcave të krijuara pas Luftës së parë botërore 1914—1918.

Në këtë Konferencë u krijua edhe «Lidhja e Kombeve»,

Çështja e çarmatimit, çështja e ndalimit të bombës atomike, ndalimi i agresionit, zhdukja nga rrënjet e fashizmit, mbrojtja e lirive demokratike dhe e vetëqverisjes së popujve, probleme këto të dorës së parë, të ngritura dhe të mbrojtura prej Bashkimit Sovjetik, po sillen e matasillen, po komplikohen, po luftohen haptas nga anglezët dhe amerikanët me të vetmin qëllim, që këto probleme kaq të rëndësishme për botën, të mos të zgjidhen kurrë. Patjetër anglo-amerikanët për t'ja mbërritur këtij qëllimi, përpiken të kenë sa më tepër klientë të votës në OKB dhe sa më pak pjesëtarë mbrojtës të vërtetë dhe luftëtarë të paepur kundër fashizmit dhe agresionit. Këtu ishte qëllimi i votës kundër kandidaturës së Shqipërisë dhe të Mongolisë, vende ku çshtë vendosur demokracia e vërtetë e popullit, vende dhe popuj që luftojnë me mish e me shpirt për lirinë e tyre, për mirëqenjen e tyre dhe për paqen e vërtetë në botë.

Por e gjithë kjo politikë kërcënimi, frikësimi dhe shantazhi nga ana e imperialistëve amerikanë dhe anglezë, është e destinuar të falimentojë, pse në ballë të përpjekjeve për mbrojtjen e paqes së drejtë, për mbrojtjen e njerëzimit përparimtar, për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të popujve qëndron i fuqishëm dhe i pathyeshëm Bashkimi i madh Sovjetik. Pse gjithë popujt përparimtarë të botës, qofshin ata të lirë dhe të pavarur, sikundërqë është vendi ynë, qofshin ata që sot kanë në krye qeverira antipopullore, qofshin popujt që vuajnë nën sundimin e politikës koloniale, janë të gjithë

organizatë ndërkombëtare që u bë vegël e fuqive imperialiste dhe kryesisht e Anglisë dhe e Francës.

të bashkuar dhe të vendosur për të mbrojtur paqen dhe demokracinë, për të fituar lirinë, për të mbrojtur liritë e fituara me gjak dhe pavarësinë e tyre. Të gjitha përpjekjet e këtyre popujve janë të bashkuara për të përkrahur me të gjitha forcat e tyre politikën e drejtë dhe vendimtare të Bashkimit të madh Sovjetik, që mbron kauzën e drejtë të njerëzimit. Dhe kauza e drejtë e njerëzimit do të fitojë, garanci është Bashkimi Sovjetik dhe përpjekjet e gjithë popujve përparimtarë të botës. Populli ynë, përshëndet edhe një herë me gjithë zemër mikun e madh Bashkimin Sovjetik, miqtë që mbrojtën kauzën e tij të drejtë dhe i siguron se ai kurrë nuk e humbet shpresën dhe do të luftojë për drejtësinë iminente që do të triumfojë kundër atyre që kërkojnë ta shtypin.

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 824,
21 gusht 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 824,
21 gusht 1947*

FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË FIERIT DHE TË MYZEQESE

29 shtator 1947

Fshatarë të Myzeqesë dhe qytetarë të Fierit,

Jam shumë i lumtur sot që ndodhem në mes jush dhe ju sjell përvendosjet më të nxehta të qeverisë sonë dhe të miat.

Ndryshime të mëdha janë bërë në vendin tonë pas fitores së shkëlqyer të Luftës nac.-çl. mbi okupatorët fashistë e tradhëtarët e vendit. Me vendosjen e pushtetit popullor vendi ynë filloi një etapë të re, në të cilën ai po ndërton me punën e tij një jetë më të mirë e më të lumtur. Ky është rezultati i revolucionit të madh shoqëror që u bë në vendin tonë me Luftën nacional-çlirimtare dhe realizimet e mëdha që bëhen sot nuk janë veçse konkretizimi i dëshirave shekullore të popullit tonë. Për këtë luftuan masat e popullit tonë, punëtorët, fshatarët, rinia jonë heroike dhe gratë; për këtë ata u hodhën me vetëmohim të pasembullt në zjarrin e Luftës nacional-çlirimtare dhe pas përpjekjesh të përgjakshme jo vetëm çliruan vendin, por bashkë me okupatorët fashistë italianë e gjermanë goditën për vdekje

edhe armiqtë e popullit, bejlerët, agallarët, çifligarët dhe gjithë klasën e privilegjuar të vendit tonë që i shërbue me mish e me shpirt okupatorëve fashistë kundër interesave të popullit.

Në këtë luftë vigane të popullit tonë u shemb nga themellet shoqëria e vjetër e privilegjeve dhe e padrejtësisë dhe me forcën e vullnetin e tij populli ngriti pushtetin e ri, pushtetin e popullit.

Vetëm në saje të kësaj lufte të madhe të popullit tonë, vetëm në saje të bashkimit të tij në Frontin Nacional-Çlirimtar, të vetëmohimit e të sakrificave të mëdha të masave, në saje të udhëheqjes së drejtë, të sigurtë dhe largpamëse të Partisë sonë Komuniste, qe e mundur fitorja e shkëlqyer mbi okupatorët fashistë e armiqtë e brendshëm, qe e mundur vendosja e pushtetit popullor dhe çelja e rrugës për reforma të mëdha në çdo fushë, në interes të masave punonjëse të popullit tonë.

Për të gjitha këto u deshën sakrifica të mëdha, shpeshherë të pashembullta në historinë tonë, por populli ynë, i sigurt në udhëheqjen e tij të shëndoshë, me besim në drejtësinë e luftës së tij, të forcave të tija, me besim të patundur në fitoren e Bashkimit Sovjetik, të udhëhequr nga Stalini i madh dhe në luftën e përbashkët kundër të njëjtit armik, populli ynë u hodh pa rezerva dhe fitoi.

Në këtë luftë të madhe, ju shokë fshatarë të Myzeqesë, keni dhënë kontributin tuaj të madh me gjakun e bijve tuaj, me ndihmat tuaja, me sakrificat tuaja dhe, ashtu si i gjithë populli shqiptar, ju situat të drejtat, për të cilat luftuat, të drejtat që u ishin mohuar me forcë nga klikat parazite të bejlerëve çifligarë.

Vetëm në saje të përpjekjeve tuaja, në saje të pushtetit popullor ju fituat të drejtën për të gjëzuar tokën që të shtypur, të robëruar, të raskapitur nën thundrën e bejlerëve feudalë si Vrionasit, Resulët, etj. gjysh pas gjyshi e kishit punuar për të tjerë. Prandaj, vetëm sot ju punoni të lirë tokën tuaj, që në saje të kujdesit të pushtetit popullor, muarët nga reforma agrare, duke u dhënë fund kështu vuajtjeve.

Ju e dini se vetëm në pushtetin popullor qe e mundur të realizohet dhe të realizohet në mënyrë rrënjosore reforma agrare. Ju e dini sa rëndësi ka kjo për jetën tuaj e për popullin tonë. Toka tani është e juaja përgjithmonë. Ju e dini gjithashtu sa janë përpjekur ta pengojnë, ta sabotojnë zbatimin e kësaj reforme armiqtë e pushtetit dhe të popullit, që donin të kthenin kohën e vjetër. Por në saje të vigjilencës të pushtetit popullor, në saje të vullnetit, të bashkëpunimit të masave të popullit me pushtetin e vet, tentativat e tyre qenë destinar të falimentonin dhe reforma agrare u krye me sukses të plotë.

Po kështu në saje të politikës së drejtë të qeverisë, reforma të tjera të mëdha ekonomike e shoqërore janë realizuar në vendin tonë. Çdo ditë me këto masa të rëndësishme populli ynë po ecën përpara, po konsolidon dhe po zgjeron fitoret e Luftës nac.-çl., po krijon kondita të një jete më të mirë, po ngre me mund dhe me djersë Shqipërinë e re, jetën e tij të lumtur.

Me reformën agrare, me shtetëzimet e fabrikave e të minierave, me ligjet e mëdha përparimtare dhe shoqërore, me ndërmarrjet e mëdha që po bëhen në vendin tonë, me punën e palodhur dhe me hovin e ma-

save punonjëse të vendit tonë, të punëtorëve, të fshatarëve tanë e të rinisë, me pjesëmarrjen e gruas në prodhim, me një punë vigane të të gjithë popullit tonë dhe me ndihmën e madhe të Bashkimit Sovjetik vendi ynë ka hyrë në një fazë të re, në fazën e ndërtimit të shqërisë së re, të jetës së re e të lumtur.

Anembanë Shqipërisë populli ynë po punon me vetëmohim dhe entuziazëm, ashtu si luftoi dje kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve. Ai është i bindur në rrugën e tij dhe ka besim të patundur në qeverinë e tij, në forcat e tija krijuar, në miqtë e tij të singertë dhe dita-ditës po realizon planet që i vë përpara qeveria e tij.

Nën udhëheqjen e Partisë dhe i bashkuar në Frontin Demokratik, populli ynë po realizon aspiratat e tija shekullore dhe asnjë tentativë e armiqve nuk do ta largojë dot nga kjo rrugë.

Punët për rindërtimin dhe veprat e mëdha të ndërtimit të vendit tonë, rrugët e reja, urat, kanalet, shkollat, spitalet, ngritja e fshatrave të djegura, bonifikimet e mëdha, fabrikat, centralet, etj. që po ndërtohen në vandin tonë pas çlirimit, janë vepra, që vetëm një popull i bashkuar dhe një pushtet rrënjosish demokratik, mund t'i bëjë. Kjo dëshmon edhe njëherë më shumë vendosmërinë e popullit tonë, vullnetin e patundur të tij për të krijuar një jetë të lumtur, nën udhëheqjen e drejtë dhe besnikë të qeverisë së popullit.

Popull i Fierit dhe i Myzeqesë,

Ju sot jeni zot të tokës suaj që jua dha reforma agrare. Kjo është një nga fitoret më të mëdha të popu-

llit tonë, por kjo fitore duhet të forcohet e të zgjerohet sa më shumë, që ju vetë dhe i tërë populli ynë të mund të korrë frytet e saj.

Ju e dini mirë sa pasuri e vlefshme dhe e paçmueshme është për ju toka që punoni, por njëkohësisht ajo është një pasuri e madhe për tërë popullin shqiptar, për tërë vendin tonë, prandaj ju do të dini ta shfrytëzoni këtë pasuri të madhe, të përfitonit prej saj sa më tepër, duke prodhuar sa më shumë dhe duke u kujdesur me tërë forcat tuaja për të nxjerrë produkte sa më të mira.

Është e qartë se për këtë duhet një punë e madhe, një punë e palodhur, duhet djersë e mund, pse vetëm kështu do t'ja arrijmë qëllimit tonë për të krijuar një jetë më të mirë.

Të rritësh dhe të përmirësosh prodhimin, do të thotë të përmirësosh ekonominë tënde, gjendjen tënde, po njëkohësisht edhe të ndihmosh e të furnizosh me prodhime bujqësore mbarë popullin shqiptar.

Prandaj detyra juaj është që të punoni sa më tepër e sa më mirë tokat tuaja, të përmirësoni cilësinë e prodhimeve tuaja, të futni në një shkallë më të gjerë kulтивimin e bimëve të reja, sidomos të bimëve industriale, pse vetëm kështu do të rritet, do të zhvillohet dhe do të përparojë bujqësia jonë. Është e qartë se, sa më e përparuar të jetë bujqësia jonë, aq më tepër bollëk do të keni ju për vete, aq më tepër do të përmirësohet gjendja juaj dhe e mbarë popullit shqiptar.

Kultivimi i bimëve industriale, për të cilat janë bërë hapat e parë, duhet të zgjerohet më tepër dhe rezultatet do të janë më të mira. Këto do të janë lënda e parë për industrinë që do të ngremë në të ardhmen

dhe sigurisht Fieri do të bëhet qendër e rëndësishme për kultivimin dhe përpunimin e këtyre bimëve. Prandaj, ju akoma më tepër duhet të kontribuoni me të gjitha forcat për të patur suksese sa më të mëdha në punën tuaj.

Një nga këto detyra të mëdha dhe imediate janë mbjelljet e vjeshtës. Mbjelljet e tanishme duhet të bëhen më mirë se në vitet e kaluara. Të plotësoni me çdo kusht planin që u është parashtruar dhe të vini të gjitha forcat për ta tejkaluar atë duke mbjellë më shumë dhe më mirë, pse kështu do të rritni rendimentin dhe do merrni prodhime me një kualitet më të mirë.

Pushteti popullor ju bën të gjitha lehtësitë dhe do t'ju ndihmojë çdo ditë më tepër, por detyra tuaj është që të dini t'i shfrytëzoni këto lehtësi e ndihma që ju jep pushteti juaj, duke shfrytëzuar në maksimum forcat tuaja duke organizuar dhe duke racionalizuar fuqitë tuaja të punës, duke ndihmuar njëri-tjetrin dhe duke përdorur në një shkallë të gjerë punën kolektive, d.m.th. punën e përbashkët.

Frytet e një pune të tillë do të jenë mjaft të mira. Prandaj këtu është detyra e organizatave të Frontit, të rinisë, të gruas, që të mobilizojnë tërë masat për t'i kushtuar tërë forcat kryerjes më me sukses të mbjelljeve të vjeshtës.

Pushteti popullor nuk bën asgjë që është në disfavorin tuaj. Përkundrazi të gjitha urdhëresat që nxjerr qeveria për çështjen e drithërave janë në favorin tuaj.

Ju e dini që, si gjithë populli shqiptar, edhe ju keni detyrime ndaj shtetit, ndaj shoqërisë.

Këto s'janë më detyrime që kanë ekzistuar njëherë, në kohën e kaluar, kur ju derdhnit djersën për të tjerët.

pse tashmë janë thyer njëherë e përgjithmonë zinxhirët e beat që ju robëronte. Ato janë detyrime para kolektivitetit, para shoqërisë sonë të re, janë detyrime që kthen prapë, për të mirën tuaj e të gjithë popullit tonë. Ato përdoren nga shteti për të ngritur nivelin e jetës së mbarë popullit, për t'i dhënë popullit e fshatarëve më shumë drithë e kulturë, për të hapur rrugë, për të bërë kanale, shkolla, spitale, për të siguruar prodhime industriale, me një fjalë, për të ngritur nivelin e jetës dhe për të zhvilluar fuqinë ekonomike të popullit. Këto detyrime nuk janë aspak të rënda, sepse janë në dobinë tuaj e të të gjithë vendit.

Këtë e dinë mirë edhe armiqjtë tanë, të cilët përipiqen të sabotojnë punën tonë ndërtimtare. Ata komplotojnë dhe shiten te i huaji, për të përbysur pushtetin popullor, për të kthyer kohën e vjetër, për të robëruar edhe njëherë popullin tonë, ashtu si kanë qenë mësuar të bëjnë, duke jetuar me punën e të tjereve. Por kjo kohë në vendin tonë ka marrë fund përgjithmonë, e zhduku nga faqja e dheut Lufta heroike nacional-çlirimtare. Ata e dinë mirë se përbushja e këtyre detyrimeve, d.m.th. zbatimi nga ana juaj i masave dhe i urdhëresave që nxjerr qeveria, do të thotë forcimi i pushtetit popullor, do të thotë përmirësimi i ekonomisë dhe i jetës suaj. Prandaj ata punojnë me tërë forcat e tyre, që ju të mos i përbushni këto detyrime, sepse e dinë se kështu, ju, shteti dhe i gjithë populli ynë do të kenë më tepër vështirësi dhe jeta juaj dhe e mbarë vendit, nuk do të përmirësohet me shpejtësinë e duhur.

Ju i dini kush janë këta njerëz, ju i njihni mirë dhe i kuptoni se çfarë duan.

Këta janë njerëzit e klasave të privilegjuara, që kanë humbur privilegjet e tyre, që u ikën nga duart tokat, fabrikat, pasuritë e tyre të mëdha, të cilat u bënë pronë e popullit. Këta nuk mund të durojnë këtë situatë të re, pse ata e kanë halë në sy popullin e pushtetin e tij. Prandaj ata luftojnë me tërë forcat e tyre, për të penguar ecjen tonë përpara, për të sabotuar punën tonë, për ta bërë të vështirë gjendjen tonë, për të mos realizuar planet tona. Ata e dinë mirë se, sa më tepër të përmirësohet gjendja e popullit tonë, aq më tepër forcohet dhe konsolidohet pushteti popullor dhe aq më e sigurtë është vdekja e tyre. Dhe që populli të mos jetë në fuqi, ata janë gati të shiten te çdo i huaj, të bëhen vegla dhe spiunë të imperialistëve të huaj, të tradhëtojnë popullin e atdheun.

Por populli ynë është vënë me vendosmëri në rruġġen e përparimit dhe po punon me tërë forcat e veta për të krijuar një jetë më të mirë, prandaj, me pushtetin e tij të fortë, ai i kap, i godit pa hezitim dhe pa mëshirë armiqtë e tij.

Ju keni parë para gjyqeve të popullit, armiqtë tanë të betuar të pohojnë poshtësitë dhe tradhëtitë e tyre, ashtu si patë dhe ata, të kapur kohët e fundit¹ që, të lidhur kokë e këmbë me reaksionin e jashtëm dhe të brendshëm, me «Ballin» e «Legalitetin», të shitur te imperialistët e huaj anglo-amerikanë e te monarko-fashistët grekë, kérkonin t'i bënin varrin popullit tonë. Por

¹ Eshtë fjala për grupin e deputetëve tradhëtarë dhe të agjentëve e sabotatorëve që, të shtyrë dhe të ndihmuar nga imperialistët amerikano-anglezë, kryen akte spiunazhi, sabotazhi dhe terrorizmi, për të rrëzuar me forcë pushtetin popullor.

populli i kapi dhe u dha dënimin e duhur, ashtu si e meritojnë të gjithë spiunët, sabotatorët, tradhëtarët e popullit.

Por nga ana tjetër populli ynë duhet të ketë kurdoherë sytë hapët, për të ruajtur punën e tij ndërtimtare nga armiqtë e popullit dhe për të ecur me vendosmëri e hov në rrugën që ka zgjedhur.

Popull i Fierit dhe i Myzeqesë,

Populli ynë është vënë me vendosmëri në rrugën që i garanton një të ardhme të lumtur. Ai po ecën pa u ndalur nga pengesat që i dalin përpara. Në punën e tij paqësore e ndërtimtare ai ka gjetur miq dhe aleatë të singertë, që i duan të mirën dhe i japid çdo përkrahje materiale dhe morale.

Këto ndihma të popujve vellezër të Bashkimit Sovjetik, janë një mjet i fuqishëm për ngritjen dhe zhvillimin e ekonomisë sonë dhe një garanci e shëndoshë për të ardhmen tonë.

Ne i jemi thellësisht mirënlohës Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit të madh për ndihmën që i jep popullit tonë të vogël për të shkuar përpara.

Popull i Fierit dhe i Myzeqesë,

Sot në vendin tonë po bëhen punime të mëdha, në bazë të një plani të studjuar që ka për qëllim zhvillimin dhe përparimin e ekonomisë sonë dhe ngritjen e nivelit të jetës së popullit tonë.

Në këtë plan një vend me rëndësi zë bujqësia jonë,

e cila duhet të zhvillohet dhe të përparojë më tepër. Këtej dalin detyra të mëdha për çdo fshatar që të realizojë dhe të tejkalojë planin. Prandaj mobilizoni gjithë forcat tuaja në këtë drejtim.

Qeveria dhe unë kemi besimin më të madh se ju, duke realizuar situatën që po krijohet në vendin tonë nga puna juaj përparimtare, do të dini të shfrytëzoni punën dhe iniciativën tuaj, duke punuar sa më shumë e sa më mirë për të korrur suksese gjithmonë më të mëdha, për të prodhuar sa më shumë e për të kontribuar në maksimum për mirëqenjen tuaj dhe të mbarë popullit tonë.

Rroftë populli i Myzeqcsë dhe i qytetit të Fierit!

Rroftë populli heroik i Shqipërisë!

Rroftë Republika jonë Popullore!

Rroftë Ushtria jonë heroike!

Rroftë miku i dashur i vendit tonë Stalini i madh!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 858,
30 shtator 1947*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qend-
ror të Partisë*

FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË KRAHINËS SË MALLAKASTRËS NË MITINGUN E ORGANIZUAR NË BALLSH

29 shtator 1947

Popull i Mallakastrës.

Me gëzim të madh ju përshëndes në emër të qeverisë dhe timin sot të mbledhur në këtë ditë të shënuar.

Mallakastra gjatë Luftës nacional-çlirimtare u bë një nga vratat më të forta të rezistencës së popullit shqiptar kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve. Qysh në ditët e para të luftës sonë, duke ndjekur besnikërisht traditat e luftës për liri të popullit tonë, populli i Mallakastrës ju përgjegj thirrjes së Frontit Nacional-Çlirimtar me Partinë Komuniste në krye, duke u bashkuar dhe duke ngritur krye me armë në dorë për lirinë e vendit tonë. I gjithë populli i Mallakastrës, burra e gra, të rinj e pleq, rrokën armët për të luftuar armikun.

Në krahinën e Mallakastrës, kudo që të hedhësh sytë, që nga Patosi dhe deri në Rabije, që nga Selishta e deri në Qafë të Sinjës, kudo duken akoma dhe sot gjurmët e rënda të luftës heroike që bëri populli i Mallakastrës.

E kaluara e popullit të Mallakastrës është një e kalluar plot luftëra e përpjekje kundër çfarëdo okupatori që ka shkelur në tokën tonë dhe kundër çfarëdo tradhëtarë të vendit. Përpjekjet e fshatarëve të Mallakastrës kundër sundimtarëve turq dhe bejlerëve të vendit nën udhëheqjen e Rrapo Hekalit, kanë qenë shembull i gjallë. Rrapo Hekali hyri në historinë e popullit shqiptar si një figurë e fortë e luftës së fshatarësisë kundër shtypjes së okupatorëve turq dhe feudalëve të vendit. Bile deri pak para çlirimit të Shqipërisë, oxhaku feudal dhe tradhëtar i Cakranit këndonte këngën e ahmarrjes kundër fshatarëve të Mallakastrës së Rrapo Hekalit që vranë Isuf Bej Beratin, i cili kish ardhur për të marrë taksa dhe xhelepe nga Mallakastra për sultinanin e Stambollit.

«Mallakastr' e sipërme
Ç'dashke vënë në batare
Vrave goxha Isuf be».

Por, populli i Mallakastrës, ashtu sikundër vrah Isuf Benë, me Luftën nacional-çlirimtare që bëri, vari edhe Bektash Benë e Cakranit, përfaqësuesin e oxhakut feudal të Mallakastrës. Ky bej ka bashkëpunuar me të gjithë okupatorët e huaj, si me turqit, ashtu dhe me grekët, si me italianët, ashtu dhe me gjermanët, vetëm e vetëm për të mbrojtur interesat feudale dhe për të shtypur popullin.

Në ditët e para të 1943-së, kur krisi pushka në Gjorm të Mesaplikut kundër italianëve dhe milicëve të Mustafa Krujës dhe Qazim Koculit, populli i Mallakastrës dha alarmin e luftës dhe treqind e ca burra u grumbulluan menjëherë në Poçem, gati për të vajtur në ndih-

më të vëllezërve të tyre vlonjatë dhe kurveleshas. Kjo gjë i tronditi shumë bejlerët cakranjotë dhe shërbëtorët e tyre si Tefik Cfiri, Ali Zeneli, Besim Belishova dhe Reuf Fratari. Këta tradhëtarë nuk mund të rrinin indiferentë kundrejt një gjendjeje të tillë. Ata e dinin mirë se kryengritja e popullit me armë, ishte kryengritja për liri dhe pavarësi. Prandaj ata u hodhën me armë në dorë kundër popullit të Mallakastrës dhe kundër të gjithë popullit shqiptar.

Përgjegjja e parë që i dha populli i Mallakastrës okupatorit italian dhe Bektash Beut, qe krisma e pushkëve, e mitralozave dhe e bombave, që u përzien me flakën dhe tymin e Patosit më 10 shkurt 1943. Presionet dhe kërcënimet e italianëve, manevrat dhe intrigat e «Ballit Kombëtar» me anën e bejlerëve të Cakranit, nuk zunë vend përpara vrullit të kryengritjes të popullit të Mallakastrës.

Dhjetë ditë pas aksionit të Patosit, natën e 20 shkurtit të 1943-së, atë natë kur krerët e «Ballit» të Mallakastrës dhe të Vlorës, ishin mbledhur në Fier bashkë me italianët për të bërë planin e operacionit kundër popullit të Mallakastrës, çeta partizane e Mallakastrës, bashkë me atë të Vlorës, bënë aksionin e shkëlqyer mbi Selenicë, i cili u kushtoi italianëve përmbi 20 milion lireta. Ky aksion i ogërsoi dhe më tepër okupatorët italianë dhe ballistët, të cilët dërguan një ekspeditë karabinierësh për të ripushtuar Selenicën. Dihet mirë prej të gjithëve se kjo ekspeditë u kushtoi okupatorëve dhe armiqve të popullit, asgjësimin e plotë të saj: 120 të vrarë dhe 80 robër karabinierë e oficerë, ndër të cilët edhe një nënkolonel.

Si ahmarrje të këtyre grushteve të popullit, italianët dhe «Balli Kombëtar» organizuan operacionin e qershorit kundër Mallakastrës. Rreth dy mijë italianë të armatosur gjer në dhëmbë, 500 e ca milicë të Maliq Bushatit dhe banda balliste e kriminelit Isa Toska, shpërthyen një operacion më 26 qershor kundër Mallakastrës. E gjithë Mallakastra u çua më këmbë kundër këtij operacioni. Të gjitha çetat e fshatarëve zunë pozitat e veta dhe u hodhën në kundërsulm mbi armikun. Që nga «Përroi i Lapulecit» dhe deri te «Shkëmbi i Ruzhdijes» bëhej pushkë prej «Çetës Plakë», çetave të Greshicës, Drizarit, Hekalit, Kutës, Cakranit dhe prej të gjitha çetave të tjera. Mallakastra u bë shesh luftimesh të paprera dhe i gjithë populli shqiptar shikonte me admirim këtë luftë patriotike.

Pas këtij operacioni italianët ehe «Balli Kombëtar» organizuan një operacion tjetër. 26 mijë italianë dhe dy mijë ballistë të Isa Toskës u grumbulluan në «Qafën e Rabijes» në Berat, në Fier, në Selenicë. Mallakastra ishte rrrethuar nga të gjitha anët. Nën thirrjen e Partisë Komuniste, e cila organizonte dhe udhëhiqte popullin e Mallakastrës, sikurse gjithë popullin shqiptar në Luftën nacional-çlirimtare, të gjitha çetat e Mallakastrës, dy mijë e ca burra e gra, të armatosur, u grumbulluan më 10 korrik te «Mulliri i Kashtës». Dhe kur u pyet populli nëse pranonte më mirë të digjej Mallakastra, por me ndër, duke e pritur armikun me luftë, apo të pranonte turpin e kompromisin, në këtë moment kritik populli i Mallakastrës dha përgjigje me një batare pushkësh kundër aeroplanëve fashistë që fluturonin mbi kokë. Ishte përgjegje e denjë, ishte shenja se populli i Malla-

kastrës kishte vendosur të luftonte në çdo rrrethanë, deri në fund e pa asnjë kompromis me armikun.

Populli i Mallakastrës nuk u përkul, as nga djegjet e plaçkitjet, as nga pushkatimet e njerëzve të pafajshëm. Ai e forcoi dhe më tepër bashkimin e tij rrreth Frontit Nacional-Çlirimtar dhe besimin e tij në Partinë Komuniste. Italianët u detyruan të largoheshin menjëherë nga Mallakastra.

Operacionin e dimrit¹ populli i Mallakastrës e priti me luftë, sikurse operacionet e para. Okupatorët e rinj, gjermanët, bashkë me ballistët e Bektash Cakranit, Tefik Cfirit, Isa Toskës, Kadri Cakranit, Reuf Fratarit, Isa Manastirliut dhe Hamit Matjanit, shpërthyen një operacion në shkallë të gjerë mbi Mallakastrën. Populli luftoi heroikisht dhe i shkaktoi humbje të rënda armikut. Porse armiku më i shumtë në numër dhe më i armatosur, kudo ku hyri, pushkatoi në masë dhe shkrettoi vendin. Populli i Mallakastrës, sikurse i gjithë populli shqiptar, përulet me mirënjojje përpara kujtimit të dëshmorëve të Mallakastrës që ranë në sheshin e nderit.

Djemtë trima të Mallakastrës si gjeneral-major Mehmet Shehu, luftuan jo vetëm në krahinën e tyre, por edhe në të gjitha krahinat e Shqipërisë, kudo ku u luftua me armikun. Edhe në Jugosllavi ku luftuan divizionet tona, shumë djem dhe vajza të Mallakastrës dhanë jetën në luftën heroike që bënë brigadat tona partizane. Dervishi², Shefiti³, Xheviti⁴ e të tjera dësh-

¹ Operacioni armik i dimrit 1943—1944.

² Dervish Osman Hekali

³ Shefit Feti Goxhaj

⁴ Xheviti Bektash Pashaj.

morë si këta, kanë qenë shembull guximi dhe trimërie në brigadat tonë heroike. Këshilli nacional-çlirimtar i Hekalit, i cili u pushkatua prej tradhëtarëve ballistë, është shembull guximi dhe trimërie kundrejt çështjes së popullit, jo vetëm për popullin e Mallakastrës, po edhe për gjithë popullin shqiptar.

Populli shqiptar, në saje të luftës që ai bëri, në saje të luftës së madhe që bënë popujt e Bashkimit Sovjetik dhe të luftës të të gjithë popujve demokratë kundër fashizmit, u çlirua nga okupatorët e huaj, dërmoi reaksionin e brendshëm dhe mori në dorë vetë push-tetin. Pushteti demokratik i dha fshatarit atë që i përkiste, tokën dhe të gjitha të drejtat. Sot në Shqipëri toka i përket atij që e punon. Bujqit e shtypur të Mallakastës u çliruan njëherë e përgjithmonë nga zgjedha e agait. S'ka më në Mallakastër Bektash Cakran, Bektash Çorrush, Xhemal Aranitas, Qazim Selfo, ose bejlerë e agallarë të tjerë si këta. Tani bujku nga Varibopi ose nga Cakrani, ashtu edhe ai nga Romsi ose nga Bejari ka tokën e tij që e ka fituar me gjak.

Ju e dini mirë se ashtu si lufta nuk mund të fitohej pa bashkimin e të gjithë forcave të popullit shqiptar, ashtu edhe vendi ynë dhe jeta jonë nuk mund të përmirësohet pa një bashkim të shëndoshë të të gjithë popullit dhe pa një punë të palodhur. Me këtë dua të them që fshatarët duhet të kuptojnë mirë se lidhja e ngushtë me masat punonjëse të qytetit është e domos-doshme dhe jetike. Po të mendojë gjithsecili për vete dhe vetëm për vete, atëherë punët do të çalojnë. Pse ne rrokëm armët dhe rrëzuam regjin e bejlerëve dhe të agallarëve? Sepse bejlerët dhe agallarët, duke shtypur

fshatarët, s'mendonin përveçse për veten e tyre. D.m.th. ne luftuam që të mos ekzistojë më ky mendim, por të zëvendësohet me një vëllazërim të shëndoshë, me një bashkëpunim të singertë në mes të shtresave të katundit dhe të punëtorëve të qytetit. Që të dy kanë nevojë për shoqi-shoqin, asnjeri nuk mund të rrojë pa tjetrin. Fshatari ka nevojë për rrobe, për gaz, përmenda e shumë e shumë gjëra të tjera, të cilat i pret nga punëtorët e qytetit dhe, anasjelltas, punëtori i qytetit pret nga fshatari bukën, mishin, etj. Pra këtu është çështja që këto shkëmbime të bëhen në rregull, të bëhen drejt, të mos ketë spekulime dhe të mos ketë mungesë. Qëllimi i qeverisë, pra, është që t'i harmonizojë të gjitha këto shkëmbime në të mirën e të gjithë popullit. Fshatarët tani kanë tokën e tyre, pra duhet ta punojnë mirë tokën, të prodhojnë sa më shumë për veten e tyre në radhë të parë dhe pastaj për të gjithë popullin. Në këtë drejtim fshatarët kanë pasur të gjithë ndihmën e qeverisë dhe do ta kenë kurdoherë më shumë. Fshatarët shohin vetë sa është përmirësuar jeta e tyre po ta krasojnë me shtresat e tjera të popullit. Detyra e fshatarëve është pra, përveç asaj që thamë më lart, t'i kuptojnë mirë ligjet dhe urdhëresat e qeverisë dhe t'i zbatojnë drejt dhe me përpikëri. Kjo gjë është në interesin e vetë fshatarëve, pse ata duhet të kuptojnë se në rast që nuk dorëzojnë me të holla dhe me çmime të drejta, tepricën e bereqetit të tyre, një pjesë e popullit do të ketë më pak bukë. A është e drejtë kjo? Kjo s'është e drejtë aspak. A është e drejtë që punëtorët të kenë më pak bukë, kur gruri dhe misri është bërë me bollëk? A do të mundin dot punëtorët të punojnë në fabrika, në

ndërmarrje për të prodhuar sa më shumë gjëra dhe vçgla për fshatarin, të kryejnë si duhet dhe shpejt nevojat e fshatarëve, kur ata të mos kenë bukë të mjaftueshme për të ngrënë, të mos gjejnë asgjë në treg, ose t'i gjejnë me çmime shumë të larta, në një kohë kur mund të themi se bujqësia nuk ka shkuar keq? Jo, kjo s'është aspak e drejtë. Atëhere po të ngjasë kështu unë ju pyes: Ku qëndron solidariteti dhe vëllazërimi? Në rast se ka fshatarë që, me dashje a pa dashje, nuk i zbatojnë mirë urdhëresat e qeverisë, atëhere do të ngajë kjo, që fshatari mund të pasurohet diçka, por ai do të humbasë nga ana tjetër, pse ai do të gjejë më pak gjëra në treg dhe, natyrisht, do t'i blejë këto shtrenjtë, d.m.th. kush humbet në këtë mes? Është e natyrshme që do të humbasë edhe fshatari, edhe punëtori, edhe populli. Duke vepruar kështu pushteti ynë dobësohet dhe kjo do të thotë t'i hapim rrugë përsëri Bektash Beut me shokë, të vijnë të shtrohen këmbëkryq në vatrat tona. Për të arritur këtu e bëmë gjithë këtë luftë dhe e derdhëm gjithë këtë gjak? Jo, aspak. Por mund të ketë ndonjë fshatar, që nga moskuptimi i duket sikur i bën mirë vctes, kur përpinqet të fshehë disa kile grurë ose misër. Këtij fshatari duhet t'i hapim sytë dhe ta mësojmë se kjo s'është në të mirën e tij, por në dëmin e tij, pse ai duhet të dijë se nuk punon vetëm për një mot, por ai punon për tërë jetën e tij, për jetën e fëmijëve të tij, e cila nuk mund të përmirësohet, duke fshehur disa kile grurë. Përmirësimi i jetës së tij do të vijë gradualisht dhe së bashku me atë të gjithë popullit shqiptar, sepse populli shqiptar është si gjithë trupi i njeriut, që, kur çalon një këmbë, le të jetë sa të dojë e shëndoshë

tjetra, gjithë trupi është kurdoherë i sëmurë. Por ka edhe disa fshatarë, të cilët kanë qenë të pasur dhe tanë ata kanë ardhur në një radhë me ata që ishin të varfër dje. Këta fshatarë të pasur nuk janë të kënaqur nga këto punë. Ata do të përpinqen kurdoherë të shkojnë kundër ligjeve dhe urdhëresave të qeverisë, do të përpinqen të fshehin prodhimet, të shajnë, të kritikojnë, të bëjnë dhe të tjerë të pakënaqur pa arësy, pse ata këtë qëllim ndjekin, d.m.th. t'i bëjnë dhe të tjerët sipas vetes. Prandaj i mbani sytë hapët, ju fshatarë të Mallakastrës nga këta njerëz të ligj, i mbani sytë hapët ju, që u dogjët me shtëpi dhe katandi, juve që u janë vrarë djemtë në luftë. Bëhuni mbrojtësit më të ashpër të ligjeve dhe të urdhëresave të qeverisë, pse këto dhe vetëm këto do të përmirësojnë jetën tuaj dhe do t'ju nxjerrin në dritë. Do t'ju këshilloj dhe një gjë tjetër që ju luftëtarë të pamposhtur do ta kuptioni më mirë dhe do të bëni të mësojnë dhe të tjerë, do t'ju këshilloj një gjë me rëndësi: të forconi këshillat e pushtetit. Mos i quani këto si një gjë shkel e shko dhe mos kujtoni se mund të bëni dhe pa to, ose mund të bëni edhe me ato këshilla, ku janë futur brenda njerëz që s'meritojnë, njerëz që s'kanë besimin e popullit dhe disa herë kanë qenë kundër popullit. Po të mendojmë kështu, atëhere punët nuk do të na shkojnë mirë. Po të themi: «Le të zgjidhet filani në këshill, se ai është i gjezdisur, se ai ka qenë kryeplak përpara» e të tjera, atëhere vaj hallit kush do t'ja shohë interesin popullit. Këshilli është qeveria juaj dhe atje duhet të zgjidhen njerëz të ndershëm, njerëz punëtorë, njerëz që kanë lufthar dhe që kanë pasë vënë kokën në torbë për intere-

sin e popullit. Vetëm këta do të punojnë për interesin e popullit dhe të mos pritni asnje gjë të mirë nga ish-kryepçeqtë e Zogut dhe qehajallarët e Bektash Cakranit. Kurdoherë që do të votoni për këshillat, ju duhet të keni në mendje se pushteti është i popullit dhe atje duhet të zgjidhen njerëz të popullit. Dhe ata që zgjidhen të mos kujtojnë se e kanë marrë punën me tapi dhe mund të bëjnë ç'të duan. Ata duhet të bëjnë atë që do populli dhe kur ata nuk veprojnë kështu, ju keni të gjitha të drejtat — këtë jua jep Statuti i Republikës — ta merrni për veshi dhe t'i thoni: «Shko bëj punë tjetër, se ti s'je i zoti të na qeverisësh». Kështu do të na shkojnë punët mirë dhe në këtë rrugë ju do të keni përkrahjen e plotë të qeverisë, të Partisë dhe timen. Edhe një gjë tjetër të keni kujdes: ngrini kooperativa të shitblerjes. Kjo gjë është në interesin e madh tuaj. Këto kooperativa duhet të janë të popullit dhe jo të kuptohen si dyqani i një njeriu. Këto të drejtohen nga vetë ju dhe të mbajnë çdo gjë që i nevojitet fshatarit dhe ju çoni në ato çdo gjë që keni për të shitur. Në këtë mënyrë ju do të keni çdo gjë te dera; ju nuk do t'i blini shtrenjtë plaçkat, as nuk do t'ju gënjejnë më matrapazët dhe tregëtarët spekulatorë. Nga ana tjetër ju do të furnizoni me prodhimet tuaja konsumatorin e qytetit në një mënyrë të rregullt dhe të drejtë. Ju do të fitoni kohë të vlefshme, që tani e harxhonи duke bërë aq orë rrugë në borë e në shi dhe ju do ta përdorni këtë kohë për të punuar më mirë, për t'u çlodhur nga puna, për të mësuar shkrim dhe këndim, për të rregulluar më mirë shtëpinë dhe jetën tuaj. Cili është ai fshatar që s'i do këto gjëra të mira? Por këto nuk bien nga qiejt.

Duhet të punojmë kështu, që t'i arrijmë këto gjëra. Duke punuar kështu ju do të rritni mirëqenjen, i gjithë populli do të rritë mirëqenjen, shteti ynë do të bëhet më i fortë dhe do të kemi më shumë shkolla, do të kemi më shumë spitale, do të kemi më shumë fabrika, do të kemi më shumë bukë. Këto janë në duart tona që t'i bëjmë dhe do t'i bëjmë. Ne bëmë gjëra edhe më të mëdha, ne luftuam me shtete aq të fortë dhe aq të fuqishëm saqë disa thoshnin nëpër buzë: «Çfarë bëjnë këta njerëz. Lufton veja me devenë?» Po, luftoi veja me devenë dhe deveja u shtri përdhe, sepse veja ishte më e fortë. Dhe populli shqiptar është i fortë dhe do t'i realizojë të gjitha qëllimet e tija.

Përpara pra, motra dhe vëllezër të Mallakastrës, përpara në punë të palodhur për të ndërtuar jetën tonë më të mirë.

Rroftë populli heroik i Mallakastrës!

Rroftë populli heroik shqiptar!

Rroftë Republika jonë Popullore!

Rroftë Fronti Demokratik!

Rroftë Ushtria jonë heroike!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 858,*

30 shtator 1947

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 858,*

30 shtator 1947

FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË VLORËS

30 shtator 1947

Popull heroik i Vlorës,

Gëzimi im është i patregueshëm sot që ndodhem në mes jush, në qytetin heroik të Vlorës, që është mburrija e gjithë Shqipërisë.

Në luftën e madhe antifashiste populli vlonjat e përsërithi edhe një herë epopenë e të parëve të tij. Ndjenja liridashëse e ka shtyrë popullin e krahinës së Vlorës kurdoherë, gjatë historisë sonë shekullore, të përqafojë lëvizjet çlirimtare dhe të luftojë kundër skllavërimit të huaj dhe shtypjes së brendshme. Në Vlorë u ngrit flamuri më 1912 dhe u shpall pavarësia e Shqipërisë. Kjo është një ditë e shënuar në historinë e vendit tonë, pse nga Vlora heroike u shpall përparrë botës imperialiste vullneti i popullit shqiptar, i cili kishte vendosur të rronte i lirë dhe i pavarur. Populli vlonjat, sikurse gjithë populli i Shqipërisë, i tregoi botës se ai nuk do t'u përulej kurrë okupacioneve të huaja.

Lufta e Vlorës e 1920-s kundër imperializmit italianni, i fuqishëm në njerëz dhe në material, është një

epope më vte. Djemtë e Labërisë, fshatarë, punëtorë dhe populli kreshnik i këtij qarku, hodhën poshtë me përbuzje intrigat e atyre që ishin të shitur te i huaji dhe vendosën: ose të rronin të lirë, ose të vdisnin me nder me armë në dorë. Me dyfekë të vjetër, me hanxharë, me sopata, me një krohdë bukë në trastë, zbatthur dhe zhveshur, por me një vullnet të hekurt, populli i krahinës së Vlorës sulmoi italianët dhe i mundi. Gunat dhe lesat u bënë urë kalimi mbi telat dhe istikamet italiane. Ata i mbërthyen për gryke topat e armikut, ata luftuan trimërisht derisa armiku u hodh përtëj detit. Heroizmat e Selam Musait, të Hodo Zeqirit, të Zigur Lelos, të Sali Muratit e të të tjerëve, do të mbeten brez pas brezi në historinë e përpjekjeve përliri të popullit shqiptar. Por epopeja e 1920-s u përsërit me një madhështi të jashtzakonshme edhe një herë në luftën antifashiste.

Populli i Vlorës u rezistoi me armë në dorë okupatorëve italianë dhe gjermanë, ai goditi pa mëshirë tradhëtarët dhe bashkëpunëtorët e armikut, ai nuk ju përkul shtypjes dhe as nuk ju tremb sakrificave dhe rreziqeve. Vuajtjet dhe sakrificat, që kaloi populli i Vlorës gjatë periudhës së luftës, nuk ja ulën për asnje moment moralin, përkundrazi, e bënë atë të ashpërsonte më tepër goditjet, të forconte më tepër bashkimin dhe të luftonte më me tërbim okupatorin. Ai ishte i bindur se vetëm me luftë, me vetëmohim dhe sakrifica do të fitohej liria, ai ishte i bindur se Fronti Nacional-Çlirimtar dhe Partia Komuniste e Shqipërisë që ndiqnin rrugën e drejtë të popullit, do ta ngrinin lart flamurin e lirisë dhe do ta çonin popullin shqiptar në fitore.

Populli i Vlorës nuk e linte aq kollaj armikun e tij të përhershëm, Italinë imperialiste, të zbriste me qetësi në portin e Vlorës më 7 prill të 1939-s. Gjaku i popullit të Vlorës u derdh në Skelë, por Zogu me klikën e tij, që kishin pregetitur okupacionin, e tradhëtuan popullin shqiptar në momentet më tragjike. Në anën tjetër, bashkëpunëtorët e fashizmit, bejlerët e Vlorës, Qazim Koculët e të tjerë bënë çmos për ta sabotuar luftën e popullit të Vlorës dhe të gjithë Shqipërisë.

Italia fashiste e pushtoi Shqipërinë, por populli vlonjat, sikurse gjithë populli shqiptar, vendosi menjëherë të ndjekë rrugën e shpëtimit, rrugën e luftës. Armiku nuk u la asnje ditë i qetë. Ju e keni të gjallë ditën e demonstratës, 28 Nëntorin 1941, kur flamuri tringjyrësh i urryer i italianëve me sopatat e fashizmit, u hoq zvarrë në rrugët e qytetit. Greva e bukës¹, sabotimet, vrasjet e karabinierëve dhe të spiunëve tregojnë vendosmërinë dhe përpjekjet e popullit të Vlorës. Shkëndijat e pushkës dhe rezistenca e ashpër që bëhej kudo në qarkun e Vlorës, u sillte në mendje fashistëve italianë disfatat e tyre të vjetra dhe se populli i Vlorës nuk mund të mposhtej dhe të nënshtrohej kurrë. Kudo, ju vëllezër dhe motra të Vlorës, të organizuar në guerrile partizane dhe të udhëhequr prej bijve më të mirë të popullit të Vlorës, si trimi Hysni Kapo e të tjerë, goditët pa më-

¹ Greva që organizoi Komiteti qarkor i PKSH për Vlorën në 9 mars 1942 për të protestuar kundër vështirësive të mëdha ekonomike që i kishte shkaktuar vendit pushtimi fashist. Kjo grevë u kthye në një aksion politik, sepse populli që mori pjesë në të, i udhëhequr nga komunistët, u përlesh me pushtuesit fashistë dhe tradhëtarët e vendit.

shirë qendrat ushtarake të fashizmit, milicët e tyre, autokolonat e tyre. Malet e Labërisë dhe bregoret rrëth qytetit të Vlorës oshëtinin nga krismat e pushkëve të luftëtarëve të çlirimit. Heroikisht luftoi dhe ra i riu komunist, Teli Ndini. Ai sulmoi me bomba dore me dhjetëra fashistë dhe kuislingë. Në vitin 1942 në qellin e Vlorës ngrihej lart një flakë e madhe: depot e Pashalimanit, ku ishin grumbulluar nga fashistët 30 mijë tone-lata municione po hidheshin në erë. Atje patrioti, i riu komunist, Shyqri Alimerko, djalë fshatari të varfër, e kreua me ndër detyrën që i kish ngarkuar Partia e tij; ai i tregoi popullit se si luftojnë djemtë e tij, kurse armikut se sa e ashpër ishte lufta e popullit shqiptar. Po në vitin 1942 çeta e parë e Vlorës godit autokolonën fashiste në Malin e Bardhë dhe e asgjëson. Kështu u armatosën luftëtarët e Vlorës. Autokolonat goditeshin njëra pas tjetrës në grykën e Mesaplikut dhe këto suksese të një-pasnjëshme shtuan edhe më tepër hovin e luftës, ngjallën entuziazëm në popull, u shtuan radhët e partizanëve dhe okupatori e ashpërsoi edhe më tepër luftën. Do të mbeten në histori data e 3 nëntorit 1942, kur u krijua çeta e parë e Vlorës, e cila u inaugurua në zjarrin e luftës. Çeta e parë e Vlorës nuk mund t'i linte rehat milicët të ktheheshin nga Mesapliku, ku kishin djegur dhe vrarë popullin e asaj krahine. Te Ura e Gjormit krisi pushka dhe fashistët e paguan shtrenjtë. Që më 28 Nëntor 1942 postat e fashizmit u qëruan nga Mesapliku dhe «Çeta Plakë» e Vlorës bashkë me popullin e festonin me gjëzim ditën e ngritjes së flamurit.

Njerëzit e shitur te okupatori, Qazim Koculi me shokë, e shihnin rrezikun e madh që u turrej nga lufta

heroike e popullit të Vlorës, prandaj, ata tok me Halil Alinë, Selim Kaloshin dhe me kolonel Klementin në krye, u vërsulën me forcat fashiste për të shuar luftën e Vlorës. Me ta ishin bashkuar edhe tradhëtarët Hysni Lepenica, Skënder Muço e të tjerë. Këta tradhëtarë kishin për qëllim jo të luftoton okupatorin, por ta ndihmonin okupatorin duke përqarë popullin. Por planet e tyre dështuan, pse populli i Vlorës që nga Myzeqeja deri në Kurvelesh, që nga Mallakastra deri në Karaburun u mobilizua i gjithë dhe në malet e Tragjasit, të Gjormit, në brigjet e Gumenicës dhe te Ura e Gjormit krisi pushka e partizanit kundër afro 3 mijë këmishëzëve dhe mercenarëve. Fashistët u thyen. Mesapliku nuk u dogj këtë herë dhe komandanli italian Klementi, tok me milicët e tij, la koskat atje. Triumfuan forcat e popullit, pse atje luftoton trimat partizanë, të frymëzuar nga Partia Komuniste, pse atje luftonte Beqir Selimi, Qamil Asllani dhe Bajram Xhebrua, që dhanë jetën heroikisht duke u hedhur me këngë në gojë mbi tanksat dhe mitralozat e armikut. Ndërsa spiunët e fashizmit italo-gjerman, Qazim Koculi, Hysni Lepenica e Skënder Muço u vranë nga dora e vetë atyre, në shërbimin e të cilëve ata kishin shitur edhe shpirtin. I paharruar do të mbetet në histori sulmi i partizanëve mbi Selenicë, lufta e Çepratit, ku Mitati¹ dhe Lefi² ranë heroikisht duke u përpjekur me kavalerinë fashiste. Këto suksese të mëdha bënë që burra, gra, të rinj dhe të reja të mbushnin radhët e njësiteve tona partizane. Pas «Çetës Plakë» u

¹ Mitat Dautaj.

² Lef Sallata.

krijuan çeta e Drashovicës, çeta «Halim Xhelë», çeta «Hodo Zeqiri», çeta «Zigur Lelo», çeta «Ismail Qemali», çeta «Kanan Maze» e të tjera. Përballë Ushtrisë Nacional-Çlirimtare që po ngrihej, okupatori bëri operacione pas operacionesh, por të gjitha këto s'i patën sukses, pse brigjet e Tragjasit, gryka e Mesaplikut, Plloça, Shushica, Selenica dhe brigjet e Vuncit u bënë kështjella e partizanëve, ku thyheshin sulmet e barbarëve fashistë. Goditjet e rënda që kishte pësuar ushtria fashiste në Ujë të Ftohtë, në Radhimë, Tragjas, Izvor, Llogara dhe gjatë gjithë rrugës Llogara-Vlorë, e bënë të pamundshme kalimin e lirë për në Himarë.

Po në shtatorin e 1943-së, kur Italia fashiste kaptulloi, populli i Vlorës, sikurse gjithë populli shqiptar, me krenari pa edhe një herë ushtrinë e imperatorisë italiane të dorëzohet e thyer dhe e mbuluar me turp. Populli i Shqipërisë kontribuoi në shkallë të gjerë për preqatitjen e disfatës italiane. Por populli i Vlorës besnik deri në vdekje ndaj udhëheqjes së tij dhe gjithë popullit shqiptar, besnik ndaj Partisë Komuniste dhe Frontit Nacional-Çlirimtar, po preqatitej për një luftë tjetër, më të ashpër, kundër një okupatori tjetër më barbar, fashizmit gjerman. Populli i Vlorës dhe partizanët e këtij qarku ndoqën dhe zbatuan me përpikërinë më të madhe urdhërat e Shtabit të Përgjithshëm, i cili u thoshte: «Të forcojmë luftën, të forcojmë bashkin, pse përrapa nesh kemi akoma ditë të vështira, pse kemi përrpara nesh armikun më të egër që ka parë njerëzimi». Dhe, më 14 shtator në kodrat e Drashovicës nga ku Selam Musai me shokët e tij u vërsul mbi Vlorë, do të përsëritet edhe një herë epopeja e 1920-s. Batalionet parti-

zane «Halim Xhelë», «Perlat Rexhepi» e të tjerë shpërthyen në ofensivë kundër Drashovicës dhe me luftën e tyre heroike i detyruan gjermanët të lënë pozitat. Ushtrisë naziste ju desh të linte 200 të vrarë dhe të luftonte 20 ditë rresht, pastaj të hynte në Vlorë.

Lufta heroike e popullit të Vlorës nuk mund të përshkruhet në një orë, atë do ta përshkruajë historia e popullit tonë dhe do të jetë shembull për brezat e ardhshëm të Shqipërisë, por ka disa ngjarje që janë themelore në historinë e luftës dhe të ushtrisë sonë dhe një ndër këto ngjarje është krijimi i Brigadës V, e cila u mbulua me lavdi gjatë gjithë luftërave të saja. Në Brigadën V, e formuar nga djemtë më të mirë të Vlorës dhe të Labërisë, Vlora shikonte një nga formacionet e ushtrisë së organizuar, shikonte punën e madhe të Partisë, shikonte sigurinë e fitores. Nga ana tjetër, me krijimin e formacioneve të mëdha, populli shikonte dobësinë e armikut. Në fushën e Tërbaçit, afër fshatit që i ka dhënë vendit tonë luftëtarë dhe patriotë të shquar, afër fshatit të patriotit, veteranit komunist, Halim Xhelos, ku u inaugura Brigada V, përfaqësuesit e gjithë krahinave të Vlorës përsëritën edhe një herë betimin për të luftuar deri në vdekjen e fashizmit dhe të bashkëpunëtorëve të tij. Lufta e ashpër filloi tri ditë pas formimit të Brigadës V. Batalionet partizane, si batalioni «Perlat Rexhepi» dhe Brigada V në Vlorë, të zhveshur dhe të zbathur, pa ngrënë e pa gjumë, luftuan me trimërinë më të madhe në fusha, gryka dhe gërxhe; ata e dërmuan okupatorin dhe bënë të dështojë ofensiva e tij e dimrit.

As masat barbare që morën okupatorët, as torturat

dhe pushkatimet në masë, as internimet e qindra burrave dhe fëmijëve në kampet e përqëndrimit në Gjermani e gjetkë, nuk e ulën moralin e popullit të Vlorës. Ai rezistoi dhe luftoi me armë në dorë nën udhëheqjen e Partisë dhe të Frontit, derisa u çlirua e gjithë Shqipëria dhe u vendos demokracia e vërtetë në vendin tonë.

Kurorat më të bukurë me dafina janë për popullin heroik të krahinës së Vlorës!

Lavdi të përjetshme bijve heroikë të Vlorës, që dhanë jetën për atdheun: Perlat Rexhepit, Musa Ramos, Teli Ndinit, Shyqri Alimerkos, Kastriot Muços, Zaho Kokës, Zonja Çurres, Hysen Çinos, Hajredin Beqarit, Laze Nuros, Ismail Azizit, Qani Nuredinit, Mitat Dautajt, Lef dhe Mitraq Sallatës, Spiro Gjiknurit, Rrapo Hasimit, Beqir Selimit, Damën Xhelos, Abaz Shehut nga Tepeleña dhe familjes së Ormën Elmas Murrës që dha tre djem në luftë, që vetë u vra prej fashistëve dhe që gruaja e tij vdiq nga vuajtjet që i shkaktoi lufta! Lavdi gjithë dëshmorëve të tjerë të kësaj krahine!

Motra dhe vëllezër të Vlorës,

Pas një lufte kaq të ashpër që bëri populli ynë për liri dhe për demokraci, nuk mund të përsëritet në asnje mënyrë e kaluara. Gjaku i popullit tonë nuk do të shërbente më për të sjellë në fuqi klikat e bejlerëve, të agallarëve dhe të politikanëve me njëqind flamurë. Lufta jonë jo vetëm që nuk do të shërbente për këtë, por llogaria me këto klika do të qërohej përgjithmonë. Populli i qëroi lakrat me të gjithë ata që kishin shkaktuar fatkeqësinë e tij dhe që në çdo çast e shitnin atdheun dhe popullin. Bejlerët, agallarët dhe politikanët reak-

sionarë u bashkuan që në ditët e para të okupacionit me shkelësit e vendit tonë. Fashizmi ishte dhe diktatura e tyre, ai ishte mbrojtësi i çifliqeve dhe i pasurive të tyre, d.m.th. këta shihnin te fashizmi dhe vetëm te ai fuqinë që do të përjetësonte sundimin e tyre gjakpirës në kurri zyrtar të popullit. Pra, lufta që bëmë kishte dy qëllime: të çlirohet atdheu nga okupatorët dhe tradhëtarët dhe populli të merrte fuqinë në duart e tij. Këtij objektivi të madh ne ja arritëm qind për qind. Në vendin tonë të çliruar, populli ngriti demokracinë e tij popullore dhe vendosi ligjet e tija të drejta. Ai mori të gjitha masat që fitoret e luftës të konsolidoheshin dhe të zhvillohen në interesin e masave të gjera punonjëse.

Ligjet e popullit fshinë koncesionet e huaja dhe pasuritë e tyre u bënë pronë e popullit tonë. U fshi fuqia ekonomike e spekulatorëve industrialë dhe e tre-gëtarëve të mëdhenj; fabrikat, minierat u bënë pronë e popullit shqiptar. U dënuar ashpërsisht tradhëtia dhe u ngriten gjyqet e popullit. Katundarët që luftuan heroinë kisht morën tokën që u përkiste dhe Shqipëria u shpall Republikë Popullore me Statutin Themeltar nga më të përparuarit në botë. Këto ishin masat e para kryesore, mbi të cilat u mbështetën përpjekjet e njëpasnjëshme të pushtetit tonë popullor për të rindërtuar atdheun dhe për të përmirësuar jetën e popullit tonë. Ju vetë keni luftuar me vendosmërinë më të madhe, ju vetë keni punuar me entuziazmin më të madh për ndërtimin e Shqipërisë së re dhe sukseset tona kanë qenë të konsiderueshme. Kjo është e natyrshme. Kur populli është në fuqi, kur ai punon për ndërtimin e shtëpisë së tij, për ndërtimin e jetës së tij dhe të kalamajve të tij.

atëhere ka kurdoherë suksese. Vetëm armiqtë e popullit, që nuk na e duan të mirën, që ëndërrojnë kohën e vjetër dhe përpiken me të gjitha mënyrat të kthejnë përsëri të kaluarën, vetëm ata nuk kanë pasur besim se populli ynë do të arrinte në këto fitore. Ata sabotonin, ata talleshin, ata kritikonin çdo ndërmarrje të popullit, por populli ndiqte rrugën që i kish caktuar vetes dhe, duke kaluar nga fitorja në fitore, i shtypi të gjithë ata armiq që e pengonin në rrugën e tij. Ju e dini mirë sa e vësh-tirë është jeta dhe se jeta fitohet me luftë dhe me punë. Ju e dini mirë se kur digjet shtëpia, ajo nuk vihet kollaj në vend, se kur shkatërrohet ekonomia, ajo nuk mund të ndreget për një ditë. Pas luftës së madhe që bëri populli ynë, shkatërrimet ishin kolosale. Po ku qëndron heroizmi i popullit tonë? Ai qëndron në faktin se përpara gërmadhave populli ynë përveshi duart dhe ju fut punës, ai i mori parasysh vështirësitë, pengesat, ai i tha vetes se duheshin bërë sakrifica të mëdha. Në një kohë të shkurtër prej tre vjetësh Shqipëria jonë ka ndryshuar në saje të punës së popullit dhe të sakrificave që ai ka bërë. Jeta e popullit tonë është përmirësuar mjaft dhe me hapa të sigurtë ne po ecim në ndërtimin e një jete akoma më të mirë. Në ç'vend të botës është parë që në një kohë kaq të shkurtër dhe me mjete shumë të var-fëra dhe pas një lufte kaq shkatërrimtare, të ndërtohen me aq shpejtësi, rrugët, urat, kantieret, fabrikat dhe një pjesë e madhe e shtëpive të djegura? Ku është parë që në një kohë kaq të shkurtër të hapen kaq shkolla dhe arësimi e kultura të marrin një hov dhe të kapër-cejnë shumë nivelin e paraluftës? Ku është parë që në vjetët e pasluftës, kur kishte kaq fatkeqësi dhe uri,

populli shqiptar të mos vuajë as nga uria, as nga së-mundjet? Kjo ngjau në vendin tonë, pse populli shqiptar, një popull i vogël, por i fortë, që mori pushtetin në duart e veta, u gjeti zgjidhjen më të mirë të gjitha problemeve. Por, pa dyshim, punët tona shkuan mbarë, pse ne ditëm gjatë kohës së luftës të zgjidhnim si duhej dhe drejt çështjen e pushtetit, të zgjidhnim gjithashtu miqtë dhe aleatët e jashtëm. Ju e dini dhe e kuptioni se me gjithë përpjekjet tona, s'do të ishte e mundur të sigurohej fitorja mbi fashizmin, pa luftën heroike të popujve sovjetikë, pa Ushtrinë e Kuqe të lavdishme dhe pa Stalinin. (*Populli brohoret Enver-Stalin*). Ju brohoritni me gjithë zemër për Stalinin. Populli shqiptar dhe djemtë e vajzat e tij, që binin në fushën e luftës duke kënduar lavdinë e Stalinit, dinin ç'bënин. Ata e dinin së në Shqipëri luftohej, por fati i Shqipërisë dhe i botës luhej në fushat e Rúsisë. Bashkimi Sovjetik na mbron sot me të gjitha forcat e tij kundër lakkive dhe intrigave të imperialistëve anglo-amerikanë dhe monarko-fashistëve grekë. Bashkimi Sovjetik na ndihmon për të ngritur ekonominë tonë dhe për të përmirësuar jetën e popullit. I dëgjova me veshët e mi fjalët aq të qeta dhe aq të dashura të Stalinit të madh për popullin tonë. Ai fliste për Shqipërinë me një simpati të madhe dhe kishte besim se populli shqiptar do të forconte demokracinë dhe do të përparonte me hapa të sigurtë. Bashkimi Sovjetik, që i dha botës lirinë, sot lufton me këmbëngulje t'i sigurojë botës paqen e drejtë. Populli ynë, si gjithë popujt përparimtarë, është me Bashkimin Sovjetik, pse ai është mbrojtësi i njerëzimit përparimtar. Me popujt e Jugosllavisë në luftë ne u lidhëm ngushtë me gjakun

e djemve tanë. Populli shqiptar do ta forcojë dita-ditës miqësinë me popujt e Jugosllavisë.

Ju i njihni shpifjet, provokacionet e panumërtë të kurdisura nga imperialistët amerikanë dhe anglezë dhe të vëna në zbatim nga monarko-fashistët grekë. Këta përpiken të na dëmtojnë, të na grabitin, por planet e tyre janë të destiguara të falimentojnë. Më kot në OKB amerikanët, anglezët, tok me veglat e tyre, përpiken të nxjerrin pengesa për të prishur paqen dhe për ta bërë OKB-në një vegël të tyre, me anën e së cilës ata të më-këmbin Gjermaninë hitleriane, të forcojnë pozitat e fashizmit dhe të hedhin botën në një luftë të tretë. Bashkimi Sovjetik, më i fortë se kurrë dhe gjithë popujt e tjerë përparimtarë, nuk do të lejojnë që të ngjajë një llahtarë e tillë. Politika e bombës atomike dhe e dollarit do të dështojë, ashtu sikundër do të dështojnë dhe shantazhet e anglezëve kundrejt vendit tonë me të ashtu-quajturin incident të Korfuzit¹, ashtu si do të dështojnë dhe manevrat e monarko-fashistëve grekë, të shtyrë nga imperialistët amerikanë. Amerikanët përpiken të më-këmbin dhe të forcojnë fashizmin në Itali dhe të puqin në një aleancë Italinë fashiste dhe Greqinë monarko-fashiste. Ju i kuptioni mirë se ku synojnë qëllimet e imperializmit amerikan dhe manevrat e fashizmit italian që përpiqet të ringjallet. Por Vlora dhe Karaburuni me Sazanin qëndrojnë si kështjella të hekurta dhe këmba e pasardhësve të Musolinit nuk do të mundë kurrë të shkelë tokat tona.

¹ Është fjala për incidentin e provokuar nga imperialistët anglezë në kanalin e Korfuzit më 12-13 nëntor 1946.

Vëllezër dhe motra të Vlorës,

Ne jemi një popull i vogël paqedashës, që dëshirojmë të rrojmë të qetë në punët tona dhe që s'kërkojmë t'i bëjmë keq asnjerit. Ata shtete, që pretendojnë se populli ynë është një «popull agresor» dhe që «rrezikon paqen», bëhen qesharakë dhe e tregojnë haptas natyrën e tyre prej fashisti. Por të gjitha këto, ne as na frikësojnë, as na ndalojnë të ndjekim rrugën tonë të drejtë. Me besimin më të madh në paqen, në drejtësinë dhe në të ardhmen tonë ne t'i përvishemi punës me forca të shumëfishuara për të kryer detyrat që na vihen përpara. Kurrë të mos ulet entuziazmi ynë në punë, disciplina dhe organizimi në çdo ndërmarrje të bëhen më të fortë. Të vëmë forcat tona për ta forcuar sa më shumë pushtetin tonë popullore duke e bërë sa më demokratik, pse me anë të pushtetit do të mundim t'i zgjidhim çështjet. Të gjitha punët do të shkojnë mbarë dhe planet e shtetit tonë do të realizohen qind për qind, kur në pushtet të ketë njerëz të ndershëm dhe të besuar të popullit. Nga çdo gabim i vogël yni, nga çdo lëshim, ka njerëz këtu brenda që do të përpinqen të përfitojnë. Askush të mos kujtojë se në të gjithë punën e madhe që po zhvillohet në vendin tonë, të mos ketë edhe gabime. Ata që punojnë mund të bëjnë dhe gabime, por këto gabime, kur vigjilencia e popullit është e madhe, shihen dhe korrigohen dhe, kur këto gabime janë bërë me qëllim, luftohen dhe dënohen rreptësisht. Armiqtë e pushtetit tonë, mos kujtoni se flenë. Ata, të lidhur me të huajt, përpinqen të na dëmtojnë; këtu duhet të kemi kujdes dhe të mos na zërë gjumi. Ju i patë veprat e atyre

që u gjykuan në Tiranë, Abdyl Kokoshi, Sheh Karbu-nara dhe të tjerë tradhëtarë, që të lidhur ngshtë me Ali Këlcyrën, Mithat Frashërin e të tjerë u përpoqën të riorganizonin «Ballin» dhe «Legalitetin». Nën drejtimin direkt të amerikanëve, tradhëtarët sabotuan, bënë atentate, u përpoqën të rrëzonin regjimin e popullit. Por ata s'mundën kurrsesi t'ja arrijnë këtij qëllimi, ashtu si nuk do të mundin kurrsesi mbeturinat e tjera të fashizmit. Pushteti ynë është më i fortë se kurrë, pse ai i ka bazat e shëndosha në popull, pse populli është vetë pushteti. Çfarë do të presë populli nga familja e Kokoshit, e Koculit, e Risilisë, e Sharrës, e Peshkëpisë? Asgjë tjetër, përveçse një varg tradhëtarësh, të cilët njëri pas tjetrit zbulohen dhe marrin dënimin e meritor. Çdo tentativë për organizimin e këtyre njerëzve do të falimentojë, po t'i kemi sytë hapët. Këta e fillojnë punën me parulla helmatuese duke kritikuar dhe duke sharë nën gunë për të krijuar pakënaqësi dhe konfuzion, për të ngallur mosbesimin e popullit në punë dhe në forcat e tij. Këta s'janë nga ata njerëz që të kritikojnë haptas, ku është për të kritikuar, por këta kritikojnë vrimave, atje ku s'ka për të kritikuar. Prandaj nga ana e gjithë popullit, përveç disiplinës, rregullit dhe vigjilencës në punë, duhet të luftohen pa mëshirë parullat helmatuese të këtyre elementëve tradhëtarë. Përkëta s'ka mëshirë. Bejlerët, agallarët, reaksionarët duhet të dinë se s'janë më në kohën e regjimit të tyre. Këta duhet t'u binden dhe t'u nënshtrohen ligjeve të pushtetit, ligjeve të popullit punonjës, se përndryshe ata e dinë mirë se ç'i pret.

Qeveria jonë, Partia jonë Komuniste dhe unë jemi

të bindur se populli heroik i Vlorës, që qëndroi në krye të luftës së çlirimit dhe të luftës së rindërtimit, do të qëndrojë kurdoherë në krye të punës për realizimin e planeve të pushtetit dhe të qeverisë, që do ta bëjnë jetën e popullit tonë të lumtur. Vlora ka qenë, është dhe do të jetë një nga kalatë më të forta të popullit shqiptar dhe një mbështetje kryesore për ruajtjen e pavarësisë, të iirisë dhe të fitoreve të luftës dhe të pasluftës.

Rroftë populli heroik i Vlorës!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë Republika jonë Popullore!

Rroftë ushtria jonë heroike!

Rroftë miku më i madh dhe i fuqishëm, Bashkimi Sovjetik, mbrojtësi i paqes së njerëzimit!

Rroftë J. V. Stalini, miku i shtrenjtë i popullit tonë!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 859,*

1 tetor 1947

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 859.*

1 tetor 1947

FJALA E MBAJTUR PËRPARA PUNËTOREVE TË MINIERËS SË SELENICËS

1 tetor 1947

Shokë punëtorë dhe teknikë,

Sot, para gjithë popullit tonë dhe sidomos para klasës punëtore të vendit tonë, shtrohen detyra të mëdha, që kanë një rëndësi jetike, pse nga zgjidhja e tyre varet shkuarja jonë përpara, varet e ardhmja e lumtur e popullit tonë.

Eshtë e vërtetë se në një kohë relativisht të shkurtër, që nga çlirimi e këtej, me gjithë të metat që kemi pasur, ne kemi mundur të zgjidhim problemet tona ekonomike dhe të forcojmë ekonominë tonë. Por para nesh kemi perspektiva të gjera dhe për t'i realizuar këto, duhet më shumë punë, duhet një mobilizim i gjithashëm i forcave punonjëse të vendit tonë.

Sukseset tona në lëmin ekonomik, veprat e mëdha të rindërtimit, masat dhe ligjet e përparuara, me të cilat ne po rregullojmë jetën tonë, u bënë të mundura, sepse ne kemi ngritur një pushtet thellësisht demokratik, pushtetin e popullit, sepse ne kemi krijuar në vendin tonë konditat themelore për një jetë të tillë.

Duke luftuar për çlirimin e vendit kundër okupatorëve fashistë italianë e gjermanë dhe kundër tradhëtarëve të brendshëm, që u shërbenin okupatorëve, populli ynë bëri njëkohësisht një revolucion të madh shoqëror, përmbysi nga themellet pushtetin e vjetër të klasave shfrytëzuese dhe ngriti pushtetin e vet, me të cilin, menjëherë pas çlirimit të Shqipërisë, mori të gjitha masat për ndërtimin e vendit dhe për të ngritur ekonominë e tij dhe detyroi gjithë spekulatorët, gjithë bejlerët e çifligarët t'i kthenin popullit çka i kishin grabitur.

Në këtë luftë të madhe të popullit tonë, klasa punëtore e Shqipërisë, ishte në ballë të përpjekjeve, pse në këtë luftë ajo siguronte një të ardhme më të mirë. Në vendin tonë s'ka më shfrytëzim dhe ligjet përparimtare mbrojnë masat e punëtorëve tanë dhe u sigurojnë atyre kondita jetese më të mira. Me pushtetin në duart e forta të popullit, me reformat e mëdha ekonomike, me masat që ka marrë dhe merr qeveria në favor të popullit, ne kemi filluar të ngremë një ekonomi të re dhe një jetë të begatshme.

Pikërisht për këtë realitet të madh masat tona punonjëse anembanë Shqipërisë i janë vënë punës së rindërtimit me një hov dhe entuziazëm që nuk është parë deri sot në vendin tonë, pse tamam për këtë lufthan masat e gjera të popullit shqiptar dhe të bashkuara në Frontin Nacional-Çlirimtar korrën fitoren e tyre të madhe. Pikërisht mbi këto baza të krijuara me gjakun e djersën e popullit tonë, mbi sukseset e punës sonë të re e të madhe, ne do të mbështetemi për të shkuar përpara.

Midis reformave që bëri dhe masave të tjera të

rëndësishme që mori pushteti popullor një vend të dorës së parë zë shtetëzimi i minierave tona. Kapitalistët e huaj, kapitalistët italianë, që në saje të politikës së Zogut kishin hyrë në vendin tonë dhe, me kapitalet e tyre, përfitonin nga pasuritë tona, i merrnin popullit pasuritë e tij dhe e shfrytëzonin për interesat e tyre, kurse punëtorët vuanin nga shfrytëzimi i egër që u bëhej.

Por sot punët qëndrojnë ndryshe. S'ka më kapitalistë italianë, s'ka më shfrytëzime në minierat tona, këto u shtetëzuan, ju hoqën spekulatorëve të huaj dhe të brendshëm; ato u bënë pronë e popullit. Sot minierat tona punojnë për popullin tonë, për plotësimin e nevojave të tij.

Këto fitore të mëdha populli ynë e sidomos klasa punëtore duhet t'i ketë gjithmonë parasysh dhe të kuptojë mirë se tani çështja kryesore është që të vëmë gjithë forcat tona për t'i konsoliduar dhe për t'i zgjegruar gjithnjë më tepër fitoret tona. Prandaj, detyra juaj kryesore, shokë punëtorë e teknikë të Selenicës, është të punoni sa më shumë, të shtonи prodhimin, të shtonи rendimentin në punë, të vini gjithë forcat për plotësimin dhe tejkalimin e planit, pse nga sukseset tuaja varet shumë e ardhmja juaj.

Në kohën e kapitalistëve italianë, kur punëtori kishte për detyrë vetëm të punonte dhe askush nuk interesohej për jetën e tij, për të ardhmen e tij, ndërsa pasuritë e vendit tonë shkonin për të majmur padronët e huaj, ishte e kuptueshme pse ju nuk ishit të interesuar për shtimin e prodhimit dhe pse e luftonit me çdo mjet okupatorin dhe e sabotonit atë. Kjo jo vetëm që ishte e

kuptueshme, por ishte shumë e drejtë dhe një detyrë e madhe ndaj popullit dhe atdheut.

Por ne sot jemi të pavarur, fuqinë e ka në duart e tij të forta populli, si konsekuençë e revolucionit të madh shoqëror që është bërë në vendin tonë. Sot detyra kryesore e gjithë popullit tonë dhe e klasës punëtore është që, me punën e tyre, të forcojnë dhe të sigurojnë pavarësinë, të punojnë për të qenë më të fortë dhe për t'u bërë të pavarur ekonomikisht, se në këtë mënyrë ne zhdukim rrezikun e varësisë ekonomike, rrezikun e imperializmit që kërkon të rrojë mbi kurrizin e më të dobtëve.

Prandaj, siç thashë dhe më lart, detyra juaj e madhe është që t'u përgjigjeni nevojave të mëdha të popullit tonë me tërë forcat tuaja për të rritur sa më shumë prodhimin.

Me qenjen e pushtetit të popullit, me konsolidimin e pozitave të tij edhe konditat tuaja janë përmirësuar. Masat e ndryshme dhe ligjet për mbrojtje e ndihmë shoqërore në dobi të punëtorëve, për kategorizimin e tyre dhe përpjekjet e qeverisë për t'ua lehtësuar dhe për t'ua përmirësuar jetën, i kanë bërë më të mira konditat e jetës, të cilat do të përmirësohen edhe më shumë dhe qeveria do të kujdeset vazhdimisht për plotësimin e nevojave më të mëdha që keni ju. Këto probleme të rëndësishme, shteti do t'i zgjidhë ashtu si ka zgjidhur probleme edhe më të mëdha.

Por unë dua t'u them se përmirësimi i jetesës suaj, nuk qëndron vetëm në plotësimin e këtyre nevojave materiale, por njëkohësisht edhe në ngritjen e nivelit tuaj teknik të përgjithshëm, d.m.th. që ju të bëheni

punëtorë më të zot, më të aftë, të rritni aftësitë tuaja, të specializoheni në punët e minierës. Kështu do të ngrihet kapaciteti dhe produktiviteti i punës suaj.

Këtë detyrë, që është e nevojshme, e madhe dhe urgjente për vendin tonë, duhet ta kenë parasysh dhe ta kuptojnë mirë kuadrot që drejtojnë sindikatat dhe gjithë kolektivi punonjës i minierave. Të gjithë të vënë forcat e tyre për ta realizuar këtë detyrë të madhe.

Duhet të keni gjithashtu parasysh se armiqtë e pushtetit dhe të popullit, që kanë humbur pasuritë e tyre, koncesionet e mëdha, tokat, fabrikat dhe që kanë humbur gjithë privilegjet që kishin në kohën e kaluar, janë gati të na godasin kudo që të mundin, të përfitojnë nga çdo neglizhencë, nga çdo lëshim e dobësi, për të na luftuar, për të na sabotuar. Ata i kanë halë në sy fitoret e mëdha të popullit, të masave të gjera punonjëse, ata tentojnë me çdo mënyrë të pengojnë konsolidimin e ekonomisë sonë të re, sepse e dinë se forcimi i saj, shënon vdekjen e tyre. Prandaj ata përpilen të na luftojnë në punën tonë të rindërtimit, në veprat e mëdha që ka ndërmarrë pushteti ynë në kantiere e miniera me qëllim që të dëmtojnë sa më rëndë ekominë tonë të re, të pengojnë ngritjen e saj, të diskreditojnë pushtetin dhe të plotësojnë më lehtë qëllimet e imperialistëve te të cilët ata janë shitur.

Vigjilencia e qeverisë ka bërë të falimentojnë tentativat e poshtra të tyre dhe drejtësia e popullit i ka goditur në vend dhe ashpër. Gjyqet e popullit kanë nxjerrë në shesh lakuriq tërë tradhëtinë e këtyre njerëzve të klasave të privilegjuara, të shitur kokë e këmbë te imperialistët e huaj, armiq të betuar të pavarësisë

dhe të interesave të popullit e të atdheut. Këtë ju e patë edhe tani, në gjyqin e popullit në Tiranë, ku një grup armiqsh e tradhëtarësh të ndryshëm, spiunë e sabotatorë, mbeturina të «Ballit» dhe të «Legalitetit» qenë bashkuar në tradhëtinë e tyre, qenë shitur te imperialistët anglo-amerikanë e te monarko-fashistët grekë për të goditur pas shpine popullin tonë, në një kohë kur ky i ishte vënë me tërë forcat e veta, rindërtimit të vendit. Por forca e popullit është kolosale. Ai nuk lejon më që, disa aventurierë, të luajnë me fatin e tij, ashtu si kanë qenë mësuar të bënin edhe më parë, ai i kapi dhe u dha dënimin e rëndë që meritonin.

Por ju, si i gjithë populli ynë dhe këtë e kam thënë dhe herë tjetër, e dini mirë se armiqjtë e popullit nuk mund të zhduken, as në një ditë e as në një mot. Në çdo fitore tonën do të ketë edhe nga këta që do të dalin mbi ujë, por vetë përpjekjet dhe puna e pareshtur e popullit, do t'ua çjerrin maskën këtyre armiqve.

Prandaj tamam këtu duhet të zhvillohet e gjallë dhe e ashpër lufta e klasës sonë punëtore. Tentativave të armikut, klasa punëtore t'u përgjigjet me një mobilizim total duke kryer detyrat e veta.

Detyra e çdo punëtori të minierës suaj, e çdo tekniku, me një fjalë e të gjithë kolektivit punonjës të minierës është që: të kryejë punën që ka përsipër, të rritë ndjenjën e përgjegjësisë që ka ndaj shoqërisë dhe shtetit, të luftojë kundër çdo lëshimi e çdo neglizhencë, sepse këto, pa dashur, n'a dëmtojnë rëndë si dhe të vëré të gjitha forcat për ngritjen e rendimentit të punës dhe për shtimin e prodhimit.

Por që të luftohen armiqjtë që kërkojnë të sabo-

tojnë dhe që djersa jonë të mos vejë kot, punëtorët dhe teknikët e minierës duhet të kuptojnë dhe të kenë gjithmonë parasysh se kanë dhe një detyrë tjetër, po aq të madhe: të mësojnë, të ngrenë aftësitë e tyre profesionale dhe të bëhen më të zot për të drejtuar punët e minierës.

Është e vërtetë që sabotimet e armiqve na kanë dëmtuar, por prapë punët tregojnë se ekonomia jonë po ecën përpara dhe se populli po e ngrë me duart e veta atë. Punët tregojnë se çdo tentativë e armiqve do të dëmtohet para vullnetit të pathyeshëm dhe forcës krijuese të masave punonjëse të vendit tonë. Kjo ndodh sepse njerëzit tanë po përpilen me tërë forcat e veta për të kryer me sukses detyrat e tyre. Ja, minierën tuaj, që ishte shkatërruar nga lufta, megjithëse nuk kishim teknikë të mjaftueshëm dhe disa prej tyre qenë armiq të shitur te të huajt, ne e ngritëm dhe sot kjo punon dhe prodhon. Rivënya e minierës në shfrytëzim është një nga sukseset e punëve të mëdha që po realizohen sot në vendin tonë nga pushteti popullor. Por kjo nuk duhet të na dehë e të na bëjë që të mos i bëjmë kritikën e drejtë punës sonë. Përkundrazi duhet të njohim mirë realitetin e të godasim pa hezitim çdo të metë që pengon punën, pse vetëm kështu do të mundim të përmirësojmë e të zmadhojmë punën e minierës.

Shokë punëtorë e teknikë të minierës së Selenicës,

Me punën e tij paqësore e ndërtimitare populli ynë ka gjetur përkrahjen më të shëndoshë e më të sinqertë të popujve të Bashkimit të madh Sovjetik. Bashkimi

Sovjetik e Stalini i madh nuk kanë kursyer asnjëherë ndihmën e madhe morale e materiale për popullin tonë.

Shokë punëtorë e teknikë të minierës së Selenicës,

I tërë populli ynë i është vënë punës së madhe të ndërtimit. Nën udhëheqjen e qeverisë së tij ai ka ndërmarrë e po kryen punime të mëdha e shumë të rëndësishme. Punime të tjera janë parashikuar në planin e shtetit. Për çdo qytetar të Republikës sonë dhe në radhë të parë për klasën punëtore të vendit tonë, e cila duhet të japë shembullin për një punë të organizuar dhe të palodhur, dalin detyra të mëdha për kryerjen e planit të shtetit. Vetëm në qoftë se çdo punëtor, çdo qytetar i Republikës sonë, çdo kolektiv pune do të kryejë mirë dhe me ndërgjegje detyrën që i ve përpëra plani i shtetit, vetëm atëhere vendi ynë do të shkojë përpëra dhe ekonomia jonë do të fuqizohet e do të përparojë, do të dështojë çdo tentativë e armiqve tanë, të jashtëm dhe të brendshëm dhe populli ynë do të përmirësojë vazhdimisht jetën e tij. Prandaj detyra juaj është të angazhoni tërë forcat tuaja për mobilizimin e tejkalimin e planit.

Shokë punëtorë e teknikë të minierës së Selenicës,

Punët në minierën e Selenicës do të zgjerohen, miniera do të zhvillohet edhe më tepër dhe ne do të kemi më shumë produkte për të fuqizuar ekonominë tonë.

Populli dhe qeveria, shokë punëtorë të Selenicës, ka besim në forcat dhe në vullnetin tuaj, ka besim të

patundur se ju do të vini tërë energjitet tuaja për të punuar sa më shumë e për të rritur prodhimin.

Rrofshin punëtorët e minierës së Selenicës!

Rroftë klasa punëtore e Shqipërisë!

Rroftë Partia e lavdishme Komuniste e Shqipërisë!

Rroftë populli heroik shqiptar!

Rroftë Republika Popullore!

Rroftë miku ynë i shtrenjtë, Stalini i madh!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 860,
2 tetor 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 860,
2 tetor 1947*

FJALA E MBAJTUR NË DRASHOVICË PËRPARA FSHATAREVE TË KRAHINAVE TË VLORES

1 tetor 1947

Motra dhe vëllezër,

Ju përshëndes në emër të qeverisë, në emër të Partisë dhe në emrin tim personal e të shokëve të mi.

Jam tepër i gjuar që ndodhem midis jush, popullit të krahinave heroike të Vlorës, që u bëtë lavdia e qarkut dhe e gjithë Shqipërisë, që nuk u kursyet aspak për të çliruar atdheun nga barbarët fashistë dhe nazistë.

Kur dha kushtrimin Partia, se Shqipëria ishte në rrezik dhe populli kërcënohej dhe çdo njeri duhej të bëhej luftëtar i pamposhtur, ju ishit të parët që u hodhët në luftën e çlirimt, të cilën e udhëhiqte Partia. Ju përshëndes nga zemra dhe mendoj që dita e luftës së Drashovicës, 14 shtatori, të jetë dita e përvjetorit të kësaj krahine. Ju vetë keni luftuar këtu. Epopeja e 20 ditëve luftë kundër gjermanëve, tregon sa i vendosur ishte populli i këtushëm për të luftuar kundër okupatorëve dhe sa i dashur është për ju atdheu, liria, pavarsia. Kjo epope tregon vendosmërinë tuaj në rrugën e lavdishme që ndiqte populli shqiptar, në rrugën e

nderit që Partia Komuniste ja bëri të qartë popullit tonë, qysh në fazën e parë të okupacionit. Kjo tregon vendosmërinë në rrugën e re që ndiqte populli vlonjat sikurse gjithë populli shqiptar, jo vetëm për t'u çliruar nga okupatorët, por bashkë me ta, të shfaroste dhe gjithë bashkëpunëtorët e tyre, bejlerë dhe agallarë.

Lufta që bëri populli ynë kundër imperializmit fashist, vulosi edhe njëherë ndjenjat liridashëse që ka ky popull për mbrojtjen e atdheut. Por kjo s'ishte e para herë që ju luftonit kundër qenve fashistë.

Imperializmi fashist, i etur për të sulmuar popujt, sulmoi më 7 prill Shqipërinë, por populli i Vlorës u çua më këmbë i téri kundër armikut dhe ashtu si më parë, kur i hodhi të gjithë përtej detit, ai i dërmoi fashistët italianë.

Megjithëse regjimi i Zogut, që përsaqësonte bejlerët dhe agallarët, e kish shtypur popullin, populli shqiptar ndoqi rrugën që i kishte caktuar Partia.

Ju hodhët në supet dyfekët dhe luftuat kundër armikut me heroizmin më të madh. Ushtria u formua nga djemtë tuaj më të mirë dhe u udhëhoq nga punëtorë dhe fshatarë të thjeshtë, barinj që ruanin dhitë, të cilët u treguan më të zot, më të fortë nga gjeneralët italianë e gjermanë. Këtu, në krahinat tuaja u ngrit kështjella e luftës pa kompromis. Ju ishit një nga qendrat më të zjarrta të Partisë sonë. As terrori, as vuajtjet, as grabitjet, nuk ju tronditën. Ju qëndruat të fortë si malet tuaja. Bjtë e bijat që dualën nga gjiri juaj u treguan patriotë të shquar dhe me qindra prej tyre dhanë jetën për atdheun. Vendosmëria dhe trimëria që treguan djemië, vëllezërit dhc prindërit tuaj gjatë luftës, të cilët luf-

tuan pa armë, pa municion, të varfër në çdo material dhe ekonomikisht keq, shpjegohen me ndjenjat e tyre patriotike. Popullit të krahinës së Vlorës nuk ju trëmb syri nga armiku, mbasi kishte besim në forcat e veta dhe e dinte se në luftë do të armatosej, do të luftonte. Ai preferonte vdekjen me nder se sa nënshtrimin, turpin dhe tradhëtinë. Kështu shpjegohet heroizmi i Ali Demit, i Mitatit e i Lefit, i Teli Ndinit, i Shyqri Alimerkos, i Beqir Selimit, i Qamil Asllanit, i Resul Veliut, i Musa Ramos, i Ismail Azizit, i Qani Nuredinit, i Hajredin Beqarit, i Kastriot Muços, i Bako Tafilit, i Rrapo Hasimit, i Sefer Shanos, i Hysen Çinos, i Damën Xhelos, i Sadik Zotos dhe i qindra të tjera.

Krijimi i Çetës së parë Plakë të Vlorës më 3 nëntor 1942 do të jetë një datë e paharrueshme në historinë e luftës së popullit të krahinave tuaja. Kjo çetë një ditë më vonë shpartalloi afro 70 veta këmishëzëz në Urën e Gjormit, të cilët kthehenëshin me mburrje për krimet dhe plaçkitjet që kishin bërë në kasollet tona. Lufta juaj e vazhdueshme e tronditi rëndë armikun, prandaj tradhëtarët e vendit tonë Qazim Koculi, Halil Alija, Hysni Lepenica, Skënder Muço, grumbulluan reaksionarët për të përçarë Frontin tonë, që ka qenë dhe është organizatë e madhe masash, e udhëhequr nga Partia. Armiqtë deshën ta përçanin e ta shpartallonin Frontin, por nuk mundën, sepse Fronti ishit ju dhe lufta juaj u bë më e ashpër, më e fortë dhe Selenica, Penkova, Drashovica, Shushica, Plloça, Luarthi, Gjormi, Tragjasi, Velça, Ramica, Brataj, Vranishti, Çeprati, Kallarati, Shëngjergji, etj., u bënë kala të pathyeshme të luftës suaj kundër operacioneve fashiste. Ju, si gjithë populli shqiptar, me

Iuftën e paprerë e të ashpër kundër fashistëve italianë dhatë një kontribut të madh për mposhtjen e tyre. Italia fashiste u detyrua të hedhë poshtë armët, të kapitullojë.

Por qëllimi kryesor ishte të mposhtej Gjermania, në të cilën mbështeteshin forcat e errësirës. Kjo ishte hallka kryesore, ku qenë lidhur të tërë forcat reaksionare. Por, po të mos ishte Ushtria e Kuqe, vaj hallit për të gjithë popujt liridashës.

Lufta këtu ishte e madhe dhe çdo ditë bëhej më e ashpër kundër okupatorëve nazistë gjermanë, por atje në fushat e Bashkimit Sovjetik, ku luftonte Ushtria e Kuqe heroike, luhej fati ynë dhe i gjithë popujve liridashës. Ushtria e Kuqe i dha dërmën fashizmit, ajo doli fitimtare dhe ngriti flamurin e saj mbi Berlin.

Ushtria e Kuqe fitoi, sepse atë e drejtonte udhëheqësi i madh i proletariatit botëror, Stalini.

Pas luftës ne na viheshin detyra shumë të mëdha. Ne ju vumë punës me të gjitha forcat tona dhe brenda pak kohe arritëm rezultate të mëdha. U ndreqën rrugët, urat, u rindërtuan minierat, fabrikat, etj. U ndreq Kuçova që sot prodhon më tepër se në kohën e Zogut e të okupacionit fashist. Ju e keni parë minierën e Selenicës. Ajo e ka dyfishuar prodhimin e saj. Kjo gjë s'ndodhi as në kohën e Zogut dhe as në kohën kur italianët ishin në kulmin e fuqisë së tyre. Ne i ndërtuam të gjitha, pa maqina, me kazma dhe me lopata të prishura, po i ndërtuam, pse kishim vullnet të madh.

Bujqësia mori një hov të madh, pse populli që mori fuqinë në dorë, ua mori edhe tokën atyre, që vjete me radhë shfrytëzonin djersën tuaj dhe qeveria jua dha fshatarëve. Kjo është arësyja, për të cilën bujqësia

mori një hov më të madh dhe do të përparojë më shumë, pse fshatarët tani punojnë për veten e tyre e jo për beun e aganë, dhe është e natyrshme, që kush punon për vete, punon me tërë vullnetin e tij, me tërë forcën e tij dhe më mirë.

Kështu pushteti ynë po bëhet gjithnjë më i fortë. Por çështja që ka një rëndësi të madhe është ajo e kë-shillave. Këto janë qeveria juaj. Sa më i mirë të jetë këshilli, aq më mirë dhe më mbarë do të na shkojnë punët. Të keni kujdesin që në këshillat të zgjidhen njerëz të ndershëm, njerëz që u dhimbset populli, njerëz të vendosur për popullin.

Çfarë do të bëjë p.sh. qeveria në qendër, kur dërgon kripën, vajgurin dhe ndodh ndonjë njeri i keq që mund ta ndajë me hatëre? Gjëra të tilla nuk mund t'i lejojmë kurrë, në asnjë mënyrë. Këtu duhet të jenë njerëz të ndërgjegjshëm dhe të drejtë, që të ndihmojnë popullin, ta duan e të punojnë për të, të kenë sytë hapët dhe t'u lidhin duart atyre, që punojnë kundër interesave të popullit e kundër pushtetit të tij.

Ne kemi pasur suksese të mëdha, por ne nuk jemi nga ata që themi se mjaft kemi bërë dhe të kënaqemi me pak kile grurë, me pak kile misër dhe me pesë kokë bagëti. Ne duam që jeta jonë të shkojë më përpara, të përmirësohet gjendja e popullit, të përmirësohet gjendja juaj ekonomike, pse po të jeni ju ekonomikisht mirë dhe jeta bëhet më e mirë për të tërë.

Por kjo nuk do të zbresë nga qiejt, po do të vijë me punën tonë dhe me një plan.

Për çështjen e bujqësisë dhe të blegtorisë, qeveria në radhë të parë do të interesohet që t'u japë fshatarëve

mjete moderne që, me më pak kohë, do të prodrojnë më shumë; ajo do t'u japë plehra dhe çdo ndihmë tjetër në bujqësi; do të fillojnë bonifikimet me plan. Çështja e kanaleve ka rëndësi, pse kështu do të përmirësohet toka e puna. Është e vërtetë se janë hapur shumë toka dhe bagëtia ka mbetur ngushtë, por do të krijohen dhe kullota, pse nuk mund të shkojë përpara bujqësia pa blegtorianë.

Krahas me bujqësinë e blegtorianë shkojnë edhe minierat. Nafta, vajguri, sera, janë si gjaku i trupit dhe po s'eci gjaku, trupi mbaron. Prandaj ne do t'i vëmë rëndësi të madhe këtij sektori në mënyrë që minierat të jatin sa më shumë e të kemi jo vetëm përvete, por edhe për të nxjerrë jashtë, që kështu të plotësojmë nevojat e tjera.

Po kështu do të zhvillohet edhe kultura e arësimi. Ne kemi qenë të paditur, pse kështu na kanë lënë armiqjtë. Pa mësim, pa shkollë nuk bëhet gjë. Më përpara mësonin vetëm djemtë e agallarëve dhe të bejlerëve. Ata u përpoqën që populli të mos mësonte, pse po të mësonte, do të bëhej rrezik për bejlerët dhe agallarët. Ata mësonin vetëm djemtë e tyre për të shtypur popullin. Por koha e tyre kaloi. Tani është koha që të mësojnë djemtë tuaj, se ata janë besnikë. Kalamanët tuaj duhet të venë në shkollë, qofshin djem ose çupa.

Edhe ti xhaxho¹ duhet të mësosh të shkruash e të këndosh, pse kështu do të duketjeta më e mirë, do të kënaqesh kur të këndosh në libër historinë e djalit tënd, që është vrarë në luftë për çlirimin e atdheut.

¹ Shoku Enver Hoxha i drejtohet një fshatari plak.

Grekët kërcënojnë popullin tonë, kërkojnë Korçën e Gjirokastrën, por të gjitha përpjekjet e tyre do të dështojnë. Reaksiuni po mundohet të rimëkëmbë fashizmin për të hapur një luftë tjetër. Por ne nuk duam më një luftë tjetër. Bashkimi Sovjetik qëndron në ballë kundër atyre që duan luftë. Ai po përpinqet të mos derdhet më gjak dhe ne jemi me Bashkimin Sovjetik.

Popull i krahinave të Vlorës,

Ashtu sikundër Partia ka pasur besim në luftë, ka edhe tani besim qind për qind te ju se, të grumbulluar rreth Frontit Demokratik, ju do t'i përvisheni punës për të ndërtuar kasollet tona, për të ngritur ekonominë e vendit.

Të rrojë pepulli i krahinave të Vlorës!

Të rrojë populli shqiptar!

Të rrojë Partia!

Të rrojë Ushtria Kombëtare!

Të rrojë Stalini i madh!

I paharruar qoftë kujtimi i dëshmorëve!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 861,
3 tetor 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 861,
3 tetor 1947*

FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË KRAHINËS SË KURVELESHIT

2 tetor 1947

Motra dhe vëllezër të dashur të Kurveleshit heroik,
të Kurveleshit tonë të lavdishëm,

Në ditët më të zeza të historisë sonë, kur jeta e popullit tonë ishte në rrezik dhe ne kërcënoheshim të zhdukeshim nga një armik barbar, nga një armik i armatosur deri në dhëmbë, populli shqiptar u çua i gjithë më këmbë. Dhe në ballë të popullit shqiptar u çuan burrat e Kurveleshit, u çuan gratë e Kurveleshit për të mbrojtur atdheun, për të mbrojtur nderin, për të mbrojtur popullin.

Lavdi popullit heroik të Kurveleshit!

Kur flitej për luftë, kur flitej për sakrifika, kur flitej për heroizma, kurveleshasit qëndronin në ballë. Gjaku i djemve të tij, gjaku i çupave të tij u derdh pa kursyer. Ata ishin atje ku rreziku ishte më i madh. Atje ku duhej guxim, atje ku duheshin mbajtur istikamet, atje ishin djemtë e Kurveleshit, atje ishin çupat e Kurveleshit.

Kur u krijua Partia jonë Komuniste, ajo u dha ur-

dhër anëtarëve të saj të shkonin në malet e Kurveleshit të bisedonin me popullin e Kurveleshit, t'i thonin atij të çohej me armë në dorë për të shpëtuar atdheun. Partia kishte bindje se Kurveleshi do të bëhej nga qendrat më të forta të saj dhe me të vërtetë ashtu u bë. Kurveleshi dhe gjithë populli shqiptar u fut në një luftë të ashpër. Ne nuk ju përkulëm as vrasjeve, as djegjeve, as terrorit, por rrokëm armët që në ditët e para, rezistuan me vullnetin më të madh. Ne ishim një popull i vogël, por i fortë, vullneti ynë ishte i çelniktë. Shumë nga ata tradhëtarë, të cilët e kishin rjepur dhe e kishin shitur popullin, në fillim të luftës talleshin me ne e thoshnin: «Këta njerëz janë të marrë, a luftohet me gjithë këtë shtet?» Ku e kishin qëllimin këta? Këta kishin për qëllim që populli shqiptar të mos rrokte armët, të lidhëte duart, të shtypej, të skllavërohej nga fashistët italianë, se kështhu fashistët italianë do të plotësonin qëllimin e tyre. Ata jo vetëm do të robëronin Shqipërinë por krejt Ballkanin. Ishin këta tradhëtarë, nga shtëpitë e bejlerëve, nga shtëpitë e agallarëve, nga shtëpitë e njerëzve më reaksionarë, si Ismail Golemi, Veip Runa, Zenel Gjoleka, që tërë jetën e tyre kishin bërë dallaverc, tërë jetën e kishin vënë në shërbim të atyre që shtypnin popullin shqiptar e i pinin gjakun. Pra ishin po këta njerëz që e këshillonin popullin se nuk duhej luftuar dhe këto i thoshnin, sepse ata kishin lidhur fatin e tyre me Italinë dhe mbrojnë njëkohësisht oxhakun e tyre, forcën e tyre politike, forcën e tyre ekonomike, pasuritë e tyre të fituara mbi kurrizin e popullit. Këta e dinin se fitorja e popullit do të zhdukte forcën e tyre, prandaj këshillonin që populli të mos luftonte. Mirëpo populli nuk i dëgjoi këta

tradhëtarë, se i dinte kush ishin, i kishte njohur denbabaden. Këta tradhëtarë për të organizuar më mirë luftën kundër nesh, kundër Partisë që udhëhiqte popullin në fitore, për të na luftuar më mirë, formuan organizatën e «Ballit Kombëtar», organizatën e «Legalitetit» dhe shumë organizata të tjera tradhëtare. Këto organizata që u krijuan nga okupatori dhe që kishin në krye njerëz si Ali Këlcyrë, Zenel Gjoleka etj., mbronin interesat e tyre. Këta hodhën parulla nacionaliste mashtruese duke thënë se gjoja këtyre u dhimbsej populli, kurse neve, djemve tuaj, jo. Këta filluan një propagandë të ashpër kundër Partisë Komuniste. Këtu e kishin qëllimin, se Partia Komuniste ishte ajo që udhëhiqte popullin në fitore. Ç'ishte Partia jonë? Partia jonë ishte Partia e popullit, ishte Partia e djemve tuaj më trima, më të guximshëm e më të vuajtur që mbanin mbi supet e tyre mjerimin shekullor dhe këta djem u bashkuan dhe udhëhoqën popullin.

Kundër Partisë ata hodhën parullat më të poshtra. Ata i quanin komunistët të shitur. Dhe kush i quante? Ata që ishin shitur kokë e këmbë, ata që kishin shitur nderin, që kishin shitur atdheun; ata i quanin komunistët imoralë se gjoja martoheshin vëlla me motër etj. Kurse ju e dini mirë se ç'ishin komunistët: ishin djemtë tuaj më të mirë, djemtë tuaj më të ndershëm. Gjithë këto cilësime që kërkonin të na vinin tradhëtarët, kishin për qëllim të izolonin Partinë Komuniste nga populli dhe populli të ndiqte këta myteberë që do ta çonin në greminë. Mirëpo, ishte e natyrshme: populli nuk mund t'i ndiqte këta njerëz, këta tradhëtarë. Demagogjia e tyre, fjalët e bukura që thanë në fillim, nuk do të pinin ujë. Populli i shihte këta njerëz që bridhnin nga

një orë maleve për të vjedhur ndonjë pulë. Populli u tha këtyre: «Ku veni? A keni dalë për të luftuar, apo për të vjedhur pula? Ja këtej, ja andej». Këta e hoqën maskën dhe vanë ku ishte armiku, u bënë vegël e okupatorëve.

Besimi i popullit dhe forcat e popullit u shtuan, u shumëfishuan, u krijuan çeta, u krijuan batalione, u krijuan brigada, u krijuua ushtria jonë heroike.

Prej kujt është e formuar kjo ushtri? Prej djemve tuaj, prej jush. Kush e udhëhiqte këtë ushtri? Djemtë tuaj. Kush ishin këta? Ata që rrithnin hekurin, ata që ruanin lopët, ata që ruanin dhentë, ata që ruanin dhitë u bënë udhëheqës njëqind herë më të fortë se gjermanët e italianët che i mundën. Ushtria jonë me forcat e veta çlroi atdheun, i dha popullit lirinë dhe pavarësinë, ja siguroi këto për jetë, pse pavarësia e liria e popullit tonë gjatë kohës së vjetër ishin shkelur.

Baballarët tuaj kanë luftuar edhe herë të tjera kundër Italisë në Vlorë, kundër grekëve, por ç'ka ngjarë atëhere? Fuqinë ja kanë rrëmbyer nga duart popullit të tjerët, me njëmijë dallavere, gjoja se ata ishin të mësuar në jetën politike. Gjakun e derdhët ju dhe fuqinë e morën të tjerët, bejlerët; por këtë herë nuk do të ngjiste më kështu. Shkoi koha e vjetër. Populli, kur rroku armët, i tha vetes se do të bëjë një luftë për dy qëllime: për të çliruar atdheun nga okupatorët dhe për të zhdukur përgjithmonë të gjithë ata që i kishin shkaktuar fatkeqësinë e tij, të gjithë bejlerët, agallarët, gjithë reaktionarët, për të marrë vetë në dorë fuqinë dhe për të drejtuar. Edhe kështu bëri. Fuqia sot është në duart e popullit edhe për këtë fitore të madhe Kurveleshi ka

dhënë kontributin e tij të çmuar. Kurveleshi ka luftuar kudo kundër italianëve, gjermanëve e ballistëve. Kurveleshi u bë kala e çelniktë, ku armiku theu qafën e ku djemtë partizanë priteshin me krahëhapët. Që nga kalamani e deri te plaku, kanë luftuar. Ata u çonin partizanëve bukë nga buka e tyre dhe municion. Kurveleshi i ka dhënë qeverisë sonë dhe do t'i japë Shqipërisë djem të zot që të drejtojnë punët, që të drejtojnë ushtrinë, që të drejtojnë pushtetin tonë, pushtetin popullor. Pushteti popullor, qeveria, Partia, unë dhe i gjithë populli kemi besim të patundur se Kurveleshi që i dha atdheut, që i dha Shqipërisë Heroin e Popullit Asim Zenelin, që i dha Shqipërisë trima si Memo Meton e Mustafa Matohitin, do t'i japë vendit tonë edhe trima të tjerë.

I lavdishëm dhe i përjetshëm të jetë kujtimi i Heroit të Popullit, Asim Zenelit, i Memo Metos, i Mustafa Matohitit, i Dervish Aliut, i Mitat Gjolikut, i Mumin Kallaratit, i Musa Brahos, i Seit Abazit dhe i qindra e qindra të tjerëve të panumërt, por heroikë (*populli thërrret: «do të ndjekim rrugën e tyre»*). Po, mirë thoni ju, mirë thotë populli dhe rinia heroike, se ne duhet të ndjekim rrugën e dëshmorëve, të trimave, të vëllezërve e të motrave tona — ta ndjekim këtë rrugë me besnikërinë më të madhe. Ata dhanë gjakun e tyre, ne duhet të vëmë gjithë forcat tona për të ndërtuar atdheun që ata e donin si shpirtin e tyre. Shqipëria sot është e lirë, tani populli është në fuqi dhe pushtetin e ka në duart e tij.

Ju e keni parë, ju e dini fare mirë se armiku na dogji kasollet, na dogji shtëpitë, na prishi rrugët, na

prishi fabrikat, na shkatërrroi bujqësinë tonë. Pas luf-tës ne gjendeshim në një hall të madh, por në momen-tet më të këqia ne nuk e humbëm shpresën. Kur çliruam Shqipërinë ne i thamë vetes se tani duhet ta ndërtoj-më me tërë fuqitë tona. As mjete kishim, as të holla kishim, por kishim një gjë, që kishte vlerë më të madhe nga floriri, më të madhe nga mjetet: vullnetin e pa-thyeshëm të popullit tonë, i cili i kaloi të gjitha pen-gesat dhe korri fitore të njëpasnjëshme. U ndreqën ura, u ndreqën rrugë, u ndreq një numër i madh shtëpish të djegura, u ndërtuan të gjitha kantieret e vajgurit, të serës së Selenicës, u ndërtuan të gjitha fabrikat që ishin shkatërruar, u ngritën shkolla në një numër shu-më më të madh se ç'ishin më përpara. Të gjitha këto u bënë në saje të popullit. Populli luftoi, që tani ai lë rrojë i lirë, të rrojë në paqe.

Një çështje kryesore ishte çështja e reformës ag-rare, e cila do t'i jepte katundarëve tokën që ishte e ty-rja, pse ata kishin derdhur djersën gjysh pas gjyshi. Dhe reforma agrare u bë. Katundari mori tokën që i përkiste. Por të gjitha këto s'ishin të mjafta. Qeveria jonë, qeveria e popullit i ka vënë detyrë vetes që të mos qëndrojë kurrë në një vend, por të ecë kurdoherë për-para si në bujqësi, ashtu edhe në industri, në arësim e në kulturë. Për të gjitha këto gjëra populli e qeveria në krye do të vënë të gjitha forcat e tyre. Për bujqësinë tani që ju dha toka katundarëve, qeveria do të marrë një sërë masash të tjera që do ta bëjnë tokën më pro-dhuese, të japë më shumë dhe më mirë, që bujku ynë të përmirësojë gjendjen ekonomike, të rrojë si njeri dhe njëkohësisht të përmirësohet gjendja e gjithë popullit.

Qeveria do të hapë kanale kulluese, kanale vaditëse, do të hapë toka të reja, do t'i japë kredi bujkut që të shtojë bujqësinë, të shtojë kafshët e trasha e të imta. Gjithashtu qeveria do të përpinqet dhe ka marrë masa që bujqësia të modernizohet.

Nga ana tjetër qeveria ka filluar ndreqjen e hekurudhës. Në planet e ardhshme do të ndërtohen 3-4 udhë të tillë që do të lidhin qytetet dhe fshatrat. Kjo ka një rëndësi të madhe se jo vetëm do të lehtësojë shumë komunikacionin me fshatrat dhe me qytetet, por gjëja më kryesore është se hekurudha do të ndihmojë për shfrytëzimin e pasurive të nëntokës, shfrytëzimin e minierave, pasuri të mëdha këto në vendin tonë. Këto pasuri janë nafta, kromi, sera, hekuri, bakri, etj. Me këto ne do të bëjmë që vendi ynë të pasurohet dhe kjo pasuri do të shërbejë për të mirën e popullit e për asgjë tjetër.

Një detyrë tjetër që i ka vënë qeveria vetes, është çështja e kulturës, çështja e shkollës. Shkolla ka një rëndësi të madhe, ajo i hap sytë njeriut, ajo i zhvillon mendjen e ndihmon të punojë më mirë, dhe të prodhjë më shumë. Kjo është rëndësia e shkollës. Në shkolla në radhë të parë do të mësojnë djemtë e popullit, djemtë tuaj, djemtë e katundarëve. Vetëm ata do të marrin frenat e pushtetit në duar.

Interesin e popullit nuk mund ta shohin ata që u gjykuant në Tiranë, tradhëtarët, të shiturit te amerikanët, te anglezët, te fashistët grekë. Reaksioni ndërkombëtar me reaksionin amerikan në krye, përpinqet me të gjitha forcat e tij të preqatitë një luftë tjetër, sepse ai e sheh që pozitat e tij dominuese, po tronditen nga poptuq që kanë vendosur demokracinë popullore. Ai bën

çdo orvatje, ai shpif, ai thur intriga, ai nxit reaksionin e çdo vendi që të ngrihet kundër këtyre pushteteve popullore. Po këtë gjë bën ai edhe në vendin tonë. Të gjithë tradhëtarët, që u gjykuar në Tiranë dhe që morën dënimin e merituar, ishin të organizuar nën urdhërat direkte të agjentëve dhe të spiunëve në shërbim të amerikanëve. Këta kishin në program të bënин atentate, të bënин sabotazhe, të rrëzonin pushtetin e popullit me forcë, dhe kishin arritur të bënин disa sabotazhe, por vigjilanca e pushtetit, forca e popullit nuk i la të arrinin qëllimin e tyre, i kapi, ja dorëzoi drejtësisë, e cila u dha dënimin e merituar. Po në këtë mënyrë do të dështojnë të gjitha tentativat e këtyre njerëzve. Këta nuk mund t'ja arrijnë kurrë qëllimit të tyre, sepse populli i ka sytë katër dhe ruan. Prandaj unë them që bijtë tuaj duhet të venë të mësojnë në shkolla që ata të dalin oficerë, inxhinierë, doktorë, agronomë e të qërohen fare e përgjithmonë ferrat e gjëmbat që kanë mbetur. Mos të ketë më në ushtrinë tonë oficerë të vjetër që kanë qenë brez pas brezi tradhëtarë, por atje të jenë djemtë tuaj, djem të popullit. Të mos ketë më doktorë dhe inxhinierë nga bejlerët e Fierit dhe nga ata të Klosit, po të ketë nga djemtë tuaj, se djemtë tuaj kanë treguar aftësi dhe janë më të zot. Ne shohim nëpër shkollat ushtarake e në shkollat e tjera se djemtë e Labërisë s'janë vetëm udhëheqës, s'janë vetëm ushtarë të lavdishëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, s'janë vetëm për të punuar tokën, për të ruajtur bagëtitë, por janë njerëz që përvetësojnë edhe kulturën. Prandaj shkollat duhet të ndiqen me kujdesin më të madh, se kjo është në interes të popullit dhe në interesin tuaj.

Motra dhe vëllezër të Kurveleshit,

Ju e dini dhe e keni në zemër se në këtë luftë të madhe që bëri populli shqiptar si edhe në këtë fazë të rindërtimit ai u ndihmua me gjithë forcat, me gjithë shpirt nga Bashkimi i madh Sovjetik, nga Ushtria e lavdishme e Kuqe e udhëhequr nga Stalini i madh. Djemtë e popullit shqiptar, djemtë tuaj, shpirti juaj, kur vriteshin në këto gërxhe, këndonin lavdinë e Stalinit të madh. Ç'thoshnin tradhëtarët për ne? «Këta janë të shitur te Stalini». Jo, ne ishim aleatë me Stalinin edhe ne e dinim se ç'bënim. Djemtë tuaj kur binin në këto gërxhe e dinin se fati i Shqipërisë luhej atje, në Rusi. Në saje të ndihmës së Ushtrisë së Kuqe do të shpëtonte gjithë njerëzimi nga barbarizmi fashist e nazist, prandaj populli ynë brohorit për Bashkimin Sovjetik dhe për Stalinin e madh.

Prandaj me punën tonë, në rrugën tonë paqësore e ndërtimitare ne duhet të forcojmë sa më shumë bashkimin ndërmjet nesh, bashkimin politik e bashkimin ekonomik të gjithë shtresave të ndershme të popullit tonë dhe këto forca t'i koordinojmë si duhet; fshatarësia me gjithë masat e qytetit duhet të lidhet ngushtë. Që të mund të realizojmë këtë duhet të zbatojmë edhe ligjet e urdhëresat. Këto duhet të kuptohen dhe të zbatohen mirë, se dalin nga populli, pse janë në interes të popullit. Çdo gjë që bëhet në vendin tonë, nuk bëhet kurrë në disfavorin e popullit. Që të kuptohen mirë këto gjëra duhet të bëhet një punë e mirë politike. Ju bëtë luftën pse e kuptuat dhe luftuat deri në fund. Ligjet dhe urdhëresat, po t'i kuptioni mirë, po të kuptioni thelbin e

tyre, do të jeni mbrojtësit më të fortë se janë për ju dhe në interesin tuaj.

Në rrugën tonë të drejtë, s'kemi frikë nga askurrikush, as nga armiqtë e brendshëm, as nga armiqtë e jashtëm. Ne kemi një pushtet të fortë e demokratik, të cilin do ta mbrojmë dhe do ta forcojmë. Populli i Kurveleshit, sikurse qe në luftë i pari, do të jetë kurdoherë në ballë të luftës për rindërtim.

Rroftë populli heroik i Kurveleshit!

Rroftë Republika Popullore!

Rroftë ushtria jonë e lavdishme!

Rroftë Partia jonë heroike!

Rroftë Fronti Demokratik!

Rroftë Stalini i madh!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 862,*

4 tetor 1947

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetiës «Bashkimi», Nr. 862,*

4 tetor 1947

FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË GJIROKASTRËS

3 tector 1947

Të dashura mëma, motra dhe vëllezër të Gjirokastrës,

Lufta e tmerrshme kundër okupatorëve italianë dhe gjermanë më ndau për shumë kohë nga qyteti im, ku kam lindur dhe jam rritur, ku kam marrë mësimet e mia të para, ku kam jetuar vegjelinë time me gëzimet, hidhërimet dhe shpresat e saj, ku është formuar karakteri dhe ndërgjegjja ime, ku, si të gjithë djemtë e thjeshtë të këtij qyteti heroik, më ishte rrënjosur në zemër dashuria për atdheun dhe për popullin tonë të shumëvuajtur.

Lufta më kishte ndarë nga ju, por zemra ime, shpirti im ishte me ju. Qyteti im i dashur, ku kam lindur, ju kaldrëme me gurë, dhe ju shtëpi të vjetra me dërrasa, që keni qenë gjithë bota ime dhe gëzimi im i kohës së vegjelisë, ju mëma plaka, motra dhe vëllezër të Gjirokastrës, që më keni rritur, që më keni këshilluar, që më keni qortuar dhe gëzuar kur kam qenë i ri, një mall i madh më kishte marrë për ju dhe sot jam thellësisht i emocionuar nga gëzimi që ndjej.

Qyteti im i dashur, ku kam lindur, është e vërtetë se të shoh për herë të parë, pas kaq vjet lufte të madhe, ku luhej e ardhmja dhe fati i popullit tonë, por ti ke qenë në çdo kohë në zemrën dhe në mendjen time. Lufta jote heroike e çlirimt ishte për mua model i shkëlqyer, ishte shembulli që duhej të ndiqja deri në vdekje, si djali yt që isha.

Edhe unë, tok me popullin tonë trim, u përpoqa me gjithë fuqitë e mia për çlirimin e atdheut tonë të dashur. Edhe unë, me gjithë popullin tonë heroik, luftova për të fituar lirinë, pavarësinë, sovranitetin e Shqipërisë. Unë s'bëra veçse detyrën time, që më ngarkonte atdheu dhe populli, si çdo qytetari të ndershëm të Shqipërisë, ndër momentet më kritike nga ku kalonte kombi ynë dhe gjithë njerëzimi. Qyteti im i dashur, ku kam lindur, të jam mirënlohës përjetë, pse ti më rrite, ti më mësove, ti më dhe forcë të kryej detyrën ndaj atdheut dhe të luftoj për fitoren e atyre që shtypeshin, e atyre që vuanin nga mjerimet dhe nga uria.

Tërë jetën, populli ynë ka vuajtur dhe ka luftuar trimërisht, për t'u çliruar nga zgjedha e shtypësve të ndryshëm. Vendi ynë i vogël ka qenë kurdoherë një plaçkë tregu për fuqitë e huaja imperialiste, të cilat na vrisnin, na gjakosnin, na copëtonin, na shisnin ndër ata që ua donte interes i tyre. Këto shtete të mëdha imperialiste, që kanë pasur dhe kanë akoma, pas kaq luftërash dhe revolucionesh, në programin e tyre shtypjen dhe skllavërimin e popujve, kolonizimin dhe shfrytëzimin e tyre në një mënyrë të pamëshirshme, në interesin e kapitalistëve dhe të monopolistëve gjakpirës, si mundet të interesoheshin me të vërtetë për lirinë e një

populli të vogël, sikundërqë ishte populli ynë? Ngjarjet e historisë e tregojnë qartë veprimtarinë shtypëse të këtyre shteteve, historia dhe ngjarjet e luftës së fundit vënë mirë në dukje vazhdimesinë e qëllimeve grabitëse të këtyre shteteve. Tani, në kohën e pasluftës së dytë botërore, në të cilën u vranë me miliona njerëz, u derdh gjaku rrëke dhe u shkatërrua tmerrësisht bota, ne shohim se si reaksiioni ndërkontebtar, me në krye anglo-amerikanët, po përpinqet të preqatitë një luftë të tretë botërore. Sikundërqë e shihni, ujqërit qëndrojnë kurdoherë ujqër dhe gati të sulmojnë.

Ujqërit fashistë italianë dhe gjermanë, të mahur dhe të nxitur nga imperializmi botëror, sulmuan Evropën; këta më 7 prill 1939 sulmuan edhe popullin tonë. Në prakun e tragjedisë së 7 prillit vendi ynë u ndodh në mjerimin më të madh. Në krye të vendit u gjend një mbret gjakpirës dhe satrap, kusar me çizme, feudal, shtypës i popullit tonë dhe i çdo ideje përparimtare dhe antifashiste. Ahmet Zogu, i rrethuar nga klika e tij prej banditësh, e kish bërë vendin tonë një çiflik të madh të tij, kurse popullin e ripte dhe e vriste pa mëshirë. Një jetë e rëndë mbretëronte në vendin tonë të vogël. Vendit ynë, nën regjimin e Zogut, nuk ishte i pavarrur përveçse në formë. Këtu mbretëronin agjentët fashistë të Musolini, të cilëve Zogu u kish shitur vendin tonë, pasuritë e vendit tonë, sekretet e shtetit tonë. Zogu me klikër e tij bashkëpunuan me ndërgjegje të plotë për të preqatitur robërimin e popullit tonë nga italianët. Dhe përfundimi logjik i këtij regjimi ishte okupimi i Shqipërisë, që filloi më 7 prill. Përballë një armiku të egër, të armatosur deri në dhëmbë, populli ynë duhej të

zgjidhte vetë rrugën: o t'i gjunjëzohej okupatorit, ose të luftonte. Rruga e luftës ishte rruga e shpëtimit, populli ynë kurrë nuk ishte mësuar të rronte në gjunjë, prandaj pa hezituar asnjë minutë ai zgjodhi rrugën e luftës, rrugën e nderit.

Motra dhe vëllezër të Gjirokastrës,

Vendimi që mori populli ynë ishte i shenjtë dhe nga më të rëndët; kurrë në historinë e tij populli ynë nuk ka pasur përballë tij një armik kaq të egër dhe kaq barbar. Prandaj sakrificat do të ishin shumë të rënda. Vetëm popujt e fortë mund t'i rezistonin këtij rrebeshi të madh të armikut, i cili jo vetëm kishte superioritet dërmues në njerëz, në armë dhe në municione, por kishte arritur të preqatiste që me kohë dhe fushën këtu brenda me anën e kolonës së pestë, e cila përbëhej prej njerëzve të Zogut. Populli ynë, pra, duhej të përballonte një-kohësisht okupatorin dhe veglat e tij të brendshme, tradhëtarët dhe kuislingët. Lufta që fillonte ishte luftë për jetë a për vdekje. Për të kuptuar më mirë sa i fortë ka qenë populli ynë, sa trimëri dhe sa vetëmohim ka treguar, sa i drejtë dhe i vendosur ka qenë në të gjitha veprimet e tij dhe sa e ka merituar që të rrojë i lirë dhe të vetëqeveriset, në vendin e tij indipendent e sovran, le të hedhim sytë prapa, në të shkuarën e afërme, për të parë më mirë sa përpjekje janë dashur, sa gjak është derdhur, sa rrënime ka pësuar vendi ynë. Ju e dini vetë, shokë dhe shoqe të mi, pse tok kemi luftuar, se fillimi ka qenë mjaft i zorshëm nga një pikëpamje: çështja e udhëheqjes së luftës. Shtresat e gjera të popullit tonë

e urrenin okupatorin me të gjitha forcat e shpirtit të tyre. Në prakun e sulmit fashist mbi Shqipërinë në të katër anët e Shqipërisë shpërthyen demonstratat; në portet tona u gjakosën ushtarët e Musolinit; filloj rezistenca pasive, grevat në qytete dhe në shkolla, por këto nuk mjaftonin.

Çështja ishte që rezistenca duhej mbajtur gjallë, duhej shtuar dita-ditës, ajo duhej organizuar dhe duhej shndërruar në kryengritje të përgjithshme dhe në luftë të armatosur kundër okupatorëve e tradhëtarëve. Kjo nuk mund të bëhej pa një dorë të hekurt, pa një udhëheqje të shëndoshë, që të dilte nga gjiri i popullit të shumëvuanjtur, nga gjiri i popullit heroik, që kishte vendosur o të shuhej i téri, o të triumfonte. Të mos e harrojmë historinë e shkuar të popullit tonë. Populli ynë ka luftuar pa pushim, për liri, por, kur ka ardhur puna për të marrë fuqinë në duart e veta dhe për të gëzuar frytet e fitores, këto i janë rrëmbyer nga duart prej bejlerëve dhe politikanëve spiunë, të shitur te të huajt. Gjaku i popullit tonë, pra, ka shërbyer për të vendosur regjime që ai i urrente. Ata që dilnin me dallavere në ballë të këtyre luftërave, shumë shpejt e harronin popullin dhe premtimet që i kishin dhënë. Luftoi herokisht Çerçizi me shokët e tij për lirinë e Shqipërisë, por bejlerët, me Zogun në krye, e shkelën gjakun e tyre. Luftoi Avni Rustemi nga Libohova dhe Koto Hoxhi nga Qesorati me gjithë patriotët e tjerë të Shqipërisë, por të tjerë i korrën frytet e përpjekjeve të tyre. Pse ngjiste kjo? Shumë rrethana kishte që determinonin situata të tillë, por çështja kryesore ishte se nuk kishte bashkim të shëndoshë, se nuk kishte udhëheqje të shëndoshë, bes-

nike deri në vdekje për kauzën e popullit. Çerçizi me fshatarët luftonte në Mal të Gjerë dhe në Mashkullorë, por të tjerë përsitonin dhe bënин politikën që s'kishte asnjë lidhje me interesat e vërteta të popullit. Selam Musai me fshatarët sulmonte mbi Vlorë dhe i hidhte italianët në det, por të tjerë e bënин politikën, që s'kishte asnjë lidhje me interesat e vërteta të popullit dhe me qëllimet e fshatarëve dhe të patriotëve që derdhnin gjakun. Dhe kështu të tjerë vriteshin, të tjerë fitonin. Regjimi i Zogut dhe spiunët e Italisë ishin përpjekur që me çdo kusht populli ynë të humbiste çdo besim në forcat e veta, që kështu të mos ngrinte krye, por të bëhej raja dhe mish për top për Musolinin. Natyrisht, në fillim të okupacionit, populli ynë përpara tragjedisë së madhe të tij, ishte i çorientuar, por në asnjë moment i dekurajuar. Kjo ishte merita e popullit tonë. Në momentet më të kritikshme të historisë së tij ai s'u përgjunj, e mbajti kokën lart dhe gjeti rrugën, rrugën që do ta conte në fitore. Populli ynë pa që në fillim se çfarë tradhëtarësh të poshtër ishin një tok njerëzish që hiqeshin nacionalistë dhe patriotë. I pa përnjëherë, se ata u puqën me okupatorin, ata u bënë vegla të okupatorit. Këta pseudopatriotë, këta pseudointelektualë, këta bejlerë, që dje gjoja hiqeshin kundër Zogut dhe klikës së tij, këta s'ishin veçse njerëzit e Italisë dhe të Gjermanisë, të shitur kokë e këmbë te ata. Të tillë kanë qenë Ali Këlcyra, Bahri Omari, Rasim Babameto dhe të tjerë të këtij llumi. Jo, populli nuk do të lejonte më, që ai të vritej dhe të tjerë të fitonin dhe të vendosnin regjimin e tyre të urryer. Pra, populli që ishte gati të luftonte, kërkonte udhëheqjen dhe udhëheqja do të dilte nga zjarri i luftës,

udhëheqja do të përbëhej nga ajo pjesë e popullit që për popullin, për atdheun do të hidhej me trimëri në zjarr e në flakë. Dhe populli në luftën e tij nxori udhëheqjen më të lavdishme që ka parë historia e vendit tonë gjatë shekujve, Partinë e lavdishme Komuniste të Shqipërisë.

Formimi i Partisë Komuniste të Shqipërisë ishte agimi i fitores së madhe të popullit tonë, ishte siguria në organizimin e madh të luftës, ishte sigurimi i fitores së popullit mbi fashistët italo-gjermanë dhe mbi tradhëtarët. Pse ndodhët kështu? Ndodhët sepse Partia Komuniste ishte pjella më e denjë e popullit tonë, pse ajo përbëhej nga bijtë më të ndërgjegjshëm, më heroikë të popullit tonë të shumëvuanjtur, pse ajo përbëhej nga punëtorët më trima, nga katundarët e papërkulur, nga intelektualë patriotë. Të gjithë këta njerëz, që përbënë Partinë, kishin një parullë: «Vdekje Fashizmit-Liri Popullit». Interesat e popullit dhe të Partisë ishin një dhe të pandara. Partia luftonte për popullin me gjithë forcat e saja, pa asnje rezervë. Atje ku ishte rreziku më i madh, atje ku ishte lufta më e tmerrshme, atje ku derdhej gjaku më shumë, atje ishin njerëzit e Partisë, që binin në fushën e nderit për interesat e popullit dhe vetëm për interesat e popullit tonë. Prandaj populli ishte me Partinë, prandaj populli luftoi me aq heroizëm, se ai e krijoi vetë udhëheqjen e tij dhe e ndoqi udhëheqjen nëpërmjet furtunash, nëpërmjet luftërash të përgjakshme me besim të patundur.

Kjo ishte çështja kryesore, sikundërqë e përmenda edhe më lart. Udhëheqja tani ishte e siguruar. Populli i gjithë Shqipërisë u çua më këmbë, u çua vegjelia, u

çuan masat punonjëse që kishin vuajtur tërë jetën, që kishin luftuar me jetën, u çuan të shtypurit, u çuan të ndershmit, patriotët, për t'i dhënë fund njëherë e përgjithmonë shtypjes dhe skllavërimit. Epopeja e madhe e popullit tonë të vogël kishte filluar. Këtu u ndanë dhe lakrat. C'ishte fashizmi? Ai ishte diktatura më e egër e kapitalit, e krijuar prej këtij për të shtypur popullin, për të shtypur demokracinë, për të shtypur përparimin dhe për ta kthyer botën në kohën e mesjetës, ku të sundonte i plotfuqishëm kapitali dhe shfrytëzimi i njerëzve që punojnë të ishte në rendin e ditës. Kuptohet, pra, se fashizmi që na okupoi, kishte me vete edhe ndihmën e bejlerëve, të çiflikshabirinjve, të agallarëve dhe të tregëtarëve të mëdhenj, të pseudointelektualëve dhe të pseudodemokratëve, që me njëqind flamuj në xhep ishin në shërbim të plotë të fashizmit. Këtyre shtresave, natyrisht, s'u interesonte kurrsesi që populli të ngrihej në luftë kundër okupatorit, pse një gjë e tillë vinte në rrezik pasuritë e tyre, çifliqet e tyre, floririn e tyre. Këto shtresa pasanikësh, ishin, pra, në luftë me popullin dhe të lidhur ngushtë me fashistët italo-gjermanë, që na okuponin. Okupatori kishte interes që populli të mos ngrinte krye, që kështu ta milte më mirë. Në qoftë se ja arrinte këtij qëllimi, punët shkonin mirë edhe për atë edhe për miqtë e tij, tradhëtarët shqiptarë. Por punët nuk shkuan në këtë rrugë. Me organizimin e luftës së popullit filloi edhe organizimi i tradhëtisë nga ana e okupatorit. Tradhëtarët nën urdhërat direkt të okupatorëve u grumbulluan në organizatat tradhëtare «Balli Kombëtar», «Legaliteti», etj. Qëllimi i këtyre organizatave ka qenë vetëm të ndihmonin okupatorin në

shtypjen e Luftës nacional-çlirimtare dhe të popullit shqiptar. Këto organizata përfaqësonin interesat e reaksionit të brendshëm të Shqipërisë, interesat e bejlerëve, të agallarëve të pasur dhe spekulatorë. Pra, këta ishin në kundërshtim dhe në luftë me popullin shqiptar dhe me Frontin e tij Nacional-Çlirimtar. Shumë krerë të «Ballit Kombëtar» ishin demaskuar në popull për lodrën e tyre tradhëtarë, por kishte dhe nga ata që përpinqeshin të fshiheshin pas një demagogjie të ndytë dhe të përfitonin nga situata që ekzistonte në vendin tonë, dua të them nga influencat e vjetra, nga lidhjet familjare, nga injoranca që ekzistonte në vendin tonë, nga mungesa e një edukate politike të gjerë në masat e popullit tonë, etj. etj. Taktika e tradhëtarëve, e diktuar nga okupatori, synonte në shpartallimin e bashkimit të popullit shqiptar në Frontin Nacional-Çlirimtar dhe në dobësimin e shtypjen me gjak të Luftës nacional-çlirimtare. Bejlerët, tradhëtarët që prej Lumo Skëndos e Ali Këlcyrés, Mehdi Frashërit e Abaz Kupit dhe qindra të tjera, që tërë jetën e tyre kanë qenë të shitur te okupatorët e huaj, mendonin se do ta hiqnin popullin nga hunda dhe do ta çonin ku të dëshironin ata. Për këta tradhëtarë, populli ekzistonte për të qenë i bindur dhe i përvlur nën diktatin e këtyre njerëzve dhe gjithë klasës së tyre të kapitalit. Populli për ta s'ishte përvëçse një masë e gjerë injorantësh, që duhet të punojë dhe të robitet vetëm për bejlerët dhe për agallarët dhe sa për «politikën e madhe» dhe fatin e atdheut, ishin të predestinuar ta bënin dhe ta rregullonin Mithat Beu, Ali Beu, Mehdi Beu dhe Zogu me Bazin e Canes. Por këta «politikanë të mëdhenj», ose më mirë pelivanë të mëdhenj, i bënë

hesapet pa popullin dhe nuk u feksi, si themi ne në Gjirokastër. Këta tradhëtarë e panë rrezikun e madh që u turrej; bota e tyre e vjetër po tronditej, po tronditeshin themelet e privilegjeve të tyre shekullore, po ngriheshin kodrat për të rrëzuar malet. Okupatori, tok me «Ballin Kombëtar», lëshoi hordhitë e tij në të katër anët e vendit, për të përballuar situatën që bëhej dita-ditës e kritikshme për ta. Okupatorët dhe tradhëtarët duhej të goditnin udhëheqjen, ta izolonin udhëheqjen nga masat e gjera të popullit, pse ata e dinin mirë se vetëm kështu mund t'ja dilnin mbanë ndërmarrjes së tyre. Ishte puna me luftue pa mëshirë Partinë Komuniste, organizatoren e lavdishme të Frontit Nacional-Çlirimtar, organizatoren e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, organizatoren e fitores. I keni dëgjuar vetë, shokë e shoqe të Gjirokastrës, demagogjité dhe sharjet e turpshme, shpifjet që «Balli Kombëtar» dhe njerëzit e tij i bënин Partisë Komuniste. Ata ç'nuk kanë thënë, për të dobësuar Frontin dhe për të shtypur lëvizjen. Ata e kanë quajtur Frontin si maskën e Partisë Komuniste të Shqipërisë, ata e kanë paraqitur Partinë Komuniste dhe komunistët të shitur te Rusia, ata përpinqeshin t'i paraqisin komunistët si njerëz që shkatërronin familjen, si imoralë dhe që martohen vëllai me motrën dhe të tjera ndyrësi të tilla. Por populli ynë e dinte dhe i shihte vetë se kush ishin komunistët. Ata ishin djemtë e tij më të mirë, më të dashur, më të guximshëm. Tradhëtarët përpinqeshin ta dobësonin udhëheqjen, ta paraqisin sikur lufta jonë ishte «një luftë kalamajsh me njerëz të fandaksur, që s'dinë ç'bëjnë dhe s'dinë ku venë». Ne dinim mirë përsë luftonim dhe ku po shkonim. Këtë e

dinin dhe armiqtë tanë, por u leverdiste të flisnin ashtu.

Fronti Nacional-Çlirimtar, organizatë e gjerë politike e masave të popullit tonë, triumfoi përpara forcave italiane, gjermane, kuislinge dhe përpara organizatave tradhëtare të «Ballit Kombëtar», të «Legalitetit» dhe bandave të tyre. Asgjë s'mund të ndalonte forcën e madhe të popullit, që çante rrugën me trimëri të pashoqe nëpërmjet kaq pengesash, nëpërmjet kaq luftërash përtë fituar lirinë dhe pavarësinë. Ushtria e lavdishme Nacional-Çlirimtare, ushtria e popullit tonë, e formuar nga djemtë më të mirë të saj, e udhëhequr nga djemtë e thjeshtë të popullit që lanë punëtorinë, lanë arat, lanë bagëtitë, braktisën shkollat dhe rrokën pushkët, kjo ushtri e fortë si çeliku i theu njëren pas tjetrës ofensivat e italianëve dhe të gjermanëve. Kovaçët dhe hekurxhijtë tanë, barinjtë dhe bujqit tanë, i mundën gjeneralët fašistë gjermanë dhe italianë. Ne s'kishim armë dhe topa si gjermanët dhe italianët, ne na mungonin deri fishekët, ne ishim nëpër male, me bukë e pa bukë, pa këpucë në këmbë dhe pa guna në krahë, por ne e kishim zemrën top dhe asgjë s'mund të mposhte vullnetin tonë. Ne luftuam, ua rrëmbyem armët armiqve dhe i mundëm me armët e tyre. Kurrë nuk mund të thyhej vullneti i popullit tonë kur ai kish djem si Qemal Stafa, Asim Zeneli, Vojo Kushi, Ali Demi, Misto Mame, Koci Bako, Kajo Karafili, Perlat Rexhepi dhe qindra e mijëra të tjerë si këta heronj të popullit tonë. Si mund të mposhtej vullneti i popullit tonë, kur gjithë populli shqiptar u çua më këmbë me armë në dorë? U çua peshë Vlora, Korça, Tirana, Berati, Elbasani, Shkodra, u çove ti, Gjirokastër Plakë, Gjirokastra e Çerçizit, e Bajo Topullit, e Avni

Rustemit, e Koto Hoxhit, u çua Kurveleshi heroik i Asim Zenelit, i Memo Metos, i Mustafa Matohitet dhe i qindra e qindra dëshmorëve të tjerë. Gjirokastër, vendi im, vend që ke vuajtur të zezat e ullirit, që kurdoherë ke qenë në mëshirën e imperialistëve të huaj, të cilët kanë dashur të të bënин placët tregu, të të shisnin te greku, vend që ke parë kaq ditë të zeza, kaq okupacione të ndryshme, që ke vuajtur nga bombat e italianëve, nga tmerret e tyre, që ke vuajtur urinë dhe torturat në kohën e luftës italo-greke, që ke vuajtur nën thundrën e agallarëve gjakpirës, ti Gjirokastër ishe nga të parat që rroke armët dhe u hodhe pa rezerva në luftë. Që nga Kurveleshi dhe deri në Konispol, krisi pushka e popullit të shtypur të krahinës së Gjirokastrës, krisi pushka përliri. Më kot agallarët e Gjirokastrës dhe ideologët e tyre: Ali Këlcyrët, Bahri Omarët, Rasim Babametot, Beso Gegët, Vasil Shahinët, Aleks Çuçët e të tjerë u përpinqën të të përçanin, të futnin grindjen e vjetër musilimanë e të krishterë, shqiptarë dhe minoritarë. Të gjitha manevrat e tyre dështuan. Popull trim i Gjirokastrës, kurveleshas, gjirokastritë, zgoritë, dropullitë e të tjerë, që të gjithë ishit të bashkuar si një trup, ju ishit të vëllazëruar, ju ndiqnit një rrugë.

Për ju as nuk ka ekzistuar as nuk ekziston musiliman e i krishter, ju jeni bij të një mëmë, të Shqipërisë dhe ju luftoni përmëmën Shqipëri, përveten tuaj, përtë ardhmen e kalamajve tuaj. Por agallarët dhe arhondët e Gjirokastrës të shitur te Zogu, të shitur te fashistët grekë, ishin të parët që u shitën te italianët dhe te gjermanët. Kjo është afër mendjes. Për ta nuk ka ekzistuar kurrë çështja e atdheut dhe e popullit, për ta ekzistonte

vetëm paraja, pasuria, si ta ruanin këtë pasuri të grabitur dhe si ta shtonin në kurrizin e popullit fukara. Ç'i lidhte Sheraf Karagjozët dhe serselenët e tyre, Hasanajt, djemtë e Sami Kokalarit, Litajt, Çeçët, djemtë e Xhevdet Selfos, Xhevrat Kallajxhiun, etj. me popullin e kësaj krahine? Asgjë. Këta çifligarë dhe spekulatorë rronin vetëm për veten e tyre dhe për të pirë gjakun e popullit të krahinës, për të shtypur buqit e Dropullit, të Lunxhërisë e të Zagorisë, për të spekuluar dhe për të grabitur edhe dhjetëshin e fundit të fakir fukarasë. Si mundet këta njerëz të ishin me fakir fukaranë, që po rrokte armët për të luftuar okupatorin dhe për të vendosur drejtësinë dhe demokracinë në vendin tonë? Ata ishin matanë murit, ata ishin me armikun deri në fund dhe, natyrisht, ata bënë ç'mundën për të luftuar kundër popullit të kësaj krahine dhe kundër gjithë popullit të Shqipërisë. Por ata s'ja dolën dot mbanë, pse në krye të popullit dolën trima që organizuan luftën, dolën trima që derdhën gjakun pa kursyer për kauzën e popullit, pse çdo shtëpi e varfër e Gjirokastrës, çdo shtëpi patrioti e këtij qyteti, i gjithë Kurveleshi, kasolle më kasolle e gërxh më gërxh, pse malet dhe fshatrat e Lunxherisë dhe të Zagorisë, pse kasollet e katundarëve minoritarë, të lidhur ngushtë me kauzën e popullit shqiptar, pse Përmeti heroik, që u dogj tri herë nga lufta, u bënë çerdhet, u bënë kalatë e pamposhtura të popullit që luftonte me ashpërsinë më të madhe kundër fashizmit. Populli i kësaj krahine e ngriti lart e më lart flamurin e Luftës nacional-çlirimtare. Për vjete me radhë gjëmonin këto male nga pushka e partizanëve dhe armiku e pagoi shtrenjtë. Lufta juaj, popull i krahinës së Gjiro-

kastrës, ka qenë një nga faktorët kryesorë të fitores. Ju u dogjët, ju u vratë, ju u torturuat nga okupatorët, por ju, tok me gjithë popullin e Shqipërisë, çliruat atdheun dhe vendosët në Shqipëri regjimin e popullit, drejtësinë e popullit, regjimin dhe drejtësinë tuaj.

Lavdi popullit heroik të Gjirokastrës!

Lavdi të përjetshme heronjve të kësaj krahine, që ranë në fushën e nderit për çlirimin e Shqipërisë dhe të popullit!

Lavdi të përjetshme Asim Zenelit, Mustafa Matohit, Memo Metos, Mitat Gjolikut, Demo Fejzos, Abaz Shehut, Sofo Meksit, Çome Mandit, Myzafer Asqerit, Pertef Kokonës, Kapo Bacos, Isuf Omarit, Jonuz Çuçit, Muhamet Bakirit, Bule Naipit, Ago Topullit, Pano Xhamballos, Themo Vasit, Misto Mames, Mihal Durit, Theodhor Mastorës, Thanas Zikos, Lefter Talos, Gani Nivicës, Selfo Abedinit, Thoma Lulës, Pandeli Boçarit, Qirjako Dhrosos, Adem Shemes, Mitro Xhanit, Arshi Lengos, Peço Llukanit, Zenel Baboçit e qindra e qindra dëshmorëve të tjerë!

Shokë dhe shoqe gjirokastritë,

Fitorja u arrit e plotë në saje të gjakut që derdhë populli ynë, por fitoret e Luftës sonë të lavdishme nacional-çlirimtare duheshin ruajtur, duheshin forcuar e zhvilluar edhe ca më tej. Luftën e bëmë, gjakun e derdhëm, vendi ynë u dogj dhe u rrënuat që Shqipëria të ishte e lirë, që populli shqiptar të vetëqeverisej, që të vendosej në vendin tonë regjimi i popullit, ligji i drejtë i shumicës, ligji i popullit. Këto ishin qëllimet e luftës,

këtë rrugë duhej ta vazhdonim me vendosmërinë më të madhe dhe e vazhduam. Lufta jonë u dha fund përgjithmonë regjimeve të urryera të bejlerëve, të fajdexhinjve, të agallarëve e të spekulatorëve.

Programi i gjerë i qeverisë dhe i pushtetit popullor u përqafua dhe u zbatua me entuziazmin më të madh nga masat e gjera të popullit tonë. Kurrë s'është parë në historinë e vendit tonë të bëhet një mobilizim i tillë i popullit për rindërtimin. Pse ngjau kjo? Kjo ngjau, sepse populli luftoi për t'u çliruar, pse populli erdhi në fuqi, sepse Shqipëria tani është e tij dhe se populli e di që tani punon për veten e tij, për të ndërtuar jetën e vet më të lumtur, më të begatshme dhe s'punon më për bejlerët dhe për agallarët. Populli ka bërë dhe vazhdon të bëjë akoma sakrifica, por ai e di që këto sakrifica dhe këto mundime nuk i bën për të huajt, por për veten e tij. Populli e di se sakrificat janë akoma në rendin e ditës edhe për një kohë. Kollaj s'vihen në vend shkatërrimet e mëdha të luftës, bollëku nuk vjen përnjëherë dhe nuk bie nga qiejt. Këtë do ta sjellim ne vetë me punën tonë të palodhur, të organizuar, me heroizmin tonë në punë, me vetëmohimin tonë dhe me sakrifica. Kështu bëmë edhe gjatë kohës së luftës për të korru fitore dhe ashtu si ishim të sigurt se fitorja ishte jona, ashtu edhe tani jemi të sigurt se me djersën e ballit tonë ne do t'i sjellim vendit ditë më të lumtura, jeta jonë dita-ditës do të përmirësohet, ne do të ndërtojmë për kalamajtë tanë një jetë të lumtur dhe do t'u sjellim ditë të bardha, sepse e meritojnë. Zemra ime e di, motra dhe vëllezër të Gjirokastrës, se në shtëpitë tuaja, se në kasollet tuaja ka akoma varfëri, shumë gjëra ju mun-

gojnë, por unë e di gjithashtu se besimi juaj është i madh, se të gjitha këto do të kalojnë dhe do të përmirësohen dita-ditës kushtet e jetesës. Ne jemi të lirë, ne kemi pushtetin në duart tona dhe ne do t'i mundim të gjitha vështirësitë. Pse e kam këtë besim të patundur te ju? E kam, pse ju jeni popull heroik, popull punonjës, i ndershëm, me vullnet të hekurt, që i kapërcen të gjitha pengesat. Unë kam besim të plotë pse ju, motra dhe vëllezër të Manalatit, të Dunavatit të Sipërm, të Çetemelit dhe të të gjitha mëhallave të Gjirokastrës, pse ju, fshatarë të Kurveleshit, të Dropullit, të Lunxhërisë dhe të të gjitha krahinave të tjera të kësaj prefekturë, tërë jetën tuaj keni çarë malet dhe keni nxjerrë dërrasa, keni mbartur tërë jetën ujë me bucela në krahë, keni rrojtur dhe keni vuajtur me atë bagëti të vogël dhe të varfër që keni pasur, keni punuar me thonj dhe me dhëmbë tokën nën kamxhikun e agallarëve dhe e dini ç'është jeta, e dini ç'është puna dhe s'keni frikë nga puna. Ju e dini se jeta është luftë. Por sot ju jeni të lirë, ata që ju shtypnin ne i vumë nën këmbë përgjithmonë; ju jeni në fuqi, ju bëni ligjin, pushteti është në duart tuaja dhe puna juaj e lirë do ta përmirësojë jetën tuaj. Askush nuk do të guxojë të rrëmbejë frytet e djersës suaj. Ju e shihni vetë se jeta juaj shkon dita-ditës duke u përmirësuar, përmirësohet ekonomia juaj. Shkollat janë përdjemptë tuaj, spitalet janë për ju, çdo ndihmë e pushtetit tonë popullor është për ju, se ai është juaji. Këto t'i keni kurdoherë parasysh dhe të punojmë me kurajon më të madhe në këtë drejtim.

Mos kujtoni se mbeturinat e agallarëve i kanë hedhur armët krejtësisht. Jo, ata rrinë e përgjojnë, ata

kritikojnë, ata përqmojnë punën tonë, ata pëshpërisin se «s'ka bukë», se s'ka ashtu edhe s'ka kështu. Gjoja këta i qajnë hallin popullit. Jo, këta s'e kanë hallin te fatkeqësitet e popullit, këta e kanë hallin te fati i tyre. Këta agallarë kanë akoma bukë të hanë, por vetëm qajnë se shkoi koha e byrekëve dhe e bakllavave, shkoi koha kur ata kapardiseshin nëpër pazar dhe sundonin nëpër fshatrat, shkoi koha kur ata bënin ligjin dhe që nga Zogu dhe deri te prefekti, që nga kryetari i bashkisë dhe deri te xhandari ishin njerëzit e tyre, që i mbronin këta gjakpirës, për të shtypur dhe për të rjepur popullin. Këtu e kanë hallin këta dhe këtë kohë ata kërkojnë dhe përpinqen ta sjellin. Por çdo vepër e tyre do të dështojë; këta duhet t'i binden ligjit tuaj, ligjit të popullit, ligjit të pushtetit, përndryshe mbi ta do të bjerë grushti i rëndë. Për ta s'ka asnë mëshirë. Këta njerëz të degjeneruar dhe armiq të popullit janë vëllezërit dhe shokët e atyre që u gjykuani në Tiranë. Ç'kanë dashur ata tradhëtarë dhe këlyshët e tyre, që tani qëndrojnë si thëngjij të mbuluar me frikë në zemër se mos diktohen, por që pushteti i njeh që të gjithë fill e për pe? Këta kanë dashur të rrëzojnë regjimin e popullit, këta kanë komplotuar kundër Republikës, këta kanë dashur të sjellin në Shqipëri regjimin e vjetër të Zogut, të bezlerëve, të tregëtarëve të mëdhenj, të agallarëve; këta kanë bërë sabotazhe në punën e popullit dhe kanë bërë atentate kundër njerëzve të pushtetit. Këta kanë dashur dhe janë përpjekur të bëjnë atentate kundër udhëheqësve të shtetit shqiptar, këta janë përpjekur dhe kanë punuar për shpërthimin e një lufte tjetër këtu në Shqipëri, këta kanë qenë për një okupim të Shqipërisë prej anglezëve

dhe amerikanëve, këta kanë qenë spiunë direkt të amerikanëve dhe të anglezëve, këta kanë qenë spiunë të fashistëve grekë, këta kanë dashur t'i japid Greqisë Gjirokastrën e Korçën. Të tillë janë ata që u gjykuar në Tiranë, në mes të tyre ka edhe gjirokastritë. Këta gjirokastritë tradhëtarë s'janë djemtë e popullit heroik të Gjirokastrës, por kanë qenë dhe janë armiqtë e popullit të Gjirokastrës dhe të Shqipërisë. Syrja Selso, Hivzi Kokalari, Salim Kokalari, Pertef Karagjozi, Sheraf Karagjozi, Aqif Kashau, Milto Lito, etj. janë nga ata dhe bijtë e atyre që kanë shtypur popullin e kësaj krahine tërë jetën, që kanë qenë të lidhur me italianët, që u kanë shërbyer gjermanëve, janë miqtë dhe vellezërit e ballistëve të Ali Beut¹, janë nga ata që, kur populli i Gjirokastrës vuante në shpellat, në budrumet e kalasë dhe nëpër male pa strehë dhe pa shtëpi dhe, kur populli i Gjirokastrës luftonte, ata pasuroheshin, ata bënin trengëti nga të katër anët, ata bënin ziafete e thernin mishra me njerëzit e Metaksait, me italianët, me gjermanët, me Ismail Golemët e të tjerë banditë. A mund të ketë mëshirë për këta njerëz? Jo, kurrë. Tradhëtia duhet zhdukur nga rrënjet, ferrat duhen qëruar pa mëshirë, pse ndryshe nuk rritet gruri, as nuk lulëzon bahçeja. Populli dhe pushteti i tij u kanë dalë borxhit këtyre qenve. tanë drejtësia le të jetë e pamëshirshme dhe populli t'i ketë sytë hapët, pse ujku qimen e ndërron, por lëkurën nuk e ndërron kurrë.

Përpara nesh vihen detyra të rëndësishme që, sigrisht, do t'i kryejmë dhe sa më të rënda që bëhen

¹ Ali Bej Këlcyrë.

këto detyra, aq më të mëdha janë fryshtet e punës sonë. Pikësëpari, sikundërqi e kam theksuar dhe shumë herë, duhet të vëmë gjithë forcat dhe vëmendjen tonë për ta bërë pushtetin sa më të fortë dhe ky të jetë i téri në duart e popullit. Kjo është gjëja kryesore. Sigurisht, më kuptioni se ç'dua të them me këtë. Në këshillat e pushtetit duhet të vijnë njerëzit më të ndershëm, më patriotët, duhet të vijnë ata te të cilët ka besim më shumë populli, kjo është qeveria jonë populllore. Po s'u bë kështu, punët do të na çalojnë. Duhet t'u bëjmë lustë atyre njerëzve, që i shohin ngushtë punët, që largojnë popullin nga drejtimi politik dhe i ekonomisë së vendit me pretekstin se një njeri i thjeshtë është i mirë, por nuk e kryen dot atë punë ose këtë punë dhe në vend të tij të vihen ata që origjina e tyre është e errët, ata që dinë me fjalë të bukura të bëjnë nga një shkresë, por që në realitet s'e kryejnë punën që duhet. Askush të mos dyshojë asnjë minutë në forcat krijuese të popullit, në zotësinë e tij. Njerëzit e ndershëm, njerëzit punëtorë, janë të zot të drejtajnë çdo gjë, të mësojnë shpejt edhe më mirë nga të tjerët. Nga këta ka me qindra mijëra në gjirin e popullit tonë punonjës. Këta duhet të vijnë kudo në fuqi: në këshilla, në ndërmarrje, në dyqane të shtetit, në kooperativa e të tjera. Këta janë të ndershëm dhe besnikë të mëdhenj ndaj popullit, pse janë djemtë dhe vajzat e përvuajtura të popullit, pse këta kanë dhe aftësinë të bëhen të zot dhe të mësojnë shpejt. Por kjo s'është një çështje e thjeshtë mekanike: hiq atë dhe vur këtë. Kjo është një gjë, që duhet marrë parasysh, por njëkohësisht duhet që gjithë populli të marrë pjesë gjallërisht në punët e përgjithshme të shtetit, qofshin punë

politike ose ekonomike, qofshin organizative. Me këtë dua të them që, krahas me pushtetin, duhet të jetë në gjallëri të madhe edhe Fronti Demokratik, i cili duhet të marrë pjesë fuqimisht në jetën politike të vendit dhe të luftojë që qeveria të zbatojë dëshirat dhe vullnetin e popullit. Në këtë mënyrë, çdo gjë do të jetë e drejtë, çdo gjë do të dalë e studjuar, e rrahur në mbledhjet e gjera të masave të Frontit. Atje do të shfaqen nevojat, atje do të rrihen problemet dhe do të sugjerohen zgjidhjet e këtyre problemeve. Kështu ligjet e Kuvendit Popullor dhe urdhëresat e qeverisë do të janë pasqyrë besnikë e dëshirave të popullit. Atëhere dhe vetëm atëhere çdo masë e qeverisë, çdo ligj i Kuvendit Popullor do të zbatohet me përpikëri, me vullnetin më të madh, pse ato s'janë përveç dëshirat e popullit, të kthyera në ligj. Po të veprojmë në këtë mënyrë, atëherë të jemi të sigurtë se të gjitha ligjet do të janë të kuptueshme edhe për njeriun më të thjeshtë. Çdo formë organizimi do të jetë e kuptueshme prej njeriut më të thjeshtë, kur ai e kupton përse krijohet një organ, atëhere kur ka kuptuar më parë punën që do të kryejë ky organ. Në aparatin e shtetit tonë çdo organizim, çdo ligj dhe çdo urdhëresë është e thjeshtë, e kuptueshme prej të gjithëve. Këtu është çështja, pra, me e forcue këtë organizim, por kjo s'do të thotë me e komplikue. Sa më i thjeshtë të jetë organizimi i pushtetit, aq më i fortë është ai dhe aq më tepër populli e kuption, e mbron dhe ka iniciativë ta përsosë me astësinë e tij. Përsosja e pushtetit është gjithashtu me rëndësi, pse me një pushtet të tillë ne do të zgjidhim problemet e rëndësishme që na vihen përpara.

Populli duhet të ketë kontroll të vazhdueshëm në të gjitha punët. Këtu është çështja të kontrollojë njerëzit që ka caktuar në komitetet ekzekutive dhe në këshillat e pushtetit. Këto janë të detyruara t'i jepin llogari popullit. Ata që u fshihen llogarive përpara popullit, ata aqik s'janë njerëz të mirë. Nga ata njerëz askush të mos ketë frikë, por t'i kritikojë haptas e me guxim përpara opinionit publik. Çdo mashtrim, çdo shtrembërim, çdo abuzim, qoftë edhe i vogël, i bërë prej kujdo qoftë, nëpunës i madh ky, apo i vogël, të demaskohet, të kërkohet të korrigjohet, që të ecë drejt, ashtu si e do drejtësia e popullit. Mos kini frikë. Duke vepruar kështu, pushteti ynë nuk dobësohet, përkundrazi, forcohet shumë e më shumë, ai spastrohet nga sëmundjet dhe kalbësirat hidhen në shportë. Duke vepruar kështu do të shihni se punët do të shkojnë mbarë. Të zhduket mentaliteti i vjetër se nuk mund të kritikohen (kuptoj kurdoherë kritikën me vend konstruktive), njerëzit e pushtetit, pse ata janë qeveria, pse ata janë njerëzit e qeverisë etj. Jo, s'është ashtu, qeveria dhe gjithë pushteti janë njerëz të popullit, të zgjedhur prej popullit dhe për t'i shërbyer popullit. Ata s'kanë marrë asgjë me tapi. Populli është i plotfuqishëm mbi të gjithë. Populli u heq veshin atyre që bëjnë gabime, i çon në shtëpi ata që s'bëjnë detyrën dhe i zëvendëson me njerëz të zot, ose i fut në burg, në rast se ata abuzojnë dhe tradhëtojnë popullin; kurse ata që punojnë mirë, që janë besnikë të popullit dhe të çështjes së tij, populli i do si shpirtin e tij, i mbron, i nderon. Kështu duhet të shikohen punët. Kështu pushteti ynë do të bëhet sa më popullor, sa më demokratik, sa më i fortë. Kështu, Fronti

ynë do të bëhet një organizatë e masave të gjera të popullit, një organizatë politike, plot gjallëri dhe plot jetë dhe kështu do të dalin në dritë vlerat e popullit, të cilat do ta bëjnë shtetin tonë të fortë e do të shkojmë me hapa të shpejtë drejt përparimit dhe jetës më të lumtur.

Të gjitha këto t'i kemi parasysh në punimet e rëndësishme që do të kryhen paskëtaj dhe që do ta ndërrojnë krejtësisht faqen e Shqipërisë. Plani i punës i qeverisë sonë ka për qëllim përmirësimin e shpejtë të jetës së popullit tonë. Në programin e qeverisë parashihen bonifikime të shumta, që do të thotë hapja e tokave të reja, që tani janë moçale ose janë pa ujë. Kjo do të thotë se bujqësia do të marrë një zhvillim të madh dhe, pra, vendi ynë nuk do të ndodhet përpara rrezikut të mungesës së bukës. Përveç këtyre do të mbillen bimë industriale, si pambuk, luledielli, recin, panxharsheperi e shumë të tjera, me të cilat do të punojnë fabrikat e vendit tonë dhe do të kemi për të shitur edhe jashtë. Kjo do të thotë se do të kemi veshmbathje më shumë, bukë më shumë, sheqer më shumë, vaj më shumë. Bonifikime të tillë, natyrisht, do t'i japin një hov dhe blektorisë, bagëtia do të shtohet dhe sidomos bagëtia e trashë dhe me këtë, natyrisht, do të shtohet dhe do të modernizohet edhe industria që ka lidhje me blektorinë.

Minierat e ndryshme në vendin tonë do të marrin një hov më të madh, do të prodhojnë më shumë dhe më mirë; industria e lehtë dhe prodhimet e saj do të shtohen dhe do të përmirësohen. Njëkohësisht, do të ndërtohen rrugë të hekurta të tjera, përveç asaj Durrës-Elbasan, do të hapen rrugë të reja automobili, përveç atyre që do të asfaltohen në pjesën më të madhe.

Kultura dhe arësimi do të marrin një hov shumë më të madh se deri tani, shkolla të reja do të hapen, ku do të marrin pjesë jo me mijëra, por me dhjetëra mijëra djem të popullit. Do të hapen spitale dhe ambulanca të reja, do të krijohen vende verore pushimi për punëtorët, nëpunësit, pionierët, etj. Me miliarda lekë do të harxhohen në këto punime të ndryshme, të cilat do të ngrenë ekonominë tonë dhe do të përmirësojnë jetën e popullit tonë.

Të gjitha këto përbëjnë me pak fjalë në vija të përgjithshme planin tonë pesëvjeçar që qeveria është duke e punuar. Siç e shihni, për kryerjen e këtyre detyrave të mëdha, që ne i vëmë përpara vetes dhe që përbëjnë të ardhmen e popullit tonë lypset mobilizimi i gjithë masave të gjera të popullit: i punëtorëve nëpër fabrika dhe nëpër kantiere, i fshatarëve nëpër ara, i atyre që merren me blegtori, i nëpunësve të shtetit që nga i madhi deri te i vogli, i gruas qostë kjo në fabrikë, në arë, në punë shtetërore ose në ekonominë private, i nxënësve të shkolllave, nga të cilët kërkohet që të mësojnë sa më shumë dhe sa më mirë, kërkohet edhe nga pionierët që ata të mësojnë mirë, se ata do të jenë shpresë e vendit tonë, brezi i ri që do të rritet me të gjitha të mirat dhe që do të përjetësojë dhe do të forcojë ca më shumë veprën e filluar prej prindërve të tyre.

Ne do të kemi sukses të plotë në ndërmarrjen tonë të madhe, kur të gjithë të kenë kuptuar detyrat dhe të kenë marrë angazhime për të kryer këto detyra me nder, në mënyrë të përsosur dhe të organizuar. Gjithsecili duhet të mendojë se kush kryen detyrën në radhë të parë ai i ka shërbyer popullit, ka bërë detyrën ndaj atdheut

dhe pastaj i ka shërbyer vetes. Patriotizmi tregohet në punë dhe jo me muhabete. Kush bën muhabet dhe heq tespitë në regjimin e sotëm të Shqipërisë së re është i destinuar të vdesë nga uria. Për të gjithë janë krijuar mundësitë të punojnë dhe të nxjerrin bukën me ndër.

Masat punonjëse të forcojnë sindikatat e tyre ku ata bëjnë pjesë, dhe këto të bëhen me tërë kuptimin e fjalës mbështetja më e fuqishme e pushtetit tonë në kryerjen e punimeve të mëdha që kemi përpara. Ato të janë një-kohësisht një shkollë e madhe politike për punëtorët dhe për nëpunësit tanë. Të forcohen dhe të shtohen kooperativat e ndryshme dhe këto t'i shërbejnë më së miri popullit. Në këto kooperativa të marrë pjesë sa më shumë populli, se këto jo vetëm që do të furnizonë popullin me çdo gjë, jo vetëm që do të ndihmojnë në ngritjen e shumë punishteve, që deri tani janë organizuar në mënyrë private, të çala dhe pa fryte të dukshme, por njëkohësisht do të edukojnë masat të punojnë më mirë, të punojnë kolektivisht, të luftojnë prirjen e tepruar të tregëtisë së vogël e private, të përfitojnë kohë dhe këtë kohë të vlefshme ta përdorin për të prodhuar sa më shumë. Krijimi dhe forcimi i kooperativave janë në interesin e bujikut dhe të popullit, prandaj ato duhet të inkurajohen. Në këtë mënyrë, do të zhduken dhe tendencat e spekulimit dhe të fitimeve jashtë masës dhe ligjit. Duhet të punohet shumë për forcimin e solidaritetit në mes njëri-tjetrit, të forcohet aleanca e fshatit me qytetin. Masat punonjëse të fshatit duhet të kuptojnë se puna e tyre është e lidhur ngshtë me masat punonjëse të qytetit. Për t'ja arritur këtij qëllimi nc duhet t'i përvishemi punës, dhe të vazhdojmë rrugën e drejtë

që kemi nisur, sepse kjo është rruga që do t'i sjellë përparimin vendit tonë dhe jetën e lumtur dhe të begatshme për popullin shqiptar.

Vëllezër dhe motra të Gjirokastrës,

Në punën përparimtare dhe ndërtimtare që po bën populli shqiptar, ka përkrahës dhe miq të vlefshëm, besnikë deri në fund për popullin tonë të vogël. Të tillë miq të jashtëm populli ynë, nuk ka pasur kurrë deri sot në historinë e tij. Dhe këta miq dhe aleatë të shtrenjtë të vendit tonë janë në radhë të parë popujt e Bashkimit të madh Sovjetik. Pa ekzistencën e Bashkimit Sovjetik, pa Ushtrinë famëmadhe të Kuqe, bota e tërë do të lëngonte kush e dë sa kohë akoma nën terrorin e fashizmit gjerman. Bashkimi Sovjetik ishte faktori kryesor i fitores mbi fashizmin; Bashkimi Sovjetik mbajti peshën më të rëndë të luftës në supet e veta dhe fati i luftës, fati i botës u vendos në fushat e Bashkimit Sovjetik. Në fushat e Bashkimit Sovjetik dhe nga Ushtria e Kuqe hordhitë e Hitlerit u dërmuan. Kjo tregon forcën e madhe të popujve sovjetikë, forcën e regjimit socialist, e regjimit të popullit; kjo tregon gjenialitetin e Stalinit të madh, udhëheqësit të lavdishëm sovjetik, njeriut që e adhurojnë të gjithë popujt përparimtarë të botës, që e adhurojnë popujt që ishin të robëruar nga fashizmi, që e adhuron me gjithë shpirt populli ynë. Lufta e Bashkimit Sovjetik kundër okupatorëve hitlerianë ishte një luftë e pamëshirshme, pa rezerva, kurse përpjekjet e «demokrative» imperialiste të blokut antifashist, që nga fillimi dhe deri në fund kishin më tepër

për qëllim dobësimin e Bashkimit Sovjetik, zgjatjen e luftës së tmerrshme, mosshembjen totale të regjimit hitlerian, riforcimin e pozitave të reaksionit në të gjitha ato vende, ku lufta nac.-çl. kishte marrë proporcione të mëdha dhe ku populli luftonte me të gjitha forcat e tij përvendosjen e rendit të demokracisë popullore. Kjo gjë ka qenë e qartë gjatë gjithë kohës së luftës por, kjo bëhet edhe më e qartë në dritën e evenimenteve të pasluftës, në kohën e rindërtimit të pagues. Të mos shkojmë më tej, por të hedhim sytë në kohën e luftës sonë, ku intrigat kanë qenë në një shkallë të madhe. Kur populli ynë luftonte me ashpërsinë më të madhe kundër okupatorëve dhe kuislingëve, Londra¹ këshillonte çdo natë: «Të mos harxhohen forcat, të ruhen forcat përmomentin e volitshëm». Qëllimi ishte që të dobësohej lufta kundër gjermanëve dhe italianëve, pse kështu ata do ta shtypnin më lehtë popullin tonë, pse kështu nuk do të demaskohej lodra e agjentëve të Italisë dhe të Gjermanisë, si Mithat Frashëri, Ali Këlcyra, Bazi i Canës, Xhafer Deva, etj., që ishin njëkohësisht dhe agjentë të anglo-amerikanëve, kështu këta tradhëtarë do të forcoheshin edhe më tepër dhe kur Londra të gjente momentin oportun, të jepte shenjën që Shqipëria të bëhej një Greqi e dytë, d.m.th. të sundonin këtu fashistët e orës së parë, që prej Mehdi Beut² dhe deri te Xhelal Staravecka. Këtë taktikë Londra dhe Uashingtoni e shoqëronin edhe

¹ Është fjalë përmisionet në gjuhën shqipe që transmetonte radio Londra.

² Mehdi Bej Frashëri.

me kërcënime, duke na refuzuar shumë herë dhe armatimet që u kërkoheshin. Misionet anglo-amerikane s'kishin ardhur në male për ta ndihmuar luftën tonë si duhej, por për të thurur më shumë intriga, për të organizuar reaksionin me «Ballin» dhe «Legalitetin» që të preqatitnin zbarkimin e tyre në Shqipëri e të tjera gjëra të këtij lloji. Por të gjitha këto u vanë fuq, si themi ne në Gjirokastër. Anglo-amerikanët ku gjejnë shesh bëjnë pëershesh. Shembulli më tipik është Greqia fatkeqe. Por pas luftës, kur Gjermania hitleriane dhe satelitët e saj i hodhën armët, u duk më qartë se «sa të vendosur» ishin anglo-amerikanët për luftën kundër Gjermainisë naziste. Popujt që luftuan heroikisht, me Bashkimin Sovjetik në krye, popujt që derdhën gjakun rrëke, që u rrënuan, që panë me sy dhe ndjenë në trupin e tyre terrorin shtazarak të hitlerianëve, natyrisht, kërkojnë me këmbëngulje që të shkulet nga rrënja fara e fashizmit, të vendoset paqja e drejtë dhe e vazhdueshme, t'u jepet fund agresioneve e luftërave, të dënohen agresorët fashistë e kuislingët dhe të paguhën deri në një reparationet nga ana e atyre që e hodhën botën në këtë kasaphanë të tmerrshme. Sot Bashkimi Sovjetik është armiku i betuar i fashizmit dhe mbrojtësi i njerëzimit përparimtar, mbrojtësi i popujve të vegjël dhe të mëdhenj, që aspirojnë një paqe të drejtë; Bashkimi Sovjetik është për zhdukjen e fashizmit, për çarmatin, për zhdukjen e bombës atomike, për bashkëpunimin e singertë të popujve dhe të shteteve demokratike.

Kështu e shohim ne dhe gjithë popujt përparimtarë të botës Bashkimin Sovjetik. Ne e mbështetim politikën e drejtë dhe konsekiente të Bashkimit Sovjetik për

mbrojtjen e paqes dhe të drejtësisë. Veçanërisht për vendin tonë Bashkimi Sovjetik dhe kryetari i tij, i madhi Stalin janë treguar mbrojtësit besnikë të çështjes sonë, të të drejtave tona, të pavarësisë dhe të sovranitetit të vendit tonë. Populli i Gjirokastrës dhe i gjithë Shqipërisë me mirënjojje të madhe nuk do t'i harrojë kurrë mbrojtjet e shkëlqyera të përfaqësuesve sovjetikë, Mollotovit, Vishinskit, Manuilskit, që i bënë çështjes sonë në Konferencën e Paqes të Parisit dhe dërmuan intrigat dhe pretendimet e monarko-fashistëve dhe të mbrojtësve të tyre, që kërkonin të copëtonin Shqipërinë, që kërkonin të na rrëmbenin Korçën dhe Gjirokastrën. Qeveria sovjetike dhe Stalini i madh ushqejnë për popullin tonë simpatinë më të madhe, ata me admirim e kanë ndjekur luftën heroike të popullit tonë të vogël dhe nuk e kur-syen aspak ndihmën ndaj popullit shqiptar. Ata na akorduan përnjëherë një kredi për të blerë në Bashkimin Sovjetik fabrika dhe traktorë, si edhe mjete për zhvillimin e arësimit e të kulturës në vendin tonë; Bashkimi Sovjetik na mbron në rrugën tonë të drejtë dhe paqësore nga kërcënimet e reaksionit ndërkombëtar, ai e ndihmon popullin tonë të marrë veten nga plagët e rënda që ka pësuar në luftë. Kjo është miqësi e vërtetë dhe e singertë dhe për të gjitha këto populli shqiptar brohorit me gjithë zemër:

Rroftë Bashkimi Sovjetik, mbrojtësi i paqes së vërtetë e të drejtë dhe mikë i shtrenjtë i popullit tonë!

Rroftë sa malet Stalini i madh!

Me popujt e Jugosllavisë na lidh gjaku i bijve dhe i shokëve tanë që u derdh së bashku, na lidhin aspiratat e njëjta. Interesi i reaksionit ka qenë dhe është që Shqi-

përia të izolohet, që kështu ata ta kenë si një kafshatë për ta gjelltitur. Popujt tanë të lidhur me njëri-tjetrin do të ecin në rrugën e paqes e të përparimit. Populli shqiptar do të vërë të gjitha forcat që vendi i tij të përparojë dhe miqësia me Jugosllavinë të bëhet një faktor i rëndësishëm.

Vendi ynë ka marrëdhënje nga më të përzemërtat me popullin bullgar, me atë vend, ku populli ka ardhur në fuqi dhe demokracia përparon me hapa të shpejtë dhe të sigurtë. Populli ynë do t'i forcojë edhe më shumë marrëdhënjet e tij me këtë popull përparimtar paqedashës dhe fqinj ballkanas. Ne do të bëjmë që populli ynë dhe populli bullgar të njojin më mirë shoqi-shoqin, të kenë marrëdhënje kulturale dhe të tjera të zhvilluara dhe të plota dhe kjo është në interesin e të dy vendeve tona dhe në interesin e demokracisë dhe të paqes në Ballkan e në botë. Marrëdhënje të mira kemi me shumë shtete të Evropës, me Poloninë, me Çekoslovakinë, Rumaninë, Hungarinë dhe me Francën. Dëshira dhe vullneti ynë është që me të gjitha shtetet demokratike dhe përparimtare të vendosim marrëdhënje të mira miqësie. Një gjë e tillë është në interesin e paqes dhe të mirëqenjes së popujve.

Vëllezër dhe motra të Gjirokastrës,

Kur populli ynë po rindërton vendin e tij që ja shkatërrroi lufta, kur vendi ynë ka vënë të gjitha forcat për forcimin e demokracisë së tij popullore dhe ecën në rrugën e tij paqësore dhe përparimtare, fqinji ynë i Jugut, Greqia monarko-fashiste, përdor njëmijë e një më-

nyra nga më të poshtrat për t'i bërë dëm popullit tonë. Ju e dini se ç'tragjedi e tmerrshme po ndodh në Greqi. Populli fatkeq por heroik grek po lufton kundër fashistëve monarkistë dhe intervencionit të huaj. Bota përparrimtare dhe demokrate është e indinjuar thellësisht, kur sheh këtë tragjedi të madhe të këtij populli që meriton të rrojë i lirë dhe sovran, por që fatkeqësisht po shtypet dhe vritet pa mëshirë prej bashkëpunëtorëve të fashizmit italo-gjerman, që tani janë nën urdhërat direkte të reaksionit amerikano-anglez. Populli ynë, si edhe gjithë popujt e tjerë të botës, simpatizon luftën heroike të popullit grek, që luftoi heroikisht kundër okupatorëve italianë dhe gjermanë dhe që tani lufton me heroizëm për t'u çliruar nga okupatorët e rinj dhe nga kuislingët e përgjakshëm monarko-fashistë. S'ka njeri që e quan veten demokrat që të mos simpatizojë përpjekjet e popullit grek për liri e demokraci. Por lufta e popullit grek është një luftë e brendshme e tij dhe vetëm e tij dhe kjo nuk i përket në asnjë mënyrë popullit tonë dhe qeverisë sonë të përzihet në çështjet e brendshme të të tjerëve. Populli shqiptar dhe qeveria askurrë nuk janë përzierë dhe nuk do të përzihen në çështjet e brendshme të Greqisë, se ato janë çështje të vetë popullit grek dhe ai vetë le t'i zgjidhë si të dëshirojë çështjet e veta. Ky ka qenë, është dhe do të jetë qëndrimi ynë. Këtë gjë e përsëris, se ju e dini se ç'fushatë e poshtër shpifjesh dhe mashtrimesh po bëhet kundër vendit tonë nga ana e monarko-fashistëve grekë dhe e mbrojtësve të tyre amerikanë dhe anglezë. Këta e akuzojnë vëndin tonë dhe fqinjët e tjerë se gjoja ndërhyjnë në çështjet greke, se ne ndihmojmë luftën e demokratëve, se gjoja ne u fur-

nizojmë atyre armë dhe municion dhe pra, që këndej, ata duan të nxjerrin se lufta e popullit grek shtyhet dhe mbahet prej të huajve. Kjo është një gënjeshtër e madhe, ky është një provokacion i madh dhe i denjë pér fashistët. Populli grek po torturohet, po vritet dhe po digjet prej banditëve fashistë dhe ai ka rrokur armët pér të shpëtuar jetën e tij, jetën e kalamajve të tij, pér të shpëtuar atdheun e tij. Amerikanët dhe anglezët dhe hyzmeqarët e tyre këtë e quajnë intervencion të jash-tëm. Kjo është, si me thënë, me mbulue diellin me shoshë. Jo, populli ynë dhe fqinjët e tij, as nuk kanë gisht në luftën e popullit grek dhe as u kanë dhënë dhe as do t'u japid asnjë fishek, por amerikanët, anglezët dhe monarko-fashistët, kur bëjnë këto akuza dhe shpifje kanë qëllimin të fshehin natyrën e vërtetë të luftës së popullit grek, të fshehin origjinën e kësaj lufte, të fshehin terrorin e monarko-fashizmit grek, të fshehin lodrën e tyre tragjike, dua të them, intervencionin e tyre të hapët dhe të egër. Aq sa është tragjike, aq është dhe qesharake që Amerika të akuzojë popullin tonë të vogël, paqedashës, se gjoja ai është shkaktar i luftës që po zhvillohet në Greqi dhe se gjoja e furnizon atë me armë e municion. Këtë asnjeri s'e ha, amerikanët mund të bindin vetëm vetëveten. Qëndrimi armiqësor i qeverive amerikane dhe angleze ndaj vendit dhe popullit tonë është i njobur prej të gjithë popullit shqiptar dhe prej të gjithë popujve të botës. Kundër një populli të vogël, që ka luftuar me heroizëm kundër okupatorëve, që ka ngritur një regjim nga më demokratikët dhe që i është përveshur punës ndërtimitare dhe paqësore me të gjitha forcat e tija, reaksiuni amerikan dhe anglez po

përdor njëmijë mënyra antidekomokratike, po përdor kërcënimin, shantazhin, shpifjet që ju i dini të gjitha dhe që janë të provuara me argumenta që bëhen për të dëmtuar vendin tonë dhe demokracinë tonë popullore. Ju i keni dëgjuar të gjitha ç'pohuan agjentët e ndytë të anglo-amerikanëve përpara gjyqit në Tiranë, ju i keni dëgjuar se si njerëzit e misioneve anglo-amerikane kanë organizuar me tradhëtarët e popullit shqiptar rrëzimin e pushtetit popullor në Shqipëri, se si kanë organizuar sabotazhet, atentatet. Ata njerëz dhe ato qeveri që kanë paturpësinë të shpifin gjëra të paqena kundër popullit tonë të vogël, i kanë futur duart deri në bërryl në punërat tona të brendshme. Por vetëm se nuk ju ndezi. Të gjitha veprimet e tyre të dënueshme u zbuluan me kohë dhe agjentët e tyre do të marrin dënimin e merituar. Më kot Departamenti i Shtetit¹ dhe Forin Ofis² mund të bëjnë deklarata për të përgënjeshtuar pjesë-marrjen e njerëzve të tyre në punët e brendshme të një shteti sovran. Dielli nuk mbulohet me shoshë. Faktet dhe argumentat janë monumente, që nuk mund të shemben nga deklarata të tillë. Zyrtarët e Departamentit të Shtetit Amerikan i cilësojnë demokratë-liberalë sabotatorët, atentatorët, banditët, spiunët që u gjykuani në Tiranë, që donin t'i jepnin Greqisë së Calderisit qytetet e Gjirokastrës dhe të Korçës, që janë djep i patriotizmit të vendit tonë. E merrni vetë me mend se si e kuption demokracinë Departamenti i Shtetit Amerikan. Jo, në vendin tonë, ku u derdh kaq gjak i popullit dhe

¹ Departamenti i Shtetit për Punët e Jashtme i SHBA.

² Ministria e Jashtme e Anglisë.

ku ka një demokraci të vërtetë, Shefqet Bejën¹ me shokë ne i quajmë banditë fashistë dhe i dënojmë pa mëshirë, u pëlqeka ose s'u pëlqeka zyrtarëve të Departamentit të Shtetit Amerikan. Por çështja është se Departamentit të Shtetit Amerikan, nuk i pëlqen që populli të jetë në fuqi, të vetëqeveriset, të bëjë ligjet vetë dhe të ndërtojë jetën e tij ashtu si ai e dëshiron. Ai që akuzon kot të tjerët për ndërhyrje në punë të tjegrit, jo vetëm që ndërhyr vetë, por përpinqet me të gjitha mjetet të shtypë nën thundrën e hekurt popujt e tjerë. Kjo është gjoja demokracia e Departamentit të Shtetit, me doktrinën e Trumanit dhe me planin e Marshallit. Ajo që po ngjet në Greqi, është vetëm vepra e reaksionit amerikan, anglez, e monarko-fashistëve dhe e askujt tjetër. Greqia monarko-fashiste jo vetëm që është shndërruar në një bazë të reaksionit amerikan, por ajo është bërë një kërcënim për paqen në Ballkan dhe në botë.

Kundër vendit tonë ka vjete me radhë që monarko-fashistët grekë kanë shpallur një fushatë provokimesh e sharjesh, një fushatë pretendimesh tokësore, një luftë nervash që i kanë kaluar ato të nazistëve gjermanë. Gati çdo ditë monarko-fashistët e Athinës dhe bandat e tyre na provokojnë në kufi, na qëllojnë rojet tona, na vrasin fshatarët e qetë që punojnë në ara. Të gjitha këto hyjnë në planin e përgjithshëm të kurdisur nga reaksi i amerikan dhe anglez për të mbajtur më këmbë

¹ Shefqet Beja, deputet tradhëtar, që u vu në shërbim të imperialistëve amerikanë dhe anglezë për të përmbysur me forcë pushtetin popullor. U gjykua nga gjyqi i popullit për tradhëti ndaj atdheut dhe mori dënimin e merituar.

tezën e tyre të falimentuar me kohë. Monarko-fashistët u kanë bërë strehë një numri banditësh fashistë shqiptarë dhe këta i organizojnë në grupe të vogla për të goditur rojet tona, për të krijuar incidente në kufi, për t'i futur në vendin tonë të bëjnë atentate dhe sabotazhe. Por kufiri ynë është gardh, atë e ruajnë djemtë e popullit tonë heroik, që vjete me radhë luftuan dhe mundën gjermanët dhe italianët dhe që s'u trembet syri nga larot e Zervës dhe të Caldarisit.

Rrofshin rojet e pafjetura të kufirit tonë! Përtej kufirit dhe në tokën e tyre monarko-fashistët le të bëjnë ç'të duan, por këtej kufirit tonë ata e dinë mirë se ç'i pret. Por edhe në qoftë se nuk e dinë, ja ku po u themi: Për të mbrojtur atdheun tonë, kufitë tanë, të drejtat tona, neve s'na trembet syri dhe syrin e kemi pishë. Ju i njihni mirë pretendimet qesharake të fashistëve grekë mbi të ashtuquajturin Vorio Epir, domethënë mbi Gjirokastrën dhe Korçën, bile edhe mbi Elbasanin deri në Shkumbin. Kjo është kënga e tyre e vjetër e Mukës, kjo është kënga e vjetër e «Megaliidhesë» e Venizellosit¹, e bandave të Zografos². S'kemi kohë të merremi me fjalë të gjata mbi këto çështje, por populli shqiptar ua thotë

¹ Elefterios Venizelos, personalitet politik reaksionar grek. Kryeministër i Greqisë në v. 1910—1928 (me ndërprerje). Armik i tërbuar i lëvizjes kombëtare shqiptare dhe i shtetit të pavarur shqiptar. Ndoqi me vendosmëri politikën e copëtimit të Shqipërisë dhe të aneksimit të Shqipërisë së Jugut nga Greqia.

² J. K. Zografi, personalitet politik reaksionar grek. Ministër i Greqisë më 1911. Armik i lëvizjes kombëtare shqiptare. Luftol për aneksimin e Shqipërisë së Jugut nga Greqia. Më 1914 u bë kryeministër i të ashtuquajturës qeveri të Vorio Epitrit në Gjirokastër.

shkurt fashistëve grekë: Korça dhe Gjirokastra janë tokat tona dhe vetëm tokat tona, atij që ja mban, le t'i prekë, të shohim. Nuk këshillojmë njeri të luajë me zjarrin, por ne nuk kemi frikë nga zjarri, kur është çështja për të mbrojtur atdheun dhe jetën tonë. Qeveritarët e Greqisë na e njojin mirë kokën.

Monarko-fashistët grekë po bëjnë shpifjet më të poshtra, se gjoja shqiptarët vrasin, torturojnë, djegin minoritetin e vogël grek që jeton në krahinë tonë të Gjirokastrës. S'ka poshtërsi më të madhe. Por monarko-fashistët grekë e matin me kutin e tyre dhe kujtojnë se ne veprojmë si vepruan ata me minoritetin shqiptar të Çamërisë, që e vranë, e dogjën dhe, më në fund, e grabitën dhe e dëbuan. Jo, ju e dini më mirë nga të gjithë se si jetojmë ne me minoritetin vëlla grek që ndodhet këtu. Ne minoritetin e vogël grek në Shqipëri e kemi si vellanë tonë. Minoritarët janë lidhur me popullin shqiptar si mishi me thuan. Djemtë trima të fshatarëve të minoritetit luftuan krah për krah me popullin shqiptar, luftuan për lirinë e Shqipërisë, për demokracinë e vërtetë, luftuan njëkohësisht për t'u çliruar, si dhe gjithë populli shqiptar, nga zgjedha e agallarëve dhe e bejlerëve të Libohovës dhe të Gjirokastrës. Populli shqiptar këndon trimërinë e Lefter Talos, të Thanas Zikos dhe të tjerëve dëshmorë të minoritetit, ashtu sikundër këndon këngën e Asim Zenelit dhe të Qemal Stafës. Populli shqiptar nuk mund t'i ndajë brez pas brezi bijtë e minoritetit të rënë në luftë nga bijtë e tij. Minoriteti i vogël grek luftoi me popullin shqiptar, fitoi tok me popullin shqiptar dhe gjëzon dhe jeton jetën e re tok me popullin vëlla shqiptar. Fshatarët e

minoritetit morën nga reforma agrare tokën dhe kjo u bë tani e tyrja përgjithmonë. Ata kanë ndihmën e push-tctit popullor, që është pushteti i tyre dhe që s'bën as më të voglin dallim nga popullsia e Shqipërisë. Minoriteti i vogël grek gjëzon të gjitha të drejtat, ai ka shkolllat e tij në gjuhën greke, ai ka gazetën e tij. Motrat dhe vëllezërit e minoritetit të vogël grek i dinë dhe i gjoznjë të gjitha këto të drejta. Ata e kuptojnë se sa qesharake dhe të poshtra janë shpifjet e fashistëve të Athinës. Minoriteti grek në Shqipëri, që rron i qetë, në paqe dhe që gjëzon jetën, e sheh se ç'ngjet në Greqi dhe se ku e-çojnë popullin heroik grek çakajtë e Athinës. Dhe zemrat e vëllezërve dhe të motrave të minoritetit grek në Shqipëri janë lënduar për fatkeqësitetë e mëdha që u ngjasin vëllezërve të tyre në Greqi. Kjo është e vërtetë për ata sikundërqë është edhe për ne. Por minoriteti i vogël grek, i lidhur përjetë me popullin shqiptar, duhet të mburret me popullin heroik grek, që është i pamposhtur dhe që lufton trimërisht kundër okupatorëve dhe bandave fashiste të Caldarisit, për lirinë e Greqisë, për demokracinë e vërtetë.

Motra dhe vëllezër të Gjirokastrës,

Duke ju falenderuar nga zemra për dashurinë që tregoni për qeverinë tonë dhe për mua, le të brohorasim për Shqipërinë që ngritëm me gjakun dhe me vuajtjet tona.

Rroftë Shqipëria e re!

Rroftë populli heroik shqiptar!

Rroftë populli heroik i krahanës së Gjirokastrës!

Rroftë qyteti heroik i Çerçiz Topullit, i Muzafer Asqeriu, i Muhamet Bakirit, i Kapo Bacos, i Bule Naipit, etj.!

Rroftë Ushtria jonë heroike, mbrojtësja e çelniktë e indipendencës, e sovranitetit dhe e fitoreve të popullit!

Rroftë Bashkimi Sovjetik, kështjella e pamposhtur e paqes!

Rroftë Stalini i madh, miku më i dashur i popullit tonë!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 862,
4 tetor 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 862,
4 tetor 1947*

FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË PËRMETIT

6 tetor 1947

Vëllezër e motra të qytetit dhe të fshaṭrave të Përmetit,

Jam shumë i gëzuar sot që vij përsëri në qytetin tuaj, në këtë qytet, ku janë bërë mbledhje të një rëndësie historike për vendin tonë. Jam i lumtur që vij te ju t'ju sjell përshëndetjet e qeverisë, përshëndetjet e mia, përshëndetjet e Partisë sonë Komuniste. Ju qëndruat besnikë deri në fund të Luftës sonë nacional-çlirimtare, qyjeti juaj, viset tuaja u dogjën tri herë nga fashistët italianë dhe nga nazistët gjermanë, bijtë tuaj luftuan nëpër brigadat dhe divizionet tona për çlirimin e popullit shqiptar dhe për lirinë e atdheut. Ju e dini se lufta ka qenë shumë e ashpër dhe sakrificat shumë të mëdha, por populli ynë këto i mori parasysh, se vetëm në saje të luftës do të fitonim lirinë, do të fitonim pavarësinë, vetëm në saje të luftës Shqipëria do të bëhej Republikë Popullore. Kur populli shqiptar mori armët në dorë, i tha vetes së tij se duhet të çlirojë atdheun nga okupatori, po njëkohësisht duhet të qërojë të gjithë ata, që na kanë shkaktuar mjerime për shekuj,

bejlerët dhe agallarët, të cilët tërë jetën e tyre e kanë shitur Shqipërinë te armiqtë e vendit tonë, te të huajt. Populli shqiptar i doli mbanë punës së tij, pse ishte më i fortë, më i zot nga armiqtë okupatorë dhe nga veglat e tyre të poshtra.

Në luftë e sipër djemtë e vuajtur të Shqipërisë, që kishin rrokur armët e kishin formuar çetat, batalionet e brigadat dhe luftonin nëpër male, njëkohësisht ngri-nin dhe pushtetin popullor, qeverinë e popullit, d.m.th. këshillat nacional-çlirimtare. Këshillat nacional-çlirimtare duhet të zëvendësonin pushtetin e vjetër, që ishte i téri në dorën e Zogut dhe të njerëzve të Zogut, në dorën e hajdutëve, në dorën e kriminelëve që e shtypnin dhe e grabitnin popullin. Kur erdhën italianët dhe gjermanët, u ngritën qeveri që u bënë vegla të okupatorëve. Populli shqiptar duke luftuar okupatorët ngriti dhe qeverinë e tij që ishte qeveria popullore.

Ju e dini se këtu në Përmet, tre vjet më parë, më 24 Maj është zhvilluar një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e Shqipërisë, Kongresi i Përmetit. Partia Komuniste e Shqipërisë, që udhëhoqi Frontin Nacional-Çlirimtar, që udhëhoqi Ushtrinë tonë Nacional-Çlirimtare të lavdishme u dha urdhër brigadave të çlironin qytetin e Përmetit dhe për ndër të qytetit të Përmetit, që u dogj tri herë me radhë, për punën e sakrificat e böra, Partia Komuniste caktoi që ky kongres të bëhej këtu, në Përmet.

Cilat janë rezultatet e këtij kongresi? Këto janë të një rëndësie të madhe historike. Kongresi i Përmetit do të shkruhet në histori dhe brez pas brezi do të këndohet nga të gjithë, pse Kongresi i Përmetit legalizoi

pushtetin tonë popullor. Kongresi i Përmetit përfaqësonte popullin nga të katër anët e Shqipërisë. Nga Kongresi i Përmetit doli Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar, nga i cili u zgjodh Kryesia e Këshillit Antifashist Nac.-Çl. dhe kjo zgjodhi Komitetin Antifashist Nac.-Çl., d.m.th. qeverinë e parë provizore për popullin shqiptar. Populli shqiptar, që nga Kongresi i Përmetit kishte qeverinë e tij, kishte udhëheqësit e tij, bij të popullit, të zgjedhur nga populli në mënyrën më demokratike. Kjo qe një ngjarje me shumë rëndësi, që u priste shpresën të gjithë kusarëve e banditëve si Ahmet Zogu me shokë, që përpinqeshin me anë të reaksionit anglo-amerikan të krijonin qeveri kukulla jashtë për t'i ngatëruar mendjen popullit shqiptar. Me krijimin e Komitetit Antifashist Nac.-Çl. ju pre shpresa, si armiqve që ishin jashtë, edhe reaksionit ndërkombëtar. Nga ana tjetër krijimi i Komitetit Antifashist ua çori maskën dhe ua preu shpresën armiqve të brendshëm që me parulla nacionaliste kishin dalë për të përçarë popullin shqiptar, për të përçarë Luftën nacional-çlirimtare. Të gjithë tradhëtarëve të «Ballit» dhe të «Legalitetit» që ishin në shërbim të okupatorit fashist ju pre shpresa. Këshilli Antifashist, i dalë nga Kongresi i Përmetit, mori vendime me shumë rëndësi. Ai anuloi traktatet e vjetra, me anën e të cilave qeveritë e vjetra antipopullore si ato të Ahmet Zogut etj. ua kishin shitur pasuritë e vendit tonë imperialistëve të huaj. Këto traktate i kishin sjellë robërinë popullit tonë, robërimin e Shqipërisë, kishin bërë që pasuria jonë e nëntokës t'u jepoj të huajve dhe vendi ynë të ishte bërë pre e fashistëve italianë. Pra, Kongresi i Përmetit krijoj mundësitet

që të gjitha traktatet, që ishin bërë në dëm të popullit shqiptar, të anuloheshin dhe populli shqiptar nuk njihet asnjë angazhim. Pasuritë e Shqipërisë ishin të popullit shqiptar dhe asnjë detyrim nuk kishte ai ndaj shteteve të huaja, të cilave Zogu dhe qeveritë e tij u kishin dhënë koncesione e të drejta në vendin tonë për të mbushur xhepat e tyre. Koncesionet që i ishin dhënë vendeve kapitaliste, si Kuçova, Patosi, Rubiku, Scelenica etj. Kongresi i Përmetit i fshiu.

Kongresi i Përmetit, bëri dhe një gjë tjetër me rëndësi: ai vendosi që Zogu të mos kthehej më në Shqipëri. Kur të krijoheshin konditat dhe kur qeveria provizore e Shqipërisë do ta gjente të arësyeshme, do të bëhenzit zgjedhjet e përgjithshme, për të thirrur Asamblenë Kushtetuese, e cila do të shpallte Shqipërinë Republikë Popullore. Siç e shihni, pra, në Përmet u muarën vendime të mëdha, këtu u realizuan aspiratat shekullore të popullit shqiptar.

Në Kongresin e Përmetit është vendosur edhe një gjë tjetër. Ju e dini se, kur bëhej kongresi dhe populli i krahinave e i fshatrave të Shqipërisë po brohoriste me entuziazëm për këtë ditë të shënuar, aeroplanët gjermanë fluturonin rrëth e rrötull, d.m.th. Shqipëria akoma nuk ishte çliruar. Ushtria jonë Nac.-Çl. e cila në atë kohë ishte zmadhuar e ishte forcuar, pse me mijëra punëtorë, fshatarë, gra e burra mbushën radhët e saj, kishte për detyrë të çlironte sa më parë vendin tonë dhe, në fryshtë e vendimeve të Kongresit të Përmetit, u dha urdhëri që Divizioni I i lavdishëm të kalonte në ofensivë në Shqipërinë e Veriut dhe kështu u bë. Ushtria jonë Nac.-Çl. luftoi ditë e natë duke i ndjekur këmba-

-këmbës gjermanët, ballistët dhe gjithë tradhëtarët e tjerë; ajo shpartalloi në Veri forcat e Bazit të Canes, të Fiqri Dines etj.; më 29 Nëntor Shqipëria u çlirua.

Ju e dini se me çlirimin e Shqipërisë na viheshin përpara detyra më të rënda. Shqipëria ishte djegur, ishte varfëruar, ishte shkatërruar. Si Përmeti, ashtu dhe krahinat e tjera të Jugut kishin pësuar dëme të mëdha. Prandaj ne duhej t'i përvisheshim punës me ndërgjegje e me kurajo të madhe pa marrë parasysh sakrificat. Dhe ne kështu punuam. Populli u mobilizua. Në çdo anë u ndërtuan ura, rrugë, fabrika, miniera, etj. Me se u ndërtuan këto? Ne ishim të varfër, s'kishim as para, as mjete, por populli i ndërtoi vetë këto, sepse kishte vullnet të madh, sepse e dinte që s'punonte më për të huajt. për gjakpirësit, po për shtëpinë e tij, për veten e tij. Populli ynë e dinte se nuk do të arrinte menjëherë bollëkun. Ai që luftoi për vjete me radhë nëpër male, me bukë e pa bukë, i zhveshur e pa municione, natyrisht. nuk do t'i trembej sakrificave. Tani që ai ishte i lirë, nuk do të trembej të ndërtonte vendin e vjet. Këtu është forca e popullit tonë dhc këtu është shkaku që të gjitha këto vepra u ndërtuan në një kohë aq të shpejtë sa në asnjë vend të botës. Ju e patë vetë në sa ditë u ndërtuan urat në krahinën tuaj.

Këto punime që ka bërë populli ynë nën drejtimin e Partisë sonë Komuniste dhe të qeverisë sonë dhanë rezultate të mira; jeta e popullit është përmirësuar. Por siç e thashë dhe më parë, bollëku nuk do të vijë përnjëherësh, jeta jonë do të bëhet sigurisht më e mirë. Por duhet akoma punë. Ne i kemi konditat që të ecim përpara, që jeta e popullit tonë të bëhet më e mirë dhe

do të bëhet më e mirë. Qeveria jonë duke zbatuar reformën agrare i dha fshatarit tokën dhe bëri që bujqësia të marrë një zhvillim më të madh, që gruri dhe misri sivjet të bëhen më shumë se kurrë, që bimët e tjera të mbjella të jatin frytet e duhura, që fshatari të punojë tokën më me zell e vullnet, pse nuk punon më për beun dhe aganë, por punon për shtëpinë e tij dhe punon tokën e tij. Qeveria ka ndihmuar fshatarin, por këto ndihma nuk janë të mjasta. Ajo ka në programin e saj që të ndihmojë fshatarin më shumë duke i dhënë kredi në bankë dhe mjete moderne punimi. Qeveria ka plane për realizimin e të cilave do të harxhohen shuma të mëdha. Do të ngrihen fabrika të reja, do të ndërtohen rrugë të hekurta, etj. dhe këto kanë për qëllim të zhvillojnë industrinë tonë, minierat tonë; ne do të ndërtojmë edhe rrugë të reja, shkolla të reja; bujqësia do të marrë gjithashtu një hov të madh dhe fshatari do të përmirësojë gjendjen ekonomike. Në këtë mënyrë do të përmirësohet gjendja ekonomike e gjithë popullit shqiptar.

Ju e dini se ne kemi miq të fortë që na ndihmojnë siç është Bashkimi Sovjetik, që na ndihmon për të ngritur ekonominë tonë, për të bërë që jetë e popullit tonë të vihet në rrugë të mbarë. Nga ana tjetër ai na mbron nga çdo rrezik që kërcënon vendin tonë nga jashtë. Ju e dini mirë se reaksioni anglo-amerikan po bën çmos për të dobësuar demokracitë popullore që janë ngritur te ne. Ju e dini se ato vende, ku sundon kapitalizmi që shfrytëzon punëtorët e fshatarët, nuk mund të durojnë në asnjë mënyrë që në vendin tonë ta ketë fuqinë në dorë dhe të sundojë populli. Ata përpiken të organizojnë një

luftë tjetër për të mëkëmbur fashizmin, ata ndihmojnë monarko-fashistët grekë, ata përpiken të hedhin popujt në një luftë të tretë, në një kasaphanë të re. Mirëpo nuk do t'ja dalin dot, sepse në krye të popujve, që mbrojnë paqen, që mbrojnë njerëzimin, qëndron Bashkimi Sovjetik. Ata kujtojnë se Bashkimi Sovjetik është dobësuar nga lufta. Kjo nuk është e vërtetë. A është dobësuar populli shqiptar pas kësaj lufte? Kurrë ndonjëherë populli shqiptar nuk ka qenë më i fortë se tani. Kështu është edhe Bashkimi Sovjetik dhe gjithë popujt që kanë luftuar fashizmin. Prandaj manevrat anglo-amerikane do të dështojnë, sepse forcat e paqes dhe të përparimit janë të forta. Vetë në Amerikë dhe në Angli populli është kundër politikës së qeverive të tyre. Në këto vende punëtorët shpërthejnë në greva.

Imperialistët duan kurdoherë çështjet t'i zgjidhin me luftë, prandaj ata nxisin këlyshët e tyre në Greqi, monarko-fashistët, të cilët bëjnë provokime të vazdueshme në kufitë tanë. Ata na akuzojnë se ne jemi shkaktarë të luftës civile në Greqi; ata na akuzojnë se gjoja ne i japim armë ushtrisë demokratike greke. Këto s'janë të vërteta, por ne e shohim me sy të mirë popullin grek, ne duam që populli grek të çlirohet, pse e meriton. Ai ka luftuar dhe lufton për lirinë e tij; kjo është një punë e popullit grek. Këtë le ta zgjidhin vetë. Ne as jemi përzier dhe as përzihemi në punët e brendshme të Greqisë. Por anglo-amerikanët këtë e bëjnë për të fshehur lodrën e tyre të përgjakshme. Ata gjoja e ndihmojnë Greqinë për t'u rimëkëmbur dhe i dërgojnë topa e mitraloza për të vrarë popullin grek. Këtë lodër monarko-fashistët duan ta fshehin, prandaj na

akuzojnë nc. Por me shpifjet e akuzat e tyre ata nuk mund të bindin asnjeri. Ne s'kemi frikë nga manevrat e tyre; ajo që ngjet në Greqi është vepër e anglo-amerikanëve dhe e monarko-fashistëve dhe e askujt tjetër. Me veprime të tillë, ata përpinqen për të luftuar vendin tonë, Republikën tonë Popullore.

Misionet anglo-amerikane, që kishin ardhur në Shqipëri gjoja për të njohur qeverinë, grumbulluan gjithë tradhëtarët, reaksionin, mbeturinat e «Ballit» e të «Legalitetit», për t'i hedhur në luftë kundër popullit shqiptar. Ata u përpoqën të organizonin sabotazhe, të bënин atentate, të rrëzonin pushtetin tonë popullor me forcë dhe gjithë shpresat e tyre vareshin në një zbarkim të anglo-amerikanëve. Ky zbarkim, as nuk u bë, as nuk do të bëhet kurrë. Pushteti popullor i kapi këta njerëz nga zverku, i coi në gjyq dhe u dha dënim të pamëshirshëm. Të tillë kanë qënë Agathokli Xhitomi e të tjerë. Kush ishin këta njerëz? Këta njerëz ishin nga ata që tërë jetën e tyre janë shitur te të huajt dhe që tërë jetën e tyre janë përpjekur ta shesin edhe vendin tonë; ata janë përpjekur ta shesin vendin tonë te Greqia e Caldarisit. Kush ishte Agathokli Xhitomi? Ai qe shërbëtori i Zogut, që tri ditë para se të vinin italianët, bërtiste si çakall nga Bashkia e Korçës, për Zogun e trashëgimtarët e tij, por, kur u zaptua Shqipëria, po ky cirrej për Musolinin. Tani ky është i shitur te reaksiuni anglo-amerikan dhe te monarko-fashistët grekë. Si ky ishin edhe të tjerët, të cilët kishin shpresa te amerikanët e te anglezët. Mirëpo anglo-amerikanët këta njerëz i kanë si limoni: i shtrydhin sa i shtrydhin, pastaj i hedhin. Tradhëtarët në vendin tonë nuk do të mundin

kurrë t'ja arrijnë qëllimit. Populli ynë dhe pushteti ynë janë më të fortë se kurrë. Prandaj, me besimin më të madh për të ardhmen tonë, t'i përvishemi punës. Të zbatojmë si duhet planin dhe urdhëresat e ligjet e qeverisë, të cilat janë në favor të popullit. Zbatimi i tyre ka një rëndësi të madhe për jetën tuaj. Duhet të përpinqeni që të gjitha ligjet e urdhëresat t'i kuptioni mirë se kjo ka një rëndësi të posaçme; t'i kuptioni si nga ana politike, ashtu dhe nga ana ekonomike, sepse këtej varet mirëqenja juaj, jeta juaj dhe e kalamanëve tuaj. Mos dëgjoni armiqtë, të cilët përpinqen si e si të kritikojnë, të shajnë e të thonë andej-këtej gjoja se s'kemi bukë, s'kemi atë, s'kemi këtë. Në këtë mënyrë këta njerëz duan të dobësojnë pushtetin tonë, por ne nuk do t'i lëmë. Fronti Demokratik duhet të bëhet një organizatë e gjallë, ku duhet të mblidheni shpeshherë për të biseduar e për të diskutuar për çdo problem; të kritikoni ata njerëz që nuk punojnë mirë, që nuk punojnë drejt. I kritikoni pa frikë këta njerëz, sepse ata njerëz që zgjidhen në këshillat popullore janë njerëz të popullit e zgjidhen për t'i shërbyer popullit. Në qoftë se nuk veprojnë kështu, ju i zboni. Në asnjë mënyrë mos gaboni që të zgjidhni në këshilla njerëz, që nuk gjëzojnë besimin e popullit, njerëz që nuk e duan popullin, njerëz që nuk kanë vuajtur. Në këshillat duhet të jenë njerëzit më të ndershëm, më luftëtarët, ata që shkrijnë çdo gjë për popullin dhe jo bejlerë e agallarë. Këshillat kanë një rëndësi të madhe dhe në rast se nuk do të kuptioni rëndësinë e këshillave, atëhere puna do të çalojë. Qeveria do t'u ndihmojë, do t'u japë shumë gjëra. Por në qoftë se njerëzit në këshillat tuaja nuk janë të

mirë, atëhere ata do të bëjnë hatëre. Pra çështja është që pushteti dhe Fronti Demokratik të bëhen sa më të fortë.

Prandaj me atë besim, që ka pasë në luftë, populli i Përmetit si dhe i gjithë populli i Shqipërisë t'i përvishet punës, pse do të kemi ditë më të mira.

Rroftë populli i Përmetit!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë Republika Popullore!

Rroftë Partia Komuniste!

Rroftë Fronti Demokratik!

Rroftë Ushtria jonë Kombëtare!

*Botuar përmirë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 864.*

7 tetor 1947

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 864.*

7 tetor 1947

FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË BERATIT

6 tector 1947

Të dashur motra dhe vëllezër të qytetit të Beratit dhe të gjithë qarkut.

Jam shumë i gjëzuar dhe shumë i emocionuar nga pritja kaq e përzemërt që më bëni. Në emër të qeverisë sonë, në emër të Partisë sonë dhe në emrin tim, ju bie pëershëndetjet më të përzemërtat.

Tre vjet më parë, në prakun e çlirimtimit të plotë të Shqipërisë, unë me shokët e mi ishim në qytetin tuaj. Në qytetin tuaj, Berat, ne mbajtëm një mbledhje me rëndësi¹, e cila vendosi që Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar të shndërrrohej në Qeveri Demokratike të Shqipërisë. Ishte një eveniment me shumë rëndësi, sepse Qeveria Demokratike kishte përpëra detyra të mëdha dhe me shumë rëndësi. Tamam në qytetin tuaj Qeveria Demokratike përcaktoi edhe më mirë detyrat që dilnin para nesh në prakun e çlirimtimit të plotë të Shqipërisë.

¹ Është fjala për Mbledhjen e dytë të Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar që zhvilloi punimet në Berat më 20-23 tector 1944.

përisë. Çështja kryesore ishte që të nxirrej jashtë atdheut armiku që kishte shkelur vatrat tona dhe që kishte djegur e vrarë popullin tonë. Dhe këtej nga Berati, qeveria dha urdhër që armiku të ndiqej këmba-këmbës, derisa të dorëzonte armët. U dha urdhëri që të çlirohej Tirana dhe tërë Shqipëria. Brigadat dhe divizionet tona u hodhën në sulm. Në qytetin e Tiranës në shtëpi, në rrugë, në penxhere luftuan djemtë tanë me heroizëm të pashembullt. Ata u morën istikamet gjermanëve dhe vranë me mijëra e me mijëra gjermanë dhe Tirana u çlirua. Më 29 Nëntor, që do të jetë një datë historike e pavdekshme, atdheu ynë i dashur u çlirua i téri.

Vellezër dhe motra të dashura,

Ju e dini se sa e egër dhe e ashpër ishte lufta. Që të çlirohej populli ynë duhej patjetër të derdhte gjakun e djemve dhe të çupave të tija më të mira, duhej të merrte parasysh çdo gjë edhe sakrificën e fundit, d.m.th. jetën. Populli e kishte kuptuar këtë, Partia jonë Komuniste ja tregoi rrugën. Ajo i tha popullit: do të ecësh në rrugën për çlirimin e atdheut. Prandaj dhe populli ynë rroku armët dhe me parullat e Partisë dhe të Frontit triumfoi. Nga populli fukara, nga gjiri i popullit të shumëvuajtur dolën djem trima që shkruan faqen më të shkëlqyeshme në historinë e vendit tonë, ata bënë mrekullira, formuan batalionet, brigadat, divizionet dhe luftuan me tërë fuqitë e tyre kundër italianëve, kundër gjermanëve, kundër ballistëve dhe i mundën, sepse luftuan dhe mbrojtën çështjen e popullit. Gjermanët e italianët kishin armë, kishin munizione, forca të mëdha

balliste, bejlerë e agallarë, tregëtarë spekulatorë, të gjithë këta përhapnin parulla si e si të përçanin popullin; ata donin ta ndanin popullin nga Fronti Nacional-Çlirimtar, që kështu ta shtypnin më mirë. Mirëpo, populli i organizuar në Frontin Nacional-Çlirimtar, nuk eci në rrugën e tyre, ai i njihetë mirë kush ishin Ali Këlcyrë me shokë; ata ishin nipërit dhe stërnipërit e atyre që kishin shtypur katundarët dhe popullin për shekuj me radhë dhe që e kishin katandisur popullin të vuante për një copë bukë.

Populli ndoqi Partinë, ndoqi Partinë e tij Komuniste, se në Partinë ishin djemtë tuaj, ishin çupat tuaja, ishte shpirti juaj.

Partia e udhëhiqte popullin në luftë për të fituar pavarësinë dhe për të vendosur këtu në vendin tonë ligjin tuaj, ligjin e popullit. Që në ditët e para të luftës krahina e Beratit ka luftuar me trimëri kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve. Kudo në malet e kësaj krahine djemtë tuaj luftuan me heroizëm të pashoq.

Lavdi dëshmorëve të kësaj krahine që dhanë jetën për atdhe!

Lavdi Margarita Tutulanit, Kristaq Capos, Ramiz Aranitasit, Kristaq Tutulanit, Ajet Xhindolit, Kolë Myzeqarit, Xhezmi Saraçit, Skënder Libohovës, Jani Robos e qindra të tjera që dhanë jetën për lirin!

Në saje të gjakut të derdhur, në saje të sakrificave ne arritëm në ditën e 29 Nëntorit 1944 që përmenda më lart. Qeveria, e krijuar në Berat, vajti në Tiranë dhe janisi punës për të realizuar qëllimet dhe aspiratat, përtë cilat luftoi populli ynë.

Vendi ynë ishte i shkatërruar: urat, rrugët, fabri-

kat, minicerat, centralet të gjitha ishin hedhur në erë; bujqësia ishte shkatërruar. Katundarit tonë ju rrëmbyen bagëtitë; armiqtë i kishin marrë popullit tonë edhe ato pak plaçka që kishte. Por para kësaj situate të tillë ne nuk u dëshpëruam, përkundrazi ne i ndërtuam të gjitha me një vullnet të madh. Patjetër ne luftuam për disa qëllime të shenjta dhe këto nuk do të realizoheshin, po të ngjiste sikur ka ngjarë në historinë e popullit tonë, që populli luftonte dhe bejlerët e agallarët rrëmbezin frytet e gjakut të tij. Prandaj që në ditët e para të çlirimit të Shqipërisë ne muarëm një seri masash për t'i siguruar popullit një jetë më të mirë. Këto masa ishin: shtetëzimi i minierave dhe i fabrikave. Ato s'mund të ishin prona e të huajve dhe as që mund të ishin pronë e bejlerëve, e agallarëve dhe e tregëtarëve spekulatorë. Kuçova, Patosi, Rubiku, etj. u bënë pronë e popullit dhe u vunë në shërbim të popullit që në ditët e para të çlirimit. Me kë i ngritëm ne këto? Me ju, që punuat në të katër anët, që punuat e mblohdhët copa hekurash të vjetra dhe, me gjithë sabotazhet e italianëve që kishin mbetur këtu, ndërtuat Kuçovën. Ne ja arritëm qëllimit, ne ngritëm Kuçovën e sot kjo prodhon më tepër se në kohën e italianëve dhe të gjermanëve. Kuçova prodhon naftën, që është shumë e nevojshme për ne.

Të gjitha reformat që u bënë pas çlirimit ndihmuani që jeta e popullit tonë të bëhet më e mirë, të mos mungojë buka e drita. Katundari mori tokën dhe filloi ta punojë më mirë dhe të prodhojë më tepër, se tani toka ishte e tij. Nga ana tjetër, u hapën më shumë shkolla, me qindra shkolla më tepër nga ç'kishim përpara. e kjo tregon se pushteti ynë shkon përpara.

Nga ana tjeter, kjo tregon një gjë me shumë rëndësi: populli ynë, pas këtij revolucioni të madh që bëri, ka etje të madhe për t'u pajisur me kulturë, për të mësuar, për t'u zhvilluar. Arësimi dhe kultura do të bëjë që populli ynë të dalë sa më shpejt në dritë, pse sa më shumë të mësojë ai, aq më tepërjeta e tij do të bëhet më e mirë.

Por sukseset që kemi pasur gjatë këtyre tre vjetve do të na shërbejnë për të arritur fitore edhe më të mëdha. Qeveria jonë ka pregetitur një plan pesëvjeçar. Ky plan parashikon që bujqësia jonë të marrë hov, që në fushat tuaja të Myzeqesë të bëhen kanale të mëdha vaditëse dhe kulluese për tharje tokash. Me këto punime do të bëhet e mundur që të shtohet sipërfaqja e tokës dhe bujqit tanë do të kenë mundësi që të mbjellin më shumë dhe të marrin më tepër prodhime bujqësore. Kjo ka rëndësi të madhe. Qeveria jonë mendon që bujqit tanë të mos punojnë tokat me mjete të vjetra. Për këtë arësy qeveria parashikon t'u japë bujqevnjë kredi të mjaftë, me të cilën ata do të blejnë plugje dhe mjete moderne. Me këto mjete toka do të punohet më mirë dhe, nga ana tjetër, bujqit do të shtojnë bagëtitë e kafshët e trasha dhe do të përmirësojnë racën e kafshëve. Gjithashtu qeveria ka sjellë dhe do të sjellë një numër të madh traktorësh dhe farëra të seleksionuara. Të gjitha këto do të bëjnë që fshatari të përmirësojë gjendjen ekonomike dhe kur përmirësohet gjendja e fshatarit, është përmirësuar gjendja e tërë popullit tonë.

Plani i shtetit parashikon të ndërtohen hekuru-dha të reja përvèç hekurudhës Durrës-Elbasan. He-

kurudha ka rëndësi shumë të madhe, e para, se lehtësohen marrëdhënjet e krahinave të ndryshme, po dhe shkëmbimi i mallrave dhe i prodhimeve bëhet më i lehtë. Mirëpo rëndësia më e madhe e saj është se, me anë të hekurudhave, do të shfrytëzohen edhe më mirë pasuritë e nëntokës sonë. Këto pasuri nga ana e tyre do ndihmojnë për ngritjen e fabrikave. Këto do të bëjnë që populli ynë të ketë më shumë mallra dhe më të lira. Nga ana tjetër, pasuria e nëntokës sonë në këtë mënyrë do të eksportohet edhe jashtë shtetit duke i ndërruar me gjëra që kemi nevojë.

Do të hapen rrugë të reja, shkolla të reja, kurse etj., ku do të mësojnë djemtë tuaj. Këto e shumë gjëra të tjera përbledh plani pesëvjeçar i shtetit tonë. Dhe çdo ditë ju do të konstatoni se jeta do të përmirësohet, ju e konstatoni dhe tani se gjendja nuk është më ajo e dy-tre vjetve më parë. Sot punëtori ynë është më mirë, katundari ynë është më mirë. Kjo ngjet, se pushteti është në duart e popullit dhe ai punon me mish e me shpirt për të mirën e popullit, për interesat e popullit.

Ne jemi një popull i vogël, por heroik, ne luftuam me mish e me shpirt, ne po ndërtojmë vendin me një vullnet të madh, me një mobilizim të fortë dhe që s'është parë kurrë në vendin tonë. Por në këtë çështje ne patëm dhe ndihmën e miqve tanë. Ne luftuam me heroizëm, por fitorja jonë, fitorja e Evropës dhe fitorja e gjithë njerëzimit ishin të lidhura me fitoren e Ushtrisë së Kuqe. Në saje të Ushtrisë së Kuqe u thye Gjermania. Bashkimi Sovjetik është miku dhe aleati ynë më i ngushtë dhe më i singertë. Ai tani në kohën e ri ndërtimit të vendit tonë po na ndihmon me të gjitha

mundësitë, qoftë për të ngritur ekonominë, qoftë për të zhvilluar kulturën dhe arësimin, qoftë për të na mbrojtur kundër intrigave të reaksionit të jashtëm. Qeveria sovjetike i akordoi popullit tonë gjithshka që ne i kërkuan. Qeveria sovjetike na dha fabrika, na dha traktorë, na dha mjete për shkolla, na dha mundësitë që djemtë tanë të mësojnë në universitetet më të mira të Bashkimit Sovjetik.

Bashkimi Sovjetik na ndihmon edhe kundër intrigave të reaksionit ndërkombëtar. Ju e dini se ka edhe shtete që nuk e duan të mirën e popullit tonë, por neve aq na bën. Ne gjatë rrugës sonë të drejtë, rrugës sonë paqësore, ecim të sigurtë me gjithë pengesat e reaksionit ndërkombëtar me amerikanët në krye, që përpiken si e si të prebatit një luftë të re. Ata përpiken me të gjitha mënyrat të ringjallin Gjermaninë hitleriane, të ringjallin fashizmin italian, ata përpiken të forcojnë monarko-fashistët grekë e të tjerë banditë të tillë, t'i organizojnë e t'i hedhin në një luftë të tretë kundër Bashkimit Sovjetik dhe popujve përparimtarë të botës, në mes të cilëve bën pjesë dhe populli ynë i vogël. Ju keni dëgjuar se ç'poshtërsira, mashtrime, gënjeshtra po bëjnë monarko-fashistët grekë kundër vendit tonë; keni parë dhe keni dëgjuar se si njerëzit amerikanë, që kanë qenë këtu në Shqipëri, në vend që të vinin këtu si miq dhe alcatë për të njohur qeverinë e popullit tonë. ata kishin ardhur me të vetmin qëllim që të organizonin fashistët, mbeturinat e «Ballit» e të «Legalitetit», bejlerët e agallarët dhe t'i hidhnin në luftë kundër popullit tonë. Mirëpo, që të gjitha këto manevra dështuan dhe do të dështojnë njëra pas tjetrës.

Akuzat që bëhen kundër popullit tonë, se gjoja ne ndihmojmë ushtrinë demokratike të popullit grek, se jemi shkaktarë të luftës civile e të tjera profka, janë gjennjeshtra. Ne as i kemi ndihmuar dhe as që i ndihmojmë, por ne i simpatizojmë ata që luftojnë për lirinë, për pavarësinë e popullit grek.

Ju keni parë dhe dëgjuar gjyqin që u zhvillua në Tiranë kundër disa tradhëtarëve e të shiturve te i huaji. Mestan Ujaniku¹ nuk është bir i maleve kreshnikë që kanë lindur trima, që kanë dhënë heronj, që kanë luttuar me vetëmohim për çlirimin e Shqipërisë; ai ka qenë shok me Xhelal Staraveckën², ai ka organizuar komplotin kundër patriotëve Baba Faja³ e Baba Fejzo⁴, ai qe lidhur ngushtë me anglo-amerikanët dhe për këtë arësy populli duhet të ketë sytë hapët dhe ata që punoj-

¹ Mestan Ujaniku, ish-komandant i Shtabit të qarkut të Beratit gjatë Luftës nacional-çlirimtare. Pas çlirimit të vendit zhvilloi veprimtari armiqësore në shërbim të imperialistëve amerikanë. U dënuar nga gjykata popullore si armik i popullit dhe i atdheut.

² Xhelal Staravecka, dezertor nga radhët e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Bashkëpunëtor i pushtuesve nazistë gjermanë, udhëheqës i bandave të organizatës tradhëtare të «Ballit Kombëtar».

³ Mustafa Xhani, (1910—1947) Hero i Popullit. Anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar dhe i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH gjatë Luftës nacional-çlirimtare, deputet i Kuvendit Popullor të RPSH. U vra tradhëtisht nga armiqëtë e popullit dhe të pushtetit popullor më 18 mars 1947.

⁴ Fejzo Dervishi, pjesëmarrës aktiv në Luftën nacional-çlirimtare. Pas çlirimit deputet i Kuvendit Popullor të RPSH. U vra tradhëtisht nga armiqëtë e popullit dhe të pushtetit popullor me 18 mars 1947.

në për kauzën e tij të shenjtë, t'i vërë në krye të punës, kurse për ata që punojnë kundër tij, të mos ketë asnjë mëshirë. Të jeni të sigurtë se në këtë mënyrë pushteti do të jetë më i fortë dhe Shqipëria do të lulëzojë më shpejt.

Ne kemi besim në forcat e popullit tonë, të cilin e kemi parë në momentet më të rrezikshme, të cilin e kemi parë gjatë Luftës nacional-çlirimtare, të cilin e pamë tani me sytë tanë kudo që vamë, që nga Fieri e deri këtu.

Rroftë populli i Beratit!

Rroftë Fronti Demokratik!

Rroftë Partia Komuniste!

Rroftë ushtria jonë heroike!

Rroftë rinia jonë e lavdishme!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 864,
7 tetor 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 864,
7 tetor 1947*

FJALA E MBAJTUR PËRPARA PUNËTOREVE TË KUÇOVËS

7 tetor 1947

Shokë punëtorë të Kuçovës,

Gëzimin që ndjej unë sot, që vij në mes tuaj, nuk mund ta përshkruaj. Jam i gëzuar sepse ndodhem në mes jush, që keni qenë dhe jeni shtylla më e fortë e Partisë sonë Komuniste, e Partisë sonë të fortë që e drejtoi popullin në një luftë të ashpër dhe sot po ndërton ditë më të mira, fate të lumtura për popullin dhe për atdheun tonë. Në emër të Partisë, në emër të qeverisë dhe në emrin tim ju përshëndes nga zemra, shokë punëtorë dhe teknikë të Kuçovës.

Ju e dini, shokë punëtorë, se populli ynë i udhëhequr nga Partia jonë bëri një luftë të ashpër, për këto qëllime: për pavarësi, për liri, për sovranitetin e popullit tonë, për ta sjellë popullin në fuqi që ai të drejtojë fatet e veta dhe njëkohësisht të luftojë pa mëshirë dhe të zhdukë nga faqja e dheut farën e fashizmit. Në këtë vepër populli ynë ishte aleat i vogël por besnik i Bashkimit të madh Sovjetik dhe i të gjithë popujve të tjerë përparimtarë që ndoqën po këtë rrugë, rrugën e lavdish-

me të Bashkimit Sovjetik. Ju e dini se Bashkimi Sovjetik mbajti mbi supet e tij peshën më të rëndë të kësaj lufte të përgjakshme dhe në saje të tij u mundën Gjermania naziste dhe gjithë satelitët e saj. Bashkimi Sovjetik luftoi për t'u dhënë liri popujve të vegjël, për të çliruar botën nga skllavëria më e rëndë, për të vendosur një paqe të drejtë. Për këtë arësyen Bashkimi Sovjetik dhe gjithë popujt e robëruar të Evropës dhe popujt përparimtarë ndoqën me vendosmëri rrugën për zhdukjen e Gjermanisë naziste, të Japonisë militariste dhe të satelitëve të tyre.

Në aleancën antifashiste kishte dhe të tjerë shtete si Amerika dhe Anglia, të cilat nuk ndoqën po këtë qëllim. Imperialistët anglo-amerikanë kishin për qëllim që të zhduknin konkurentët e tyre, fashistët dhe nazistët gjermanë etj., e mandej të vendosnin në botë hegemoninë e tyre.

Që në kohën e luftës dukeshin qartë qëllimet e Bashkimit Sovjetik e të popujve përparimtarë dhe ato të imperializmit anglo-amerikan. Ne po shohim që kjo rrugë të përcaktohet edhe më qartë në kohën e pasluftës.

Nga njëra anë shohim Bashkimin Sovjetik, Shqipërinë dhe të tjera vende që ndjekin rrugën e drejtë, rrugën e sigurimit, rrugën e paqes, rrugën e bashkëpunimit ndërkombëtar për mbrojtjen e pavarësisë, të lirisë dhe të demokracisë së vërtetë. Nga ana tjetër shohim forcat imperialiste, me në krye imperializmin amerikan, që mundohen të mëkëmbin Gjermaninë naziste, Japoninë militariste dhe të tjerë këlyshë të tyre, të krijojnë kështu një situatë lufte për të hedhur popullin në një kasaphanë të tretë. Por të gjitha manevrat e tyre do të

dështojnë, se në krye të luftës për mbrojtjen e fitores, për mbrojtjen e demokracisë e të paqes qëndron Bashkimi Sovjetik me në krye Stalinin e madh.

Këto momente duhet t'i kuptojë mirë populli ynë dhe në radhë të parë klasa punëtore, e cila duhet të jetë në pararojë që t'uua bëjë të qartë popullit tonë se këtej varet sigurimi i lirisë dhe i pavarësisë, që ne e kemi fituar me kaq vuajtje e sakrifica.

Ju, shokë punëtorë, i keni dëgjuar e mësuar të gjitha manevrat, të gjitha shantazhet e frikësimet që i bëhen popullit tonë nga imperialistët anglo-amerikanë. Ata përpiken që popullin dhe vendin tonë ta kthejnë në kohën e vjetër, ata kërkojnë të rimëkëmbin përsëri mbeturinat e reaksionit fashist dhe këto t'i organizojnë dhe t'i hedhin në luftë kundër pushtetit popullor. Njëkohësisht, me manevrimet që bëjnë këtu brenda me agjentët e tyre, ata zhvillojnë një fushatë shpifjesh kundër vendit tonë. Ata na akuzojnë për gjëra të paqena. Na akuzojnë se populli ynë, liridashës e demokratik, kërcënnon paqen. Na akuzojnë se gjoja ne jemi një popull që kemi shkaktuar luftën në Greqi, që gjoja ne ndihmojmë popullin grek, etj., etj. Të gjitha këto i thonë që të fshehin lodrën e tyre politike grabitëse e shtypëse. Nën maskën e demokracisë false ata po ndezin zjarr në shumë vende. Ajo që po ngjet në Greqi është vepër e tyre dhe jo e jona dhe as e Jugosllavisë e as e Bullgarisë. Populli grek ka marrë armët e po lufton, po gjakoset, po shtypet e po vritet për pavarësinë e tij.

Të gjithë mbeturinat e fashizmit, bejlerët e agallarët, të fshehur nën maskë, po përpiken me njëmijë mënyra për të dëmtuar punën, për të dëmtuar djersën

tonë. Këtë ju e keni parë vetë këtu në Kuçovën tuaj, që e keni ngritur me thonj e me dhëmbë duke ndënjur pa gjumë. Këta agjentë të imperializmit anglo-amerikan janë munduar të bëjnë sabotazhe. Këta kanë qenë djem bejlerësh e agallarësh që e kanë pasur në gjak shtypjen e punëtorëve. Ata nuk mund të duronin këtë situatë që është krijuar në vendin tonë në saje të revolucionit tonë popullor. Këta agjentë, duke mos pasur mbështetje në masat e popullit, u lidhën me të huajt, me ata që kishin shkaktuar fatkeqësi për shekuj me radhë në vendin tonë dhe u përpoqën me mish e me shpirt që të na goditin më mirë. Por morën dënimin e merituar. Në kapjen e këtyre sabotatorëve ju keni qenë mbrojtësit e pushtetit dhe ju i keni demaskuar këta me punën tuaj. Vetëm në këtë mënyrë, me vigjilencën tuaj, ata nuk do të munden kurrë t'ja arrijnë qëllimit. Ata jo vetëm që nuk do t'ja arrijnë dot kurrë qëllimit të rrëzojnë pushtetin tonë, por nuk do t'i lëmë që të na cënojnë qoftë edhe pak. Klasa punëtore duhet të jetë në ballë të çdo përpjekjeje të popullit shqiptar, se ajo është klasa më e ndërgjegjshme, ajo është klasa udhëheqëse, prandaj ju, punëtorët e Kuçovës, duhet të përfitonit nga teknika, ta përvetësoni teknikën që të mos mbetet më në duart e atyre që na sabotojnë, që lidhen me armiqtë dhe kërkojnë ta djegin dhe ta hedhin në erë Kuçovën. Nga punëtorët e Kuçovës duhet të dalin njerëz të zot, duhet të dalin teknikë të zot, se vetëm kështu Kuçova do të përparojë, vetëm kështu fabrikat dhe minierat tona do të ecin përpara.

Qeveria dhe Partia janë lidhur ngushtë me ju. Ju e dini se sa rëndësi të madhe ka nafta e benzina për vendin tonë. Prandaj ju duhet që planin e shtetit jo

vetëm ta përbushni, por edhe ta tejkaloni. Kjo është detyra juaj.

Ju e dini se pa naftë nuk mund të ecin të gjitha punimet, ajo është si gjaku në trupin e njeriut, d.m.th. te ju varet që vendi ynë, fabrikat tona të kenë naftë më tepër. Prandaj ju, punëtorët e Kuçovës, ashtu si keni punuar që në ditët e para të çlirimtët në këto kantiere, tanë duhet të punoni njëqind herë më shumë, ju duhet të jeni vigjilentë shumë e më shumë, ju duhet të jeni mbrojtësit e fitores e të pasurisë së shtetit, që është pasuria e popullit. Ju punëtorët jeni nga ushtarët më besnikë të Partisë sonë, e cila çliroi Shqipërinë e që eçon drejt përparimit.

Nga puna juaj, e punëtorëve të Kuçovës dhe e gjithë punëtorëve të kantiereve të vendit tonë janë arritur rezultate të mëdha në punë. Industritë dhe fabrikat në vendin tonë do të shtohen, se për këtë gjë kemi ndihmën më të madhe të Bashkimit Sovjetik.

Kur shkova në Bashkimin Sovjetik, bisedova me Stalinin e madh, mikun e shtrenjtë të popullit tonë. Ai fliste me dashuri të madhe për popullin tonë, për luftën e ashpër dhe për punën tonë. Ai u interesua për klasën punëtore dhe për jetën e gjithë popullit. Nga ana tjetër, ai tha se «populli shqiptar është një popull i mirë, ka luftuar për liri dhe ne do ta ndihmojmë me gjithë zemër». Ai na dha fabrika, të cilat do të vijnë për së shpejti, na dha një numër të madh traktorësh, të cilët do të ndihmojnë për zhvillimin e bujqësisë sonë, na dha mjete për të përhapur kulturën e arësimin tonë. Ai tha që «Shqipëria të dërgojë djemtë e klasës punëtore e fshatare që të mësojnë e të zhvillohen për ta shpënë

Shqipërinë më përpara», që populli ynë të bëjë një jetë më të lumtur. Këto më tha Stalini i madh.

Rroftë Stalini i madh!

Shokë punëtorë, rruga që po ndjekim është rruga e vërtetë, është rruga e shpëtimit. Detyrat tona janë të mëdha. Ju nuk duhet të keni frikë nga puna. Prandaj t'i përvishemi punës me mish e me shpirt që Kuçova jo vetëm të prodhojë më shumë naftë e benzinë, por të nxjerrë edhe teknikë e specialistë të mbaruar, të cilët të marrin në duart e tyre punimet në fushat e tjera të naftës për të zhvilluar ekonominë e vendit tonë. Zhvillimi i ekonomisë në vendin tonë ka një perspektivë të madhe.

Ne nuk do të mbetemi me hekurudhën Durrës-Elbasan, por do të ndërtojmë edhe hekurudha të tjera, siç parashihen në planin pesëvjeçar që jemi duke e hartuar. Hekurudhat jo vetëm që do të shërbejnë për të shkëmbyer mallrat nga një vend në tjetrin, jo vetëm që do të përhapin kulturën e përparimin në vendin tonë, por ato do të shërbejnë sidomos për zhvillimin e minierave tona, që janë pasuria më me rëndësi e vendit tonë.

Prandaj, shokë punëtorë, të ecim përpara me vendosmëri dhe me besimin më të madh që t'i sigurojmë popullit tonë një jetë më të lumtur. Të forcojmë demokracinë tonë, pushtetin popullor, të ruajmë integritetin e sovranitetin e vendit tonë e të forcojmë aleancën e miqësinë me Bashkimin Sovjetik.

Rroftë klasa punëtore e Shqipërisë!

Rrofshin punëtorët e Kuçovës!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë Partia jonë Komuniste!

Rroftë Fronti Demokratik!

Rroftë ushtria jonë heroike!

Rroftë rinia jonë heroike!

Rroftë mbrojtësi i paqes, i lirisë, i demokracisë,
Bashkimi Sovjetik!

Rroftë miku më i shtrenjtë dhe më i dashur i po-
pullit tonë, Stalini i madh!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 865,*

8 tetor 1947

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 865,*

8 tetor 1947

PËRMBLEDHJE E FJALËS SË MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË LUSHNJËS

7 tetor 1947

Ju përshëndes nga zemra në emër të qeverisë, në emër të Partisë, që ju e doni aq shumë dhe në emrin tim.

Ju e doni me gjithë shpirt Partinë dhe keni të drejtë që jeni me të. Në saje të Partisë sonë heroike ne arritëm në ditën e sotme. Partia Komuniste, që u formua në ditët më të errëta të vendit tonë, që u formua nga ju punëtorë, fshatarë, patriotë, që u formua nga të gjithë ata që kishin hequr të zitë e ullirit, nga bijtë më të mirë, më trima, më besnikë, nga bijtë tuaj, e udhëhoqi popullin në luftën më të tmerrshme që ka parë vendi ynë, që ka parë gjithë njerëzimi.

Me formimin e Partisë, fitorja u bë e sigurtë, se populli kishte një udhëheqje të fortë, udhëheqjen e Partisë Komuniste.

Partia Komuniste kishte një program, i cili përmblidhte në radhë të parë çlirimin e të gjithë popullit shqiptar, çlirimin nga zinxhirët e bejlerëve dhe të agallarëve dhe formimin e këshillave nacional-çlirimtare.

Por për t'ja arritur këtyre qëllimeve nuk ishte një punë e lehtë. Partia ju kishte thënë se do ta fitojmë

lirinë e pavarësinë, por do të bëjmë shumë sakrifica, se pa sakrifica ne nuk mund t'ja dalim mbanë.

Armiku ishte i armatosur gjer në dhëmbë, kurse populli ynë nuk kishte as armë, as municion, asgjë prej gjëje, por ai kishte diçka më shumë se armiku — kishte zemrën e fortë dhe vendosmërinë e tij për të fituar pavarësinë. Prandaj u hodh në luftë pa rezerva dhe fitoi.

Pastaj shoku Enver foli mbi reformat e mëdha që janë bërë në Shqipëri pas çlirimt, për goditjet e rënda që u bëri tradhëtarëve pushteti popullor.

«Ju e dini se edhe regjime të tjera, për t'i hedhur hi syve popullit, flisnin për reformën agrare. Ky ishte regjimi kusar i Zogut. Atëherë u bënë ca regjistrime katundarësh, por nuk u prek toka e Vrionasve, as e Toptanasve dhe reforma u zbatua në kurrit të katundarëve të varfër».

Shoku Enver foli mbi zbatimin e drejtë të reformës agrare dhe mbi programin e qeverisë për një zhvillim më të mirë të bujqësisë.

«Populli shqiptar ka pasur gjithmonë frikën e bukës, frikën e urisë, por këtej e tutje kjo frikë do të zhduket, se këtej e tutje do të punojmë më shumë e do të hapim toka të reja. Ne do të mbjellim edhe bimë industriale. Gëzimi im më i madh qe atëhere, kur një djali nga tuajt më dhuroi buqetën me pambuk. Për mua qe një gëzim shumë i madh ai që ndjeva atëhere».

Pasi vuri në dukje rëndësinë e zhvillimit të bimëve industriale, shoku Enver foli mbi bashkëpunimin që duhet të ekzistojë në mes punëtorëve dhe fshatarëve. Gjithashtu ai theksoi rëndësinë e urdhëresave e të ligjeve të qeverisë dhe të Kuvendit Popullor.

«Ju duhet ta kuptoni mirë — shtoi shoku Enver — se qeveria dhe Kuvendi Popullor punojnë e mendojnë për ju dhe vetëm për ju».

Duke demaskuar qëllimet e poshtra të reaksionit dhe parullat e tij, shoku Enver shtoi: «Katundarët s'janë budallenj, s'i hanë më ato. Ata thonë se s'kemi bukë, ose kemi vetëm për ca kohë, etj. profka. Ne kemi parë se si ata gjatë zbatimit të reformës agrare janë përpjekur të sabotojnë dhe kanë hedhur parulla. Ata i kemi kuptuar dhe kundër tyre kemi marrë dhe do të marrim masa. Ata tradhëtarë kishin për qëllim të dobësonin pushtetin, ta merrnin atë në duart e tyre dhe pastaj me anë të pushtetit të kishin mundësi të realizonin qëllimet e tyre të poshtra. Ju e keni parë në gjyqin e popullit se si tradhëtarët i deklaruan të gjitha qëllimet e tyre të errëta. Një nga ata ishte dhe Sheh Ibrahim Karbunara. Ata donin të merrnin pushtetin dhe të sabotonin reformën agrare».

Pasi theksoi se këta morën dënimin e merituar dhe se në këtë mënyrë do të dënohen të gjithë ata që do të ecin në këtë rrugë, shoku Enver foli për përpjekjet e misioneve anglo-amerikane në Shqipëri si gjatë luftës, ashtu dhe pas çlirimit, për t'i rrëmbyer popullit shqiptar frytet e gjakut dhe të sakrificave të tij.

Pastaj shoku Enver theksoi miqësinë e madhe dhe vëllazërore që kemi me Bashkimin e madh Sovjetik dhe Jugosllavinë Federative.

Shoku Enver e përfundoi fjalën e vet me thirrjen:

«Popull i Lushnjës, ne do të punojmë si gjithmonë dhe do të përpiqemi akoma më shumë, të prodhojmë sa më shumë, të forcojmë bashkimin, të forcojmë Frontin

dhe të jemi të sigurtë se asnje forcë nuk mund të na ndalë në rrugën tonë paqësore e përparimtare, për të ndërtuar një jetë më të mirë për popullin fukara, për popullin punëtor dhe gjithë njerëzit e ndershëm».

Rrofshin katundarët e Myzeqesë dhe të gjithë Shqipërisë!

Rroftë Republika jonë Popullore!

Rroftë Partia jonë Komuniste!

Rroftë Fronti Demokratik!

Rroftë rinia jonë trime!

Rroftë ushtria jonë, garancia më e madhe e pavarësisë!

Rroftë miku ynë i dashur dhe i shtrenjtë, Stalini i madh!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 866,
9 tetor 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 866,
9 tetor 1947*

FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË ELBASANIT

8 tetor 1947

Të dashur vëllezër dhe motra të qytetit dhe të qarkut të Elbasanit,

Ju përshëndes në emër të qeverisë, të Partisë dhe në emrin tim.

Jam shumë i gjëzuar dhe i emocionuar nga pritja juaj kaq e përzemërt. Gëzimi im dhe i shokëve të mi është i papërvikshkrueshëm që ne ndodhemi në qytetin, ku ka lindur shoku ynë më i dashur, Heroi i Popullit, Qemal Stafa dhe qindra dëshmorë të tjerë. Jemi të gjëzuar sot që ndodhemi në gjirin tuaj, në këtë qytet që ka qenë një nga qendrat e Luftës nacional-çlirimtare, një nga vendet e rezistencës sonë gjatë luftës më të ashpër e të egër që ka bërë populli ynë kundër okupatorëve italianë e gjermanë dhe kundër tradhëtarëve të vendit tonë.

Ditë të zeza kaluan mbi popullin tonë për vjete me radhë. Ne u gjendëm më 7 prill përpëra një armiku të madh, i cili, i armatosur deri në dhëmbë, na sulmoi që të na robëronte përjetë dhe të zhdukte popullin tonë.

Tragjedia e 7 prillit ishte rrjedhim i regjimit tradhëtar të Zogut dhe i kuislingëve të tjerë, si Mustafa Kruja, Shefqet Vërlaci e të tjerë tradhëtarë. Më 7 prill, populli ynë i vogël u gjend vetëm dhe i paarmatosur, ne u gjendëm vetëm në një kohë, kur demokracitë imperialisante, Anglia dhe Franca, të qeverisura nga klika reaktionare, bënин veshin të shurdhër dhe as që donin të dinin përfatim e një populli të vogël.

Por populli ynë i vogël nuk u përul, nuk e pranoj robërinë dhe që më 7 prill rroku armët e gjaku u derdh në tokat tonë. Populli ynë kurrë gjatë historisë së tij nuk e ka pranuar robërinë. Fakti është se megjithëse ishte një popull i vogël prej një milion banorësh, ai qëndroi i fortë dhe heroik kundër okupatorëve. Ai nuk u përul, por, me besim të madh në forcat e veta, filloi të organizojë rezistencën e luftës. Populli ynë e kuptoi që në fillim se pa luftë, nuk mund të shpëtonte nga thonjtë e italianëve okupatorë. Për këtë gjë, sikurse e dini dhe ju, ai bëri përpjekje të mëdha.

Por populli ynë kërkonte në luftën e tij një udhëheqje që ta shpinte në fitore. Kjo udhëheqje nuk do të ishte një udhëheqje sidokudo. Ajo duhej të dilte nga lufta, nga zjarri i luftës, nga bijtë më trima e më të guximshëm dhe kjo udhëheqje doli. Ajo ishte Partia jonë Komuniste. Partia Komuniste ishte partia e popullit, e përbërë nga bijtë e popullit fukara, nga bijtë e punëtorëve, nga bijtë e katundarëve, nga patriotët më të ndershëm, të cilët para çdo gjëje vinin interesat e popullit dhe përfshinat e cilin nuk kurserin as gjakun. Partia u tha anëtarëve të saj që të hidheshin atje ku ishte zjarri më i madh, të hidheshin atje ku ishte rreziku më i madh.

Ne e dinim se populli shqiptar, që kish vuajtur shekuj me radhë, do të haste në rrugën e tij edhe armiq të brendshëm. Cilët ishin këta armiq? Këta armiq ishin bejlerët e pashallarët si Shefqet Vërlaci, Ibrahim Biçaku e të tjerë, të cilët u lidhën me okupatorin kokë e këmbë pér të shpëtuar pasurinë e tyre, çifliqet e tyre që ishin në rrezik, pse populli do të ngrihej, pse populli do të udhëhiqej nga një parti e fortë. Këta përbënин një rrezik të madh. Ju e dini mirë çfarë metodash, çfarë mënyrash të poshtra përdornin tradhëtarët të grumbulluar në «Ballin Kombëtar», në «Legalitetin» e në të tjera organizata tradhëtare pér të luftuar Partinë, pér të luftuar e përqarë Frontin, pér të luftuar popullin shqiptar. Ata përdornin parulla gjoja nacionaliste. Ata bënë sikur dolën në mal pér të luftuar. Por ata nuk luftuan, sepse kishin qëllimin e tyre, donin të përqanin popullin, por ata s'mundën dot, sepse populli shqiptar ishte më i fortë, ishte organizuar në çeta, në batalione e në brigada dhe ai u hodh në sulme të njëpasnjëshme kundër okupatorëve, shpartalloi forcat e «Ballit» e të «Legalitetit», forcat e Shefqet Vërlacit e të Xhaf Balit etj., çliroi Shqipërinë me forcat e veta dhe na dha pavarësinë që ne gjëzojmë sot.

Gjatë kësaj lufte, këtu, në Elbasan është zhvilluar një aktivitet i gjerë revolucionar. Familjet e varfëra, familjet e përvuajtura në momentet më të rrezikshme kanë qenë çerdhet tona. Kudo ku kemi shkuar ne, dyert e zemrat i kemi gjetur hapur. Nënët plaka na kanë pritur mirë, na kanë inkurajuar duke na thënë: «Shkoni djema, luftoni, mos kurseni gjakun pér liri!»

Në krahinat tuaja kemi pasur ngjarje nga më të rëndësishmet. Këtu, në qarkun tuaj është formuar Shtabi

i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, datë e rëndësishme historike për luftën e popullit shqiptar. Me formimin e Shtabit të Përgjithshëm u organizuan njësitë e Ushtrisë sonë të lavdishme Nacional-Çlirimtare. Këtë Shtabi ynë ka dhënë urdhëra për të goditur kolonat e armikut, forcat e armikut. Këtu ishte Shtabi i Përgjithshëm, kur italianët dorëzuan armët. Në Labinot, në një nga momentet më të rrezikshme që po kalonte vendi ynë, u bë konferenca me rëndësi e Partisë Komuniste¹. Kjo konferencë u bë në fshehtësinë më të madhe, se forcat armike përgjonin dhe mund të sulmonin. Nga kjo konferencë doli Komiteti Qendror i Partisë Komuniste. Në Labinot u bë përsëri dhe Konferenca e dytë Nacional-Çlirimtare², ku u muarën vendime me rëndësi për t'u dhënë grushtin e fundit bandave të «Ballit», që ishin bërë vegël e okupatorit.

Në Luftën nacional-çlirimtare qyteti i Elbasanit dhe i krahinave të tij i ka dhënë Shqipërisë trima dhe heronj.

Lavdi këtyreve, lavdi e përjetshme! Lavdi Tomor Sinanit, Thoma Kalefit, Ptoleme Xhuvanit, Kozma Nas-kës, Tajar Guranjakut, Jorgji Dilos, Adem Krasniqit, Janaq Kilicës e qindra e qindra të tjerëve!

Motra e vëllezër,

Shqipërinë e çliruam, por ne duhej të realizonim të gjitha qëllimet e popullit tonë, për të cilin ai luftoi e derdhi gjak. Pjesa më e madhe e qëllimeve u arrit, ne

¹ Është fjala për Konferencën e parë të Vendit të PKSH që zhvilloi punimet në Labinot të Elbasanit më 17-22 mars 1943.

² Është fjala për Konferencën e dytë Nacional-Çlirimtare që zhvilloi punimet më 4-9 shtator 1943.

fituam lirinë e pavarësinë dhe pushtetin e mori populli në dorë. Kjo ishte çështja kryesore. Për kalimin e pushtetit në duart e popullit luftuan, për këtë na luftuan edhe armiqjtë.

Me anën e pushtetit ne do të realizonim reforma të njëpasnjëshme që do t'i jepnin popullit tonë tokën, do t'i siguronin bukën, do t'i jepnin arësimin e kulturën. Reforma agrare, që bëri qeveria jonë, u dha tokën katundarëve tanë, që brez pas brezi kishin vuajtur nën kamxhikun e beut dhe të agait. Toka tani i përket katundarit të varfër dhe ai do ta gëzojë përgjithmonë.

Gjithë minierat tona, të cilat Zogu me anë koncessionesh dhe me traktate ua kish shitur të huajve, u bënë pronë e popullit.

Të gjitha këto reforma shërbyen për të ngritur ekonominë e vendit tonë, për të hapur rrugë të reja, për të ndërtuar fabrika, për të ndërtuar shkolla, spitale, që do të ruajnë dhe do të përmirësojnë shëndetin e popullit tonë. Këto ishin reforma të domosdoshme. Në saje të këtyre reformavejeta e popullit tonë zuri të përmirësohet. Populli, që kish luftuar me heroizëm të madh, po me atë heroizëm ju përvesh punës dhe ai kishte besim në forcat e veta dhe e dinte se punonte për vete dhe jo më për të tjerët.

Por qeveria nuk do të mbetet me kaq. Ne nuk jemi një popull që të themi se fituam dhe mjaft, por jemi nga ata që nuk kënaqemi me kaq, por duam të ecim përpara me hapa edhe më të mëdhenj. Kurrë nuk është e mjaftë që katundari të ketë vetëm të hajë bukë dhe të jetojë në një kasolle të varfër dhe kalamajtë të jenë zhveshur e pa këpucë.

Prandaj qeveria janë ka një plan të madh, me anën e të cilit faqja e Shqipërisë do të ndërrojë dhe Shqipëria do të përparojë shumë e më shumë ejeta e popullit tonë do të përmirësohet.

Që nga dita e çlirimt e deri më sot në bujqësi janë bërë shumë gjëra. Me vullnetin e madh të popullit e me ndihmën e qeverisë janë hapur mjaft kanale vadi-tëse e kullucse. Por këto s'janë të mjafta. Në planin e ardhshëm do të ketë një seri bonifikimesh. Në fusha e kudo në Shqipëri do të hapen toka të reja buke. Katundarit do t'i bëhen të gjitha lehtësitë, do t'i jepen kredi, që të blejë vegla të reja pune, që të rrisë më mirë dhe të shtojë kafshët, të përmirësojë farën, etj.

Përsa i përket industrisë, do të hapen shumë fabrika, një pjesë e të cilave ka ardhur dhe pjesa tjetër do të vijë. Do të zhvillohen minierat në shkallë të gjerë, sidomos nxjerrja e naftës, që ka një rëndësi të jasht-zakonshme për vendin tonë; do të hapen rrugë të hekurta, veç asaj Durrës-Elbasan, të cilat do të zhvillojnë komunikacionin, do të lehtësojnë shkëmbimin e mallrave dhe do të nxisin zhvillimin e minierave tona.

Arësimi dhe kultura do të marrin një hov të madh. Në Shqipëri brenda një kohe të shkurtër do të hapen një numër i konsiderueshëm shkollash, bile edhe në katundet që s'kanë pasur, ku do të venë të mësojnë fëmijët e katundarëve, gjë kjo që është e domosdoshme për vendin tonë.

Të gjitha këto ne do t'i kryejmë me forcat tona, me vullnetin tonë dhë me ndihmën e Bashkimit të madh Sovjetik.

Populli ynë me besim të plotë ecën në rrugën e

drejtë që ka caktuar vetë, në rrugën e përparimit, në rrugën e paqes, por duhet të dini se pas kësaj lufte forcat e errësirës po përpiken të rimëkëmbin fashizmin dhe të hedhin botën në një kasaphanë të tretë. Por dëshirat e këtyre për luftë, janë shumë larg nga realizimi, se përballe tyre qëndron i pathyeshëm mbrojtësi i paqes, mbrojtësi i popujve të vegjël, Bashkimi Sovjetik me Stalinin e madh në krye.

Në krye të reaksionit ndërkombe tar qëndron reaksiuni amerikan, i cili kërkon të skllavërojë botën, të skllavërojë popujt e të vendosë forcën e kapitalit. Përpara këtij rreziku të gjithë popujt demokratë, të gjitha ato vende, ku është vendosur demokracia popullore, duhet të shtërngojnë radhët e tyre, të forcojnë frontet popullore dhe të grumbullojnë në këto organizata masat e gjera të popullit kundër çdo rreziku që mund të kërcenojë jetën e popujve.

Kështu edhe ne në vendin tonë, në Republikën tonë, duhet të shtërngojmë radhët e të forcojmë Frontin Demokratik. I gjithë populli ynë, i madh e i vogël, duhet të mobilizohet, pse vetëm me punë ne do të ndërtojmë jetën më të mirë. Duhet të kemi parasysh se kemi brenda dhe armiq, të cilët nuk ja duan të mirën popullit e përpiken të dëmtojnë veprën e popullit, por ata jo vetëm nuk do të munden kurrë t'ja arrijnë qëllimit të tyre, por nuk do të munden të dëmtojnë aspak punën ndërtuese që po bëjmë. Gjithashtu armiq të vendit tonë mbeturinat, bejlerët e agallarët, nuk kanë asnje mbështetje në popull. Këta armiq, të gjitha shpresat i kanë te anglezët e amerikanët dhe nuk janë veçse spiunë e agjentë të këtyre të fundit, që kanë shitur

atdheun, nderin dhe popullin. Të tillë ishin ata që u gjykuar në Tiranë dhe u dënuan pa mëshirë nga gjyqi i popullit. Këta njerëz do të vazhdojnë përsëri të përpiqen për të na dëmtuar. Kurdoherë që ne do të kemi suksese, atyre do t'u vihet hallka në grykë dhe dc të përpiqen me njëmijë manevra të na luftojnë, por të gjitha do t'u dështojnë.

Prandaj me besim të patundur të vëmë të gjitha forcat tonë për të ndërtuar vendin, për të ndërtuar jetën e re, pa asnje ndrojtje, se jeta është e sigruar nga ushtria jonë heroike.

Rroftë populli i Elbasanit!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë Partia jonë Komuniste!

Rroftë Fronti Demokratik!

Rroftë Ushtria jonë Kombëtare!

Rroftë rinia jonë heroike!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 866,*

9 tetor 1947

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 866.*

9 tetor 1947

FJALA E MBAJTUR NË INAUGURIMIN E KANALIT VADITËS «NAUM PANXHI»

9 tetor 1947

Shokë punëtorë dhe teknikë që punuat për hapjen e këtij kanali,

Shokë fshatarë,

Gëzimi i sotshëm është i papërshkrueshëm. Dhe keni përsë, sepse sot ju u dhatë fund punimeve për ndërtimin e kanalit Hajdaran-Gostimë. Kjo është një fitore tjetër që i shtohet realizimeve tona të mëdha që janë parashikuar në planin e shtetit për vitin 1947. Sot në vendin tonë po kryhen punime të rëndësishme si kurrë ndonjëherë tjetër. Megjithëse me mjete të pakta teknike, pushteti ynë ka ndërmarrë shumë punime me rëndësi që do të përmirësojnë ekonominë e jetën e popullit tonë. Kanali i Hajdaranit është një ndër veprat e pushtetit dhe ka për qëllim të përmirësojë tokat, ekonominë dhe jetën e popullit të këtyre krahinave. Shekuj me radhë populli i këtyre krahinave ka punuar për beun, ka mbjellur e ka korrur për Vërlacin, Biçakçinjtë e të tjerë. Në këto krahina ka peshuar rëndë mbi shpatullat e fshatarëve feudalizmi me të gjitha konsekuençat e tij. Të gjitha tokat ishin të beut, të gjithë fshatarët e këtyre

krahinave punonin për hesap të tij, që pasurohej me djersën e mundin e bujkut, të cilin ai e kishte lënë në mjerim e në injorancë. Bejlerët si Shefqet Vërlaci me shokë, tradhëtarë e kriminelë të popullit shqiptar, kanë punuar e kanë vrarë mendjen vetëm si ta shtypnin popullin e këtyre krahinave, si të linin në mjerim, në varfëri e në injorancë masat fshatare, sepse kështu do të mundnin që t'i shfrytëzonin më mirë. Ashtu kanë bërë edhe Vrionasit në krahinat e Vlorës dhe të Beratit; ashtu kanë bërë të gjithë bejlerët, latifondistët dhe bajraktarët në krahinat e tyre.

Gjatë luftës ne i thamë fshatarit që të hidhej në Luftën nacional-çlirimtare, sepse vetëm kështu do të fitonte lirinë dhe tokën, duke i dhënë fund njëherë e përgjithmonë skllavërisë dhe shfrytëzimit që peshonte kaq rëndë mbi shpatullat e tij. Partia Komuniste e Shqipërisë dhe Fronti Nacional-Çlirimtar u treguan fshatarëve rrugën e shpëtimit; ato i organizuan dhe i udhëhoqën në Luftën nacional-çlirimtare, në luftën e madhe që bëri populli ynë për çlirimin e vendit nga okupatorët, në luftën që i siguroi popullit tonë pavarësinë, lirinë dhe pushtetin, me anën e të cilit mori tokën dhe u bë zot në shtëpinë e vet. Dhe në të vërtetë fshatarësia jonë u hodh në Luftën nacional-çlirimtare, pse atje shikonte realimin e aspiratave të saja. Fshatarësia jonë u hodh në luftë për çlirimin nacional nga okupatorët italianë e gjermanë dhe për çlirimin e saj nga shtypja e beut që e kishte hedhur në mjerim, në varfëri e në injorancë.

Ajo që ne i thamë fshatarit që në fillim, u realizua plotësisht. Reforma agrare e bëri fshatarin zot të tokës dhe zot të fateve të veta. Fshatari tani po punon me të

gjitha forcat e veta për të përmirësuar vazhdimesht tokën që mori nga reforma agrare dhe për ta bërë atë sa më pjellore. Ai po punon sot më mirë e me shumë kujdes; ai po ndërton kanale për vaditje dhe për kullimin e ujit; ai po adopton metoda të reja pune, duke punuar kolektivisht dhe duke u organizuar nëpër kooperativa; ai po përdor mjete moderne që do të sjellin patjetër përparimin e bujqësisë sonë të prapambetur.

Shteti në këtë drejtim u ka dhënë dhe do t'u japë të gjithë ndihmën e tij fshatarëve. Kanalizimet e mëdha dhe bonifikimet në stil të gjerë që parashikohen në planin tonë që po preqatit qeveria dhe masa të tjera me rëndësi për sigurimin e farës, të mjeteve të punës etj, tregojnë kujdesin e ndihmën e madhe të qeverisë në favor të bujqësisë dhe të fshatarëve tanë. Vetë kanali i Hajdaranit është një ndërmarrje e shtetit që ndihmon fshatarët e kësaj krahine. Prej këtij kanali 33 kilometrash të gjatë dhe që vadit 2 500 hektarë tokë, do të përfitojnë shumë këto krahina dhe si rrjedhim, gjithë vendi ynë.

Armiku në fillim u përpoq me pengue fshatarin që të hidhej në Luftën nacional-çlirimtare, kurse më vonë, kur filloi zbatimi i reformës agrare, armiqtë e pushtetit popullor e të fshatarëve thanë se «bujqit injorantë, nuk do të dinë të punojnë tokën, nuk do të kenë farë, kafshë pune, se bujqësia do të dëmtohet dhe fshatari do të mbetet i varfër, ashtu si ka qenë ose dhe më keq». Por sot, faktet po tregojnë të kundërtën. Bujqësia jonë po përparon me hapa të shpejtë dhe po përmirësohet përditëjeta e fshatarit. Shteti po e ndihmon fshatarin për me e çue përparrë bujqësinë, po e ndihmon atë me anë të kreditit agrar, po i siguron farë e mjete pune,

kur ai ka nevojë; po e mëson si me punue me metoda të reja e me mjete moderne dhe po përpinqet me e nxjerrë nga injoranca e prapambejja duke i hapur shkolla e kurse për me mësue ai dhe fëmijët e tij.

Nga ana tjetër edhe fshatarët përgjithësisht po kryejnë detyrat e tyre ndaj shtetit; ata u mobilizuan si kurrë ndonjëherë tjetër për mbjelljet e pranverës, ata kanë punuar për të hapur toka të reja dhe përgjithësisht në të gjitha punimet e tjera që parashikonte plani i shtetit. Por duhet që në të ardhmen ata të kryejnë akoma më mirë detyrat e tyre ndaj shtetit. Ata duhet t'i mbjellin tokat sipas planit që ka caktuar shteti dhe duhet të zbatojnë të gjitha urdhëresat e qeverisë, të cilat synojnë vetëm për të mirën e popullit, pra edhe të fshatarëve. Politika e grumbullimit të drithërave dhe e prodhimeve të tjera bujqësore nga ana e shtetit bën pjesë në planin e përgjithshëm të shtetit dhe në të gjithë sistemin tonë ekonomik. Fshatarësia jonë duhet t'u përgjigjet me ndërgjegje detyrave të saj për zbatimin e politikës sonë ekonomike. Duke dorëzuar bereqetin e prodhimet e tjera bujqësore, ata kryejnë detyrat e tyre ndaj shtetit dhe gjithë popullit, ashtu dhe ju, punëtorë të ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, keni kryer detyrën tuaj duke i dhënë fund punimeve të këtij kanali.

Sot çdo njeri në Shqipëri duhet të kryejë mirë detyrën e tij. Punëtorët, që punuan në këtë kanal, kishin për detyrë të kryenin punimet sa më parë e më mirë. Tani fshatarët kanë për detyrë të mbjellin të gjitha tokat, të realizojnë planin e shtetit dhe të gjitha urdhëresat e vendimet e qeverisë. Punëtorët në miniera dhe në fabrika kanë për detyrë me realizue planin e

tyre për çdo ditë, çdo javë, çdo muaj, etj. Nëpunësit në zyra duhet të organizojnë mirë punën dhe të bëjnë që planet të kryhen në kohën e duhur dhe sa më mirë. Nxënësit në shkolla të mësojnë sa më mirë e kështu me radhë. Në qoftë se çdo qytetar i Republikës do të kryejë mirë detyrën e tij, në qoftë se masat punonjëse të vendit tonë do të angazhojnë të gjitha forcat për realizimin e planeve të shtetit, atëhere sigurisht vendi ynë do të përparojë, duan apo s'duan armiqtë tanë të jashtëm e të brendshëm, të cilët janë përpjekur, po përpinqen e do të përpinqen për t'i prerë hovin popullit tonë. Elementët tradhëtarë, agjentët e spiunët e imperializmit dhe sabotatorët e çdo kategorie, janë përpjekur e përpinqen t'i grabitin popullit tonë fitoret që ai arriti në Luftën nacional-çlirimtare. Forcat e reaksionit ndër-kombëtar, me në krye ato angleze e amerikane, duke përdorur si vegël edhe monarko-fashistët grekë, janë përpjekur dhe përpinqen t'i nxjerrin pengesa popullit tonë, duke bërë një seri provokacionesh e akuzash të pavend kundër Republikës sonë.

Në rrugën që ka hyrë populli ynë ka gjetur ndihmën vëllazërore të Bashkimit Sovjetik dhe të Jugosllavisë. Bashkimi Sovjetik, që është sot mbrojtës i paqes dhe i lirisë së popujve, e ka përkrahur dhe e ka ndihmuar vendin tonë. Ne i jemi mirënjohës Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit të madh për ndihmën e madhe dhe të gjithanshme që i jep vendit tonë të vogël, i cili ka vendosur të shkojë përpara në rrugën e demokracisë e të përparimit përkrah të gjitha forcave demokratike.

Në fund dua të përshëndes nga zemra punëtorët dhe gjithë ata që kanë marrë pjesë në punimet e këtij

kanali, i cili do t'i sjellë shumë përfitime kësaj krahine dhe gjithë vendit tonë. Dua t'ju përvendos për punën tuaj të mirë, për vullnetin që keni treguar në punë e për ndërgjegjen që keni treguar në kryerjen e detyrave tuaja të përditshme.

Shokë fshatarë,

Këtë vepër të madhe të pushtetit dhe të popullit, këtë kanal prej 33 km., që shkon nga Hajdarani në Gostimë, do ta pagëzojmë me emërin e Naum Panxhit. Naum Panxhi, partizan dhe bir i një fshatari të varfër, luftëtar që në ditët e para të okupacionit ra në fushën e nderit që në moshën 22 vjeç, duke i këshilluar shokët të vazhdonin luftën deri në fund.

Ujët e kanalit «Naum Panxhi» le të vaditë fushat dhe t'i bëjë pjellore; gruri dhe bimët e tjera industriale të ngrihen lart dhe Shqipëria të bëhet e begatshme.

Fshatarë, që do të punoni në këto fusha dhe që tani janë tuajat, të mbani lart lavdinë e Naum Panxhit dhe të të gjithë luftëtarëve të Lustës nacional-çlirimtare! Këta s'e kursyen jetën e tyre, ata u vranë, që Shqipëria të rrojë, që populli shqiptar të përparojë, që fshatarët tanë të ndërtojnë një jetë më të mirë në liri dhe në pavarësi duke punuar pa u lodhur në rrugën që na caktuan heronjtë tanë të çlirimt.

Rrofshin fshatarët e Shqipërisë!

Rroftë Republika Popullore!

Rroftë populli shqiptar!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 867,*

10 tetor 1947

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 867,*

10 tetor 1947

PËRMBLEDIJE E FJALES SË MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË POGRADECIT

9 tetor 1947

Vëllezër dhe motra të Pogradecit,

Pritja kaq e përzemërt që më bëni mua dhe shokëve të mi të qeverisë do të mbetet e paharruar. Emocioni ynë është i madh sot që ndodhemi këtu në Pogradecin që i dha Shqipërisë dy heronj të popullit: Kajan Karafilin, Reshit Çollakun dhe dëshmorë të tjerë.

Qyteti i Pogradecit dhe krahina e tij në Luftën e madhe nacional-çlirimtare kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve mori pjesë aktivisht dhe u bë një nga faktorët me rëndësi të luftës sonë të çlirimit. Populli i Pogradecit dhe i krahinave, me të dëgjuar thirrjen e Partisë sonë Komuniste, u rreshtua në radhët e Frontit Nac.-Çl. Ju e kuptuat se me luftë do të çlirohej atdheu ynë, se me luftë do të zhdukeshin përgjithmonë edhe bejlerët e agallarët që i kishin sjellë fatkeqësi popullit tonë shekuj me radhë e që kurdoherë e kishin shitur vendin te imperialistët e huaj.

Populli i Pogradecit nuk u tremb as nga terrori, as nga djegjet, as nga vrasjet në masë. Ai nuk i dëgjoi

intrigat e «Ballit Kombëtar», të bejlerëve të Starovës dhe të agallarëve të tjerë, të cilët përpinqeshin me mish e me shpirt të ndanin popullin nga Partia, të ndanin popullin nga Fronti Nac.-Çl. Qëllimet e okupatorëve dhe të tradhëtarëve ishin të njëjtë: ata donin të ndalonin popullin të hidhej në luftë, sepse shihnin në luftën e popullit një rrezik të madh. Ata e dinin se po të çohej populli në këmbë, jeta e tyre do të mbaronte së bashku me pushtetin ekonomik dhe politik të tyre. Prandaj ata u bashkuan plotësisht me armiqtë e vendit tonë.

Populli shqiptar i bashkuar në Frontin Nac.-Çl., i udhëhequr nga Partia Komuniste, i kapërceu të gjitha pengesat, i kapërceu të gjitha vështirësitë, theu të gjitha operacionet e okupatorëve, vuri nën këmbë të gjitha intrigat e bejlerëve, të ballistëve, të zogistëvc, etj. Ai ndoqi rrugën e Partisë.

Ju e dini mirë se këtu, si në të gjithë Shqipërinë, tradhëtarët u organizuan në «Ballin Kombëtar» dhe në fillim përdorën parulla gjoja nacionaliste sikur donin popullin dhe se kishin dalë në mal për të luftuar okupatorin. Por këto s'ishin të vërteta, ato ishin bërë me qëllim për të shkëputur popullin nga lufta. Ata u përpinqën të luftonin Partinë Komuniste, duke thënë kundër Partisë sharjet më të poshtra. Ju i keni dëgjuar se si tradhëtarët: Aqif Blloshmi, Xhevrat Starova e Dule Alarupi i quanin komunistët njerëz të shitur te Rusia, i quanin komunistët njerëz që prishnin moralin, njerëz që prishnin familjen. Të tilla ndyrësira u thoshnin bijve tuaj më të mirë, bijve tuaj më heroikë që u hodhën në zjarr e në flakë për interesat e popullit, vetëm për interesat e popullit, për ta çliruar atdheun, për ta bërë

vendin të pavarur që të mos sundonin më bejlerët dhe këlyshët e tyre. Por me besim te Partia populli ynë luftoi dhe fitoi. Prandaj le të brohorasim për lavdinë e dëshmorëve të kësaj krahine që ranë në fushën e nderit për lirinë e popullit dhe çlirimin e atdheut.

Lavdi të përjetshme heronjve të popullit Kajan Karafili e Reshit Çollaku!

Lavdi dëshmorëve Milo Gjoka, Cane Mane, Muharrem Çollaku, Koli Gusho e dhjetëra e dhjetëra dëshmorëve të tjerë të kësaj krahine! (Populli brohorit: «Partia Komuniste»!)

Me të drejtë ju dhe gjithë populli shqiptar brohoritni për Partinë Komuniste, sepse Partia ato që i premtoi popullit, ja dha: Ajo i dha gjënë kryesore — pushtetin, qeverinë në duart e popullit, gjënë për të cilën populli ka luftuar e ka derdhur gjak. Armiqtë për këtë na luttuan; na luftoi fashizmi, na luftoi dhe «Balli Kombëtar». Këta e dinin se, pasi të merrnim pushtetin në dorë, do të fillonin reformat e mëdha ekonomike dhe shoqërore sikurse u filluan nga qeveria jonë demokratike.

Pastaj shoku Enver Hoxha foli për transformimet ekonomike që ishin kryer në vendin tonë dhe në mënyrë të veçantë për reformën agrare.

«S'do të ketë asnje forcë — tha shoku Enver — që t'u marrë tokën nga duart katundarëve; u shtyp përgjithmonë fuqia e bejlerëve dhe e agallarëve».

Pasi përmendi shkatërrimet e mëdha që kishte lënë lufta në të gjitha degët e ekonomisë, shoku Enver tha: «Populli nuk u dëshpërua nga kjo gjendje e vështirë ekonomike, ashtu sikurse nuk u dëshpërua në kohët më të këqia. Ne i ndërtuam dhe i vumë në vend të

tëra ato që ishin shkatërruar. Sot ne prodhojmë më shumë se në kohën e paralufstës. Ne ishim të varfër, s'kishim vegla, s'kishim të holla, por i ndërtuam, sepse kishim vullnetin e çelniktë, i ndërtoi populli dhe këto rezultate janë të dukshme për çdo njeri.

Pas lufte ishte krizë e madhe në gjithë Evropën e robëruar, të porsaqlliruar. Kishte zi buke. Në vendin tonë, me gjithëse vend i varfër, nuk vdiq njeri për bukë. Ne ishim të lidhur me njëri-tjetrin dhe të bashkuar, ndihmonim njëri-tjetrin, ashtu sikundër ndihmonim shoqi-shoqin në male. Populli e kishte kuptuar, se duke u bashkuar, do të fitonte lirinë, duke qenë i bashkuar dhe duke ndihmuar shoqi-shoqin, do të ndërtonte jetën e re. Ju e shihni se në barazim me popujt e tjerë që akoma po vuajnë nga uria, në Shqipëri jeta është përmirësuar mjaft. Por kjo nuk domethënë se s'kemi mungesa, ne na mungojnë shumë gjëra. Ju duhet të keni parasysh se të gjitha këto do t'u plotësohen, kur çdo gjë do ta kryejmë me punën tonë, me djersën tonë. Ju e dini sa vëشتirësi të mëdha kemi; të gjithë ata që rrojnë me punë e dinë se këto vëشتirësi do të përballohen me djersë. Të gjitha vëشتirësitë nuk mund të kapërcehen menjëherë, por ne do t'i kapërcejmë pa një pa dy».

Më poshtë shoku Enver foli për zhvillimin që do të marrë bujqësia nën kujdesin e pushtetit popullor. Foli gjithashtu për kanalizimet që ishin kryer deri atëhere.

«Sot inauguruam kanalin më të madh vaditës, kanalin «Naum Panxhi», 33 km. të gjatë. Në Shqipërinë e mëparshme nuk ishte ndërtuar kurrë një vepër e tillë.

Krahas me bujqësinë — tha shoku Enver — një rëndësi të madhe do t'i jepet çështjes së kulturës. Në

shkollat tona do të mësojnë bijtë e popullit, bijtë e katundarëve dhe agallarët e bejlerët nuk do të drejtojnë më maqinat tona, fabrikat tona dhe nuk do të mund të na sabotojnë më».

Më poshtë shoku Enver foli për zhvillimin e industrije minerale dhe theksoi se «minierat do të marrin një zhvillim më të madh me ndërtimin e hekurudhave. Ju e dini — vazhdoi shoku Enver — se mbas disa javësh ne do të inaugurojmë hekurudhën e parë në Shqipëri, Durrës-Peqin».

Duke folur për marrëdhënjet e Shqipërisë me vendet e tjera shoku Enver tha: «Ne kemi miq të ngushtë, që na duan e na mbrojnë me gjithë zemër, si Bashkimi Sovjetik me Stalinin e madh në krye. Katër fabrika të mëdha, që do të na vijnë për së shpejti, na i jep Bashkimi Sovjetik, 200 traktorë do të na vijnë së shpejti nga Bashkimi Sovjetik; edhe ndihma të tjera do të na vijnë për shkolla, ku do të mësojnë fëmijët tanë. Këto janë ndihma ekonomike. Përveç këtyre ai na mbron kundërsitë intrigave të reaksionit ndërkombëtar. Ju e dini se pas kësaj lufte reaksiioni ndërkombëtar, me në krye Amerikën përpinqet me çdo mjet të dëmtojë jo vetëm vendin tonë, po edhe gjithë vendet e tjera, ku populli ka marrë fuqinë në dorë. Ata kanë bërë njëmijë shpifje dhe njëmijë intriga, që s'kanë asnjë bazë, asnjë themel. Ku e kanë qëllimin reaksiioni amerikan dhe anglez? Ata kanë qëllim të shtypin popujt, të shfrytëzojnë popujt dhe të vendosin regjimet e tyre kapitaliste. Këta jo vetëm që shpifin, po edhe kërcënojnë. Kush ka frikë nga këta? Nga këta kanë frikë ata që kanë nerva të dobëta, por nuk i kemi nervat e dobëta. Ne jemi një popull i

vogël, që kemi luftuar me gjithë forcat tona e që ndjekim një politikë të drejtë, që kemi për qëllim mbrojtjen e paqes, mbrojtjen e njerëzimit. Amerikanët dhe anglezët u përpoqën gjatë luftës si e si të shtynin Gjermaninë kundër Bashkimit Sovjetik që ta dobësonin. Por Bashkimi Sovjetik nuk u dobësua; ai u forcua edhe më dhe, në saje të tij, u arrit fitorja kundër Gjermanisë.

Ç'bëjnë amerikanët dhe anglezët për të tremburata që i kanë nervat e dobëta? Ata thonë se Bashkimi Sovjetik është i dobët. Por sot forcat demokratike, me në krye Bashkimin Sovjetik, janë më të forta se kurrë. Bashkimi Sovjetik dhe gjithë popujt demokratikë do t'i demaskojnë të gjitha tentativat e reaksionit ndërkombëtar dhe që të gjitha do të dështojnë.

Çfarë bën anglo-amerikanët në Shqipëri? Në kohën e luftës ata kishin dërguar këtu misionet e tyre gjoja për të ndihmuar partizanët, por ata jo vetëm armë s'na jepnin, por dhe ato që na jepnin, ishin shumë të pakta. Ata kishin ardhur të ne për tjetër punë, për të organizuar reaksionin e brendshëm që ta përdornin, kur të thyhej Gjermania dhe ta binin në fuqi për të shtypur popullin, sikundër po ngjet në Greqi.

Misionet anglo-amerikane, që kishin ardhur në vendin tonë pas çlirimit, u përpoqën të grumbullonin e të organizonin elementin kundërshtar të pushtetit si bejlerët, agallarët e tregëtarët e mëdhenj, të sabotonin, të bënин atentate dhe me anën e këtyre, të rrëzonin pushtetin me forcë. Këta njerëz s'kishin dhe as që mund të kishin mbështetje në popull. Ata shpresonin në një zbarkim të anglo-amerikanëve.

Anglo-amerikanët nuk mundën të bënin as gjënë

më të vogël këtu, në vendin tonë, sepse populli i ruante e i vëzhgonte.

Prandaj, në punën e tij ndërtimtare, për të mbrojtur pushtetin e vet, populli shqiptar duhet t'i ketë sytë hapët. Mos të kujtojmë se armiqtë janë zhdukur. Ekzistojnë akoma mbeturina, që na kritikojnë, na shajnë, por ne i dimë dhe do t'i ndjekim këmba-këmbës, do t'i ndjekim, pse ne nuk luftuam e nuk derdhëm gjakun që të lëmë përsëri hajdutët të vijnë në fuqi, të na vrasin e të na rjepin. Kjo nuk do të ngjajë kurrë dhe gjithë planet e tyre do të dështojnë. Populli shqiptar, me besim të madh në forcat e veta, do të forcojë e do të ruajë si sytë e ballit Republikën e tij Popullore.

Rroftë populli i Pogradecit dhe i rrëtheve të tij!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë Partia Komuniste!

Rroftë Republika Popullore!

Rrofshin të rinjtë dhe pionierët tanë!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 868,*

11 tetor 1947

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 868,*

11 tetor 1947

**FJALA E MBAJTUR PËRPARA PUNËTOREVE
DHE FSHATARËVE TË MALIQIT ME RASTIN
E PËRFUNDIMIT TË PUNIMEVE TË PARA
PËR THARJEN E KËNETËS**

12 tetor 1947

Shokë punëtorë dhe teknikë të kantierit të Maliqit
dhe fshatarë të rrethit,

Sot po inaugurohet mbarimi i punimeve të para të
Maliqit, një nga ndërmarrjet më të mëdha të pushtetit
tonë. Mbarë populli shqiptar përshëndet në këtë vepër
një nga fitoret më të mëdha të punës sonë për ndërtimin
e jetës së re në vendin tonë, e një jete më të begatshme
dhe më të gjëzueshme për masat punonjëse.

Duke luftuar kundër okupatorit fashist dhe tradihëtarëve
të vendit për çlirimin e atdheut, populli ynë
ishte i vendosur që të bënte një Shqipëri me të vërtetë
demokratike, duke ngritur një pushtet popullor dhe një
rend të ri shoqëror. Dhe me të vërtetë populli ynë me
luftën e tij heroike ja doli mbanë.

Kështu populli ynë në saje të këtij pushteti, në
kondita mjaft të vështira të shkaktuara nga lufta filloj
të rindërtojë vendin e shkatërruar. Ai mori një sëri
masash të domosdoshme për përmirësimin e jetës së vet.

ai goditi klasën shfrytëzuese duke e shpronësuar atë. Ai ja mori asaj fabrikat, minierat, i vuri tatimet e luftës, i mori tokën beut dhe agait, duke krijuar kështu kondita për një jetë më të mirë, më të begatshme dhe më të lumtur, duke krijuar kështu edhe mundësitetë për të ndërmarrë vepra të tilla të mëdha, siç është tharja e kënetës së Maliqit.

Edhe të tjerë kishin provuar të ndërmirrin tharjen e Maliqit. Ju, shokë fshatarë të rrethit të Maliqit, keni parë dhe keni dëgjuar në kohën e regjimit antipopullor të Zogut dhe të fashizmit, sa herë kishin ardhur këtu teknikë, me plan në dorë, sa herë është matur Maliqi për së gjati dhe për së gjeri, sa para janë vjedhur nën emrin e Maliqit dhe prapë, as regjimi i Zogut, as regjimi fashist, nuk bënë gjë, së pari sepse ata, si regjime anti-popullore, nuk donin të mirën e popullit e së dyti, sepse nuk është e kollajshme të ndërmarrësh një vepër të tillë kaq të madhe siç është tharja e kënetës së Maliqit.

Por ne e ndërmuarëm, pse pushteti ynë është pushteti i popullit, i cili do që populli të ketë sa më shumë bukë. Ne e ndërmuarëm këtë megjithëse dispononim mjete teknike mjaft të pakta për një vepër kaq të madhe. Edhe për ne një ndërmarrje e tillë qe mjaft e zorshme duke marrë parasysh këto kondita, por megjithatë ne e kryem, pse pushteti ynë ka një mjet tjetër të fuqishëm dhe kryesor, që përbën mbështetjen e tij më të madhe, të cilën nuk mund ta kenë regjimet antipopullore. Ky mjet është vullneti dhe vetëmohimi i popullit tonë në punë, janë vetë ndërmarrjet e reja të krijuara në sistemin tonë shqëror, ku çdo gjë që bëhet, shkon në të mirën e popullit.

Dhe në fakt ne i hymë punës dhe ja, sot ne po inaugurojmë dhe po brohorasim me gjithë zemër mbarimin e punimeve të para të Maliqit.

Por këtu nuk mund të lëmë pa përmendur se, në këtë vepër të rëndësishme pér ngritjen e ekonomisë sonë, kemi pasur edhe pengesa, edhe akte sabotazhi të kryera nga elementë teknikë, armiq të popullit, të shitur me dollarë dhe stërlina te i huaji, të cilët, siç ka dalë edhe në gjyqet e zhvilluara më parë dhe siç doli akoma më qartë në gjyqin që u zhvillua në Tiranë, janë përpjekur të na luftojnë në rrugën tonë të ndërtimit me qëllim që ndërmarrjet tona të mos realizohen, të mos mundim të forcojmë ekonominë tonë po të mbetemi të varur ekonomikisht, dhe t'i zgjatim dorën imperialistëve anglo-amerikanë, duke humbur kështu paravësinë tonë ekonomike dhe politike, duke krijuar kështu sheshi të lirë pér qëllimet e tyre grabitqare. Ata janë përpjekur të na sabotojnë në punën tonë të ndërtimit edhe me qëllim që, duke mos u realizuar veprat që ndërmirrnim, të diskreditohej pushteti para masave, ta nxirrin pushtetin tonë të paaftë, etj.

Por kjo nuk ngjau. Llogaritë e armiqve të vendit dhe të popullit tonë dolën të gabuara dhe me rezultate të hidhura pér ta. Ne po e ndërtojmë Shqipërinë e re, ne po inaugurojmë sot mbarimin e punimeve të para të Maliqit, ndërsa armiqtë e popullit, sabotatorët përfunduan në litar dhe këtu do ta kenë mbarimin e tyre të gjithë ata që do të tentojnë të bëjnë akte të tillë pér të na penguar në rrugën tonë të lavdishme të ndërtimit.

Të gjitha këto pengesa ne i kapërcyem, pse vullneti juaj, shokë punëtorë, qe i madh, ashtu siç është i

madh vullneti i gjithë popullit shqiptar, i cili i është përveshur punës së ndërtimit me vrull të madh. Ju, shokë punëtorë, i shtuat forcat tuaja, punuat gjithnjë me hov dhe ja, e mbaruat para afatit kanalin. Për punën e madhe që keni bërë, ju përgëzoj me gjithë zemër, përgëzoj fshatarët vullnetarë që punuan në Maliq, brigadat e të rinjve që punuan me vullnetin më të madh, ashtu siç punon kudo rinia, brigadën e gruas dhe popullin e Korçës që dha ndihmën e tij për kryerjen e punimeve të Maliqit.

Përgëzoj gjithashtu të gjithë shokët teknikë që punuan me ndërgjegje duke i shërbyer si duhet popullit tonë.

Ne do t'i vazhdojmë gjer në fund punimet e Maliqit, me sistemimin e gjithë kënetës. Përfitimet e Maliqit, natyrisht, do të jenë shumë të mëdha: mijëra ha. tokë do të përmirësohen, fusha e Korçës do të japë një rendiment më të madh. Pushteti u erdhi në ndihmë fshatarëve me një vepër të tillë të madhe, e cila do të sigurojë zhvillimin e përparimin e bujqësisë në fushën e Korçës, gjë kjo që do të lejojë që të ngrihen fabrika, si ajo e sheqerit, që do të përpunojnë prodhimet e tokës.

Prandaj është detyrë e fshatarëve të rrethit të Maliqit, të cilët dinë ta punojnë tokën, që ta shtojnë gjithnjë më shumë produktivitetin e tokës, pse kështu ata do të kryejnë detyrën e tyre ndaj gjithë popullit tonë dhe atdheut, pse kështu ata do të jasin kontributin e tyre të madh për forcimin e ekonomisë sonë për zhvillimin e përparimin e vendit tonë, që do të thotë forcimi i pavarësisë sonë.

Gjithashtu, pra, është detyrë e fshatarëve që t'i

përgjigjen në mënyrë të ndërgjegjshme detyrimeve të tyre ndaj pushtetit, që do të thotë ndaj kolektivitetit, ndaj gjithë popullit, që të jasin sa më shumë prodhime mbi planin e detyrimeve, pse këto duhen për masat punonjëse të qytetit, për Ushtrinë tonë Kombëtare, mbrojtësen vigjilente të atdheut tonë, për punëtorët që punojnë në ndërmarrjet e ndryshme të pushtetit tonë. Ja, shokë fshatarë, ku e keni shembullin; punëtorët e Maliquit, që punuan në kanal, që dërsinë për ju, për tokat tuaja, që këto të bëhen sa më pjellore, duan bukë që të hanë. Dhe është tamam për këtë, shokë fshatarë, që armiku është përpjekur vazhdimisht që urdhëresat e qeverisë të mos zbatohen. Ai po hedh parulla të ndryshme armiqësore me qëllim që fshatari të mos e punojë mirë tokën. Ata thonë: «Është e kotë të mbjellësh, qeveria po na e merr bereqetin»! Këta janë ata që humbën pronat dhe privilegjet e tyre; këta janë ata që nuk duan të hapen kanale, këta nuk duan që në vendin tonë të ndërtohen fabrika; këta pra, shokë fshatarë, nuk duan që toka juaj të bëhet sa më shumë pjellore, që ju të jetoni sa më mirë, që ju të jeni të veshur dhe të mbathur mirë.

Shokë punëtorë dhe teknikë të kantierit të Maliquit, shokë fshatarë,

Sot po inaugurohet mbarimi i punimeve të para të Maliquit; në pranverën e ardhme do të fillojnë punimet në pjesën e sipërme dhe për sistemimin e gjithë liqenit. Gëzimin që ndjeni ju sot, e ndjen gjithë populli ynë, i cili punon me vullnet të madh për ngritjen

e jetës së re dhe të lumtur. I gjithë populli ynë, i bashkuar në Frontin Demokratik, është mobilizuar në ndërtimin e Shqipërisë së re. Sot, nën drejtimin e qeverisë së tij, populli ynë ka angazhuar tërë forcat e tij në ndërmarrjet e ndryshme të pushtetit. Në këtë punë ndërtimtare ne kemi mbështetjen e Bashkimit Sovjetik dhe të popujve të Jugosllavisë.

Vepra të tillë si tharja e kënetës së Maliqit, tre-gojnë se ç'mund të bëjë populli punëtor kur është në fuqi, me gjithë konditat e vështira, me gjithë mungesat dhe pengesat e ndryshme që janë kapërcyer në saje të forcave tona, të vullnetit tonë dhe të ndihmës së çmueshme që na kanë dhënë miqtë tanë të singertë. Këto vepra janë fitore të popullit tonë, realizimi i të cilave ka qenë i mundshëm në saje të fitores së madhe të popullit tonë, të luftës së tij të lavdishme, në saje të pushtetit që ju keni në duart tuaja.

Ja, shikoni se ç'po ngjet gjetkë, ku populli nuk është në fuqi, megjithëse ata janë vende me një nivel teknik më të lartë. Pas mbarimit të luftës, në vend që të ecin përpara, ata po i kërcënnon kriza e paevitueshme, atje ka greva, ka papunësi, niveli i jetesës së tyre është më i ulët. Ja, shikoni se ç'ngjet në Greqi, ku janë në fuqi monarko-fashistët, të cilët, të përkrahur direkt nga imperialistët anglo-amerikanë, po sundojnë me terror duke e katandisur vendin në një kasaphanë të tmerrshme.

Ja, shokë, ç'do të thotë të jetë populli në fuqi. Të punojmë pra pareshtur dhe me forca të shumëfishuara për ndërtimin e ekonomisë së re në vendin tonë, pse kështu do të forcojmë edhe më shumë pushtetin tonë,

pse kështu do të ndërtojmë jetën e re, të begatshme
dhe të gjëzueshme për veten tonë dhe për kalamajtë tanë.

Rrofshin punëtorët dhe teknikët e Maliqit!

Rrofshin fshatarët e Shqipërisë!

Rroftë populli shqiptar!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 870,
14 tetor 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 870,
14 tetor 1947*

FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË KORÇËS

12 tetor 1947

Vëllezër dhe motra të dashur korçarë,

Dita e sotme është për mua një nga më të gjëzuarat, pse ndodhem në mes tuaj, punëtorë dhe punëtore, katundarë dhe qytetarë të Korçës heroike, që ka qenë dhe do të jetë kurdoherë zemra, ku ka rrahur me të madhe ndjenja e lartë e patriotizmit dhe e sakrificave më të mëdha për të mirën e atdheut dhe të popullit. Jam i gjëzuar dhe i lumtur, pse ndodhem në Korçën Plakë, që ka qenë djepi i ideve përparimtare, i kulturës dhe i arësimit të vendit tonë. Korça më është e dhembshur dhe e dashur, pse këtu u kristalizuan dhe u forcuan idetë e mia sociale, pse këtu, që djalë i ri, gjeta rrugën që kërkoja, rrugën që duhej të ndiqte çdo djalë i ndershëm i popullit tonë të mjeruar.

Korça ishte një nga vendet më të njoitura të Shqipërisë, ku brezat e rinj jo vetëm pajiseshin me kulturë, por sidomos, nëpërmjet historisë së përpjekjeve të popullit tonë dhe veçanërisht të popullit të kësaj krahine, ato edukoheshin me frymën e lartë të patriotizmit, të luftës për liri dhe pavarësi, flamurin e së cilës Korça

e ka mbajtur kurdoherë lart dhe u ka prirë lëvizjeve çlirimtare të popullit tonë. Me Korçën mburret mbarë Shqipëria dhe i është mirënjohëse. Në ditët më të errëta të së kaluarës, kur grekërit kishin shkelur vendet tona, kishin shkelur dhe digjin e Korçën tonë, Gjirokastrën tonë, patriotët e shquar të Korçës, tok me popullin e tyre, në asnjë moment nuk ju përulën tiranisë, por luf-tuan me trimëri të pashoqe. Binte Papa Kristo Negovani, për Shqipërinë; binte mësuesi patriot Petro Nini Luarasi, për Shqipërinë; binin trimat Spiro Bellkameni, Gani Butka, Muço Qulli, Pandeli Cale, heronjtë e Orman Çiflikut¹, për Shqipërinë; luftonte nëpër male Mihal Grameno, Haki Mborja etj., për Shqipërinë. Këta ishin partizanët e kohës së Rilindjes, të cilëve u dhimbsej populli dhe atdheu dhe përpara këtyre trimave dridhes-hin evzonët dhe gjiritlinjtë².

Çështja e shqiptarizmës për këta trima ishte mbi të gjitha; vuajtjet e popullit dhe të atdheut u dhanë këtyre forcën e duhur morale e fizike që të luftonin pa pushim, për të shporrur grekërit nga vatra tona dhe ta bënин Shqipërinë të pavarur. Imperialistët francezë dhe hyz-meqarët e tyre, bejlerët, e vranë trimin Themistokli

¹ Është fjala për Kostaq Kosturin, Odhise Koten, Bajazit Rehovën, Kristaq Furxhiun, Nuçi Lapin dhe Nuçi Kras-tasillakun, pjesëtarë të çetave kryengritëse që vepronin në rre-thet e Korçës kundër pushtuesve turq. U vranë duke luftuar si heronj, duke qenë të rrethuar nga forca të shumta turke në afërsi të fshatit Orman Çiflik më 30 korrik 1911.

² Evzonët dhe gjiritlinjtë — Ushtarë të zgjedhur, të cilët përbënë pjesën kryesore të ushtrisë greke, që kish pushtuar krahinat tona të Jugut në vjetet 1912—1916.

Gërmënji, pse ky nuk pranoi kurrsesi të shkelej dhe të copëtohej Shqipëria dhe ngriti flamurin e pavarësisë. Këto akte patriotike nuk mund t'ja lejonin popullit tonë të vogël as imperialistët francezë, as hyzmeqarët e tyre, bejlerët, as grekërit e «Megalidhesë» dhe as të gjitha ato shtete që tërë jetën kanë luajtur me fatet e tij. Këta të parët tanë të nderuar, ranë në fushën e nderit për atdheun, por atdheu ynë vuajti edhe për shumë kohë fatkeqësi të tmerrshme, që kurrë s'i kishte parë historia e popullit tonë.

Por ç'të mbjellësh do të korrësh, thotë fshatari ynë. Patriotizmi ishte lulja më e bukur e popullit të krahinës së Korçës. Ditë të errëta kaluan mbi vendin tonë, terrori dhe shtypja ishin vënë në rendin e ditës nga satrapët e popullit tonë. Sa u çliruam nga të huajt, ne hymë në një robëri tjetër të rëndë, nën robërinë e regjimit mesjetar të feudalit gjakpirës, Ahmet Zogut, regjim i turpit, i terrorist, i tradhëtisë dhe i shtypjes së pamëshirshme. Dhe Korça, si kurdoherë, i rezistoi me ashpërsinë më të madhe Zogut dhe këlyshëve të tij. Në një kohë kur mbretëronte ligji i bajonetës dhe i litarit, këto rrugë dhe bulevardë kanë parë trimërinë e punëtorëve të Korçës, të cilët u vërsulën mbi bajonetat e xhandarëve të Zogut. Forcat e popullit po ngriheshin për të mposhtur tiraninë, punëtorët e Korçës po organizoheshin për të mbrojtur të drejtat e tyre politike dhe ekonomike, punëtoria e Korçës bëhej një faktor i rëndësishëm për organizimin e rezistencës. Ata nuk e njihnin frikën dhe trimat, që mbrojnë drejtësinë dhe popullin, kurdoherë fitojnë. Fitoret e punëtorëve të Korçës, në lëmin politik dhe ekonomik, nën regjin e Zogut tregojnë forcën revo-

lucionare të popullit që po ngrihej dhe dobësimin e rëgjimit feudal të Zogut. Në qytetin e Korçës për të parën herë formohet Fronti Popullor, që udhëhiqet prej komunistëve të Korçës dhe ky front fiton në zgjedhjet bashkiake¹. Kjo qe një fitore e madhe për demokracinë, për të cilën po luftohej. Zogu përdori forcën dhe e fshiu vullnetin e popullit, të shfaqur ditën e zgjedhjeve, por demokratët e Krcës, me komunistët në krye i mprehën armët edhe ca më shumë për një luftë më të ashpër kundër regjimit dhe lufta vazhdoi e pamposhtur. Shoqëritë e punëtorëve ishin bërtamat e lëvizjes dhe, me gjithë masat e Zogut, punëtorët përdorën çdo formë legale dhe ilegale për ta forcuar më tepër organizimin dhe bashkimin. Korça u bë qendra më e rrezikshme për regjimin e Zogut. Kur Zogu prishi shoqërinë e punëtorëve, këta menjëherë morën në duart e tyre shoqëritë jashtëshkollore, të cilat u shndërruan në një vatër rezistence përparimtare. Zogu u përpooq t'i fshinte edhe këto. Madhështore ka qenë përgjegjja e punëtorëve të Korçës, tradhëtarit Aqif Përmeti, këlyshit të Zogut, që kish ardhur të likuidonte shoqërinë jashtëshkollore të Korçës. Më vonë, ky tradhëtar, që u bë gjeneral i fashizmit italian dhe gjerman, pas çlirimt u dënuia me pushkatim nga gjyqi i popullit.

«Shkon i thoni padronit tuaj se punëtorët e Korçës nuk dalin nga palestra pa derdhur gjak dhe ne vendo-

¹ Në zgjedhjet për këshillin bashkiak, që u zhvilluan më 1938, bloku demokratik i kryesuar nga komunistët fitoi 86 për qind të votave.

sim edhe pa ty edhe pa padronin tënd»¹. Dhe nga palestra doli me bisht nëpër shalë shërbëtori i Zogut me gjithë xhandarët e tij. Lufta u fitua nga punëtorët e Korçës. Korça qe e para që hodhi alarmin për rrezikun e fashizmit që po i turrej vendit tonë. Komunistët e Korçës me në krye veteranin e pamposhtur, komunistin, Ali Kelmendi, hodhën parullën e krijimit të frontit antifashist për të luftuar rrezikun e okupacionit. Bash këtu afër, punëtorët e Korçës përllesheshin me agjentët e fashistit italian Xhiros dhe të Ahmet Zogut; bash këtu afër, sulmoheshin zyrat e spiunazhit italian, me në krye agjentin Shanazo; bash në këto bulevard shpërthyen demostratat e popullit heroik të Korçës që kërkonte armë për të luftuar okupatorin italian, që kish sulmuar vendin tonë; bash në këto rrugë, komunistët e Korçës organizonin vullnetarët për t'i pritur italianët me armë dhe pikërisht në sallonin e bashkisë së vjetër komunistët e Korçës dhe patriotët e tjera u mblohdhën për të vendosur në momentin më tragjik krijimin e komitetit të «Salut public»², për të marrë në dorë pushtetin dhe për të filluar rezistencën. Dhe atje, në sallonin e bashkisë u duk e qartë që atë ditë tradhëtia e bejlerëve si Fazlli Frashëri, tradhëtia e agjentit të imperializmit, trockis-

¹ Kjo mbledhje e organizatës së rinisë jashtëshkolllore, «Rinia Korçare», të Korçës u bë në dhjetor të vitit 1938 për të zgjedhur komitetin e ri drejtues të saj. Në atë mbledhje mori pjesë edhe Aqif Përmeti, i dërguar apostafat nga A. Zogu me qëllim që të shpërndante këtë organizatë. Mirëpo nuk ja arriti qëllimit, sepse ndeshi në qendresën energjike të anëtarëve të kësaj organizate, e cila udhëhiqej nga grupi komunist i Korçës.

² «Salut public» (frëngj.) — «Shpëtimi i popullit».

tit Zai Fundo, tradhëtia e arhondëve, si Petraq Katro me shokë, të cilët ishin lidhur ngushtë me Zogun dhe me okupatorët e rinj.

Jo, bejlerët, arhondët dhe gjithë borgjezia reaksionare e pasuruar në kurrizin e popullit s'mund të ishin për një luftë, as kundër Zogut dhe as kundër okupatorëve të vendit tonë. Fashizmin këta e priten me duar hapët, italianët i futën deri në familjet e tyre. Qëllimet e tyre puqeshin dhe prandaj ata u puqën për të luftuar rezistencën dhe luftën e popullit tonë. Mbreti tradhëtar, Ahmet Zogu, la pas zëvendësit e tij për ta vazhduar veprën e tij, që ai e kreua deri më 7 prill të vitit 1939 me ndërgjegjen më të plotë në favor të fashizmit italian.

Luftën për çlirimin e Shqipërisë do ta bënte vetëm populli punonjës, populli i shumëvauajtur, kurse roli i udhëheqjes së luftës më të lavdishme të historisë së popullit tonë do t'i takonte Partisë heroike Komuniste të Shqipërisë. Kështu do të zhvillohej procesi, kjo ishte e vëtmja rrugë për shpëtimin e Shqipërisë nga kthetrat e okupatorëve dhe të kuislingëve dhe për rrëzimin e rendit të vjetër e zëvendësimin e tij me një pushtet të ri, me një pushtet popullor. Puna s'ishte aspak e lehtë, pse kishim përballë një armik të madh dhe të egër, me të cilin ishin bashkuar shtresa pasanike e bejlerëve latifondistë, e agallarëve dhe e spekulatorëve. Lufta që po ndërmerrnim bëhej edhe më e vështirë, pse vendi ynë ishte i prapambetur, populli ynë s'kishte akoma një edukatë politike të mjaftueshme dhe ekzistonte fanatizmi, ekzistonte akoma vargu i të metave të shoqërisë patriarkale. Por populli ynë, megjithkëtë, e gjeti shpejt rrugën që ai duhej të ndiqte me vendosmërinë më të

madhe. Populli ynë bëri një luftë dhe një revolucion aq të madh, sa shumë popuj, që hiqen të përparuar, mund ta marrin si shembull. Kjo ngjau pse populli ynë, megjithëse ishte i prapabetur nga ana e kulturës dhe e arësimit, megjithëse ekzistonte akoma fanatizmi, kishte të zhvilluar në maksimum ndjenjën e lirisë e të pavareësisë dheurrejtjen më të madhe kundër Italisë imperialiste e fashiste si dhe kundër të gjithë shkelësve të vendit tonë. Historia e popullit tonë ka qenë mbushur me një varg mjerimesh, por edhe me një varg luftërash të pareshtura, ku populli ka pasur fitore edhe disfata, por në asnjë moment nuk ka pranuar robërinë dhe zgjedhën. Fakti është se një popull i vogël, si i yni, u ka rezistuar invazioneve të panumërtë dhe ka ruajtur gjallë çdo gjë kombëtare, që nga gjuha dhe deri te zakonet më të thjeshta. Merita tjetër e lavdishme për mobilizimin e popullit dhe organizimin e tij në një luftë kaq të madhe, për ta çuar në rrugën e fitores, i bie Partisë Komuniste të Shqipërisë. Pa Partinë Komuniste, nuk do të kishte ekzistuar as Lufta nacional-çlirimtare, as Fronti Nacional-Çlirimtar. Pa këtë nuk do të qe sigruar, as fitorja e madhe mbi fashizmin e tradhëtarët dhe as realiteti i sotëm. Fashizmi gjerman dhe italian synonte shkatërrimin e Bashkimit Sovjetik, kështjellën e demokracisë së vërtetë dhe të paqes në botë; gjithashtu ai synonte zhdukjen e partive komuniste në botë, që udhëhiqnim luftën e klasës punëtore dhe të njerëzve që shfrytëzoheshin kundër kapitalizmit dhe diktaturës së tij, fashizmit. Po t'ja arrinte këtyre qëllimeve fashizmi gjerman dhe italian, atëherë ai do t'i kishte vënë nën thundrën e tij të gjithë popujt e botës. Por kjo nuk

ngjau. Gjithashtu edhe në vendin tonë propaganda dhe goditjet më të ashpra të fashizmit dhe të reaksionit të brendshëm shqiptar drejtosheshin kundër Partisë Komuniste, pjellës së denjë të popullit, që kishte marrë përsipër organizimin e luftës çlirimtare.

Partia Komuniste e Shqipërisë e kishte rrugën të qartë. Ajo luftonte për të çliruar atdheun dhe popullin nga zgjedha dhe kjo gjë nuk mund të arrihej, pa një luftë të pamëshirshme e pa asnjë kompromis kundër okupatorëve dhe atyre që mbanin anën e tij. Pra, duhej krijuar Fronti Nacional-Çlirimtar i popullit shqiptar dhe duhej organizuar lufta e armatosur dhe kryengritja e përgjithshme. Partia Komuniste e bëri këtë gjë me suksesin më të madh dhe populli i Shqipërisë e ndoqi Partinë Komuniste deri në fund, nëpërmjet rreziqesh të tmerrshmë. Ai e ndoqi me besimin më të madh, pse populli shihte te Partia realizimin e qëllimeve të tij, pse Partia ishte besnike e çështjes së popullit deri në vdekje dhe pse Partia përbëhej nga djemtë e saj më të zot, më heroikë, më të vuajtur, më me eksperiencë dhe nga më të ndershmit. Këtu qëndron çështja e suksesit të grumbullimit dhe të mobilizimit të popullit në Frontin Nacional-Çlirimtar të udhëhequr nga Partia Komuniste, këtu qëndron çështja e suksesit të Luftës nacional-çlirimtare dhe të rezultateve të saja që i gjithë populli ynë sot. Në anën tjeter, ishte fashizmi okupator me të gjithë aparatin e tij shtypës, me armët e tij më moderne dhe me demagogjinë e tij të pashembullt në histori. Një nga armët që përdori fashizmi për të kryer punën e tij ishte reaksiioni i brendshëm i vendit tonë. «Balli Kombëtar», «Legaliteti» dhe të gjitha organizatat e tjera tradhëtare

ishin armët e fashizmit në dorën e OVRA-s dhe të Gestapos. Njerëzit e «Ballit», të «Legalitetit» etj., s'ishin përveçse spiunë të thjeshtë dhe ekzekutuesit e urdhërave të Gestapos dhe të OVRA-s fashiste. Të gjithë në këtë rrugë dualën, por lodra e tyre dhe demagogjia që përdornin, nuk ishin nga më të thjeshtat dhe shumë njerëz ranë brenda. «Balli Kombëtar» dhe organizatat e tjera përfaqësonin interesat e klasave pasanike të bejlerëve, të agallarëve, të tregëtarëve të mëdhenj spekulatorë dhe të intelektualëve fashistë. Këto klasa, natyrisht, në luftën e popullit shihnin një rrezik të madh që kërcënonte pasuritë e tyre dhe që do t'i pengonte ata në zhvillimin e mëtejshëm të veprës së tyre shtypëse. Ishte, pra, në rrezik si forca ekonomike e tyre dhe ajo politike. Për okupatorin dhe për tradhëtarët çeshtja vihej që në Shqipëri, të mos ekzistonë Lufta nacional-çlirimtare dhe, në rast se kjo fillonte, ajo duhej shtypur me çdo kusht. Dhe ata përdorën metodat që i shërbyen Gëbelsit për të pasur sukses në ato vende, ku kolona e pestë e tij u hapi dyert me të dy kanatet hordhive gjermane dhe që siguruan sukseset e para të ushtrisë gjermane. Por në vendin tonë ngjau ndryshe; okupatori u prit me pushkë dhe lufta e popullit tonë filloi e pamëshirshme. Atëherë «Balli Kombëtar» luajti kartën e tij. Ai doli nën maskën e një organizate «nacionaliste», që gjoja kishte në program të çlironte atdheun. Por nga kush do ta çlironte atdheun, nga okupatorët apo nga populli shqiptar që kishte rrokur armët? Sigurisht, jo nga okupatorët. Taktika e tij e fillimit ka qenë që kjo organizatë tradhëtare nën parulla demagogjike të përpinqej të pengonte bashkimin e popullit në Frontin Na-

cional-Çlirimtar, të luftonte dhe të izolonte Partinë Komuniste nga populli dhe mbasandaj tok me okupatorin dhe në mënyrë të hapët, të asgjësonte forcat luftarakë të popullit. Shumë bezlerë dhe agallarë dilnin nga një çerek ore në mal, duke mbajtur pas një sëri qehajallarësh dhe këta i quanin çeta, por çeta që shkonin për të grabitur popullin, për të bërë propagandë kundër Frontit dhe Partisë Komuniste dhe aspak për të hedhur ndonjë pushkë qoftë dhe gabimisht kundër okupatorëve. Të tilla ishin çetat e Fazlli Beut¹, të Hetem Beut², të Safet Butkës dhe të disa banditëve të tjera. Por a mund të vazhdonte një situatë e tillë? Ishte e pamundur. Të kesh ngrënë hudhër dhe të kërkosh që të të bjerë goja erë trëndafile, kjo është një gjë e pamundur. Lodra e «Ballit» s'do të vazhdonte gjatë. «Balli» u katandis pikërisht ashtu siç kishin për qëllim okupatori dhe reaksiuni i brendshëm që e kishin krijuar: në banda terroriste në dorën e armikut dhe në luftë të hapët me popullin. Disa përpiken të arësyetojnë se qëllimet e fillimit ishin të mira, por më vonë degjeneruan. Jo, qëllimet e fillimit ishin po ato të mbarimit, vetëm se taktika e fillimit, u demaskua nga lufta e popullit shqiptar, dhe «Balli Kombëtar» dhe organizatat e tjera tradhëtare u detyruan nga populli të marrin fytyrën e vërtetë të tyre. Ali Këlcyrë, Mithat Frashëri etj. banditë kishin po ato qëllime, si në fillim dhe në mbarim dhe qëllimi i tyre, derisa të ngordhin, do të jetë shtypja e popullit shqiptar. Por planet e fa-

¹ Fazlli Bej Frashëri

² Hetem Bej Frashëri

shizmit gjerman dhe italian dështuan, dështuan tok me to edhe planet e tradhëtarëve shqiptarë.

Në Shqipëri u ndez lufta e çlirimtit nga të katër anët dhe qarku i Korçës ka qenë një nga vratat më kryesore të kësaj lufte. Punëtorët, fshatarët, intelektualët patriotë, rinia heroike dhe gratë e qytetit të Korçës, ju përgjegjën menjëherë thirrjes së Partisë. I madh dhe i vogël u çua në këmbë me parullën e Frontit Nacional-Çlirimtar: «Vdekje Fashizmit — Liri Popullit». Heroizma të jashtzakonshme janë bërë prej popullit të Korçës gjatë luftës së çlirimtit. Me mijëra e me mijëra banorë të këtij qyteti dhe të rretheve të tij demostronin dhe përlesheshin me forcat e okupatorit dhe të tradhëtarëve. Heroikisht binte në ballë të demonstratës Heroi i Popullit, Koci Bako, militant i vjetër komunist, përfaqësues i denjë i punëtorisë së Korçës, e cila ka qenë bërrthama e shëndoshë që do t'i jepte Partisë sonë Komuniste, luftës së popullit dhe atdheut, njerëz të zot dhe trima. Heroikisht luftuan dhe u vranë të rinxjtë Kiço Greço dhe Midhi Kostani, përfaqësues të rinisë heroike të Korçës, e cila ka qenë një nga shtyllat kryesore të luftës sonë ngadhnjimitare. Rinia e demonstratave të para, e grevave, e sabotazheve u bë faktori i rëndësishëm i luftës sonë të çlirimtit. Ajo ishte pararoja e lavdishme e luftës. Të rinxjtë punëtorë, fshatarë, studentë, me grupe të organizuara dilnin në male nga qyteti dhe fshatrat e Korçës. Ata braktisën punëtoritë, parmandat, shkollat dhe ju përgjegjën thirrjes së atdheut duke i dalë zot atdheut. Këto male do të mbajnë gjallë brez pas brezi kujtimin e luftërave heroike, të çetave, të batalioneve dhe të brigadave të Korçës, që luftuan me trimëri dhe me vetë-

mohimin më të madh për çlirimin e atdheut. Populli ynë do të këndojë brez pas brezi përpjekjet heroike të komunistit të vjetër, Sotir Gurrës, që luftoi tërë jetën e tij dhë u vra duke luftuar për çështjen e popullit. Populli ynë dhe brezat e ardhshëm të Shqipërisë do të ruajnë të pavdekshëm në zemrat e tyre kujtimin e qindra heronjve të popullit shqiptar dhe sakrificat e mëdha të tyre do të jenë për ne modeli i gjallë për të vazhduar rrugën, për të cilën ata ranë.

Lavdi popullit heroik të Korçës!

Lavdi punëtorëve dhe punëtoreve të Korçës, flamurtarë të lëvizjes çlirimtare!

Lavdi të përjetshme dëshmorëve të qarkut të Korçës: Ali Kelmendit, Heroit të Popullit Koci Bakos, Sotir Gurrës, Kiço Greços, Midhi Kostanit, Fuat Babanit. Rahmi Stropanit, Shaban Sulit, Taqi Trenit, Petro Lakuorit, Nazif Verlenit, Nevruz Poloskës, Haxhi Dobreñjit, Todi Grapshit, Naskë Hoçishtit, Bexhet Vishocicës. Gani Nexhipit, Male Cangonjit, Jorgo Plakut, Muhamet Rexhepit, Raqi Qirinxhiut, Raqi dhe Stavri Themelit, Floresha Myteveliut, Sotir Rrëmbecit, Denir Progrit. Faik Ponaços, Xhafer Lubonjës. Kristaq Illos!

Popull i Korçës,

Kur u okupua vendi ynë nga Italia fashiste, vetëm Bashkimi Sovjetik ngriti zërin dhe protestoi energjikisht kundër agresionit të poshtër që i bëhej vendit tonë. Kjo ishte e natyrshme, pse Bashkimi Sovjetik ishte i vetmi shtet, ku populli ishte në fuqi; atje ishte vendosur socializmi dhe shteti sovjetik mbronte me të gjitha forcat e tija paqen që po kërcënohej nga nazizmi gjerman,

i mahur dhe i nxitur për luftë nga imperialistët dhe, në radhë të parë, nga Anglia dhe Franca. Anglia e Çemberlenit dhe Franca e Lavalit dhe e Daladierit i lanë dorë të lirë Gjermanisë dhe Italisë të fillonin veprën e tyre gjakatare, pra ishte fare e kuptueshme që këto dy shtete të mos tronditeshin aspak për fatin e popullit tonë, kur ky u sulmua më 7 prill. Por populli ynë e kuptoi mirë që atëhere se asgjë të mirë nuk mund të priste nga të ashtuquajturat demokraci të Perëndimit, të cilat jo vetëm që s'çanë kryet për fatin e popullit tonë, të popujve çekoslovakë dhe austriak, por qëllimi i tyre ishte që, me anën e Gjermanisë, të mposhtnin Bashkimin Sovjetik, atdheun e socializmit dhe kështu të mundnin të vendosnin hegemoninë e tyre. Por çështjet nuk u zhvilluan ashtu si menduan ata dhe Hitleri. Përfundimet e Luftës së dytë botërore të gjithë ne i kemi të qarta. Gjermania hitleriane u mposht në saje të luftës heroike të popujve të Bashkimit Sovjetik, në saje të sakrificave të mëdha të këtyre popujve, në saje të regjimit socialist që ishte krijuar në Bashkimin Sovjetik, në saje të udhëheqjes gjeniale të Stalinit të madh. Popujt demokratë dhe përparimtarë të botës dhe, në radhë të parë, popujt e robëruar të Evropës, që luftuan me ashpërsinë më të madhe kundër fashizmit, këtë gjë e kanë të qartë dhe nuk mund ta errësojë, qoftë për një grimë, demagogjia e Uashingtonit dhe e Londrës. Peshën më të madhe të luftës e mbajti Bashkimi Sovjetik dhe në saje të Bashkimit Sovjetik u mposht Gjermania hitleriane dhe satelitët e saj.

Qëllimet e imperializmit amerikan dhe atij anglez, që muarën pjesë në Luftën e dytë botërore, ishin të

kundërta nga ato të Bashkimit Sovjetik dhe të popujve të tjerë të robëruar të Evropës që luftonin fashizmin, megjithëse bënин pjesë që të gjithë në blokun e madh antifashist. Flamurin e luftës së çlirimt e mbajti fort dhe e ngriti lart Bashkimi Sovjetik, i cili vuri të gjitha forcat e tija kolosale për mundjen e Gjermanisë hitleriane dhe të satelitëve të tyre, për zhdukjen e fashizmit nga faqja e botës, për vendosjen e një paqeje të drejtë dhe të qëndrueshme dhe për dënimin pa mëshirë të agresorëve; ai luftoi për vendosjen e demokracisë dhe fuqizimin e saj në Evropë, për vendosjen e marrëdhënieve të ngushta dhe bashkëpunimin e sinqertë ndërkombëtar në mes të shteteve. Këto ishin qëllimet e Bashkimit Sovjetik, të përkrahura nga të gjithë popujt përparimtarë të Evropës që ndodheshin nën thundrën gjermane. Bashkimi Sovjetik vuri të gjitha fuqitë e tija që lufta të merrete fund sa më shpejt dhe të mposhtej Gjermania, që kështu vuajtjet, mjerimi, humbja e njerëzve, të merrnin fund sa më parë dhe pasuritë e popujve, si edhe qytetërimi të dëmtoheshin sa më pak dhe të shpëtoheshin sa më shpejt nga murtaja fashiste. Mirëpo, pjesëtarët e tjerë kryesorë të blokut antifashist, amerikanët dhe anglezët, mendonin ndryshtë dhe qëllimet e tyre ishin të tjera. Reaksiioni amerikan dhe anglez, kur panë se Hitleri u erdhi deri në portat e Londrës, hynë në luftë me Gjermaninë hitleriane dhe me Japoninë militariste e fashiste me qëllim që të zhduknin dy konkurrentë të rrezikshëm për të vendosur hegemoninë e tyre. Kështu që lufta që bënин anglo-amerikanët s'kishte aspak një karakter çlirimtar. Qëllimi tjetër i imperialistëve amerikanë dhe anglezë ishte, që nga kjo

luftë Bashkimi Sovjetik të dilte sa më i dobësuar dhe të mos linin që popujt e tjerë të vendosnin në vendet e tyre, me luftë të paprerë kundër okupatorëve, pushtet popullore. Kështu shpjegohet ngadalësimi i luftës nga amerikanët dhe anglezët, vonesa e hapjes së frontit të dytë, i cili u hap pas të vjelave, kur Ushtria e Kuqe marshonte mbi Berlin; kështu shpjegohen përpjekjet e anglezëve dhe të amerikanëve në apelet e pareshtura drejtuar popujve të robëruar që luftonin kundër gjermanëve, «për të ngadalësuar luftën», «për të mos u vrarë më kot», «për të rezervuar forcat për momentin e duhur» që, natyrisht, do ta shpallnin Londra me Uashingtonin. Qëllimi ishte që reaksiioni i brendshëm i çdo vendi të mbante të paprekura pozitat e veta që kërcënoheshin nga luftërat nacional-çlirimtare të popujve të robëruar, në mënyrë që, kur Gjermania të thyhej, reaksiioni, tradhëtarët dhe kuislingët të vazhdonin të ishin në fuqi dhe të shtypnin popullin nën maskën e një demokracie false, si ato që «lulëzojnë» në Perëndim.

Por, me gjithë këto përpjekje të anglo-amerikanëve gjatë gjithë periudhës së luftës, planet e tyre dështuan. Gjermania hitleriane u mposht dhe në shumë vende të robëruara të Evropës, si në Jugosllavi, Poloni, Çekoslovakia, Bullgari, Hungari, Rumani, të çliruara nga Ushtria e Kuqe, populli erdhi në fuqi dhe u vendos demokracia popullore, ashtu si dhe në Shqipëri.

Në të gjitha vendet ku është vendosur demokracia popullore dhe veçanërisht në vendin tonë, përpjekjet e reaksionit ndërkombëtar kanë qenë të pareshtura dhe të turpshme për të dëmtuar popullin tonë dhe për të luftuar demokracinë tonë. Misionet angleze dhe ameri-

kane, që kishin ardhur në Shqipëri gjatë periudhës së luftës, na kanë ndihmuar fare pak me armë dhe me municion, gjë për të cilën ata duhej të kishin ardhur. Mirëpo qëllimet e tyre kanë qenë të ndryshme dhe gjatë periudhës së luftës ne kemi qenë në konflikt të përhershëm me ta. Misionet në fjalë kishin ardhur për ta dobësuar luftën e popullit tonë dhe jo për ta ndihmuar; ata u përpoqën dhe erdhën në lidhje me «Ballin Kombëtar» dhe krerët e tij, që haptas bashkëpunonin me okupatorët italianë dhe gjermanë; ata u përpoqën të organizonin dhe të forconin pozitat e reaksionit; ata u munduan dhe krijuan «Legalitetin» për të luajtur kartën e Zogut; ata u përpoqën të pengonin luftën tonë kundër kuislingëve dhe tradhëtarëve; ata na kërcënonin, ata u orvalën të zbarkonin në vendin tonë gjatë kohës së luftës. Por të gjitha këto u demaskuan dhe misionet angleze dhe amerikane dështuan në planet e tyre. Pas çlirimtë të Shqipërisë ata vazhduan të qëndronin në Shqipëri gjoja për të pregetitur njohjen e Shqipërisë dhe të qeverisë së saj. Por qëllimi ishte gjetkë. Pas disfatës që pësoi reaksiioni i brendshëm në Shqipëri, reaksiioni amerikan dhe anglez u përpoqën përsëri ta rigrumbullonin, t'i jepnin zemër dhe ta organizonin për ta hedhur në luftë kundër pushtetit popullor dhe në këtë mënyrë ta bënin Shqipërinë një Greqi të dytë. Në të gjitha veprimet e tradhëtarëve në Shqipëri, inspiruesit dhe organizuesit direkt kanë qenë anglezët dhe amerikanët me misionet e tyre në Tiranë. Kjo gjë është e provuar dhe e dokumentuar. Por edhe këto përpjekje të tyre u dështuan si të gjitha. Populli shqiptar ishte vigjilent për të ruajtur atdheun e tij, lirinë, pavarësinë.

demokracinë dhe fitoret e luftës. Nervat e popullit tonë ishin të shëndosha dhe as kërcënimet, as shantazhet e anglo-amerikanëve nuk e tronditën në asnjë moment. Anglo-amerikanët, megjithëqë e panë se brenda në vendin tonë planet e tyre dështuan dhe përparrë botës u zbuluan qëllimet e tyre agresive, prapë s'i hodhën armët, përkundrazi filluan të bëjnë kundër vendit tonë një fushatë të ashpër ndërkombëtare. Anglo-amerikanët pa pikë turpi na kanë mohuar të gjitha të drejtat tona që i kemi fituar me gjak; ata krijuan incidente, si ai i Sarandës, incident i krijuar fund e krye nga anglezët; ata nxisin monarko-fashistët grekë të na provokojnë dita me ditë në kufi, të na vrasin ushtarët tanë, të kërkojnë Korçën e Gjirokastrën e të tjera poshtërsi të tilla. Reaksioni amerikan dhe anglez e akuzon vendin tonë si një vend agresor që rrezikon paqen, që është shkaktar i luftës në Greqi dhe se gjoja lufta në Greqi furnizohet nga ne me armë dhe municion. Të tilla janë përpjekjet e reaksionit amerikan kundër vendit tonë, por të gjitha këto tentativa të poshtra, shpifëse do të dështojnë, si edhe tentativat e para.

Populli ynë nuk frikësohet nga këto veprime të anglo-amerikanëve dhe as që pengohet në rrugën e tij paqësore dhe ndërtimtare. Por orvatjet e reaksionit ndërkombëtar, me në krye reaksionin amerikan për të vendosur hegjemoninë e tij në botë janë të mëdha. Reaksioni amerikan, anglez, francez etj., të përkrahur nga socialistët e djathtë, tradhëtarë të klasës punëtore, përpiken të mëkëmbin fashizmin dhe të forcojnë pozitat e reaksionit, të humbura dhe të dobësuara nga Lufta e dytë botërore. Reaksioni amerikan, që e organizon dhe

e udhëheq këtë fushatë, përpinqet të robërojë popujt e botës si ekonomikisht, ashtu edhe politikisht, përpinqet të mëkëmbë Gjermaninë hitleriane dhe Japoninë militariste që t'i përdorë këto si një armë për të luftuar Bashkimin Sovjetik dhe gjithë popujt e tjerë që kanë vendosur në vendet e tyre demokracitë popullore. Reaksiuni amerikan me nxitësit e tij të luftës, me politikën e dollarit dhe të bombës atomike, me doktrinën e Trumanit dhe me planin Marshall, përpinqet të hedhë botën në një kasaphanë të tretë, përpinqet të frikësojë dhe të kërcënojë popujt liridashës dhe paqedashës. Reaksiuni amerikan, të cilit i shërbejnë besnikërisht shërbëtorët e tij, përpinqet që Organizatën e Kombeve të Bashkuara ta shkëmbejë në një Lidhje të Kombeve të dytë, që të ketë vetëm për funksion aprovin e metodave dhe të qëllimeve agresive, ekspansioniste dhe skllavëruese të imperializmit amerikan. Por të gjitha këto orvatje të reaksiunit amerikan dhe të shërbëtorëve të tij do të falimentojnë, pse përballë këtyre manevrave gjenden popuj dhe shtete me nerva të fortë, me forca kolosale, që do t'i mposhtin këto manevra dhe do të bëjnë të triumfojë drejtësia, të vendoset një paqe e drejtë dhe e vazhdueshme, të luftohet pa mëshirë agresioni dhe agresorët, të forcohet demokracia popullore dhe të vendoset bashkëpunimi i drejtë në mes të popujve përparimtarë të botës. Në krye të këtyre forcave përparimtare, që luftojnë për paqen dhe për mbrojtjen e njerëzimit, qëndron si një kala e çelniktë dhe më e fortë se kurrë Bashkimi i lavdishëm Sovjetik i udhëhequr nga Stalini i madh dhe nga Partia Bolshevikë e Lenin-Stalinit. Të gjitha manevrat e reaksiunit ndërkombëtar dhe të nxi-

tësve të luftës po bëhen pluhur përpara politikës së drejtë dhe konsekuente të Bashkimit Sovjetik. Asgjë s'mund t'i rezistojë forcës së madhe të popujve dhe të shtetit sovjetik. Gjithë popujt përparimtarë të botës e mbështesin me të gjitha forcat e tyre politikën e drejtë paqësore dhe përparimtare të Bashkimit Sovjetik. Popujt përparimtarë të botës shohin te Bashkimi Sovjetik shpëtimtarin e njerëzimit nga kthetrat e Gjermanisë hitleriane dhe atë që përpinqet të shpëtojë botën dhe njerëzimin nga kërcënimi i imperializmit amerikan e ndërkombëtar. Popujt e botës nuk duan më luftë, prandaj nxitësit e luftës do të dështojnë në veprën e tyre. Popujt e botës duan të ruajnë sovranitetin e tyre, prandaj do të dështojnë të gjitha orvatjet e reaksionit amerikan dhe të shërbëtorëve të tyre, që kërkojnë ta zhdukin këtë sovranitet të çdo populli për të vendosur hegemoninë e kapitalit. Popujt e botës duan të rrojnë të lirë, të paravarur dhe nën regjime demokratike popullore, prandaj do të dështojnë me turp edhe doktrina Truman, edhe varianti i tij, plani Marshall. Bashkimi i madh Sovjetik dhe të gjitha ato shtete, ku është vendosur demokracia popullore, si edhe gjithë popujt e tjerë përparimtarë dhe demokratë të botës, janë shumë më të fortë nga nxitësit e luftës, nga forcat e errësirës, prandaj, politika e Bashkimit Sovjetik do të fitojë si kurdoherë, do të fitojë drejtësia, kurse politika e kërcënimave, e shantazheve, politika e dollarit dhe e bombës atomike do të dështojnë.

Popull i Korçës,

Populli ynë luftoi që të çlirohet nga okupatorët dhe tradhëtarët e vendit dhe të merrte përgjithmonë fuqinë

në duart e veta. Këtij qëllimi ja arriti. Shqipëria u shpall Republikë Popullore dhe në vendin tonë u vendos demokracia popullore nga më përparimtaret në botë. Lufta jonë nacional-çlirimtare i dha vendit tonë lirinë, pavarësinë, i siguroi sovranitetin e tij shtetëror, por njëkohësisht ajo i dha popullit tonë forma organizative dhe e edukoi politikisht në atë mënyrë, që demokracia jonë jo vetëm t'i kishte bazat të shëndosha, të hekurta, për t'i rezistuar çdo rreziku dhe çdo kërcënimi, por demokracia jonë të zhvillohej, të përparonte për t'i siguruar vendit tonë ditë më të lumtura. Lufta jonë, revolucioni ynë popullor, jo vetëm që rrëzuan nga themelet regjimet dhe institucionet e urryera të paraluftës, të cilat kurrë nuk do të ringjallen, por dhe farkëtuan njerëzit e rinj, me një botëkuptim të ri, me një koncept të fuqishëm dhe të ri patriotik, të përshtatshëm me regjimin që ndërtoi populli me gjakun e tij. Të gjitha këto fitore të revolucionit tonë popullor bënë që vendi ynë brenda një kohe të shkurtër mundi të dalë nga gjendja e vështrë e pasluftës. Ju i dini sukseset e njëpasnjëshme që ka pasur pushteti popullor në Shqipëri. Këto ishin të mëdha dhe sidomos për konditat, në të cilat u arritën këto suksese. Askush të mos kujtojë se këto suksese ranë nga qiejt, asgjë s'bie nga qiejt, por çdo gjë varet nga krahët dhe nga djersa e ballit. Dhe populli ynë punoi me heroizmin më të madh, me vetëmohimin më të madh, pa marrë parasysh pengesat, mungesat, privacionet, sakrificat. Këtu qëndron forca që ngriti minierat tona të shkatërruara, centralet elektrike të shkatërruara, urat, rrugët, fabrikat, linjat telefonike. Këtu qëndron forca që u rimëkëmb dhe u përmirësua ekonomia jonë, buj-

qësia jonë, blegtoria, arësimi dhe kultura jonë. Këtu duhet të shohim forcën e pathyeshme të popullit, besimin që ai ka në forcat e veta, në pushtetin e tij. Këtu duhet të shohim zgjuarësinë dhe zotësinë e tij. Ky është patriotizmi i madh i masave të gjera të popullit tonë, që, i bashkuar në Frontin Demokratik dhe i udhëhequr nga Partia jonë Komuniste, bëri dhe vazhdon të bëjë gjëra të habitshme. Por ka disa njerëz që e kuptojnë gabim patriotizmin dhe përpiken si e si të lënë të kuptohet se gjoja regjimi ynë nuk i respekton patriotët e vjetër, i nënçmon, ose i lufton. Të tilla mendime s'kanë asnje bazë dhe duhen luftuar pa mëshirë. Patriot, qoftë ky i vjetër ose i ri, qoftë ky i Rilindjes, ose i Luftës nacional-çlirimtare, për ne është ai, që është me popullin dhe lufton për kauzën e popullit. Zaten regjimi ynë atje e ka forcën. Nuk mund të ketë regjim tjetër në botë që të nderojë e të ndihmojë patriotët, qofshin këta të rinj ose pleq, si regjimi ynë demokratik. Por patriotizmi i vërtetë nuk mund të jetë një gjë statike dhe i konceptit të vjetruar. Nuk mund të quhet patriot ai njeri që mund të ketë qenë me Mihal Gramenon dhe me Çerçiz Topullin, por që më vonë ai është bërë agjenti më i poshtër i italianëve dhe i gjermanëve dhe të ketë luftuar me ashpërsinë më të madhe kundër popullit tonë. Nuk mund të quhet patriot Safet Butka dhe shokët e tij të cilët, duke spekuluar në përpjekjet patriotike të Gani Butkës, u bënë banditët më të ndytë, që vranë dhe plaçkitën popullin në favor të italianëve. Si mund të quhet patriot një Kolë Tromarë, ose një Fazlli Frashër, që u bënë veglat më të poshtra të Italisë dhe të Gjermanisë për të shtypur popullin shqiptar. Jo. Këta janë tra-

dhëtarë, dhe të gjithë ata që i quajnë këta «patriotë», nuk janë përveçse shokët e tyre. As nuk mund të quhen patriotë ata njerëz që kanë luftuar disi gjatë Luftës nacional-çlirimitare dhe që më vonë ata, në vend që të vazhdonin të luftonin dhe të punonin me mish e me shpirt për popullin, për forcimin e demokracisë dhe të regjimit të tij, ata u bashkuan me tradhëtarët e vendit tonë, u puqën tok me ta dhe nën udhëheqjen e reaktionit ndërkontëtar u përpoqën t'i bëjnë varrin popullit dhe Shqipërisë. Jo, patriotë nuk mund të jenë ata njerëz që gjatë Luftës nacional-çlirimitare janë hequr pro lëvizjes, ose kanë marrë pjesë me qëllime krejt të ndryshme nga ato të popullit dhe kur kanë parë se punët nuk po shkonin ashtu si ëndërronin ata, u përpoqën të shajnë e të kritikojnë vrimave, të lidhin duart e të pretendojnë se gjoja u vajti mundimi kot, se regjimi ynë nuk ua vë veshin ose i përbuz. Jo, këta s'janë patriotë, këta janë armiq, këta janë pjesë e borgjezisë reaksionare, mbeturina të feudalizmit dhe intelektualë fals. Në udhëtimin tim në malet e Vlorës unë u takova me një katundar plak 80-vjeçar. Ai kishte luftuar me çetat e Rilindjes, kishte luftuar në Luftën e Vlorës. Ai ishte kundër Zogut, ai doli partizan në mal që në fillim, ai humbi në luftë djalin e tij të vetëm dhe tani drejton pushtetin në lokalitetin e tij. Ky është model i patriotit të vërtetë. Patriot i vërtetë është ai që tërë jetën e tij i qëndron besnik çështjes së popullit, që është konsekuent në këtë qëndrim, që punon me mish e me shpirt për popullin, që lufton për pushtetin popullor, për forcimin e Republikës dhe që është kurdoherë me gjithë zemër dhe me të gjitha forcat e tija që disponon, në pararojë, për të

luftuar kundër armiqve të popullit, kundër armiqve të demokracisë, armiqve të paqes. Patriotizëm tjetër, jashtë këtij prizmi nuk ka. Të gjitha të tjerat janë profka dhe demagogji. Patriot është ai, qoftë plak ose i ri, që ka luf-tuar për çlirimin e Shqipërisë nga okupatorët dhe tradhëtarët, patriot është ai që tanë vazhdon të punojë më me vrull për ndërtimin e atdheut, patriot është ai që hap kanale, që punon mirë në miniera, në fabrika, në ara, në shkolla e kudo ku punohet për popullin, për atdheun. Patriotët më të shquar janë punëtorët dhe gjithë masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit. Dhe në saje të këtij patriotizmi të madh vendi ynë po përparon me hapa të mëdhenj dashkan ose s'dashkan armiqtë e brendshëm ose reaksiuni ndërkombëtar.

Duke u bazuar në sukseset e deritashme vendi ynë do të shohë ditë më të lumtura. Qeveria jonë po pre-gatit planin pesëvjeçar, i cili parashikon ngritjen e një sërë fabrikash në vendin tonë për të shfrytëzuar prodhimet tona bujqësore dhe blegtore, parashikon një ndihmë të madhe bujqësisë me një seri bonifikimesh e modernizimesh përsa u përket metodave dhe mjeteve të punës. Parashikohet një shfrytëzim më i madh i minierave tona dhe ndërtimi i disa linjave të tjera hekur-udhore, që do të lehtësojnë edhe më tepër shfrytëzimin e pasurive të nëntokës sonë dhe do të lehtësojnë marrëdhënjet dhe shkëmbimet, qoftë brenda Shqipërisë, qoftë jashtë.

Krahas me zhvillimin e ekonomisë dhe e pandarë nga kjo do të zhvillohet dhe kultura e arësimi në vendin tonë. Korça ka qenë dhe duhet të jetë kurdoherë, jo vetëm një qendër ekonomike nga më të rëndësishmet

në vendin tonë, por edhe një nga qendrat kryesore të shkencës së re. Me fitoren e kryengritjes së popullit, shkenca dhe kultura në Shqipërinë e re morën një karakter krejt të ri, një karakter thellësisht demokratik dhe s'ka asnjë dyshim se vetëm vendosja e pushtetit të popullit e bëri të nevojshme dhe të mundshme demokratizimin e kulturës dhe të arësimit. Në regjimet e vjetra shkenca, kultura ishin monopol i një pakice të privilegjuarish, me Ahmet Zogun në krye. Me çlirimin e atdheut tonë na vihej përpëra problemi i rëndësishëm i ndërtimit të kulturës së re dhe i forcimit të arësimit, duke i përhapur këto në shkallë të madhe në masat e gjera punonjëse të vendit tonë. Kultura dhe arësimi duhej të futeshin në fabrika, në masat fshatare e kudo ku punohet. Kultura dhe arësimi duhej të bëheshin privilegji i popullit dhe arma e shëndoshë e tij për të ndërtuar atdheun dhe jetën e tij më të mirë. Gjatë tre vjet lirie janë bërë shumë hapa përpëra në këtë drejtim. Por këto nuk janë të mjafta. Në vendin tonë janë çelur shumë shkolla fillore, unike, të mesme; një luftë e madhe bëhet kundër analfabetizmit, plagë kjo e trashëguar nga e kaluara dhe çdo vit po dërgohen studentë në universitetet e Bashkimit Sovjetik e gjetkë. Në vargun e detyrave të qeverisë, problemi i kulturës zë një vend me rëndësi të madhe. Vendi ynë, shteti ynë nga më demokratikët ka nevojë të madhe për kuadro të rinj dhe të zot, të dalë nga gjiri i popullit të përvuajtur, pse këta do ta çojnë me besnikërinë më të madhe përpëra vendin tonë. Për të ndërtuar jetën e re, preqatitja e kuadrove të rinj është një kusht i domosdoshëm. Natyrisht preqatitja e tyre nuk është aq e lehtë, por asgjë s'është e pamundur për një po-

pull që rron në liri të plotë dhe vetëqeveriset. Në një kohë të shkurtër në vendin tonë dolën njerëz të rinj dhe të zot, që dijtën të drejtojnë shtetin tonë në të gjithë sektorët e jetës. Këta janë njerëzit e luftës, punëtorë dhe fshatarë, që gjer dje mbaheshin larg jetës politike të vendit, larg shkencës dhe kulturës. Populli ynë është një burim i pashterur forcash, populli ynë tani që ka të gjitha mundësitë di të mësojë dhe të mësojë mirë, është i aftë të përvetësojë si duhet shkencën dhe këtë shkencë ta vërë në shërbimin e interesave të tij. Kultura në vendin tonë është në rrugën e re dhe të drejtë. Një nga karakteristikat kryesore të kulturës sonë të re, karakteristikë që duhet pasur kurdoherë dhe vazhdimit parasysh, është kjo: shkenca duhet të ketë lidhje të ngushta me jetën dhe me praktikën. Shkenca duhet të lidhet me nevojat e jetës dhe të ecë krahas me to, ajo duhet të ketë për qëllim që t'i shërbuje shoqërisë dhe nevojave të jetës dhe këto nevoja të popullit duhet të plotësohen shpejt dhe mirë, pse ato nuk presin. Kulturë në baza idealiste, e mbajtur larg nevojave të popullit, nuk mund të ekzistojë në një regjim si yni. Që shkenca dhe kultura të kryejnë misionin e tyre, duhet të bazohen mbi principet shkencore të pavdekshme të marksizëm-leninizmit, mbi botëkuptimin materialist të botës. Këtë njerëzit e kulturës dhe të shkencës, nuk duhet ta harrojnë në asnjë moment. Të gjithë ata që mendojnë ndryshe, duke u përpjekur të mbajnë gjallë dhe të forcojnë botëkuptimin e tyre idealist, jo vetëm që nuk janë njerëz të shkencës, por ata dhe ideologjia e tyre i shërbijnë armikut të popullit tonë, borgjezisë reaksionare dhe imperializmit sklla-

vérues. Botëkuptimi materialist i botës, filozofia materialiste, materializmi dialektik dhe historik, këto dhe vetëm këto duhet të jenë bazat shkencore që do të bëjnë të përparojë shkenca dhe kultura në vendin tonë, të përparojë atdheu dhe populli ynë nga të gjitha pikëpamjet.

Të gjitha këto detyra që thashë më lart janë të realizueshme dhe ne do t'i realizojmë. Për t'i kryer me sukses këto detyra, të cilat do të bëjnë që jeta jonë të përmirësohet, duhet të bëhet mobilizimi total i masave të gjera të popullit tonë. I madh e i vogël, burra dhe gra, rinia jonë heroike, të hidhen të gjithë në punë me vullnetin dhe me zellin më të madh, për të ndërtuar sa më shpejt, për të punuar sa më mirë dhe për të prodhuar sa më shumë dhe sa më lirë. Plani i shtetit tonë të jetë ligj për të gjithë, ligji më i madh që duhet zbatuar me rigorozitetin dhe me përpikërinë më të madhe, pse andej varet jeta e popullit tonë, forcimi i pushtetit popullor dhe i Republikës, andej varet e ardhmja e lumtur e kalamajve tanë. Këtë mobilizim të madh të masave të popullit tonë duhet ta realizojë Fronti Demokratik nën udhëheqjen e lavdishme të Partisë sonë Komuniste. Fronti Demokratik duhet të jetë organizata e fortë dhe e gjerë e masave të popullit, ku të marrë pjesë i gjithë populli punonjës dhe atje të forcohet politikisht për të kryer si duhet detyrat që historia na vë përpara.

Me Frontin Nacional-Çlirimtar, të udhëhequr nga Partia Komuniste, ne fituam luftën, çliruam atdheun, ngritëm demokracinë dhe Republikën. Me Frontin Demokratik, të udhëhequr nga Partia Komuniste, nga par-

tia e punës, ne do t'i përvishemi punës dhe do të ndërtojmë jetën më të mirë dhe më të lumtur.

Vëllezër dhe motra të Korçës,

Ju i dini të gjitha intrigat, shpifjet, provokacionet që na bëhen nga fqinji ynë i Jugut, Greqia monarko-fashiste, e nxitur dhe e shtytur nga reaksioni amerikan dhe anglez. Dini gjithashtu qëllimet e reaksionit anglo-amerikan që i bën këto gjëra dhe pretendimet qeshrake të fashistëve grekë mbi Korçën dhe Gjirokastrën.

Qentë kanë zanat të lehin, por ka kush i bën zap. Kur këta qen do të tentojnë të kafshojnë, ne u hedhim zinxhirët në grykë. Le të lehin, pra, fashistët grekë dhe ata që i nxitin, Korça dhe Gjirokastra kanë qenë, janë dhe do të janë tonat, dhe as do të ketë forcë në botë që do të guxojë t'i prekë. Shkoi koha kur vendi ynë ishte pa zot dhe imperializmi ndërkombëtar na kish bërë një monedhë shkëmbimi. Por çështja është gjetiu. Kjo lodër e turpshme e reaksionit ndërkombëtar, e udhëhequr nga imperializmi amerikan, ka për qëllim ta ngrejë çështjen greke në një shkallë të madhe ndërkombëtare, për të kërcënuar paqen në Ballkan e në botë, për të lufuar demokracitë popullore në Ballkan e gjetiu dhe në radhë të parë për të lufuar Bashkimin e madh Sovjetik, kështjellën e pamposhtur të demokracisë së vërtetë. Reaksioni amerikan lufton në OKB me argumenta false, me gënjeshtra dhe me dokumenta të rreme. Vallë, a mund të kenë sukses këto veprime të tyre të ndyra dhe jashtë ligjit? Jo, kurrë. Të gjitha këto do të falimentojnë përparrë drejtësisë dhe vendosmërisë së popujve demo-

kratikë. Populli ynë nuk trembet, as nga frikësimet dhe as nga shantazhet e këtyre qeverive fashiste e imperialiste, por ai vazhdon me vendosmérinë më të madhe rrugën që i ka caktuar vetes dhe që është rruga e përparimit dhe e paqes. Siguri për ecjen tonë në këtë rrugë të drejtë është edhe miqësia e ngushtë dhe e sinqertë që populli ynë ka me popujt e Bashkimit Sovjetik. Bashkimi Sovjetik ka qenë dhe është shpëtimtari i popullit tonë të vogël, prandaj populli ynë, kudo që shkova, në qytete dhe në fshatra të ndërtuar në majë të shkëmbinjve, brohoriste me dashurinë më të madhe për lavdinë e Bashkimit Sovjetik, për lavdinë e Stalinit të madh. Pa Bashkimin Sovjetik ne nuk mund të çliroheshim, prandaj për popullin tonë Bashkimi Sovjetik dhe Stalini janë të shtrenjtë për ne.

Në rrugën tonë të drejtë le të ecim me vendosmérinë më të madhe; populli heroik i Korçës le të qëndrojë si kurdoherë në ballë të përpjekjeve të popullit shqiptar; punëtorët heroikë dhe fshatarët e Korçës të jenë kurdoherë në pararojë në ndërtimin e jetës sonë të mirë, rinia heroike e Korçës le të jetë kurdoherë shembull për gjithë rininë e vendit tonë, si në shkollë, ashtu edhe në punë, që kështu Shqipëria të rrojë e lumtur dhe e fortë.

Rroftë populli heroik i Korçës!

Rrofshin punëtorët e Korçës!

Rroftë populli ynë heroik!

Rroftë Republika jonë Popullore!

Rroftë Partia jonë Komuniste!

Rroftë Fronti Demokratik!

Rroftë rinia heroike!

Rroftë ushtria jonë e lavdishme, mbrojtësja e fitoreve të luftës dhe e lirisë, e indipendencës dhe e integritetit tokësor të vendit tonë!

Rroftë Bashkimi i madh Sovjetik dhe Stalini i madh!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 870,
14 tetor 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 870,
14 tetor 1947*

PËRMBLEDHJE NGA FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË VITHKUQIT

14 tetor 1947

Shokë dhe shoqe, fshatarë dhe fshatare të Vithkuqit
dhe të rretheve të tij,

Ju keni kaluar ditët më të këqia, por më të lavdish-
me. Në Vithkuqin tuaj u organizuan çetat dhe batalionet
e para, u organizuan repartet e mëdha të Ushtrisë sonë
Nacional-Çlirimtare, si Brigada I. Vithkuqi dhe fshatrat
rreth e rrotull kanë qenë qendrat më të rëndësishme
të Luftës nacional-çlirimtare. Ju vellezër, motra, mëma,
na keni pritur me gjithë zemër, pse e kuptuat se për
të fituar lirinë e pavarësinë duhej të luftonim me ash-
përsinë më të madhe. Ju edhe gjënë më të shtrenjtë,
jetën e djemve tuaj e dhatë për atdheun. Vithkuqi u
dogj, por ju nuk u përkulët, nuk u trembët. Ju siku-
ndër gjithë populli muarët parasysh të gjitha sakri-
ficat dhe është kjo arësyjeja që ne arritëm këto ditë
të gëzuara.

Sot që situam lirinë i jemi përveshur punës me
mish e me shpirt, ndërtojmë atdheun tonë, jetën tonë.

Shembullin më të mirë e kemi këtu në Vithkuq. Ju, me gjithë fukarallëkun, keni ngritur 120 shtëpi. Por ne do t'i ndërtojmë të gjitha ato që na ka shkatërruar armiku, pse kemi vendosur pushtetin e popullit.

Shoku Enver pasi përmendi se minierat dhe fabrikat kaluan në duart e popullit dhe punojnë vetëm për popullin, vazhdoi:

«Qeveria jonë me planin e saj që po preqatit do t'i japë rëndësinë e duhur çdo krahine, çdo fshati; ata do të zhvillojnë qoftë bujqësinë e industrinë, me një fjalë atë degë të ekonomisë që i përshtatet atij vendi më mirë».

Duke folur për synimet dhe veprimtarinë e armiqve, shoku Enver tha: «Ju i njihni më mirë se cilët kanë qenë armiqtë tanë, bejlerët, agallarët dhe qehajallarët e tyre. Por ka akoma mbeturina nga ata që u kanë rënë thonjtë dhe dhëmbët, por që përpinqen të kafshojnë me nofulla. Ata s'bëjnë gjë tjetër veçse të kritikojnë punën e popullit dhe ligjet e pushtetit, që janë bërë apostafat për të mirën e popullit. Ata përpinqen në këtë mënyrë që të dobësojnë besimin e popullit në forcat e veta dhe të pushtetit».

Shoku Enver, pasi foli mbi përpjekjet e reaksionit anglo-amerikan për rimëkëmbjen e fashizmit, vazhdoi: «Ne kemi miq të fortë, Bashkimin Sovjetik dhe Jugosllavinë e re».

Duke përfunduar shoku Enver tha: «Përpjekjet e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm kanë dështuar dhe do të dështojnë. Ju forconi pushtetin tuaj, forconi këshillat dhe pushtetin demokratik. T'i përvisheni punës me vrullin më të madh. Urdhëresat dhe ligjet e qeve-

risë dhe të Kuvendit Popullor t'i zbatoni me kujdesin më të madh, pse ato janë për të mirën e popullit, për të mirën tuaj».

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 872,
16 tetor 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 872.
16 tetor 1947*

PËRMBLEDHJE NGA FJALA E MBAJTUR NË NJË TAKIM ME PUNËTORËT E KORÇËS

14 tetor 1947

Shokë punëtorë të Korçës,

Sot kam ardhur këtu më shumë që të takohem me ju e t'ju shoh, se sa të mbaj një fjalim dhe t'ju përshëndes në emër të Komitetit Qendror të Partisë sonë.

Lëvizja më e fortë komuniste lindi dhe u zhvillua këtu në Korçë, pse këtu punëtoria ishte më e ndërgjegjishme dhe më luftarake. Punëtoria e Korçës i dha lëvizjes komuniste njerëz që, të udhëhequr nga një dashuri e madhe për popullin, për socializmin, për Bashkimin Sovjetik, punuan për krijimin e grupit komunist të Korçës dhe dhanë çdo gjë. Ishte grapi komunist i Korçës që hodhi parullat e para për organizimin e frontit populor. Ishte grapi komunist i Korçës, që me vijën e tij politike më të drejtë, hodhi bazat e Partisë sonë heroike. Prandaj, Partia jonë, që çlirroi atdheun, që çlirroi popullin, ka në gjirin e saj luftëtarë dhe organizatorë të shquar që kanë dalë nga gjiri i juaj, nga punëtorët e Korçës.

Por Partia nga ju pret njerëz të zot që të drejtojnë gjithë popullin, gjithë Shqipërinë. Klasa punëtore duhet

të forcohet më shumë, pse dhe Partia duhet të jetë më e fortë, pse punëtorët janë shtylla më e fortë e Partisë.

Prandaj ju duhet të jeni gjithnjë në ballë, organizatorët më të mirë, punëtorët më të mirë, të spastroni radhët tuaja nga njerëzit karrieristë, nga ata që kritikojnë kot, të luftoni oportunizmin, të zbatoni direktivat e Partisë dhe të jeni shembull për të gjithë.

Ju duhet të jeni mbrojtësit më të zjarrtë të ligjeve dhe të urdhëresave të qeverisë dhe këto t'jua bëni të qarta popullit.

Më poshtë shoku Enver foli për rolin udhëheqës të klasës punëtore.

«Punëtorët më trima duhet të drejtojnë postet më të rëndësishme të shtetit. Nga ju kanë dalë shokë që drejtojnë poste të rëndësishme të shtetit; ju keni dhënë prova për besnikërinë më të madhe. Nga ju pret populli dhe Partia, ju duhet ta bëni detyrën gjer në fund.

Duhet të edukoheni të zotëroni teknikën, të mos mbetet asnjë punëtor pa mësuar të shkruajë e të këndojet. Pa kulturë nuk mundet të përparojmë, prandaj, klasa punëtore duhet të armatoset me kulturë, me armen e kulturës marksiste, pse kështu ajo do të zgjidhë të gjitha problemet që i shtrohen përpara. Tregoni kujdesin më të madh që të përvetësoni zanatin tuaj.

Në sindikatat tuaja punëtorët duhet të edukohen në mënyrë që këto të bëhen një mbështetje e madhe e Partisë.

Ju e dini rëndësinë e sindikatave, të Frontit Demokratik. Ju duhet të jeni udhëheqësit, pse kështu armiku nuk do të mundet të na përcajë. Prandaj ne duhet të zhvillojmë një punë intensive që armiqtë e bre-

ndshëm të mos na dëmtojnë. Armiqtë do t'i gjejmë kudo. Ata përdorin metoda të ndryshme. Çështja është që ne t'i kuptojmë. S'ka oportunizëm me ta. Në radhët e punëtorëve ka drejtësi dhe këtë ju duhet ta vendosni kudo që punoni.

Në këto punë të mëdha të shtetit, klasa punëtore duhet të japë kontributin e saj të madh. Partia dhe qeveria kanë besim se ju do ta kryeni detyrën».

*Botuar përf herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 872,*

16 tetor 1947

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 872,*

16 tetor 1947

MOSKA DHE POPULLI SHQIPTAR

(*Shkruar me rastin e 800-vjetorit të Moskës*)

6 nëntor 1947

Që i vogël, në bankat e shkollës, fillova të të dua me gjithë shpirt, o Moskë e madhnueshme, o Moskë heroike! Kjo dashuri lindi në zemrën time të re, kur këndova për herë të parë luftën tënde të pavdekshme, patriotike kundër Napoleonit, kundër invadorit francez.

«Ditë të errëta. Imperatori kthehej ngadalë
Duke lënë pas të digjej Moskën në tym.

.....
Për herë të parë shqiponja ulte kryet»¹.

Vjersha e Viktor Hygo-së 'ekzaltonte fantazinë timë të re dhe muzika e Çajkovskit² me tingujt e saj të pavdekshëm ma bënин më të gjallë përpjekjen vigane të popullit heroik rus, që ndiqte këmba-këmbës dhe go-

¹ V. Hygo: Oeuvres Poétiques complètes, p. 313. Jean-Jacques Pauvert, Editeur, Paris 1961.

² Eshië fjala për muzikën e uverturës solemne «Viti 1812», të P.I. Çajkovskit.

diste pa mëshirë ata që kërkonin ta robëronin. Dhe në dallgët e muzikës së Çajkovskit Marsejeza, hymni i revolucionit, që kish udhëhequr «sans-culottes»¹ kundër armiqve të republikës, e copëtuar dhe e grisur në furtunën e luftës dhe të tërheqjes në Rusi, nuk shërbente më për ekzaltimin e shpirtrave, ajo binte si hymn i vdekjes për ata që e keqpërdornin për qëllimet e tyre imperialiste.

Popull heroik rus, ti luftove kundër invadorit dhe fitove, se çështja jote ishte e drejtë, ti e shpartallove «ushtrinë e madhe» të Bonapartit që kish skllavëruar Evropën. Moska nuk e uli flamurin, por e ngriti lart, plot me lavdi dhe atje mbaroijeta e Napoleonit, atje mbaroi vepra e tiranit. Edhe populli ynë i vogël kish luftuar me trimëri, si edhe populli i madh rus kundër invadorëve dhe tiranëve otomanë dhe shumë të tjerëve imperialistë; edhe populli ynë i vogël, shekuj me radhë, mbajti lart flamurin e tij dhe nëpër male, ku ai luftonte për liri, udhëhiqe prej heronjsh të popullit, udhëhiqe prej Gjergj Kastriotit — Skënderbeut, që, tok me malësorët e Shqipërisë, u bëri ballë hordhive të pamërtë të sulltanëve të Stambollit dhe i theu kurdoherë. Këto më bënë të ndjeja në zemrën time, se diçka e shëndoshë e lidhte popullin tonë të vogël me popullin heroik të Rusisë.

Por kur unë kisha filluar të njihja historinë e popujve të Rusisë, këta kishin shkruar faqet më të lavdish-

¹ «Sans-culottes» — emër shumë i përhapur me të cilin thirreshin masat popullore revolucionare të qytetit në kobën e revolucionit borgjez francez të fundit të shekullit 18.

me të historisë së tyre shekullore, kishin bërë revolucionin më të madh që kish parë bota. Këta kishin rrëzuar botën e vjetër të shtypjes dhe të skllavërimit, kishin rrëzuar tiranët e tyre, kishin rrëzuar përgjithmonë regjimin e shtypjes dhe të terrorist, regjimin e urryer kapitalist dhe kishin vendosur regjimin e popullit, regjimin e punëtorisë, diktaturën e proletariatit. Dhe Moska e shekujve, lavdia e popujve të Rusisë, ishte bërë selia e gjenive të revolucionit të madh, Leninit dhe Stalinit, ishte bërë qendra e udhëheqjes së lavdishme të Partisë heroike Bolshevikë të BRSS, ishte bërë kryeqyteti i Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike.

S'kishte mundësi pér ne, bijtë e një populli të vogël, të shtypur e në mjerimin më të madh, të mësonim ç'po ngjiste në të vërtetë në një të gjashtën e botës, ku ishte ngritur regjimi socialist. Populli shqiptar ishte i robëruar, i okupuar prej grekërve, italianëve, austriakëve e të tjerë. Jeta jonë, pavarësia jonë ishin në rrezik dhe, kur populli ynë me luftë i hodhi italianët në det, fryti i gjakut të tij që derdhi, ju rrëmbye nga duart prej feudalëve dhe bejlerëve, prej Ahmet Zogut, xhelat i popullit tonë dhe agjent i fuqive të huaja imperialiste. Në vendin tonë mbretëronte terrori, uria, injoranca dhe mjerimi i patregueshëm. Regjimi i Zogut përdorte çdo mjet pér të shtypur popullin, pér ta mbajtur në errësirë; ai shtypte çdo përpjekje tërparimtare dhe çdo tentativë lëvizjeje pér të hedhur poshtë robërinë e rëndë. Në vepren e tij tradhëtare Zogu dhe klika e feudalëve dhe e pseudodemokratëve kishte ndihmën e Italisë fashiste, e cila de faktto okuponte vendin tonë, shtrydhët popullin tonë, kishte hedhur në dorën e saj gjithë pa-

suritë e Shqipërisë, me një fjalë, kishte filluar kolonizimin e vendit tonë dhe shkombëtarizimin e popullit shqiptar.

Rreth Bashkimit Sovjetik po bëhej propaganda më e poshtër në stilin e ndyrë fashist. Një perde e rëndë shpifjesh dhe mashtrimesh ishte ngritur nga regjimi i Zogut dhe përkrahësit e tyre fashistë italianë në mes Bashkimit Sovjetik dhe popullit tonë. Çdo njeri përparimtar ndiqej dhe vritej si bolshevik. Por me gjithë këto persekutime e mjerime, vepra e madhe e Leninit dhe e Stalinit, drita që shkëlqente në Moskë dhe në gjithë Bashkimin Sovjetik, depërtonte natën, mbulonte vendin tonë, ngrohte zemrat dhe ekzaltonte shpirtrat e popullit shqiptar. Propaganda e Zogut dhe e fashistëve nuk ngjiste në shtresat punonjëse të vendit tonë. Ndjenjat e lirisë, shpirti përparimtar i popullit tonë, sidoqë ky ishte i prapambetur ekonomikisht dhe politikisht, qëndronin të pamposhtura dhe e lidhnin popullin tonë me popujt heroikë të Bashkimit Sovjetik. Populli ynë ndjente se diçka e madhnueshme kishte ngjarë atje larg në Moskë, në Rusi, ai ndjente se populli atje, me luftë dhe me përpjekje, kishte fituar lirinë dhe kishte marrë fuqinë në dorën e tij dhe bash për këtë arësyё xhelatët e popullit tonë, Zogu dhe këlyshët e tij, i bënin Bashkimit Sovjetik një luftë kaq të ashpër. Armiqtë e popullit tonë, ata që e shtypnin popullin dhe i pinin gjakun, ishin kundër Bashkimit Sovjetik, kundër Leninit dhe Stalinit, kundër Moskës. Instinktivisht dhe me gjithë zemër populli ynë ishte me Moskën, ishte me Leninin dhe me Stalinin dhe këtë ai do ta tregonte më vonë, me luftë, me gjak, me përpjekje në luftën e tij të madhe

patriotike kundër invadorëve fashistë dhe kuislingëve shqiptarë. As që mund të kuptohet ndryshe dashuria dhe entuziazmi i popullit tonë për Bashkimin Sovjetik. Reperkusionet e thella të Revolucionit të madh të Totorit, madhështia e tij, drejtësia e pavdekshme që vendosej në një të gjashtën e botës, zgjoi masat e gjera të popullit tonë, ashtu sikundër zgjoi të gjithë popujt e tjerë të botës, që lëngonin nën thundrën e imperialistëve dhe të shërbëtorëve të tyre. Fotografitë e Leninit dhe të Stalinit qarkullonin fshehurazi e dorë më dorë. Elementët përparimtarë këndonin fshehurazi, në dritën e kandilave Leninin dhe Stalinin. Ndërgjegjja e një populli të vogël por heroik po zgjohej, po shtohej besimi i tij në fitoren e ardhshme, që duhej ta prebatiste. Moska po ndriste si diell i shkëlqyeshëm mbi popujt, që i kishte pllakosur errësira e natës; si dielli, Moska po u jepte forcë e jetë njerëzve të shtypur për të ngritur krye dhe për të shkëputur zinxhirët e robërisë. Njerëzit përparimtarë të Shqipërisë, me në krye punëtorët, të ndjekur e të persekuuar nga spiunët dhe xendarët e regjimit të Zogut, nën kërcënimin e përhershëm të vdekjes, brenda në bodrume, hapnin dhe dëgjonin radio Moskën. Ky ishte momenti më patetik për ta. «Ja, ja, Moska, flet Moska, ja revolucioni, ja Stalini, Lenini», thërriste punëtori Koci Bako, çdo mbrëmje i mbledhur me shokët e tij për të dëgjuar radio Moskën në bodrumin e dyqanit të mjeruar të tij. Përjashta patrullat e xhandarmërisë përgjonin, por Koci Bako, as donte t'ja dinte. «Ja, po bie kambana e Kremlinit, është ora e revolucionit, atë e dëgjon Stalini, atë e dëgjojmë ne, e dëgjojnë gjithë punëtorët e botës», thoshte përsëri Koci Bako. «Ja, po

dëgjohet zhurma në Sheshin e Kuq, ku parakalon Ushtria e Kuqe e Revolucionit», dhe me grushtin përpjetë, Koci Bako dhe shokët e tij nderonin hymnin e lavdishëm të njerëzimit të ri, Internacionalen. Kaq kuptonte Koci Bako, ai s'merrte vesh asnjë gjuhë të huaj, por për të ishte mjaft. Ai kish kuptuar shumë gjëra dhe trupi i tij i kërrusur nga puna dhe nga vuajtjet ngrihej si vigan në errësirën e bodrumit, vigan si shpirti i tij prej punëtori, se emri i Leninit dhe i Stalinit, fjalët revolucion dhe Moskë e bënин atë të pathyeshëm për të vazhduar luftën me ashpërsi, për popullin e tij që lëngonte. Dhe Heroi i Popullit Koci Bako, luftoi dhe rasi trim, që në ditët e para të revolucionit tonë popillor, ra nën bombat e fashistëve italianë, në demostratën e Korçës¹. Ai ra për popullin tonë, për revolucionin me Leninin dhe Stalinin në zemër.

Kështu ringjallej ndërgjegjja e popullit tonë të vogël. Në shkollën e Revolucionit të madh të Totorit po edukoheshin revolucionarët e vendit tonë, që organizon rezistencën kundër regjimit të shtypjes së Ahmet Zogut e të feudalëve dhe pregatisnin luftën kundër fashizmit, që kërcënonte jetën e popullit tonë.

Revolucioni i madh i Totorit i mësoi luftëtarët e popullit tonë se i vetmi shpëtim i popullit, ishte spastimi rrënjosor i feudalizmit, zhdukja e tij dhe e mbeturinave të tij në mënyrë rrënjosore, pse ky pengonte zhvillimin, përparimin dhe mirëqenjen e vendit tonë.

¹ Kjo demostratë në të cilën u vra Heroi i Popullit Koci Bako u organizua nga grupet komuniste, ditën e themelimit të PKSH më 8 nëntor 1941.

Revolucioni i madh i Totorit i mësoi luftëtarët e popullit tonë se, masat e gjera të popullit të shtypur, në radhë të parë punëtorët e katundarët dhe me ta në ballë të luftës, duhej me luftë të pamëshirshme e të paepur, të rrëzonin monarkinë tiranike të Zogut dhe të klikës së tij, të merrnin fuqinë në duart e veta, toka të bëhej e katundarit që e punonte, të çlirohej gruaja nga sklavëria e rëndë. Revolucioni i madh i Totorit ua bëri të quartë luftëtarëve të popullit tonë se në saje të këtij revolucioni të madh, u vendos në një të gjashtën e botës rendi socialist, u vendos diktatura e proletariatit dhe u çel një epokë e re e historisë së botës, epoka e sundimit të një klase të re, deri atëherë e shtypur nga regjimi kapitalist, u çel epoka e sundimit të klasës që ngriti në këmbë një rend të tipit të ri të demokracisë, diktaturën e proletariatit. Revolucioni i madh i Totorit u tregoi popujve të botës se Bashkimi Sovjetik, pjella e revolucionit, u bë kështjella e pamposhtur e luftës për çlirimin e njerëzimit nga zgjedha e kapitalit dhe për zhdukjen e luftërave imperialiste.

Revolucioni i madh i Totorit u mësoi luftëtarëve të popullit shqiptar se revolucionë nuk mund të quheshin ato kryengritje bajraktarësh, ose «kryengritje opertash», siç i quan Stalini që «sjellin në timonin e shtetit një grup ekspluatonjësish në vend të një gru皮 ekspluatonjësish tjetër» dhe si konsekuençë «ndërrroheshin ekspluatonjësit, por ekspluatimi qëndronte». Stalini thotë për Revolucionin e Totorit: «Revolucioni i Totorit ndryshon parimisht nga këto revolucionë. Ai nuk ka për qëllim të zëvendësojë një formë shfrytëzimi me një formë tjetër shfrytëzimi, një grup shfrytëzuesish me

një grup tjetër shfrytëzuesish, por të zhdukë çdo shfrytëzim të njeriut prej njeriut, të zhdukë të gjitha grupet shfrytëzuese, të vendosë diktaturën e proletariatit, të vendosë pushtetin e klasës më revolucionare ndër të gjitha klasat e shtypura që kanë ekzistuar deri më sot, të organizojë shoqërinë e re socialiste pa klasa»¹. «Revolucion i Totorit lindi dhe u forcua nën flamurin e marksizmit, nën flamurin e idesë së diktaturës së proletariatit, nën flamurin e leninizmit që është marksizmi i epokës së imperializmit dhe të revolucioneve proletare»². Luftëtarët e popullit shqiptar panë se Revolucioni i madh i Totorit u udhëhoq me heroizmin më të madh dhe me zotësi të shquar nga Partia e çelnikëtë Bolshevikë e Lenin-Stalinit, e vëmja udhëheqje e sigurt dhe besnikë e kauzës së shenjtë të popullit punëtor.

Revolucioni i madh i Totorit i tregoi popullit shqiptar me fakte të gjalla se Bashkimi Sovjetik, pjella e Revolucionit të madh të Totorit, nga një vend i prapambetur, si nga pikëpamja ekonomike e kulturale, u bë vendi më i përparuar në botë, atje u ngritjeta e re, një jetë e gëzuar. Vendi i Sovjetëve po përparonte me hapa të mëdhenj në çdo fushë aktiviteti. Industrializimi i vendit u bë një realitet i madh, bujqësia dhe kolektivizimi përparonte me hapa të mëdhenj dhe të sigurtë; kultura dhe arësimi u bënë të masave të gjera të popullit; u forcuan sindikatat, kooperativat. U forcua dhe u modernizua Ushtria e famshme e Kuqe. Stalini thotë: «Sukseset e

¹ J.V. Stalin. Veprat, vëll. 10, f. 232-233.

² Po aty, f. 240.

pamohueshme të socializmit në BRSS në frontin e ndërtimit, treguan qartë se proletariati mund ta qeverisë me sukses vendin pa borgjezinë dhe kundër borgjezisë, se ai mund të ndërtojë me sukses industrinë pa borgjezinë dhe kundër borgjezisë, se ai mund të drejtojë me sukses ekonominë popullore pa borgjezinë dhe kundër borgjezisë, se ai mund të ndërtojë me sukses socializmin, me gjithë rrethimin kapitalist»¹.

Dhe populli shqiptar pa se popujt e Bashkimit Sovjetik, me në krye Partinë e lavdishme Bolshevikë të Lenin-Stalinit, i thyen me sukses biellogardistët, forcat e intervencionit dhe të gjithë armiqtë e brendshëm.

Bashkimi Sovjetik u bë shpresa e gjithë njerëzimit të shtypur, që vuante nën thundrën e hekurt të kapitalit dhe njëkohësisht ai u bë forca e pathyeshme që minoi themelët e imperializmit botëror. Stalini thotë:

«Duke tronditur imperializmin, Revolucioni i Tetorit krijoj njëkohësisht, me diktaturën e parë proletare, një bazë të fuqishme dhe të hapët të lëvizjes revolucionare botërore, të cilën ajo nuk e ka pasur kurrë më parë dhe në të cilën tani ajo mund të mbështetet. Ai krijoj një qendër të fuqishme dhe të hapët të lëvizjes revolucionare botërore, të cilën ajo nuk e ka pasur kurrë më parë dhe rreth së cilës tani ajo mund të grumbullohet, duke organizuar frontin unik revolucionar të proletarëve dhe të popujve të shtypur të të gjitha vendeve kundër imperializmit»².

Mësimet e mëdha të Revolucionit të madh të Teto-

¹ J.V. Stalin. Veprat, vëll. 10, f. 234.

² Po aty, f. 238.

rit, mësimet e të madhit Lenin dhe të Stalinit të madh i hapën sytë popullit tonë që lëngonte nën thundrën e feudalit Ahmet Zogu dhe klikës së tij gjakpirëse. Nën terrorin më të madh, populli ynë i shumëvuajtur dhe me shpirt në dhëmbë, por i papërkulur, filloi të organizojë rezistencën dhe revolucionin e tij popullor; grupet klan-destine të komunistëve shqiptarë filluan aktivitetin e tyre për formimin e frontit kundër fashizmit, që kërcë-nonte botën dhe që kërcënonët veçanërisht Shqipërinë me një zbarkim të afërt. Zbarkimi i forcave fashiste të Musolinit në vendin tonë u bë më 7 prill 1939. Shqipëria jonë e vogël u okupua, por më 7 prill fillooi rezistenca heroike, Lufta e lavdishme nacional-çirimitare e popullit tonë të vogël, kundër forcave robëruese mesjetare. E edukuar me mësimet e më-suesve të mëdhenj të proletariatit, Marks-Engels-Lenin-Stalin dhe e armatosur me mësimet e Revolucionit të madh të Totorit, Partia heroike Komuniste e Shqipërisë qëndronte në ballë të luftës sonë të çirimit; si flamurtare e pamposhtur e luftës çirimitare, ajo udhëhoqi popullin tonë heroik në luftën ngadhnjimtare e njëkohësisht më të egër që kishte parë bota.

Në malet tona të mbuluara me borë, ku frynte i tèrbuar murlani e bënte furtunë, partizanët shqiptarë luftonin kundër armiqve fashistë dhe tradhëtarëve të vendit. Pushka e tyre s'pushoi kurrë. Mjerimi i popullit tonë dhe ideali i lirisë që i frymëzonë, i bënte djemtë dhe vajzat e popullit tonë të pathyeshëm, i bënte të hekurt për të mposhtur armikun me çdo kusht, i bënte të harronin urinë, borën, furtunën, të mos kishin frikë nga vdekja. Dhe në ndjekje të përhershme të armikut,

në gërxhe e në shpella, në fusha e në qytete, ata këndonin këngën e partizanëve sovjetikë:

Nëpër fusha, nëpër male,
 Nëpër borë e në tufan,
 Nën kushtrimin e Leninit
 Dalin shokët partizan.

Po, i ndritur Lenin, mësues i madh i proletariatit dhe i gjithë njerëzve të shtypur, themelues gjenial i shtetit të parë socialist, gjenia e revolucionit, Ti frymëzoje punëtorët, katundarët, malësorët, patriotët e vendit tonë të vogël, të luftonin për lirinë e popullit të tyre, për të fituar të drejtat e veta dhe për t'i ruajtur këto të drejta që të mos ua grabisnin më kapitalistët, imperialistët, feudalët dhe hyzmeqarët e tyre. «Lenini ishte babai i punëtorëve e i katundarëve të shtypur, ai i udhëhoqi nëpërmjet revolucionit dhe punëtorët e katundarët dualën triumfues. Ne jemi me Leninin, ne jemi me Stalinin, ne jemi me Moskën dhe prandaj ne jemi të sigurt në fitoren, ne do ta çlrojmë atdheun tonë dhe do ta marrim fuginë në duart tonë. Ky ishte besimi i gjithë popullit tonë që luftonte në qytete e në male kundër armikut më të egër që kishte parë njerëzimi. Luftë bëhej kudo, luftë bëhej edhe në malet e Shqipërisë, por fatet e botës dhe të njerëzimit luheshin atje, në Moskë. Zemrat e popullit tonë rrighthnin për ty, o Moskë heroike, pse fatet e popullit tonë ishin të lidhura me fatin tënd, pse fatet e mbarë njerëzimit ishin lidhur me fatin tënd! Moskë, armiku kërkonte të të mposhtëtë, se vetëm kështu ai do të mposhtëtë gjithë popujt e tjerë! Po ti, Moskë e Leninit

dhe e Stalinit, Moskë e revolucionit, ti ishe e thirrur të shpëtoje njerëzimin nga katastrofa dhe ti e shpëtovë. Brez pas brezi, njerëzit do të këndojnë lavdinë tënde. Me shkronja të arta do të shkruhet historia e luftës që u bë në portat e tua, ku Ushtria heroike e Kuqe, nën udhëheqjen e Stalinit, u tha ndal fashistëve gjermanë dhe i theu tmerrësisht. Të paharruara në shekuj do të mbeten trimëritë e pashoqe të njerëzve sovjetikë, të ardhur nga të gjitha anët e Republikave Socialiste Sovjetike, të inkadruar si një trup i vetëm në radhët e Ushtrisë Sovjetike, ku rrihte vetëm një zemër, për të mbrojtur kryeqytetin e tyre të dashur, vendin e shenjtë që u dha jetë e u dha dritë, qytetin ku prehej i madhi Lenin në mauzolenë e tij, në Sheshin e Kuq afër Kremlinit. Dhe kur lufta ziente në portat e Moskës dhe në të gjithë Bashkimin Sovjetik, kur ju, qytetarë heroikë të Moskës dhe të gjithë Bashkimit Sovjetik, luftonit me heroizmin dhe vetëmohimin më të madh për të shpëtuar atdheun tuaj dhe gjithë popujt e tjerë nga robëria më e rëndë, kur ju nga radioja e Moskës, nga Kremlini, dëgjonit zërin e dashur dhe të qetë të kryetarit tuaj, Stalin, që ju udhëzonte e ju drejtonte, që ju mësonte si ta luftonit ashpërsisht armikun dhe si të fitonit mbi të, në një vend të vogël të Ballkanit, në një vend të vogël të mbuluar me male, populli shqiptar me mish e me shpirt ishte me ju. Ai ishte i sigurt se fitorja do të vinte pas shumë sakrificash, pas një lufte të ashpër dhe të përgjakshme me fashistët. Dhe populli ynë e zgjodhi këtë rrugë me vendosmërinë më të madhe, zgjodhi rrugën e të parëve të tij. Vuajtjet tuaja ishin vuajtjet e popullit tonë. «Jo, Moska kurrë nuk do të bjerë në duart e gjermanëve

barbarë, pse atë e mbron populli sovjetik, pse atë e mbron partia, pse atë e mbron Stalini, pse atje është trupi i shenjtë i Leninit». Ky ishte besimi i patundur i popullit shqiptar, i partizanëve shqiptarë. «Të ashpërsojmë luftën kundër gjermanëve, t'i godasim për vdekje, të vrashim sa më shumë qena fashistë, thoshnin partizanët shqiptarë, pse kështu edhe ne, një popull i vogël, do të ndihmojmë heronjtë e Moskës, të Leningradit, të Stalingradit dhe të Ushtrisë së Kuqe ngadhnjimtare, pse kështu ne do të çlrojmö vendin tonë, do të fitojmë lirinë dhe do t'u tregojmë mirënjojhen tonë popujve vëllezër dhe heroikë të Bashkimit Sovjetik».

Dhe heronjtë e popullit tonë, njëri pas tjetrit, në luftëra të furishme binin në fushën e nderit solidarë deri në vdekje me heronjtë e popullit sovjetik, kundër të njëjtit armik, që kërkonte të na skllavëronte. Heronjtë e popujve sovjetikë binin në fushën e nderit për atdheun e tyre dhe për kauzën e madhe të njerëzimit. Dhe heronjtë e popullit tonë, që luftonin dhe vriteshin përlirinë e popullit tonë, binin duke kënduar lavdinë e Stalinit. Stalini për ta ishte Bashkimi Sovjetik, ishte Moska. Në sulm, me emrin e BS e me shkrimet e Stalinit në gji, binte në luftë katundari nga malet e Kurveleshit. Mendimet më të mira dhe zemra e heroit Vojo Kushi ishin për Stalinin, kur ai, pas një qëndrese heroike prej gjashtë orësh, i rrethuar në një shtëpi, sulmoi me gjoks përpara dhe me bomba dore tanksat e armikut. Me emrin e Bashkimit Sovjetik në gojë digjeshin flakë në shtëpinë e tyre të rrethuar në Shkodër e të kthyer në një kështjellë të vërtetë, Perlat Rexhepi nga Vlora dhe shokët e tij. Ata luftuan deri në fund, ata nuk u dorë-

zuan, ata u dogjën tok me shtëpinë. Kështu dhe vetëm kështu çlirohet atdheu dhe populli. Ky ishte mësimi që u jepte Partia Bolshevikë njerëzve sovjetikë, por ky ishte dhe një mësim për njerëzit e popullit tonë dhe për gjithë luftëtarët antifashistë të të gjithë botës, ky ishte i vetmi shpëtim. Populli shqiptar, luftëtarët partizanë të Shqipërisë ecën me mësimet e Stalinit të madh, ndoqën shembullin e popujve heroikë sovjetikë, ishin të pamëshirshëm kundër okupatorëve e kundër kuislingëve dhe prandaj fituan, prandaj atdheu ynë u çlirua, prandaj populli ynë mori fuqinë në dorë dhe vendosi ligjin e tij, vendosi demokracinë dhe drejtësinë. Kjo ngjet për herë të parë në historinë shekullore të popullit tonë. Populli ynë me gjithëse shekuj e shekuj ka luftuar për këtë liri, ai kurrrë s'kishte mundur ta fitonte. Dhe sot ai e fitoi, fitoi liri të plotë, demokraci të vërtetë, në saje të udhëheqjes së PKSH, në saje të mësimeve të mëdha të Revolucionit të madh socialist të Totorit, në saje të Bashkimit të lavdishëm Sovjetik, kështjella e paqes dhe e demokracisë, në saje të luftës heroike të popujve të Bashkimit Sovjetik dhe të ushtrisë së tyre të lavdishme, në saje të mësimeve dhe të luftës së Leninit dhe të Stalinit, të cilët çuan popujt sovjetikë në fitore, që u dha njëkohësisht popujve që lëngonin dhe luftonin kundër fashizmit lirinë, pavarësinë. Të gjitha këto populli i vogël shqiptar, i shumëvaujtur, i kishte të qarta që në fillim të luftës, dhe ja pse heronjtë e popullit tonë e donin, e adhuronin dhe binin në luftë me emrin e Stalinit në gojë. Ja pse populli ynë i ndoqi deri në fund bijtë e tij më të shtrenjtë dhe luftoi deri në fund, derisa u shpartalluan bishat gjermane dhe tradhëtarët shqip-

tarë. Moska për të gjithë popujt përparimtarë, që luftonin fashizmin ka qenë fari i madh që ndriste rrugën e tyre të çlirimit, ka qenë njëkohësisht shembull i madh i heroizmit dhe i sakrificës. Moska ndriçonte mendjen e njerëzve përparimtarë, forconte zemrat e luftëtarëve antifashistë, i bënte këta të aftë dhe të zotët të mobilizonin masat e gjera të popujve të tyre në luftë kundër fashizmit, bënte të kuptonin mirë manevrat e fashizmit dhe të reaksionit, t'i demaskonin këto dhe t'i luftonin pa mëshirë, i bënte këta heronj për të mbrojtur kauzën e drejtë të popujve të tyre. Në shembullin e Bashkimit Sovjetik dhe të Moskës, që ishin shtyllat e çelnikta të blokut të madh antifashist, popujt luftëtarë antifashistë, me luftën e tyre, e forconin sa më shumë këtë front dhe solidaritetin ndërkombëtar të popujve të vëllazëruar në këtë luftë të madhe, nga ku varejjeta e tyre, e ardhmja e tyre. Bashkimi Sovjetik mbajti në supet e veta peshën më të rëndë të luftës kundër fashizmit gjerman dhe satelitëve të tij; ai pësoi shkatërrimet më të tmerrshme dhe me miliona njerëz të tij nga më të mirët e derdhën gjakun e tyre të vlefshëm në luftërat më të përgjakshme që ka parë bota, e derdhën gjakun e tyre për kauzën më të shenjtë të njerëzimit përparimtar. Bashkimi Sovjetik me luftën e tij jo vetëm që fitoi adhurimin e popujve përparimtarë të gjithë botës, por bota e përparuar shihte te Bashkimi Sovjetik, te udhëheqësi i tij dhe te Moska, forcën e madhe, kalanë e pathyeshme për mbrojtjen e fitores së madhe, për mbrojtjen dhe konsolidimin e pages dhe të demokracisë së vërtetë. Lufta e lavdishme e popujve sovjetikë, politika e drejtë dhe konsekuente e qeverisë sovjetike,

ishte siguria e botës përparimtare në rindërtimin e shkatërrimeve që kishte pësuar nga lufta. Ashtu sikundër popujt e botës kishin sigurinë më të madhe në fitoret e luftës kundër fashizmit, pse në krye të luftës çlirimitare qëndronte Bashkimi Sovjetik, ashtu dhe pas fitores popujt e çliruar të Evropës dhe të botës, me heroizëm dhe me një kurajo të pashembullt, ju përveshën punës për rindërtimin e vendeve të tyre, përkonsolidimin e fitoreve të tyre, përforcimin e demokracisë dhe të drejtësisë që i kushtoi aq gjak, ju përveshën punës së tyre ndërtimitare, pse ata ishin të sigurt se në punën e tyre ata kishin mbrojtjen e madhe të Bashkimit Sovjetik, i cili më i fortë se kurrë mbronte jetën dhe të ardhmen e tyre nga fashizmi dhe reaksiioni ndërkombëtar, që përpilen të rikthejnë kohën e vjetër dhe të pregatisin një kasaphanë të tretë. Për çlirimin e vendeve të tyre, popujt e shtypur u bashkuan si mishi me thoin me Bashkimin Sovjetik dhe tok fituan mbi fashizmin. Këta popuj, tanë të çliruar, janë përsëri të bashkuar me të gjitha forcat e tyre me Bashkimin e madh Sovjetik për të ruajtur paqen e drejtë, sigurimin dhe fitoret e tyre.

Këtu qëndron e vërteta dhe burimi i pashteruar i kësaj dashurie të madhe që populli ynë i vogël ushqen për Bashkimin Sovjetik, për Stalinin, për Moskën. Ne jemi qytetarë të lirë, bijtë e një populli të lirë dhe s'kemi frikë të themi atë që ndjejnë zemrat tona dhe që janë ndjenjat e gjithë popullit tonë, përsa i përket Bashkimit Sovjetik. Bashkimi Sovjetik është një gjë e madhe për ne. Ai është i lidhur ngushtë me jetën e popullit tonë, me luftën e madhe të tij të çlirimit, me heronjtë e luftës sonë të

çlirimini, me të ardhmen e vendit tonë dhe me sigurimin e indipendencës dhe të sovranitetit të popullit tonë. Ndjenja të tilla të kulluara ndaj një vendi kaq të madh dhe kaq trim, i jepin jetë dhe gjallëri popullit tonë në rrugën e tij të drejtë dhe në ndërtimin e jetës së tij të lumtur.

Në një shtëpi të varfër të një qyteti të Shqipërisë, rastësisht kur shkova, pashë në mur katër fotografi, fotografinë e një burri, e një djali të ri, të një çupe të re dhe mbi ta, fotografinë e Stalinit. Plaka e shtëpisë, një grua e fortë shqiptare, me mburrje më tha: «Ky është burri im, këta janë djali dhe çupa ime, që të tre partizanë. Këta ranë në fushën e nderit për çlirimin e Shqipërisë. Fotografinë tjetër, ti e njeh, ai është Stalini. Kur unë i nisa fëmijët e mi për në luftë, ata më dhanë këtë fotografi dhe më porositën ta ruaja si sytë e ballit dhe, në rast se më kontrollonin, më mirë të preferoja vdekjen, se t'ua dorëzoja qenve fashistë. E shikoja këtë fotografi, por nuk e njihja këtë njeri. Mandata e burrit dhe e fëmijëve më erdhën njëra pas tjetrës, dhe çdo herë unë forcoja zemrën time duke shikuar fotografinë, amanetin e shtrenjtë të fëmijëve të mi. Tash unë e di se kush është në këtë fotografi, unë e di se kush është Stalini dhe ç'është për popullin tonë Stalini. Të rrojë sa malet Stalini! Fotografinë e tij nuk do ta ndaj kurrë nga fotografat e fëmijëve të mi, ashtu sikundër do t'i ruaj në zemrën time derisa të vdes».

Në një letër që më shkruan një katundare nga malet e Kurveleshit më thotë: «Kur më shkuan djemtë në luftë, u thashë: merrni pushkët dhe gjerdanët dhe, ja vdekje ja liri. Në kasolle ndryshe të mos kthehi. Dhe

ata s'u kthyen më në kasolle, ata i korri lufta. Por në kasollet tona erdhi liria, në saje të gjakut të bijve tanë, në saje të ndihmës së madhe që na dha Bashkimi Sovjetik dhe Stalini».

Bashkimi Sovjetik në periudhën imediate të pasluftës u bë për Shqipërinë e vogël, sikundër edhe për të gjithë popujt e tjerë, mbrojtës i shkëlqyer i kauzës së tyre të drejtë. Pas krizës së madhe, gjatë së cilës njerëzimi përparimtar duroi shnderimet dhe masakrat më të egra, vepra të banditëve hitlerianë dhe satelitëve të tyre, popujt e lirë të botës, me në krye Bashkimin Sovjetik, jo vetëm aspironin për një paqe të drejtë dhe për dënimin shembullor të agresorëve, por kishin vënë të gjitha forcat dhe vigilencën e tyre të justifikueshme që të arrihej paqja e vërtetë, e drejtë, e vazhdueshme, e cila t'u jepte fund përgjithmonë agresioneve të përsëritura të imperialistëve gjermanë e ndihmësve të tyre të çdo kallëpi dhe të fshehur nën maska të ndryshme. Në fushat e gjera të Rusicë dhe në portat e lavdishme të qytetit të Moskës mbaroi vepra gjakatare e Hitlerit dhe përsëri në këtë kështjellë të lavdishme të paqes, siç është Moska, sytë dhe shpresat e gjithë njerëzimit përqëndrohen për arritjen e një paqeje të tillë, që të shprehë dëshirat dhe aspiratat e popujve paqesorë dhe të lirë. Të gjitha forcat e popullit të vogël paqedashës shqiptar janë të mobilizuara për ta mbështetur veprën e pavdekshme të Moskës.

Në periudhën e pasluftës forcat e errëta të fasizmit dhe të imperializmit ndërkombëtar, me të gjitha mjetet e tyre, përpigen të errësojnë fitoren e madhe dhe të rikthejnë botën në errësirën e mëparshme. Ata

përpiqen që të luftojnë veprën e madhe të paqes dhe të demokracisë përparimtare, sepse ata shohin në të rrezikun që i kërcënon për vdekje. Kapitali i egër kërkon të rivendosë thundrën e tij të hekurt mbi popujt që derdhën gjak dhe fituan me kaq vuajtje lirinë dhe të drejtat e tyre. Të gjithë ata popuj që luftuan me heroizëm fashizmin dhe panë me sytë e tyre tmerret e mëdha të luftës së shkaktuar nga Gjermania hitleriane, janë me mish e me shpirt me Moskën, pse kjo është për një paqe të vërtetë, pse kjo lufton me këmbëngulje për zhdukjen e agresioneve dhe shfarosjen e agresorëve, se kjo kërkon me këmbëngulje çarmatin, zhdukjen e bombës atomike, dënimin e agresorëve, pse kjo lufton me të gjitha forcat e saj që Organizata e Kombeve të Bashkuara të bëhet një organizatë ndërkombëtare që të mbrojë me të vërtetë interesat e popujve dhe të paqes dhe jo të bëhet vegla e errët e imperialistëve zjarr-ndezës. Lufsta që bën Moska për mbrojtjen e paqes dhe për principet e drejta të njerëzimit përparimtar shpreh ndjenjat dhe aspiratat e popullit të vogël shqiptar, i cili pëershëndet qeverinë sovjetike, popujt e Bashkimit Sovjetik, Stalinin e madh, me një fjalë Moskën, për shërbimin e madh që u bëjnë popujve të botës dhe çështjes së drejtë të lirisë dhe të demokracisë.

Populli shqiptar sheh te Moska mikën më të shtrenjtë që mbron në çdo rast të drejtat e vendit tonë të vogël, që shtetet imperialiste kërkojnë t'ja rrëmbejnë ose t'ja shkelin. Në konferencat e ndryshme ndërkombëtare, qoftë në Nju Jork, qoftë në Paris, qoftë në Moskë, ku çështja shqiptare luftohet paturpësisht dhe pa asnjë bazë nga këto shtete imperialiste, zëri i fuqishëm i

Bashkimit Sovjetik mbron me sukses pavarësinë dhe sovranitetin e vendit tonë. Ai nuk lejoi që një popull i vogël, si yni, të merret nëpër këmbë dhe sidomos, kur një popull i vogël, siç është populli ynë, ka hedhur të gjitha ç'kishte në balancën e luftës kundër fashizmit dhe që sot bashkon të gjitha përpjekjet e tij me të atyre që kërkojnë konsolidimin e paqes kaq të dëshiruar dhe të paguar kaq shtrenjtë.

Disave u pëlqen të thonë se historia përsëritet me të gjitha të këqiat e saj, por populli shqiptar luftoi me heroizëm që të këqiat e tij të shkuara, të mos përsëriten më. Dhe ka njerëz, që vënë të gjitha forcat e tyre që t'i përsërisin padrejtësitë dhe tmerret e së shkuarës, por ka edhe të tjerë, dhe këta janë shumica, se ata përbëjnë popujt progresistë, të ndershëm dhe të drejtë, që janë të vendosur deri në fund për t'i ndaluar këto padrejtësi dhe të ndërtojnë një jetë të re dhe plot me dinjitet e me nder për njerëzimin. Populli shqiptar është një prej këtyre popujve. Historia e hidhur e së shkuarës së tij është një pasqyrë e qartë e këtyre padrejtësive dhe intrigave që bëheshin në kurrizin e popullit tonë, i cili ka luftuar gjithmonë për drejtësinë e vërtetë, për lirinë dhe pavarësinë. Shqipëria ka qenë kurdoherë lodër e fuqive imperialiste dhe fashiste. Vendi dhe populli ynë kanë qenë në mëshirën e diplomatëve pa skrupull. Fati i vendit tonë ishte në dorën e më të fuqishmit dhe përdorej prej tij si monedhë shkëmbimi. Kjo tragedji e popullit tonë vazhdoi deri në fitoren mbi Gjermaninë naziste. Shqipëria, pas kaq mjerimesh dhe sakrificash, pas kaq luftërash të përgjakshme që ka bërë, s'ka vallë të drejtë të rrojë në paqe dhe të gjëzojë frytet e fitores,

s'ka vallë të drejtë të rindërtojë mbi gërmadhat e së kaluarës së keqe, jetën e re ashtu si i pëlqen asaj, apo vallë Shqipëria nuk është në rrugën e drejtë të paqes, kur ajo reziston energjikisht kundër atyre që duan t'i përsërisin padrejtësitë e së kaluarës dhe ta bëjnë vendin tonë përsëri një vatër intrigash dhe një monedhë shkëmbimi për të kërcënuar kësisoj paqen, për ngritjen e së cilës janë nderur gjithë energjitet e popujve përparimtarë? Populli shqiptar i ka fituar të gjitha të drejtat dhe ai lufton për një paqe të drejtë. Për një paqe të tillë dhe për një jetë të lumtur populli i vogël shqiptar ka luftuar tërë jetën, ka luftuar kundër shkelësve në të kaluarën, ka luftuar heroikisht kundër italianëve dhe gjermanëve në të tanishmen dhe prandaj i ka fituar të gjitha të drejtat, prandaj Bashkimi i madh Sovjetik e mbron popullin shqiptar me të gjitha forcat e tij.

Forcat imperialiste skllavëruese të botës, të udhëhequra dhe të frysmezuara nga reaksiuni amerikan, kanë shpërthyer një luftë të ashpër kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokrative të reja në Evropë dhe në botë, për të mbytur demokracinë dhe për të vendosur hegemoninë e imperializmit amerikan. Reaksiuni amerikan me qëllim që të skllavërojë popujt dhe të pregetitë një luftë të tretë botërore, ka grumbulluar të gjitha forcat e reaksionit anglez, francez, italian, grek, turk, të gjithë fashistët gjermanë dhe të vendeve të tjera, dhe tok me ta ka shpërthyer luftën në drejtime të ndryshme dhe në vende të ndryshme. Taktika e reaksionit ndërkombëtar e ka bërë të sajën taktilën hitleriane si: kërcënimet, masat ushtarake e strategjike, shantazhet e robërimet ekonomike dhe një propagandë të shfrenuar ideologjike

me qëllime të caktuara, nën maskën antikomuniste, kundër Bashkimit Sovjetik, demokracive të reja dhe të gjithë popujve përparimtarë në Evropë e në botë dhe për nxitjen për një luftë të tretë. Imperializmi amerikan u ka hedhur thonjtë në grykë shumë shteteve dhe, me ndihmën e qeverive reaksionare, kërkon të sundojë në shumë vende, të sklavërojë popujt e këtyre vendeve dhe të shtypë pa mëshirë e me gjak çdo liri demokratike. Një gjë e tillë ngjet në Angli, në Francë, në Belgjikë, në Itali, në Greqi, në Turqi, në Kinë e gjetkë. Thonjtë e tyre me gjak, imperializmi amerikan dhe shërbëtorët e tij, kërkojnë t'i futin edhe në ato vende, ku është vendosur regjimi demokratik i popullit. Për t'ja arritur këtij qëllimi, imperializmi anglo-amerikan përdor çdo mjet. Tentativat më të poshtra e më kërcënuese janë bërë nga imperializmi anglo-amerikan kundër popullit tonë, si në periudhën e luftës dhe në atë të pasluftës së dytë botërore. Për të goditur demokracitë e reja, që janë ngritur me kaq gjak dhe sakrifica nga ana e popujve respektivë të Ballkanit, imperialistët anglo-amerikanë kanë zhvilluar dhe zhvillojnë një aktivitet në ethe për t'i minuar këto demokraci të reja ballkanike dhe për ta bërë Ballkanin një fuçi baruti si qëmoti. Ata e kanë bërë Greqinë një shesh lufte dhe operacionesh nga ku ata përpilen të zhvillojnë aktivitetin e tyre djallëzor. Natyrisht, përpjekjet e tyre janë drejtuar me ashpërsinë më të madhe dhe kundër vendit tonë të vogël. Gjatë periudhës së luftës kundër fashizmit, anglo-amerikanët janë përpjekur të shuanin Luftën nacional-çlirimtare në vendin tonë duke nxitur kukslingët të organizoheshin dhe, nën mbrojtjen e gjermanëve, të luftotonin forcat

popullore. Ata i kanë ndihmuar organizatat kuislinge me armë e municion dhe njëkohësisht u kanë dhënë mbështetjen e tyre morale. Ata janë përpjekur të zbarkonin në vendin tonë të çliruar, nga vetë forcat popullore, trupa okupimi angleze me qëllim që Shqipëria të bëhej një bisht i Greqisë monarko-fashiste. Por kur panë se të gjitha këto tentativa të turpshme, të bëra nën maskën e aleatit, dështuan, anglo-amerikanët që prej çlirimt të Shqipërisë ja filluan aktivitetit të tyre, për të rrëzuar pushtetin popullor në Shqipëri. Ata organizuan reaksionin, banditët fashistë nga ishin e nga s'ishin, ata organizuan sabotazhe dhe atentate, ata bënë kundër demokracisë sonë të re një fushatë të turpshme në lëmin ndërkombëtar, për të fuqizuar përpjekjet që bënин agjentët e tyre brenda në Shqipëri dhe për t'i dalë kësisoj mbanë qëllimit të tyre skllavërues. Anglo-amerikanët i mohuan popullit tonë demokrat të gjitha të drejtat, që fitoi me luftën e tij heroike, ata krijuan incidente të turpshme për ta bërë fajtor popullin tonë në lëmin ndërkombëtar, ata mbështetën rivendikimet e fashistëve grekë mbi tokat shqiptare, ata organizuan me anën e fashistëve grekë, provokime të përditshme në kufirin tonë të Jugut; më në fund, ata e akuzuan popullin tonë të vogël sikur ai organizonte luftën e demokratëve grekë kundër monarko-fashistëve. Anglo-amerikanët po organizojnë hapët dhe në mënyrën më skandaloze fashistët shqiptarë në Itali për t'i pasur si një armë kundër demokracisë së vendit tonë. Në këtë vepër neofashizmi italian dhe qarget reaksionare qeveritare në Itali po ndihmojnë fuqimisht. Pasardhësit e Musolini, me gjithë disfatat dhe grushtet e rënda që

kanë ngrënë nga populli ynë, i kanë kurdoherë sytë përtej Adriatikut. Por ujku nuk ndërron, veç qimen. Fashistët italianë kanë gjetur padronë të rinj te anglo-amerikanët, dhe aleatë të tjerë te grekët dhe te turqit pér të rifilluar, në mundshin, veprën e lënë përgjysmë nga Musolini. Por përpara të gjitha këtyre manevrave, shantazheve, frikësimeve, provokacioneve, organizimeve klandestine, populli ynë i vogël qëndroi e qëndron i patundur, i patrembur dhe i pamposhtur. Kjo u tregoi qartë anglo-amerikanëve dhe shërbëtorëve të tyre grekë e italianë dhe reaksionarëve shqiptarë të brendshëm, se populli shqiptar, që lustoi me aq vendosmëri pér të çliruar vendin nga okupatorët fashistë dhe vendosi në vendin e tij të lirë e sovran një demokraci të shëndoshë, është i vendosur qind pér qind që t'i mbrojë deri në vdekje këto fitore të mëdha. Pér mbrojtjen e lirisë, të pavarësisë, të sovranitetit, të integritetit tokësor dhe të pushtetit popullor të tij, populli i vogël shqiptar nuk ka frikë nga vdekja. Në përpjekjet e tij, pér të mbrojtur këto të drejta të shenjta të tij, populli ynë ka pasur përkrahjen pa rezervë të Bashkimit Sovjetik, të Stalinit të madh, të shokut të tij, Mollotovit, të Vishinskit, të Manuilskit dhe të shumë njerëzve të tjerë sovjetikë. Populli ynë nuk do ta harrojë këtë ndihmë.

Dhe populli ynë i vogël, që nga Majat e Hekurave¹ dhe deri në Konispol u këndon këngë lavdie Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit të madh.

Sot populli ynë i lirë, në saje të luftës së tij, në saje të mësimeve të Revolucionit të madh të Tetorit, në saje

¹ Male në Alpet Veriore të Shqipërisë.

të mësimeve të Leninit të madh e të Stalinit, në saje të ndihmës së Bashkimit të fuqishëm Sovjetik, po ndërton atdheun e tij, jetën e tij më të mirë, pse popujt e Bashkimit Sovjetik janë mbrojtësit e çclniktë të të drejtave tona, të drejtësisë, të paqes dhe të demokracisë në botë.

Në prakun e 30-vjetorit të Revolucionit të madh të Totorit kurorat më të bucura me trendelinë e maleve tona të lira janë për Leninin e madh, zemrat e të gjithë njerëzve të Shqipërisë buçasin për atdheun e lavdishëm të socializmit dhe rrahin së toku me ato të popujve sovjetikë, për Ju, shoku Stalin, që të na rroni sa malet.

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 890,
6 nëntor 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 890,
6 nëntor 1947*

**TELEGRAM DËRGUAR J. V. STALINIT ME RASTIN
E 30-VJETORIT TË REVOLUCIONIT SOCIALIST
TË TETORIT**

7 Nëntor 1947

**GJENERALISIMIT STALIN, KRYETAR I KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË BRSS**

Moskë

Me rastin e 30-vjetorit të Revolucionit të madh socialist të Tetorit, në emër të popullit shqiptar, të Qeverisë së Republikës Popullore dhe në emrin tim personal, kam nderin t'Ju transmetoj, urimet tona më të nxehta, Juve udhëheqës i Bashkimit të madh Sovjetik.

Në këtë ditë të rëndësishme për të gjithë njerëzimin përparimdashës populli ynë me entuziazmin dhe dashurinë më të madhe përshëndet 30-vjetorin e Revolucionit socialist të Tetorit, i cili shënon për të gjithë botën përparimtare, fitoren e madhe të njerëzimit kundër errësirës e regjimit të shfrytëzimit të kapitalizmit dhe

triumfin e ideve të përparimit, të drejtësisë dhe të demokracisë.

Populli ynë, që në saje të Revolucionit të madh të Tectorit, të luftës vigane të Bashkimit Sovjetik fitoi lirinë e pavarësinë e tij, feston me gjithë zemër përvjetorin e Revolucionit socialist të Tectorit, që lindi shtetin e madh dhe të fuqishëm sovjetik. Bashkimi Sovjetik, ashtu si gjatë luftës kundër fashizmit u bë kampion i kësaj lufte dhe shpëtimtari i gjithë popujve nga barbarët fashistë, ashtu edhe sot është bërë mbrojtësi më i fortë e i papërkultur i një paqeje të drejtë e demokratike dhe udhëheqësi kryesor i të gjitha forcave përparimtare kundër agresionit imperialist.

Duke përhëndetur veprën e shkëlqyer të Leninit të madh, të Partisë Bolshevik, Tuajën dhe të të gjithë popujve sovjetikë, populli ynë shpreh dashurinë e tij të pafund dhe mirënjohjen e tij të thellë ndaj Jush dhe popujve sovjetikë, për miqësinë e madhe dhe për ndihmën e vazhdueshme që Ju dhe Bashkimi Sovjetik i jepni për ndërtimin e jetës së tij të re dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirisë së tij. Populli ynë që ka vuajtur tërë jetën, do ta ruajë si sytë e ballit këtë miqësi të shtrenjtë dhe do të jetë kurdoherë në ballë të luftës për të mbrojtur fitoret, që i kanë kushtuar kaq gjak, për të mbrojtur paqen dhe demokracinë kundër sulmeve të poshtra të imperialistëve.

Për këtë, populli ynë, i madh dhe i vogël brohorit me gjithë zemër për 30-vjetorin e Revolucionit të madh socialist të Tectorit, për popujt heroikë sovjetikë, për Bashkimin e madh dhe të lavdishëm Sovjetik dhe për udhëheqësin e tyre, Stalinin e madh.

Rroftë Bashkimi i madh Sovjetik, atdheu i lavdi-shëm i socializmit dhe mbrojtësi i pathyeshëm i paqes dhe i demokracisë në botë.

Kryetari i Këshillit të Ministrave të Republikës
Popullore të Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr.891,
7 nëntor 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 891,
7 nëntor 1947*

MESAZH DREJTUAR POPULLIT ME RASTIN E PËRVJETORIT TË TRETË TË ÇLIRIMIT TË ATDHEUT

29 Nëntor 1947

Popull shqiptar,

Sot festojmë përvjetorin e tretë të ditës më të shënuar dhe më madhështore të gjithë historisë së popullit tonë, ditën e çlirimit të Shqipërisë nga robëria e rëndë e fashizmit dhe e hyzmeqarëve të tij, feudalëve dhe gjithë klikës kapitaliste e borgjeze, armiq të betuar të popullit tonë, të lirisë, të pavarësisë dhe të demokracisë. Do ta festojmë sa të jetë jeta këtë ditë, pse ajo përsaqëson përpjekjet e pareshtura të popullit tonë, përsaqëson Luftën heroike ngadhnjimtare nacional-çlirimtare që realizoi plotësisht qëllimet dhe dëshirat e zemrës së popullit shqiptar.

Populli ynë donte të rronte dhe prandaj ai luftoi me ashpërsinë më të madhe dhe me heroizëm të pashoq për një jetë më të mirë, më të denjë, në liri të plotë dhe në një demokraci me të vërtetë popullore. Për realimin e këtyre qëllimeve të mëdha, që në ditët e para të robërisë u çua në këmbë i gjithë populli ynë i shumëvuajtur. Përpara armiqve aq të egër, siç ishin fashistët

gjermanë dhe italianë dhe kuislingöt e vendit tonë, duhej të zhvillohej nga ana e popullit një luftë e organizuar fort, një luftë e pamëshirshme, e paprçrë dhe pa kompromis kundër kundërshtarëve. Njëkohësisht lufta, që të kish suksesin e plotë, duhej të drejtohej nga një dorë e çelniktë, besnikë deri në vdekje për kauzën e popullit, që të kishte besimin e plotë të masave të gjera punonjëse të Shqipërisë, që të kishte në programin e saj realizimin e qëllimeve dhe të aspiratave shekulllore të popullit tonë dhe të luftonte deri në vdekje për realizimin e këtij programi. Lufta jonë e lavdishme nacional-çlirimtare u zhvillua kësisoj, prandaj populli ynë korri sukseset që ai gjëzon sot. Organizatorja e lavdishme e luftës dhe e gjithë fitoreve të popullit tonë është Partia Komuniste e Shqipërisë dhe sot në këtë ditë të madhe, populli i gjithë Shqipërisë shfaq dashurinë e papërshtkuar për të, këndon lavdinë e pavdekshme të Partisë, që udhëhoqi me zotësinë dhe me vendosmërinë më të madhe popullin shqiptar drejt fitores mbi armiqtë okupatorë, mbi armiqtë e brendshëm të popullit tonë dhe që i dha këtij lirinë e plotë, pavarësinë, sovranitetin, demokracinë e re popullore, Republikën Popullore. Me besim të patundur te Partia dhe të grumbulluar e të bashkuar si një trup i vetëm në Frontin Nacional-Çlirimtar, të inkuadruar në njësitë partizane dhe në ushtrinë tonë heroike, luftuan me heroizmin legjendar punëtorët, katundarët, rinia jonë trime, intelektualët patriotë, luftuan gratë e Shqipërisë.

Populli shqiptar, që e fitoi me gjak betejën për jetën, pati ndihmën e luftës së lavdishme ngadhnjmëtare të Bashkimit të madh Sovjetik, të udhëhequr nga Stalini.

Fitoret e popullit tonë janë të lidhura me fitoret e Bashkimit Sovjetik, me luftën e tij legjendare, me sakrificat dhe heroizmat e tij. Bashkimi Sovjetik me në krye Stalinin e madh ndihmoi popujt për të fituar lirinë, duke mposhtur nëpermjet betejash të përgjakshme fashizmin gjerman dhe satelitët e tij. Prandaj populli ynë në këtë ditë feste të madhe me dashurinë më të madhe shpreh mirënjojen e tij të pakufishme për popujt e Bashkimit Sovjetik dhe për Stalinin e madh, shpëtimtarin e njerëzimit, të qytetërimit, të demokracisë.

Lufta nacional-çlirimtare i dha popullit shqiptar dhe një fitore tjetër, aleancën me popujt e Jugosllavisë së re. Të dy popujt tanë i lidhi lufta, i bashkuan qëllimet, i bashkoi jetë. Fashizmi okupator, tradhëtarët dhe kuislingët, imperialistët anglo-amerikanë bënин çdo gjë që ta shuanin luftën tonë dhe të izolonin popullin tonë nga popujt e tjerë.

Popull shqiptar,

Tre vjet kanë kaluar që nga dita e çlirimtës së plotë të vendit tonë nga okupatorët dhe tradhëtarët. Këta tre vjet janë mbushur plot heroizma, sakrifica dhe punë të palodhur dhe të frytshme nga ana e popullit tonë heroik, për të rindërtuar atdheun dhe jetën e tij. Populli ynë, nën udhëheqjen e sigurt të Partisë sonë, i rreshnuar dhe i organizuar në Frontin tonë Demokratik, me pushtetin popullor në duart e tij të sigurta, ka ndërmarrë punime të rëndësishme dhe të gjithanshme dhe ka dalë me sukses të madh në veprën e tij përparimtare. Populli ynë ka kapërcyer me heroizëm çdo pengesë dhe vështirësi që gjente përpara dhe këto ishin të natyrsh-

me, sepse vendi ynë ishte krejtësisht i shkatërruar nga lufta. Duke kuptuar rëndësinë e momenteve, ai s'është tërhequr kurrë përpara pengesave, por ka punuar, ka sakrifikuar dhe më në fund ka fituar. Puna e palodhur e klasës sonë punëtore, besnikëria e saj e madhe ndaj çështjes së popullit, puna e pandërprerë e fshatarësisë sonë, e intelektualëve tanë popullorë dhe puna heroike e rinisë sonë bënë që të forcohet, të konsolidohet Shqipëria jonë e re, pushteti ynë popullor, bënë që të forcohet Republika jonë, të ndërtohen dhe të prodrojnë fabrikat dhe minierat tona, të zhvillohet dhe të përmirësohet bujqësia, të zhvillohet kultura dhe arësimi. Me një fjalë këto bënë që jeta e masave të gjera punonjëse të vendit tonë të përmirësohet. Nga ana tjetër masat e gjera punonjëse fituan eksperiencë të vlefshme drejtimi dhe organizimi, gjë që solli një ndryshim rrënjosor në zhvillimin e punimeve. Populli ynë, gjithashtu, në luftën e tij për ndërtimin e jetës së re u ndesh me armiqtë e brendshëm të popullit, me tradhëtarët dhe agjentët sabotatorë në shërbim të anglo-amerikanëve që përpinqeshin të sabotonin, të rrëzonin pushtetin tonë popullor dhe të përsëritnin kohën e vjetër të tiranisë dhe të shtypjes kapitaliste. Populli ynë u ndesh ashpër me ta, i luftoi, i demaskoi dhe i dënoi pa mëshirë. Populli ynë, kurdoherë vigjilent për ruajtjen e fitoreve të tij, do t'i godasë pa mëshirë të gjithë ata armiq të popullit që do të tentojnë të dëmtojnë punën dhe veprat e pavardekshme të tij. S'ka dhe s'duhet të ketë kurrë lëshime dhe mëshirë kundrejt armiqve të popullit; kundër tyre lufta duhet të bëhet e organizuar, e gjithanshme dhe e ashpër deri në shfarosjen e plotë të tyre.

Sukseset e arriitura në lëmin ekonomik, kultural dhe shoqëror, kanë forcuar për së tepërmë pushtetin tonë popullor, ndërgjegjen e masave të gjera punonjëse të vendit tonë, eksperiencën dhe vigjilencën e tyre. Këto suksesë kanë forcuar ekonominë tonë dhe zotësinë e kuadrove tanë, saqë pushteti ynë popullor me baza të tilla të shëndosha po ndërmerr punime të rëndësishme, me plan që do të ndryshojnë faqen e Shqipërisë dhe do të forcojnë bazat për shkuarjen drejt socializmit. Plani ynë i ardhshëm dhe realizimi i tij i sigurt do të bëjë që populli ynë të shohë ditë akoma më të mira. Për realizimin e planit tonë, që do të thotë realizimi i jetës më të mirë, të nderen të gjitha energjitet e popullit tonë, të armatoset i gjithë populli me eksperiencë të vlefshme nga puna e përditshme, të përvetësohet shpejt dhe mirë teknika, të zhvillohet arësimi dhe kultura në shkallë të gjerë, të forcohet organizimi dhe disiplina në punë, të forcohet dhe të organizohet vigjilanca kundër armiqve të brendshëm dhe të jashtëm, të cilët do të bëjnë sigurisht përpjekje të panumërtë për të na dëmtuar në punën tonë. Ushtria jonë heroike dhe popullore duhet të ruajë dhe të zhvillojë traditat e Luftës nacional-çlirimtare; ajo duhet të jetë kurdoherë e gatshme, e fortë dhe vigjilente për të përbushur detyrat që i ka besuar populli. Detyrat që na vihen përpëra për realizimin e planit të shtetit tonë janë të shenja e jetike për çdo qytetar dhe duhet t'i kryejmë me përpikërinë më të madhe.

Imperialistëve anglo-amerikanë nuk u pëlqen demokracia jonë popullore; ata po përpiken të luftojnë me çdo mjet dhe në çdo moment popullin tonë, ata përpiken të dëmtojnë veprën e popullit tonë, të rrëzojnë pushtetin

popullor me anën e agjentëve tradhëtarë dhe të forcës, për ta bërë vendin tonë një Greqi të dytë, ku të sundojë terrori dhe fashizmi. Por planet e tyre kanë dështuar dhe do të dështojnë edhe në të ardhmen. Populli ynë me vendosmërinë më të madhe do të luftojë deri në vdekje kundër tentativave të poshtra të imperialistëve anglo-amerikanë dhe shërbëtorëve të tyre; populli ynë me vendosmërinë më të madhe ka vënë forcat e tija në kampin e fuqishëm antiimperialist dhe demokratik, në krye të të cilit qëndron i fuqishëm dhe i pathyeshëm Bashkimi i madh Sovjetik. Popullit tonë nuk i trembet syri nga kërcënimet, shantazhet dhe padrejtësitë e paturpshme, që i bëhen nga imperialistët anglo-amerikanë dhe satelitët e tyre monarko-fashistët grekë si dhe nga përpjekjet e armiqve të brendshëm të vendit tonë. Populli ynë është i bindur në drejtësinë e tij, në rrugën e tij të drejtë përparimtare dhe paqësore, në forcat e tija të gjalla dhe populli ynë ka miq dhe aleatë besnikë dhe të fuqishëm që e ndihmojnë, ka Bashkinin e madh Sovjetik me Stalinin e madh, ka gjithë popujt e tjerë demokratikë dhe përparimtarë.

Populli ynë, me vendosmërinë më të madhe, i grumbulluar si një trup i vetëm në Frontin Demokratik dhe nën udhëheqjen e lavdishme të Partisë Komuniste, do të ecë në rrugën e tij të përparimit dhe të mirëqenjes.

Rroftë populli heroik shqiptar!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 910,
29 nëntor 1947*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Bashkimi», Nr. 910,
29 nëntor 1947*

**FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT
TË QYTETIT TË SOFJES NË MITINGUN
E ORGANIZUAR ME RASTIN E VIZITES
SË DELEGACIONIT TË QEVERISE SË RPSII
NË RP TË BULLGARISË**

14 dhjetor 1947

Popull vëlla bullgar,

Gëzimi ynë sot është shumë i madh, pse ndodhemi te ju dhe i sjellim popullit heroik dhe vëlla bullgar, Qeverisë së Republikës suaj Popullore dhe kryetarit tuaj të shquar, Gjergj Dimitrovit, përshëndetjet më të nxehta vëllazërore të popullit shqiptar dhe të qeverisë sonë.

Ne pritëm me gëzim ftesën e qeverisë suaj dhe erdhëm në Bullgarinë e lirë dhe demokratike për të forcuar miqësinë tradicionale, që ka ekzistuar në të kaluarën në mes të dy popujve tanë dhe që pas kësaj lufte të madhe çlirimtare kundër fashizmit kjo miqësi u zhvillua e u bë një realitet i fuqishëm. Për një miqësi dhe vëllazërim të tillë, popujt tanë kanë luftuar dhe janë përpjekur gjithmonë. Populli ynë i vogël si dhe juaji, ka vuajtur shtypjet më barbare nga okupatorët e ndryshëm imperialistë, të cilët na kanë gjakosur, por s'kanë

mundur kurrë të shuajnë luftën e popullit tonë për liri, pavarësi e demokraci.

Në momentet e rënda të së kaluarës patriotët shqiptarë të Rilindjes, që luftonin kundër armikut të përbashkët otoman, kanë gjetur në gjirin e popullit vëlla bullgar strehë të sigurtë dhe kanë zhvilluar në Sofje një aktivitet të madh politik dhe kultural. Në Sofje, që në fillim të këtij shekulli janë themeluar shoqëritë e para patriotike shqiptare të mërgimit. Këtu kanë parë dritën nga më të parat gazeta në gjuhën shqipe, që kanë luajtur një rol me rëndësi në zgjimin e ndërgjegjes patriotike të popullit tonë të robëruar. Por për popujt tanë nuk ishin mbaruar të këqiat. Klikat reaksionare të feudalëve dhe të borgjezisë shtypnin pa mëshirë popujt tanë dhe çdo përpjekje e tyre për t'u çliruar më në fund tradhëtohej nga këto klika. Popujt tanë u gjendën përballë armiqve më të egër, që kishte parë njerëzimi: fashizmit gjerman, italian dhe shërbëtorëve të tyre. Por popujt tanë vendosën të luftonin gjer në fund për të mundur fashizmin dhe për të vendosur demokracinë popullore. Që më 7 prill 1939 populli ynë i vogël u hodh në luftë me armë në dorë dhe nuk i lëshoi këto në asnë moment, sepse e dinte se lirinë dhe pavarësinë do ta fitonte me gjak dhe do të vendoste pushtetin e drejtësinë e tij.

Popujt tanë luftuan me besim të patundur në fitoren, pse lufta kundër fashizmit udhëhiqej nga Bashkimi i lavdishëm dhe i pathyeshëm Sovjetik dhe nga Stalini i madh. Popujt tanë dhe e gjithë bota i detyrojnë kryesisht Bashkimit Sovjetik, Ushtrisë heroike Sovjetike dhe Gjeneralisimit Stalin, çlirimin dhe fitoren mbi fashizmin.

Me popullin punëtor dhe liridashës bullgar, populli ynë ka vendosur të lidhet e të bashkëpunojë ngushtësisht dhe të rrojë i vëllazëruar sikundër po bën me popujt vëllezër të Jugosllavisë së re. Populli ynë nuk është një popull sllav, por ai është i lidhur me miqësi të ngushtë me popujt sllavë. Imperialistët skllavërues, fashistët dhe shovinistët, u përpoqën të na armiqësojnë, por ata dështuan në veprën e tyre. Popujt e Jugosllavisë, të Bullgarisë dhe të Shqipërisë, duke luftuar, hapën rrugën e vëllazërimit dhe të bashkimit, rrugën e shpëtimit dhe të mirëqenjes, që ne sot po e ndërtojmë së bashku me gjithë fuqitë tona. Ballkani nuk do të jetë më një fuçi baruti, ka thënë kryetari juaj shoku Gjergj Dimitrov, pse popujt tanë nuk do të lejojnë kurrë që imperialistët dhe shërbëtorët e tyre, monarko-fashistët grekë dhe të tjerë, të kërcënojnë integritetin dhe sovranitetin e vendeve tona. Popujt tanë do të ruajnë si sytë e ballit të gjitha fitoret që u kushtuan gjak dhe sakrifika; ata do ta ruajnë, do ta forcojnë dhe do ta zhvillojnë vëllazërimin dhe bashkëpunimin në mes tyre. Të tilla marrëdhënje, siç ekzistojnë në mes të dy popujve tanë, përbëjnë një faktor të rëndësishëm për forcimin e demokrative tona popullore dhe për forcimin e paqes së vërtetë në Ballkan dhe në Evropë. Të tilla marrëdhënje do të bëjnë që të dështojë çdo manevrë e imperialistëve amerikanë, anglezë dhe e shërbëtorëve të tyre. Popujt tanë janë me të gjitha forcat e tyre me kampin antiimperialist dhe demokratik. Besnikë deri në vdekje ndaj kauzës së madhe të paqes dhe të demokracisë së vërtetë, të dy popujt tanë kanë vendosur të ecin krah për krah të bashkuar në rrugën e jetës së lirë e të begatshme.

Të rrojë miqësia dhe vëllazërimi midis dy popujve tanë!

Rroftë populli vëlla bullgar!

Rroftë Republika Popullore motër e Bullgarisë!

Rroftë kryetari juaj i madh Gjergj Dimitrov!

Rrofshin popujt e Bashkimit të madh Sovjetik dhe udhëheqësi i tyre, Gjeneralisimi Stalin!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkim», Nr. 924,*

16 dhjetor 1947

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkim», Nr. 924.*

16 dhjetor 1947

**FJALA E MBAJTUR NË SOFJE ME RASTIN
E DEKORIMIT NGA PRESIDIUMI I ASAMBLESE^E
SË MADHE POPULLORE TË RP TË BULLGARISË**

14 dhjetor 1947

Shoku kryetar,

Zonja dhe zotërinj,

Në emër të shokëve dhe të shoqeve të delegacionit tonë dhe në emrin tim ju shpreh përshëndetjet dhe falenderimet më vëllazërore dhe më të sinqerta të atyre që kanë nderin sot të dekorohen me dekoratat më të larta të popullit bullgar.

Këto dekorata nuk janë vetëm për ne, këto janë për gjithë popullin tonë, i cili ka luftuar heroikisht së bashku me popullin tuaj për lirinë e popujve, për demokracinë e paqen në botë.

Ne marrim me gëzim dekoratat tuaaja të larta dhe do t'i mbajmë me krenari, sepse ato i jepen nga populli juaj, popullit tonë dhe shprehin miqësinë në mes të dy popujve tanë vëllezër. Kjo miqësi e sinqertë në mes të popujve tanë është një gjë e vlefshme për popullin shqiptar dhe i ka rrënjet e saj qysh nga ditët më të errëta të historisë së popullit tonë. Populli bullgar në të

kaiuarën na ka ndihmuar në luftën kundër okupatorëve të ndryshëm që të fitojmë lirinë. Dhe sot, kur popujt tanë me luftë janë çliruar nga fashizmi dhe vendosën regjime demokratike e popullore në vendet e tyre, ne do të ecim gjithmonë përpara. Rruga e re për të ardhmen më të lumtur për popujt tanë është e hapët dhe askush nuk është në gjendje të na pengojë, që të shkojmë në rrugën e përbashkët.

Populli bullgar duhet të jetë i bindur se, në popullin tonë të vogël, ka një mik të singertë dhe besnik. Kjo miqësi do të forcohet dhe më tepër me marrëdhënet që do të nënshkruajmë këtu dhe do të bëjmë ç'është e mundur që kjo miqësi të jetë shekullore, sepse i ka rrënjet e saja në luftën e përbashkët të popujve tanë.

Ne në të ardhmen do të shkojmë gjithnjë përpara, sepse siç tha dhe shoku President i Presidiumit të Asamblesë së Madhe, kemi aleat Bashkimin Sovjetik të të madhit Gjeneralisimit Stalin, Bashkimin Sovjetik, i cili me qëndrimin e tij heroik mbron demokracinë dhe lirinë e popujve.

Në momentin kur ne gjendemi këtu, populli ynë me entuziazëm brohorit për popullin tuaj, për udhëheqësin tuaj dhe mësuesin tonë shokun Gjergj Dimitrov, që me shembullin e tij, na ka mësuar si të luftojnië kundër fashizmit.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi». Nr. 924,*

16 dhjetor 1947

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Bashkimi», Nr. 924,
16 dhjetor 1947*

FJALA E MBAJTUR ME RASTIN E DEKLARIMIT QYTETAR NDERI TE QYTETIT TE SOFJES

14 dhjetor 1947

Shoku kryetar i Bashkisë,

Për mua është një nder i madh dekorata e madhe dhe deklarimi qytetar nderi i kryeqytetit tuaj të bukur, Sofjes, të Sofjes që ka luftuar kundër fashizmit e kundër okupatorit, të Sofjes e cila është shkatërruar nga bombardimet armike, por qytetarët e të cilës nuk u tronditën dhe qëndruan heroikisht, të Sofjes, që është koka e Bullgarisë, ku qëndron qeveria e Frontit Patriotik, dhe ku jeton e punon udhëheqësi i popullit bullgar, shoku Gjergj Dimitrov. Sofja është një nga kryeqytetet e popujve demokratikë të Ballkanit, që ka luajtur dhe luan një rol me rëndësi për demokracinë dhe paqen në Ballkan dhe në botë.

Populli ynë ndjen po atë dashuri të madhe për popullin bullgar që ndjejnë edhe qytetarët e Sofjes për ne, por sot ne pamë me sytë tanë sa shumë na duan qytetarët e Sofjes dhe sa dashuri ka populli bullgar për popullin tonë.

Me gëzim të singertë ne do t'i tregojmë popullit tonë ato që pamë dhe, si qytetar nderi i Sofjes, do të vë

të gjitha përpjekjet e mia për përforcimin e bashkëpunimit dhe të vëllazërimit në mes të popujve tanë.

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 924.
16 dhjetor 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 924,
16 dhjetor 1947*

**FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË
QYTETIT TË PLOVDIVIT ME RASTIN E VIZITËS
SË DELEGACIONIT TË QEVERISË SË RPSH
NË RP TË BULLGARISË**

15 dhjetor 1947

I dashur popull i qytetit Plovdiv dhe i Bullgarisë,

Duke hyrë në qytetin tuaj ne u pritëm nga zëri i sirenave që përfaqëson frymën dhe vrullin revolucionar të popullit punëtor bullgar.

Gëzimi im dhe i delegacionit të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë është shumë i madh, sepse ndodhemi sot midis jush, midis popullit vëlla bullgar. Në emër të popullit shqiptar, të qeverisë së tij dhe në emrin tim personal, ju sjell pëershëndetjet më të zjarrta dhe më të përzemërta vëllazërore. Shprehja e simpatisë suaj kundrejt popullit shqiptar na prek thellë; ne do t'i themi popullit shqiptar se në popullin bullgar ai ka një vëlla të sinqertë.

Të dy popujt tanë janë të lidhur prej vjetësh me një miqësi tradicionale. Me luftën e tyre heroike kundër okupatorëve fashistë dhe klikave reaksionare të brendshme, me në krye pushtetet popullore, popujt

tanë kanë krijuar të gjitha konditat dhe kanë hedhur baza të shëndosha në çdo pikëpamje të brendshme dhe të jashtme që t'i forcojmë akoma më shumë këto marrëdhënje miqësore dhe vëllazërimi që lindën dhe u cimentuan me gjak gjatë luftës çlirimtare. Ne do t'i konkretizojmë këto marrëdhënje, ashtu siç janë aspiratat e dëshirat e zjarrrta të dy popujve tanë vëllezër. Me këtë rrugë ne do të ndërtojmë të ardhmen tonë të përbashkët, të lumtur dhe të përparuar. Në këtë rrugë ne jemi krahas dhe popujve vëllezër të Jugosllavisë së re. Kjo është garanci për forcimin e paqes dhe të demokracisë së vërtetë në Ballkan dhe në Evropë. Ne përbëjmë një front të pathyeshëm për ruajtjen e pavarësisë, të lirisë dhe të integrititetit të vendeve tona, kundër tentativave të imperializmit skllavërues dhe të gjithë agjentëve të tij që duan dhe përpilen, me anë shantazhesh, provokacionesh e manevrash të poshtra të shkaktojnë një luftë të re.

Ballkani nuk mund të jetë më një fuçi baruti në duart e imperialistëve, ashtu siç ka qenë dje. Sot popujt tanë i kanë fatet në duart e tyre dhe vendet tona, nga një vatër grindjesh e luftërash, janë kthyer në një bazë e shëndoshë paqeje dhe vëllazërimi. Një gjendje e tillë nuk ekziston sot në Greqinë monarko-fashiste. Atje sundojnë imperializmi dhe klikat reaksionare fashiste, që e shtypin dhe e torturojnë popullin heroik grek, i cili nga ana e tij është duke bërë një luftë me të vërtetë heroike për çlirimin e vet, për vendosjen e demokracisë së vërtetë në vendin e tij dhe për ruajtjen e paqes. Popujt tanë, që kanë vuajtur nga imperializmi dhe që janë të vendosur të ruajnë fitoret e luftës së tyre me

çdo kusht, simpatizojnë me gjithë zemër luftën e popullit heroik grek dhe i japid atij çdo ndihmë morale dhe politike, sepse ai e meriton plotësisht këtë, sepse ne jemi për lirinë e popullit grek, për paqen e shëndoshë dhe për demokracinë në Ballkan dhe në Evropë. Ne jemi të vendosur gjer në vdekje të qëndrojmë besnikë, të patundur ndaj kauzës së madhe të kampit antiimperialist dhe demokratik, në krye të të cilit qëndron Bashkimi i madh Sovjetik, i udhëhequr nga Gjeneralisimi Stalin.

Ne kemi ardhur në Bullgarinë e re dhe demokratike, në atdheun e lirë të popullit vëlla bullgar, të udhëhequr nga prijesi i shquar Gjergj Dimitrov, që të konkretizojmë ashtu si duhet dhe të vulosim me anën e marrëveshjeve që do të lidhim, dëshirat dhe aspiratat e të dy popujve tanë vëllezër, që të hedhim bazat e një bashkëpunimi të ngushtë, konkret dhe vëllazëror, në interesat e pandashme të të dy popujve tanë. Marrëveshjet tona janë marrëveshje popujsh, sepse i kanë themelat e tyre në luftën e përbashkët. E ardhmja jonë është e sigurt dhe nuk do të ketë asnjë forcë në botë që të ndalojë arritjen e saj, sepse popujt tanë sot i kanë vetë fatet e tyre në dorë, sepse kanë në udhëheqjen e tyre partitë e tyre komuniste heroike.

Ne e sigurojmë popullin vëlla bullgar se populli i vogël shqiptar do të vërë të gjitha forcat që bashkëpunimi dhe vëllazërimi, që ekzistojnë sot midis demokrative tona të reja popullore, do të bëhen sa më të fortë dhe se populli shqiptar do t'i mbrojë me gjakun e tij, sepse për këto ai ka luftuar vjete me radhë.

Rroftë populli vëlla bullgar dhe udhëheqësi i tij i madh, Dimitrovi!

Rroftë vëllazërimi i pathyeshëm midis popujve të Bullgarisë dhe të Shqipërisë!

Rroftë Bashkimi i pathyeshëm Sovjetik, mbrojtësi i paqes, i demokracisë e i lirisë dhe udhëheqësi i tij, Stalini, miku më i madh dhe i shtrenjtë i popujve tanë!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 927.*

19 dhjetor 1947

*Botohet sëpas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 927,*

19 dhjetor 1947

**FJALA E MBAJTUR NË PALLATIN E KRITÇIMIT
NË PLOVDIV ME RASTIN E NËNSHKRIMIT TË
TRAKTATIT TË MIQËSISË, BASHKËPUNIMIT
DHE NDIHMËS RECIPROKE MIDIS RPSH DHE
RP TË BULLGARISË**

16 dhjetor 1947

I nderuari zoti Kryeministër, të nderuar shokë e shoqe,

Unë do të shpreh ndjenjat e thella të popullit tonë ashtu sikundër i shprehu shoku juaj, njëkohësisht dhe yni, Gjergj Dimitrovi. Po, ato janë të njëjta. Ne erdhëm këtu si ushtarë të popullit tonë, si ushtarë të Partisë sonë Komuniste me vullnetin e popullit shqiptar, i cili është i vendosur të rrojë në vëllazërim dhe në bashkëpunim me popullin heroik bullgar.

Vendi ynë i vogël ka qenë gjithmonë i shtypur; për ne kurrë nuk ka pasur mëshirë. Ne kemi qenë mone-dhë shkëmbimi. Por për popullin tonë lindi shpresa, ashtu si lindi shpresa për gjithë njerëzimin përparimtar pas Revolucionit të madh të Tetorit. Me gjithë shtypjen e pamëshirshme të feudalëve, me gjithë propagandën e tyre të poshtër, që kishin ngritur kundër Bashkimit të madh Sovjetik, populli ynë thoshte: «Atje në

Rusi ngjan diçka e madhe, atje punëtorët kanë marrë pushtetin në duart e tyre, atje është vendosur drejtësia popullore». Dhe me shpresë se do ta fitonte lirinë e tij, ai filloi përpjekjet qysh në kohën e Zogut. Mësuesit e mëdhenj të proletariatit të mbarë njerëzimit përparimtar, Lenini dhe Stalini, e mësuan popullin tonë, mësuan luftëtarët e tij se si ata duhet ta duan vendin e tyre dhe të luftojnë për liri, të luftojnë pa mëshirë dhe pa kompromis kundër armiqve. Qysh në ditët e para të okupacionit, populli ynë kuptoi se kishte ardhur koha ja të fitonte lirinë, ja të vdiste dhe ai rrëmbeu armët. Dhe, kur Bashkimi Sovjetik u sulmuva poshtërsisht nga barbarët hitlerianë, populli ynë e shtoi edhe më shumë luftën dhe bijtë e tij më të mirë dualën në mal e luf-tuan deri në fund krah për krah me popujt demokratikë për të njëjtin qëllim: për çlirimin nga fashizmi dhe për sigurimin e demokracisë dhe të paqes së vërtetë.

Fuqitë e popullit tonë ishin të vogla, por ai e kuptonte se duhej të kontribuonte me gjakun e tij për shkatërrimin e armikut, sepse në këtë mënyrë ai çlironte vetëveten dhe tregonte mirënjohjen e tij të madhe kundrejt Bashkimit Sovjetik, kundrejt Stalinit të madh dhe Ushtrisë së pathyeshme Sovjetike. Në luftën tonë të rëndë ne patëm në krah popujt e Jugosllavisë. Kundër vëllazërimit të popullit tonë me popujt sllavë dhe me popujt e tjerë fqinjë, armiqtë tanë kishin punuar djallëzisht.

Për të na përçarë ata përhapnin poshtërisht propagandë shoviniste. Po ajo nuk gjeti vend në gjirin e popullit tonë. Ai e ndjente veten si vëlla me popujt sllavë të Jugut të robëruar nga fashizmi. Në luftë kundër zaptuesve të huaj dhe shtypësve të brendshëm, populli

ynë është lidhur me popujt sllavë; edhe në të kaluarën ne kemi luftuar së bashku me popujt sllavë.

Lufta jonë kundër fashizmit tregoi se propaganda antisllave s'kishte zënë vend në mes të popullit tonë. Populli ynë thoshtë se ne do të fitojmë, sepse me ne është Bashkimi Sovjetik dhe Jugosllavia e re, dhe ne luftuam së bashku, derdhëm gjakun së bashku dhe u lidhëm akoma më ngushtë.

Me popullin vëlla bullgar ne kemi pasur gjithmonë lidhje të ngushta, siç tha shoku Dimitrov, dhe këtë na e tregon historia. Kurrë nuk ka pasur armiqësira në mes të popujve tanë. Përkundrazi, populli bullgar na ka ndihmuar. Dhe kur luftonim nëpër male, ne mejtonim për popullin bullgar, për partizanët bullgarë, të cilët luftonin në kondita të rënda kundër të njëjtë armik. Një shok nga Bullgaria erdhi në malet tona. Ne dërguam shokët tanë që të takoheshin me të, që të mësonin për luftën e popullit bullgar. Dhe në saje të luftës së përbashkët me Bashkimin e madh Sovjetik ne fituam lirinë dhe vendosëm regjimet popullore në vendet tona. Ashtu siç tha shoku Dimitrov, në krye të popujve tanë qëndrojnë partitë komuniste, të cilat janë garancia më e fortë për vendet tona.

Sikundër tha shoku Dimitrov, popujt tanë kanë armiq të përbashkët, që janë ngritur në një front të përbashkët kundër demokracisë dhe paqes. Populli ynë derdhi shumë gjak, prandaj ai nuk do të lejojë të tallen me gjakun e partizanëve tanë e as të luhet me fatin e tij. Popujt tanë nuk duan luftë dhe, sikundër tha shoku Dimitrov, ajo që ne po kryejmë këtu, forcon paqen. Ne kemi plot të drejtë të mbrojmë jetën e popujve tanë

kundër çdo rreziku dhe çdo agresioni dhe ne do t'i mbrojmë, sepse vëllazërimi i popullit shqiptar me popullin bullgar është një realitet. Popujt tanë do të vënë gjithë fuqitë e tyre dhe do të ecin në të njëjtën rrugë. Një bashkim i tillë i forcave do të pengojë armiqjtë tanë, monarko-fashistët grekë dhe neofashistët italianë që të kenë sukses në planet e tyre. Ata nuk do të kenë sukses, sepse në krye të kampit demokratik qëndron Bashkimi i madh dhë i pathyeshëm Sovjetik, mbrojtës i paqes dhe i demokracisë të të gjithë popujve të botës. Shoku ynë, Stalini i madh, na ka mësuar si të luftojmë dhe si të fitojmë. Ai na mëson si të bashkëpunojmë dhe si të forcohem për të mos pasur sukses armiqjtë tanë të jashtëm dhe të brendshëm. Sot ne shfaqim gëzimin tonë të madh që ndjejmë përfundimin e këtyre marrëveshjeve vëllazërore, të cilat shprehin vullnetin e popujve tanë dhe thérresim:

Rroftë vëllazërimi dhe bashkëpunimi midis popullit vëlla bullgar dhe popullit shqiptar!

Rroftë sa malet udhëheqësi juaj i lavdishëm, një nga më të shquarit mësues të proletariatit dhe mësuesi ynë, i cili na tregoi rrugën e luftës së pamëshirshme kundër fashizmit, shoku Gjergj Dimitrov, shembullin heroik të të cilit ne e ndoqëm në luftë!

Rroftë Bashkimi i madh Sovjetik, mbrojtësi i paqes dhe i demokracisë në gjithë botën!

Rroftë sa malet mësuesi ynë, Stalini i madh!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 928,
20 dhjetor 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 928,
20 dhjetor 1947*

**DEKLARATË E BËRË PËRPARA PËRFQËSUESVE
TË SHTYPIT BULLGAR DHE TË HUAJ NË LIDHJE
ME NËNSHKRIMIN E TRAKTATIT TË MIQËSISE,
BASHKËPUNIMIT DHE NDIHMËS RECIPROKE,
MIDIS RP TË SHQIPËRISË DHE RP TË
BULLGARISË**

17 dhjetor 1947

Sikurse e dini, dy qeveritë tona, bullgare dhe shqiptare, nënshkruan në Kritçim Traktatin për miqësi, bashkëpunim dhe ndihmë reciproke.

Në këtë traktat, që nënshkruam ne, është shprehur vullneti i popujve tanë, që duan të jetojnë miqësish të bashkuar për ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë të popujve tanë, që duan të sigurojnë pavarësinë, sovranitetin dhe lirinë e vendeve të tyre, të fituara me shumë gjak dhe me shumë sakrifica.

Traktati që nënshkruam me Bullgarinë, ka për qëllim të forcojë paqen, të forcojë luftën kundër nxitësve të luftës, kundër imperialistëve të të gjitha vendeve me anglezët dhe amerikanët në krye, të cilët me çdo kusht duan të ndezin luftëra të reja dhe të nënshtrojnë popujt tanë, të cilët janë shumë të lidhur për demokracinë dhe paqen.

Popujt tanë nuk do të lejonin kurrë të prekej lumburia jonë, pavarësia jonë dhe liria jonë.

Ne jemi të bindur se e kaluara e zezë, kur popujt tanë bëhen shin monedhë shkëmbimi është likuiduar njëherë e përgjithmonë. Në mes të popullit shqiptar dhe bullgar, si dhe në mes të popujve të tjerë të Ballkanit, nuk ka asgjë që të mund t'i përcajë, por ka çdo gjë që i bashkon.

Armiqtë tanë kanë bërë dhe mundohen edhe tani të bëjnë çmos që të krijojnë incidente ose të bëjnë një politikë të tillë, që të mund të shkaktojë përçarje në mes të popujve tanë.

Por armiqtë tanë duhet ta dinë se në mes të popujve tanë nuk ka dhe as nuk do të ketë përçarje, që të mund t'i përdorin për t'u futur thikën pas kurrizit popujve tanë.

Ne e dimë, se kemi armiq, të cilët luftojnë pa pushim kundër nesh. Ne i kemi në kufitë tanë të Jugut monarko-fashistët grekë, të cilët ndihmohen haptas nga amerikanët dhe anglezët. Ata çdo ditë bëjnë incidente të çfarëdo lloji, me të vetmin qëllim që të turbullojnë paqen dhe të pengojnë demokracitë tona popullore. Anglezët dhe amerikanët me këtë duan të tregojnë, se gjoja populli shqiptar është një popull agresiv, që rrezikon paqen si dhe pallavra të tjera të tillë. Në realitet populli ynë është një popull liridashës, që nuk e do luftën, që kërkon të jetojë në paqe dhe që ka përqëndruar të gjitha fuqitë e veta për përforcimin e paqes. Ne derdhëm shumë gjak, që të kemi paqe të drejtë dhe demokratike dhe ne nuk i fshehim ndjenjat tona të mëdha të simpatisë ndaj popullit grek, që lufton herokisht kundër okupatorit dhe tradhëtarëve.

Lufta që bën kundër nesh reaksiuni, me në krye amerikanët nuk kufizohet vetëm me kaq. Ju i dini mirë qëndrimet armiqësore ndaj popullit shqiptar në të gjitha konferencat ndërkombëtare. Ai lufton me të gjitha mjetet për të na penguar që ne të marrim të drejtat tona, të cilat i fituam me luftë të ashpër dhe në radhë të parë që të jemi anëtarë të vërtetë me të gjitha të drejtat në OKB.

Populli ynë e di, se luftën kundër fashizmit e fituam duke bashkuar të gjitha fuqitë tona dhe duke vënë në balancën e luftës kundër fashizmit të gjitha forcat tona. Ne e dinim atëhere dhe e dimë edhe tani se duhet të vëmë të gjitha forcat tona në anën e kampit demokratik dhe antiimperialist, në krye të të cilit është Bashkimi i pamposhtur Sovjetik, mbrojtësi i lirisë, i demokracisë dhe i paqes, mbrojtësi i popujve tanë. Ne të gjithë, shqiptarë, bullgarë, jugosllavë, çekoslovakë, polonezë, rumunë dhe popuj të tjerë kemi vënë të gjitha forcat tona në këtë kamp dhe do të luftojmë me të gjitha fuqitë për paqen. Mbi të gjitha kjo është detyrë e gjithë popujve që duan lirinë dhe demokracinë.

Ne dimë gjithashtu, se, që të mund të realizojmë të gjitha këto, do të na duhet të punojmë me të gjitha forcat tona, për përparrimin e demokrative tona popullore dhe kjo do të arrihet, vetëm kur të punojmë si tani, të vëllazëruar.

Populli bullgar dhe shqiptar, të cilët në të kaluarën kanë vuajtur aq shumë, tani janë të fortë, sepse kanë miq besnikë të gjithë popujt e Evropës, që ishin të okupuar nga gjermanët dhe italianët dhe që gjatë luftës na ndihmuani në luftën tonë çlirimtare.

Përveç këtyre ne kemi Bashkimin Sovjetik me në krye Stalinin e madh që është shtyllë e paqes dhe e demokracisë.

Ne jemi të sigurtë se do të fitojmë një paqe të vërtetë, demokratike.

Miqësia në mes të popullit bullgar dhe popullit shqiptar nuk fillon sot. Në të kaluarën populli bullgar na ka ndihmuar. Dhe tani mbas kësaj lufte, kur jetojmë të njëjtat kondita, miqësia jonë bëhet gjithnjë më e thellë.

Ne pamë sa dashuri dhe sa simpati të thiellë ka populli bullgar ndaj popullit tonë. Gjithkund ku ne shkuam, nga më i rrituri deri te më i vogli, shprehëj në mënyrë spontane dashuria dhe simpatia e tyre ndaj Shqipërisë.

Kur kalonim me tren përmes katundevc, ne pamë si populli bullgar shprehte dashurinë e tij për popullin shqiptar.

Ne vizituam fabrika, ku pamë punën e punëtorëve bullgarë, një punë të palodhshme dhe konsekuente.

Një punëtor na tha: «Ne punojmë me të gjitha fuitë, sepse tani punojmë përvete dhe jo përkapitalistët».

Po kjo gjë është edhe në Shqipëri. Garancia për triumfin e kauzës sonë është tamam këtu, sepse në vendet tona popujt janë në pushtet, se popujt do ta ruajnë pushtetin e tyre dhe do ta forcojnë. Ne e ndjejmë përdetyrë t'i transmetojmë popullit tonë atë që pamë në vendin tuaj, atë që na thanë dhe e shprehën populli bullgar dhe udhëheqësit bullgarë, me në krye udhëheqësin e madh të popullit bullgar, Gjergj Dimitrovin.

I transmetoni popullit bullgar, se populli shqiptar ushqen të njëjtat ndjenja për popullin bullgar.

Popujt tanë që sot e tutje do të ecin krah për krah që të ndërtojnë një të ardhme të përbashkët, një të ardhme të lumtur, të lirë dhe sovrane.

Për këtë qëllim ata do të vënë të gjitha forcat që të realizojnë në vepra atë që ne nënshkruam në Kritçim.

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 928,
20 dhjetor 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 928,
20 dhjetor 1947*

**FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT NË
MITINGUN E ORGANIZUAR NË TIRANË ME
RASTIN E KTHIMIT TË DELEGACIONIT TË
QEVERISË SË RPSH NGA VIZITA NË RP
TË BULLGARISË**

19 dhjetor 1947

Popull shqiptar,

Delegacioni i Qeverisë së Republikës sonë shkoi në Bullgarinë popullore të Gjergj Dimitrovit që të forconte dhe të çelnikoste më shumë miqësinë tradicionale që ka ekzistuar në mes të dy popujve tanë, miqësi e cila, pas luftës kundër okupatorit fashist dhe kuislingëve, u bë më e fortë.

Më 16 të këtij muaji, sikundërqë ju e dini nga komunikata e përbashkët që lëshuan, delegacioni ynë dhe delegacioni i qeverisë bullgare, kemi nënshkruar një traktat miqësie, bashkëpunimi dhe ndihme reciproke si dhe një konventë kulturale.

Këto marrëveshje të popullit tonë me popullin bullgar kanë një rëndësi të madhe, të jashtzakonshme, rëndësi që i ka mbushur popujt tanë me një entuziazëm të papërshkrueshëm.

Popujt tanë janë jashtëzakonisht të gjëzuar, ata kanë siguruar të ardhmen e tyre, jetën e tyre më të mirë, pavarësinë, lirinë e demokracinë.

Ky vëllazërim e bashkëpunim i popujve tanë, ka frikësuar armiqjtë tanë, armiqjtë e popujve tanë dhe i ka frikësuar se ata janë kundër paqes, se ata nuk duan të ketë paqe në Ballkan dhe në botë. Dhe këtë punë që ne kemi bërë, duke u lidhur me njëri-tjetrin, e kemi bërë për të mbrojtur paqen, për të mbrojtur interesat e popujve tanë. Por armiqve tanë, imperialistëve, me në krye amerikanët dhe anglezët e shërbëtorëve të tyre kjo gjë nuk u pëlqen. Imperialistët si në të kaluarën, ashtu dhe gjatë luftës e pas luftës, kanë vënë të gjitha forcat e tyre për të shtypur popujt tanë. Askush nuk e ndan popullin tonë nga populli bullgar, nga popujt e tjerë sllavë si dhe nga gjithë popujt e tjerë të Ballkanit.

Por imperialistët dhe agjentët e tyre janë përpjekur të na ndajnë, të na copëtojnë dhe të na armiqësojnë me njëri-tjetrin, se kështu ata do të na sundonin më mirë e do të na pinin gjakun.

Historia e vërtetë e popullit tonë dhe jo ajo e shkruar prej spiunëve të imperialistëve, jo ajo e imperialistëve italianë, fashistëve ose imperialistëve të tjerë, tregon se populli ynë ka dashur dhe është përpjekur që të rrojë në miqësi me popujt e Ballkanit dhe të gjitha prirjet janë që ai të rrojë në bashkëpunim dhe i vëllazëruar.

Armiqtë e popullit tonë kanë pas ngritur në sistem ndjenjën e shovinizmit e të nacionalizmit të kalbur borgjez dhe tradhëtarët e spiunët si Gjergj Fishta e të tjerë, tërë jetën e tyre kanë punuar të na ndajnë e të na ar-

miqësojnë me ata popuj, me të cilët ne ishim vëllezër dhe që në ditët e para të luftës sonë u bashkuam me gjithë forcat tona.

Këto rezultate ne i dimë si u arritën, në saje të kujt fituam lirinë, vendosëm në vendin tonë demokracinë popullore dhe bëmë që populli të jetë zot i fateve të tija. Ne e dimë se të gjitha këto i kemi në saje të ndihmës së Bashkimit të lavdishëm Sovjetik, të luftës së Ushtrisë heroike Sovjetike dhe të udhëheqësit të saj, mësonjësit të shquar dhe të lavdishëm të proletariatit të përbotshëm dhe të gjithë popujve punëtorë të botës, Stalinit të madh.

Ne e fituam luftën kundër fashizmit se ne i grumbulluam të gjitha forcat tona rreth Bashkimit të madh Sovjetik. Edhe sot e tutje dhe kurdoherë ne do të fitojmë mbi imperializmin, mbi shërbëtorët e tyre, mbi monarko-fashistët grekë, mbi neofashistët italianë, sepse forcat tona janë të bashkuara më shumë se kurrë dhe luftojnë për paqen e demokracinë me vendosmërinë më të madhe.

Marrëveshja e popullit tonë me popullin e Bullgarisë së re bën një forcë të pathyeshme në kampin e fuqishëm demokratik antiimperialist. Popujt tanë do të jenë kurdoherë zgjuar, gati për të mbrojtur interesat e tyre kundër atyre që kërkojnë të na kërcënojnë lirinë, integritetin e vendeve tona dhe të dëmtojnë interesat e popujve tanë.

Imperialistët nuk do të mundin më të futin duart në Ballkan e të ngatërrojnë vendet tona. Ata i kanë futur duart e tyre gjer në bërryl në Greqi, ata i kanë shpalitur luftë dhe luftojnë me forcat e tyre kundër popullit vëlla grek, kundër ushtrisë demokratike. Por populli ynë luftën e popullit grek kundër monarko-fashistëve dhe

imperialistëve amerikanë dhe anglezë e shikon me simpati të madhe, pse populli grek derdh gjak dhe lufton për lirinë e tij dhe për të vendosur pushtetin e tij popullor.

Detyra e popullit tonë, pra, është që të vërë të gjitha forcat që këto marrëveshje të zbatohen në jetë.

Populli ynë e populli bullgar, me të cilin ne u lidhëm sot, janë të sigurtë për të ardhmen e tyre.

Me gëzim të madh i transmetoj popullit tonë përshtendetjet më vëllazërore të popullit vëlla bullgar, të qeverisë së tij dhe të Dimitrovit. Ne u pritëm në Bullgari, në Sofje, në çdo qytet ku vamë, në fabrikat që vizituam, me krahë hapët dhe kudo shprehej një dashuri e singertë dhe e madhe ndaj popullit tonë, një vendosmëri për të jetuar në një miqësi të ngushtë, të bashkuar e të vëllazëruar, për të ndërtuar së bashku të ardhmen tonë më të mirë dhe të përbashkët.

Të rrojë populli bullgar dhe kryetari i tij i shquar, Gjergj Dimitrovi!

Të rrojë Bashkimi i madh Sovjetik dhe kryetari i tij i lavdishëm, Gjeneralisimi Stalin!

Rroftë populli shqiptar!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 928,
20 dhjetor 1947*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 928,
20 dhjetor 1947*

MESAZH DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR ME RASTIN E VITIT TË RI 1948

1 janar 1948

Popull shqiptar,

Motra dhe vëllezër të dashur,

Jam shumë i lumtur t'ju uroj nga zemra një vit plot suksese të reja, plot gjëzim e lumturi, për të gjithë ju dhe për atdheun tonë të dashur.

Me plot besim në të ardhmen e lumtur, të bashkuar rreth Frontit Demokratik dhe me Partinë tonë në krye, të mbështetur në pushtetin tonë popullor, fitorja më e madhe e Luftës sonë nacional-çlirimtare, ne hyjmë në vitin e katërt të lirisë, të pavarësisë dhe të sovranitetit tonë.

Viti 1947 ka qenë viti i përpjekjeve të mëdha për ndërtimin e atdheut tonë të dashur, viti i kapërcimit të shumë vështirësive në rrugën tonë, por edhe një vit i mbushur plot suksese dhe realizime të rëndësishme. Viti 1947 është i rëndësishëm për ne, sepse shënon në jetën e vendit dhe të popullit tonë të parin vit të ndër-

timit ekonomik, kultural dhe arësimor në bazë të planit të shtetit. Masat e gjera punonjëse, punëtorët, fshatarët, të rinxjtë e të rejat, anembanë Shqipërisë kanë qenë të mobilizuar për realizimin e këtij plani, duke e kuptuar dhe duke e bërë këtë një çështje nderi dhe patriotizmi, një çështje që lidhej ngushtë me të ardhmen e lumtur dhe me sigurimin e vendit tonë.

Viti 1947 në fushën e marrëdhënjeve tona ndërkombëtare, karakterizohet nga suksese të mëdha, që i sigurojnë popullit tonë të ardhmen e tij: lirinë, pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin tokësor të vendit tonë. Miqësia jonë me Bashkimin e pathyeshëm Sovjetik, mbrojtësi i paqes, i lirisë dhe i demokracisë në të gjithë botën, i udhëhequr nga Stalini i madh, miku më i dashur dhe më i shtrenjtë i popullit tonë, është bërë më e thellë.

Ne jemi lidhur me miqësi me popujt e Jugosllavisë së re.

Ne jemi lidhur me popullin vëlla të Bullgarisë së Dimitrovit me një aleancë të fortë dhe vëllazërore dhe me marrëdhënje miqësore me të gjithë popujt demokratikë. Të gjitha këto kanë qenë dhe janë një kontribut i vlefshëm i popullit tonë në kampin antiimperialist e demokratik për forcimin e paqes dhe të demokracisë së vërtetë në Ballkan dhe në botë. Në këtë rrugë suksesesh na është dashur t'u bëjmë ballë shumë intrigave dhe manevrave të poshtra të imperialistëve amerikanë dhe anglezë si dhe të agjentëve të tyre brenda dhe jashtë vendit tonë. Por këto s'kanë bërë tjetër veçse të rritin më shumë këto suksese dhe të shtojnë më tepër urrejtjen dhe vendosmërinë në luftë të popullit tonë kundër imperialistëve dhe nxitësve të një lufte të re.

Popull shqiptar, motra dhe vëllezër të dashur,

Ne hyjmë në vitin e ri 1948 me një seri realizimesh, që i kanë siguruar popullit tonë baza të shëndosha për të ardhmen e tij të lumtur; por përpala nesh dalin gjithashtu detyra të mëdha dhe të rëndësishme. Populli ynë duhet të mobilizojë të gjitha forcat e tij të gjalla për t'i kryer me ndër e me sukses këto detyra. Përpala nesh kemi planin e shtetit të vitit 1948; realizimi i këtij plani është detyrë për të gjithë qytetarët e Republikës sonë Popullore, nga më i madhi gjer te më i vogli. Ai do të kërkojë sakrifica, përpjekje dhe punë të palodhur nga të gjithë.

Forcimi i pushtetit tonë popullor dhe kryerja e planit të shtetit nga ana e punëtorëve në fabrika e kantiere, nga ana e fshatarëve me shtimin e tokave të mbjella dhe me kultivimin sa më të gjerë të bimëve industriale dhe të gjithë detyrave të tjera që u vihen masave të popullit, në lidhje me këtë plan, duhet të karakterizojnë punën tonë të përditshme gjatë vitit 1948.

Në këto përpjekje për forcimin e gjithanshëm të vendit tonë na vihet detyra që të forcojmë dhe të çelnikosim sa më shumë miqësinë dhe vëllazërimin tonë me Bashkimin Sovjetik, të forcojmë dhe të çelnikosim sa më shumë bashkëpunimin dhe vëllazërimin me popujt vëllezër të Jugosllavisë së re, të Bullgarisë së Dimitrovit dhe me të gjithë popujt e tjerë demokratikë. Të qëndrojmë të paepur, të godasim pa mëshirë manevrat e imperialistëve skallavërues amerikanë dhe anglezë dhe të këlyshëve të tyre që përpilen të prishin paqen dhe të ndezin një luftë të re, duke bashkuar dhe duke vënë

të gjitha forcat tona në balancën e kampit të pathyeshëm antiimperialist dhe demokratik, koka e të cilit është Bashkimi i madh Sovjetik që udhëhiqet nga mësuesi ynë i madh, Gjeneralisimi Stalin.

Në rrugën për ndërtimin e së ardhmes sonë të sigurtë, ku na udhëheq Partia jonë heroike, të grumbulluar dhe të bashkuar fort në Frontin Demokratik, të të gjithë popullit tonë, ju uroj, motra dhe vëllezër të dashur, vitin e ri 1948, si vit pune dhe suksesesh të reja për lumturinë e atdheut tonë të dashur!

Rroftë populli shqiptar!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 938,
1 janar 1948*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 938,
1 janar 1948*

**FJALA E MBAJTUR NË KUVENDIN POPULLOR
ME RASTIN E RATIFIKIMIT TË TRAKTATIT
TË MIQËSISE, BASHKËPUNIMIT DHE NDIIHMËS
RECIPROKE SI DHE TË KONVENTËS
KULTURALE MIDIS RP TË SHQIPERISE
DHE RP TË BULLGARISE**

3 janar 1948

Shokë deputetë,

Kam nderin të paraqes në emër të Qeverisë së Republikës sonë Popullore, për ratifikim, Traktatin e miqësisë, bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke midis Republikës sonë Popullore dhe Republikës Popullore të Bullgarisë, gjithashtu edhe Konventën kulturale në mes të dy vendeve tonë.

Traktati që ne nënshkruam, ka një rëndësi të madhe për të dy popujt tanë, për popujt e Ballkanit dhe për të gjithë popujt e Evropës, pse ai lidh popullin shqiptar dhe bullgar me një miqësi dhe vëllazërim të pathyeshëm, pse ai mbron paqen në Ballkan dhe forcon kampin demokratik e antiimperialist e fuqizon veprën e madhe të popujve demokratikë dhe liridashës kundër nxitësve të luftës, kundër atyre që kërkojnë të prishin paqen në botë dhe që përpiken me të gjitha mjetet që

të mos arrihet një paqe e shëndoshë me të vërtetë demokratike, që kërkojnë të hedhin botën në një luftë të tretë, për të shtypur popujt dhe për t'u rrëmbyer këtyre fitoret, lirinë, pavarësinë dhe të drejtat që kanë fituar me gjak, me vuajtje dhe me sakrifica gjatë luftës së madhe antifashiste.

Traktati që ne nënshkruam me qeverinë bullgare, shpreh ndjenjat dhe aspiratat e të dy popujve tanë dhe forcon e çelnikos miqësinë e vjetër tradicionale. Ky traktat, sikundërqë e dini të gjithë, u prit me entuziazëm të madh nga të dy popujt tanë dhe u përshëndet nga të gjithë popujt demokratikë të botës. Dëshiroj të përsëris, se delegacioni i qeverisë së Republikës sonë u prit nga populli vëlla bullgar, nga qeveria e tij dhe kryetari i qeverisë, shoku Dimitrov me gjëzim të papërshkruar dhe mikpritje shumë të përzemërt. Kjo do të thotë se populli vëlla bullgar, ushqen një dashuri dhe simpati të madhe për popullin tonë, me të cilin ai dëshiron të rrojë në vëllazërim dhe në një unitet të fortë. Entuziazmi, dashuria, simpatia për popullin tonë, shprehej në çdo fytyrë. Ishte njëkohësisht e qartë se populli vëlla bullgar e kuptonte rëndësinë e këtij akti, të këtij traktati që ne nënshkruam. Po kjo gjë ngjau edhe në popullin tonë. Kudo në Shqipëri, traktati me Bullgarinë popullore u prit me entuziazëm të madh, sepse ky është një garanci tjetër e shëndoshë për mbarëvajtjen dhe lulëzimin e vendit tonë, një besim që shtohet në zemrën e popullit tonë, sepse zgjeron dhe forcon miqësinë e popullit tonë me popujt e tjerë miq dhe vëllezër të Ballkanit.

Ky traktat, sikundërqë e dini u nënshkrua pas

traktatit që ne kemi nënshkruar me popujt e Jugosllavisë, me Republikën Popullore Federative të Jugosllavisë. Traktati me popullin bullgar, e forcon edhe më tepër marrëveshjen që ne kemi me Jugosllavinë. Këto marrëveshje dhe traktate u arritën në saje të përpjekjeve dhe të luftës së popujve tanë. Ato kanë një frymë vëllazërimi dhe bashkëpunimi.

Imperialistët, fashistët dhe armiqtë e brendshëm të vendeve tona, qindra vjet me radhë janë përpjekur dhe kanë luftuar kundër popujve tanë, që këta të fundit të mos hynin kurrë në rrugën e miqësisë, pse atëhere imperialistët do të kishin humbur çdo gjë. Por popujt tanë e fituan këtë betejë të madhe, ne e bëmë këtë vëllazërim dhe do ta forcojmë dita-ditës për të mirën e popujve tanë.

Fitoret e popujve tanë, demokracitë popullore, marrëveshjet dhe aleancat që lidhen në mes të popujve tanë dhe që kanë për qëllim të vërtetë të sigurojnë e të forcojnë paqen në botë dhe të sigurojnë popujt tanë nga çdo agresion eventual që mund t'i kërcenojë, nuk u pëlqejnë imperialistëve skllavërues anglo-amerikanë dhe këlyshëve të tyre monarko-fashistëve grekë e neofashistëve italianë. Të gjithë e dimë nga eksperiencia e së kaluarës sonë të hidhur dhe këtë nuk do ta harrojmë kurrë si kanë qenë të shtypur dhe të shfrytëzuar popujt tanë nga imperialistët e huaj dhe xhelatët e brendshëm. Ne nuk do të harrojmë kurrë si u fuqizua fashizmi dhe tmerret që pësuam nga fashistët gjermanë e italianë dhe nga kuislingët. Ne dimë t'i dallojmë çakejt imperialistë që nën maska të ndryshme përpinqen të skllavërojnë botën. Ne nuk mund të lejojmë që të bëhen lëshime

dhe gabime që të dëmtojnë qoftë edhe pak veprën e madhe të popujve tanë. Neve nuk na lejohet që të mos u sigurojmë qind për qind popujve tanë, të ardhmen e lumtur, pavarësinë, lirinë dhe integritetin tokësor. Kjo gjë do të bëhet duke qenë kurdoherë vigjilentë, të pre-gatitur dhe të gatshëm për të goditur pa mëshirë armiqtë e demokracisë, të paqes dhe të lirisë së popujve.

Kampi demokratik dhe antiimperialist zhvillon sot një luftë të ashpër kundër forcave të errëta skllavëruese të imperialistëve amerikano-anglezë dhe shërbëtorëve të tyre. Populli ynë i vogël po lufton me të gjitha forcat e tija kundër këtyre skllavëruesve të popujve dhe armiqve të paqes e të demokracisë. Populli ynë pa asnjë rezervë është në kampin e fuqishëm demokratik dhe antiimperialist. Imperialistët janë lëshuar nga zinxhirët dhe përpiken me të gjitha forcat e tyre që të mos arrihet një paqe e vërtetë demokratike, ashtu sikundër janë marrë vendime në konferencat e mëdha që janë mbajtur gjatë luftës dhe në mbarim të luftës. Imperialistët shkelin paturpësisht çdo vendim të marrur më përrpara. Imperialistët përpiken të mëkëmbin Gjermaninë hitle-riane, të forcojnë reaksionin, ta armatosin dhe ta hedhin në luftë kundër Bashkimit Sovjetik si edhe kundër demokrative popullore.

Përrpara këtyre armiqve, të egër dhe qëllimeve të tyre ne duhet të qëndrojmë të paepur, të forcojmë pozitat tonë, të forcojmë miqësinë, vëllazërimin, bashkëpunimin në mes popujve tanë dhe të jemi kurdoherë të gatshëm dhe të pamëshirshëm për të goditur tentativat e tyre të poshtra, manevrat, intrigat, shantazhet e kërcënimet. Për të fuqizuar mbrojtjen e popullit tonë dhe

të paqes në botë, bëhen traktate si ky që ratifikojmë sot. Ne jemi në rrugën tonë të drejtë dhe me mish e me shpirt këtë rrugë do ta mbrojmë. Populli ynë do ta vërë në jetë këtë vijë, do t'i zbatojë gjer në fund këto angazhime që merr ndaj vëllezërve dhe aleatëve. Ne jemi të sigurtë se në këtë rrugë që po ndërtojmë e që po e forcojmë, do të dalim fitimtarë, sepse jemi më të fuqishëm, pse kampi demokratik e antiimperialist është një forcë e madhe nga çdo pikëpamje, pse në krye të tij është Bashkimi Sovjetik dhe rreth Bashkimit Sovjetik janë gjithë popujt përparimtarë e liridashës të botës dhe në radhë të parë demokracitë popullore.

Armiqtë kanë thënë dhe do të thonë se ky traktat, që ne kemi nënshkruar me Bullgarinë ka qëllime të errëta, ka qëllime agresioni e të tjera. Ata le të thonë ç'të duan. Në traktat qëllimet tona janë të qarta, janë të shkruara në kartë dhe këto janë qëllimet tona dhe s'ka të tjera. Ne nuk do të lejojmë në asnje mënyrë qëjeta, liria, pavarësia e demokracia e vendit tonë të cënohen. Këtë nuk do ta lejojmë.

Prandaj të brohorasim këtë marrëveshje që kemi bërë me qeverinë e Bullgarisë dhe me popullin vëlla bullgar.

Të rrojë populli vëlla bullgar dhe miqësia, vëllazërimi e bashkëpunimi i popullit tonë me popullin vëlla bullgar!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 941,*

4 janar 1948

Botohet sipas tekstit të gazetës «Bashkimi», Nr. 941,

4 janar 1948

**FJALA E MBAJTUR NË KUVENDIN POPULLOR,
ME RASTIN E SHQYRTIMIT DHE APROVIMIT
TË PROJEKTLIGJIT MBI PLANIN E SHTETIT
PËR VITIN 1948**

27 janar 1948

Shokë deputetë,

Qeveria e Republikës Popullore po i paraqet sot Kuvendit Popullor për shqyrtim dhe aprovim projektligjin mbi planin e shtetit për vitin 1948, i cili do të jetë faktor i rëndësishëm për zhvillimin dhe forcimin e ekonomisë sonë. Është i dyti vit ky që, pas çlirimit të plotë të atdheut tonë nga robëria e fashizmit okupator dhe e veglave të tija të brendshme, ekonomia jonë ecën në rrugën e një ekonomie të planifikuar. Zhvillimi i planifikuar i ekonomisë është një sukses i madh për popullin dhe për vendin tonë. Nga një ekonomi e prapambeatur dhe e dëmtuar rëndë nga lufta e ashpër kundër okupatorit, sot ekonomia jonë jo vetëm që u rimëkëmb me hapa të shpejtë e të sigurtë dhe bëri përparime të ndieshme, por ajo hyri edhe në rrugën e planifikimit që do të thotë sigurimi i plotë i suksesit për zhvillimin, modernizimin e forcimin e ekonomisë sonë dhe për

ngritjen kështu të standardit të jetës së masave të popullit punonjës.

Një zhvillim i tillë i ekonomisë sonë dhe qëllimet e larta të këtij zhvillimi janë të lidhura ngushtësisht me Luftën nac.-çl., që bëri populli ynë, me fitoret e tij dhe me ruajtjen e forcimin e këtyre fitoreve. Një ekonomi e tillë që zhvillohet vetëm në interesin e masave të popullit dhe jo në interesin e një pakice gjakpirësish feudalë, kapitalistë dhe spekulatorë të ndryshëm, është fryt i vendosjes së demokracisë popullore në vendin tonë dhe i marres së pushtetit në duart e sigurta të popullit. Demokracia jonë popullore, për vendosjen e së cilës populli ynë luftoi me ashpërsinë më të madhe vjete me radhë kundër armiqve të betuar të demokracisë dhe të njerëzimit përparimtar, u forcua në përpjekje të ashpra dhe të vazhdueshme me forcat e errëta të imperializmit dhe të fashizmit. Ajo u forcua në luftën kundër tradhëtarëve kukslingë, kundër zgjedhës feudale të çifliksahibinjve, kundër tregëtarëve kapitalistë të mëdhenj, kundër industrialëve spekulatorë, kundër borgjezisë reaksionare dhe shërbëtorëve të saj. Demokracia jonë popullore u forcua në luftë kundër intrigave dhe komplateve të kurdisura nga imperialistët anglo-amerikanë dhe spiunët e tyre shqiptarë që kërkonin t'i bënин varrin demokracisë sonë popullore dhe, pra, popullit tonë. Për popullin tonë heroik, që u mobilizua si një trup i vetëm në Frontin Nac.-Çl. nën drejtimin e Partisë Komuniste dhe që u hodh pa rezerva në luftë, marrja e pushtetit në duart e tij dhe fjala demokraci kishin një kuptim të madh. Këto ishin objektiva të domosdoshme që duhesh të arrinte ai pa marrë parasysh

edhe sakrificat më të mëdha, pse, me arritjen e këtyre objektivave, populli ynë do të siguronte përgjithnjë të ardhmen dhe këtë të ardhme të lumtur do ta ndërtonte me duart dhe me djersën e tij, ashtu si e kuptonte dhe e ndjente ai vetë.

Populli ynë i vogël, duke qenë konsekuent në vepren e tij të pavdekshme dhe i qartë në rrugën që ndiqte për rindërtimin e vendit dhe të jetës së tij, pér forcimin e rendit demokratik të vërtetë, pér mbrojtjen e paqes së drejtë demokratike, pas çlirimt të plotë të Shqipërisë, vazhdoi me vendosmërinë më të madhe luftën e tij aktive dhe të ashpër kundër forcave të reaksionit të brendshëm dhe të jashtëm, kundër atyre që kërkonin të grabitnin fitoret e tij, kundër atyre që donin, duan dhe pregatitin luftën. Populli ynë mori një seri masash pér të zhdukur nga rrënjet fashizmin dhe mbeturinat e tij në vendin tonë. Këto ishin masa të domosdoshme pér të mbrojtur interesat jetike të masave të gjera punonjëse të vendit dhe pér të shkuar pérpara. Por nuk mjaftonte të zhduknim fizikisht dhe pa mëshirë banditët fashistë dhe tradhëtarët e vendit, por duhej të zhduknim përgjithmonë bazën sociale dhe ekonomike të tyre, që përbëhej nga tokat e gjera nën sundimin e bejlerëve latifondistë dhe nga kapitali tregëtar.

Populli me pushietin e tij, që është një fitore e madhe e Luftës nac.-çl., i mori përnjëherë këto masa dhe zbatoi reformat e mëdha ekonomike dhe sociale që dihen prej të gjithëve. Me zbatimin e këtyre reformave të mëdha të pushtetit popullor u shpronësuant tokat e bejlerëve dhe të agallarëve dhe bujku shqiptar u bë zot i tokës që ai punonte. Nga ana tjetër u hodhën bazat

dhe u forcua sektori i ri shtetëror. Ky sektor u krijua me nacionalizimin e minierave të vendit, pasuria e paçmueshme e Shqipërisë, që kishte shërbyer për pasurimin e fashizmit italian dhe të shërbëtorëve të tij si dhe me nacionalizimin e fabrikave dhe të të gjitha mjeteve kryesore të prodhimit, që ishin në duart e industrialëve dhe të tregëtarëve të mëdhenj kapitalistë. Këta jo vetëm që e humbën pasurinë e tyre, e cila u bë pronë e popullit punëtor, por u detyruan të paguajnë deri në një tatimet e jashtzakonshme të luftës. Kështu u eliminuan postet komanduese që mbanin bejlerët, tregëtarët e mëdhenj kapitalistë dhe borgjezia pasanike në ekonominë e vjetër, u zhduk zotrimi i tyre shfrytëzues. Këto klasa humbën përgjithmonë pushtetin politik dhe atë ekonomik. Populli ynë u bë zot i fateve të tij. Pushteti kaloi në duart e tij pas një lufte të përgjakshme; u ndryshuan marrëdhënjet e vjetra kapitaliste në prodhim, që bazoheshin mbi shfrytëzimin total të masave punonjëse dhe u ndërtuan marrëdhënje të reja prodhimi në baza socialiste; u ndryshuan marrëdhënjet ndërmjet industrisë dhe bujqësisë. Bujqësia, që i nënshtrohej interesave të kapitalit industrialo-tregëtar, tanë krijoj me industrinë marrëdhënje të tilla, që mbështeten në ndihmën reciproke dhe në përbushjen e nevojave të tyre. U ndryshua tregëtia dhe roli i saj. Në vend të ndërmjetësit, tregëtarit të madh kapitalist, që shfrytëzonte popullin punonjës dhe vinte pasuri kolosale, ne kemi sot një tregëti shtetërore, kooperativiste, si dhe tregëti të vogël private, detyra e të cilëve është që, me shpenzime minimale të kryejnë sa më mirë dhe qarkullimin e mallit, të furnizojnë masat punonjëse të qytetit

dhe të fshatit me prodhimet industriale dhe të grumbullojnë prodhimet bujqësore për të bërë një shpërndarje të drejtë dhe të shpejtë në interesin e masave të gjera të popullit punonjës.

Me të gjitha këto masa, filloi rindërtimi i vendit, filloi të ngrihej dhe të forcohej në baza të reja ekonomia jonë popullore. Reformat shoqërore dhe ekonomike, që u realizuan, patën për qëllim ta bënин ekonominë tonë t'i përshtatet superstrukturës së re politike, që është shteti ynë në shërbim të plotë të popullit punonjës dhe arma e sundimit të masave popullore e punonjëse të vendit, d.m.th. arma e punëtorëve, e fshatarëve dhe e intelektualëve patriotë e progresistë. Demokracia jonë popullore dha prova të shëndosha. Detyrat e rënda, që ju vunë përpëra popullit tonë dhe pushtetit të tij, që në ditët e para të pasluftës, ai i kreua me sukses. Detyrat ishin të rënda dhe të zorshme, por kurrë në historinë e vendit tonë nuk është parë një mobilizim kaq i madh i popullit për ndërtimin e jetës së re e të lirë në atdheun indipendent dhe sovran. Energjitetë e pashteruara të popullit tonë, që dha prova të shkëlqyera në fushën e luftës, bënë mrekullira të tjera edhe në kohën e paslufës. Populli që luftoi për lirinë dhe demokracinë provoi në luftë dhe në punë sa të mëdha dhe të fuqishme ishin forcat e tija dhe me besim të madh në këto forca ai po vazhdon tani rrugën për ndërtimin e jetës së tij më të mirë.

Të gjitha këto ndryshime themelore, që u bënë në vendin tonë në këtë periudhë relativisht të shkurtër, janë rezultat i fitoreve të Luftës sonë nac.-çl. Vendosja e demokracisë popullore në vendin tonë, marrja e push-

tetit në duart e popullit dhe reformat e mëdha me karakter ekonomik dhe shoqëror e ndryshuan krejtësisht faqen e vendit tonë. Me këtë rrugë zhvillimi të vendit tonë nuk janë armiqtë e popullit, të gjithë fashistët dhe spiunët, të gjithë ata që trupin e kanë këtu, por shpirtin e kanë të skllavëruar te kapitali dhe te imperializmi, të gjithë ata që kanë frikë nga populli, që s'e durojnë dot sundimin e drejtë të tij, që s'mund t'i durojnë dot fitoret e popullit, të gjithë ata borgjezë shovinistë dhe pseudodemokratë që, me liri dhe pavarësi, kuptojnë «lirinë dhe pavarësinë» nën thundrën e imperializmit amerikan, nën thundrën e bejlerëve, të tre-gëtarëve kapitalistë dhe të spekulatorëve për të rikthyer kohën e vjetër të robërisë në kurriz të masave popullore dhe të punonjësve të vendit tonë. Por koha e këtyre ka perënduar përgjithmonë dhe tentativat e tyre janë pa shpresë dhe të destinuara të falimentojnë dhe të mbyten në vezë. Këta tradhëtarë të popullit dhe spiunë të imperialistëve amerikanë janë për planin Marshall, për planin robërues të imperializmit amerikan që synon të skllavërojë popujt e Evropës dhe të botës, që t'i futë këta nën kthetrat dhe nën çizmen e tij të hekurt dhe të krijojë konditat për një kasaphanë të tretë kundër popujve përparimtarë, kundër Bashkimit Sovjetik, kundër demokrative popullore, kundër njerëzimit përparimtar dhe progresist. Populli ynë është me të gjitha forcat e tija kundër planit skllavërues Marshall dhe lufton me të gjitha fuqitë e tija kundër manevrave të imperializmit amerikan dhe të satelitëve të tij, se për popullin tonë liria, pavarësia, sovraniteti janë gjëra të shenjta, pa të cilat ai nuk mund ta ketë jetën.

Në vitin 1947 ne dolëm me planin e parë njëvjeçar unik për gjithë vendin dhe sot do të aprovojmë planin e dytë njëvjeçar të vitit 1948, i cili do të jetë një mbësh-tetje e madhe për preqatitjen në të ardhmen të planit vazhdues pesëvjeçar, që do t'i çelë popullit tonë rrugën e zhvillimit dhe të përmirësimit të jetës së tij.

Plani i vitit 1947 u bë një faktor i madh rrëgullues për të gjithë sektorët e ekonomisë së vendit. Për realizimin e tij, u mobilizuan gjatë vitit me mijëra e mijëra punëtorë dhe punëtore, që dualën nga gjiri i popullit tonë dhe u arritën rezultate të kënaqshme, u kaluan shumë vështirësi e pengesa dhe megjithëse ishte viti i parë që ekonomia jonë drejtohej në bazë të një plani, sukseset kanë qenë të mëdha. Klasa jonë punëtore, të gjithë masat punonjëse të vëndit dhe të gjithë funksionarët e shtetit i priten dhe i kryen me gëzim dhe entuziazëm detyrat që u vinte përpëra plani i vitit 1947. Me iniciativën e tyre krijuese, me vullnetin dhe disiplinën në punë ata bënë që brenda vitit të realizoheshin një seri veprash të mëdha e të vogla, të cilat do të jenë një mbështetje e madhe në forcimin e ekonomisë, në shtimin e prodhimit dhe në ngritjen e standardit të jetesës së popullit. Në saje të punës së madhe të rinisë sonë heroike u ndërtua në vendin tonë hekurudha e parë prej 43 km. Duke përballuar të gjitha vështirësitë e hasura dhe me përpjekjet e sakrificat e punëtorëve tanë, ne patëm rezultate të rëndësishme në ngritjen e fabrikave të reja që caktonte plani i vitit 1947 dhe në shfrytëzimin racional të industrisë sonë dhe të të gjitha minierave, të cilat kanë qenë një faktor i rëndësishëmi në shtimin e përmirësimin e prodhimit. Kështu që pro-

dhimi i naftës, që është një bazë e rëndësishme për ekonominë tonë arriti në 179% në krahasim me vitin 1946 dhe prodhimi i bitumit në 105%. Bujqësia, që është bazë kryesore për ekonominë tonë, ka pasur përparrime të dukshme gjatë vitit 1947 në krahasim me paraluftën. U mbuall një sipërfaqe prej 305 000 ha. që do të thotë 38% më tepër se në vitin 1938. Fshatari punonjës dëgjoi thirrjen e pushtetit dhe të Frontit Demokratik, për një mobilizim total për të mbjellë sa më shumë toka dhe për të marrë prodhime sa më të mëdha. Pushteti, me anën e investimeve të mëdha në bonifikime, ka ndihmuar në shtimin e sipërfaqes së tokës së punuar. Ky vit na ka dhënë vepra të rëndësishme në bonifikime, si kanali për tharjen e kënetës së Maliqit, i cili na dha një sipërfaqe të re toke prej 4 530 ha., kanali vaditës «Naum Panxhi», i cili do të ujitet dhe do të shpëtojë nga thatësira e verës një sipërfaqe mbi 2 000 ha., e të tjera vepra të tillë që do të luajnë një rol të madh në shtimin e prodhimit.

Një rëndësi e veçantë i është vënë zhvillimit të arësimit dhe të kulturës së popullit. Numri i shkollave fillore arriti në 1 751 dhe i nxënësve në 151 817 që do të thotë 292% në krahasim me paraluftën. Në kurset kundër analfabetizmit mësuan shkrim e këndim 59 900 vetë, nga shkollat e mesme mbaruan 540 vetë dhe jashtë shtetit, me bursë, mbaruan 328. Këto shifra tregojnë sukseset dhe interesimin e madh të pushtetit popullor për këtë sektor të rëndësishëm.

Organizimi i luftës kundër gjithë sëmundjeve ngjittëse dhe veçanërisht luftimi i malarjes ka qenë i mirë. Gjatë këtij viti janë ndërtuar dhe adaptuar godina të

reja për spitale dhe institute të tjera shëndetësore, është shtuar kapaciteti i tyre duke arritur numri i shtretërve në 2 790, shifër kjo që do të thotë 380% në krahasim me paraluftën.

Gjatë vitit 1947 me rëndësi ka qenë organizimi ekonomisë sonë në baza të reja planifikuese. U organizuan të gjitha ndërmarrjet shtetërore në baza të reja dhe u shkëputën nga centralizimi burokratik që ndalonte zhvillimin dhe iniciativën e tyre. Hyri në fuqi një strukturë e re çmimesh dhe sistemi unik i çmimeve, i cili ka qenë një bazë e rëndësishme për rregullimin e jetës së popullit. Realizimet e planit të vitit 1947 përmirësuan konditat e jetës së popullit. Ngritja e rrogave të punëtorëve dhe të nëpunësve, aplikimi i ligjit të rëndësishëm të sigurimeve shoqërore për punëtorët e nëpunësat, aplikimi i çmimeve të arësyeshme në prodhimet bujqësore dhe ngritja e racionit të bukës, janë rezultate të dukshme, të realizuara në saje të përpjekjeve të gjithanshme të masave punonjëse të vendit tonë.

Të gjitha këto realizime, që në vija të përgjithshme u përmendën dhe të tjera si këto, tregojnë forcën e madhe të popullit tonë dhe në të vërtetë janë suksese të mëdha dhe hapa të dukshëm përpëra për ekonominë tonë popullore. Këto janë një grusht i shëndoshë për armiqtë tanë të brendshëm dhe të jashtëm, që kritikojnë dhe tallen me planet tona dhe shfaqin mosbesim e dyshime në forcat e popullit tonë. Por do të ishte gabim i madh, sikur ne të kënaqeshim dhe të deheshim nga këto suksese dhe të mos shihnim mirë të metat dhe mungesat, nga të cilat gjatë këtij viti ka pasur mjaft.

Një e metë e dukshme ka qenë mosrealizimi i një-

llojtë i planit në të gjithë sektorët. Shumë kuadro dhe ndërmarrje kanë gjetur pretekste për të justifikuar këto mungesa. Mirëpo e vërteta është se këta nuk kanë bërë përpjekjet e duhura për të përdorur çdo mjet në përballimin e këtyre pengesave, por janë mjaftuar vetëm me justifikime të thata. Kjo e metë duhet të na shërbejë shumë për këtë vit, pse plani ynë nuk mundet të realizohet pa përpjekje, pa sakrifica dhe pa kapërcyer pengesat. Drejtuesit në sektorët e ekonomisë duhet të njohin mirë konditat tona objektive dhe brenda këtyre konditave duhet të përqëndrojnë të gjitha energjitet e tyre, për realizimin dhe tejkalimin e planit dhe jo vetëm në disa sektore, por në të gjithë sektorët e prodhimit dhe të ndërtimit, duke u bërë një luftë të ashpër të gjithë atyreve, që e teorizojnë çështjen e planit, që flasin për plane të fryra e të mëdha dhe të parealizueshme, që i premtojnë popullit qiellin, por që në realitet nën këto justifikime e pretendime kërkojnë t'i shpëtojnë përgjegjësisë dhe të dëmtojnë rëndë rrugën e drejtë në të cilën ecën ekonomia jonë.

Disiplina e planit nuk ka qenë e fortë e aq sa duhet. Është e vërtetë se disciplina e planit nuk duhet marrë në kuptimin e ngushtë, të humbasë dhe të zhdukët elasticiteti operativ i organeve operative, por nga ana tjetër, duhet kuptuar mirë ky elasticitet dhe të mos spekulohet dhe të mos gabohet në saje të këtij elasticiteti. Plani është ligj e disiplinë për të gjithë dhe të gjithë e kanë për detyrë ta zbatojnë.

Megjithëse janë bërë përpjekje për përmirësimin e jetës së punëtorëve tanë, përsëri, në shumë ndërmarrje dhe kantiere, ka pasur neglizhenca të palejueshme në

këtë drejtim. Nuk është treguar kujdesi i duhur përuajtjen e shëndetit të punëtorëve tanë, për organizimin e jetës së tyre dhe pér zhvillimin e tyre politik dhe kultural. Të tilla neglizhenca nuk duhet të përsëriten këtë vit gjatë realizimit të planit tonë. Të gjitha këto të meta dhe të tjerat që nuk po i përmend dhe që shokët e tjerë do t'i vënë në dukje më konkretisht, janë mundësítë që të përmirësohen. Prandaj le të bëhen mësimë dhe eksperiencë pér të gjithë njerëzit tanë, pér realizimin dhe tejkalimin e planit të ri, që ne sot kemi përrapa dhe që kërkon përpjekje dhe organizim më të shëndoshë pér tu realizuar.

Shokë deputetë,

Duke u mbështetur në forcën e madhe të popullit tonë punëtor, në realizimet e arritura gjatë kësaj periudhe trivjeçare pér ngritjen dhe forcimin e ekonomisë sonë popullore, Qeveria e Republikës parashtron pér aprovim para jush planin e ri të përgjithshëm të shtetit pér vitin 1948.

Sikundër do ta shihni edhe vetë, qëllimet e planit tonë, synojnë zhvillimin dhe forcimin e ekonomisë popullore, ngritjen e përmirësimin e nivelit ekonomik dhe kultural të popullit, ndërtimin e mëtejshëm të vendit dhe forcimin e fuqisë mbrojtëse të atdheut tonë.

Duke i pasur kurdoherë parasysh këto qëllime gjatë vitit 1948 do t'i jepet një rëndësi e madhe shfrytëzimit më të mirë të burimeve tona minerale dhe sidomos naftës dhe bitumit, pér të cilët janë të gjitha mundësítë edhe rezervat. Kështu prodhimi i naftës duhet

të rritet 150% në krahasim me vitin e kaluar, kurse ai i bitumit 107%. Në lidhje me planin tonë perspektiv, në shfrytëzimin e burimeve minerale gjatë vitit 1948 do të bëhen studime dhe kërkime gjeologjike, që do të sigurojnë rezerva të reja për minierat tona, në mënyrë që shfrytëzimi të bëhet më i gjerë në të ardhmen. Të gjitha këto burime të rëndësishme, që deri dje kanë shërbyer për fashizmin italian dhe shërbëtorët e tij, të cilët pregetitën Luftën e dytë botërore dhe skllavërimin e popullit tonë, sot këto shërbejnë për ndërtimin e jetës së re e të lumtur të masave të gjera punonjëse. Nga ana tjetër një shfrytëzim i tillë i madh i burimeve tona minerale do të ndihmojë në zhmadhimin dhe forcimin e klasës sonë punëtore, e cila sot po bëhet forca e sigurtë drejtuese e pushtetit popullor.

Industria jonë ekzistuese deri dje ka qenë në duart e disa kapitalistëve shfrytëzues. Ajo ishte e paorganizuuar, e prapambetur dhe pa asnjë orientim dhe perspektivë. Këtë industri të vogël, planet tona kanë synuar ta përmirësojnë, ta racionalizojnë, ta modernizojnë me sa ka qenë e mundur dhe gjithashtu ta grumbullojnë që të bëhej sa më rentabile, duke shfrytëzuar sa më mirë burimet e vendit. Industrisë sonë të lehtë i janë shtuar dhe do t'i shtohen fabrika të reja moderne si ajo e shëquerit, e lesshit, e pambukut, e litarit, e konservave, e peshkut, e frutave etj., të cilat do të plotësojnë, do të shtojnë prodhimin dhe do të influencojnë në uljen e çmimeve. Një zhvillim i tillë i drejtë i industrisë sonë të lehtë do të ndihmojë për së tepërmri në përmbushjen e nevojave të popullit me prodhime industriale. Veçanërisht rëndësi e madhe duhet t'i kushtohet zhvillimit

e forcimit të industrisë së lëndë ndërtimit, (duke shfrytëzuar të gjitha burimet e vendit, si gurin, baltën, tjequllat, tullat, etj.) dhe industrisë së drurit, të cilat do të jenë një bazë e rëndësishme për ndërtimin e shpejtë të vendit.

Duhet që pushteti lokal t'i japë rëndësi të madhe organizimit dhe forcimit të industrisë lokale, sepse kjo do të bëhet një bazë për zhvillimin e ekonomisë në rrethe. Prandaj duhet të bëhen përpjekje të mëdha që të shfrytëzohen lëndët e para në bazë, të shtohen rezervat lokale, të shtohet prodhimi në ndërmarrjet lokale, të shtohet prodhimi industrial i lëndë ndërtimit dhe i mallrave të konsumit të gjerë. Krijimi i një ekonomie të tillë në rrethe, do të kontribuojë për forcimin e pushtetit lokal.

Plani i vë rëndësi të madhe zhvillimit dhe forcimit të artizanatit, i cili duhet të përfshihet në planin e prodhimit dhe të ndërtimeve të shtetit, të bëhet një forcë prodhuase, që do t'i vijë në ndihmë industrisë sonë për plotësimin e nevojave të vendit. Artizanati do të furnizohet me lëndët e para të nevojshme si dhe me vegla pune në mënyrë që të përmirësohen konditat e punës dhe të prodhimit dhe të rriten aftësitë profesionale të artizanëve. Shteti, pra, do ta inkurajojë, do ta ndihmojë dhe do ta organizojë këtë në kooperativa të prodhimit, me qëllim që prodhimi i tij të kalojë atë të paraluftës në 220%.

Plani i kushton një kujdes të veçantë zhvillimit dhe forcimit të bujqësisë si bazë themelore që është për ekonominë tonë. Më parë fshatari ynë shfrytëzohej pa mëshirë; ai nuk kishte asgjë të siguruar dhe ishte nën mëshirën e beut dhe të agait. Sot fshatari, në saje të

Luftës nac.-çl. është bërë zot i tokës së tij, ai e ka të sigurtë jetën dhe përmirësiinin e saj.

Fshatari punonjës duhet ta ketë të qartë se zhvillimi dhe përmirësimi i bujqësisë sonë, nuk mund të kuptohen të shkëputur nga zhvillimi dhe përmirësimi i gjithë sektorëve të tjerë. Pra, ekonomia fshatare, për të siguruar këtë zhvillim duhet të ecë në rrugën që përcakton plani i shtetit për këtë sektor, pse kështu ajo do të përfitojë sa duhet dhe si duhet nga kujdesi i vencantë dhe i madh që i kushton shteti ynë bujqësisë. Fshatari punonjës nuk është sot një individ i izoluar dhe i shfrytëzuar, por është pjesëtar i gjithë kolektivitetit që punon dhe ndihmon me të gjitha forcat për zhvillimin dhe forcimin e ekonomisë së përgjithshme të vendit. Marrëdhënjet midis fshatit dhe qytetit nuk janë më ato të parat. Fshatari me punëtorin dhe me masat e tjera punonjëse të qytetit, kanë marrëdhënje ndihmë reciproke dhe jo marrëdhënje në baza shfrytëzimi. Duke e parë çështjen kështu, planet tona ekonomike i sigurojnë iniciativën fshatarit tonë punonjës, i sigurojnë ndihmën atij dhe e vënë në radhi të parë zhvillimin e bujqësisë. Pushteti popullor përpinqet me të gjitha forcat për eliminimin e prapambetjes në bujqësinë tonë; këtë e tregojnë investimet e vitit 1948 prej 224 milionë lekë, nga të cilat 137 milionë janë për bonifikime, për forcimin e mekanikës bujqësore, etj.

Duke marrë për bazë rëndësinë e madhe që i jep plani këtij sektori, zhvillimit të mëtejshëm të tij dhe shtimit të prodhimeve bujqësore, sipërfaqja e mbjellë, duhet të arrijë në 328 000 ha. d.m.th. 48% më tepër nga sipërfaqja e mbjellë paraluftës.

Duhet të bëhen përpjekje të mëdha për ngritjen e rendimentit të tokës dhe ky të jetë një problem i rëndësishëm, për të cilin të merren të gjitha masat, si nga organet drejtuese të ekonomisë bujqësore, ashtu dhe nga fshatari punonjës. Të vihen në veprim metoda të reja pune, të bëhen përpjekje të mëdha për perfektionimin e seleksionimin e farës që kjo t'u përshtatet konditave të vendit. Për të siguruar shtimin e sipërfaqes në të ardhmen dhe për të shpëtuar tokën nga përmbytjet gjatë dimrit, një punë e madhe do të bëhet për bonifikimet, duke përfunduar ato të mëdhatë, që kanë filluar dhe duke ndërmarrë edhe vepra të tjera. Por një rëndësi e madhe do t'u jepet bonifikimeve të vogla, të cilat do të janë një faktor i rëndësishëm në lidhje me zhvillimin e iniciativës së masave fshatare për përmirësimin e tokës, për shtimin e sipërfaqes dhe për ujitjen e saj.

Në lidhje me zhvillimin e bujqësisë një vëmendje e madhe t'u kushtohet kooperativave të punës, të cilave do t'u jepen të gjitha ndihmat materiale, organizative dhe profesionale, që këto të transformohen dhe të bëhen me të vërtetë model, për të inkurajuar iniciativën e një pune kolektive të përparuar.

Mekanika bujqësore, e parashikuar në plan, do të vihet në shërbim të fshatarësise dhe veçanërisht në shërbim të kooperativave të punës.

Një rëndësi e madhe do t'i vihet shtimit të bagëtisë në sasi dhe përmirësimit të racës, në mënyrë që të shtohen prodhimet blegtoriale dhe të përmirësohet ushqimi i popullit. Me këto prodhime do të forcojmë gjithashtu eksportimet tona.

Të gjitha këto masa kanë për qëllim shtimin dhe

përmirësimin e prodhimeve bujqësore dhe sigurojnë edhe ngritjen materiale dhe kulturale të fshatarësisë sonë punonjëse. Shteti i merr të gjitha këto angazhime ndaj fshatarit, por edhe fshatari ynë, përpara kësaj ndihme të madhe dhe angazhimeve që merr shteti për përmirësimin dhe forcimin e ekonomisë bujqësore, duhet të përgjigjet duke plotësuar detyrat e tij. Ai duhet të punojë me entuziazëm sa më shumë toka dhe sa më mirë, të zhvillojë iniciativën e tij krijuese dhe të bëjë sakrifica e privacione për interesin e përgjithshëm. Ai duhet të dorëzojë në rregull detyrimet ndaj shtetit dhe të vërë të gjitha forcat që të ndihmojë në realizimin e planit të shtetit. Ekonomia e planifikuar kërkon disiplinë dhe përbushjen qind për qind të angazhimeve që parashikon plani i shtetit.

Në sektorin e ndërtimit plani parashikon punime të mëdha. Gjatë këtij viti do të mbarohen së ndërtuari dhe do të fillojnë nga prodhimi një seri fabrikash që kanë filluar të ndërtohen që në vitin e kaluar, do të ndërtohen ura si dhe ndërtesa banimi për punëtorët dhe për popullin, ndërtesa për zyra, për shkollat, për institute shëndetësore etj. Plani i këtij viti i shton vendit tonë dhe një vijë tjetër hekurudhore me rëndësi: hekurudhën Durrës-Tiranë. Kryeqyteti ynë do të lidhet me rrugë hekurudhore me portin tonë kryesor, gjë kjo që ka një rëndësi të madhe ekonomike dhe hap perspektiva të reja. Imperialistët e ndryshëm okupatorë të vendit tonë e kanë detyruar popullin shqiptar të mos shohë nga deti i tij dhe të mos shfrytëzojë detin në të gjitha pikëpamjet. Armiqtë e popullit tonë janë përpjekur të krijojnë një mentalitet që deri diku është rrënjosur në mendjen e

popullit tonë se: «ky nuk është një popull detar dhe se deti është një gjë e huaj për të». Historia e popullit tonë tregon të kundërtën. Por armiqë e vendit tonë kanë dashur ta eliminojnë popullin shqiptar nga Adriatiku dhe në të, të sundonte imperializmi dhe fashizmi italian. Koha tani ka ndryshuar. Deti për ne do të bëhet një nga vijat e rëndësishme të komunikacionit tonë. Në portet tona, në radhë të parë në Durrës e Vlorë si dhe në Sarandë e Shëngjin, do të bëhen ndërtime të rëndësishme dhe gjithë bregdeti ynë do të lulëzojë, ashtu si do të lulëzojë gjithë vendi ynë. Linja hekurudhore Durrës-Tiranë do të shërbejë për të furnizuar kryeqytetin tonë me materialet e nevojshme për ngritjen e industrisë, dhe për gjithë nevojat e tjera të popullit të kryeqytetit dhe të qendrave të tjera të Shqipërisë. Sikundërqë shihet plani i vë një rëndësi të madhe zhvillimit të komunikacionit. Të orientohemi drejt zhvillimit e shtimit të vijave hekurudhore e detare, të cilat do t'i japid një zhvillim shumë të madh ekonomisë sonë, do të zgjidhin problemin e madh të transportit të brendshëm dhe do të bëjnë që vendi ynë të vijë në kontakt me të gjitha vendet e tjera miq të Ballkanit.

Plani i vë detyra të mëdha përparrë edhe tregëtisë sonë, e cila duhet të zgjerohet dhe të forcohet për të përbushur me sukses qarkullimin e mallrave për konsumin e gjerë të popullit. Të organizohet mirë rrjeti i dyqaneve të shtetit, të shtohet numri i tyre dhe të perfektionohet shërbimi i tyre për popullin. Dyqanet e shtetit, kooperativat e konsumit në qytet dhe kooperativat e shitblerjes në fshat, duhet të përbëjnë një forcë të madhe shpërndarjeje dhe të lehtësojnë qarku-

Ilimin e mallit në të gjitha krahinat. Mallrat e konsumit të gjerë duhet të shpërndahen në të gjitha krahinat proporcionalisht e sipas nevojës dhe kohës. Ndërmarrjet e mëdha tregtare duhet të njojin mirë juridiksonin e tyre, nevojat dhe zakonet e popullit e të bëjnë një politikë të drejtë shpërndarjeje të mallit. Të krijohen marrëdhënje të shëndosha ndërmjet bazave të shpërndarjes dhe magazinave të shitjes dhe të furnizohen në rregull kooperativat e shitblerjes, të cilat do të jenë një mbështetje e madhe jo vetëm për shpërndarjen, por edhe për grumbullimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale. Të organizohet mirë rrjeti i grumbullimeve, të tregohet kujdes në ruajtjen e mallit dhe të bëhen përpjekje të mëdha për pakësimin e firos dhe për uljen e shpenzimeve. Të ngrihet aftësia profesionale dhe teknike në gjithë aparatin e tregëtisë shtetërore.

Të shtohen eksportimet tona dhe të bëhen përpjekje të mëdha nga organet e tregëtisë dhe nga gjithë prodhonjësit për të gjetur burime të reja eksportimi.

Për realizimin e planit neve na duhet, natyrishët, që të mendojmë seriozisht për ngritjen dhe edukimin e kuadrove tanë dhe në këtë drejtim duhet të orientojmë arësimin tonë popullor. Të bëjmë të gjitha përpjekjet që parashikon plani për shtimin e nxënësve në ekonomi, nga të cilët ne do të kemi punëtorë të kualifikuar. Të ngremë një seri të madhe kursesh profesionale, të cilat do të na ndihmojnë të preqatitim kuadro teknikë, punëtorë të kualifikuar, specialistë etj.

Populli ynë duhet ta kuptojë mirë se ngritja dhe forcimi i ekonomisë nuk bëhet pa sakrifica, pa privacione dhe pa kursime. Është detyrë e të gjithëve që të sakri-

fikojnë shumë për të forcuar eksportimin, për të sjellë mjete dhe maqina. Do të ngrihen fabrika dhe vija hekurudhore të reja, do të vijnë mjete dhe maqinceri të ndryshme për minierat dhe për industrinë tonë, prandaj sot për sigurimin e tyre duhet të shtojmë eksportimet tona. Duhet të sakrifikojmë sot, që të jemi mirë nesër.

Parashikimet në plan janë të mëdha, por reale. Plani është bërë brenda mundësive dhe fuqive tona, por përpjekjet dhe lufta që duhet të bëjmë për realizimin e tij, duhet të jenë të mëdha dhe të pandërprera. Plani që kemi përparsa dhe që po e shqyrtojmë, duhet të transformohet nga shifra në vepra. Për këtë gjë duhet të zhvillohet një betejë e madhe që jo vetëm të realizohet, por edhe të tejkalohet. Kjo është një detyrë e madhe për të gjithë njerëzit që do të drejtojnë dhe do të punojnë për realizimin e këtij plani. Plani do të transformohet në vepra me punë dhe me sakrifica, me lodhje dhe me vështirësi dhe jo në mënyrë spontane.

Do të ishte një gabim shumë i madh sikur të mendohet që, me përpilimin e planit në letër dhe me mbarimin e tij nga organet planifikuese, puna ka mbaruar. Përpilimi i planit na çel vetëm rrugën, na konkretizon perspektivën dhe na përcakton konkretisht detyrat, por drejtimi i vërtetë me plan, përpjekjet dhe vështirësitë fillojnë pas përpilimit të tij.

Plani që shtrohet për zbatim është një detyrë e madhe për të gjithë qytetarët punonjës dhe ligj që duhet ta zbatojnë të gjithë. Është detyrë e të gjitha organeve operative që ta marrin e ta analizojnë planin, ta bëjnë të njobur në të gjithë njerëzit dhe të mobili-zohen për realizimin e tij. Plani nuk duhet të mbetet

si instruksion i thjeshtë, as si shifra të thata, por duhet të jetë një forcë e gjallë mobilizuese që me vetëmohim, me sakrifica dhe me disiplinë masat punonjëse duhet ta realizojnë. Nuk mjafton vetëm dëshira për realizimin e tij, por duhet një vullnet i çelniktë, duhet shfrytëzimi i gjithë fuqive të gjalla të popullit dhe gjithë kapaciteti i njerëzve tanë.

Por realizimi i planit paraqet dhe vështirësi. Ne duhet t'i kalojmë këto vështirësi dhe të jemi konshientë për të tilla vështirësi. Prandaj duhet që gjatë zbatimit të planit të parashikohen mungesat dhe vështirësitë dhe të merren masa me kohë.

Puna e çdo individi dhe e çdo kolektivi punonjës, qoftë në fabrikë ose në arë, në hekurudhë ose në zyrë, në shkollë ose në ndonjë institut tjetër, duhet t'i nënshtronhet detyrave të zbatimit dhe të tejkalimit të planit. Çdo punonjës i ynë duhet të njohë mirë qëllimet e mëdha të planit dhe të ketë parasysh detyrat e tij kundrejt planit. Është detyra e propagandës sonë të luftojë për realizimin e planit dhe këtë gjë ta shpjegojë në një mënyrë të thjeshtë që ta kuptojë çdo njeri.

Zbatimi i planit kërkon mobilizimin total të masave punonjëse, ndershmérinë dhe vetëmohimin e tyre, disiplinën në punë. Ai kërkon drejtimin dhe organizimin e mirë të punës nga kuadrot tanë, të cilët duhet të hyjnë në hollësira të punës së tyre, të njohin mirë punën dhe planin, të drejtojnë konkretisht dhe jo në përgjithësi, të vënë në zbatim urdhërat dhe udhëzimet që u jepen dhe të mos i lënë në letër, por t'i ndjekin gjer në fund. Në luftën për realizimin e planit dhe në vështirësitë që do të hasen, do të forcohen fuqitë tona, do të perfek-

sionohet organizimi, kurse njerëzit do të mësojnë të drejtojnë. Realizimi i planit kërkon një luftë të vazhdueshme kundër burokracisë dhe javashllëkut, kundër të pandërgjegjshmëve.

Realizimi i planit kërkon një organizim të shëndoshë në të gjitha ndërmarrjet dhe organet operative dhe forcimin e evidencës operative gjatë realizimit. Organet operative duhet të ndjekin çdo ditë realizimin e planit, duhet të konstatojnë çdo ditë pengesat dhe duhet të ndërhyjnë menjëherë. Prandaj evidencat statistikore nuk duhet të jenë me afat të gjatë dhe të përdoren si baza studimi, por duhet të jenë baza drejtimi dhe kontrolli për udhëheqjen operative, duhet të shfrytëzohen në rregull dhe të kenë efektin e duhur për të ndihmuar në realizimin e planit.

Armiqtë tanë brenda ose jashtë qofshin, do të përpiken të ndalojnë zbatimin e planit dhe të sabotojnë. Por është detyrë e të gjithë njerëzve të ndershëm dhe patriotë që t'i zbulojnë e t'i godasin rëndë dhe t'i bëjnë të pavleleshme tentativat e tyre. Armiqtë e vendit dhe të popullit tonë, armiqtë e demokracisë sonë popullore, nuk i kanë hedhur armët. Kërcënimet, shantazhet dhe provokacionet e hapëta kundër popullit tonë, nuk kanë mbaruar nga monarko-fashistët grekë, vegla të imperialistëve amerikanë dhe anglezë, përkundrazi, ato po shtohen dita-ditës. Imperialistët amerikanë dhe anglezë dhe agjentët e tyre dështuan me turp në orvatjet e tyre kriminale për të krijuar turbullira, atentate dhe sabotazhe brenda në vendin tonë, pse populli shqiptar dhe pushteti i tij, vigjilent si askurrë, i zbuloi, i demaskoi dhe i shtypi pa mëshirë të gjitha këto tentativa. Im-

perialistët amerikanë dhe veglat e tyre i kanë humbur shpresat për të goditur popullin tonë nga brenda, prandaj po na kërcënohen që jashtë. Provokacionet e imperialistëve anglo-amerikanë dhe të veglave të tyre, fashistëve grekë, kanë disa vjet që po vazhdojnë me një ritëm kurdoherë më të madh kundër vendit tonë. Arësyeja është lehtë të kuptohet pse ngjet kështu. Lufta heroike e popullit grek ka marrë proporcione të jasht-zakonshme. Ushtria demokratike greke po çliron tokat e atdheut të saj nga okupatorët imperialistë amerikanë e anglezë dhe hyzmeqarët e tyre grekë, të cilët janë strukur në qytete. Monarko-fashistët grekë dhe padronët e tyre ndodhen në një qorrssokak. Ata më kot akuzojnë Shqipërinë, Jugosllavinë e Bullgarinë se gjoja këto tri shtete ndihmojnë popullin grek me armë e municion. Kësaj gjenjeshtre të madhe i doli boja. Gjithë bota përparimtare, demokrate dhe paqedashëse e ka kuptuar tani më së miri se ku është qëllimi i amerikanëve dhe i satelitëve të tyre, kur bëjnë këto shpifje. Ata s'kanë tjetër rrugë daljeje, përveçse të gjunjë mjetet provokuese për të shtypur popullin heroik grek, për ta bërë Greqinë një bazë amerikane dhe fashiste, nga ku ata të kërcënojnë demokracitë popullore në Ballkan, Bashkimin Sovjetik, paqen. Imperialistët amerikanë dhe monarko-fashistët grekë, po ndërrojnë taktikë në shantazhet dhe në provokacionet e tyre. Deri dje ata bënin shpifje dhe akuza të poshtra kundër të tri vendeve: Shqipërisë, Jugosllavisë, Bullgarisë, por ata s'mundën të bindnin njeri për këtë gjë. Ndërkohë ata janë të detyruar të zembrapsen përpëra sulmeve heroike të ushtrisë demokratike greke. Në një situatë të tillë, imperialistët

amerikanë dhe monarko-fashistët grekë i kanë drejtuar akuzat e tyre dhe provokacionet e hapëta kundër vendit tonë, duke kujtar se vendi ynë është pikë e dobët, ku ata mund të provokojnë dhe të krijojnë një gjendje të nderë, për t'i lejuar të zbatojnë aktet e tyre banditeske. I ashtuquajturi Komision i OKB-së për Greqinë, që nuk është përveçse vegël e imperialistëve luftëdashës amerikanë, në raportin e tij akuzon vendin tonë se ndihmon me armë dhe me municion partizanët grekë. Mirëpo në kohën kur agjentët e imperializmit amerikan po pregatitin raportin për në OKB kundër Shqipërisë, bateritë e monarko-fashistëve grekë nga malet e Konicës godasin me artileri kufirin tonë, tokat tona, fshatrat dhe popullin tonë të qetë, aeroplanët grekë dhe amerikanë fluturojnë çdo ditë gjatë kufirit dhe tokës sonë. Ata bëjnë provokacione të hapëta me qëllime të caktuara, duke shkelur haptas sovranitetin e një populli të lirë dhe të pavarur. Kjo është pregatitja e një fushate të hapët kundër vendit tonë nga ana e imperialistëve amerikanë, të cilët, duke dashur të krijojnë një situatë lufte në mes vendit tonë dhe Greqisë monarko-fashiste, për të rrezikuar kështu paqen, s'përjashtohet që, me anën e veglave të tyre, monarko-fashistëve grekë, të vazhdojnë provokacionet e tyre të hapëta kundër vendit tonë. Por asgjë nuk mund ta gjejë në befasi popullin shqiptar. Populli ynë i vogël, përparimtar dhc paqedashës, lufton me mish e me shpirt për paqen dhe për demokracinë e vërtetë; ai ndodhet afër gojës së ujkut, por nuk trembet nga të kërciturat e dhëmbëve të tij. Populli ynë ka parë dhe ujqër më të mëdhenj, është matur me ta dhe i ka mundur. Populli shqiptar dhe ushtria e tij e lavdishme,

mburoja e çelniktë e indipendencës dhe e integritetit tokësor të vendit tonë, janë kurdoherë zgjuar dhe vigjilëtë për çdo situatë. Populli ynë do të mbajë kurdoherë gjakftohtësinë përpara provokacioneve që po i bëjnë. Populli ynë me simpati të madhe dhe me admirim shikon të rriten dhe të triumfojnë forcat e demokracisë në Greqi dhe i brohorit këto fitore, pse janë fitore të demokracisë në botë dhe faktorë për forcimin e paqes. Ushtria jonë heroike, që ruan ditë e natë në kufitë tanë të Jugut, e di detyrën e saj të lartë ndaj atdheut dhe popullit; ajo e ka treguar besnikërinë e saj të pafund ndaj popullit të vet dhe çdo provokacion i hapët, që do të guxojnë të bëjnë imperialistët amerikanë dhe monarko-fashistët në kufitë tanë, do të hasë si sharra në gozh-dë, si thotë populli ynë. Përpara situatave të tilla populli ynë forcon besimin në punën e në luftën e tij për paqen dhe i dhjetëfishohen energjitetë e tij. Armiqtë e popullit tonë, imperialistët amerikanë dhe shërbëtorët e tyre gabohen, kur besojnë se vendi ynë është pikë e dobët, ku ata mund të bëjnë provokacione. Populli ynë e do paqen dhe lufton për paqen, prandaj ai nuk është vetëm. Ai ka mik besnik Bashkimin e lavdishëm Sovjetik, që e ka ndihmuar me gjithë zemër dhe e ndihmon me të gjitha forcat e tij në rrugën e vet përparimitare, në rrugën e tij paqësore. Populli ynë ka miq të fortë dhe të shëndoshë gjithë pjesëtarët e blokut demokratik dhe antiimperialist, me të cilët populli ynë lufton së bashku për një demokraci të vërtetë në botë, për një paqe të drejtë demokratike, lufton kundër imperializmit sklavërues amerikan dhe satelitëve të tij, nxitës të një kosphane të re. Populli ynë e di se duke kryer detyrat që

i vihen përpara për ndërtimin e ekonomisë së tij dhe të jetës së tij, për forcimin e pushtetit të tij demokratik popullor, për forcimin e mbrojtjes së tij, ai do t'ja arrijë qëllimit, që është i dyfishtë: do të shohë për vete të tij ditë të lumtura, dhe do të bëhet kështu një pjesëtar i fortë dhc i denjë i kampit demokratik antiimperialist, i cili ka në krye Bashkimin Sovjetik. Për këto qëllime të larta ka luftuar dje populli ynë, do të luftojë sot e deri në fund dhe do të triumfojë, pse kauza e tij është kauza e kampit të fuqishëm demokratik antiimperialist, është kauza e gjithë botës përparimtare.

Shokë deputetë,

Realizimi i planit tonë është sigurimi i një jete më të mirë për popullin tonë, është sigurimi dhe forcimi i fitoreve të mëdha të Luftës sonë nacional-çlirimtare, është sigurimi i lirisë, i indipendencës dhe i integritetit të vendit tonë. Në këto përmblidhen të gjitha dëshirat dhe aspiratat e mësave të gjera të popullit tonë heroik,jeta e tij, e ardhmja e tij, e ardhmja e brezave të rinj.

Prandaj nga kjo tribunë e popullit, si përfaqësues dhe udhëheqës të tij, t'i bëjmë thirrje gjithë popullit tonë, që i madh e i vogël, të çohet në këmbë dhe të mobilizohet totalisht për realizimin qind për qind të planit. për ndërtimin e jetës së tij më të mirë.

Në radhë të parë i bëjmë thirrje klasës punëtore heroike të vendit tonë, të jetë në ballë të luftës për realizimin e planit. Ajo të tregojë si kurdoherë, heroizmin dhe besnikërinë e saj ndaj popullit, të jetë shembull për

të gjitha masat punonjëse, shembull discipline të çelniktë, shembull sakifice, shembull zotësie në drejtimin e të gjitha punëve. Klasa punëtore, në ballë të luftës si kurdoherë, për realizimin e planit, të përvetësojë teknikën, të kualifikohet, të zotërojë maqinën dhe ta ruajë fabrikën si sytë e ballit. Klasa punëtore të jetë e zgjuar kundër armiqve që do të përpilen të na sabotojnë, t'i godasë köta pa mëshirë, të jetë shembull në këtë drejtim për të gjithë patriotët e vendit tonë.

U bëjmë thirrje katundarëve tanë punonjës dhe patriotë, të mobilizohen të gjithë në punë. Të punojnë sa më shumë dhe të prodhojnë sa më shumë. Të zhvillojnë ndjenjën e kolektivitetit dhe të forcojnë miqësinë e aleancën me klasën punëtore dhe me të gjitha shtresat punonjëse të qytetit; të modernizojnë punën e tyre, të braktisin metodat e vjetra në bujqësi dhe të përqafojnë metodat e reja të punës dhe të prodhimit. Detyrat që u vë plani i shtetit përpara, katundarët tanë duhet të vënë gjithë forcat e tyre, gjithë entuziazmin e tyre që t'i përm bushin, pse kështu jeta e tyre do të bëhet më e mirë dhe do të përparojë bujqësia.

I bëjmë thirrje rinisë sonë heroike, kudo që punon, në fabrika, në ara, në shkolla. Ajo të shtojë shumë e më shumë entuziazmin dhe hovin në punën e madhe të saj, të kryejë si kurdoherë me sukses dhe me nder detyrat që i vihen përpara. Jeta e re është për atë, e ardhmja është për atë. Rinia jonë ka kryer me sukses kaq vepra të rëndësishme për vendin tonë. Vjet ajo ndërtoi vijën hekurudhore Durrës-Peqin. Sivjet, qeveria jonë, me gjëzim dhe me një besim të madh te rinia jonë, po e ngarkon për ndërtimin e vijës hekurudhore Durrës-

-Tiranë. Rinia të jetë kurdoherë e gatshme për të goditur të gjithë armiqjtë e popullit tonë, që kërkojnë të sabotojnë përpjekjet e popullit shqiptar, që kërkojnë të godasin jetën e popullit dhe të rinisë sonë.

U bëjmë thirrje grave heroike të Shqipërisë, të mobilizohen të gjitha për realizimin e planit. Gratë të luftojnë me të gjitha forcat e tyre fanatizmin që ekziston akoma në vendin tonë, të luftojnë injorancën, të forcojnë besimin në forcat e tyre të mëdha dhe këto forca vitale është e domosdoshme të vihen në shërbimin e atdheut. Gratë e Shqipërisë, që rritin brezin tonë të ardhshëm, janë të interesuara në radhë të parë për të siguruar një jetë të lumtur përfshirë e tyre, prandaj ato janë në gjendje dhe do të luftojnë kurdoherë më mirë për realizimin e planit të shtetit, që përfaqëson jetën e popullit tonë.

U bëjmë thirrje të gjithë nëpunësave të shtetit të kryejnë me përpikëri detyrat që u vihen përpara.

I bëjmë thirrje gjithë popullit shqiptar të forcojë pushtetin demokratik, i cili është garancia e realizimeve të sojmë dhe të ardhshme të vendit tonë. Me pushtetin e fortë në duart e popullit; do të realizohen të gjitha. Prandaj tani, që po zhvillohet fushata e zgjedhjeve, gjithë populli ynë duhet të luftojë që në pushtet të zgjidhen njerëzit më punëtorë, patriotët më të zjarrtë, njerëzit e ndershëm që u dhimbset çështja e popullit dhe që do të punojnë me të gjitha forcat përfshirë t'i zgjidhur dhe përfshirë përmbytjet e popullit. Armiqtë do të përpiken të futen në pushtetin tonë përfshirë na sabotuar nga brenda, prandaj këta duhen luftuar e demaskuar ashpërsisht. Pushteti ynë duhet të jetë sa më popullor dhe ky do të bëhet me të vërtetë popullor dhe demo-

kratik, kur masat e gjera punonjëse të marrin pjesë në të, ta kuptojnë si duhet rëndësinë dhe rolin e tij dhe të luftojnë që ta forcojnë pushtetin, ta modernizojnë dhe ta bëjnë të astë të zgjidhë të gjitha problemet që i vihen përpara dhe të drejtojë popullin në rrugën e përparimit.

Për të pasur sukses të plotë në zgjedhjet e pushtetit dhe në të gjitha punët tona i gjithë populli shqiptar, populli i ndershëm e punëtor duhet që të forcojë Frontin Demokratik të Shqipërisë, organizatën politike të përgjithshme të masave të gjera të popullit tonë. Në Frontin Demokratik, me Partinë e lavdishme Komuniste në krye, të mobilizohet populli, të edukohet politikisht, t'i kuptojë qartë momentet, punët dhe detyrat dhe t'i kryejë këto me entuziazmin më të madh, me hovin më të madh për mbrojtjen e atdheut, për lulëzimin e atdheut, për mposhtjen e armiqve të popullit, për çrrënjosjen e fashizmit që nga rrënjet dhe për mbrojtjen e paqes që kërcenohet nga imperialistët agresorë dhe luftëdashës.

Përpara pra të gjithë, të grumbulluar si një trup i vetëm në Frontin Demokratik, nën udhëheqjen e sigurtë dhe besnikë të Partisë Komuniste të lavdishme, të kryejmë me nder dhe me besnikëri ndaj atdheut të gjitha detyrat që na vihen përpara dhe të korrim për popullin tonë, për demokracinë tonë popullore, për Republikën tonë fitore të reja.

NGA FJALA E MBAJTUR NË KOMISIONIN E NGRITUR PËR ÇËSHTJEN E URBANIZMIT TE QYTETIT TE TIRANËS DHE TE QYTETEVE TE TJERA TE VENDIT

19 shkurt 1948

Çështja e urbanizmit të Tiranës dhe e qyteteve të tjera të Shqipërisë duhet të merret në shqyrtim, pse ka mjaft rëndësi. Për këtë gjë krijohet edhe ky komision permanent, që, me njerëz teknikë, të zgjidhë dhe të vërë në udhë të drejtë këtë problem me rëndësi.

Shokët ministra, që bëjnë pjesë në këtë komision, do të luajnë rolin kryesor, por jo vetëm këta; këtu bëjnë pjesë edhe ndihmësministra, përfaqësues nga ushtria dhe nga çdo dikaster. Që të gjithë këta duhet të japid ndihmën e tyre, të mendojnë e ta kenë parasysh këtë problem. Pra të gjithë shokët e komisionit, para çdo ndërtimi të mendojnë edhe nga ana strategjike, shëndetësore, kulturale, bujqësore, etj.

Çështja urbanistike e kryeqytetit, duhet të na preokupojë dhe të zërë një vend të parë në Tiranë, si kryeqytet i Shqipërisë së re, që të bëhet shembull për qytetet e tjera; Tirana të bëhet qyteti më i dashur i gjithë popullit, prandaj duhet një kujdes për zhvillimin e krye-

qytetit dhe s'duhet lënë në një gjendje të tillë. Kryeqyteti do të zhvillohet nga ana industriale, kulturale, artistike, sportive; ai do të marrë zhvillim të madh dhe do të jetë qendër e rëndësishme e vendit tonë. Kjo perspektivë të na nxitë që të marrim masa dhe të fillohet që tani nga puna.

Zona industriale mendoj të jetë në drejtim të kazermave dhe në rrëzë të kodrave të Yzberishit. Në këtë zonë do të ngrihen tri fabrika të mëdha dhe do të punojnë e do të banojnë rrëth 4 000 punëtorë, prandaj, me ngritjen e këtyre banesave, duhet shikuar edhe ana strategjike, çështja e shëndetit, etj. Qendrat e banimit të punëtorëve të janë jo të shpërndara; këto qendra do të lidhen dhe me hekurudhën Durrës-Tiranë.

Lidhur me zhvillimin industrial të Tiranës është edhe çështja e kanalizimit të ujit dhe përhapja e drithës elektrike.

Çështja e kanalizimeve të preokupojë veçanërisht, komisionin, sepse këtej varet shëndeti i popullit.

Tirana vuan për ujë, kjo çështje do të zgjidhet tani me marrjen e ujit nga Selita. Ujet të mos kursehet për pastërtinë e qytetit, se kështu do të evitohen sëmundjet; kjo çështje duhet studjuar me qëllim që të sigurohet ujë boll, jo për pirje e larje, përdorim shtëpiak, por edhe për zhvillimin perspektiv të industrisë si dhe për pastrimin e qytetit. Tirana duhet të jetë një nga qytetet më të pastra. Të parashikohet vaditja e parqeve, e kopshteve dhe e tokave të rrëthit të Tiranës. Fshatrat rrëth Tiranës janë prapa, këto duhet të zhvillohen paralelisht me qendrën, të bëhen vende turistike, të krijohen kopshte për zarzavate, t'i ndriçojmë me elektrik, të fillojnë

të sistemohen e të bëhen qendra të bukura, të pyllëzo-
hen dhe të mbillen pemë, ullinj, etj. Qyteti e fshatrat
e Tiranës të bëjnë një kompleks. Qyteti i Tiranës të
ketë drita të forta.

Pjesa më e madhe e popullit banon në ndërtesa të
vjetra, prandaj duhet të merren masa për këtë gjendje.
Ka pluhur e rrugë të këqia, s'ka një park për fëmijët;
kjo është e keqe për shëndetin. Duke marrë parasysh
që ne sot kemi nevojë të madhe për strehim, duhet të
ngrihen banesa për punëtorët. Gjithë populli të shikojë
një gjendje të përmirësuar, prandaj duhet të ketë ini-
ciativë në këtë drejtim. Çdo gjë që do të ngrihet, të për-
shtatet me regjimin tonë popullor. Të shikohet ana e
shëndetit, komoditeti; shtëpitë për punëtorët e nëpu-
nësit të jenë të bukura, me kopshte e me pemë; të mos
zënë shumë hapësirë, por edhe të mos u mungojë asgjë
atyre që banojnë. Godinat të shtrihen në gjerësi e jo
shumë në lartësi; arqitektët duhet të kenë parasysh stilin
popullor. Të përpilen që të krijojnë një stil në përshta-
tje me karakteristikat e vendit tonë.

Të tregohet kujdes që ndërtesat kryesore shtetërore të
jenë në qendrën e qytetit, në vende të përshtatshme
që të plotësojnë nevojat dhe ta zbukurojnë kryeqytetin.

Rrugët e kryeqytetit të jenë më të gjera dhe të
bëjmë çmos për ngritjen e parqeve dhe të lulishteve.

Të kemi një park të madh, ku të vejë populli, të
çlodhet; të ketë këtu edhe vende dëfrimi, teatër për
fëmijët, të cilët sot për sot janë në pluhur e në rrezik
nga ndonjë aksident. Gjëra të tilla mund të bëhen me
pak shpenzime e me iniciativën e komiteteve ekzekutive.

Vendi ynë ka një florë të pasur, bimë të vlefshme

dhe një faunë të mirë. Fare mirë mund të bëhet koleksioni i tyre, përvèç atyre që mund të sjellim nga jashtë dhe të ngrihet një kopësht botanik-zoologjik që të jetë vend shetitjeje e çlodhjeje.

Kryeqyteti të jetë i tërë si një kopësht, të pyllëzohet me dru për hije dhe me pemë për fruta. Të tregohet kujdes që në shembjen e godinave e të rrugëve, mos dëmtohen gjelbërimet.

Varrezat që janë në anë të qytetit, ose të sistemohen ose të mendohet për t'i vendosur në një vend tjeter. Nga ana tjeter një kujdes shumë i madh të tregohet për varrezat e dëshmorëve të Luftës nacional-çlirimtare. Të mos lejohet që varrezat e tyre të janë në hendeqe. Për këta, veçanërisht, të mendohet një vend i veçantë dhe të hartohet një plan për sistemimin e tyre.

Të ngrihet monumenti i «Ushtarit të panjohur»¹ në një vend të bukur, të dukshëm, të pyllëzuar, i cili të jetë vend çlodhjeje dhe njerëzit të shkojnë në formë pelegrinazhi, të marrin forcë dhe fuqi. Modeli i monumentit të bëhet me konkurs.

Fshatrat rreth Tiranës të janë vende dëfrimi, plazhi i Durrësit s'mjafton, duhet që Dajti të bëhet një qendër verore ku të ngrihen edhe hotele.

Tirana të bëhet qendër artistike, kulturale nga më të rëndësishmet. Këtu të ketë shkolla të larta, këtu të jetë universiteti i ardhshëm. Të mendohet për ngritjen e një muzeumi, ku të ekspozohen të gjitha dokumentat e luftës së popullit tonë. Shtëpi kulture të ketë kudo,

¹ Është fjalë për monumentin kushtuar dëshmorëve që dhanë jetën për çlirimin dhe mbrojtjen e atdheut.

populli ynë ka nevojë dhe etje për edukim dhe këtë rol duhet ta luajnë këto shtëpi. Prandaj këto institucionë duhet të janë të pastra, të bukura, që të tërheqin popullin dhe fëmijët. Teatrot dhe kinematë të janë atje ku është populli punëtor, i cili s'ka si të vejë, kur këto janë shumë larg. Të tilla do të ketë edhe në qendër, por mund të ketë edhe në lagje.

Zona sanitare të mbetet atje ku është dhe prirja të jetë që andej të ndërtohet çdo gjë që ka lidhje me mbrojtjen e shëndetit. Malarja është shumë e përhapur në popull. Ministria e Shëndetësisë, veç masave mjekësore, duhet të zhvillojë një punë të madhe që vetë populli të marrë masa për t'u ruajtur dhe kjo të bëhet çështje edukate.

Problemi i strehimit në Tiranë është vështirësuar. Punëtorë, njerëz të popullit, oficerë, funksionarë, janë ngushtë me shtëpi, prandaj një zgjidhje e këtij problemi është edhe largimi nga ky qytet i njerëzve parazitë, që s'i lidh asgjë me qytetin e Tiranës. Të mbahet gjithashtu parasysh që banesat të ndërtohen në bloqe të vecanta e mundësishët afër qendrave të tyre të punës.

Për realizimin e këtyre detyrave duhen arqitektë dhe inxhinjerë dhe njerëzit tanë ta konsiderojnë këtë si çështje nderi e t'i vihen punës me zemër e me shpirt. Prandaj edhe ky komision të mos bëjë mbledhje formale, por mbledhje pune dhe për këtë problem me rëndësi duhet të merret mendimi i popullit: si mendon ai për sistemin e qytetit e të fshatrave dhe për çdo gjë tjeter në lidhje me urbanizmin.

Në këtë rast, në ngritjen e fshatrave të kemi parasysh që ato të mos janë të shpërndara, por me shtëpi

të afruara, sepse në kolektivitet ecet më shpejt drejt socializmit. Gjithashtu për ndërtimin e këtyre shtëpive mos prisni projekte të mëdha nga arqitektët, mjafton edhe një gjeometër i mirë i popullit që, në këshillim me fshatarë, mund të projektojë, të ngrejë ndërtesa dhe t'i sistemojë këto fshatra.

Për të gjitha këto gjëra të fillchet puna që tanë; të hartohet një plan dhe që sivjet të fillohen punime në këtë drejtim. Komitetit ekzekutiv të Tiranës do t'i vëmë në dispozicion edhe ato 4 milionë lekë që ka kërkuar për meremetimin e rrugëve e të shtëpive dhe në këtë aksion duhet të tregohet një kujdes i madh nga ana e komitetit. Qyteti i Tiranës s'është hiç i pastër, është mos më keq. Po në këtë aksion ka shumë gjëra që, me vetë iniciativën e masave të popullit, mund të ishin bërë.

Po në këtë drejtim duhet të punohet edhe për qysetet e tjera, si për Durrësin, Shkodrën, Korçën e të tjera. Komitetete ekzekutive të rretheve t'u jepen udhëzime të veçanta që të punojnë për këtë problem dhe të krijojnë kushtet për një jetë më të mirë për popullin, i cili të shikojë kushtet e reja të jetesës, të shikojë ndryshimet që vijnë nga ndihma e pushtetit popullor, të shikojë si shteti përpinqet për të dhe jep rezultate.

Botohet për herë të parë sipas procesverbalit të mbledhjes që gjendet në Arkivin e Kryeministrisë

PËRSHËNDETJE DËRGUAR USHTRISË SË LAVDISHME SOVJETIKE ME RASTIN E 30-VJETORIT TË THEMELIMIT TË SAJ

22 shkurt 1948

Jam i lumtur të përshëndes në emër të gjithë popullit shqiptar, të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare dhe timin personal, Ushtrinë e lavdishme Sovjetike për ditën e 30-vjetorit të themelimit të saj.

Populli shqiptar merr pjesë me gjithë zemër në festën e madhe të popujve sovjetikë dhe brohorit me entuziazmin më të madh për lavdinë e Ushtrisë Sovjetike dhe të udhëheqësit të saj, Gjeneralisimit Stalin.

Lufta dhe veprat e saja të lavdishme, që nga dita e themelimit të saj, do të mbeten për jetë një shërbim i madh para gjithë njerëzimit.

Historia e Ushtrisë Sovjetike është historia e luftërave dhe e përpjekjeve heroike të të gjithë popujve sovjetikë, që, nën udhëheqjen e Partisë së madhe Bolshevikë dhe të gjenisë së Leninit dhe të Stalinit, dërmoi të gjitha tentativat e armiqve imperialistë dhe të armiqve të brendshëm; është historia e lavdishme e armatës së popujve të vëllazëruar të Bashkimit Sovjetik, që, e edukuar nga Partia Bolshevikë dhe nën udhëheqjen e

Leninit e të Stalinit, mbrojti me heroizëm fitoret e Revolucionit të parë socialist në botë dhe u bë roje e çelniktë e kufive të shtetit të parë socialist dhe e punës ndërtimitare dhe paqësore të popujve të lirë sovjetikë.

Ushtria Sovjetike qe forca kryesore, që dërmoi fashizmin dhe në saje të luftës së saj popujt fituan lirinë.

Gjithë bota përparimtare i është mirënlohëse Ushtrisë së lavdishme Sovjetike dhe Stalinit të madh.

Prestigji i saj i madh që ka fituar në gjithë botën dhe forca e saj e pathyeshme janë sot garanci edhe për ruajtjen e paqes, të lirisë së popujve dhe të demokracisë.

Populli ynë i është mirënlohës Bashkimit të madh Sovjetik dhe ushtrisë së tij, pse ai e di, se, pa Bashkimin Sovjetik, pa luftën e Ushtrisë së Kuqe, nuk do të kish pasur fitore mbi fashizmin.

Në luftën tonë kundër fashizmit ne u hodhëm pa rezerva e me besim të patundur në fitore, sepse ne kishim besim të plotë në luftën e Ushtrisë Sovjetike dhe në udhëheqjen e Stalinit të madh.

Luftërat e mëdha dhe fitoret mbi armikun e përbashkët që korre Ushtria Sovjetike, ishin për popullin tonë dhe për ushtrinë tonë burim kurajoje dhe guximi me të cilët ne luftuam deri në fund; fitoret e saja, ishin fitoret tona, pse ne dinim që Ushtria Sovjetike, duke luftuar fashizmin, luftonte dhe për çështjen tonë.

Rroftë Ushtria e lavdishme Sovjetike!

Lavdi dhe jetë të gjatë Stalinit të madh, mikut më të dashur të popullit tonë!

Rroftë miqësia e pathyeshme e popullit tonë me
popujt e Bashkimit të madh Sovjetik!

Komandanti i Përgjithshëm i forcave të armatosura
të Republikës Popullore të Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 983,
22 shkurt 1948*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 983,
22 shkurt 1948*

**FJALA E MBAJTUR NË SELINË E LEGATËS
SOVJETIKE NË TIRANË, ME RASTIN E
MARRJES NË DORËZIM TË DEKORATËS
«URDHËRI SUVOROV KI. I» AKORDUAR
NGA PRESIDIUMI I SOVJETIT SUPREM
TË BRSS**

10 mars 1948

Shoku ministër i Bashkimit Sovjetik, shokë oficerë,
shoqe dhe shokë,

Eshtë një nder shumë i madh që i bëhet sot popullit shqiptar dhe mua me rastin e dorëzimit të dekoratës së lartë sovjetike, me të cilën u dekorova disa muaj më parë prej Presidiumit të Sovjetit Suprem të Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike.

Për popullin shqiptar dhe për mua, kjo është shprehja e lartë e dashurisë dhe e simpatisë së madhe që ushqen Bashkimi i lavdishëm Sovjetik ndaj popullit tonë të vogël dhe ushtrisë së tij trime.

Populli ynë i vogël rrroku armët që në ditët e para të robërisë dhe luftoi me heroizëm kundër dy okupatorëve fashistë, italianë dhe gjermanë, për të fituar lirinë e tij, pavarësinë dhe për të vendosur demokracinë popullore. Ne luftuam se jeta jonë ishte në rrezik, ne

luftuam se populli ynë nuk mund të rronte pa liri. Me sakrificat më të mëdha dhe me çdo kusht, populli ynë duhej të këpuste përgjithmonë zinxhirët e robërisë fashiste dhe shtypjen e feudalëve, të bezlerëve dhe të borgjezisë reaksionare, të shitur kokë e këmbë te armiku dhe te xhelatët e popullit tonë. Populli ynë s'kurseu asgjë në luftën e madhe të çlirimit dhe fitoi. Në këtë luftë ai kishte besim të patundur te popujt e Bashkimit Sovjetik, te Ushtria e lavdishme Sovjetike dhe te udhëheqësi i tyre, Stalini i madh. Lufta e lavdishme e Ushtrisë Sovjetike, që shpëtoi botën nga robëria më e rëndë e barbarëve nazistë, ishte për popullin tonë shembull dhe nxitje. Mësimet e Stalinit të madh dhe të Partisë Bolshevikë të Lenin-Stalinit i treguan popullit tonë rrugën e shpëtimit, e mësuani popullin tonë të mos përkulet kurrë përpara armikut, ta godasë armikun e jashtëm e të brendshëm me ashpërsinë më të madhe, pse vetëm kështu fitohet liria. Ne e fituam lirinë në saje të sakrificave tona të papara në histori, në saje të heroizmave të popujve sovjetikë dhe të ushtrisë së tyre. Për këtë gjë gjithë populli ynë do të ruajë për jetë mirënjojhen më të thellë për Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin e madh.

Pas luftës së madhe çlirimtarejeta lulëzoi në vendin tonë. Bashkimi Sovjetik, me kryetarin e dashur të tij, s'kursejnë asgjë për të ndihmuar popullin tonë të vogël, që ky të përparojë në çdo pikëpamje, që jeta e tij të bëhet më e mirë, që vendi ynë dhe demokracia jonë popullore të forcohen sa më shumë.

Vendi ynë do të vëré të gjitha forcat e tija për forcimin e kampit demokratik dhe antiimperialist, në krye të të cilët qëndron i pamposhtur Bashkimi Sovjetik,

mbrojtës i lirisë, i demokracisë së vërtetë popullore, i paqes së qëndrueshme. Ne, me mish e me shpirt do të luftojmë deri në vdekje për mbrojtjen e paqes dhe të demokracisë kundër të gjitha tentativave të imperialisteve amerikanë dhe anglezë dhe satelitëve të tyre, që përpiken ta shkatërrojnë paqen dhe ta hedhin botën në një kasaphanë tjetër të tmerrshme.

Popullit tonë të vogël po i bëhen dita-ditës provokime të poshtra nga ana e monarko-fashistëve grekë, vegla qorre të imperialistëve amerikano-anglezë. Para këtyre provokacioneve të poshtra, para shpifjeve dhe shantazheve, populli ynë di të mbajë gjakftohtësinë kundrejt këtyre banditëve dhe këtë ai e bën në interesin e madh të paqes. Por populli shqiptar, as nuk frikësohet dhe as nuk përkulet përpara këtyre kërcënimeve. Ai nuk do të lejojë kurrë që të cënohet toka e tij, integriteti dhe indipendenca e tij. Ai do të luftojë deri në fund dhe do të fitojë kundër atyre që do të ndërmarrin marrëzira të tilla. Kështu mendon populli ynë të mbrojë veten, të drejtat e tij, demokracinë popullore dhe paqen e qëndrueshme e demokratike në botë.

Ju lutem, shoku ministër i Bashkimit Sovjetik, të keni mirësinë t'i transmetoni, në emrin e popullit shqiptar dhe në emrin tim personal, Presidiumit të Sovjetit Suprem të BRSS dhe qeverisë sovjetike, falenderimet dhe mirënjohjen tonë më të thellë për këtë nder të madh që po na bëhet. Kjo dekoratë e lartë që po marr sot është shumë e shtrenjtë për mua dhe do ta mbaj me dashuri të madhe dhe me krenari, sepse ajo më jepet nga popujt e dashur sovjetikë dhe i përket popullit shqiptar dhe ushtrisë së tij trime.

Nga zemra ne brohorasim për popullin e dashur sovjetik dhe për mikun më të shtrenjtë të popullit tonë, Stalinin e madh, të rrojë sa malet!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 999,*

12 mars 1948

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 999,*

12 mars 1948

MESAZH DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR ME RASTIN E FESTËS SË 1 MAJIT

1 Maj 1948

Popull shqiptar,

1 Maji, festa ndërkombe të punëtorëve dhe e gjithë masave punonjëse të botës, e gjen popullin tonë të gjuar dhe të mobilizuar në rrugën për të korrur suksese të reja, për ngritjen dhe përmirësimin e jetës së tij, për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e paqes së drejtë dhe të demokracisë.

1 Maji përfaqëson për popullin tonë jetën e re, të fituar me sakrifica të pashembullta, me luftëra të përgjakshme, me punë të palodhur. Për atdheun tonë të dashur, Shqipërinë, që të ishte e lirë, e pavarur dhe sovrane, luftuan pa pushim, shekuj me radhë, fshatarët kreshnikë të Shqipërisë, punëtorët dhe patriotët e tjera.

Për popullin tonë të dashur, për mëmëdheun tonë të robëruar nga fashistët italianë dhe gjermanë dhe veglat e tyre të brendshme, luftoi Partia jonë e lavdishme Komuniste, e cila në rrugën e saj të drejtë, me dorën e saj të hekurt, me dashurinë e saj të pafund për popullin punonjës të Shqipërisë, çoi popullin tonë heroik në rrugën e fitores më të madhe që ka parë historia e

vendit tonë. Rreth Partisë Komuniste, që udhëhiqte Frontin Nacional-Çlirimtar, marshuan me vendosmërinë më të madhe punëtorët, fshatarët, rinia jonë, gratë e Shqipërissë, intelektualët patriotë, të gjithë të bashkuar me besimin e patundur te Partia Komuniste, te Bashkimi i lavdishëm Sovjetik, te Ushtria e lavdishme Sovjetike, dhe te i shtrenjti dhe i dashuri i zemrës së gjithë popullit tonë, shoku i madh Stalin. Ata ecën përpara me pushkë në dorë në luftëra të vazhdueshme dhe të ashpra, për të fituar përgjithmonë lirinë, për të vendosur demokracinë popullore, për të ndërtuar socializmin, jetën e re, jetën e lirë, jetën e lumtur.

Sot, ditën e 1 Majit, le të brohoritim për popullin tonë heroik, që nuk u përkul kurrë përpara skllavërueshve të ndryshëm; le të brohoritim për Partinë tonë të dashur Komuniste, organizatoren e të gjitha fitoreve të popullit tonë, e cila me urtësinë e saj të shquar, që e karakterizon dhe me vendosmërinë më të madhe, drejton popullin tonë të dashur në rrugën për ndërtimin e socializmit, të jetës së re, të jetës së lirë, të jetës së lumtur.

Sot, ditën e 1 Majit, le të brohoritim për lavdinë e Bashkimit Sovjetik, për lavdinë e Ushtrisë glorioze Sovjetike, për lavdinë e Stalinit të madh, të cilët na ndihmuant të fitojmë lirinë, ta bëjmë Shqipërinë independente dhe sovrane, të rindërtojmë vendin tonë dhe të ecim në rrugën e ndërtimit të socializmit.

Popull shqiptar,

Fitoret e deritanishme janë një provë e gjallë dhe një garanci e shëndoshë për të korruar suksese të reja në

rrugën tonë. Dita e 1 Majit të na gjejë të gjithë të bashkuar dhe të mobilizuar në Frontin Demokratik për të korrur fitore të reja.

Gjithë populli ynë duhet të mobilizohet për kryerjen e detyrave të mëdha që na vihen përpara nga plani ynë i shtetit për vitin 1948. Realizimi i planit kërkon prej të gjithëve ndërgjegje të lartë në punë, disiplinë dhe organizim të shëndoshë, kërkon sakrifica dhe heroizëm, kërkon aktivizimin teknik dhe politik të të gjitha masave punonjëse të vendit tonë. Realizimi i programit të punimeve në industri, në bujqësi, në arësim e në kulturë dhe në të gjitha lëmet e aktivitetit të jetës së vendit, kërkon prej të gjithëve të vëmë në veprim të gjitha forcat tona, diturinë tonë, vullnetin e papërkulur, që karakterizon masat e gjera punonjëse të vendit. Vetëm kështu ne jemi të sigurtë se do të korrim suksese të mëdha dhe do të përmirësojmë dita-ditës më shumë jetën e mbarë popullit shqiptar, do të forcojmë Republikën dhe pushtetin tonë popullor, do të forcojmë aftësinë mbrojtëse të vendit tonë, do të forcojmë demokracinë popullore.

Klasa jonë punëtore të mobilizohet e tëra, ashtu sikundër ka bërë kurdoherë dhe si kurdoherë ajo të jetë në ballë të luftës për realizimin dhe tejkalimin e planit. Ajo të jetë shembull për të gjitha masat punonjëse të vendit tonë, ajo t'i udhëheqë këto masa, për të shtuar prodhimin, për të zhvilluar emulacionin në punë, për të zhvilluar shumë e më shumë lëvizjen sulmuese; klasa punëtore të jetë shembull për të gjithë, për aplikimin e drejtë dhe të shpejtë të metodave të reja në punë, për racionizimin më të përsosur, për

disiplinë dhe ndershmëri në punë. Punëtorët e Shqipërisë, kudo që punojnë, të forcojnë ndërgjegjen e klasës dhe të kuptojnë rolin e madh drejtues që u ngarkon historiën.

Gjithashtu për fshatarët e Shqipërisë janë vënë detyra të rëndësishme, që kanë lidhje me zhvillimin më të madh të bujqësisë, me zhvillimin e kulturave industriale e të tjera. Fshatarët tanë patriotë duhet të vënë të gjitha forcat për të punuar sa më shumë toka dhe sa më mirë dhe për të prodhuar gjithashtu sa më shumë. Kjo është në interesin e tyre dhe të gjithë vendit. Fshatarët duhet të përdorin format dhe mjetet e reja të punës, pse këto do ta bëjnë bujqësinë tonë të zhvillohet, të modernizohet.

Gjithashtu për rininë tonë heroike, dita e 1 Majit të jetë një ditë e gjzuar dhe t'i shtojë rinisë sonë vullnetin dhe heroizmin që kurrë s'i kanë munguar në punë e në mësimë. Rinia jonë të jetë në ballë si kurdoherë, pse gjithë populli ynë dhe Partia jonë Komuniste, e ka rrethuar atë me një dashuri të madhe dhe punojnë për të ardhmen e lumtur të saj.

Për të gjitha masat punonjëse të vendit tonë, për gratë, për intelektualët patriotë, për të madh e të vogël, dita e 1 Majit të jetë për ne një ditë e gjzuar dhe ditë mobilizimi total, për kryerjen me sukses dhe me nder të detyrave që na ngarkon atdheu.

Populli shqiptar, i sigurtë në të ardhmen e tij më të mirë, të cilën po e ndërton, të forcojë dhe të çelnikosë dashurinë e madhe që ai ushqen për popujt sovjetikë dhe për udhëheqësin e tyre të madh, mikun më të shtrenjtë dhe më të dashur të popullit tonë, shokun

Stalin. Në të gjitha përpjekjet e popullit tonë, për të fituar lirinë dhe për të ndërtuar jetën e re, Bashkimi Sovjetik dhe shoku Stalin me të gjitha forcat e ndihmognë popullin tonë të përparojë. Populli ynë do të forcojë dita-ditës më shumë aleancën dhe vëllazërimin e madh që e lidh me popujt vëllezër të Jugosllavisë së re. Populli ynë do të forcojë aleancën dhe vëllazërimin me popullin vëlla bullgar. Demokracitë tona popullore do të ecin në një rrugë për ndërtimin e jetës së tyre të re dhe do të jenë një faktor i rëndësishëm për mbrojtjen e paqes në Ballkan dhe në botë. Populli ynë me të gjitha forcat e tija do t'i shtojë dita-ditës këto forca dhe do të luftojë për mbrojtjen e paqes së drejtë demokratike. Populli shqiptar, i cili është pjesëtar i vendosur i kampit demokratik antiimperialist do të japë çdo gjë për forcimin e kampit demokratik, në krye të të cilat qëndron i pamposhtur Bashkimi i madh Sovjetik, mbrojtësi i paqes së vërtetë, i lirisë, i pavarësisë së popujve, luftëtar i shquar për demokracinë e vërtetë. Gjatë këtyre katër vjetve kemi përballuar dhe kemi shpartalluar të gjitha tentativat e imperialistëve amerikanë dhe satelitëve të tyre, monarko-fashistëve grekë dhe të gjitha veglave të tyre, të cilët vazhdimisht kërkojnë të na pengojnë në rrugën tonë të drejtë. Por manevrat e tyre të poshtra, kërcënimet dhe shantazhet e luftëdashësve imperialistë, do të dështojnë të gjitha, pse përballë gjendet kampi i fuqishëm demokratik, me në krye Bashkimin Sovjetik dhe rrëth tij gjithë popujt e demokrative popullore si dhe popujt përparimtarë të të gjithë botës. Forcat e demokracisë dhe të paqes janë të pathyeshme.

Populli shqiptar me besim të patundur t'i përvishet

punës për një jetë shumë më të lumtur, të forcojë vijgilencën kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm dhe t'i godasë këta armiq pa mëshirë në të gjitha format që do të guxojnë të shfaqen gjatë punës sonë ndërtimitare, të forcojë aftësinë mbrojtëse të vendit të tij dhe i gjithë i grumbulluar në Frontin Demokratik, nën udhëheqjen e Partisë sonë Komuniste, të ecë përpara, kurdoherë përpara, për ndërtimin e jetës së tij më të mirë, për të korrur suksese të reja.

Rroftë dita e 1 Majit, dita e forcave luftarake të punëtorëve!

Rroftë populli shqiptar!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 1042,
1 maj 1948*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 1042,
1 maj 1948*

**FJALA E MBAJTUR NË KUVENDIN POPULLOR ME
RASTIN E PARAQITJES PËR APROVIM TË DISA
PROJEKTLIGJEVE**

11 maj 1948

Shokë deputetë,

Bashkë me përshëndetjet që i sjellim Kuvendit Popullor në emër të Qeverisë së Republikës dhe në emrin tim personal, është detyra jonë të vëmë sot në dijeni, përfaqësuesit e popullit në këtë kuvend, për realizimin e planit të tremujorit të parë të vitit që vazhdon. Gjithashtu është vendi që të theksoj edhe rëndësinë e disa projektligjeve të dorës së parë që qeveria jonë ka pranuar dhe i shtron përpala jush për diskutim dhe aprovim.

Kur u aprovua plani i vitit 1948 nga ky kuvend u bënë të qarta të gjitha detyrat që i dilnin pushtetit tonë, organeve operative, klasës punëtore, bujqve dhe masave të gjera punonjëse, në lidhje me realizimin e tij. Tani që plani i tremujorit të parë ka marrë fund, mund të nxjerrim përfundime të rëndësishme në lidhje me plotësimin e detyrave të këtij tremujori dhe köto t'i kemi parasysh për periudhat e tjera. Nga kjo analizë e planit, të mbështetur kryesisht në forcat dhe në mundësitë

tona, del se ai është real dhe i realizueshëm. Me plot të drejtë mund të thuhet se mobilizimi i masave punonjëse drejt plotësimit të detyrave të planit është në rrugë të mirë. Kjo periudhë e tremujorit të parë karakterizohet nga përpjekje të mëdha, nga sakrifica dhe nga një vullnet i pathyeshëm për të arritur rezultate sa më të mira. Me punë të palodhur dho në luftë me pengesat dhe të metat, që na dalin përpara, pushleti ynë, organet operative dhc masat punonjëse të vendit po përpilen gjithnjë e më shumë për ta plotësuar dhc për ta tejkaluar planin e këtij viti. Gjatë këtij tremujori rezultatet në punë nuk kanë qenë aq sa duhet të kënaqshme në të gjithë sektorët e punës, por duke marrë parasysh nga një anë pengesat dhc nga ana tjetër vullnetin e madh të masave punonjëse, mund të thuhet se fillimi i zbatimit të detyrave të parashikuara në planin e vtit, në përgjithësi paraqitet mjaft i mirë. Njëkohësisht ky fillim na tregon në praktikë edhe anët tona të dobëta dhe ku duhet të godasim më fort për të pasur në fund të vtitit një realizim dhe tejkalim të planit në të gjithë sektorët e aktivitetit, si në prodhim, në ndërtim, në ngritjen e standardit të jetës, etj.

Në planin e prodhimit të tremujorit të parë ishin parashikuar proporcione zhvillimi në bazë të të cilave do të kryheshin detyrat në degët e ndryshme të aktivitetit. Ka ndodhur që mosrealizimi i planit në një degë, mosmbajtja e proporcionit të caktuar në plan, ka influencuar edhe në mosrealizimin në ndonjë degë tjetër të aktivitetit. P.sh. në industrinë e drurit plani u realizua në 76,34% gjë kjo që influencozi në mosrealizimin e plotë të planit të ndërtimit. Analiza e prodhimit na

tregon se plani në vlerë është realizuar në 104,67% dhe këtu kanë influencuar rezultatet e mira të arritura në industrinë ushqimore, në industrinë kimike, në metalurgjinë e metaleve me ngjyrë, në prodhimin e qymyrgurit, etj. Në industrinë ushqimore plani në vlerë është realizuar në 140,67%; në industrinë kimike në 106,27%; në metalurgjinë e metaleve me ngjyrë si bakri 102,8% kromi në 130,26% dhe në nënproduktet e naftës në 122,52%. Por kjo është e pamjaftueshme në rast se realizimi në bazë të llojeve të produktit nuk është i plotë. Ja disa të dhëna mbi realizimin e planit në sektorë të prodhimit sipas matësve natyralë: nafta 73,56%, kurse nënproduktet e saj 122,52%; në industrinë tekstile prodhimi i bezeve ka arritur 130,60%, kurse i fanellave në 66%; në prodhimin e lëkurëve plani u realizua 91,90%, kurse në prodhimin e këpucëve 52,20%; në industrinë ushqimore, në makaronat 119,71%, në vaj ulliri 149,93%; në energjinë elektrike 87,13%. Në lidhje me investimet e parashikuara të tremujorit të parë, sidomos në sektorin e ndërtimeve rezulton se realizimi nuk është i kë-naqshëm. Këtu duhet të vëmë në dukje se është punuar sipas planit vetëm për dy muajt e fundit të tremujorit të parë, kurse në janar është punuar për të përfunduar disa objekte të mbetur nga viti i kaluar.

Duke marrë parasysh kohën më të përshtatshme për punë gjatë tremujorëvc të tjerë dhe mundësitetë e sigurimit të lëndës së parë etj, organeve tona operative, klasës punëtore dhe gjithë masave punonjëse, u bie si detyrë ta analizojnë mirë punën e tyre dhe t'i përvishen punës më me vrull, për zhdukjen e të gjitha të metave dhe pengesave të konstatuara, të cilat kanë influencuar

në mospasjen e rezultateve të planifikuara për tremujorin e parë. Qysh tani shtrohet çështja e rregullimit të planeve tona për tremujorët e tjerë, duke marrë parasysh ç'mbetet pa u realizuar nga tremujori i parë e duke u mobilizuar për ta plotësuar gjatë kohës së ardhshme. U bëj thirrje të gjithëve e në radhë të parë klasës punëtore dhe të gjithë masave punonjëse që të bëhet një organizim më i mirë në punë, të arrihen rezultate më të mira në rritjen e rendimentit në punë dhe këtu të mbahet parasysh plotësimi i të gjitha nevojave të klasës punëtore. Si një nga detyrat me shumë rëndësi duhet të qëndrojë çështja e shpërblimit të punëtorëve sipas punës, pse kështu do të rritet rendimenti. Lidhur me këtë të tregohet kujdes i madh dhe të bëhen përpjekje për aplikimin e normave në të gjithë sektorët dhe proceset e prodhimit ku është e mundshme. Puna me gara të marrë një hov më të madh dhe një karakter masiv sa më të theksuar; të bëhen përpjekje të mëdha për shfrytëzimin e plotë të maqinerive tona dhe të përdoret me vend fuqia punëtore; të forcohet disiplina e planit, duke luftuar për vendosjen e proporcioneve të planit, për zbatimin me kohë dhe drejt të të gjitha detyrave që cakton plani. Duke marrë parasysh rolin e madh të transportit në zbatimin e planit, të bëhen përpjekje të mëdha për një organizim më të mirë të punës, për një shfrytëzim racional të mjeteve tona dhe për ruajtjen e këtyre mjeteve. Furnizimit të tregut t'i kushtohet një kujdes i madh për të kënaqur nevojat e masave punonjëse të qendrave të punës të qytetit dhe të fshatit dhe të merren masa për një organizim më të gjerë dhe më të mirë të punës në këtë drejtim. Qeveria

dhe pushteti ynë popullor kanë vënë të gjitha forcat që gjendja ekonomike e bujqve të përmirësohet dhe tok me këtë gjithëjeta e popullit tonë punëtor. Gjendja ekonomike e katundarëve, në saje të punës së palodhur të tyre dhe në saje të reformave të mëdha të pushtetit popullor, është përmirësuar shumë. Përveç që katundarët tani janë zot të tokës së tyre, ligji i ri që do të aprovojmë¹ u jep të gjitha mundësitë dhe ndihmat katundarëve të zgjerojnë pronën e tyre duke hapur toka të reja dhe toka të reja ka boll për të hapur në vendin tonë. Nga ana tjetër pushteti i vet popullor i ndihmon katundarët në zhvillimin më të madh të bujqësisë. Ai i ndihmon ata me mjete të reja pune, duke u dhënë plugje moderne, plehra kimike, farëra dita-ditës më të zgjedhura, kredi bujqësore dhe traktorë modernë, që na i dërgon Bashkimi Sovjetik. Pushteti popullor po i udhëzon katundarët në mbjelljen e kulturave të reja industriale, të cilat do të rritin të ardhurat e vendit dhe të katundarit. Të gjitha ligjet e reja mbi bujqësinë janë bazuar në principet e drejta demokratike dhe që të gjitha synojnë për të përmirësuar jetën e katundarëve. Nga të gjitha këto masa e reforma, mirëqenja ekonomike në katund ka zënë rrënët e shëndosha dhe kjo mirëqenje dita-ditës do të shtohet. Shpirti përparimtar i bujkut tonë shkon krahas me patriotizmin e tij të madh. Ashtu sikundër bujku ynë rroku armët, kur i bëri thirrje Partia e dashur Komuniste, për çlirimin e popu-

¹ Është fjalë për aprovimin e dekretligjit Nr. 593, datë 12 prill 1948 «Mbi ndarjen për kultivim të tokave të punueshme kolektive dhe shtetërore».

llit dhe të atdheut, ashtu edhe pas çlirimit, bujku ynë i përqafoi përnjëherë dhe i bëri të tijat dhe luftoi e punoi me të gjitha fuqitë pér t'i realizuar siç ja këshilloi Partia dhe qeveria e tij popullore reformat e reja, ligjet e reja, metodat e reja të punës. Provat janë të gjalla dhe dihen prej të gjithëve. Unë do të mjaftohem të përmend disa nga sukseset kryesore në lidhje me realizimin e planit tremujor.

Gjatë tremujorit të parë të këtij viti, në sektorin e bujqësisë, çështja kryesore ka qenë fushata e mbjelljeve pranverore. Tani mund të thuhet se gati në të gjitha kulturat e parashikuara në plan janë arritur rezultate të mira. Në këtë sektor flasin qartë disa shifra mbi përparimet tona dhe mbi përfitimet e fshatarësisë në përgjithësi. Gjatë vitit të kaluar u mbuall një sipërfaqe prej 305 000 hektarë, d.m.th. 38% më tepër nga viti 1938. Në planin e sivjetëm është parashikuar që kjo sipërfaqe të rritet më shumë, afro 107% nga viti i kaluar dhe që tani po duken përfundime të mira. Për t'u përmendur është se sipërfaqja e mbjellë me bimë industriale është shtuar në një mënyrë të konsiderueshme nga ajo e vitit të kaluar, bile në një raport shumë më të madh nga shtimi i përgjithshëm i tokës së mbjellë. Kjo tregon në radhë të parë se në fshatarësinë tonë po zë mirë vend çështja e shfrytëzimit të tokës pér një rendiment më të madh. Kjo do të thotë se fshatarësia jonë përpinqet të ngrejë standardin e jetës jo vetëm duke siguruar një prodhim sa më të madh në bereqet, por duke bërë një shfrytëzim më të mirë të tokës, me mbjelljen e bimëve industriale. Statistikat tregojnë se prodhimi i drithrave në vitin 1947 është shtuar në afro 168% më

shumë nga prodhimi i vitit 1938. Ky shtim i dedikohet mobilizimit të fshatarësisë që ju përgjegj thirrjeve të Frontit Demokratik për një rendiment më të madh e më të mirë në bujqësi, i dedikohet veprave të mëdha që realizoi pushteti ynë popullor në favor të bujqësisë, në interesin e fshatarësisë e në interesin e përgjithshëm të popullit.

Nga të katër anët e Shqipërisë, fshatarët i kërkojnë qeverisë më shumë traktore, më shumë plugje të rinj, më shumë plehra kimike, më shumë farëra të reja dhe të zgjedhura, më shumë kooperativa, më shumë shkolla e arësim. Dhe fshatarët e gjithë populli punonjës do të kenë çdo muaj më shumë nga këto që kërkohen; këtë e garanton puna e palodhur dhe plot heroizëm e vetëmohim e popullit tonë, e pushtetit të tij popullor, e garanton Partia e lavdishme Komuniste.

Detyra e madhe e bujqve tanë është: të mbjellin sa më shumë e t'i rrinë në kokë punës, të prodrojnë sa më shumë dhe sa më mirë; të hapin sa më shumë toka të reja dhe të organizohen sa më shumë në punë kolektive e në kooperativa të ndryshme. Fshatarët tanë të kenë kurdoherë parasysh të forcojnë aleancën me klasën tonë punëtore dhe me gjithë masat punonjëse të vendit, të shikojnë më larg nga shtëpia dhe fshati i tyre, të solidarizohen shumë e më shumë me përpjekjet e gjithë popullit tonë, pse vetëm kështu do të përmirësohetjeta e tyre dhe e gjithë popullit. Për realizimin dhe tejkalimin e planit, të mobilizohet i tërë populli ynë me në krye klasën tonë punëtore; puna e palodhur, heroizmi dhe sakrificat të jenë në rendin e ditës, pse kështu populli ynë do të ndërtojë socializmin në vendin

tonë, jetën e re, të lumtur dhe të begatshme për veten e vet dhe për brezat e ardhshëm të vendit tonë, pse kështu ne do të shohim ditë edhe më të mira, jeta e popullit tonë do të përmirësoset shumë më tepër.

Qeveria e Republikës është kujdesur kurdoherë për bukën e popullit dhe ne kemi përballuar në të kaluarën momente shumë të vështira. Jemi përpjekur që problemi i bukës të mos jetë më problem për popullin tonë dhe ne kemi bërë shumë përparime në këtë drejtim, por kjo nuk përashton vështirësitë që hasim në rrugë. Çdo vit duhet të pakësohen vështirësitë dhe në fakt janë pakësuar. Viti 1947 nuk ka qenë një vit i keq për bujqësinë tonë dhe racionet në vendin tonë kanë qenë shumë të mira për të gjithë. Kemi përpara një muaj e gjysmë nga korrjet e reja, që paraqiten të mbara dhe të mira si në sasi dhe në cilësi dhe pikërisht në këtë një muaj e gjysmë ne jemi përpara disa vështirësive në çështjen e furnizimit të racioneve të caktuara. Sigurisht që, deri në korrjet e reja, rezervat e misrit nuk janë të mëdha, por në vend kemi aq sa të marrë racionet e caktuara gjithsecili. Por çështja është që një pjesë e fshatarëve prodhues, duhet të tregojnë më tepër solidaritet me masat punonjëse të qytetit dhe të bashkohen në sakrificat e përbashkëta që bën populli ynë për ndërtimin e jetës më të mirë, duke plotësuar rigorozisht detyrimet e tyre ndaj shtetit. Kjo pjesë e fshatarëve prodhues duhet të ketë parasysh heroizmin dhe sakrificat e klasës sonë punëtore. Punëtorët e naftës në Patos transportojnë nëpër male me qindra e me qindra ton hekur në krahë, për të hapur më tepër puse vajguri, që fshatari ynë të ketë më tepër vajguri, që vendi ynë

të prodhojë më tepër naftë. Ata kanë vuajtur tërë dimrin pa strehë të mjaftueshme, por me heroizëm i përballuan të gjitha vështirësitë. Punëtorët e naftës të Kuçovës, punojnë ditë e natë pa u lodhur, punëtorët e tjerë punojnë me vetëmohim në fabrika e kantiere të ndryshme, që populli i qytetit dhe katundari të kenë më shumë sende të manifakturës; ata punojnë për të çarë male, për të ngritur centrale elektrike, për t'u dhënë ujë e dritë qyteteve dhe fushave. Rinia jonë heroike punon pa u lodhur dhe bën sakrifica të panumërtë duke ndërtuar rrugë, udhë të hekurta, tunele, që të lëvizin automjetet dhe trenat sa më parë, që të përparojë vendi, të përparojë industria, bujqësia, që të furnizohet më shpejt e më mirë fshatari dhe i gjithë populli. Në këto sakrifica të panumërtë, që bën klasa punëtore dhe masat e tjera punonjëse, duhet patjetër të bashkohet edhe ajo pjesë e fshatarëve, që nuk i është përgjegjur edhe si duhet detyrimeve ndaj shtetit dhe popullit të vet. Është një detyrë patriotike për të gjithë, që të përmbrashin si duhet dhe në kohë detyrat e tyre. Unë mendoj se me përbushjen e detyrimeve që ka, kjo pjesë e fshatarëve prodhues, do të ndihmojë mjaft dhe unë jam i bindur se fshatarët tanë kurrë nuk do t'i shmanget detyrës dhe sakrificave, kur është çështja për të mirën e përgjithshme.

Shokë deputetë,

Në këtë sesion do të paraqiten përpara Kuvendit një seri projektligjesh me rëndësi të madhe në fushën e së drejtës penale, në atë të së drejtës civile dhe veç-

nërisht në fushën e së drejtës familjare, etj. Këto projektligje, si ligji mbi martesën, mbi raportet në mes prindërve dhe fëmijve, mbi kujdestarinë dhe adoptimin, etj. janë pjesë të përgjithshme të kodit penal. Promulgimi i këtyre ligjeve është i një nevoje të dorës së parë, pse plotësohet legjislationi ynë i ri, që ngrihet mbi baza të reja, mbi parimet e shkencës marksiste-leniniste.

Në shtetin tonë e drejta dhe ligjet janë shprehje e vullnetit dhe e interesave të masave të gjera punonjëse të vendit. Ligjet e demokracisë sonë popullore janë armë të forta për të mbrojtur interesat e masave punonjëse dhe për të mbrojtur fitoret e Luftës nacional-çlirimtare. Kodi i ri penal ka një rëndësi të madhe, pse ai përmban nocionet themelore dhe hedh bazat e së drejtës penale në vendin tonë... Kodi jep definicionin e fajit penal, duke e studjuar këtë nga pikëpamja e materializmit dialektik, cakton qëllimin e dënimit, konditat dhe bazat e përgjegjësisë penale. Kodi përcakton gjithashtu në mënyrë të qartë vijën politike të pushtetit tonë në fushën e kriminalitetit, vijën që do të ndjekin organet ndjekëse, organet e prokurorisë dhe gjykatat e popullit në zbatimin në praktikë të këtij kodi.

Kodi i ri penal nuk ka asgjë të përbashkët me ligjet penale të shteteve kapitaliste dhe borgjeze si edhe me kodin penal të vjetër të vendit tonë. Kodet dhe ligjet e shteteve kapitaliste shprehin vullnetin dhe interesat e një pakice sunduesish dhe kodet e ligjet e këtyre shteteve janë armë të kësaj pakice gjakpirëse, për të mbrojtur shfrytëzimin ekonomik, për të ruajtur pushtetin politik të tyre dhe për të shtypur çdo lëvizje përparimtare të masave të shtypura dhe të shfrytëzuara. Për

këtë qëllim shkenca borgjeze mbi të drejtën penale i ka dhënë fajit penal gjithnjë një përcaktim formal. Kodi ynë i ri nuk e fsheh karakterin e tij klasor, përkundrazi, me përcaktimin e fajit penal dhe të dënimit vihet mirë në dukje qëllimi i legjislacionit tonë penal të ri dhe i dënameve. «Legjislacioni penal — thuhet në nenin 1 të kapitullit I të kodit — ka për qëllim.... të mbrojë nga veprat shoqërisht të rrezikshme shtetin popullor të ngritur mbi fitoret e Luftës nacional-çlirimtare, rendin juridik dhe ndërtimin e tij socialist si edhe personin dhe të drejtat e shtetasit». Ndërsa në nenin 2 thuhet: «Dënimi ka për qëllim: të zhdukë çdo veprimtari shoqërisht të rrezikshme, të prapsë dhe të ndalojë autorin që të kryejë faje penale të reja; të riedukojë dhe të përmirësojë autorin, të ushtrojë një influencë të përgjithshme edukuese mbi pjesëtarët e tjerë të shoqërisë që të mos kryejnë faje penale».¹ Në shoqërinë kapitaliste dënimi ka qëllimin e hakmarrjes.

Ligjet që do të formojnë kodin e ri të familjes kanë për qëllim forcimin e familjes. Familja është baza e shoqërisë sonë. Konceptet e vjetra prapanike dhe reaksionare mbi familjen, nuk mund të jenë bazat e familjes sonë. Një familje e shëndoshë dhe e fortë duhet të ngrihet në baza krejt të reja. Këto baza janë barazimi i vërtctë i gruas me burrin, barazimi i fëmijve të lindur jashtë martesës me fëmijët e lindur nga martesa, mbrojtja e nënës dhe e fëmijës, forcimi i pozitës së gruas në shoqëri dhe emancipimi i saj i plotë, kontrolli mbi prindët dhe kujdestarët, që të kryejnë si duhet detyrën

¹ Gazeta Zyrtare Nr. 63, f. 1, viti 1948.

e tyre në lidhje me rritjen dhe arësimin e fëmijve të mitur.

Pushteti ynë ka marrë dhe po merr masa që gruaja të hyjë në prodhim dhe kështu të forcohet pozita e saj jo vetëm në shoqëri, po edhe në familje. Pushteti po merr masa për mbrojtjen e fëmijve të mitur, pa prindër ose të pambrojtur. Ky është qëllimi i ligjeve të reja të familjes. Për forcimin e familjes është e nevojshme që të luftohen zakonet e këqia, që mbajnë larg gruan ngajeta shoqërore e vendit, që dobësojnë pozitën e saj në familje dhe në shoqëri dhe mbajnë fëmijët nën sundimin e kryetarit të familjes. Parimet e kodit penal dhe të ligjeve të tjera kanë lindur gjatë luftës heroike të popullit tonë për liri. Kodi penal dhe ligjet e tjera zhvillojnë dhe plotësojnë parimet që konsakron Kush-tetuta e Republikës Popullore.

Shokë deputetë,

Tre vjet më parë, si pardje, më 9 maj të vitit 1945, Gjermania naziste u dërmua dhe dorëzoi armët. Flamuri i lavdishëm i Sovjetëve valoi mbi Rajhstagun në Berlin dhe popujt e botës muarën frymë lirisht. Fitorja e madhe e njerëzimit përparimtar u arrit vetëm në saje të heroizmit të pashebullt të popujve sovjetikë dhe të forcave të lavdishme të tyre të armatosura, që i udhëhoqi në rrugën e lavdisë Stalini i madh. Atdheu i madh e i fuqishëm i socializmit, Ushtria e lavdishme Sovjetike, të udhëhequra nga Partia Bolshevikë e Leninit dhe e Stalinit, shpëtuan popujt e Evropës dhe të botës nga skllavërimi më i egër dhe më gjakatar i fashizmit gjer-

man. Me besimin e patundur te Bashkimi Sovjetik, te Ushtria heroike Sovjetike, te udhëheqësi i shquar, Gjeneralisimi Stalin, luftuan popujt e robëruar të Evropës dhe të botës, luftoi me heroizëm edhe populli ynë i vogël.

Shokë, le të kujtojmë ditët e zeza të robërisë, kur shkeli atdheun tonë të dashur çizmja e gjakosur e fasizmit. Populli ynë në asnjë moment nuk u përkul përpara armikut. Që në thirrjen e parë që Komiteti Qendror i Partisë sonë heroike Komuniste i drejtoi popullit të tij për të rrokur armët dhe për të luftuar deri në vdekje okupatorët dhe tradhëtarët, i tha popullit shqiptar se fitoreja ishte jona, ishte e sigurt, pse lufta e madhe patriotike e çlirimtut udhëhiqej nga popujt e dashur të Bashkimit Sovjetik, udhëhiqej nga Partia e lavdishme Bolshevikë, udhëhiqej nga Stalini i madh. Populli shqiptar, i grumbulluar si një trup rrëth Partisë, i bashkuar në Frontin Nacional-Çlirimtar, luftoi me heroizëm të madh për lirinë dhe për demokracinë popullore, me emrin e Stalinit në gojë dhe me dashuri për popujt e Bashkimit Sovjetik dhe për Ushtrinë e Kuqe. Me miliona nga njerëzit më të mirë të Bashkimit Sovjetik ranë heroikisht në fushën e nderit për kauzën e madhe të njerëzimit. Ata luftuan dhe ranë, që Bashkimi Sovjetik të rrojë i fuqishëm dhe i lulëzuar në shekuj, që komunizmi të triumfojë; ata luftuan dhe ranë, që popujt e botës të rrojnë të lirë. Sot, në ditët e para të përvjetorit të tretë të fitores mbi Gjermaninë naziste dhe satelitët e saj, populli ynë me nderimin më të madh kujton djemtë dhe vajzat e tij më të mira, që ranë për çlirimin e atdheut dhe të popullit, kujton me admirimin më të madh heroinjtë e Bashkimit Sovjetik, dhe brohoret për lavdinë e

Bashkimit Sovjetik, të Ushtrisë Sovjetike, dhe të Stalinit të madh, ndaj të cilëve ai ushqen dashuri të madhe dhe mirënjojje të pakufishme.

Pas Luftës së dytë botërore, lufta më e madhe që ka parë bota, Bashkimi Sovjetik, popujt e demokrative popullore dhe gjithë popujt e tjerë paqedashës të botës ju përveshën punës së palodhur për të rindërtuar vendet e tyre të shkatërruara, për të ngritur ekonomitë e tyre, për të ndërtuar dhe për të konsoliduar paqen e vërtetë dhe të vazhdueshme, për të zhdukur nga rrënjet mbeturinat e fashizmit. Por ndërtimi i paqes së shëndoshë dhe të vazhdueshme, si dhe mirëqenja e popujve, që luftuan për të rrojtur të lirë dhe të pavarur, nuk i pëlqen imperializmit të egër amerikan dhe satelitëve të tij. Imperializmi amerikan po kërcënnon njerëzimin përparimtar me një luftë të tretë botërore. Ai po rimëkëmb dhe po grumbullon rreth tij fashistët dhe gjithë klikat imperialiste. Ai po gjakos një sërë popujsh, të cilët po vazhdojnë të luftojnë akoma me heroizëm për të fituar lirinë e tyre që ua kanë rrëmbyer okupatorët e rinj anglo-amerikanë dhe mercenarët e tyre, vegla të poshtra të fashizmit dhe të imperializmit amerikano-anglez. Imperializmi i egër amerikan, me doktrinën fashiste Truman dhe me planin Marshall po shtyp popujt e Evropës Perëndimore dhe të pjesëve të tjera të kontinenteve. Ai armatos reaksionin botëror dhe Gjermaninë Perëndimore, për t'i pasur si armë kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokrative popullore, kundër gjithë frontit demokratik, antiimperialist dhe gjithë popujve përparimtarë të botës. Por orvatjet e imperializmit amerikan dhe të satelitëve të tij do të dështojnë të gjitha, pse përballë

tyre është kampi i fuqishëm demokratik, në krye të të cilat qëndron i pathyeshëm, më i fortë se kurrë Bashkimi Sovjetik, rrëth të cilat janë grumbulluar si një trup i vetëm të gjithë popujt e demokrative popullore dhe gjithë popujt liridashës të botës. Popujt tanë e dinë se sa u kushtoi liria, sa gjak derdhën për demokracinë e vërtetë, që vendosën në vendet e tyre. Forcat e popujve tanë janë dhjetëfishuar pas kësaj luste të madhe, ku u çelnikos trupi dhe shpirti i tyre. Popujt tanë nuk u trembën as nuk u përkulen përparrë mizorisë Gjermane; aq më pak atyre nuk u trembet syri nga kërcënimet dhe shantazhet e imperializmit amerikan dhe të satelitëve të tij. Përkundrazi, me nervat e tyre të shëndosha dhe me qëndrimin e tyre të palëkundur, ata bëjnë që të dështojë çdo orvatje, çdo manevër e imperialistëve. Popujt e kampit demokratik, me në krye Bashkimin Sovjetik, nuk do të lejojnë kurrë që të drejtat e tyre të dhunohen nga luftëdashësit imperialistë, qoftë edhe një grimë. Kampi demokratik, me në krye Bashkimin Sovjetik lufton me të gjitha forcat e tij për mbrojtjen e paqes së vazhdueshme dhe për lirinë e gjithë popujve që vuajnë e luftojnë nën thundrën e imperializmit. Parimet e shëndosha që udhëheqin politikën dhe luftën e lavdishme të kampit demokratik, koka dhe zemra e të cilat është Bashkimi Sovjetik, do të triumfojnë; do të triumfojë drejtësia e popujve liridashës, do të triumfojë kauza e paqes. Populli ynë do të luftojë deri në vdekje për këtë kauzë. Populli ynë do të shtojë dita-ditës më shumë dashurinë e madhe që ushqen për Bashkimin e madh Sovjetik, për Stalinin e madh, mikun më të shtrenjtë të tij. Populli ynë do të forcojë dita-ditës më shumë

vëllazërimin, miqësinë e shtrenjtë me popujt vëllezër të Jugosllavisë. Populli ynë do të forcojë dita-ditës më shumë vëllazërimin dhe aleancën me popullin vëlla bullgar të Dimitrovit.

Me besimin më të madh në forcat e veta dhe në të ardhmen e tij më të lumtur, populli shqiptar do të punojë me energjinë më të madhe në rrugën për ndërtimin e socializmit në vendin tonë, për jetën më të mirë dhe më të lumtur. Ai do të vërë të gjitha forcat që të realizojë dhe të tejkalojë planin e shtetit, që do të thotë të ngrëjë dhe të bëjë të përparojë ekonomia e tij, të forcojë aftësinë mbrojtëse të vendit, të forcojë demokracinë popullore, pushtetin e tij popullor dhe të dërmojë edhe mbeturinën e fundit të armikut të popullit, që do të orvatet ta pengojë në rrugën e tij të drejtë. Kjo është rruga që ndjek dhe do të ndjekë me vendosmëri populli ynë. Kështu ai është i sigurt se lufton për të mirën e tij, lufton për demokracinë dhe për paqen e vazhdueshme, lufton kundër manevrave dhe kërcënimeve të imperialistëve amerikanë dhe satelitëve të tyre dhe bëhet një pjesëtar i denjë i kampit demokratik antiimperialist.

Rroftë populli shqiptar!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 1051.
12 maj 1948*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

URDIIER DITE ME RASTIN E PËRVJETORIT TË KATËRT TË ARMËS SË NDËRLIDHJES

22 qershor 1948

Shokë ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe gjeneralë,

Ushtria jonë sot feston përvjetorin e katërt të themelimit të Armës së Ndërlidhjes. Që prej kësaj dite në këtë armë janë bërë përparime të mëdha dhe janë korrur suksese me rëndësi.

Eshtë bërë organizimi i ndërlidhjes në formacione speciale si dhe specializimi nga ana teknike e kuadrit të dalë nga Lufta nacional-çlirimtare. Janë krijuar baza materiale me klasa mësimi model, të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme, për ta bërë mësimin sa më të kuptueshmëm dhe më praktik. Janë shtrirë qindra kilometra tel dhe janë organizuar qendra telegrafonike e radiotelegrafike në të gjitha repartet e ushtrisë, duke siguruar ndërlidhjen e tyre me mjete moderne. Nga radhët e reparteve të Armës së Ndërlidhjes, të ardhur për të kryer shërbimin ushtarak, me mijëra djem të thjeshtë të popullit, janë bërë radiotelegrafistë, telegrafistë, telefonistë dhe elektromekanikë të zot.

Sot, në lidhje me detyrën e përgjithshme për modernizimin e plotë dhe forcimin e mëtejshëm të ushtrisë sonë, për pregetitjen luftarake në një shkallë më të lartë të saj, Armës së Ndërlidhjes, si pjesë e pandarë e kësaj ushtrie, i dalin përparrë detyra me shumë rëndësi.

Ushtarët, nën oficerët dhe oficerët e ndërlidhjes të mobilizohen me të gjitha forcat për kryerjen me sukses të plotë të programave të specialitetit; oficerët dhe nën oficerët e ndërlidhjes të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për zgjerimin e njohurive teknike për t'u bërë udhëheqës të zot dhe të perfektionuar në punën e tyre. T'i kushtohet një kujdes i madh nga të gjithë forcimit të disciplinës ushtarake. Krahas me pregetitjen speciale luftarake të ndërlidhjes, t'i vihet rëndësi e veçantë edukimit ideo-politik e kultural nga të gjithë ushtarët, nën oficerët dhe oficerët, pse kështu do të sigurohet kryerja me sukses të plotë e detyrave tuaja, që janë të pandara nga detyrat e përgjithshme të ushtrisë.

Shokë ushtarë, nën oficerë, oficerë dhe gjeneralë,

Ju uroj me rastin e katër vjetorit të festës të Armës së Ndërlidhjes suksese të vazhdueshme në kryerjen e detyrave.

Shokë ushtarë, nën oficerë, oficerë të Armës së Ndërlidhjes, ju uroj të plotësoni dhe të perfektiononi ndërlidhjen.

Me rastin e kësaj festë urdhëroj repartet e ndërlidhjes të parakalojnë dhe dita 22 Qershor të jetë ditë pushimi për Armën e Ndërlidhjes.

Rroftë ushtria kombëtare!
Rroftë arma e ndërlidhjes!
Rrofshin ndërlidhësit besnikë të ushtrisë sonë!

Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të
Armatosura të RP të Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 1086,
22 qershor 1948*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 1086,
22 qershor 1948*

**URDHËR DITE ME RASTIN E FESTËS SË
10 KORRIKUT — PESËVJETORIT TË USHTRISE
POPULLORE**

10 korrik 1948

Shokë ushtarë, nënëficerë, oficerë dhe gjeneralë,

5 vjet më parë, me iniciativën e Partisë Komuniste dhe të Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar, në Labinot u krijuva Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Kjo ditë shënon në historinë e popullit shqiptar krijimin e ushtrisë së tij heroike.

Gjatë këtyre pesë vjetve, kohë relativisht e shkurtër, Ushtria Kombëtare ka kaluar një rrugë të madhe dhe të lavdishme. E gjithë historia e saj është e mbushur me shembuj të lartë heroizmi dhe vetëmohimi ndaj popullit dhe atdheut.

E lindur në luftën e çlirimit të vendit, ajo luftoi me ashpërsi kundër okupatorëve fashistë italianë dhe gjermanë dhe kundër bandave tradhëtare të vendit tonë, ajo i mundi njërin pas tjetrit armiqëtë, i siguroi popullit çlirimin e plotë dhe i dha atij mundësinë të vendosë demokracinë popullore, duke hapur në këtë mënyrë rrugën për ndërtimin dhe përparimin e vendit drejt socialistizmit.

Populli ynë fitoi lirinë dhe demokracinë në saje të mësimeve të Leninit dhe të Stalinit, në saje të luftës së lavdishme të Bashkimit Sovjetik dhe të Ushtrisë Sovjetike, e cila, e udhëhequr prej mësuesit dhe strategut më të madh të të gjithë kohërave, Gjeneralisimit Stalin, u mbulua me lavdi dhe u dha njëkohësisht lirinë e pavarësinë popujve që vuanin nën thundrën fashiste.

Ushtria jonë fitoi, pse ajo në luftën e saj ishte lidhur ngushtë me popullin. Populli i dha asaj djemtë më të mirë, e rriti atë në gjirin e tij, e mbajti dhe e frymëzoi pa kursyer asnjë sakrificë.

Udhëheqja e Partisë Komuniste, e cila ka qenë organizatorja dhe frymëzuesja e gjithë fitoreve, përbente burimin e shëndoshë të fuqisë të ushtrisë sonë. Me politikën e saj luftarake të drejtë, të mbështetur mbi mësimet e marksizëm-leninizmit, Partia Komuniste i bashkoi e i organizoi më së miri të gjitha forcat e popullit në luftë, në gji të Frontit Nacional-Çlirimtar, në radhët e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare dhe kështu të bashkuar, i udhëhoqi në fitore.

Ushtria Nacional-Çlirimtare fitoi, pse në krye të treshtave partizane gjendeshin bijtë më të mirë të popullit, djemtë e punëtorëve e të fshatarëve dhe intelektualët patriotë që, për zotësinë e tyre në udhëheqjen luftarake, ua kaluan oficerëve dhe gjeneralëve me shkollë të armikut dhe i mundën ata.

Pas çlirimtimit të vendit, në kohën kur populli ynë filloj punën e madhe për ndërtimin e gjithanshëm të vendit, Ushtria Kombëtare filloj nga realizimi i detyrës së madhe për organizimin dhe preqatitjen e saj luftarake në baza moderne, në bazë të artit ushtarak sovjetik

dhe të eksperiencës së Luftës së dytë botërore. Përparimet që janë bërë brenda kësaj periudhe në këtë drejtim janë me të vërtetë të mëdha, por ne s'duhet të kënaqemi me kaq dhe të ndalemi në sukseset e arritura. Ne duhet vazhdimisht dhe pa u lodhur të perfeksionojmë artin luftarak dhe të zotërojmë teknikën dhe mjetet e luftës moderne.

Populli ynë, i udhëhequr prej Partisë Komuniste dhe qeverisë së tij, me përpjekje kolosale ka arritur fitore të rëndësishme në ngritjen dhe forcimin e ekonomisë. Në përvjetorin e pestë të Ushtrisë Kombëtare ai është mobilizuar për realizimin e planit të shtetit. Ky përvjetor e gjen popullin tonë më të fortë dhe më të bashkuar në gji të kampit të fuqishëm demokratik, në krye të të cilit qëndron Bashkimi Sovjetik me Stalinin e madh, e gjen ushtrinë tonë më të fortë se kurrë, të veshur e të mbathur dhe të armatosur me mjete dhe armë të luftës moderne, të gatshme të mbrojë në çdo rast kufitë e atdheut, lirinë dhe pavarësinë e popullit shqiptar. Ushtria Kombëtare është roja besnike e fitoreve të popullit tonë, ajo që në ditët e çlirimt e deri më sot ka mbrojtur me heroizëm dhe besnikëri kufitë e atdheut kundër imperialistëve dhe monarko-fashistëve grekë, që kanë bërë me qindra provokacione dhe kërcënime.

Ne nuk duhet të harrojmë për asnjë çast se imperialistët dhe shërbëtorët e tyre kanë qëllime agresive kundrejt Republikës sonë Popullore. Këto rrethana na detyrojnë që të jemi kurdoherë vigjilentë dhe të gatshëm.

Sukseset që janë arritur deri tani në stërvitjen luftarake, në edukimin ideo-politik dhe në sektorët e

tjerë të na nxitin për suksese dhe fitore të reja në detyrat që na ngarkohen për modernizimin dhe forcimin e ushtrisë sonë.

Të gjithë ushtarët, nënoficerët dhe oficerët e Ushtrisë Kombëtare të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të zgjeruar njohuritë ushtarake dhe teknike, të mësojnë nga eksperiencia dhe nga traditat e Luftës nacional-çlirimtare, të përfitojnë nga eksperiencia e madhe luftarake e Ushtrisë Sovjetike si dhe nga arti luftarak stalinian.

Shokë ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe gjeneralë,

Duke ju përshëndetur dhe duke ju uruar festën e madhe të pesëvjetorit të ushtrisë sonë kombëtare,

Urdhëroj :

1) Të gjithë ushtarët dhe nënoficerët e këmbësorisë, të mortajave, të artilerisë, të aviacionit, të tanksave, të marinës, të xhenjos dhe të ndërlidhjes, pa u lodhur dhe me një vullnet të çelniktë, të perfeksionojnë dhe të zgjerojnë artin dhe njohuritë teknike luftarake.

2) Oficerët dhe gjeneralët e të gjitha armëve të perfeksionojnë artin e komandimit, të zotërojnë taktil-kënd manevruese staliniane, të studjojnë, të përvetësojnë dhe të aplikojnë në ushtrinë tonë artin luftarak stalinian.

3) Të forcohet dhe të çelnikoset në radhët e luftëtarëve disiplina ushtarake, pa të cilën nuk mund të shkohet përpara drejt forcimit dhe zhvillimit të ushtrisë.

4) Organet politike, komisarët e reparteve dhe të

njësive të organizojnë në mënyrë të shëndoshë edukimin ideologjik e politik të ushtarëve, të nënoficerëve dhe të oficerëve, me parimet e marksizëm-leninizmit dhe të ngrenë në një shkallë më të lartë nivelin ideo-politik të tyre.

5) Me rastin e pesë vjetorit të themelimit të Ushtrisë Kombëtare në kryeqytetin e Republikës sonë Populllore, Tiranë, të zbrazen 120 të shtëna artilerie dhe në qytetet: Korçë, Gjirokastër e Vlorë, 21 të shtëna.

Në kryeqytet sot, më 10 Korrik të bëhet parada me repartet e garnizonit të Tiranës.

Rroftë Ushtria Kombëtare Shqiptare!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë Republika Popullore e Shqipërisë!

**Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të
Armatosura të RP të Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel**

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 1102,
10 korrik 1948*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 1102,
. 10 korrik 1948*

**FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT DHE
REPARTEVE USHTARAKE TË GARNIZONIT TË
TIRANËS ME RASTIN E PËRVJETORIT TË
RESTË TË KRIJIMIT TË USHTRISE
POPULLORE**

10 korrik 1948

Popull shqiptar, shokë ushtarë, nënoficerë, oficerë
dhe gjeneralë,

Ju përshëndes nxehësisht dhe ju përgëzoj në emër
të qeverisë, të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste
të Shqipërisë dhe në emrin tim për ditën e gjuar të
përvjetorit të pestë të Ushtrisë sonë Kombëtare.

Sot i gjithë populli ynë e feston me krenari përvjetorin e pestë të ushtrisë së tij që çlroi atdheun, që
i dha lirinë atdheut dhe sot ruan me besnikëri fitoret
e popullit dhe indipendencën e integritetin e Republikës
sonë Popullore.

Populli ynë sot kujton me nderimin më të madh
bijtë e tij të shtrenjtë dhe heroikë që ranë në luftën e
madhe të çlirimtë; populli ynë nderon ushtrinë e tij he-
roike dhe veprën e saj të pavdekshme.

Pesë vjet më parë, nën udhëheqjen besnikë të Partisë
sonë heroike u krijuau Ushtria Nacional-Çlirimtare, e

cila përshkoi një rrugë plot fitore dhe lavdi. Kundër fashizmit dhe tradhëtarëve të vendit, ushtria jonë, pjesë e popullit tonë punonjës, luftoi me vetëmohim dhe heroizëm të shquar për popullin. Lufta heroike e saj, gjaku i dëshmorëve të rënë në luftë dhe sakrificat e mëdha të popullit tonë nuk shkuan kot. Këto u kurorëzuan me fitoren e plotë mbi okupatorët fashistë italianë e gjermanë dhe mbi tradhëtarët e vendit, me vendosjen e pushtetit dhe të demokracisë popullore, me ngritjen e Republikës sonë Popullore.

Prandaj me plot të drejtë populli ynë ushqen dashurinë më të madhe dhe shpreh mirënjojen më të thellë për ushtrinë e tij, që u mbulua me lavdinë e kaq betejave të përgjakshme fitimtare mbi fashistët okupatorë.

Sot përvjetori i pestë i ditës së themelimit të ushtrisë sonë e gjen popullin shqiptar të mobilizuar totalisht për realizimin e planit dhe për ndërtimin e jetës së tij më të mirë, e gjen popullin tonë të rreshtuar dhe të bashkuar me gjithë popujt e demokrative popullore dhe me popujt përparimtarë të botës në kampin e patheshëm demokratik dhe antiimperialist që ka në krye Bashkimin e lavdishëm Sovjetik. Përvjetori i pestë i ushtrisë e gjen popullin tonë të vendosur, për të luftuar deri në fund kundër çfarëdo kërcënimi të armiqve imperialistë amerikanë dhe anglezë dhe veglave të tyre nën çdo maskë që ata të fshihen, e gjen popullin tonë të vendosur të mbrojë paqen e drejtë, demokracinë popullore dhe të ecë për fitoren e socializmit.

Në ditën e pesëvjetorit të Ushtrisë Kombëtare populli ynë i drejton shprehjet më të zjarrta të dashurisë

dhe të mirënjojjes së tij popujve miq të Bashkimit të madh Sovjetik, Ushtrisë heroike Sovjetike e Stalinit të madh për luftën dhe sakrificat e pashebullta që ata bë-në për shkatërrimin e fashizmit, për çlirimin e popujve të robëruar nga fashizmi.

Lufta e Bashkimit Sovjetik nuk qe vetëm shembull nga muarën forcë dhe guxim popujt përparimtarë lë botës që luftuan kundër fashizmit, por qe dhe faktori kryesor për shkatërrimin e fashizmit dhe për fitoren e lirisë dhe të pavarësisë së popujve.

Pa luftën vigane të vendit të socializmit, pa luftën dhe sakrificat e pashebullta të popujve dhe të Ushtrisë Sovjetike, që nën udhëheqjen e Partisë Bolshevikë dhe të Stalinit luftuan me tërë forcat e tyre për çlirimin e atdheut socialist dhe të mbarë njerëzimit nga murtaja fashiste, nuk do të kishte qenë e mundur fitorja mbi fashizmin.

Bashkimi Sovjetik dhe Stalini i madh asnjëherë nuk e kanë kursyer e nuk po e kursejnë ndihmën e tyre të vlefshme materiale dhe morale për popullin tonë të vogël dhe shprehjet e gjalla të miqësisë së tyre të singertë. Populli ynë e ruan në zemër si gjënë më të shtrenjtë dhe do ta forcojë gjithnjë më shumë këtë miqësi me Bashkimin Sovjetik, me Partinë Bolshevikë dhe me Stalinin e madh.

Populli ynë po e forcon e do ta forcojë dita-ditës miqësinë e tij me gjithë popujt përparimtarë të botës, të kampit demokratik dhe antiimperialist.

Për fat të keq kohët e fundit në mes të vendit tonë dhe Jugosllavisë janë vërtetuar vështirësi të mëdha dhe për këto vështirësi nuk është përgjegjës populli ynë

dhe qeveria e tij, por përgjegjësia bie mbi udhëheqësit antimarksistë të Jugosllavisë, të cilët kanë bërë një politikë të turpshme e armiqësore ndaj vendit tonë.

Populli ynë ka luftuar shekuj me radhë për të qenë politikisht dhe ekonomikisht i lirë. Ata që mendojnë se mund t'ja shkelin lirinë popullit shqiptar gabohen rëndë dhe duhet ta dinë se nuk ndahen mirë me të. Populli shqiptar mund të rrojë me një krodhë bukë, por asnje minutë pa liri. Këtë le ta mbajnë shënim të gjithë ata që mendojnë ndryshe për popullin shqiptar.

Udhëheqësit antimarksistë jugosllavë janë përpjekur ta shkëputin popullin tonë nga Bashkimi Sovjetik, por kanë dështuar në qëllimin e tyre armiqësor antisovjetik. Populli ynë s'ndahet asnje grimë nga atdheu i lavdishëm i socializmit që është mbrojtës i pathyeshëm i popullit tonë dhe i gjithë popujve të botës. Armiqtë e Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë së lavdishme të Lenin-Stalinit janë armiqëtë e popullit tonë deri në vdekje.

Populli shqiptar nuk mund të mos hidhërohet për një situatë të tillë të padëshirueshme në mes të vendit tonë dhe Jugosllavisë; ai hidhërohet pa masë për fatin e keq të popujve vëllezër të Jugosllavisë. Por populli ynë është plotësisht i bindur se këto vështirësi do të kapërcehen me sukses nga të dy popujt tanë. Popujt vëllezër të Jugosllavisë e dinë fare mirë se populli shqiptar dëshiron të ketë kurdoherë marrëdhënje të shëndosha, në baza të drejta, të cilat të mos cënojnë as pavarësinë, as lirinë dhe as të drejtat e barabarta të të dy vendeve tona, marrëdhënje të singerta ashtu si i vendosën në llogoret e Kosovës, të Metohisë, të Malit të Zi, të Bosnjës dhe të Hercegovinës, partizanët shqiptarë dhe

jugosllavë që luftonin me tërbim armikun e përbashkët dhe që mbanin në gji Historinë e Partisë së lavdishme Bolshevikë të Bashkimit Sovjetik dhe që binin në fushën e nderit me emrin e të madhit Stalin në gojë.

Popujt e Jugosllavisë e dinë fare mirë se te populli ynë ata kanë një mik besnik, që ruan në zemër si gjë të shtrenjtë miqësinë me popujt dhe atdheun e heroit të popujve të Jugosllavisë Miladin Popoviçit. Armiqtë e kësaj miqësie përpinqen ta errësojnë këtë miqësi që ekziston në mes popullit tonë dhe popujve të Jugosllavisë; ata përpinqen ta njollosin e t'i zemërojnë popujt e Jugosllavisë me popullin tonë, ata përpinqen t'i gënjejnë, por gënjeshtra i ka këmbët të shkurtra. Populli jugosllav do ta gjejë rrugën e drejtë, rrugën e nderit. Këtë rrugë i uron populli ynë i vogël.

Shokë ushtarë, nënoficerë, oficerë, komandantë dhe komisarë të Ushtrisë Kombëtare,

Detyrat që ju janë vënë përpara për forcimin dhe modernizimin e ushtrisë, të jenë të shenjta për ju dhe të zbatohen e të kryhen me përpikërinë më të madhe, pse vetëm kështu ruhet, mbrohet dhe forcohet si duhet atdheu ynë i dashur. Detyrave që ju ngarkon populli dhe atdheu t'ju përgjigjeni me gatishmëri të plotë. Të përvetësoni me një etje të madhe artin luftarak të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike, të edukoheni dhe të brumoseni me ideologjinë marksiste-leniniste, të perfeksiononi preqatitjen ushtarake dhe politike të trupës, të forconi disiplinën e çelniktë dhe të vetëdijshme, të doni si shpirtin tuaj popullin dhe atdheun, të doni Bashkimin

e madh Sovjetik dhe të madhin Stalin, të doni me gjithë zemër popujt e tjerë përparimtarë, të jeni kurdoherë të gatshëm dhe vigjilentë për të mbrojtur fitoret e popullit tonë që na kanë kushtuar gjak e vuajtje të panumërtë, të jeni gati t'u thyejmë dhëmbët të gjithë atyre armiqve, që do të guxojnë të na prekin të drejtat tona.

Lavdi heronjve të popullit tonë që dhanë jetën për çlirimin e popullit dhe të atdheut!

Lavdi partizanëve dhe partizaneve të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare!

Për ushtrinë tonë heroike, urra!

Për Partinë heroike Komuniste të Shqipërisë, urra!

Për Bashkimin e lavdishëm Sovjetik, urra!

Për Ushtrinë e lavdishme Sovjetike, urra!

Për mësuesin e lavdishëm të proletariatit të mbarë botës, për udhëheqësin e popujve të Bashkimit Sovjetik, për mikun e shtrenjtë dhe të zemrës të popullit tonë, të madhin Stalin, urra!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 1103,
11 korrik 1948*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 1103,
11 korrik 1948*

PËRMBLEDHJE E BISEDËS SË ZHVILLUAR ME NJË GRUP SULMUESISH MË TË MIRË TË VENDIT

24 korrik 1948

Duhet të formohet bindja në popull se sulmuesit janë ndër njerëzit më të nderuar; ata e kanë merituar këtë titull nderi me punën e tyre, me djersën e tyre. Me punën tuaj ju duhet të jeni shembull për gjithë popullin. Lëvizja sulmuese nuk duhet të mbetet vetëm në 500-600 sulmues, por duhet të bëhet një lëvizje e gjerë dhe e madhe e masave, pse vetëm në këtë mënyrë do të bëhet zhvillimi i mëtejshëm i industrisë dhe i ekonomisë sonë. Ju jeni ata që me shembullin tuaj do të mësoni edhe punëtorët e tjerë. Vendi ynë ka nevojë për një punë të madhe. Socializmi ndërtohet me njerëz, me krahë, me kokë. Duhet të punojmë me krahë dhe me kokë, të mos quhen këto dy gjëra të shkëputura. Punëtorët tanë duhet të jenë në ballë të punës, të punojnë me kokë, të bëhen drejtues.

Punëtorët tanë duhet të bëhen njerëzit më të mësuar, ju e dini se ç'ka hequr në regjimet e kaluara klasa punëtore. Sot kemi pushtetin popullor, shtylla e të cilit jeni ju. Partia Komuniste, që udhëheq popullin tonë, klasën punëtore e ka shtyllën e saj për ndërtimin e so-

cializmit. Sulmuesit që s'janë anëtarë partie duhet që, me punën e tyre, të bëhen të gjithë anëtarë partie. Këtu ne duhet të synojmë. Nderi më i madh është që të bëhesh anëtar partie. Anëtarë partie janë ata që punojnë më tepër, janë ata që i shërbejnë më te-për popullit.

«Ne — vazhdon shoku Enver — duhet të kemi besim të madh në forcat tona, në krahët tanë. Unë para disa kohësh isha në kantierin vajguror të Kuçovës. Kuçova drejtohet sot nga shokët tanë punëtorë. Atje punëtorët drejtojnë vetë reparte të tëra. Kështu duhet të veprohet në të gjitha fabrikat dhe minierat tona; punëtorët të marrin drejtimin dhe përgjegjësinë në dorë. Ata të drejtojnë me ndërgjegje dhe konshencë; shteti e kërkon që ata të tregojnë kujdes, vullnet të madh dhe të mësojnë sa më shumë».

Duke e vënë theksin te mbështetja në forcat e veta, shoku Enver u ndal edhe në marrëdhënjet e ndihmës reciproke me vendet miq, sidomos me Bashkimin Sovjetik. «Ne do të kemi një ndihmë të madhe nga Bashkimi Sovjetik, ndihmë që na ka ardhur dhe do të vazhdojë të vijë. Ai do të na ndihmojë me materiale dhe teknikë. Bashkimi Sovjetik do të dërgojë teknikë të zot, të cilët do t'u japid kuadrove tanë të gjithë atë që dinë, për të mësuar sa më mirë.

Tani ne jemi të varfër në maqineri, në vegla ndërrimi, prandaj duhet të kemi kujdes për mirëmbajtjen dhe për ruajtjen e tyre, pse këto nuk blehen kollaj dhe kushtojnë shumë. Merrni shembull nga Kuçova; centrali elektrik është i vjetër, por punëtorët bëjnë të gjitha përpjekjet që ky të funksionojë në rregull. Ma-

qinerinë ta konsideroni si njeri të gjallë dhe jo si hekur, asaj t'i bëhet një shërbim i madh, ju të jeni doktorë të maqinave. Nga ju kërkohet një kujdes i madh, t'i hapni sytë mirë se armiku nuk flen, por ai përpinqet të na dëmtojë. Ka armiq, prandaj duhet t'i goditni pa mëshirë. Sa më të fortë që të bëhem ne, aq më tepër do të përpinqen të na godasin ata në mënyra të ndryshme. Ju e shihni se ç'po ndodh sot në Jugosllavi, atje udhëheqësit kanë tradhëtar rrugën e marksizëm-leninizmit, kanë tradhëtar partinë dhe popullin e tyre dhe ecin drejt afrimit me vendet kapitaliste.

Klasa punëtore — vazhdoi shoku Enver — duhet të jetë në ballë, për të mbrojtur Partinë e saj, për të zbatuar udhëzimet dhe direktivat që jep Partia Komuniste, sidomos në këto momente ne duhet të vëmë të gjitha forcat për realizimin e planit të shtetit. Këto janë momente të vështira dhe do të na mungojnë disa gjëra, por ne do të vëmë të gjitha forcat për t'i kryer me sukses detyrat tona. Ne kemi mundësi që ta realizojmë planin e shtetit dhe do ta realizojmë. As në hekurudhë nuk pushuan punimet, as Kuçova, as Patosi e as të tjerat nuk ngelën pa punuar, me gjithë ato që ndodhën me Jugosllavinë. Kjo tregon se klasa jonë punëtore është në gjendje dhe ka mundësi ta realizojë planin e shtetit. Sot shkoi në Bashkimin Sovjetik një delegacion tregëtar dhe ekonomik i qeverisë sonë. Së shpejti do të kemi ndihmën e Bashkimit Sovjetik në maqineri dhe në mallra të konsumit të gjerë. Shokët tanë që shkuan atje do të kenë gjithë ndihmën dhe përkrahjen e Stalinit të madh dhe të qeverisë së tij. Gjithashtu këto ditë ka ardhur një delegacion tregëtar

bullgar; ne do të vendosim marrëdhënje tregëtare dhe me Bullgarinë. Ka ardhur atasheu tregëtar çekoslovak, edhe ky për marrëdhënje tregëtare. Vendi ynë nuk është aspak i izoluar, siç pretendojnë armiqtë tanë. Shqipëria s'është e rrëthuar; populli ynë, që ndërton me mund dhe djersë vendin e tij, ka ndihmën e madhe të Bashkimit Sovjetik, të cilin e ka mik, si dhe gjithë demokracitë popullore dhe vetë popujt e Jugosllavisë. Duhet ta dimë se popujt e Jugosllavisë janë miq të popullit tonë dhe nuk mund të janë kundër nesh. Interesat e tyre janë në kundërshtim me politikën e udhëheqjes së tyre tradhëtare dhe këtë do ta tregojnë me vepra. Popujt e Jugosllavisë do ta shohin sa i drejtë ka qenë vendimi i Byrosë Informative, sa të vlefshme dhe me vend kanë qenë këshillat e Stalinit, të Partisë Komuniste (bolshevike) të BS dhe të gjitha partive të tjera motra. Në këtë situatë, kur reaksiioni mendon të përfitojë, punëtorët duhet të vënë të gjitha forcat e veta për realizimin e planit të shtetit dhe në ballë të këtyre përpjekjeve duhet të jeni ju, sulmues!».

Pasi dëgjoi vlerësimin që i bëri një sulmues punës së teknikëve jugosllavë shoku Enver shtoi:

«Shqipëria ka pasur dhe do të ketë nevojë për teknikë, por për teknikë të ndershëm, komunistë dhe internacionalistë. Ne nuk duam nga ata, që kanë ardhur me qëllime armiqësore në vendin tonë. Ju e dini se në Kuçovë teknikët jugosllavë nuk dhanë asnjë ndihmë, përkundrazi u përpoqën të mos u mësojnë asgjë punëtorëve tanë. Ata kanë qenë armiq të klasës punëtore dhe të popullit tonë; ata janë armiq edhe të popullit të tyre. Ka të drejtë të plotë shoku sulmues që shprehet

në këtë mënyrë për teknikët jugosllavë, kur tha se ata s'kanë dhënë asnjë ndihmë. Teknikët sovjetikë, që do të qëndrojnë për një kohë në vendin tonë, kanë ardhur për të ndihmuar dhe për të mësuar njerëzit tanë që kështu të bëhem i vetë të zot për të shfrytëzuar burimet tona. A ka qëllim më të lartë se ky? Fabrikat janë tuajat, prandaj të keni kujdes të madh që të përsitoni nga teknika, sepse ju vetë do t'i drejtoni këto fabrika». «Një shok këtu, — shtoi shoku Enver — tha mirë se, çdo punëtor, qoftë anëtar partie ose jo, veç zanatit duhet të mësojë e të pajiset edhe me ideologjinë marksiste-leniniste, sepse kjo është arma më e mirë dhe më e fortë e klasës punëtore. Kur armatose me atë, çdo punë mund të bëhet, çdo gjë mund të zgjidhet».

Duke i këshilluar sulmuesit që të vizitonin ekspozitën që ishte hapur një ditë më parë, për bashkëpunimin kultural në mes RP të Shqipërisë dhe BRSS, shoku Enver u foli pjesëmarrësve edhe për marrëdhënjet kulturale me Bashkimin Sovjetik.

«Lidhja kulturale me BS ka rëndësi të madhe për ne; degët e saja duhet të ekzistojnë kudo në vendin tonë. Ato duhet të përhapin me anë gazetash, shfaqjesh dhe konferencash në popullin tonë, kulturën sovjetike, që është kultura më përparimtare në botë, kulturën e klasës punëtore të mbështetur në marksizëm-leninizmin. Kjo kulturë do të na mësojë si punojnë popujt sovjetikë, si punohet në fabrikat e në kolkozet. Populli ynë të mësojë sa më shumë prej saj. Në këto 30 vjet që kanë kaluar popujt sovjetikë, me punën ndërtuese, me shumë halle e vështirësi, kapërcyen etapa të ndryshme, por gjithnjë kanë dalë triumfues».

Pasi pyeti sulmuesit e hekurudhës mbi zhvillimin e punimeve në hekurudhë, shoku Enver tha:

«Hekurudhën do ta mbarojmë patjetër. Qeveria e RP të Rumanisë na ka falur një tren komplet dhe nga Bashkimi Sovjetik do të na vijnë shina dhe material tjetër për ndërtimin e hekurudhës».

Duke përfunduar shoku Enver u uroj suksese në punë dhe shtoi: «Do të kemi raste të shihemi më dendur, edhe unë do të kem kohë që të vi të takohem me ju. Partia Komuniste dhe qeveria ka bindje se ju do të jeni kurdoherë në krye të punës».

Botuar për herë të parë në gazetën «Bashkimi», Nr. 1115,

25 korrik 1948

Botohet sëpas tekstit të gazetës «Bashkimi», Nr. 1115,

25 korrik 1948

URDHËR DITE ME RASTIN E PËRVJETORIT TE PESTË TË ARMËS SË ARTILERISE

18 tetor 1943

Shokë ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe teknikë të artilerisë e të mortajave të Ushtrisë Kombëtare,

Sot, forcat e armatosura të Republikës sonë Popullore dhe gjithë populli shqiptar festojnë përvjetorin e pestë të Armës së Artilerisë.

E formuar gjatë luftës së madhe çlirimtare të popullit tonë dhe e inkuadruar në rreshtat e Ushtrisë heroike Nacional-Çlirimtare të udhëhequr nga Partia e lavdishme Komuniste, artileria dhe mortajat tona kaluan një rrugë të lavdishme duke u zhvilluar dhe duke u përforcuar në luftën e ashpër dhe të pabarabartë kundër zaptuesve fashistë italianë e gjermanë dhe tradhëtarëve të vendit, të mbështetur kryesisht në luftën e madhe patriotike të popujve të Bashkimit Sovjetik nën udhëheqjen e Partisë së lavdishme Bolshevikë dhe të Stalinit të madh.

Artileria dhe mortajat, si fuqi zjarri përkrahëse dhe mbështetëse e formacioneve trime partizane, kryen mëndër dhe me sukses detyrën para popullit dhe atdheut.

Dita 18 tetor 1943 është dita më simbolike, në të cilën artileria partizane bëri aksionin e madh historik

kundër gjermanëve dhe kuislingëve shqiptarë të mbledhur në Asamblenë e kurdisur për të legalizuar sundimin dhe shtypjen dhe për të pregetitur planet e tyre gjakpirëse që t'i futnin frikën popullit tonë heroik. Në këtë ditë, zjarri i artilerisë partizane, i hapur që nga kodrat e Saukut të Tiranës, shpërndau Asamblenë tradhëtare dhe populli fitoi një betejë të madhe politike.

Megjithëse në kondita shumë të vështira, artileria dhe mortajat tona me zjarr dhe me manevr, duke ndjekur shembullin e artilerisë sovjetike, kaluan male dhe fusha të atdheut tonë, që nga Jugu në Veri dhe në tokat e Jugosllavisë, duke përkrahur dhe duke mbështetur me sukses këmbësorinë e tyre në veprimet e ndryshme luftarake dhe lehtësuan e siguruan fitoret e njëpasnjëshme për Ushtrinë tonë trime Nacional-Çlirimtare.

Sot, në kondita paqësore, duke ndjekur vazhdën e traditave të luftës për liri të artiljerëve dhe të partizanëve trima të Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare dhe duke u bazuar në eksperiencën e madhe të artilerisë dhe të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike, ushtarët, kuadrot dhe teknikët e artilerisë dhe të mortajave tona po punojnë me të gjitha forcat për ngritjen e perfeksionimin e armës së tyre.

Shokë artiljerë e mortaistë,

— Të ruani dhe të përvetësoni më mirë teknikën e armës suaj.

— Të zbatoni me përpikëri të gjitha urdhërat dhe detyrat që ju ngarkohen për përforcimin e artilerisë dhe të ushtrisë sonë.

— Të gjithë oficerët e artilerisë dhe të mortajave të perfeksionojnë dituritë e tyre si artiljerë e mortaistë për udhëheqjen më të mirë të zjarrit të armëve të tyre të fuqishme.

— Të jeni vigjilentë dhe të gatshëm në çdo rast për të mbrojtur me vendosmëri interesat e larta të popullit e të atdheut.

Shokë ushtarë, nën oficerë, oficerë, teknikë të artilerisë e të mortajave dhe artiljerë në lirim,

Ju uroj dhe ju përshëndes për festën e artilerisë.

Për ndër të përvjetorit të pestë të armës suaj, urdhëroj:

Sot, 18 tetor 1948, ora 17,30' në kryeqytetin e Republikës sonë, Tiranë dhe në qytetet Korçë, Gjirokastër, Vlorë, Berat dhe Elbasan të shtihen 10 përshëndetje artilerie.

Rroftë përvjetori i artilerisë shqiptare!

Rroftë ushtria jonë heroike!

Le të rrojë atdheu ynë i dashur dhe populli trim shqiptar!

Le të rrojë Partia e lavdishme Komuniste!

Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura
të RP të Shqipërisë

Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetenë «Bashkimi», Nr. 1188,*

19 tetor 1948

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 1188.*

19 tetor 1948

**LETËR DËRGUAR REDAKSISË SË GAZETËS
«ZËRI I POPULLIT» ME RASTIN E RIFILLIMIT
TË BOTIMIT TË KËTIJ ORGANI**

5 nëntor 1948

KRYEREDAKSISË SË «ZËRIT TË POPULLIT».

Ju urojmë sukses në detyrën e rëndë që ju ngarkon Komiteti Qendror.

Në kohët më të rënda të ilegalitetit, Komiteti Qendror i Partisë sonë botoi për herë të parë «Zerin e Popullit», i cili transmetoi me besnikëri zérin e fuqishëm të Partisë sonë heroike për mobilizimin e popullit në kryengritjen e përgjithshme popullore. «Zëri i Popullit» e kreua me nder detyrën e tij, pse Partia i kreua me nder detyrat e saja para popullit tonë.

Sot rifillon përsëri të vazhdojë misionin e vet të lartë «Zëri i Popullit» dhe sot në Shqipërinë e re, ku pas kaq luftëtrash të popullit tonë, të udhëhequr nga Partia është vendosur demokracia popullore, «Zëri i Popullit» do të jetë tribuna e Partisë, për të propaganduar dhe për të luftuar për zbatimin e përpiktë të vijës së Partisë sonë që ka të vetmin qëllim: forcimin e Shqipërisë së re, mbrojtjen e demokracisë sonë popullore,

mbrojtjen e pavarësisë, të lirisë, të sovranitetit dhe të gjithë fitoreve të Luftës nacional-çlirimtare, që ka për qëllim ndërtimin e jetës më të mirë për popullin dhe për brezat e ardhshëm të vendit tonë, ndërtimin e socializmit, që ka për qëllim të mbrojë paqen dhe të luftojë me ashpërsinë më të madhe imperializmin amerikan dhe satelitët e tij luftëdashës dhe armiq të betuar të popullit tonë, të paqes dhe të njerëzimit përparimtar.

«Zëri i Popullit» me të gjitha forcat të shtojë dhe të çelnikosë në zemrat e popullit tonë dashurinë ndaj mikut të lavdishëm të popullit tonë, Bashkimit Sovjetik, ndaj Partisë së lavdishme bolshevike të Lenin-Stalinit, ndaj shokut të madh Stalin. Jeta e popullit tonë dhe e ardhmja e lumtur e tij janë të lidhura me Bashkimin Sovjetik. Shqipëria e re, nën udhëheqjen e Partisë sonë, do të ecë përpara, do të përparojë dhe do të shkojë në socializëm.

Ju uroj suksese në punë.

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 1(22), 5 nëntor 1948*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Zëri i Popullit»,
Nr. 1(22), 5 nëntor 1948*

REVOLUCIONI I MADH I TETORIT DHE SHQIPËRIA E VOGËL

5 nëntor 1948

Në ka popull në botë që ta ndjejë thellë në zemrën e tij madhështinë e Revolucionit të madh të Tetorit, veprën e pavdekshme të Partisë Bolshevikë të Lenin-Stalinit, ky është populli ynë i vogël, i mjeruar, i shtypur, i gjakosur shekuj me radhë, që triumfoi në luftë të pabarabartë mbi armiqtë e jashtëm e të brendshëm e që doli në dritë në saje të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Shqipërisë, në saje të Revolucionit të madh të Tetorit dhe të veprës së tij, Bashkimit të madh Sovjetik.

Në vigjiljen e 31-vjetorit të Revolucionit të madh të Tetorit, populli ynë i hedh një sy të kaluarës së tij të hidhur, luftës së përgjakshme dhe të paprerë të tij kundër okupatorëve të ndryshëm, që valë-valë shpërthenin si stuhi mbi vendin tonë, që digjinin e shkatërronin çdo gjë nën thundrën e tyre, por që kurrë nuk kanë qenë të zot të mposhtnin popullin tonë të vogël dhe t'ja hiqnin nga duart dogranë e tij, me të cilën ai lufkonte nëpër male për të mbrojtur jetën, dhe për të fituar lirinë e pavarësinë.

Në vigjiljen e 31-vjetorit të Revolucionit të madh të Totorit, populli ynë i hedh një sy të kaluarës së tij, kur imperialistët e ndryshëm amerikanë, anglezë, francezë, italianë, austro-hungarezë, gjermanë, grekë e jugosllavë vërsuleshin si qen mbi popullin tonë të vogël, për ta copëtar, për ta skllavëruar, për ta bërë monedhë tregëtie; populli ynë u hedh një sy vjetve të Luftës së parë botërore, kur vendi ynë u copëtua dhe u okupua nga të huajt, kujton Luftën e Vlorës me fshatarët dhe Selam Musanë, kujton Kongresin e Lushnjës, kujton përpjekjet e punëtorëve dhe të fshatarëve të Shqipërisë kundër skllavërimit dhe shtypjes së bejlerëve dhe gjakpirësve të tjerë. Dhe populli ynë mendon se cila ishte ajo forcë e madhe që e shtynte vegjelinë e Shqipërisë të luftonte me ashpërsinë më të madhe për pavarësinë dhe për tokën. Kjo forcë e madhe ishte Revolucioni i madh i Totorit dhe populli ynë e shprehu haptas dhe me guxim në 1924, përpara fytyrës së gjakosur të armiqve të tij të betuar, imperialistëve të ndryshëm, dashurinë dhe besnikërinë e tij ndaj gjeniut të madh të revolucionit, të madhit Lenin, dhe ndaj popujve të Bashkimit Sovjetik, mirënjojen e pafund të popullit tonë që përulej me dhimbje të thellë për humbjen e madhe që pësoi proletariati ndërkombëtar dhe gjithë popujt e skllavëruar të botës¹. Dashuria e popullit shqiptar që tregonte për shtetin e madh socialist, BRSS, do të mbytej në gjak e do të shtypej nën robërinë e satrapit, Ahmet Zogut, vasalit të imperialistëve, agjentit të Romës

¹ Me këmbënguljen e Avni Rustemit dhe të deputetëve përparimtarë, Asamblea Kushtetuese më 4 shkurt 1924 mbajti pesë minuta pushim për vdekjen e V.I. Leninit.

fashiste, që u hapi rrugën fashistëve të Musolinit që pushtuan vendin tonë më 7 prill të vitit 1939.

Por populli ynë, që kurrë s'e ka duruar robërinë, u çua i téri në këmbë për të luftuar fashizmin dhe sytë e popullit tonë, në momentet më të rënda, ishin drejtuar nga Moska, nga drita e Kremlinit, nga Stalini i madh, shoku i shtrenjtë i Leninit, udhëheqësi i lavdishëm i popujve sovjetikë dhe i Ushtrisë famëmadhe Sovjetike.

Revolucioni i madh i Tetorit, që shpërtheu në burgun e popujve me një suri aq të madhe që kurrë s'kish parë bota, çlroi qindra milionë njerëz nga zgjedha e kapitalit dhe e plutokracisë cariste dhe ngriti në një të gjashtën e botës socializmin, krijoj shtetin më të fuqishëm në botë: Bashkimin e Republikave Socialiste Sovjetike. Duke mos mundur dot të mposhtnin forcën e madhe të popujve dhe të shtetit socialist me anën e blokadës, të zjarrit dhe të hekurit, imperialistët dhe gjithë shërbëtorët e tyre, që mbanin nën zgjedhë popujt e tjerë të Evropës dhe të botës, u përpoqën të ndalonin përhapjen e ideve të mëdha të Revolucionit të madh të Tetorit. Por një gjë e tillë ishte e kotë dhe e pamundur, sepse e vërteta e Revolucionit të madh të Tetorit ishte e pathyeshme, ishte e pavdekshme, pse ajo ishte dufi i madh e shprehja e fuqishme e aspiratave shekullore të njerëzimit të shtypur që shpërthenin me të gjithë forcën e madhështinë e tyre dhe bëheshin një realitet i pamposhtur në atdheun e lavdishëm të Sovjetëve.

Më Revolucionin e madh të Tetorit, një epokë e re hapej përpara njerëzimit; idetë e Marksit-Engelsit-Leninit-Stalinit triumfuan plotësisht në një vend të botës, i cili do të bëhej shtylla e çelniktë dhe mbrojtësi i të

gjithë popujve të mëdhenj e të vegjël që aspironin të çliroheshin nga thundra e imperialistëve dhe e klikave gjakpirëse kapitaliste dhe feudale të tyre.

Populli ynë i vogël, kurdoherë i rrethuar nga armiq imperialistë, tani e kuption fare mirë ngajeta e tij plot vuajtje se, pa Revolucionin e madh të Totorit dhe pa ekzistencën e shtetit të fuqishëm të socializmit, nuk do të mund ta kishte shpërthyer këtë rreth të zjarrtë që e rrethon.

Populli shqiptar, çdo gjë të tijnë e lidh me Bashkimin Sovjetik. Luftën e vet më të madhe që ka bërë gjatë historisë së tij, populli ynë e lidhi me luftën heroike të Bashkimit Sovjetik; me Bashkimin Sovjetik populli ynë qëndroi deri në fund. Dhe ne triumfuam në saje të luftës sonë të vendosur e të luftës ngadhnjmëtare të popujve sovjetikë, në saje të Ushtrisë së çelnicëtë Sovjetike, pjella e popujve sovjetikë dhe e Revolucionit të madh të Totorit, të udhëhequr dhe të edukuar nga kapiteni i madh i kohërave tona J.V. Stalini.

Populli ynë u hodh në luftë me besimin më të madh në fitore, pse ai kish besimin më të madh te Bashkimi Sovjetik, te Partia Bolshevikë dhe te shoku i madh Stalin, të cilët luftonin për të mposhtur hitlerizmin, detashment sulmues i imperializmit, armiku i betuar i punëtorëve, i fshatarëve dhe i të gjitha masave punonjëse të vendeve të ndryshme. Populli ynë u hodh me besimin më të madh në Luftën nacional-çlirimtare, pse udhëhiqej nga Partia Komuniste e tij, detashmenti i organizuar, pararoja e masave punonjëse të vendit tonë dhe pse kjo pararojë ishte e frymëzuar e udhëhiqej në rrugën e saj nga müsimet e Leninit e të Stalinit dhe se

i qëndronte besnikë kauzës së Lenin-Stalinit, që ishte njëkohësisht kauza e madhe e shpëtimit të popullit tonë. Partia jonë e udhëhoqi drejt popullin në rrugën e fitores, ajo diti të shtojë në zemrat e popullit tonë luftëtar, dashurinë ndaj Bashkimit Sovjetik, diti të ngjallë në popullin tonë, në radhët e punëtorëve, të fshatarëve dhe të gjithë patriotëve të vendit tonë, entuziazmin më të madh për Bashkimin Sovjetik. Në traktin e Partisë Komuniste të Shqipërisë të hedhur në vitin 1942 ndër të tjera thuhej:

«Komunistë të Shqipërisë!... Merrni shembull nga Partia Bolshevik e të jeni me të vërtetë në ballë të luftës popullore çlirimtare duke mos kursyer as jetën. Në këtë mënyrë keni për të qenë në vendet më të rënda dhe më të rrezikshme. Shokë komunistë, Partia juaj ju thërrret që të depërtoni, të mobilizoni, të lajmëroni të gjithë ata që janë të ndershëm dhe që duan të derdhin gjak për lirinë. Shokë komunistë, ngrini lart flamurin e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit dhe betohuni që do ta mbani lart dhe me ndër këtë flamur në këtë luftë që shtrihet para nesh, për zhdukjen e armikut më të madh të njerëzimit, fashizmit»¹.

Ky besim i Partisë ndaj atdheut i të madh të socializmit dhe shokut Stalin ishte besimi i popullit tonë, i cili, duke luftuar, pa kursyer, krah për krah, ishte i sigurt se

¹ «Dokumenta kryesore të PPSH», vëll. I, f. 75. Tiranë, 1960

gjak i derdhur, nuk do t'i shkonte dëm; ai do të reali-
zonte ëndrrën shekullore, do të merrte pushtetin në
duart e tij, do të vendoste regjimin e tij populor dhe
nuk do të bëhej më plaçkë tregu nga imperialistët dhe
neofashistët, pse Bashkimi Sovjetik, që ishte shpëtim-
tari i madhi i tij nga kthetrat e fashizmit gjerman, do të
ishte dhe mbrojtësi më i madh e më besnik në kohën e
pasluftës, në kohën kur ndërtohej dhe forcohej në ven-
din tonë demokracia e re. Nuk kaluan shumë kohë nga
mbarimi i Luftës së dytë botërore, që imperializmi amerikan
dhe anglez filluan haptas luftën e tyre kundër
vendit tonë të vogël, që po ndërtonte në paqe jetën e
tij, që po shëronte plagët e mëdha të luftës. Anglo-
amerikanët synonin të rrëzonin regjimin e demokracisë
popullore në Shqipëri dhe të vendosnin regjimin e bej-
lerëve dhe të kapitalistëve, regjimin e agjentëve dhe të
spiunazhit amerikan, ta bënин Shqipërinë një fushë
intrigash për penetracionin e tyre në Ballkan, ta bënин
një Greqi monarko-fashiste të dytë. Por ata dështuan
në çdo vepër të tyre djallëzore. Vendi ynë u mbrojt me
vendosmëri nga Bashkimi Sovjetik dhe nga Stalini i
madh. Populli ynë u ndihmua përsëri nga Partia Bol-
shevike dhe nga shoku Stalin, kur grupi trockist Tito
u përpoq të aneksojë Shqipërinë dhe ta kolonizojë këtë.
Partia Bolshevikë, me letrat e saja historike e armatosi
Partinë tonë të shohë gabimet e rënda të udhëheqjes
jugosllave dhe të luftojë e të triumfojë mbi intrigat e
poshtra të grupit trockist Tito, që kishin për qëllim
shkatërrimin e Shqipërisë sonë të re, shkatërrimin e
Partisë sonë dhe degjenerimin e Republikës sonë në një
shtet borgjez.

Bashkimi Sovjetik, që në ditët e para të pasluftës, e ndihmoi Shqipërinë politikisht dhe ekonomikisht; në momentet më të rënda ai s'e la popullin tonë të vuante për bukë.

Ndihma e madhe e Bashkimit Sovjetik, që i dha dhe i jep popullit tonë për të ndërtuar socializmin, jetën e tij dhe të brezave të ardhshëm të Shqipërisë, ishte një nga faktorët kryesorë të përparimit të vendit tonë, nga ana ekonomike, politike, sociale dhe kulturale.

Ndërgjegjja e masave të gjera të popullit tonë është ngritur nga të gjitha këto përpjekje e luftëra që ka bërë. Ato kanë parë qartë se e ardhmja e tyre, indipendenca e sovraniteti janë të lidhura me Bashkimin Sovjetik, kështjellë e paqes dhe e lirisë në botë. Prandaj sot në vigjiljen e 31-vjetorit të Revolucionit të madh të Tetorit, populli ynë me Partinë e tij Komuniste në krye, e forcon edhe më tepër dashurinë e miqësinë ndaj Bashkimit Sovjetik. Populli ynë me Partinë në krye është rreshtuar fuqimisht në kampin demokratik antiimperialist, në krye të të cilit qëndron Bashkimi Sovjetik i udhëhequr nga Stalini. Populli ynë, si gjithë popujt e tjerë paqedashës dhe përparimtarë, për asnjë minutë nuk do t'i largohet politikës së urtë dhe tejpamëse, politikës shpëtimtare staliniane, por do të luftojë me të gjitha forcat e veta për ta mbrojtur këtë politikë të lavdishme, pse kështu ka mbrojtur jetën e tij dhe të gjeneratave të ardhshme nga kërcënimet e një lufte të tretë që po e pregatisin me ethe ujqërit imperialistë amerikanë dhe gjithë kampi imperialist dhe antidemokratik. Por kauza e paqes dhe e sigurimit në botë që e mbrojnë me vendosmëri Bashkimi Sovjetik e popujt e demokrative popullore dhe

gjithë masat e gjera punonjëse të botës, do të triumfojë, pse Bashkimi Sovjetik me planet e mëdha staliniane po forcohet dita-ditës dhe forcat e demokrative popullore rriten dita-ditës, zmadhojnë potencialin e tyre ekonomik në saje të ndihmës së gjithanshme që u jep Bashkimi Sovjetik. Në saje të eksperiencës së madhe të shtetit sovjetik, në saje të politikës së tij të drejtë dhe të mësimave të shokut Stalin, popujt tanë po fitojnë dita-ditës një forcë të madhe, një siguri dhe një mprehtësi politike dhe teorike, që na bëjnë të fuqishëm për të zgjidhur probleme të rënda që na vihen përpara dhe për të luftuar me ashpërsinë më të madhe imperialistët, kapitalizmin dhe gjithë shërbëtorët e tyre.

Partia jonë, që udhëheq popullin në rrugën e socializmit, është e ndërgjegjshme për detyrat e saja të rënda që ka para popullit tonë dhe ajo do t'i kryejë me ndershmëri këto detyra, pse ajo do të dijë të ecë në rrugën e marksizëm-leninizmit, në rrugën e lavdishme të Partisë Bolshevikë, në rrugën e mësimave të Stalinit të madh. Partia jonë do t'i kryejë me nder detyrat e saja, pse ajo do t'i qëndrojë besnikë deri në fund marksizëm-leninizmit dhe do ta ngrejë kurdoherë lart flamurin e internacionallizmit proletar. Nën këtë flamur të lavdishëm populli ynë do të mobilizohet i téri për ndërtimin e socializmit, ashtu sikundër u mobilizua i gjithë në luftën e madhe të çlirimit.

Duke festuar 31-vjetorin e Revolucionit të madh të Totorit, i gjithë populli ynë i drejton Bashkimit Sovjetik, Partisë Bolshevikë dhe mikut më të shtrenjtë të tij, Stalinit të madh, mirënjohjen e tij të thellë. Populli ynë i vogël do ta festojë ditën e Revolucionit të Totorit, si një

nga datat e mëdha të jetës së tij, pse me këtë ditë janë të lidhura fitoret e popullit tonë. Ne do ta ndërtojmë të ardhmen tonë të lumtur ashtu si na mëson Stalini dhe do ta mbrojmë atë nga çdo kërcënim imperialist, ashtu si na mëson Stalini.

Partia jonë Komuniste, në vigjiljen e 31-vjetorit të Revolucionit të madh të Totorit dhe në vigjiljen e Kongresit I të saj do të forcojë punën dhe radhët e saj dhe, duke u udhëhequr kurdoherë nga mësimet e mësuesve tanë të mëdhenj Marks-Engels-Lenin-Stalin, ajo do të vëré të gjitha forcat për të përfituar sa më shumë nga ndihma që na jep Bashkimi Sovjetik, do të përfitojë sa më shumë nga eksperiencia e lavdishme e Bashkimit Sovjetik dhe e Partisë Bolshevik, do të ndjekë me besnikëri mësimet e të madhit Stalin. Partia jonë, që shpëtoi nga kthetrat e trockistëve nacionalistë të Beogradit dhe ndihmësave të tyre shqiptarë, do të jetë e pamëshirshme për t'i goditur këta armiq të Bashkimit Sovjetik, të kampit të socializmit dhe të popullit tonë. Partia jonë do t'i spastrojë radhët e saja dhe do t'i forcojë këto radhë duke e mbajtur Partinë kurdoherë në aftësinë lufttarake e kurdoherë të gatshme, të mbrojë vijën e drejtë të saj, të mbrojë marksizëm-leninizmin, kundër deviacioneve nacionaliste dhe trockiste, të mbrojë popullin tonë nga armiq të e jashtëm dhe të brendshëm që kërkojnë t'i bëjnë varrin.

Lavdi Revolucionit të madh të Totorit, që i udhëhequr nga gjenia e Leninit dhe Stalinit, krijoj në një të gjashtën e botës shtetin e madh të socializmit, që ndriçon rrugën e gjithë popujve përparimtarë të botës!

Lavdi Partisë së madhe Bolshevik të Lenin-

-Stalinit, që udhëhoqi Revolucionin e madh të Teturit, që udhëhoqi me lavdi popujt heroikë të Bashkimit Sovjetik në ndërtimin e shtetit të fuqishëm sovjetik, atdheun e socializmit, që krijoi dhe edukoi Ushtrinë e lavdishme Sovjetike, e cila u mbulua me lavdi në luftën më të madhe që ka parë njerëzimi!

Rroftë shoku i madh Stalin, mësuesi dhe edukatori ynë i lavdishëm, miku më i shtrenjtë dhe më i dashur që ka populli ynë në zemrën e tij!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 1(22), 5 nëntor 1948*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Zëri i Popullit»,
Nr. 1(22), 5 nëntor 1948*

FJALA E MBAJTUR NË MITINGUN E ORGANIZUAR NË VLORE

24 dhjetor 1948

I dashur popull i Vlorës,
Punëtorë dhe fshatarë,

Brohoritjet tuaja sot në këtë miting janë për Partinë tonë heroike të Punës, vazhduesja e Partisë së lavdishme Komuniste, që udhëhoqi Luftën nacional-çlirimtare e që tani udhëheq popullin tonë në ndërtimin e socializmit, janë për atë Parti që na mëson ne të ndërtojmë një jetë më të lumtur për brezat e ardhshëm. Unë jam ngarkuar nga Komiteti Qendror dhe Byroja Politike e KQ të Partisë t'i sjell popullit heroik të Vlorës përshtendetjet më të përzemërtë e më shoqërore. Për Partinë tonë, për popullin tonë, Vlora kreshnikë është një nga vratat e shquara të heroizmave dhe të përpjekjeve të kohërave të kaluara dhe të aférme; populli i Vlorës kurrë nuk ka kursyer jetën e vet, por është hedhur në tym dhe në flakë për çlirimin e vendit. Populli punonjës vlonjat, punëtorët dhe fshatarët e Vlorës janë një nga mbështetjet më të çelnikta të Partisë sonë.

Ju e dini, qytetarë të dashur, se në fillim të nëntorit

në Tiranë u bë Kongresi I i PKSH dhe keni dëgjuar mbi punimet e rëndësishme që u zhvilluan në atë kongres. Këto punime kanë pasë si qëllim të vetëm: t'u shërbenin interesave të popullit. Për këtë gjë Komiteti Qendror i Partisë më ka dërguar posaçërisht që të punoj në organizatën tuaj të Partisë, vendimet e kongresit, të takohem me popullin e Vlorës dhe të qajmë hallet tona. Populli ynë duhet të marrë dijeni mbi çka u vendos në kongres, sepse ato vendime do të zbatohen me popullin e në interes të popullit. Armiqtë e popullit dhe të Partisë sonë janë përpjekur që të shkëputin Partinë tonë nga masat. Kontaktet e Partisë sonë me masat nuk kanë qenë si duhet. Në këtë drejtim kanë dëmtuar trockistët jugosllavë dhe bashkëpunëtorët e tyre Koçi Xoxe, etj. Partia jonë duhet të lidhet ngushtësisht me popullin dhe mos të ndahet asnjë sekondë prej tij, pse vdes. Jeta dhe forca e Partisë sonë është në popullin. Aq sa është e drejtë për Partinë kjo gjë, po aq është edhe për çdo anëtar partie veçanërisht. Shoku Stalin ka thënë:

«Unë mendoj se bolshevikët na kujtojnë heroin e mitologjisë greke, Anteu. Edhe ata, si Anteu, janë të fortë, sepse i ruajnë lidhjet me nënën e vet, me masat që i kanë lindur, ushqyer dhe rritur. Dhe derisa ta mbajnë lidhjen me nënën e vet, me popullin, ata i kanë të gjitha mundësitë që të mbeten të pathyeshëm»¹.

Edhe anëtarët e Partisë sonë, vetë Partia jonë, në rast se nuk mbështetet në popull, humbet. Pra Partia rron dhe lufton për popullin. Vija dhe programi i Partisë s'janë gjë tjetër veçse detyrat për ta çuar popullin

¹ J.V. Stalin, Veprat, vëll. 14, f. 136.

në një jetë më të lumtur, më të begatshme, më të kulturuar, për ta çuar në socializëm. Ky është qëllimi i shenjtë i Partisë sonë.

Kongresi i Partisë e studjoi këtë problem jetik, studjoi vijën dhe caktoi detyrat për Partinë. Për ta ndërtuar këtë jetë, Partia jonë udhëhoqi popullin në luftë kundër okupatorëve, tradhëtarëve, bejlerëve, agallarëve dhe kapitalistëve. Me luftën dhe përpjekjet e Partisë dhe të popullit tonë, ne do të ndërtojmë një jetë më të mirë, për ata që kanë vuajtur gjithë jetën, për ata që e meritojnë. Konditat për të realizuar këto fitore u arritën nëpërmjet Luftës nacional-çlirimtare. Eksperienca e Partisë Komuniste të Shqipërisë, eksperienca e Bashkimit Sovjetik, e Partisë Bolshevikë dhe mësimet e Leninit e të Stalinit na ndriçuan rrugën për çlirimin e Shqipërisë.

Populli ynë, tërë jetën, shekuj me radhë ka luttuar. Nuk duhet të harrojmë luftërat e popullit tonë nën drejtimin e Skënderbeut. Armiqtë trockistë jugosllavë e shqiptarë deshën ta injorojnë historinë e popullit tonë. Por luftërat e popullit tonë janë thesar. Për një çerek shekulli populli ynë me Skënderbeun luftoi heroikisht kundër zaptuesve dhe çuditit botën me trimërinë e tij.

Fshatarësia jonë ka luftuar vazhdimisht gjatë shekujve për të drejtat e veta. Në shekullin e 15-të u bë kryengritja e fshatarëve të Himarës dhe në shekullin e 17-të fshatarësia e Mirditës, e Dukagjinit luftoi me trimëri kundër feudalëve gjakpirës dhe turqve okupatorë. Revolta e madhe e fshatarësise e udhëhequr nga Zylyftar Poda, lëvizja e vegjëlisë fshatare në kohën e tanzimatit e udhëhequr nga Rrapo Hekali kundër Sulttanit dhe

feudalëve Vrionas, lëvizja e Shalës në shekullin e 19-të, ajo e fshatarëve të Plugut dhe e bajrakut të Dibrës në fillimin e shekullit të 20-të, kryengritja e fshatarëve të varfër të Shqipërisë së Mesme, e ashtuquajtur nga feudalët «Kryengritja rebete» nën udhëheqjen e Haxhi Qamilit, kundër Esat Pashë Toptanit dhe feudalëve të Tiranës, të Beratit dhe të Elbasanit, tregojnë ngritjen dhe forcën revolucionare të vegjëlisë fshatare, që me shekuj ka luftuar kundër shkelësve dhe feudalëve.

Epopeja e Luftës së Vlorës, që këndon heroizmat e fshatarësisë, e cila mundi dhe hodhi në det imperialistët italianë, tregon vendosmërinë e popullit tonë për të fituar lirinë. Imperialistët italianë e qanë Vlorën me lot gjaku, e qau Musolini asi kohe Vlorën tonë të bukur dhe të lavdishme. Musolini gjakatar e shkeli përsëri Vlorën më vonë, por përsëri ai u hodh në det nga bijtë e atyre që shkruajtën epopenë e 1920-s dhe nga bijtë e gjithë Shqipërisë. Vlora, Sazani dhe Karaburuni janë vatrata tona, ato kurrë nuk do t'i shkelë armiku i përjetdetit. (Populli thërret: «*Jemi gati që t'i mbrojmë*»).

Po shokë, do t'i mbrojmë, do t'i mbrojë populli ynë heroik që bëri luftën e madhe të çlirimt, sepse ai ka në krye Partinë e tij heroike dhe pse ka aleatin e fuqishëm, Bashkimin Sovjetik e të madhin Stalin. Këta faktorë, në të kaluarën nuk ekzistonin, prandaj populli ynë, megjithëse luftonte, nuk fitonte. Tani këta faktorë ekzistojnë, prandaj populli ynë luftoi e fitoi dhe kurdoherë do të fitojë në rrugën e tij për ndërtimin e socialistizmit.

Kemi plot 4 vjet që dualëm nga lufta. Patëm humbje të mëdha në njerëz, shkatërrime të mëdha, por ne nuk

u dekurajuam. Forca e popullit tonë u shtua, populli kuptoi se marrja e pushtetit në duar qe gjëja kryesore, që do të zgjidhte gjithshka. Me pushtetin populor u ndërtuan shumë gjëra, u përmirësua ekonomia,jeta e vendit dhe do të bëhej edhe më tepër, po mos të ishte puna trockiste armiqësore e udhëheqjes jugosllave dhe e bashkëpunëtorëve të tyre këtu. Ju e dini se Shqipëria, si vend i vogël, kishte nevojë për miq e për ndihmë. Me cilët vende dhe popuj duhej të lidhej vendi ynë? Patjetër me ata që luftuan kundër fashizmit e në radhë të parë me Bashkimin Sovjetik, mandej me popujt e demokrative popullore e popujt fqinjë të Jugosllavisë. Populli ynë u lidh me popujt e Jugosllavisë. Kjo qe e drejtë dhe në interes të të dy popujve, në interes të kampit të socializmit. Në bazë të këtyre lidhjeve do të zhvilloheshin marrëdhënjet midis dy vendeve tona. Ju vetë keni parë vështirësitë e mëdha gjatë këtyre katër vjetve. Populli ynë punonte kudo: në bujqësi, në hekurudhë, në kantiere e në fronte të tjera, por Komiteti Qendror trockist i PK të Jugosllavisë i shtrembëroi akordet. Trockistët synonin të mbytnin vrullin krijues të popullit tonë. Ata u bënë pengesë për realizimin e planeve tona, gjë që vështirësoi gjendjen tonë ekonomike. Në aparatin e shtetit u futën edhe metoda të padrejta. Pushteti filloi të ikte nga duart e popullit. Ligje e sidomos urdhëresa, parimisht të gabuara ose edhe të drejta, janë zbatuar në disfavor të popullit. Mungonte bashkëpunimi me popullin, nuk merrej mendimi i tij. Të gjitha këto veprime, trockistët jugosllavë dhe tanët, i mbulonin me parullën: «Luftojmë për të drejtën e punëtorëve dhe të fshatarëve të varfër». Por këto veprime kishin

për synim të sillnin në fuqi armiqtë e popullit, gjakpirësit, borgjezët dhe feudalët.

Të gjitha urdhëresat, ligjet mbi grumbullimin, tatumet etj., që në parim ose në zbatim kanë qenë të gabuara, do të korrigohen. Nuk është dëgjuar zëri i masës si duhet, nuk është dëgjuar zëri i fshatarit të varfër dhe të mesëm. Në zyrat e pushtetit ishte futur fryma e akraballëkut, ato filluan të bëheshin të disave e jo të popullit. Pushteti është i punëtorëve dhe i fshatarëve dhe jo i miqve dhe i farefisit të njërit dhe të tjeterit. Kështu kanë vepruar trockistët. Këto gjëra duhen zhdukur. Populli ta ngrejë fort zërin, kur sheh padrejtësi dhe, kur shikon se nuk ndreqen gabimet e kritikuara, të rrëzojë ato komitete ekzekutive ose ata njerëz që nuk veprojnë mirë. Populli ka në dorë këtë armë të shëndoshë që i jep Kushtetuta e Republikës sonë Popullore. Nëpunësit janë shërbëtorët e popullit dhe nuk duhet të rrinë të ngrechur si kokoshë. Për komunistët është nder i madh t'i shërbejnë popullit. Nëpunësit e mirë nuk e kanë mendjen te orari, por në rezultatet e punës.

Kongresi theksoi që pushteti dhe Partia të kenë mendjen në këto gjëra. Të vihet në vend drejtësia. T'u jepe fund metodave të kohës së luftës. Mos të flaket tjetri jashtë shtëpisë më të kotë. Në këtë rast t'u thuhet drejt njerëzve se jemi ngushtë, prandaj duhet të ngushtohemi. Kur t'ua shpjegojmë drejt, ata do ta kuptojnë dhe ata kanë dhënë prova se e kuptojnë dhe e pranojnë këtë. Të shikohen mirë hallet e popullit e në radhë të parë të luftëtarëve, të punëtorëve, të fshatarëve të varfër e të mesëm, por jo të pasanikëve. Shumë mirë

e tha një shoqe në aktivin e Partisë: «Këndej e taton spekulatorin, andej fut në punë me rrogë tre vetë të familjes së tij. Na rroftë lufta e klasës. Doli nga dera dhe hyri nga penxherja».

Partia i këshillon njerëzit për më pak llafë, por të shikohen mirë hallet e popullit, të ketë më tepër kujdes, p.sh., për lagjen e «Llonxhës» dhe për familjet e 600 vetëve, që humbën jetën në tokat e Gjermanisë.

Kanë ngjarë gjëra të padrejta; të tilla kanë ngjarë edhe në Vlorë. Por këto gjëra muarën fund. Shpëtoi populli ynë, Partia jonë, Republika jonë. Ne kemi lidhur marrëveshje tregtare me Bashkimin Sovjetik, me Bullgarinë dhe do të na ndihmojnë me kredi Rumania, Polonia dhe Hungaria. Kur premë marrëdhënjet me trockistët, thanë se ne mbaruam, se mbetëm të rrëthuar midis Titos dhe Calderosit. Ne as u izoluam, as u dobësuam, por dualëm më të fortë se kurrë. Bashkimi Sovjetik na ka akorduar kredi, do të vijnë fabrika për tekstile, për sheqer dhe për lëkurë c të tjera. Brenda dy vjetve ne do të prodrojmë vetë veshmbathje e sheqer për nevojat e vendit dhe, me ndihmën e Bashkimit Sovjetik, do të ngremë në të ardhmen shumë fabrika të tjera. Bujqësia do të përparojë, sepse Partia i kushton një kujdes të veçantë. Bujku ynë është përparimtar. Ai, me punën e tij, do të prodrojë gjithnjë e më tepër duke pasur gjithmonë parasysh se do t'i shërbçjë më mirë kolektivitetit. Fshatarët e varfër dhe të mesëm duhet të lidhen me punëtorët e qytetit si dy vëllezër në një shtëpi. Armiqtë luftojnë kundër kësaj aleance. Partia dhe pushteti do të luftojnë kundër kulakëve, armiqve të fshatarëve të varfër dhe të mesëm, armiqve të gjithë popullit tonë. Kula-

kët luftojnë urdhëresat dhe ligjet e pushtetit tonë, pëshpërisin kundër pushtetit, grumbullojnë bereqetin, spekulojnë duke bërë tregun e zi e të tjera. Ne i shikojmë punët e tyre dhe do t'i godasim me forcë. Fshatarët e varfër dhe të mesëm, në aleancë me punëtorët, nën drejtimin e Partisë, duhet të godasin kulakun në fshat dhe borgjezinë në qytet. Ne duhet ta mbajmë të ndezur luftën e klasave kundër pasanikëve, kundër kapitalistëve të qytetit dhe të fshatit.

Përsa i përket arësimit, Partia do të vërë të gjitha forcat që populli ynë të përparojë. Nuk mundet të ndërtohet dhe të shkojë përpara Republika jonë Popullore, pa arësim dhe pa dituri. Duhet patjetër që njerëzit e luftës, njerëzit besnikë të popullit të armatosen me dituri. Populli do shkolla, do kulturë. Me shumë të drejtë malësorët e Veriut i kërkojnë pushtetit tonë shkolla, spitale dhe rrugë. Partia dhe pushteti e dëgjon zërin e popullit.

Duke ndjekur dhe duke zbatuar vijën e Partisë, shokë qytetarë dhe fshatarë të Vlorës, ne do të shkojmë të sigurtë në socializëm. Socializmi në botë ecën me hapa të mëdhenj, kurse imperializmi po pëson disfata. Për të shkatërruar bashkimin e punëtorëve, për të dobësuar ndërgjegjen e klasës dhe solidaritetin ndërkombëtar, për të lehtesuar realizimin e politikës së tij të klasës dhe të planeve të tij ekspansioniste dhe skllavëruese, imperializmi po përdor armën e tij të helmatosur, nacionalizmin borgjez. Këtë armë imperializmi përpinqet ta përdorë kundër socializmit, që po zgjerohet triumfues. Partia jonë, si gjithë partitë revolucionare, bazohet mbi mësimet e Leninit dhe të Stalinit. Lenini thotë: «Na-

cionalizmi borgjez dhe internacionalizmi proletar janë dy parulla armiqësore të papajtueshme, që u përgjigjen dy kampeve të mëdha klasore në të gjithë botën kapitaliste dhe që shprehin dy politika»¹. «Deviacioni në anën e nacionalizmit pasqyron orvatjet e borgjezisë «vendase», «nationale» për të shkallmuar regjimin sovjetik dhe për të rivendosur kapitalizmin»² — thotë Stalini. Me parullat e nacionalizmit borgjez, shtetet imperialiste dhe agjenturat e tyre kudo në botë luftojnë kundër Bashkimit Sovjetik, kundër gjithë partive komuniste e punëtore, kundër kampit të socializmit. Ata thonë se komunistët gjoja qenkan të shitur te Moska. Kështu ata luftojnë edhe Partinë tonë. Qëllimi i tyre është që të ndajnë Partinë nga populli. Pas Revolucionit të Totorit u ringjallën shpresat e vegjëlisë në vendin tonë dhe, megjithëse regjimet e atëhershme folën shumë kundër Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Bolshevik, populli ynë nuk i hëngri këto. Kur fashizmi okupator zaptoi vendin tonë, populli ynë, në shembullin e patriotëve sovjetikë dhe përkrah tyre, bëri një luftë të madhe çlirimtare dhe fitoi. Ne komunistët jemi internacionalistë, jemi kundër nacionalizmit borgjez. Në këtë çështje kanë devijuar trockistët jugosllavë me Titon në krye. Ata u hodhën në nacionalizmin borgjez.

Shokë, forca e kampit tonë po shtohet gjithmonë më tepër, se në krye të kampit është Bashkimi Sovjetik, kështjella e pamposhtur e paqes dhe e socializmit, pse në krye të kampit të socializmit është strategu i madh

¹ V.I. Lenin, Veprat, vëll. 20, f. 12.

² J.V. Stalin, Veprat, vëll. 13, f. 348.

i kohërave, Gjeneralisimi Stalin. Politika e lavdishme e BS dhe e Stalinit po triumfon. Qindra miliona e përkrahin këtë.

Ju keni dëgjuar për luftën heroike të popujve të Kinës, të Kinës qindramilionëshe, populli i së cilës lufton kundër tiranisë, kundër imperializmit. Më tepër se gjysma e popullsisë është çliruar nga forcat nacional-çlirimtare dhe është vendosur pushteti popullor. Populli kinez lufton me besim të plotë në fitore dhe do të fitojë, se ai bën një luftë të drejtë, pse në krye e udhëheq Partia Komuniste heroike Kineze. Fitoret e mëdha të popullit kinez janë fitore për gjithë kampin e socializmit. Kudo popujt e shtypur liridashës e godasin imperializmin: në Indi, në Indonezi, në Pakistan, në Palestinë e në vende të tjera. Populli grek për 8 vjet rresht po bën një luftë heroike, kundër gjithë planeve dhe ofensivave të monarko-fashistëve dhe anglo-amerikanëve. Kampi imperialist po kalon një krizë të madhe. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë krizë për imperializmin.

Nga ana tjetër vendet e demokrative popullore po forcohen dhe përparojnë drejt socializmit. Kampi i socializmit forcohet, imperializmi kërkon të hedhë botën në një luftë të tretë botërore, por Bashkimi Sovjetik dhe gjithë popujt paqedashës, nuk do të lejojnë një gjë të tillë.

I dashur popull i Vlorës,

Të mobilizojmë të gjitha forcat tona për të zbatuar këtë vijë të drejtë të Partisë sonë, sepse kështu ne do të përmirësojmë jetën tonë, do të shkojmë në socializëm,

do të kontribuojmë në forcimin e mëtejshëm të kampit socialist dhe do t'ë bëjmë të dështojnë planet e imperializmit për një luftë të re.

Nën udhëheqjen e Partisë, përpala pür ndërtimin e socializmit!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë populli i Vlorës!

Rroftë Bashkimi Sovjetik, Partia Bolshevikë dhe Stalini i madh!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 48(69), 26 dhjetor 1948*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Zëri i Popullit»,
Nr. 48(69), 26 dhjetor 1948*

L E N D A

PARATHËNJE PËR VELLIMIN 4

V—VII

1 9 4 7

NGA BISEDA ME UDHËHEQËSIT E REDAKSISE «PIONIERI» SI DHE ME NJË GRUP PIONIERËSH (3 janar 1947)	1—12
TELEGRAM DREJTUAR MINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME TË BRSS, TË SHBA, TË ANGLISE DHE TË FRANCES, ME TË CILIN KERKOHET QË RPSH TË FTOHET SI ANËTARE EFEKTIVE NË KONFERENCËN E PAQES ME GJERMANINË (12 janar 1947)	13—15
LETËR DREJTUAR NJË NËNE QE KA MËSUAR TË SHKRUAJË E TË LEXOJË (8 shkurt 1947)	16—17
MESAZH DREJTUAR PIONIERËVE TË SHQIPËRISË, ME RASTIN E 5-VJETORIT TË KRIJIMIT TË ORGANIZATES SË PIONIERËVE (11 shkurt 1947) ..	18—23
NGA BISEDA ME UDHËHEQËSIT E RINISE PAS PLENUMIT V TE KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM TË RINISE POPULLORE TË SHQIPËRISË (6 mars 1947)	24—34

PROTESTË DREJTUAR SEKRETARIT TË PËRGJITI TIISHËM TË OKB-së KUNDËR SHKELJES SË UJE- RAVE TOKËSORE TË SHQIPËRISË (18 mars 1947)	35—30
MESAZH DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR ME RASTIN E 1 MAJIT 1947, MBAJTUR PËRPARA PO- PULLIT TË DURRESIT DHE NDËRTUESVE TË HEKURUDHËS DURRES—ELBASAN (1 Maj 1947) ..	37—53
URDHËR DITE ME RASTIN E PËRVJETORIT TË DYTE TË FITORES MBI GJERMANINË NAZISTE (9 maj 1947)	54—57
LETËR DËRGUAR ORGANIZATAVE TË PARTISE NË TERREN DHE NË USHTRI NË LIDHJE ME OPORTU- NIZMIN E SEJFULLA MALËSHOVËS DHE ME DË- NIMIN E KËTIJ OPORTUNIZMI NGA KQ I PARTISE (10 maj 1947)	58—68
TELEGRAM PROTESTE DREJTUAR SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË OKB-së NË LIDHJE ME NJË PROVOKACION TË KRYER NGA AVIACIONI GREK KUNDËR TERRITORIT TË RPSH NË RAJO- NIN PËRMET—LESKOVIK (22 maj 1947)	69—71
FJALA E MBAJTUR NË PRITJEN E ORGANIZUAR PËR NDER TË PIONIERËVE TË DALLUAR GJATE VITIT SHKOLLOR 1946—1947 (4 korrik 1947)	72—78
URDHËR DITE ME RASTIN E PËRVJETORIT TË KATËRT TË KRIJIMIT TË USHTRISË POPULLORE (10 korrik 1947)	79—81
FJALA E MBAJTUR NË KUVENDIN POPULLOR ME RASTIN E ÇELJES SË SESIONIT III TË ZAKON- SHËM TË LEGJISLATURËS SË PARË (12 korrik 1947)	82—122
PËRSHËNDETJE DREJTUAR POPUJVE TË BASH- KIMIT SOVJETIK NGA AERODROMI I MOSKËS ME	

RASTIN E VIZITËS SË DELEGACIONIT TË QEVE- RISE SË RPSH NË BRSS (14 korrik 1947)	123—125
PËRSHËNDETJE DREJTUAR POPULLIT TË LENIN- GRADIT ME RASTIN E VIZITËS SË DELEGACIONIT TË QEVERISE SË RPSH NË KËTË QYTET (23 ko- rrik 1947)	126—129
PËRSHËNDETJE DREJTUAR POPUJVE TË BASH- KIMIT SOVJETIK NGA AERODROMI I MOSKËS ME RASTIN E LARGIMIT TË DELEGACIONIT TË QE- VERISE SË RPSH NGA BRSS (26 korrik 1947)	130—132
FJALA DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR ME RAS- TIN E KTHIMIT NGA VIZITA QË BËRI DELEGA- CIONI I QEVERISE SË RPSH NË BRSS (26 ko- rrik 1947)	133—137
PËRMBLEDHJE E BISEDËS SË ZHVILLUAR ME NJË GRUP GRASH FSHATARE TË DALLUARA, QË MUARËN PJESE NË PUNIMET E PLENUMIT IV TË BASHKIMIT TË GRAVE TË SHQIPËRISË (15 gusht 1947)	138—149
PËRMBLEDHJE E BISEDËS SË ZHVILLUAR ME NJË GRUP TË RINJSH QË MUARËN PJESE NË PUNIMET E PLENUMIT VI TË RINISË POPULLORE TË SHQIPËRISË (20 gusht 1947)	150—157
SHQIPËRIA DHE VOTIMI NË KËSHILLIN E SIGU- RIMIT TË OKB-së (21 gusht 1947)	158—164
FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË FIE- RIT DHE TË QYZEQESË (29 shtator 1947)	165—174
FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË KRA- HINËS SË MALLAKASTRËS NË MITINGUN E OR- GANIZUAR NË BALLSH (29 shtator 1947)	175—185

FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË VLO- RËS (30 shtator 1947)	186—200
FJALA E MBAJTUR PËRPARA PUNËTOREVE TË MINIERËS SË SELENICËS (1 tetor 1947)	201—209
FJALA E MBAJTUR NË DRASHOVICË PËRPARA FSHATARËVE TË KRAHINAVE TË VLORES (1 te- tor 1947)	210—218
FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË KRA- HINËS SË KURVELESHIT (2 tetor 1947)	217—226
FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË GJI- ROKASTRËS (3 tetor 1947)	227—263
FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË PËR- METIT (6 tetor 1947)	264—273
FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË BE- RATIT (6 tetor 1947)	274—282
FJALA E MBAJTUR PËRPARA PUNËTOREVE TË KUÇOVËS (7 tetor 1947)	283—289
PËRMBLEDHJE E FJALEËS SË MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË LUSHNJËS (7 tetor 1947)	290—293
FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË EL- BASANIT (8 tetor 1947)	294—301
FJALA E MBAJTUR NË INAUGURIMIN E KANA- LIT VADITËS «NAUM PANXHI» (9 tetor 1947) ..	302—307
PËRMBLEDHJE E FJALEËS SË MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË POGRADECIT (9 tetor 1947)	308—314
FJALA E MBAJTUR PËRPARA PUNËTOREVE DHE FSHATARËVE TË MALIQIT ME RASTIN E PËR- FUNDIMIT TË PUNIMEVE TË PARA PËR THARJEN E KËNETËS (12 tetor 1947)	315—321

FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË KORÇËS (12 tetor 1947)	322—350
PËRMBLEDHJE NGA FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË VITHKUQIT (14 tetor 1947)	351—353
PËRMBLEDHJE NGA FJALA E MBAJTUR NË NJË TAKIM ME PUNËTORËT E KORÇËS (14 tetor 1947)	354—356
MOSKA DHE POPULLI SHQIPTAR (6 nëntor 1947)	357—381
TELEGRAM DËRGUAR J.V. STALINIT ME RASTIN E 30-VJETORIT TË REVOLUCIONIT SOCIALIST TË TETORIT (7 Nëntor 1947)	382—384
MESAZH DREJTUAR POPULLIT ME RASTIN E PËRVJETORIT TË TRETË TË ÇLIRIMIT TË ATDHEUT (29 Nëntor 1947)	385—390
FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË QYTETIT TË SOFJES NË MITINGUN E ORGANIZUAR ME RASTIN E VIZITËS SË DELEGACIONIT TË QEVERISË SË RPSH NË RP TË BULLGARISË (14 dhjetor 1947)	391—394
FJALA E MBAJTUR NË SOFJE ME RASTIN E DEKORIMIT NGA PRESIDIUMI I ASAMBLESE SË MADHE POPULLORE TË RP TË BULLGARISË (14 tetor 1947)	395—396
FJALA E MBAJTUR ME RASTIN E DEKLARIMIT QYTETAR NDERI TË QYTETIT TË SOFJES (14 dhjetor 1947)	397—398
FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT TË QYTETIT TË PLOVDIVIT ME RASTIN E VIZITËS SË DELEGACIONIT TË QEVERISË SË RPSH NË RP TË BULLGARISË (15 dhjetor 1947)	399—402

FJALA E MBAJTUR NË PALLATIN E KRITÇIMIT NË PLOVDIV ME RASTIN E NËNSHKRIMIT TË TRAKTATIT TË MIQËSISE, BASHKËPUNIMIT DHE NDIHMËS RECIPROKE MIDIS RPSH DHE RP TË BULLGARISE (16 dhjetor 1947)	403—406
DEKLARATE E BËRE PËRPARA PËRFAQËSUESVE TË SHTYPIT BULLGAR DHE TË HUAJ NË LIDHJE ME NËNSHKRIMIN E TRAKTATIT TË MIQËSISE, BASHKËPUNIMIT DHE NDİHMËS RECIPROKE, MI- DIS RP TË SHQIPËRISË DHE RP TË BULLGARISE (17 dhjetor 1947)	407—411
FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT NË MI- TINGUN E ORGANIZUAR NË TIRANË ME RASTIN E KTHIMIT TË DELEGACIONIT TË QEVERISË SË RPSH NGA VIZITA NË RP TË BULLGARISE (19 dhjetor 1947)	412—415

1 9 4 8

MESAZH DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR ME RASTIN E VITIT TË RI 1948 (1 janar 1948)	416—419
FJALA E MBAJTUR NË KUVENDIN POPULLOR ME RASTIN E RATIFIKIMIT TË TRAKTATIT TË MIQËSISE, BASHKËPUNIMIT DHE NDİHMËS RE- CIPROKE SI DHE TË KONVENTËS KULTURALE MIDIS RP TË SHQIPËRISË DHE RP TË BULLGA- RISE (3 janar 1948)	420—424
FJALA E MBAJTUR NË KUVENDIN POPULLOR, ME RASTIN E SHQYRTIMIT DHE APROVIMIT TË PROJEKTLIGJIT MBI PLANIN E SHTETIT PËR VITIN 1948 (27 janar 1948)	425—452

NGA FJALA E MBAJTUR NË KOMISIONIN E NGRI- TUR PËR ÇËSHTIJEN E URBANIZMIT TË QYTE- TIT TË TIRANËS DHE TË QYTETEVE TË TJERA TË VENDIT (19 shkurt 1948)	453—458
PËRSHËNDETJE DËRGUAR USHTRISË SË LAV- DISHME SOVJETIKE ME RASTIN E 30-VJETORIT TË THEMELIMIT TË SAJ (22 shkurt 1948)	459—461
FJALA E MBAJTUR NË SELINË E LEGATËS SO- VJETIKE NË TIRANË, ME RASTIN E MARRJES NË DOREZIM TË DEKORATËS «URDHËRI SUVO- ROV KL. I» AKORDUAR NGA PRESIDIUMI I SO- VJETIT SUPREM TË BRSS (10 mars 1948)	462—465
MESAZH DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR ME RASTIN E FESTËS SË 1 MAJIT (1 Maj 1948)	466—471
FJALA E MBAJTUR NË KUVENDIN POPULLOR ME RASTIN E PARAQITJES PËR APROVIM TË DISA PROJEKTLIGJEVE (11 maj 1948)	472—487
URDHËR DITE ME RASTIN E PËRVJETORIT TË KATËRT TË ARMËS SË NDËRLIDHJES (22 qershor 1948)	488—490
URDHËR DITE ME RASTIN E FESTËS SË 10 KORRI- KUT PESEVJETORIT TË USHTRISË POPULLORE (10 korrik 1948)	491—495
FJALA E MBAJTUR PËRPARA POPULLIT DHE REPARTEVE USHTARAKE TË GARNIZONIT TË TIRANËS, ME RASTIN E PËRVJETORIT TË PESTË TË KRIJIMIT TË USHTRISË POPULLORE (10 ko- rrik 1948)	496—501
PËRMBLEDHJE E BISEDËS SË ZHVILLUAR ME NJË GRUP SULMUESISH MË TË MIRË TË VENDIT (24 korrik 1948)	502—507

URDHËR DITE ME RASTIN E PËRVJETORIT TË PESTË TË ARMËS SË ARTILERISE (18 tetor 1948)	508—510
LETËR DËRGUAR REDAKSISË SË GAZETËS «ZËRI I POPULLIT» ME RASTIN E RIFILLIMIT TË BOTI- MIT TË KËTIJ ORGANI (5 nëntor 1948)	511—512
REVOLUCIONI I MADH I TETORIT DHE SHQIPË- RIA E VOGËL (5 nëntor 1948)	513—522
FJALA E MBAJTUR NË MITINGUN E ORGANI- ZUAR NË VLORË (24 dhjetor 1948)	523—533

Shtypur NISH Shtyp. «M. DURI», Stab. «8 NENTORI» —
Tiranë, 1970